

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**  
**“Luigj Gurakuqi”**

**BULETIN SHKENCOR**

**Seria e shkencave shoqërore**

**Viti XLI (61)**

**2011**

Shkodër, 2011

## **REDAKSIA**

*Prof. dr. Tomor OSMANI (Kryeredaktor)*  
*Prof. as. dr. Tefë TOPALLI (Sekretar shkencor)*  
*Prof. as. dr. Fatbardha HOXHA, prof. dr. Romeo GURAKUQI,*  
*MA Nevila DIBRA, dr. Meri GJELUCI (anëtarë)*

**DREJTOR I REVISTËS**  
*Prof. dr. Artan HAXHI*

**Korrektori dhe punoi në kompjutër: Arta Bajrami**

---

***Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***

---

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Redaksia e Buletinit Shkencor  
Seria e Shkencave Shoqërore  
Tel/fax: ++399 22 43747

## PASQYRA E LËNDËS

### **Alfred ÇAPALIKU**

Kolë Mirdita (Helenau). Jeta dhe vepra. Jehona.

*Kolë Mirdita (Helenau). His life and work. The Echo*..... 9

### **Shaban SINANI**

Sprovë për një periudhizim të veprës së Kadaresë

*Tentative approach at periodizing Kadaresë's work*.....17

### **Arben PRENDI**

Vazhdimësi dhe variueshmëri e stilit të Kadaresë si romancier. Romanet e shkruara pas viteve 1990

*Continuity and variety of Kadare's style as novelists The novels after 1990*.....33

### **Diana KASTRATI**

Epoka e modernizmit dhe miti i saj në Shqipëri

*The traditional myth and the modernization*.....49

### **Alva DANI**

Psikologjizmi si ndikim në letërsinë e viteve të para të 1900-tës (Pirandelo e Koliqi)

*Psychologism as an influence on the early 1900-s literature (Pirandelo and Koliqi)*.....69

### **Vjollca OSJA**

Energjia simbolike në poezitë biblike të F. Nolit

*Symbolic energy in biblical poems of F.Noli*.....79

### **Gëzim PUKA**

Fenomeni Serafin Fanko në dramën shqipe bashkëkohore

*Serafin Fanko, the phenomenon of the contemporary Albanian drama*.....85

**Alketa BEKTESHI**

Proza kuteliane midis traditës sonë krijuese popullore dhe modernitetit  
*Prose kuteliane between tradition and modernity our popular creative* .....101

**Lisandri KOLA**

Dante Alighieri përmes përkthimit të Pashko Gjeçit,  
te kënga e parë e Ferrit: përjasje. Gjurmime në tekstin dantesk  
*Dante Alighieri through the translation of Pashko Gjeçi, in the first canto of  
Hell: comparison. Researches in the Dante's text* .....111

**David LUKA**

Edhe një herë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe  
*Once more on the periodization the History of the Albanian  
Language*..... 123

**Artan HAXHI**

Familjet e gjuhëve në botë  
*Families of languages in the world*.....139

**Evalda PACI**

Disa veçori gjuhësore dhe tekstologjike në Mesharin e Gjon Buzukut  
(Vështrim i përgjithshëm)  
*Linguistic characteristics and textology in the Meshari (Missal) of Gjon  
Buzuku*..... 147

**Orjeta BAJA**

Rreth nocionit *gjuhë* përmes *artit*  
*About the notion language through art*..... . 159

**Aida URUÇI**

Ndihmesa e Martin Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare  
shqipe  
*Contributions of Martin Camaj vocabulary enrichment of Albanian  
literary language*.....165

**Irena FISTANI**

Pasurimi i shprehjeve frazeologjike shqipe e frënge, nga dialektet dhe roli i tyre, si thesare të vjera të kulturës për popujt respektiv, në mishërimin e vlerave gjuhësore, folklorike e kombëtare  
*The enrichening of Albanian and French idioms from the dialects, their role in representing the national cultural and linguistic values of the respective people*.....175

**Olese MEMA**

100 – vjetori i një fjalori dygjuhësh  
(Fjalori italisht-shqip i P.Antonio Buseti-t)  
*100 - a dictionary ANNIVERSARY OF bilingual  
(Italian-Albanian Dictionary of Antonio P. Buseti-t)*.....185

**Drita BRAHIMI**

Tre kolosë të letrave shqipe, franceze dhe amerikane, Petro Marko, Andre Malro dhe Ernest Heminguej. (Përpjekje për studim krahasues)  
*Three colossus of Albanian, French and American letters  
Petro Marko, André Malraux and Ernest Hemingway  
(comparative study attempt)*.....199

**Shpresa DELIJA**

Vendi i antonimeve në fjalorët dy-gjuhësh  
*Antonyms in bilingual dictionaries*.....205

**Rudina XHILLARI**

Evoluimi i gjuhës në përkthimet e ripërkthimet në gjuhën shqipe  
*Language evolution in Albanian translations*..... 213

**Nevila DRISHTI**

Qasje konceptuale dhe pragmatike ndaj gjenerativizmit  
*Conceptual and pragmatic approaches to generativism* .....225

**Etleva KONI**

Fjalitë pyetëse tërësore në gjuhën angleze dhe shqipe, larmia e shprehjes së tyre në gjuhën shqipe si rrjedhojë e rendit të lirë të fjalëve  
*Interrogative questions in English and Albanian, Albanian varied forms of expression due to free word order*.....237

**Rovena VORA**

Disa veçori të njësive frazeologjike foljore në gjuhën angleze e shqipe  
*English and Albanian Phrasal Verbs Their Characteristics*.....249

**Violeta SHABA**

Përdorimi në mënyrë krijuese i njësive frazeologjike: dimension i tjetër  
*The creative use of phraseological units: the other dimension*  
(Case study: English and Albanian idioms modified for use in  
*headlines*).....261

**Simon Lufi**

Historia dhe manipulimi i saj  
*History and its manipulation*.....273

**Nertila HAXHIA (LJARJA)**

Kryengritja e Malësisë së Madhe e vitit 1911  
(Mbështetur në dokumentacionin arkivor britanik të Zv.Konsullit  
Britanik në Shkodër) *The Great Highland Uprising of 1911*  
(Based on personal archival file documents of British Vice Consul  
in Scutari).....279

**Sereta KOPERAJ**

Qëndrimi britanik ndaj mbretit Zog në prag të pushtimit italian  
*British attitude towards King Zog on the verge of Italian occupation*.....291

**Hasan BELLO**

Kolonia Shqiptare e Turqisë dhe vendosja e kontakteve diplomatike  
me Perandorinë Osmane.  
*Albanian emigrants in Turkey and the establishment of diplomatic  
relations with the Ottoman Empire*.....301

**Sokol AXHEMI**

Evolucioni i hapësirës sociale të argëtimit në Shqipëri. Tendencat dhe  
perspektiva  
*The evolution of social space and perspective in Albania. Tendencies of  
entertainment in the future*.....311

**Ardita REÇI, Artan REÇI**

A është i mjaftueshëm pluralizmi i mediave për një komunikim politik funksional në demokracinë tonë?

*Is it sufficient for a plurality of media functional political communication in our democracy?.....*323

**Pranvera SKANA**

Shtypi lokal një mangësi e domosdoshme për median shqiptare

*Local press, an essential deficiency for Albanian media.....*331

**JETA SHKENCORE**

I. Veprimtari shkencore

*Scientific.....* 337

II. Promovim librash

*Work promotions.....*342

III. Jepet titulli “Profesor”

*Given the title "Professor".....*343

IV. Botime të reja të Universitetit tonë

*New editions of our University Publications.....* 344

V. Botime të pedagogëve që janë botuar jashtë shtetit

*Publications abroad.....* 345

VI. Librat e botuar gjatë vitit 2010-2011

*Books published during 2010-2011.....* 346

**ISSN 2221 - 6855**

*Doli nga shtypi në dhjetor, 2011 – Tirazhi 120 kopje – Format  
176x250 mm. Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës  
“Luigj Gurakuqi”*



Alfred ÇAPALIKU

**KOLË MIRDITA (HELENAU). JETA DHE VEPRA.  
JEHONA.**

*“Gjuha shqipe është gjaku i trupit shqiptar; sa më e begatëshme, sa më e përparuar ajo, aq më i fortë, më i gjallë trupi shqiptar”.*

E përkohshmja “Dialeria”, prill, 1920.

**Jeta dhe vepra (1900-1936)**

Kolë Mirdita u lind në qytetin e Shkodrës me 24 dhjetor 1900. Që në fëmijëri i vdiq babai. Kola ndoqi filloren e gjysmë të mesmen qytetëse dhe më tej Kolegjin Saverjan në klasat tregtare. Shkolla e jezuitëve, themeluar me 1887 qe pajisur me shtypshkronjë dhe muze, atelie artesh plastike dhe teatër 450 vendesh, bibliotekë shkencore dhe vrojtore meteorologjike, laborator kimie dhe aparat radiofonik, palestër sportive dhe kabinet fizike... Qysh më 1900 publicisti Faik Konica shkruante se ajo ishte e zonja për shumë punë të barazohej me shkollat e Francës e të Evropës. Ndërsa bashkëkohësi i Kolës, ish-nxënësi i asaj shkolle Ernest Koliqi do t'i portretizonte jezuitët:

*“Ata e lidhën rishtas menden shqiptare me qytetnin prendimore.”<sup>1</sup>*

Nga mësuesit gjuhëtarë e shkrimtarë At Antonio Busseti, At Fulvio Cordignano, At Anton Xanoni, Zef Mark Harapi, Kolë Thaçi, At Gjon Pantalija; Kola i ri mori tharmin e fjalës së shkruar dhe kultin e gjuhës së folur. Mjaft herët ai do të sjellë brumin e shqipes në sofrën e skenës.

Në shkurtin e 1914-ës interpretoi robin zezak në dramën e huaj të La Moyne-së. Po atë muaj, me shokët e tij Donat Kurti, Loro Kovaçi, Pashko Geci mori pjesë edhe tek shfaqja “Skënderbeu” e Xanonit.

Ngjarjen më të veçantë të jetës rinore ia shënon vënia në skenë e dramës “Deka e Skënderbeut”, më 1916, ku qe autor, aktor dhe regjisor, në palkun e punuar nga artisti Kolë Idromeno. Shfaqja qëndroi gjatë në repertorin e teatrit të nxënësve. U dalluan për lojën e tyre Luigj Mjeda (Skënderbeu) dhe Rrok Gjonej (sulltani). Suksesi qe i plotë. Duartrokitjet nuk ndaleshin.

Meqë vepra nuk u botua, i njohim veç skeletin skenik, në sajë të kujtesës së një spektatori entuziast: Akti i parë: pushtimi i Shqipërisë nga turqit. Akti i dytë: hyrja e Skënderbeut në Krujë. Akti i tretë: Kuvendi i Lezhës. Akti i katërt: Skënderbeu dhe i biri. Akti i pestë: porosia e fundit për bashkim.<sup>2</sup>

“Deka e Skënderbeut” i qëndroi gjykimit të kohës jo vetëm si pioniere e teatrit kombëtar, por edhe si vlerë në vetvete. Shumë vite më vonë studiuesi Kudret Velça flet:

*“Drama përshkohet nga fryma e lartë patriotike dhe tregon për një konceptim realist të veprës artistike... Ndaj arrin të bëjë një përgjithësim më të madh ideestetik nga ç'mund të bënte një kronikë historike.”<sup>3</sup>*

Në mbrëmjen e 27 nëntorit 1917 u dha premiera e dramës së dytë të Kolë Mirditës “Mojs Golemi”, por ajo u prit vakët nga gazeta “Posta e Shqipërisë”. Filip Fishta ish-shok shkollë dëshmon për dorëshkrimin e një drame të tretë, që Kolë Mirdita si natyrë e ndieshme, ndoshta nga frika e përsëritjes së kritikës, ndoshta nga trishtimi i humbjes së nënës, nuk pati guximin ta vinte në skenë. Subjekti thurej rreth një legjende pas Skënderbeut, për Gennazanon, afër Romës, ku qëndroi figurja e mbrojtëses së Shkodrës.<sup>4</sup>

Gjatë 1918-ës djaloshi brun dhe elegant do t'i zgjohen interesa të reja në letërsi e në jetë. S' do të thithë më pluhur skene, por do ta ruajë dramacitetin në poezi dhe do ta shprehë në prozë. Nga ana tjetër do të mendojë për studimet universitare larg dy zemrave të tij: motrës dhe Shkodrës. Një vështrim plot kuriozitet i rrëzëllen në fotografinë e mbarimit të shkollës, bërë në studion e Marubit.

Në vjeshtën e vitit 1919 Kolë Mirdita zgjodhi Austrinë. U nis me një valixhe të mbushur me iluzionet e një të riu pas Luftës Botërore.

Atë vend mbrojtës të interesave shqiptare preferoi për studime të thelluara në teologji e në filozofi, dyzina e personaliteteve kombëtare, paraardhëse e Kolës: shkrimtari At Anton Xanoni S.J. diplomati Prof. Dr. Gjergj Pekmezi. (Vjenë), poeti At Vinçenc Prennushi O.F.M., historiani At Marin Sirdani O.F.M. përkthyesi Dom Lazer Shantoja S.J., leksikografi Dom Nikollë Gazulli, O.F.M. melodramaturgu Dom Ndre Zadeja S.J. (Insbruk); oratori At Anton Harapi O.F.M. gjuhëtari At Justin Rrota O.F.M. (Villah); kompozitori At Martin Gjoka O.F.M. (Salsburg), etnografi At Bernardin Palaj O.F.M. publicisti Karl Gurakuqi (Grac).

Atë vend me “Kultusprotektoriat” ndaj Shqipërisë pëlqeu për arsimim të lartë, kuarteti i kulturës së re shqiptare, bashkëkohësit e Kolës: poeti Lasgush Poradeci, shkencëtari Prof. Dr. Krist Maloki (Grac), arkeologu Hasan Ceka, biografi Skender Luarasi (Vjenë), që me Helenaun formuan konstelacion.

Dega tregtare e saverjanëve të riut Kolë Mirdita i dha formimin, ndërsa drejtimin do ta merrte vetë. Për një vit në Grac (Graz) perfeksionoi gjermanishten. Pasi ndoqi për dy vite të tjera leksionet në Fakultetin e Filozofisë, u regjistrua përfundimisht në Fakultetin e Drejtësisë, po në atë qytet.

Veprimtaria patriotike e studentëve të shoqërisë “Albania” e përfshiu në vorbullën e saj që në prillin e 1920-ës. Kola është një nga tridhjetë e ca djelmoshat që ideuan programin e të përkohshmes “Dialeria”, në Café Greilinger, qendra e shqiptarëve të Vjenës:

*“... studentët shqiptarë do mundin të përmbushin detyrën e tyre duke ndihmuar në përparimin e gjuhës shqipe...”*<sup>5</sup>

Kolë Mirdita e vuri në jetë këtë program, me emrin e artist N. Helenau. Akronimi u formua nga Heine dhe Lenau, dy poetë gjermanishtshkrues, që ai i adhuronte. Helenau pati një bashkëpunim aq të ngushtë me “Dialerinë” sa dukej sikur revista nuk mund të dilte pa firmën e tij. Një novelë, fejton, tregim a poezi, por shpesh edhe më shumë u shfaqën në numrat e të përkohshmes nga prilli i 1920-ës gjer në tetor të 1922-shit, kur revista përkohësisht u ndal dhe bashkë me të edhe prurja e vullshme e Helenaut në letërsinë shqipe.

Me 1925 studentët e Gracit, në bashkëpunim me ato të Vjenës e të Linzit, të Klagenfurtit e të Insbrukut nxorën përmbledhjen “Naim Frashërit”. Përkujdesja e Kolë Mirditës dhe e Safet Butkës, e Lllazar Gushos dhe Krist Malokit për organizimin e mbledhjes përkujtimore të 25- vjetorit të vdekjes së Naimit dhe më pas për hartimin e almanakut që vërtetë e madhe. Proza poetike “Te vorri i Kombit”, shtypur mbas “Parafjalës” së grupit iniciator, u ndoq nga firmat prestigjioze të Lasgush Poradecit, Asdrenit, Lumo Skendos, Ethem Haxhiademit, prof. dr. Norbert Jokl-it etj.

Në shkurtin e 1928-ës, gjithnjë tek “Dialeria”, Helenau botoi krijimin e fundit letrar. Në korrik mbrojti disertacionin dhe u diplomua. Revista e përcolli me respekt të veçantë atë dhe shokët e tij, bashkëpunëtorë të saj:

*“Në motin 1928 mbaruan mësimet e veta Z.Z. Dr. jur. K. Mirdita, Dr. rer.pol.S.Dodbiba, Comm.. Rr.Gera e Dr. rer.pol.K.Deliana... Shpresojmë se nuk kanë me u kursye për të plotsue misionin e shenjtë që kanë kundra atdheut...”*<sup>6</sup>

Me t’u kthyer në Shqipëri, në gushtin e 1928-ës, Kolë Mirdita e nisi këtë mision. U emërua funksionar në Ministrinë e Drejtësisë. Si jurist në kryeqytet u tregua shumë aktiv. Me 1929 themeloi revistën “Jurisprudenca shqiptare” (doktrinë e drejtësi), të cilën e drejtoi dhe e redaktoi për disa vite. Që në numrin e parë të prill-maj-qershorit publikoi artikullin “Çkunorëzimi”, aq emancipues për shoqërinë e asaj kohe. Stili profesional

ka tek-tuk ndonjë xixëllimë të dikurshme arti, ndaj Kolë Mirdita edhe kësaj here mbetet interesant:

*“... në do rase të jashtëzakonshme bashkëjetimi bahet i pamundun, martesë një humnerë grindjesh e skandalesh permanente... Nji bashkëshort që i hynë martesës me ndergjegje të pastër e me qellim të mirë nuk ka nevojë të friksohet nga çkunorëzimi.” (f. 47)*

Me 1929 në Shkodër, me rastin e 50 - vjetorit të shkollës jezuite botohet përmbledhja “Kolegja Saverjane”. Emri i Kolë Mirditës figuron në vargun e ish-kolegjarëve që u shënjuan në jetën publike, si shkrimtarë, përkrah Karl Gurakuqit, Luigj Gurakuqit, Zef Harapit, Ernest Koliqit, Faik Konicës, Hilë Mosit, Lazër Shantojës, Filip Shirokës, Kolë Thaçit etj. Kolë Mirdita cilësohet aty edhe si bashkëpunëtor i të përkohshmes “Dialeria”.

Mbas këtij viti Helenaut hesht. Duket se angazhimi serioz si nëpunës në ministri, ku sistemon legjislacionin shqiptar dhe përkthen reformën agrare, ia ndal temporitmin e krijimtarisë dhe ia lë projektin e veprës së tij, të pashpalosur krejtësisht. Por ka edhe një shkak tjetër ndrydhës. Me 1932 Kola preket nga tuberkulozi gërryes. Me 3 tetor 1936 ai vdes në Itali, në sanatoriumin e Prossamasos, në Sondrio të Lombardisë. Një dorë e huaj ia mbylli sytë...

### **Jehona (1936 - ...)**

Shtypi shqiptar thaujse heshti aty për aty për humbjen e Helenaut. Veç një e përditshme e fillimtetorit 1936 në Tiranë i kushtoi Kolë Mirditës një shënim të shkurtër gazetaresk. Ndërsa e përmuajshmja “Përpjekja shqiptare” e kryeqytetit e cilësoi ngjarje të muajit për mbarë vendin, shuarjen e Kolë Mirditës. Poeti i ri Andrea Varfi, pas analizës reale të krijimtarisë dhe vështrimit panoramik të jetës së Helenaut, e përmbyll artikullin:

*“Djelmënia humbi një shok, një idealist dhe një militant aktiv në fushën e kulturës dhe të intelektit”.<sup>7</sup>*

Amplituda e jetës fizike të Kolë Mirditës ka më tepër kontraste se sa harmoni. I shkolluar për tregti u mor me filozofi. Nga aktor amatoresk u kthye në shkrimtar fin. Nga jetim i pangushëllueshëm u bë frymëzues atdhetar. Nga lëvrues i gjuhës shqipe u shfaq përkthyes i gjermanishtes. Nga bashkëpunëtor të përkohshmeje letrare arriti në drejtor reviste profesionale. Nga krijues dramash u shpall gjykatës çështjesh. Nga i ri energjik u shënjuan i sëmurë fatal.

Frekuenca e jetës artistike të Helenaut është mes prozës elegante dhe poezisë së kultivuar, mes perlave të folklorit dhe xhevahireve botërore, mes

koloritit të ndritshëm dhe monokromit gri, mes Naimit dhe Leopardit, mes luleve dhe vajzave, mes të gjallëve dhe të vdekurve, mes pasionit dhe zhgënjimit, mes Shkodrës dhe Gracit, mes influencave kulturore dhe ruajtjes së identitetit, mes traditës romantike dhe prirjeve moderne, mes botimit të shpeshtë dhe heshtjes së gjatë, mes afirmimit jashtë shtetit dhe njohjes brenda vendit.

Ashtu si jeta e tij e shkurtër, por e larmishme; ashtu si vepra e tij e paktë, por cilësore; ashtu edhe interesimi i kritikës për Helenau është fragmentar, por vlerësues.

Me 1940 kritikë konstruktiv Vangjel Koça mbasi vëren se novela shqiptare gjendej ende në një epokë transformimi vlerëson se "... *Helenau dhe Platonius na falnë novella shumë të mira...*"<sup>8</sup>

Me 1941 Helenau institucionalizohet mbasi hyn në librin e leximit për shkollat shqiptare "Rreze drite" me novelën "Nana". Patetike e quan në një shqyrtim estetik Filip Fishta. "*Gjithçka asht rendue si në një mjes poetik.*"<sup>9</sup> Atmosferën përmalluese të Helenaut ai e gjen të përshkruar edhe nga Ernest Koliqi.

Me 1942, gjashtë vite pas vdekjes, Helenau vazhdon të jetë ndër talentet letrare në fuqi, si "*nji punues i mirë i novelës shqiptare.*"<sup>10</sup> Profesor Filip Fishta e shqyrton Helenau si një nga fytyrat letrare të Shqipërisë, por që paraqet "... *një kohë letrare të novelës sonë, e cila nuk qëndroi në drejtim e në rrugë të tij.*"<sup>11</sup>

Me 1944, kritikë i ri Qemal Draçini zbulon:

"*Shkrimet e Helenaut paraqesin një shpirt të ndieshëm me një botë shpirtnore gjithmonë në trishtim e që orvatet me arrijtë nëpër mes të vargut e të shprehjes, shfrymjen e dufëve që i lidhen ny përmbrenda.*"<sup>12</sup>

Ardhja e metodës së realizmit socialist në letërsinë dhe në kritikën shqiptare bëri që të heshtet tepër gjatë për një autor aspak të angazhuar e krejt intim, tejet delikat e aq sentimental, si Helenau.

Vetëm në vitin 1959, me kujdesin e studiuesit Jup Kastrati që mblodhi e redaktoi veprën e Helenaut të shpërndarë në shtyp, u bë i mundur botimi i librit "Trandafila që s'çelin për ne" (vjersha dhe tregime), në Tiranë, në 100 faqe, me format 12x16 centimetrash.

Edhe pse Jup Kastrati ngulmonte se "*Kontributi që ka dhënë Helenau me veprat e tij modeste dhe veçanërisht me prozën e bajnë që të zają një vend të merituem në historinë e letërsisë sonë të pamvarësisë*"<sup>13</sup>, prap se prap censura ideologjike ndaloi botimin e dy prozave: fejtonit "U njallë Mascagni?" dhe novelës "Andej vorri". Pavarësisht nga kjo, dalja e vëllimit të hollë ndikoi në rikujtimin e figurës së Helenaut dhe në njohjen më të plotë e më të thellë të krijimtarisë së tij mikse.

Po atë vit, studiuesi Nasho Jorgaqi sheh një grup tresh poetësh të vdekur: Gaspër Pali, Kolë Mirdita, Veli Stafa:

*“Ata krijuan në periudhën e letërsisë së independencës, qenë të përparuar në jetë e në letërsi... trajtuan pothuajse një tematikë dhe iu afruan njëri-tjetrit, kush më shumë e kush më pak në mënyrat e tyre letrare”.*<sup>14</sup>

Pas këtij viti Helenau hyn përfundimisht në programet shkollore ku përmendet si emër, pa u cituar me vepër, ndërsa në programet universitare trajtohet si shkrimtar minor.

Më 1966, studiuesi Mark Gurakuqi ndjen lidhjen e krijimtarisë së Helenaut, veçanërisht me atë të Gaspër Palit, kësisoj:

*“Te të dy kujtimet e fëminisë, malli për vendlindjen, përshkrimi i qytetit e i jetës së tij zanë një vend të dorës së parë... As njani, as tjetri nuk depërtuan në “lagjen e varfun” të Migjenit, por prap, të dy, s’qëndruen soditës të thjeshtë.”*<sup>15</sup>

Përtej perdes së hekurt, më 1973 studiuesi i letërsisë Ernest Koliqi theksonte:

*“Pasunija letrare e një kombit përmban shkrimtarë të mëdhenj dhe shkrimtarë dytanikë (ecrivains mineurs), të cilëve nuk u duhet mohue randësija. Shpesh në dytanikët, shpirti i mshehtë autokton shfaqet i vetvetishëm e i kulluet dhe na zbulon veti të panjoftuna të brumit tonë kombëtar.”*<sup>16</sup>

Pas një heshtjeje sërish tepër të gjatë, me 1983, tek “Historia e letërsisë shqiptare” vepra dramatike, poetike dhe ajo në prozë e Helenaut vihet në dukje, por veç në sfondin letrar të kohës dhe asnjëherë në mënyrë specifike. Me 1985 Fjalori enciklopedik shqiptar e trajtoi Helenaun si zë të vogël, pa shoqërim me fotografi. Me ardhjen e pluralizmit nis rivlerësimi i veprës së tij.

Më 1996, studiuesja Miaser Dibra, në formën e shprehjes gjen pika takimi mes tre shkrimtarëve të dekadës së tretë të shekullit XX:

*“Interesant është fakti se disa autorë mbeten poetë edhe kur shkruajnë në prozë. P.sh. prozat e Migjenit ka raste kur mund t’i rendisësh në vargje e ato të fitojnë ritmikën e duhur për të tingëlluar poezi. E njëjta gjë ndodh me disa proza poetike të Helenaut, tek ndonjë prozë e lënë nga Gaspër Pali”.*<sup>17</sup>

Në vitin 2000, studiuesi Nasho Jorgaqi e zgjeron grupin tresh të poetëve të vdekur (Helenau, 36 vjeç; Gimi, 26 vjeç; Platonicus, 25 vjeç; Kolë Mirdita, Gaspër Pali, Veli Stafa) duke përfshirë edhe Migjenin, 27 vjeç; për pasojë e zmadhon vlerën e katërshes letrare:

*“Ndonëse përfaqësonin individualitete pak a shumë të ndryshme ata i lidhin disa rrethana të përbashkëta jetësore. Jeta e tyre ishte pleksur ngushtë me Shkodrën, jo vetëm se kishin kaluar aty fëmininë e rininë, ishin mëkuar me*

*traditën e saj të pasur kulturore, kishin frymëzime dhe motive nga mjediset sociale të njëjta, por që të katër vuajtën dhe vdiqën nga tuberkulozi në një moshë fare të re. Humbja e tyre brenda pak vitesh është një nga humbjet më të dhimbshme, e pangjarë ndonjëherë në letërsinë shqiptare.”<sup>18</sup>*

Më 2002 autori i një monografie për Gaspër Palin shënon se “*Letrave shqipe iu përsërit, si një skemë a si një makth vdekja e poetëve në rini*”<sup>19</sup> duke shtuar se shuarja e yllit të Helenaut, Migjenit, Platonicusit, Gimit pikëlloi veçanërisht kolegët e penës, që mbetën me nga një frymëzues më pak.

Me 2003 studiuesja Fatbardha Hoxha pikas toposet letrare-artistike të Helenaut:

*“Një varr i të shtrenjtës nënë që la në qytetin e lindjes, një dashuri e përealizuar janë të pranishme në vargjet e tij.”<sup>20</sup>*

Me 2004, studiuesi Ali Xhiku duke gjetur fillin e hollë bashkues mes prozës së Mithat Frashërit dhe të Helenaut (dhe më pas me fillin mjaft të dendur të Ernest Koliqit), përgjithëson se “*proza e shkurtër shqipe në vitet ’10-’20 të shekullit të kaluar vazhdon të mbetej në fillimet e saj, po e ndiente shpejt nevojën e ndryshimit të mënyrës së komunikimit me lexuesin, po kërkonte pjesëmarrjen e tij, në procesin e njohjes (receptimit) dhe të interpretimit të teksteve të saj*”.<sup>21</sup>

Edhe sot kjo pjesëmarrje e lexuesit në njohjen e shtyllave të traditës vlen për të përcaktuar preferencat e tij ndaj autorëve që lanë pas hijen e bukur e të plotë të veprave. Aq më tepër duhet kjo pjesëmarrje e lexuesit, në tekstin e ndërprerë të Helenaut, që sa jep xixëllim ka nevojë për ndriçim.

#### REFERENCA:

1. Ernest Koliqi: “Shkolla letrare e jezuitve” tek “Kritikë dhe estetikë”, Tiranë, 1999, f. 23.
2. Shih N.N.: “A do të treten dorshkrimet?” tek “Vepra Pijore – Kalendari”, n. 33, Shkodër, 1924, fq. 20-23.
3. Kudret Velça: “Zhvillimi i teatrit në dhjetëvjeçarin e parë pas shpalljes së Pavarësisë dhe roli i tij shoqëror”. Rev. “Nëntori”, Tiranë, Nr. 12/1982, f.112.
4. Shih Prof. Filip Fishta: “Fytyra letrare të Shqipnis. Helenau”. Gaz. “Tomori i vogël”, Tiranë, nr. 5, 1 mars 1942, f.3.
5. Pa autor: “Mbi rasën e lindjes së “Dialëriës””. Rev. “Dialeria”, Vjenë, Viti I, Nr. 1 prill 1920, f. 2.
6. Pa autor: “Të ndryshme”. Rev. “Dialeria”, Vjenë, Viti X, Volum II, Nr. 7, janar, 1929, f. 16.
7. Andrea Varfi: “Kolë Mirdita”. Rev. “Përpjekja shqiptare”. Tiranë, Nr. 2/1936, Nëntor, f. 114.
8. Vangjel Koça: “Flasin personalitetet tanë letrarë”, Rev. “Shkëndija”, Tiranë, Nr. 3, shtator 1940, f.39.

9. Shënim: N.Helenau “Nana” tek “Rreze drite”, Tiranë, 1941, f. 53. Prof. Filip Fishta: “Talente letrare në fuqi”. Gaz. “Tomori i vogël”, Tiranë, 1942, Nr. 4, 15 shkurt, f. 3.
10. Prof. Filip Fishta: “Helenau”. Gaz. “Tomori i vogël”, Tiranë, Nr. 5, 1 mars 1942, f. 6.
11. Qemal Draçini: “N. Helenau” Rev. “Fryma”, Shkodër, Nr. 7-8/1944, f. 333.
12. Jup Kastrati: “Kolë Mirdita (Helenau). (1900-1936)” tek Helenau “Trandafila që s’çelin për ne”, Tiranë, 1959, f. 10.
13. Nasho Jorgaqi: “Gaspër K. Pali” tek Gaspër Pali “Hyjt mbi greminë”, Tiranë, 1959, f. 5.
14. Mark Gurakuqi: “Hyj që nuk shuhen” tek “Autorë dhe probleme të viteve ‘30”, Tiranë, 1966, fq. 252-253.
15. Ernest Koliqi: “Zef M. Harapi, auctor romanxash e dramash”, Rev. “Shejzat - Le Pleiadi”, Romë, Nr. 1-4/1973, f. 11.
16. Miaser Dibra: “Poetët e qytetit të veriut në vitet ‘20-‘30” tek “Vlera poetike të viteve ‘20-‘30”, Shkodër, 1996, f. 30.
17. Nasho Jorgaqi: “Pionier i poezisë moderne” tek Gaspër Pali “Bisedë me vetvedin”, Tiranë, 2000, f. 3.
18. Alfred Çapaliku: “Gaspër Pali, Jeta dhe vepra. Monografi”. Shkodër, 2002, f. 12.
19. Fatbardha Hoxha: “Rrjedhave të letërsisë së traditës. Studime”, Shkodër, 2003, f. 93.
20. Ali Xhiku: “Proza. Tregimi dhe novela” tek “Letërsia shqipe si polifoni”, Tiranë, 2004, f. 217.

### **Kolë Mirdita (Helenau). His life and work. The Echo.**

#### ***SUMMARY***

Kolë Mirdita’s artistic work Helenau lies in between elegant prose and cultivated poetry, passion and disappointment, Shkodra and Graz, cultural influence and long-established identity, romantic tradition and modern inclination. The fragmentary text of Helenau represents a sparkle of the XXth century that needs to be highlighted by the present reader.



Shaban SINANI

## SPROVË PËR NJË PERIUDHIZIM TË VEPRËS SË KADARESË

**1.1.** Ismail Kadare është një shkrimtar që zë vend qendror në letërsinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të.

Pa dyshim, ai është shkrimtari për të cilin është diskutuar më shumë si në vendin e tij të lindjes ashtu dhe jashtë në Perëndim. Kjo ka shpjegimin e vet. Në rastin e I. Kadesës letërsia ishte jo vetëm çështje leximi, por dhe një çështje publike. Romani “*Dimri i vetmisë së madhe*”, për shembull, u prit me një fushatë të përgjithshme në shtyp, që zgjati mbi një vit, ku morën pjesë vrojtues vullnetarë të vijës së partisë, botuesit e redaktorët, shkrimtarët e gazetarët, zyrat e ngarkuara me shtypin, funksionarët e partisë komuniste dhe të shtetit. Qindra letra e artikuj u shkruan dhe u botuan për këtë roman, nga zyrtarët e nga populli, sidomos në të përjavshmen e vetme letrare dhe në gazetën e rinisë, derisa vetë E. Hoxha u shpreh se ishte ekzagjeruar dhe duhej mjaftuar me aq<sup>1</sup>.

Kryeargumenti i debateve për letërsinë e I. Kadesës lidhet me raportet e saj me shtetin, me pajtimet dhe mospajtimet e saj me politikën zyrtare. A është I. Kadare një shkrimtar i realizmit socialist, madje a është I. Kadare shkrimtari më i rëndësishëm i realizmit socialist? A e ka deformuar veprën e tij konformizmi politik dhe a i ka shërbyer kjo vepër si vitrinë regjimit komunist? - janë pyetje parësore të kritizërëve<sup>2</sup>. Përkundrazi, pjesa tjetër pohon me vendosmëri “*përparësinë e disidencës artistike të gjithëshme të Kadesës*”<sup>3</sup>, duke shtuar se “*Kadareja ynë e sulmoi që herët diktaturën, kur ajo ishte në kulmin e fuqisë së saj përbindëshore*”<sup>4</sup>, se “*Kadare është njëri prej më të parëve*

<sup>1</sup> Vetëm vërejtjet e drejtorit të shtëpisë botuese përbënin një “*material prej 27 faqesh*”, që nuk është gjendur në fondet arkivore. Shih më hollësisht: Sh. Sinani, “*Një dosje për Kadarenë II*”, Tetovë, 2005, f. 286.

<sup>2</sup> Në “*Dictionnaire mondiale des littératures*” (P. Mougin et K. Haddad-Wotling), Paris, 2002, nga letërsia shqipe gjenden 27 zëra dhe paraqitja e letërsisë së realizmit socialist nis me prozën e I. Kadesës, S. Godos e të tjerë në vijim.

<sup>3</sup> M. Zeqo, “*Kadareja është apeli i kombit*”, në “*Zëri i Rinisë*”, 2 nëntor 1991.

<sup>4</sup> Shih: V. Zhiti, art. i botuar në të përditshmen “*Rilindja demokratike*”, 18 tetor 1992.

*sulmues të stalinizmit, shkrimtar që godet totalitarizmin*<sup>5</sup>, se ai shkroi një vepër të drejtuar “*tërësisht kundër totalitarizmit*”.

Kjo mënyrë të diskutuari është bartur dhe në polemikat jashtë vendit, të cilat kanë krijuar shabllonet e veta. “*Ismail Kadare: Modern Homer or Albanian Dissident?*” është titulli i studimit të Peter Morgan, njërit prej njohësve të përmendur të prozës së tij<sup>6</sup>. I njëjti autor i sheh si nocione kushtëzuese letërsinë, disidencën dhe indentitetin shqiptar në veprën e Kadaresë<sup>7</sup>.

Ky është një debat i ndërlikuar, që komplikohet edhe më shumë nëse shtojmë edhe këto arsye:

**1.2.** Vepra e Kadaresë ka pasur gjithnjë dy lexime paralele, të pangjashme, brenda dhe jashtë vendit. Në Perëndim ajo lexohej jo vetëm si letërsi, por dhe si një mundësi për të kuptuar se çfarë ndodhte në një vend krejt të mbyllur si Shqipëria. Brenda vendit lexohej edhe për të verifikuar se deri ku mund të shkonte liria e mendimit.

**1.3.** Vepra e Kadaresë edhe në Shqipërinë shtetërore është lexuar krejt ndryshe në periudhën e shoqërisë së vigjilencës e krejt ndryshe pas viteve 1990, në kushtet e shoqërisë së hapur. Deri në rënien e mureve letërsia e Kadaresë çmohej së pari për fuqinë e saj si faktor për lëvizje mendimi dhe pastaj si kumt estetik. Poema e zhdukur “*Pashallarët e kuq*”, e dërguar për botim në vitin 1975, ku E. Hoxha krahasohej me Krishtin shpëtimtar (“*Salvatore Mundi*”), në kohën kur u dënua që cilësuar antikomuniste, antishtetërore, antiparti; kurse sot lexohet më shumë si një vepër që e kontestonte sistemin politik nga qëndrime të një skaji tjetër, nga qëndrime më-se-komuniste<sup>8</sup>.

**1.4.** Vetë vepra e Kadaresë ka kaluar në një proces të gjatë qortimi e vetëqortimi, në shumicën e rasteve të imponuar. “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*” u qortua për pacifizëm e altruizëm tek kundështarët, gjenerali para së gjithash, dhe u ripunua prej autorit; “*Dimri i vetmisë së madhe*” u qortua për errësi, humbje të perspektivës, degjenerim, dekadencë, kundërvënie brezash, ankth ekzistencial, dhe gjithashtu u ripunua prej autorit. Por nuk mungojnë dhe rastet e ripunimit vullnetar të veprave prej shkrimtarit: “*Dasma*” u kthye nga roman në novelë, “*Kështjella*” u

<sup>5</sup> A. Vinca, art. i botuar në “*Drita*”, 19 shkurt 1995.

<sup>6</sup> Peter Morgan, art. i botuar në “*World Literature Today*”, vol. 80, 2006/5, p. 7-11.

<sup>7</sup> Peter Morgan, “*Ismail Kadare’s The Shadow: Literature, Dissidence and Albanian Identity*”, botuar në “*East European Politics and Society*”, 2008/22, p. 402-424.

<sup>8</sup> Për karakterin euro-lindor të kësaj dukurie, të letërsisë brohoritëse me synim përqeshjen përmes stërmadhimit shih Paul Goma, “*Care nu s-au frânt*”, në “*Haemus*” 2-3/1999, f. 278.

ribohua me shtesa të vëllimshme që ndryshojnë jo vetëm formën e veprës, por edhe kumtin e saj: nga përlligje e izolimit në botimin e fundmë vepra kthehet në akuzë për vetëveçimin dhe antinomia universal “të vetët - të tjerët” merr peshë themelore. Për të kuptuar ndryshimin midis “Kështjellës” dhe “Rrethimit” mjafton të këshillohet parathënia e studiuesit Matteo Mandalà për botimin e fundmë të kësaj vepre<sup>9</sup>. Këto qortime e vetëqortime e kanë vështirësuar debatin dje dhe sot, duke shtuar çështje të tekstologjisë kritike, të filologjisë, të krahasimit dhe stabilizimit të tekstit, të dallimit të vullnetit krijues prej imponimit së jashtmi. Për më tepër që ripunimet, duke pasur herë-herë dhe karakter dekontekstualizues, kanë çuar deri tek koncepti i kritikës krahasuese “midis motërzimesh”. Për motërzime është folur jo vetëm për rastin e romanit “Kështjella”, por edhe për “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”, “Dimrin e vetmisë së madhe” etj. Dekontekstualizimi është një prirje e hershme e I. Kadaresë, sidomos sa i takon ciklit perandorak, por theksohet sidomos në periudhën pas viteve 1990, që është periudha e vetëstabilizimit prapavajtës të tekstit letrar.

**1.5.** Letërsinë e Kadaresë e bëjnë më të diskutueshmen në gjysmëshekullin e fundmë edhe disa pikënisje specifike të grupeve sociale të lexuesve. Kritikizmi ndaj tij nxitet për shembull pse nuk ka çmuar letërsinë e Fishtës, pse ka aluduar për ekzotizëm e lëvdim të prapambetjes prej E. Koliqit (identifikuar me Besian Vorpsin në “Prilli i thyer”), pse i ka satirizuar figurat e klasave të përmbysura (plaka Nurihan dhe Ekrem Fortuzi tek “Dimri i madh”, Mukadesi dhe Adrian Guma tek “Nëntori i një kryeqyteti”). Shkaqe të tilla gjenden me shumicë kurdo dhe nga kushdo.

Koha që ka kaluar prej rënies së mureve ka qenë e mjaftueshme për të provuar se ky diskutim nuk i shton gjë njohjes së veprës së Kadaresë, sepse letërsia e tij është lexuar dhe lexohet me të njëjtën kënaqësi estetike, pavarësisht prej formimit, orientimit dhe bindjeve ideologjike të lexuesit. Për të nuk ka shumë rëndësi nëse Kadare qe një shkrimtar i angazhuar apo një qortues i regjimit. Për lexuesin ka rëndësi që letërsia që ai ka shkruar ofron shije estetike dhe gjendje emocionale.

**1.5.1.** Pak shkrimtarë ka në pesë shekuj letërsi shqipe që janë bërë fenomene evropiane. Prej Marin Barletit tek G. de Rada, prej Faik Konicës e Fan Nolit tek Kadare, vështirë se mund të gjenden emra të tjerë që mund të ndërfiten.

---

<sup>9</sup> M. Mandalà, “Kështjella e letërsisë dhe themelet e poetikës kadareane”, parathënie për romanin “Rrethimi”, “Kadare, Vepra”, vëllimi i tretë, Onufri, 2008, f. 9-29. Një variant më i zgjeruar i këtij studimi është botuar në të njëjtin vit në revistën “Hylli i Dritës”.

Ismail Kadare u shfaq në letërsinë shqipe në një kohë krize letrare të përgjithshme. E. Koliqi e M. Camaj ishin larguar nga vendi. At Gjergj Fishta, Faik Konica, Mit'hat Frashëri dhe G. Schirò-i ishin ndaluar si shkrimtarë reaksionarë. Migjeni kishte vdekur para kohe. Lasgush Poradeci e Mitrush Kuteli kishin vendosur të heshtnin. Edhe një pjesë e shkrimtarëve revolucionarë a përparimtarë (Musine Kokalari, Sejfulla Maleshova, Qemal Draçini, Kasem Trebeshina) ishin dënuar e ndaluar politikisht. Të vetmit që bënë letërsi ishin shkrimtarët antifashistë. Por mjetet e tyre figurative tashmë ishin ndryshkur e konsumuar; programi i tyre poetik dhe letrar ishte shterruar. Poezia dhe proza kishin mbetur të mbërthyer në madhështimin e luftës; letërsia e karaktereve mungonte. Mbi të gjitha mungonte poezia e un-it, e subjektit. Kjo krizë inkurajoi rebelimin dhe refuzimin estetik të gjendjes. Në fillim ky qe një refuzim i kujdesshëm. Slogani më i hershëm i brezit të viteve 1960 ishte: “*Traditë natyrisht, por jo stampë!*”<sup>10</sup>. Më vonë ndarja me brezin e shkrimtarëve antifashistë u bë më e prerë dhe mori karakterin e konfliktit mes dy brezave.

**1.5.2.** Brezi i viteve 1960 e konsolidoi shumë shpejt vetveten. Mund të duket paradoksale, por në konfliktin me “të vjetrit” I. Kadare u ndihmua sa nga mbështetja politike që iu dha brezit të ri prej politikës shtetërore, aq dhe nga manifesti i futuristëve i Filippo Tommaso Marinetti-t në anën estetike. Prishja e rehatisë në art, prirja për aventurë estetike, demistifikimi i së shkuarës, ikonoklastia ndaj paraardhësve, miti i industrializimit, shkatërrimi i sintaksës (gjegjesisht i gjedheve të vargëzimit), hyjnizimi i luftës dhe barazimi i saj me një kategori estetike dhe morale (“*homo militans*”), ikja prej kohës dhe hapësirës (“*koha dhe hapësira vdiqën dje*”, “*uomo volans*”), njeriu-dinamit, përçmimi i ndjenjës, apokaliptizmi dhe fryma e përgjithshme e përmbysjes, që ishin kanonizuar në manifestin e Marinetti-t<sup>11</sup>, u përvetësuan pa bujë sidomos nga I. Kadare dhe disa poetë

<sup>10</sup> Artikulli i D. Agollit “*Traditë natyrisht, por jo stampë*” u botua në të përjavshmen “*Drita*”, më 27 gusht dhe 3 shtator 1961. Autori, qysh në hyrje të artikullit, thekson se çështja në diskutim “*nuk është ajo e metrit të vargjeve, por e mënyrës së të krijuarit poetik*”. Brezin e poetëve të rinj autori e veçon si një grupim poetësh që “*mundohen të jenë më realistë në poezinë e tyre*”. Termi “*realizëm socialist*” në artikull përmendet vetëm në përgjithësi. Në tërësi autori përqesh mënyrën folklorike të vjershërimit.

<sup>11</sup> Shih: “*Manifesto del Futurismo*”, citohet sipas botimit në “*Le Figaro*” - 20 Fevrier 1909: Art. 1: “*Noi vogliamo cantare l’amor del pericolo*”. Art. 2: “*Il coraggio, l’audacia, la ribellione, saranno elementi essenziali della nostra poesia*”. Art. 3: “*Noi vogliamo esaltare il movimento aggressivo*”. Art. 4: “*Noi affermiamo che la magnificenza del mondo si è arricchita di una bellezza nuova; la bellezza della velocità*”. Art. 5: “*Noi*

të tjerë, duke u vënë në funksion të një frymëzimi poetik që shkonte krejt në pajtim me politikën komuniste. Poemat “*Shekulli i 20-të*”, “*Poemë blindazh*” (“*Poemë e ashpër*”), “*Endërr industriale*”, “*Vitet gjashtëdhjetë*”, “*Buzëqeshje mbi botë*”; si dhe vjershat: “*Antena*”, “*Nisja e shqiptarëve në luftë*”, “*Kthimi i shqiptarëve nga lufta*”, “*Kënga e ushtarëve të vjetër*”, “*Toka kufitare*”, “*Natë teletajpesh*”, po dhe të tjera vepra si këto, në poetikë mbështeteshin në traditën e De Radës e të Migjenit, në parime pajtoheshin me futurizmin dhe në përmbajtje paraqiteshin si frymëzime komuniste<sup>12</sup>. Në poezinë “*Përcjellje vargjeve*”, që Kadare e botoi më 1961 dhe më vonë e ka quajtur “*një lloj manifesti poetik*”<sup>13</sup> si emra referencialë përmenden Migjeni, Majakovski dhe Walt Whitman. Edhe poezia “*Sfidë*”, botuar në të njëjtin vit, gjithashtu e cilësuar nga autori “*vjershë në trajtë manifesti letrar*”<sup>14</sup>, në thelbin e vet ka ndarjen prej poetëve “*të poezisë së dekluar*”, “*fanatikëve të artit*”. Një pajtim i ngjashëm i mitit komunist të industrializimit dhe përmbysjes me manifestin e futuristëve dëshmohet dhe në poemat “*Alarme të përgjakura*” e “*I përkasim komunizmit*” të F. Arapit dhe “*Vdekje përëndive*” të Xh. Spahiut. Lufta në këto vepra barazohej me një kategori estetike, ikonoklastia futuriste kundër bibliotekave dhe muzeve në poezinë e re shqipe po merrte karakterin e një ikonoklastie të vërtetë: kundër klerit, faltoreve, intelektualëve borgjezë.

---

*vogliamo inneggiare all'uomo che tiene il volante, la cui asta ideale attraversa la Terra, lanciata a corsa, essa pure, sul circuito della sua orbita*”. Art. 7: “*Non v'è più bellezza se non nella lotta. Nessuna opera che non abbia un carattere aggressivo può essere un capolavoro. La poesia deve essere concepita come un violento assalto contro le forze ignote, per ridurle a prostrarsi davanti all'uomo*”. Art. 8: “*Il Tempo e lo Spazio morirono ieri. Noi viviamo già nell'assoluto, poiché abbiamo già creata l'eterna velocità onnipresente*”. Art. 9: “*Noi vogliamo glorificare la guerra - sola igiene del mondo - il militarismo, il patriottismo, il gesto distruttore dei libertari, le belle idee per cui si muore e il disprezzo della donna*”. Art. 10: “*Noi vogliamo distruggere i musei, le biblioteche, le accademie d'ogni specie, e combattere contro il moralismo, il femminismo e contro ogni viltà opportunistica e utilitaria*”. Art. 11: “*Noi lanciamo per il mondo questo nostro manifesto di violenza travolgente e incendiaria col quale fondiamo oggi il futurismo perché vogliamo liberare questo paese dalla sua fetida cancrena di professori, d'archeologi, di ciceroni e d'antiquari. Noi vogliamo liberarla dagli innumerevoli musei che la coprono tutta di cimiteri*”.

<sup>12</sup>D. Agolli, në artikullin e cituar, veçon poemën e I. Kadaresë “*Laç*”, që do të jetë më vonë dhe mjedisi i veprimit të karaktereve dhe ngjarjeve të romanit “*Dasma*”, si poema e industrializimit, dhe çmon shumë faktin që poeti “*ka kapur embrionin e kësaj dukurie të re*”. Në vijim ai përmend se poetët e rinj, “*që shkruajnë për shekullin e 20-të, për raketat, për qytetet industriale, për nailonin e perlonin*”, nuk duhet të harrojnë se ekziston dhe buka, kalliri, ugari.

<sup>13</sup>I. Kadare, “*Vepra*”, vëllimi i shtatë, Onufri, 2008, f. 369.

<sup>14</sup>“*Kadare - Vepra*”, vëllimi i shtatë, Onufri, 2008, f. 370.

Botuesi rus i lirikave të Kadaresë, David Samoïlov, duke veçuar poemën “*Taksi drejt pafundësisë*”, e pati vërejtur i pari këtë ndikim të poetikave perëndimore<sup>15</sup>, por pa e përmendur futurizmin me emër<sup>16</sup>. Futurizmi në formë, i shartuar me një frymëzim të sinqertë komunist, ka të ngjarë të jetë lehtësuar prej poezisë së Majakovskit, edhe kjo me dy faza pa kufij të qartë<sup>17</sup>. Vetë Kadare pohon se “*libri me vjersha e poema “Shekulli i 20-të” ishte ndër librat më të lirë e më skandalozë të kohës jo vetëm në Shqipëri, por në krejt perandorinë komuniste*”<sup>18</sup>, por pa e identifikuar se nga ç’poetikë i vinte kjo liri, pa përmendur futurizmin. Kjo është periudha e iluzioneve, e besimit se shoqëria e së ardhmes, utopia komuniste, do të garantonte një Shqipëri tjetër. Nuk ka në këtë fazë në veprën e Kadaresë, në prozë e poezi, asgjë prej aluzioni. Ka vetëm një pajtim të pashpallur: koha politike kërkonte ndërtimin e utopisë së një shoqërie ideale të së ardhmes; futurizmi u ofronte shkrimtarëve mundësi teknike për shkatërrimin e mjeteve të vjetra të shprehjes dhe ndërtimin e një poetike të re. Dhe kaq liri mjaftonte. Bindje dhe besim në utopinë kundrejt një lirie poetike.

Në një fazë të mëvonshme, shumë të shpejtë, I. Kadare shfaqet si prozator. Me botimin e parë të romanit “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*” dhe pastaj të “*Përbindëshit*” (që u ndalua deri në vitin 1990), mund të flitet për një fazë të provokimit formal-estetik. “*Kronikë në gur*” dhe “*Gjenerali ...*” e larguan luftën antifashiste shumë nga pasqyra e letërsisë. “*Përbindëshi*” shthuri strukturën e romanit, sidomos unitetin e kohës dhe të karaktereve. “*Kronikë në gur*”, veç të tjerash, provoi shartimin e gjinive, që ishte një modë e letërsisë evropiane, duke bashkuar: narracionin, kronikat dhe ditarin. Për këtë vepër pati kritika për ndikim të psikanalizës freudiste, e quajtën një vepër që s’ka lidhje me realizmin socialist. Megjithatë, kjo fazë provokimi ka të bëjë kryesisht me formën dhe nuk e prek ideshmërinë.

<sup>15</sup> Shih gjithashtu: I. Kadare, në: “*E vërteta që del nga qilarët - dialog me Stéphane Courtois*”, botuar në “*Vepra*”, vëllimi i 20-të, Tiranë, 2009, f. 449-452.

<sup>16</sup> “*Pa formë është qielli / si tru idioti*” është cilësuar vargu që e detyroi D. Samoïlovin “*të shkruante në parathënie e librit se Ismail Kadare ka ndikime nga modernizmi perëndimor*”. Shih: S. Bejko, “*Gjysmë shekulli poezi*”, parathënie në “*Kadare - Vepra*”, vëllimi i 7-të, Onufri, 2008, f. 11.

<sup>17</sup> Në fillimet e veta, “*ardhëtarët*”, që themeluan futurizmin rus, kishin një program ku “*bashkoheshin si kërkesat për demokratizimin e arteve, përbuzja e artit të “elitës”, ashtu dhe individualizmi ekstrem që shpallte autonominë absolute të krijimtarisë*”. Shih për më shumë: A. Tufa, “*Poetikë apo politikë*”, botuar në “*Poeteca*”, 2009, nr. 14, f. 79.

<sup>18</sup> I. Kadare, “*Pesha e kryqit*”, Paris, 1991, f. 23.

**1.5.3.** Nuk mund të përjashtohet një fazë e tretë, ku është vështirë të ndahet frymëzimi, pranimi vullnetar i realizmit socialist, prej ndikimit apo imponimit të kanoneve zyrtare. Në vitin 1968 ai boton vëllimin “*Motive me diell*”, me poezi të tilla, si: “*Dalja e shqiptarëve nga Traktati i Varshavës*” dhe “*Shqiponjat fluturojnë lart*”, “*që e vunë Kadarenë ndër shkrimtarët më pranë partisë*”<sup>19</sup>. Dy poemat e njohura: “*Shqiponjat fluturojnë lart*” dhe “*Përse mendohen këto male*”, si dhe romani “*Kështjella*”, i shkruar në 500-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit, mbajnë shenjë e kësaj faze. Botimi i romanit “*Kështjella*” përkon njëherësh me daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës dhe fillimin e vetëveçimit të vendit ndaj botës. Nëse në gjithë periudhën e mëvonshme historia ka qenë gjithnjë një shkas për aludim kundër bashkëkohësisë, në këtë roman aludimi - të paktën sipas receptuesve të parë - ishte për ta lartësuar epokën e re. Ikja prej historicizmit dhe aluzioni pozitivist për Shqipërinë e rrethuar, për qëndresën historike, për demonët e pafundmë për qark saj, bashkojnë vullnetarizmin me kanonizimin. “*Dasma*” do të ishte lëshimi i fundmë i kësaj periudhe. Më vonë Kadare romanin “*Kështjella*” do ta ripunonte thellë, kurse “*Dasmën*” do ta qortonte më shumë se gjithë kritikët e tij: Arshi Pipa, Martin Camaj, Bilal Xhaferi, Rexhep Qosja<sup>20</sup>.

**1.5.4.** Tronditjet e mëdha të shkaktuara nga “*Brezi 1968*” në gjithë Evropën lanë gjurmë të forta dhe në krijimtarinë e I. Kadaresë. Për herë të parë në art e në letërsinë shqipe u rikthye një shije perëndimore. “*Albin Michel*” botoi frëngjisht “*Gjeneralin ...*” (1971), vepër që u mirëprit nga lexuesi dhe kritika frënge. Botimi i kësaj vepre në Perëndim shenjon ndryshimin rrënjësor të sjelljes shtetërore ndaj shkrimtarit. Brezi i vjetër i shkrimtarëve dhe kritikëve u egërsua jashtëzakonisht. “*Këtë roman e botoi borgjezia dhe kjo nuk mund të pranohet*”, thuhet në një raport të policisë politike të kohës. Egërsimi ndaj I. Kadaresë u shtua edhe më kur disa prej shkrimtarëve të rinj u bashkuan me të vjetrit për të penguar “të përkëdhelurin e Perëndimit”: “*Tani që me të vjetrit i lamë hesapet, duhet të*

<sup>19</sup> F. Arapi, “*Kujtohem që jam*”, Tiranë, 1997, f. 228.

<sup>20</sup> Recensioni i Martin Camajt, më pak i njohuri në studimet shqiptare për këtë polemikë, me titullin “*Dasma*” - romani i ri i Ismail Kadaresë”, u botua në “*Shënjzat*” - “*Le Pleiade*”, Romë, 1967/9-12, f. 469-472. Ndërsa studiuesi Rexhep Qosja, në librin e tij “*Panteoni i rralluar*”, Prishtinë, 1973, f. 191, shprehej: “*Me “Dasmën” Ismail Kadare kryen njëmend një detyrë të lartë morale e shoqërore, dhe me përmbushjen e saj romani i tij do të harrohet, ashtu siç harrohen edhe dasmat mbas tri ditësh*”. Nga i njëjti autor gjithashtu: “*Teoria e një romani*”, në: “*Kritika letrare*”, Prishtinë, 1969, f. 177-192.

*bëhemi bashkë për t'i treguar vendin I. Kadaresë*”, thuhet të njëjtin raport<sup>21</sup>. Letërsia e I. Kadaresë ishte bërë tashmë faktor ndikimi dhe pikërisht për këtë arsye mbikëqyrej jo vetëm prej zyrave të ngarkuara me botimet, por dhe nga policia politike. Ndërkaq ndikimi perëndimor po zgjerohej. Radio Tirana transmetonte drejtpërsëdrejti emisionin e Radio Italia-s “*Canzonissima*”. Frekuencat e televizionit shqiptar kishin dalë nga kryeqyteti e po përhapeshin. Festalet e këngës në radion kombëtare ndiqnin modën e San Remos. Kjo është koha kur letërsia dhe arti arritën të kthehen në lëvizje mendimi. Lindi pikëpyetja e madhe nëse letërsia apo ideologjia kishin më shumë ndikim në mendimet e rinisë. Dhe goditja nuk vonoi.

Në fillim të vitit 1973 për herë të parë dhe të fundme u dënua një festival fund e krye. Festivali u cilësua njollë në historinë e kulturës së popullit, ndikim i hapur i dekadentizmit borgjez. Ndërkaq I. Kadare kishte dorëzuar për botim romanin “*Dimri i vetmisë së madhe*”, shkruar më 1971, ku për herë të parë shkrimtari jo vetëm dyshon në vlerat e sistemit komunist, sidomos në epërsinë teorike e praktike të tij, por konteston, qorton, ironizon, duke mbërritur deri tek faza e aludimit. Është e sigurt se po të mos ishte e pranishme në këtë vepër figura e E. Hoxhës, armiqësia ideologjike ndaj autorit do të kishte pasur pasoja shumë të rënda. Romani i largohet konceptit të mbijetesës heroike në rrethim që promovonte “*Kështjella*” dhe shkon drejt paditjes së izolimit të Shqipërisë. Jo më kot u insistua që në botimin e dytë vepra të mos quhej më “*Dimri i vetmisë së madhe*”. Tre-katër departamente të aparatit të komitetit qendror të partisë komuniste dhe vetë instituti i studimeve marksiste-leniniste i drejtuar nga N. Hoxha analizoi në mënyrë anatomike gjithë tekstin e ripunuar të veprës dhe dorëshkrimi iu kthye autorit me një dosje të vëllimshme me vërejtje të gjithfarshme<sup>22</sup>.

Në këtë vepër, siç ka vënë re studiuesja ruse Nina Smirnova, mjedisi shqiptar oksidentalizohet, Tirana duket si një metropol i madh perëndimor, jeta e shqiptarëve paraqitet liberale, aq sa krijohet iluzioni se ndarja me ish-Bashkimin Sovjetik nuk është një ndarje prej një superfuqie, por një ndarje me komunizmin dhe mbi të gjitha dhe një orientim i ri politik, drejt

<sup>21</sup> “*Mbi disa qëndrime në radhët e shkrimtarëve dhe artistëve*”, informacion i ministrisë së punëve të brendshme, drejtorja e parë, drejtuar E. Hoxhës, 10 gusht 1972. Gjetet në AQSH, Fondi 14/Ap, Viti 1972, Dosja 354, fl. 2-14.

<sup>22</sup> Shih dokumentin nr. 21 në “*Një dosje për Kadarenë II*”, “*Shënime të Nexhmije Hoxhës për romanin “Dimri i vetmisë së madhe*”, origjinali i të cilit ruhet në AQSH, Fondi 14/Ap, Dosja 552, Viti 1976, fl. 31-32.



Perëndimit<sup>23</sup> Komunizmi paraqitet si ëndërr e një brezi, stafetën e vazhdimësisë nuk ka kush ta marrë, shoqëria e utopisë së dikurshme është në rrënim, aq sa kritikët vendës në korrespondencën zyrtare e krahasojnë veprën me “*Pavionin e kancerozëve*” dhe e akuzojnë autorin për frikë e ankth ekzistencial<sup>24</sup>.

Me të drejtë është pohuar se në veprën e Kadaresë vërehet një përpjekje “*për t’i veshur politikës totalitare justifikimin nacionalist*”<sup>25</sup>. Nuk është aspak për t’u habitur që një letërsi e nisur me frymëzim poetik marksist-leninist të ketë marrë në një fazë të mëvonshme karakter patriotik dhe madje një ngjyresë shoviniste<sup>26</sup>. “*Dimri i vetmisë së madhe*” është një prej veprave ku shkrimtari bën një pajtim të tillë të vështirë e të sforcuar.

**1.5.5.** Prej “*Dimrit të vetmisë së madhe*” periudha e iluzioneve, e besimit në të ardhmen e komunizmit, e frymëzimit në emër të idealeve të tij, merr fund. Me ndonjë përjashtim shumë të rrallë, si poezia “*Partia ime*”, në kohën e mëvonshme nuk ka më pajtim ideologjik e konformizëm politik (sigurisht, duke përjashtuar publicistikën). Fillon koha e zhgënjimit, që lidhet jo vetëm me kuptimin e historisë politike të vendit, por edhe me qëndrimin ndaj politikës zyrtare për letërsinë dhe artet. Kur E. Hoxha bëri thirrjen që shkrimtarët dhe artistët duhet të jenë ndihmës të partisë për edukimin komunist të masave, Kadare e kishte marrë tashmë vendimin. Zhgënjimi kthehet në aluzion, aluzioni në rrezik, rreziku në ndalim. Poema “*Në mesditë Byroja Politike u mblodh*”, pavarësisht leximeve të përkundërta, shqipton mundësinë e dështimit të sistemit dhe përgjakjen që shkaktajnë diktaturat. Me këtë rast I. Kadaresë i analizohen në mënyrë retrospektive të gjitha gabimet ideologjike dhe politike që ka bërë: prej “*Përbindëshit*” e “*Provokacionit*”, “*Nëntorit të një kryeqyteti*”, “*Dimrit të vetmisë së madhe*”, duke mos harruar madje dhe “*Gjeneralin...*”. Kjo analizë e çon shkrimtarin tek një autokritikë e pabesueshme, ku ai pohon se unë jam armik i partisë, armik i

<sup>23</sup>N. Smirnova, pashënie romanit “*Surovaja zima*” - “*Dimri i madh*”, Moskva, 1991.

<sup>24</sup>Krahasimi i romanit “*Dimri i vetmisë së madhe*” me “*Pavionin e kancerozëve*” (“*Cancer Ward*”, 1968) të A. I. Solzhenitsyn-it gjendet në procesverbalin e mbledhjes së organizatës së partisë të Lidhjes së Shkrimtarëve, që i është dërguar komitetit qendror të partisë komuniste. Origjinali ruhet në AQSH, Fondi 14/Ap, Viti 1975, Dosja 363, fl. 50-56. Shih në “*Një dosje për Kadarenë II*” dokumentin nr. 13.

<sup>25</sup>Costantino Marco, art. i botuar në “*Përpjekja*”, 1995/2, f. 66.

<sup>26</sup>Bardhyl Pogoni (translations and comments), “*Contemporary Albanian Poetry*”, Naples – Italy, 1976, p. 93.

komunizmit, por, të paktën, nuk jam tradhtar e spiun dhe i shitur tek Perëndimi<sup>27</sup>.

**1.5.6.** Ndahen kështu rrugët e politikës kulturore-letrare të shtetit, duke përfshirë realizmin socialist, me rrugën e shkrimtarit. Kadare braktis krejt bashkëkohësinë, arratiset në botën e legjendave mesjetare, në kohën e prekjës së humanizmit evropian të dheut të Arbërit. Nis koha e refuzimit të parimeve të realizmit socialist. Shkruan romane që i quan novela, që fillojnë stilistikisht me të njëjtën ligjëratë murgu si vepra e meshtarit Gjon Buzuku pikërisht kur kushtetuta e vendit e kishte shpallur Shqipërinë shtet ateist, që nuk kalon pa u vërejtur nga kritika<sup>28</sup>. Krijon një Shqipëri tjetër, fisnike, të hershme, një Shqipëri të epokës evropiane të humanizmit, si sfidë ndaj hyjnizimit të kohës moderne si periudha më e lavdishme e historisë së Shqipërisë (“*Kush e solli Doruntinën*”, “*Ura me tri harqe*”)<sup>29</sup>. I rikthehet totalitetit të ish-perandorisë osmane (“*Pashallëqet e mëdha*”, “*Komisioni i festës*”) për të denoncuar me aluzion totalitetin e shtetit shqiptar. Merr shkas prej totalitetit të kanunit tradicional për të denoncuar totalitetin e shoqërisë shqiptare bashkëkohore (“*Prilli i thyer*”, “*Një dosje për Homerin*”). Në romanin “*Vit i mbapshtë*” aludohet për një Shqipëri të çoroditur dhe në një udhë pa krye pas vdekjes së Hoxhës. Kritika e qortoi zyrtarisht pse në gjithë atë zymtësi shkrimtari nuk pa qoftë dhe një qiri që ndrit diku në fund. Aludimi do të jetë një prirje sunduese deri në fundin e viteve 1980. “*Nata me hënë*” provokon me një karakter pozitiv dhe human që nuk është njeriu i partisë. “*Ardhja e Migjenit në letërsi*”, duke dënuar absolutizmin monarkik në qëndrimin ndaj poetit, njëherësh shpall sfidën e shkrimtarit vetë, siç kishte ndodhur dhe me vëllimin “*Zgjimi i thellësive*” - cikli i Migjenit - të Xh. Spahiut. Veprat që shkruan Kadare në këtë kohë nuk bëhen dot pjesë e letërsisë së programuar, e letërsisë së virtutshme

<sup>27</sup>“Unë kam shkruar dhe kam çuar për botim një vjershë armiqësore, kundërrevolucionare, të drejtuar kundër regjimit tonë, kundër diktaturës së proletarietit. Armën të cilën Partia më kishte besuar për të goditur borgjezinë dhe revizionizmin, e ktheva kundër saj. Pavarësisht se këtë nuk e bëra me qëllim, arma, edhe e shkrehur pa dashje, të vret. E gjithë vjersha është armiqësore dhe kundërrevolucionare. Unë isha në këtë vjershë po aq i rrezikshëm sa një kundërrevolucionar”. Nga autokritika me shkrim e I. Kadaresë, origjinali ruhet në AQSH, F. 14/Ap, Viti 1975, Dosja 363, fl. 62-76.

<sup>28</sup> Shih: Klara Kodra, “*Historia, legjenda dhe aktualiteti në pasqyrën e një vepre*”, në “*Nëntori*” 1980/12. Krhs: F. Altimari, “*Kostandini ose enigma kadareane e të vdekurit që kthehet mes të gjallëve*”, parathënie në “*Kadare - Vepra*”, vëllimi i 10-të, Onufri, 2008.

<sup>29</sup> Xh. Lloshi, “*Shënime për triptikun “Ura me tri harqe” të I. Kadaresë*”, në “*Drita*”, 27 maj 1979. Gjithashtu: Pipi Mitrojorgji, “*Mendime mbi maketin “Historia e letërsisë shqipe të realizmit socialist*”, në “*Nëntori*” 1979/10.

qëllimore. Partishmëria, angazhimi ideologjik, miti i njeriut të ri, optimizmi, besimi në epërsinë e sistemit, marrin fund.

**1.5.7.** Në vitin 1980 I. Kadare boton romanin “*Nëpunësi i pallatit të ëndrrave*”, fillimisht si novelë; dhe në të njëjtin libër, titulluar “*Gjakftohtësia*”, gjendej dhe një kapitull prej romanit të ardhshëm “*Koncert në fund të dimrit*”. Të dyja këto vepra përfundimisht shenjojnë kalimin e shkrimtarit në disidencë, në kundërshtim e demaskim të sistemit politik, në sfidë ideologjike dhe letrare. Kritikët dashamirës u përpoqën të provojnë se në ish-perandorinë osmane kishte ekzistuar një institucion me emrin “pallati i ëndrrave”, për të larguar mendjet vigjilente prej paraleles evidente me “pallatin e utopisë”, komitetin qendror të partisë komuniste<sup>30</sup>. Por ishte një mundim i kotë. Të gjitha simptomat e degradimit të shtetit shumëkombësh osman lexuesi i gjente në realitetin që kishte para syve. Teokracia osmane ishte e njëjta me ideokracinë komuniste. Burokracia e shtetit sulltanor identifikohet me kthimin e burokracisë komuniste në një barrë për popullin dhe vendin. Shteti qeverisëj qorrazi njësoj si perandoria e vjetër e shajnive. Vepra u ndalua menjëherë. Shkrimtarit iu kërkua ta harrojë përgjithnjë. Në serinë e veprave të plota të Kadaresë ishte parashikuar që vëllimi i 11-të të përmbante romanin “*Nëpunësi ...*”, por seria u botua, doli dhe vëllimi i 12-të, dhe i 11-ti nuk doli kurrë, madje nuk u plotësua as pas viteve 1990<sup>31</sup>. E njëjta gjë ndodhi dhe me romanin “*Koncert në fund të dimrit*”. Romani fitoi çmimin e parë në një konkurs kombëtar në vitin 1981, por nuk u botua deri në vitin 1988. Zyrat më të larta partiake e shtetërore, duke përfshirë dhe kolegë e miq të shkrimtarit, u shprehën se kjo ishte një vepër antikomuniste, një tallje e madhe me sistemin politik, një kundërvënie e hapur ndaj ideologjisë sunduese dhe nuk mbetej tjetër veçse që shkrimtari ta shkulte nga mendja<sup>32</sup>. Ai nuk duhej ta propozonte më për botim.

<sup>30</sup> Pipi Mitrojorgji, “*Mbi përmbledhjen “Gjakftohtësia”*”, botuar në “*Drita*”, 11.01.1981.

<sup>31</sup> Informacion për mbledhjen e organizatës bazë të partisë të muajit tetor 1982. “*Novela “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” është në themel e gabuar ideologjikisht, prandaj nuk ka përse bëhen përpjekje për ribotimin e saj në veprat e I. Kadaresë*”. Ruhet në: AQSH, Fondi 14/AP, Viti 1982, fl. 22-24.

<sup>32</sup> Shih ndër të tjera: D. Agolli, recension për romanin “*Koncert në fund të dimrit*”, origjinali ruhet në AQSH, Fondi 14/AP, Viti 1983, Lista 39, Dosja 98, fl. 12-27: “*Ky roman nxjerr disa problem për krijimtarinë e I. Kadaresë. Si do të shkojë më tej kjo krijimtari? Gjithmonë do të ketë lëkundje dhe turbullira? A mos i duhet çrrënjësor nga ndërgjegjja mendimi i tij për t’i shkruar veprat për publikun e huaj, që të bëjë bujë politike? Ne atë duhet ta bëjmë të shkruajë vepra për popullin e vet dhe ta heqë çdo mendim të “bujës botërore” dhe veçanërisht franceze?*”.

**1.5.8.** Në mesin e viteve 1980 I. Kadare shprehet për herë të parë dhe për kuptimin ideologjik të realizmit socialist, duke shfaqur dhe kundërshtime teorike. Në vitin 1985 boton një artikull denoncues për përkrahjen e mediokritetin në letërsi e arte, ku demaskohet slogani parimor i kohës që artin e bën populli, e bëjnë masat, duke ngulmuar në idenë e kundërt, që artin e vërtetë e bëjnë personalitetet<sup>33</sup>. Në vitin 1989, si pjesëmarrës në konferencën kombëtare “*Letërsia e sotme - koha e sotme*”<sup>34</sup>, argumenton hapur se parimi i realizmit socialist “*përmbajtje socialiste - formë kombëtare*” mund të ketë qenë i dobishëm për Bashkimin Sovjetik, një vend shumëkombësh e shumëgjuhësh, por nuk kishte kuptim për Shqipërinë, duke provokuar diskutimin për importimin e realizmit socialist si doktrinë letrare nga jashtë<sup>35</sup>. Në fakt, këtë ide e kishte shprehur dy dekada më herët

<sup>33</sup> I. Kadare, “*Për ngritjen e nivelit në letërsi*”, botuar në të përditshmen “*Zëri i popullit*”, 27 tetor 1985.

<sup>34</sup> Aktet e kësaj konference u botuan në revistën “*Studime filologjike*” 1989/4 dhe një pjesë në “*Nëntori*”, 1990/1, f. 56-67.

<sup>35</sup> Shih më gjerësisht: I. Kadare, kumtesë në këtë konferencë: “*Për veshin tonë është tepër familjar formulimi “përmbajtje socialiste dhe formë kombëtare”, por mendoj se për letërsinë tonë të sotme kjo formulë nuk ka shumë kuptim. Pyetja e parë që do të bëhej do të ishte: përse kjo ndarje e tillë, përse kombëtares i ka mbetur vetëm forma? Nuk po zgjatem me pyetje të tjera të mundshme, të vështira për përgjigje. Formulimi i mësipërm ka lindur dhe ka patur kuptim në një vend shumëkombësh socialist, ku kombe të ndryshme përbënin megjithatë një popull, dhe një letërsi unike, letërsinë sovjetike. Në vendin tonë që është homogjen kjo ndarje komponentesh nuk qëndron. Por ndërsa raportet përmbajtje-formë, në këtë rast, nuk mbeteshin veç në kuadrin e një formule, shumë më e ndërlikuar paraqitej çështja e tipikes dhe jo tipikes në letërsi. Teoria e tipikes, e zhvilluar si e tillë në Bashkimin Sovjetik në mesin e viteve 50-të, pikërisht në prag të proceseve revizioniste, i ka sjellë çoroditje dhe dëme të pallogaritshme letërsisë socialiste në të gjitha vendet. E nxjerrë në mënyrë metafizike nga një letër e Engelsit drejtuar një shkrintareje gjermane të kohës, për një problem konkret të një lloji letërsie konkrete, një frazë e drejtë e Engelsit, duke u shkëputur nga konteksti konkret, duke u veshur me dimension universal, u shndërrua në teori, ndonëse po ta shikoje me kujdes kjo vinte në kundërshtim me vlerësimin e njohur të Marksit dhe Engelsit për letërsinë botërore. Ligjet e letërsisë s’mund të nxirren në këtë mënyrë, qoftë dhe nga një personalitet i madh si Engelsi. Ligjet e letërsisë e të artit lindin dhe përpunohen gjatë shekujve prej vetë letërsisë dhe artit, prej proceseve dhe praktikës së tyre shekullore. Në kundërshtim me çdo dialektikë të zhvillimit, e ashtuquajtura teori e tipikes, në atë mënyrë si u servir, shpallte tipike, pra të lejueshme, për letërsinë socialiste, çdo ngjarje, rrethanë a personazh që takohej më shpesh në jetë, dhe atipik, çdo ngjarje, rrethanë a personazh të pazakontë. Në këtë mënyrë letërsia i hiqte vetvetes ngjarjet e personazhet e papërsëritshëm e tejet origjinalë, që janë thesari i paçmuar i artit”. Të njëjtin mendim pati shprehur qysh në vitin 1958 E. Koliqi, i cili letërsinë shqipe e shihte të ndëshkuar prej diktatit “*nji kulturë**

E. Koliqi në një artikull botuar në *“Shëzati”*. Ndërsa në fillim të vitit 1990 do të kërkonte rishikimin tërësor të traditës letrare në historinë e letërsisë, duke filluar me *“Mesharin”* e Gjon Buzukut, për të cilin propozoi të ngrihej një përmendore para ndërtesës së Akademisë së Shkencave - ku ndërkaq gjendej busti i Stalinit.

**1.6.** Realizmi socialist në Shqipëri u shemb bashkë me rënien e sistemit politik. Ndryshe ndodhi në Rusi, ku edhe sot realizmi socialist vazhdon të jetë një prirje e qëndrueshme në botën e letrave, me vijuesit vullnetarë dhe me shtypin e organizuar. Kjo është periudha e demaskimit të realizmit socialist jo vetëm përmes një vepre letrare shumë më të lirshme, por edhe në polemikat e kohës. Në një varg librash të karakterit të eseistikës dhe memoaristikës (*“Nga një dhjetor në tjetrin”*, *“Pesha e kryqit”*, *“Dialog me Alain Bosquet”*, *“Letërkëmbim me presidentin”*), shkrimtari rigjykon veten dhe kohën, duke e vënë veprën e vet në kontekstin historik dhe duke mos harruar dhe dëmet që i kanë shkaktuar asaj metoda zyrtare dhe parimet doktrinare. Në një pjesë tjetër të veprës së tij sundon etnografizmi (*“Konkurs bukurie për burrat në Bjeshkët e Nemuna”*, *“Çështje të marrëzisë”*, *“Darka e gabuar”*, *“Kushëriri i engjëjve”*). Në shumë vepra të I. Kadaresë botuar pas viteve 1990 marrin një peshë më të madhe disa nocione klasike të psikanalizës, të pranishme dhe më herët në veprën e tij (*“Kronikë në gur”*, *“Kush e solli Doruntinën”*, *“Nata me hënë”*): ëndrra, kthimi në të shkuarën, jeta vetjake, psikozat masive, kompleksët vetjake dhe etnike, instiktet, vdekja, krimi, egërsia, tabuja në përgjithësi. Biografia, për shembull, ka qenë dhe mbetet një përbërëse themelore e krijimit në të gjitha kohërat, një shtysë parësore për krijimtari. Sepse, përderisa letërsia është shprehje e një gjendjeje të lartë shpirtërore, jeta vetjake e shkrimtarit nxit krijimtarinë. Kjo ka ndodhur gjithnjë, prej Safos e Ovidit deri tek letërsia evropiane bashkëkohore, pavarësisht se psikanaliza si shkencë dhe si metodë lindi në shekullin e 20-të, me S. Freud-in dhe pasuesit e tij (E. From, G. Jung dhe së fundi J. Lacan). Sigurisht se jo çdo prani e ëndrrës (duke përfshirë *“Nëpunësin e pallatit të ëndrrave”*), apo e seksualitetit (hetero dhe homoseksualitetit, të seksualitetit të kohshëm e të parakohshëm - *“Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazerkut”*, *“Konkurs bukurie për burrat në Bjeshkët e Nemuna”*), e seksualitetit të pakryer (*“Hija - shënime të një kineasti të dështuar”*, *“Aksidenti”*), e incestit (*“Kush e solli Doruntinën”*), e virgjinitetit (*“Nata me hënë”*), e trashëgimit të kumtit të jetës (*“Prilli i thyer”*) dhe e çështjes

---

*kombtare nga forma e socialiste (lexo: sllave) nga përmbajtja”*. Shih: E. Koliqi, *“Xhixhat e Shëzave: Bota e re shqiptare”*, në *“Shëzati”*, nr. 5-6/1958, f. 146.

së kurorës (“*Pasardhësi*“, “*Vajza e Agamemnonit*“), e psikozave masive dhe e kompleksve etnike (“*Viti i mbrapshtë*“), e vdekjes (“*thanatos*“), e tmerrit prej ndëshkimit dhe e katarsisit (“*Pashallëqet e mëdha*“), e krimtit, e refuzimit të një brezi prej tjetrit dhe e armiqësisë me prindërit, është doemos shprehje e ndikimit të letërsisë së Kadaresë prej frojdizmit, neofrojdizmit, Lacan-it dhe të tjerëve. Në kohën që njeriu egjiptian shkroi në papirus afro katër mijë vjet më parë ankimin “Ah, ky brezi i ri!“, as që i shkonte në mendje se në shekullin e 20-të të kohës tjetër një filozof do të shpjegonte raportet midis brezave me komplekse psikanalitike që përsëriten me një rregullsi të ligjshme të të gjithë popujt dhe në të gjitha kohërat. Ngjashmëria e këtij refuzimi mijëravjeçar me refuzimin e *broadway*'s-ëve në romanin “*Dimri i vetmisë së madhe*“: “*Nëse e doni aq shumë stafetën, mbajeni, ne nuk e duam*”, dhe e të dyjave me mospajtimet për motive irracionale psikanalitike midis brezave, është vetëm një prej shenjave të ikjes prej socrealizmit nga I. Kadare. Përgjithësisht vepra e tij paraqitet e tipit që ndikon dhe jo që ndikohet. Pahësimi terminologjik i psikanalizës në veprën e Kadaresë para dhe pas viteve 1990 kërkon një shqyrtim të imët për të identifikuar atë që mund të quhet “*ajo që autorit i del nga duart, i rrëshqet nga mendja dhe mendimi kontrollues*“. Duke ndjekur këtë rrugë para së gjithash do të veçoheshin ato vepra ku autori çkodifikon kumte të fshehta të miteve, të cilët janë të tillë pikërisht përse vijjnë në letërsi përmes një komunikimi midis tre institucionesh, që ndërhyjnë nga nën-membrana, duke kaluar censurën prej nënvetëdijes përmes censurës në vetëdije: “*Kush e solli Doruntinën*“, “*Ura me tri harqe*“, “*Emblema e dikurshme*“, “*Një dosje për Homerin*“, “*Eskili, ky humbës i madh*“ etj. Disa aspekte të tjera, ku vështrimi frojdist mund të prekte të vërteta më të thella, si çkriptimi i miteve, çsekretimi i të vërtetave mitologjike të pranishme në vepër, çkodifikimi i historisë, përmes prekjes së tabusë (incesti tek “*Kush e solli Doruntinën*“, virgjiniteti tek “*Nata me hënë*“, homoseksualiteti tek “*Konkurs bukurie ...*“), gjithashtu mbeten për t’u studiuar më tej.

**1.7.** Së fundmi, për veprimtarinë krijuese të I. Kadaresë në dy dekadat e fundme duhet shenjuar se një vlerë e padiskutueshme e saj është hapja e ligjëritimit gjuhësor dhe letrar dhe përgënjeshtrimi i akuzave që i janë bërë gjuhës shqipe të njësuar për pamjaftueshmëri mjetesh të shprehjes, për ngurtësi sistemore, për kufizim dhe diskriminim ndaj gegërishtes. Prej veprës së Kadaresë mund të gjykohet se është kompetenca e kufizuar e folësve të shqipes letrare ajo që nxit mëri të vazhdueshme ndaj saj, kurse vetë shqipja letrare arriti shkallën më të lartë të zhvillimit të hapur të saj me

këtë vepër, duke dëshmuar se është letërsia ajo që e hap dhe e zhvillon edhe vetë normën.

### **Tentative approach at periodizing Kadaresë's work**

#### ***SUMMARY***

The literary work of I. Kadare, even if it is structurally stable and united, it is not developed in straight-line basis. The question “conformist or dissident” has caused a lot of debate between different unhappy parties. If we refer to literature reports, in Kadare’s creative way, we can distinguish several phases: 1. The esthetic refusal phase of the ancient versification. It refers to poets and writers of the antifascist war. 2. The phase of political inspiration and conformism to the communist utopism. It is like a mix of the futurist poetry with a socialist content with the myth of future, industrialization, new. “Why do these mountains think”, “My century”, “Industrial dream”, “The wedding”. 3. A transitorial phase of esthetical provocation from the novel “The monster” and the story “The provocation”. 4. A suspect phase of attenuation of the political commitment with the novel “The winter of the big solitude” and the prohibited poem “At noon the Political Bureau was held”. 5. A contestation phase and the escape from the paradigm of socialist realism: “Who brought Doruntina”, “The bride with three arches”, “The Great Pashaliks”. 6. The dissident phase: “The employee of the dreams palace”, “Concert at the end of the winter”. 7. A creative phase after 1990 in an open society, which can be characterized as the phase of his linguistic perfection. So, the creative way of Kadare has traversed all the “stations” of our logic, from the inspiration to the refusal and dissidence.

Arben PRENDI

## VAZHDIMËSI DHE VARIUESHMËRI E STILIT TË KADARESË SI ROMANCIER. ROMANET E SHKRUARA PAS VITEVE 1990

### 1. Hyrje

Nga kritika dhe studimet letrare të kësaj periudhe romanet e shkrimtarit I. Kadare pas viteve 1990 janë parë si vazhdimësi, por edhe si variueshmëri e stilit të këtij romancieri. Për këtë arsye ndoshta ndarja në dy faza kronologjike e krijimtarisë së këtij autori ka vlerë vetëm reference sepse në tërësi ai ruan dhe përpunon cilësi dhe teknika të njohura për veprën e tij. Përfshirë elementin tematik që në kushtet e lirisë e zgjeron duke përfshirë drejtpërdrejt temat e aktualiteteve shqiptare; duket se nuk ka ndonjë “thyerje” të re në këtë vepër. Në romanin e këtij autori mund të konstatojmë edhe një herë praninë e elementëve të poetikës së romanit realist të ndërthurura lirshëm me elemente të poetikës së romanit modern apo edhe postmodern por jo si kërkim përmbysës, eksperimentim apo shkëputje nga letërsia e tij e mëparshme, por si pohim dhe rrjedhë e natyrshme e shkrimit letrar në kushtet e rënies së pengesës së jashtme ideologjike, e cila rrudhte shprehjen aristike dhe thënien e të vërtetave në mënyrë të hapur kuptimore. Sigurisht ky autor dëshmon kalimin e natyrshëm nga romani i para viteve ‘90, si një përvojë krijuese, që nuk tronditet tërësisht, por bën riparimet dhe përshtatjet e zakonshme për një shkrimtar.

Romanet e tij treguan se letërsia e mirëfilltë nuk tronditet themelisht nga ndryshimet sociale - politike, dhe se ajo krijohet mbi ligjësi të brendshme estetike të krijuesit. Siç analizon edhe një prej studiuesve të hershëm të këtij autori: *“Poetika e hapur e prozës së Kadaresë krijoi hapësirën për shprehjen e polifonizmit të ideve, artikulimin e disa zërave brenda një tipi ligjërimi të përzier dhe brenda një ligjërimi ku edhe kohët përzihen dhe ku bashkëjeton realja me irealen. Proza e Kadaresë është proza e metaforës së madhe të absurdit ekzistencial, proza e parabolës, analogjisë dhe alegorizmit. Kadare i dha kështu një fytyrë moderne prozës shqipe, në të gjithë përbërësit e vet. ... Me fjalë të tjera, Kadare e bëri romanin roman, pra, e ktheu atë te përmbajtja e vet tipologjike, që është*



*konflikti i individit me forcat që qëndrojnë jashtë tij, me institucionet morale e politike, kërkimet e tij shpirtërore dhe rragimet ekzistenciale të njeriut ose të bashkësisë njerëzore*<sup>36</sup>.

Gjatë këtij njëzet vjetëshi Kadare si romancier vijon të jetë aktiv duke pasuruar romanin tonë me tituj të rinj dhe analiza artistike sa të totalitarizmit dhe të mitologjisë universale aq edhe të totalitarizmit, mitologjisë dhe aktualitetit shqiptar. Siç edhe mund të konstatohet edhe nga titujt e disa prej romaneve, disa tema e motive thelbësore në romanet e mëparshme të këtij autori vijnë të jenë të tilla edhe pas viteve '90, si: temat nga mitologjia botërore apo shqiptare, temat nga historia e popullit shqiptar, dhe së fundit një temë e re në raport me aktualitetin shqiptar; tema nga jeta traumatike nën diktaturën komuniste shqiptare.

Përcaktimin se në romanin modern bashkëkohor shqiptar mbizotëron simbolika dhe alegoria, dhe se në të ndërthuren përbërësit realistë me përbërësit modernë, duke krijuar simbiozën karakteristike, që është në një pjesë të madhe të romanit modern evropian<sup>37</sup> mund ta gjejmë të realizuar në romanin e Kadaresë para dhe të pasviteve '90-të. Megjithatë siç është vlerësuar në ndonjë rast nga kritika përsëritja tematike brenda veprës së këtij shkrimtari ka sjellë edhe një konkurrencë të brendshme në veprën letrare të tij, konkurrencë e cila ka çuar drejt dukurisë vepër - "antivepër", ku njëra eklipson tjetrën<sup>38</sup> apo në prozën e varianteve<sup>39</sup>. Kjo "përsëritjeje tematike" dhe "variantet" në romanet e shkruara e të botuara pas viteve 1990 dëshmon se ato janë në raporte implicite intertekstualiteti dhe hipertekstualiteti me romanet e mëparshme.

Kadare pas viteve 1990 ka botuar një numër të madh romanesh ndër të cilët vlen të veçohen romanet (që autori shënon në fund të teksteve se janë krijuar pas këtij kufiri simbolik), si romani "Piramida"<sup>40</sup>, "Shkaba" (1996), S.P.I.R.I.T.U.S (1996), "Jeta loja dhe vdekja e Lul Mazrekut" (2002), "Lulet e ftohta të marsit" (2000), "Përballë pasqyrës së një gruaje",

<sup>36</sup> Jorgo Bullo, "Në vend të parathënies", në Shaban Sinani, "Për prozën e Kadaresë", "Naimi", 2009, f. 7-8.

<sup>37</sup> Bashkim Kuçuku, "Periudha e realizmit dhe e modernitetit bashkëkohor", në "Studime albanologjike", 2008/2, viti XIII, U. Tiranës, F. i Historisë dhe i Filologjisë, f. 209.

<sup>38</sup> Muharrem Jakupi, "Koha dhe teknikat e të huajimit në romanin tonë modern", në "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", Prishtinë, 2008, 27/2, f. 607.

<sup>39</sup> Behar Gjoka, "Kadare i rilexuar", "Princi", Tiranë, 2008, f. 115-130.

<sup>40</sup> Pjesa e parë e këtij romani shkruar në vitet 1988-1990 dhe përfunduar në vitin 1992, kohë në të cilën botohet njëkohësisht, në shqip dhe frëngjisht. Ky roman nga pamja kronologjike do të shënojë ndoshta edhe një kufi ndërmjet romaneve të mëparshme dhe atyre që ai boton pas viteve 1990.

“Skifteri”(2000),<sup>41</sup> “Darka e gabuar” (2008), “Pasardhësi” (2002-2003), etj. Ndërsa në disa romane të tjera si “Qyteti pa reklama”,(1959 – 2001); “Hija”, (1984-1986), (2003), “Ikja e shtergut”(1986) (2001), “Vajza e Agamemnonit” (1985) 2005, “Çështje të marrëzisë”, etj., autori shënon se janë krijuar para viteve ‘90, si romane në dorëshkrim. Me këtë rast Kadareja na shfaq edhe një pjesë të romaneve “të sirtarit” të shkruara kohë pas kohe si romani “Qyteti pa reklama” (1959), që është në fakt edhe romani i tij i parë, megjithëse i panjohur dhe i pabotuar në kohën e shkrimit të tij. Me këtë rast janë bërë objekt në këtë punim romanet për të cilat autori shënon se janë shkruar pas viteve 1990.

Mund të vërehet se kryeveprat e Kadaresë janë veprat e botuara para viteve 1990, por “Piramida”, “Shkaba”, S.P.I.R.I.T.U.S, “Jeta loja dhe vdekja e Lul Mazrekut”, “Darka e gabuar”, “E penguara, Requiem për Linda B.” “Pasardhësi”, qëndrojnë në të njëjtin nivel me veprat më të realizuara.

Kadare është ndër romancierët më prodhimtar i këtij njëzet vjetëshi por siç kanë vënë re studiuesit: *“Pas viteve 1990 ligjërimi i I. Kadaresë zhvillohet në një përmasë shumë të lartë. Krijimtaria e tij bëhet shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore dhe letrare të shqipes së njësuar. ... bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj të mëparshme: frymën etnografike, shpërfaqjen e identitetit shqiptar, duke përfshirë komplekset etnike”*<sup>42</sup>. Në tërësi romanet e këtij 20 vjetëshi, në rrafshin tematik dhe motivor në perspektiva të reja, janë një rimarrje e temave dhe motiveve të shtjelluara edhe në romanet e mëparshme, të cilat ndërfiten edhe në romanet me temë nga aktualiteti ose nga periudha e diktaturës.

Kështu në disa romane, Kadare rimerr tema e motive nga historia e ndërtimit të piramidave të faraonëve në Egjiptin e lashtë, “Piramida”; nga përrallat shqiptare “Shkaba”, dhe nga mitologjia antike greke, “Vajza e Agamemnonit”- “Pasardhësi”; nga baladat “S.P.I.R.I.T.U.S”, “Jeta loja dhe vdekja e Lul Mazrekut”, të cilat sigurisht kanë lidhje në tekst ose në nëntekst me tema të realitetit shqiptar siç është tema e tiranisë komuniste dhe fati i individit dhe shoqërisë shqiptare nën këtë tirani. Sepse në këtë mënyrë Kadareja bën mitizimin dhe çmitizimin<sup>43</sup> e botës shqiptare. Këto tema e motive kanë qenë të pranishme vijimisht në veprën letrare të këtij shkrimtari, si në romanet “Kush e solli Doruntinën?”(balada gojore), “Përbindëshi”, (lufta, Kali i Trojës) “Ura me tre harqe” (balada e murimit

<sup>41</sup> Pjesë e triptikut prej tre romanesh “Përballë pasqyrës së një gruaje”, 200.

<sup>42</sup> Shaban Sinani, “Për prozën e Kadaresë”, “Naimi”, 2009, f. 97.

<sup>43</sup> Luan Topçiu, “Tradita moderne në letrat shqipe”, Zenit, 2010, f. 208.

në urë), “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” (perandoria totalitare osmane), etj.; prandaj duhen konsideruar si vijimësi e stilit, si nga ana tematike ashtu edhe nga ana artistike e teknikës artistike që përdor autori dhe që në tërësi janë romane nën ndikimin e poetikës moderne, e pranishme kjo edhe në veprat tjera para viteve 1990. E veçanta e shtjellimit të lëndës mitologjike në romanet e Kadaresë qëndron siç kanë vënë re studiuesit në faktin se ajo “*u bë pjesë e indit dhe “lëndës” së veprave të tij me status të njëjtë me lëndën nga jeta e gjallë, nga veprat e letërsisë, nga faktet autobiografike apo ngjarjet e trilluara*”<sup>44</sup>.

Ndërkaq në romanet *S.P.I.R.I.T.U.S* (1996), “Jeta loja dhe vdekja e Lul Mazrekut” (2002), “Lulet e ftohta të marsit” 2000, “Përballë pasqyrës së një gruaje”, “Skifteri”, (2000) “Darka e gabuar” 2008, “E penguara, Requiem për Linda B.”, “Pasardhësi”; tema e aktualitetit është e drejtpërdrejtë, dhe më afër realiteteve e ngjarjeve shqiptare, që në mënyrë të qëllimshme bëjnë objekt periudhën e mbas Luftës së Dytë Botërore dhe diktaturës komuniste shqiptare, si periudhat më dramatike historike nëpër të cilën kalojnë individët dhe e gjithë shoqëria shqiptare. Prandaj në këto vepra nuk është më e nevojshme gjuha e koduar apo simbolike, por “gjasmëria” me realitetet shqiptare, gjë që e vë në plan të parë mënyrën realiste të këndvështrimit të jetës dhe personazheve që veprojnë në këto vepra, këndvështrim i cili ndërthuret me reflektime dhe analiza dhe mjete shprehëse karakteristike për romanin modern. Edhe në këtë grup romanesh elementi mitologjik apo gojëdhanor është i pranishëm dhe jo më pak i rëndësishëm se elementi me gjasmëri nga realiteti.

Romanet e Kadaresë dallohen nga romanet e autorëve të tjerë edhe për veçantinë e tyre stilistike gjuhësore, “*pasurinë e mjeteve lidhëse sintaksore, shumësinë e strukturave frazore, dialogun e shkathët me replikë apo të brendshëm; variantet gramatikore e stilistikore me rendin në paraqitjen e kategorive të veçuara ose “lojën” me këtë mjet gramatikor të fjalive tematike e rematike, - gjë që e bën autorin, - ndër stilistët më të mirë të letërsisë sonë moderne, por edhe si gjuhëkrijues (me sinoniminë e qëlluar dhe neologjizmat e goditura) dhe lëmues i përhershëm e i palodhshëm i gjuhës letrare shqipe*”<sup>45</sup>. Ndërkaq është vënë re si veçori e gjuhës artistike të këtij autori prirja për ta pasuruar gjuhën e shkruar me mjete shprehëse të gjuhës së folur si një mundësi më efikase komunikimi

<sup>44</sup> Muharrem Jakupi, “Koha dhe teknikat e tëhuajimit në romanin tonë modern”, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2008, 27/2, f. 243.

<sup>45</sup> Tefë Topalli, Mimoza Priku, “Veçori të strukturës sintaksore në disa vepra të Kadaresë” në T. Topalli, “Kërkime gjuhësore” 2, E.B. “Gjergj Fishta”, L. 2011, f.187.

me lexuesin, por edhe si pasurim gjuhësor e artistik i shprehjes artistike në tërësi gjë e cila mund të dëshmohej jo vetëm në dukurinë e elipsës por edhe në strukturën e njëjësive kumtuese sintaksore, siç janë fjalia dhe periudha<sup>46</sup>.

Vepra e Kadaresë edhe pas viteve 1990, për nga teknika e shkrimit, përshkrimi i miteve, motiveve nga letërsia gojore shqiptare, nga temat aktuale dhe ato historike, ka rëndësi të veçantë në letërsinë tonë të gjysmës së dytë të shekullit XX. Edhe në romanet e shkruar pas viteve '90, gjejmë të gërshetuara tonet tragjike, dramatike, lirike, me reflektimet universale mbi qenien njerëzore dhe historinë e saj ç'prej miteve e përrallave deri në realitetin e ideologjisë komuniste apo në realitetin e tranzicionit shqiptar postkomunist. Ajo është një vepër që e bën lexuesin pjesëmarrës dhe prodhues, interpretues të kuptimeve të larmishme të saj, brenda kufijve të mundshëm që përmban teksti artistik. Tendenca e romaneve të Kadaresë pas '90 është t'i drejtohet gjithnjë e më tepër Lexuesit Model,<sup>47</sup> që ka në vete si lexuesin semantik ashtu edhe atë semiotik me një prirje të theksuar në disa romane drejt lexuesit semiotik.

**2.1 Romani “Piramida”** i shkruar ndërmjet viteve 1986-1992, botuar në formën përfundimtare 1993, në pamjen kronologjike mund të merret si vepër - urë kalimi për shkrimtarin nga njëri sistem politik në tjetrin, por vetëm nga ky aspekt sepse edhe ky roman përshkohet nga i njëjti stil, karakteristik për Kadarenë, nga e njëjta veçori e shkrimit: shkrimi i koduar me tekste dhe nëntekste, për një lexues mesatar: teksti; për lexues mbi mesataren dhe studiuesit: nënteksti. (Ndoshta zanafillën e këtij romani duhet ta kërkojmë në poezinë “Piramida e Keopsit”, 1967<sup>48</sup>). Edhe për shkak të afërsisë kohore “Piramida” ka komunikime me romanin tjetër “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” (1981), së pari për shkak të gjuhës së koduar artistike, pastaj për temën historike dhe vizionin mbizotërues që shpesh është ëndrra dhe vdekja.

Në tekst këto janë dy vepra në të cilat stigmatizohen tiranitë dhe absurditeti, paranoja që prodhojnë ato, tirania e faraonëve në lashtësinë egjiptiane, tirania osmane në kohët më të reja; në kontekst më të gjerë stigmatizohen tiranitë e reja moderne, fashizmi, nazizmi, komunizmi, absurditetet dhe paranojat e tiranisë komuniste shqiptare. “*Simboli i kësaj piramide është i njëllotë me synimin të “Pallati i Ëndrrave”*; të lidhen mes

<sup>46</sup> Tefë Topalli, Anisa Kosteri, “Veçori të gjuhës së folur në disa vepra të fundit në prozë të shkrimtarit Ismail Kadare” në T. Topalli, “Kërkime gjuhësore” 2, E.B. “Gjergj Fishta”, L.2011, f. 226.

<sup>47</sup> Umberto Eco, “Ironi ndërtekstuale dhe nivele leximi” në “Për letërsinë”, Dituria, 2007, f. 214.

<sup>48</sup> Ismail Kadare, “Dialog me Alen Boskenë”, Onufri, 1996, f. 154.

tyre të gjitha mendjet. Përmasa metaforike e piramidës mbërrin deri në ndërgjegje: ajo është Kullë e Babelit, bibliotekë universale”<sup>49</sup>. Pra edhe në këtë roman ndjehet qartë fryma universale si në anën tematike ashtu edhe në shtjellimin e temave apo motiveve, në këtë rast mund të vërehet se Kadareja i qaset temës shqiptare nga jashtë duke u nisur nga universalja, si edhe në vepra të tjera. Siç vënë në dukje edhe studiuesit më të fundit të veprës së Kadaresë: “*Prirja drejt simboleve universale shkon paralel me interesin për lëndën e lidhur me etnogjenezën me mitin kombëtar, arketipalen, letërsinë gojore dhe strukturën shpirtërore etnike*”<sup>50</sup>. (Kjo prirje është vënë re edhe më parë nga studimet letrare mbi prozën e Kadaresë<sup>51</sup>).

Studiuesit kanë vënë re se romani “Piramida” dhe disa vepra të tjera të Kadaresë janë mbështetur gjerësisht mbi analogjinë simbolike-alegorike<sup>52</sup> apo mbi parabolat hapësinore dhe kohore<sup>53</sup>. Romani funksionon përmes disa veçorive të diskursit modern si groteskut, ironisë, alegorisë dhe mbi të gjitha simbolit piramida, të cilës mund t’i bashkëngjiten të gjitha shtresat e mundshme kuptimore, si: piramida simbol i tiranisë nga koha e Keopsit, epoka e dinastisë IV faraonike, Timurit deri tek piramida e diktatorit shqiptar në qendër të kryeqytetit shqiptar, simbol i punës së kotë të popujve nën tirani, simbol absurd i vdekjes, simbol i dhunës ndaj njeriut, simbol i ëndrrave utopike të diktatorëve dhe tiranive të tyre, por edhe simbol i fundit të tyre, si varr që është; simbol i varrezave makabre nga koha e Timur Lengut deri te varrezat masive në ish-Jugosllavi. Siç shpjegon autori në një vepër tjetër: “*Rrallë kishte ndodhur që një simbol apo një metaforë të rrezatonte kështu, njëkohësisht të njëjtin kuptim, në trutë e dhjetëra mijëra njerëzve. Kjo dëshmonte se ideja që bota antike, të cilën unë e kisha sjellë aq shpesh në veprën time, ishte e afërt me gjithësinë komuniste, nuk ishte një pjellë intelektualiste, as figurë poetike, por njëmendësi, realitet*”<sup>54</sup>.

<sup>49</sup> Jean-Luc Tingaud, “Opusi i tiranisë” në “Piramida”, Onufri, 2010, f.13.

<sup>50</sup> Luan Topçiu, “Diktatura në formë piramide” në “Tradita moderne në letrat shqipe”, Zenit, 2010, f.199.

<sup>51</sup> Tefik Çausi, “Universi letrar i Kadaresë”, Tiranë, 1993, f. 270.

<sup>52</sup> Bashkim Kuçuku, “Analogjia –përftesë e romanit modern shqiptar” në “Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare” Akad. e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akad. e Shkencave të Shqipërisë, Prishtinë, 2005, f. 144.

<sup>53</sup> Muharrem Jakupi, “Koha dhe teknikat e tëhuajimit në romanin tonë modern”, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2008, 27/2, f. 601.

<sup>54</sup> Ismail Kadare, “Dialog me Alen Boskenë”, Onufri, 1996, f. 157.

Simboli i piramidës në roman është ai i përftuar nga konstrukti fizik dhe ai i ndërtuar nga konstrukti shpirtëror ku padyshim ky i dyti është më i rëndësishëm dhe më i pasur semantikisht. *“Ajo është në radhë të parë pushtet, madhëri. Ajo është shtypje, ngushtim i mendjes, vyshkje e vullnetit, mërzi dhe humbje. Ajo është roja jote më e mirë, faraoni im. Policia e fshehtë. Ushtri, flotë dhe harem i erandshëm. Sa më e lartë të jetë ajo, aq më i mpakët ngjan shtetasi nën hijen e saj. Dhe sa më i lartë të jetë shtetasi, aq më i lartë je ti, madhëri [...] Piramida është shtylla që mban pushtetin. Po lëvizi ajo, gjithçka do të shembet”*<sup>55</sup>. Jo rastësisht autori ndërton vizionet e tri piramidave që shënojnë tri epoka të çmendurisë së kultit të individit si epoka faraonike, piramida e Keopsit, epoka e mongolit Timur Lengu, në fund shek. XIV, piramida me koka të prera njerëzish, piramida iluzore e bombës atomike në Hiroshima në fund të Luftës së Dytë Botërore, piramida e diktatorit Enver Hoxha në vitet 1986 bashkë me bunkerët- piramidat bij, dhe piramida prej qelqi në Paris... Pra, romani mbështetet veçanërisht në polisemantikën e simbolit ndërsa subjekti, personazhet qëndrojnë në hije të simbolit, teknikë kjo karakteristike për romanin modern/postmodern. Subjekti është pothuajse inekzistent i shndërruar në një rrëfim ku narratori është të shumtën neutral, ai lëviz vetëm nëpër disa pika të domosdoshme si fillimi i ndërtimit të piramidës, koha e gjatë e ndërtimit të saj, ndërtimi dhe varrosja e faraonit, vjedhja e mumjeve kohë më pas. Simboli në këtë rast e eklipson subjektin apo personazhet e romanit, duke fokusuar vazhdimisht botën e personazhit Keopsit, faraonit.

Grotesku, alegoria dhe ironia i plotësojnë dimensionet kuptimore të romanit “Piramida”. Romani nuk mbështetet në befasishtë e intrigës së linjave apo subjektit, por përkundrazi i kalon të gjitha efektet artistike dhe kuptimore në rrafshin e mjeteve shprehëse artistike, në gjuhën artistike. Me anë të groteskut autori paraqet madhështinë, por edhe shëmtinë e një vepre të tillë, me një funksion varri, që në ndryshim nga varret që hyjnë në tokë kjo ndërtohet mbi tokë, një varr mbi tokë është i panatyrshëm për mentalitetin njerëzor. Madhështinë e një vepre inxhinierike perfekte, por makabritetin e një vepre për ndërtimin e së cilës vdesin mijëra njerëz, njerëz që vdesin për të ndërtuar varrin monument të njërit, faraonit, Keopsit. Ndërkaq një vepër në të cilën shkrihen pasuria, mirëqenia, dhe jeta e një populli me qëllim që faraoni të sundonte përjetësisht edhe pas vdekjes, një vepër e cila nuk do të linte kohë as energji për të menduar. Përgjatë gjithë romanit autori stigmatizon përmes ironisë paranojën e

<sup>55</sup> Ismail Kadare, “Piramida”, Onufri, 2010, f. 27.

tiranëve të cilët për të mbetur të pavdekshëm bëjnë të vdesin mijëra e mijëra njerëz, gjë e cila rezulton e kotë sepse ata vdesin si të gjithë të vdekshmit biles edhe më ligisht, si Keopsi i cili vitet e jetës pas ndërtimit të piramidës së tij i kalon në një pikëllim dhe frikë të thellë përballë vdekjes, e cila e kërkon për ta mbyllur në piramidën e tij. Piramidat e urryera bëhen objekt i vjedhjeve dhe i zbulimit se faraoni Didufriu ishte vrarë me sa duket nga kundërshtarët e tij të oborrit.

Edhe në këtë roman alegoria me realitetin shqiptar është një nga shtresat kuptimore të veprës, biles mund të identifikohet kjo alegori me realitetin shqiptar të viteve 1980-1990, dhe me ndërtimin e piramidës së diktatorit Enver Hoxha në qendër të kryeqytetit shqiptar, me të njëjtin funksion makabër në kohët moderne, një varr me të vdekurin brenda në një rën nga galeritë e shumta të saj, për ta mbajtur sistemin politik në këmbë, si piramida e Keopsit. *“Si një shkrepëtimë kjo ndodhi në vitin 1986, kur në Tiranë filloi projektimi e më pas ndërtimi i muzeut - mauzole të diktatorit të vdekur. Qysh në ditët e para ai u quajt prej të gjithëve “piramidë”. Ashtu si Byroja Politike do të fillonte të quhej Olimp e diktatori vetë, Zeus”*<sup>56</sup>. *“Duke shkruar librin e ndieja se piramida mund të kishte pamje të tjera, ajo ishte shfaqur në formë kristali ndërkaq në Paris e, mund të shfaqej në trajta të tjera në këtë planet të shqetësuar. Por unë dhashë motërzimin tonë komunist”*<sup>57</sup>.

Siç është vënë në dukje nga kritika romani e siguron linjën alegorike edhe përmes fjalëve terma që janë karakteristike për kohën moderne dhe tipike për regjimin komunist, si: Policia e fshehtë, Ministria e Jashtme, Shefi i hetuesisë, Zëdhënësi i faraonit, dosje hetimi, përgjues, komplot, përbetim, spiunë, denoncim, sabotim, arrestim, internim, mbledhje e ngutshme, festë përrurimi, ceremoni dekorimi, pritje ambasadrësh, fjalim, mbyllja e tempujve, urdhër nga lart, qarkore, kryeqytet, kantier me fjetore dhe gjelltoje, arkitektë, dyqani i bathëve etj., deri loja me emrat e udhëheqësve të lartë të shtetit komunist, si: faraoni Horus Sekhem- Kkhet/ Meh(hem)et Sheh (Sek)-u; mbikëqyrësi i Përgjithshëm Isesi/Isai (Hekuran); shefi i policisë së fshehtë Khadrihotep/ Kadri (Khadri) Ha (ho)-zbi<sup>58</sup>. Alegoria mund të themi nga vështirimi i sotëm se shtrihet edhe në të ardhmen, kur siç thotë narratori një diktaturë e

<sup>56</sup> Ismail Kadare, “Dialog me Alen Boskenë”, Onufri, 1996, f. 157.

<sup>57</sup> Po aty, f. 158.

<sup>58</sup> Shih më hollësisht Bashkim Kuçuku, “Analogjia – përftesë e romanit modern shqiptar” në “Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare” Akad. e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akad. e Shkencave të Shqipërisë, Prishtinë, 2005, f. 147.

re mund ta shfrytëzonte rrënimin e saj ashtu siç kishin shfrytëzuar të vjetrat ngritjen<sup>59</sup>.

Diskursi eseistik i narratorit e pasuron edhe më tej rrafshin kuptimor në roman, biles ai ndihmon edhe në interpretimin e veprës dhe na paraqitet si veçori e shkrimit të romanit të Kadaresë i theksuar në veprën e tij letrare, veçanërisht pas viteve 1990, si veçori e shkrimit modern apo postmodern. *“Vegimet piramidale shfaqeshin në formë ciklike, pa u marrë vesh kurrë në ç’kohë lindnin vërtet, përderisa askush s’mund ta dinte kurrë nëse ajo që vinte ishte vërtet e ardhme apo s’qe veç e shkruar që ecte mbrapsht si gaforrja. Më tepër besohej që edhe njëra, edhe tjetra s’ishin ato që mendoheshin, ngaqë të dyja mund të ndërronin kahjet, njëlloj si trenat e metrosë në një stacion fundor”*<sup>60</sup>.

Me të vërtetë se ky roman e krijon lexuesin aktiv duke realizuar skemën e plotë të komunikimit autor, tekst, lexues, ku lexuesi ka një rol të rëndësishëm në renditjen e shtresave kuptimore të tekstit duke shtuar edhe ato personale nga përvoja e tij jetësore apo kulturore duke u bërë një lloj “bashkautori”. Me këtë roman siç ka vënë në dukje ndonjë studiues receptojmë procedime, teknika të ndryshme stilistike (ludistike), të cilat në konstruksion hibrid (ludistik), jo vetëm që mundësojnë funksion të thellë estetik, pragmatika e së cilës do të duhej të definohet në kuadër të hermeneutikës ekzistenciale, por edhe ky lloj kombinim procedimesh, dukshëm forcon modernizimin shqiptar dhe kalimin e modernizmit shqiptar në postmodernizëm<sup>61</sup>.

**2.2 Romanin “Shkaba”, 1996**, autori e lajmëron që në veprën eseistike “Ftesë në studio”, 1990, kur shprehet se *“Për një strukturë tjetër skëterre jam përpjekur të shfrytëzoj një prozë të shkurtër mitologjike shqiptare që quhet “Qerosi në botën e poshtme”. Subjekti është i thjeshtë, por madhështor: Qerosi rrëzohet një natë në një vrimë dhe bie në botën e poshtme. Njëfarë kohe jeton atje, pastaj e merr malli të ngjitet përsëri lart. Por kjo është tepër e vështirë, për të mos thënë e pamundur.[...] Është e vështirë të gjendet një strukturë më e përshtatshme për të dhënë dramën e njeriut që për t’u ringjitur nga fatkeqësia ku ka rënë është i gatshëm për gjithçka, (ndoshta dhe krim)”*<sup>62</sup>. Ndërkaq ky motiv shfaqet edhe në romanin në dorëshkrim “Vajza e Agamemnonit” (1985) botuar në vitin

<sup>59</sup> Ismail Kadare, “Piramida”, Onufri, 2010, f.169.

<sup>60</sup> Po aty, f. 183.

<sup>61</sup> Afrim Rexhepi, “Estetika e lojës (grotesku, ironia alegoria) në romanin Piramida të I.Kadaresë” në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 25/2, Prishtinë, 2006, f. 331.

<sup>62</sup> I. Kadare, “Ftesë në studio”, Tiranë, 1990, f. 256-257.



2000: “Një natë, tek ecte nëpër terr, Qerosi u rrëzua në një vrimë dhe, bjer e bjer, ra në botën e poshtme...”<sup>63</sup>. (Në romanin në fjalë personazhi del skelet në botën e sipërme i mbartur nga shkaba të cilën e ka ushqyer me mishin e vet). Ngjan se në raport me romanin “Piramida” që shëmbëllen vizionin e ferrit sipër tokës, “Shkaba” shëmbëllen vizionin e ferrit nëntokësor, grafikisht shënon një piramidë të ngulur në hon.

Romani ndërthur elemente në “gjasmim” të realitetit faktik me elemente të fantastikes, që mbështetet veçanërisht mbi motivin e përrallës popullore shqiptare, rrjedhimisht elemente të kohës dhe hapësirës reale me ato të kohës dhe hapësirës sureale, karakteristike për përrallat apo legjendat: Koha dhe hapësira surreale ndërtohet nga përçartjet onirike të Maksit personazhit kryesor, i cili shpesh përziën mitiken me faktiken, të mundshmen me të pamundshmen, historiken me ahistoriken. Ndërkaq rrafshin kuptimor të veprës e pasurojnë herë pas here intertekstualiteti me motivet e mitit të Dedalusit dhe djalit të tij Ikarit, nga mitologjia greke (në roman arkitekti Deda dhe djali i tij, që janë duke projektuar një mjet fluturimi), motivi mbi mitin e Prometeut, shkaba që ushqehet me shpretkën e heroit, motivin e mitit të Odiseut (fshehja nën barkun e deleve për t’u fshehur nga Ciklopi i verbuar), deri në aludimet për mitet Edipike (“O Zot, ishte një mëmëvrasje ose atëvrasje, si ato të antikitetit”<sup>64</sup>), vizioni i “botës së përtejme” në përrallën gojore dhe vizioni i ferrit dantesk. Pra romani, “lëndën mitike me të gjithë përbërësit e saj poetikë, semiologjikë dhe semantikë ia nënshtron një procesi përpunimi dhe pasurimi”<sup>65</sup>.

Personazhi kryesor Maksi një mbrëmje, ndërsa del në rrugë për të blerë një paketë cigare, disa ditë pas një mbledhjeje në institucionin ku punonte (referenca me kohën dhe vendin kur është në gjasmim të realitetit na paraqet periudhën e socializmit, Bankën Kombëtare të Kursimeve, në kryeqytet), meqenëse nuk reagoi në mënyrën e “duhur” ndaj një kolegu që po kritikohet kolektivisht, shkel në një dërrasë të kalbur dhe bie në “botën e përtejme”: “Mirëpo rënia vazhdoi, dhe ajo “jo”, ndonëse e shkurtër si një klithmë shpendi, arriti të mbështillte brenda saj habinë për vijimin e rroposjes, mospranimin e saj”<sup>66</sup>. Në “gjasmim” me realitetin Maksi është një i ri, i cili si qindra njerëz në diktaturën komuniste, internohet duke u transferuar nga kryeqyteti në një provincë të humbur për shkak se nuk

<sup>63</sup> I. Kadare, “Vajza e Agamemnonit”, Onufri, 2010, f. 46.

<sup>64</sup> I. Kadare, po aty, f. 98.

<sup>65</sup> Adem Jakllari, “Simbolizmi mitiko-përrallor në romanin Shkaba të I. Kadaresë” në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 25/2, Prishtinë, 2006, f.257.

<sup>66</sup> I. Kadare, “Shkaba”, Tiranë, 1996, f. 9.

mban qëndrimin e duhur ideologjik klasor. Pas internimit ëndrron të rikthehet përsëri në kryeqytet, nuk ia arrin dhe në gjendje të dehur e mbyll jetën e tij me vetëvrasje. Ndërsa në kohën dhe hapësirën surreale është njeriu i cili pëson në ndërgjegjen e tij, një krizë të rëndë shpirtërore, krizë identiteti, tjetërsimi, bie në një humnerë të errët nga e cila e ka të pamundur të dalë, në pamundësi të bëjë kapërcimin nga humnera e krizës drejt botës së epërme të lirisë dhe shpresës përfundon njësoj në gjendje të dehur, në kafazin e një shkabe duke e identifikuar veten me heroin e një përralle, në pamundësi për ta përdorur shkabën si heroi i përrallës, vret atë dhe veten.

Romani analizon dhe shpreh artistikisht “*tjetërsimin tragjik të individit, mëdyshjet e mëdha që i krijohen atij brenda sistemeve shoqërore diktatoriale, dyzimi i qenies njerëzore, që ka për shkak jo vetëm rrethanat sociale armiqësore ndaj saj, por edhe informacionet dhe shtresimet kulturore të natyrës arketipale*”<sup>67</sup>. Përtej gjuhës së koduar Kadareja e shpreh qartë këtë tjetërsim që do ta mendojë shoqërinë shqiptare edhe për shumë kohë. Shkaba është simboli kryesor i romanit, nga niveli i një shpendi të harruar në kënd të kopshtit zoologjik në një provincë të humbur ajo ngrihet artistikisht në nivelin e një simboli mitik, ajo shpesh del edhe si simbol i mjetit ndihmës për realizimin e veprimit të heroit, simbol i lirisë së pamundshme, i fantazisë dhe i ndërgjegjes njerëzore ose si në shembullin e mësipërm edhe si simbol i shtetit totalitar që kërkon të kafshojë sistematikisht diçka nga shtetasit e vet, herë trupin e herë tjetër edhe shpirtin... Jo rrallë mjeti ndihmës (shkaba e përrallës) për të fituar lirinë dhe suksesin mund të të sjellë edhe dështimin = vdekjen.

Në nivelin mitik, mjeti ndihmës sjell realizimin e misionit, ndërsa në roman sjell mosrealizimin e tij, vdekjen. Në nivelin mitik shkaba kërkon më shumë mish, heroi duhet ta ushqejë me mishin e tij, por kjo do t’i sjellë përsëri vdekjen, atëherë në situatën pa rrugëdalje heroi vret shpendin “magjik” edhe veten. Në nivelin e gjasmimit me realitetin heroi përballë pamundësisë për t’u arratisur dhe për të gjetur rrugëdalje kryen vetëvrasje në “gjendje të rënduar psikike”. Ironikisht bëhet me dije se jo rrallë ëndrra për lirinë dhe suksesin mundet të përfundojë në mënyrë groteske,

**2.3. “Spiritus roman me kaos zblesë dhe çmërs”** (1996). Siç jepet në shtesën e titullit të romanit, Kadare ruan topikën e preferueshme: fizikja - metafizikja; e kësobotshmja - e matanshmja; i vdekuri - i gjalli; i vdekuri i

<sup>67</sup> Adem Jakllari, “Simbolizmi mitiko-përrallor në romanin Shkaba të I. Kadaresë”, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 25/2, Prishtinë, 2006, f. 257- 258.

gjallë - shpirti – trupi; e reales - e mitikes, e realomitikes. Situatat dramatike e tragjike të instaluara në kohën e regjimit komunist në Shqipëri, trandin botën e gjallë dhe atë të vdekur deri atje sa mund të ndodhë e pamundshmja: nga bota e vdekur të vijë një mesazh nga një i vdekur...

Që nga romani që do ta bëjë të njohur menjëherë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1963) Kadareja, në mënyra të reja do të shtjellojë vazhdimisht temat mbi vdekjen dhe jetën, në pranëvënie temat e tmerrit dhe dhunës që prodhojnë tiranitë që nga koha e faraonëve deri te diktatori shqiptar Enver Hoxha; janë tema por edhe shqetësime prej shkrimtari dhe intelektualit; si shkrimtar gjenial që ecën nëpër rrugët e hapura nga paraardhësit e tij, si Homeri, Eskili, Dante, Shekspiri, apo bashkëkohësve, si Kafka, Buxati, Markesi, Xhojsi, Prusti etj. Për këtë veçori të tematikës e problematikës së veprës me të drejtë studiuesit kanë vlerësuar se “...Nëse do të niseshim vetëm nga shpeshësia e takimit me vdekjen, në të gjitha pamjet e saj, si ndërprerje e zakonshme e jetës, si shpagim për vdekjen e tjetrit, si prurje e lëngatës, si varje a pushkatim nga shteti, si zvarritje ose linçim nga hakmarrja, gabimisht mund të mendohej se vepra e Kadaresë është pushtuar nga një nekrofili e padurueshme. Mirëpo raporti ndërmjet jetës dhe vdekjes në një vepër letrare nuk mund të përcaktohet me diagrama statistikore.”<sup>68</sup>.

Romani ndahet në tri pjesë “Kaosi”, me 17 syzime rrëfimesh; “Zbulesa”, me 13 syzime ose kapituj dhe “Çmërsi”. Në pjesën e parë protagonistin anonim, pjesëtar i një ekipi të huaj studiuesish të përvojave të popujve nën diktaturat komuniste të Lindjes, rrëfen nga veta e parë ndërsa në pjesën e dytë dhe të tretë, narratori rrëfen nga veta e tretë. Sikurse edhe veprat e tjera, romani mbështetet në dy shtresa motivesh. Njëra e pasur me motivet mitike si motivet baladeske: motra kërkon vëllain nuk e gjen dhe bëhet qyqe; motivi i Kostandinit që çohet nga varri për të mbajtur fjalën e dhënë. Motivi i mitit mbi Edipin, motivi i Telemakut që kërkon babain, motivi i teatrit shekspirian, nga “Hamleti”, motivi i fantazmës së babait të Hamletit, Shekspiri, motivi i fantazmës së Bankos te “Makbethi” etj. Ndërkaq janë të pranishme edhe referencat me Biblën dhe simbolikën e figurave biblike. Tjetra shtresë është e pasur me episodet dhe tragjeditë individuale apo kolektive nënurvejimin dhe persekutimin sistematik të regjimit komunist.

<sup>68</sup> Shaban Sinani, “Për prozën e Kadaresë”, “Naimi”, 2009, f. 107.

“Spiritus” duhet parë edhe si “një vepër që përmbledh teknikisht prozedetë e njohura dhe tipologjike”<sup>69</sup> të romaneve të Kadaresë. Është ndër të paktët romane që artistikisht bën objekt dhe rrëfen makthin e vërtetë të shoqërisë shqiptare nën diktaturën komuniste dhe metodat e saj makabre në dënimin jo vetëm të të gjallëve, por edhe të të vdekurve, të trupit por edhe të shpirtave, një vizion i tmerrit të tiranisë komuniste. Në romanet “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” apo “Dosja H”, kemi survejimin deri në botën e ëndrrave dhe në detajet e përditshme të “Spiritus” survejimi i shtetit totalitar synon edhe më të pamundurën survejimin përgjimin dhe regjistrimin jo vetëm të intimiteteve dhe bisedave të përditshme, por edhe atë të shpirtave nga bota tjetër, nga Perëndimi ose nga zona e vdekjes. Te romani “Piramida” parabola e çmendurisë së faraonëve që veten duan të shpallin të përjetshëm dhe popullin e tyre e vrasin në një punë çnjerëzore, pa vlerë, me qëllim që ta sundojnë. Te “Piramida” ndërtuesit dhe mjeshtrat e sekreteve janë të ndëshkuar të vdesin bashkë me sekretet; te “Spiritus” regjimi ndëshkon pas përdorimit edhe nëpunësit e vet dhe funksionarët e vet politikë, me qëllim që heshtja të mbysë çdo gjë dhe në majë të piramidës shtetërore të ekzistojë përjetë diktatori ose miti i tij, pas vdekjes.

Ndërkaq lidhur me kohën e hapësirën autori edhe në këtë roman përdor një teknikë të përdorur edhe në ndonjë roman tjetër të cilën e ka shpjeguar kështu: “Nga qindra të thëna, maksimat e paradokset që kam lexuar për të, është njëra që s’më harrohet, thënia e Aristotelit, sipas së cilës ne dhe koha gjendemi në po atë raport që gjenden dy rrotëza që rrotullohen me shpejtësi të ndryshme. Në këtë mënyrë në mund ta kemi lënë pas një ngjarje, (p.sh. luftën e Trojës), po aq siç mund ta kemi atë ende përpara. Sado i palogjikshëm të duket një përfitim i tillë, poetikisht ai është i mrekullueshëm”<sup>70</sup>. Sipas këtij konceptimi Shpend Guraziu mund të quhet i vdekur që në fillim të pjesës së dytë “Zbulesa” kur merr pjesë në një seancë spiritizmi me shpirta dhe medium, sepse më vonë ai do të marrë pjesë përsëri në këtë seancë spiritizmi, por kësaj radhe si *shpirt*.

Në romanin e Kadaresë analiza e “zonës së zezë”, të fshehtë, qoftë të qenies njerëzore qoftë të shteteve totalitare, është shëndërruar tashmë në një teknikë artistike të perfeksionuar nga njëri roman në tjetrin, aq sa nuk ka roman në të cilin autori nuk e zhbiron këtë zonë deri edhe me një tendencë të qartë psikanalitike: ajo është pavetëdija, vdekja, misteri dhe fenomenet misterioze shpirtërore, por edhe instiktet, primitiviteti si

<sup>69</sup> Luan Topçiu, “Spiritus”- romani sintezë” në “Tradita moderne në letrat shqipe”, Zenit, 2010, f. 204.

<sup>70</sup> I. Kadare, “Ftesë në studio”, “Naim Frashëri”, 1990, f. 170.

kundërvënie ndaj qytetërimit. Në këtë udhëtim psikanalitik Kadare shfrytëzon siç është e njohur në romanet e tij rrugët mitike, kapilarët e të cilave i lejojnë të kalojë lehtësisht sa në një dimension sa në një tjetër, të individit apo të kolektivitetit. “... pra, zezona ishte e tillë sa që, një i vdekur, pas tre vjetësh pasi ishte kallur në dhe, kishte arritur të dërgonte një kumt mbi tokë”<sup>71</sup>.

Proza e Kadaresë prodhon efekte tronditëse përmes shtjellimit të situatave që janë në vetvete të tilla dhe artistikisht bëhen edhe më tronditëse. Përmes këtyre efekteve krijohen gjendjet e tmerrit, ankthit, absurdit, të cilat me lexuesit që i njohin realitetet e diktaturës komuniste përjetojnë dyfish, një herë si përjetim real, njëherë si përjetim artistik...

#### LITERATURA:

1. Adem Jakllari, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 25/2, Prishtinë, 2006.
2. Afrim Rexhepi, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 25/2, Prishtinë, 2006.
3. Bashkim Kuçuku, në “Studime albanologjike”, 2008/2, viti XIII, U. Tiranës, F. i Historisë dhe i Filologjisë.
4. Bashkim Kuçuku, në “Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare” Akad. e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akad. e Shkencave të Shqipërisë, Prishtinë, 2005.
5. Behar Gjoka, “Kadare i rilexuar”, “Princi”, Tiranë, 2008.
6. Shaban Sinani, “Për prozën e Kadaresë”, “Naimi”, 2009.
7. Muharrem Jakupi, në “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2008, 27/2.
8. I. Kadare, “Ftesë në studio”, Tiranë, 1990.
9. Ismail Kadare, “Dialog me Alen Boskenë”, Onufri, 1996.
10. Ismail Kadare, “Dialog me Alen Boskenë”, Onufri, 1996.
11. Tefik Çausi, “Universi letrar i Kadaresë”, Tiranë, 1993.
12. Umberto Eco, “Ironi ndërtekstuale dhe nivele leximi” në “Për letërsinë”, Dituria, 2007.
13. Tefë Topalli, “Kërkime gjuhësore” 2, E.B. “Gjergj Fishta”, 2011.
14. Luan Topçiu, “Tradita moderne në letrat shqipe”, Zenit, 2010.

---

<sup>71</sup> I. Kadare, “Spiritus”, Onufri, 1966, f. 60.

**Continuity and variety of Kadare's style as novelists  
The novels after 1990**

*SUMMARY*

From literary critics and studies of this age, I. Kadare's novels after 1990 has been seen as continuity, but also has variety of the style of this novelist. For this reason perhaps the division in two chronological phase of the composition of this author has its value only as reference, because he conserve generally and elaborate known properties and techniques of his works. To exclude thematic elements, that in freedom's condition he expand it, comprising directly Albanian actuality's themes; it seems to have not a new "break" in his new works. In the novels of this author we can notice once more the presence of poetics' elements of realist's novels free combined with poetics' elements of modern or post-modern novel, but not searching to upturn it, neither an experimentation or detachment in his former literature, but as natural affirmation and flow literary writing, when the outside ideological obstacles fall. Of course this author witness a natural passage from the novel before '90, as a creative experience, that is not shaking up completely, it does a common reparation and adaptation for a writer.

**Diana KASTRATI**

## **EPOKA E MODERNIZMIT DHE MITI I SAJ NË SHQIPËRI**

### **1.1. Miti “tradicional” dhe modernizimi**

Lindja dhe zhvillimi i miteve të reja në Shqipëri ka marrë vëmendjen e studiuesve të shkencave humanistike prej shumë kohësh. Optikën e interpretimit ndaj problemit të marrë në shqyrtim, fillojnë të marrin përthyerje mjaft të ndryshme nga çfarë jemi mësuar të kuptojmë deri më tani. Faktorët që çuan në këtë profil të studimeve humanistike, përfshi këtu edhe antropologjinë kulturore e sociale, janë të shumtë, por do të parapëlqenim të veçonim dy prej tyre që, sipas mendimit tonë, kanë qenë dhe konsiderohen si më vendimtarët: 1) *lindja dhe zhvillimi i mjeteve të komunikimit të masës*, apo siç njihen ndryshe *mass-media* dhe; 2) *Epoka e re e Modernizmit* me pasojë në shekullin e kaluar, *Globalizimin*.

Para se të shqyrtojmë këto dy aspekte-faktorë të sipërpërmendur, do të përpiqemi të analizojmë *Traditën*, apo natyrën e saj. Përseja është e thjeshtë: vetëm duke kuptuar çfarë është dhe çfarë përmban tradita, karakteristikat e saj dhe vendin e saj në shoqëritë moderne, mund të arrijmë të flasim për vendin që zë ajo realisht, apo atë që do të duhej të zinte në shkencat humanistike së pari, e pastaj në mendësitë kolektive të të gjitha shoqërive të sotme, përfshi edhe atë shqiptare. Etnografia dhe etnologjia, janë dy shkencat bazë të studimit të miteve të traditës, ato që përbëjnë zanafillën e etnokulturës shqiptare, të ushqimit shpirtëror e të praktikës sociale. Njëkohësisht, falë tyre dhe punës së palodhur e titanike të studiuesve si Mark Tirta, Qemal Haxhihasani etj., të cilët i vunë këto dy lëma dijesh në baza shkencore, arrijmë të kuptojmë edhe rrugëtimin e gjatë të mbijetesës rezistente të këtyre miteve.

Por, nëse i referohemi kuadrit të sotëm të mitologjisë moderne me markë shqiptare, do të vërejmë se kjo hartë ka ndryshuar shumë si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. *Miti tradicional* vihet në “djepin e artë” të një pasurie të palëvizshme, si një trashëgimi e bukur mbarëpopullore që ndihmon të kuptuarit e humusit etnokulturor shqiptar. Ndërrimet e forta historike e politike në terrenin tonë, kanë sjellë gjithmonë tronditje e kapërthime, ngandonjëherë të ngërçshme, të cilat janë reflektuar fuqishëm edhe në kornizën kulturore e shpirtërore të popullit shqiptar. Nga ana tjetër,

jemi të bindur se një fenomen i tillë i shndërrimeve gati radikale në të gjitha nivelet e ekzistencës njerëzore shqiptare, është karakteristikë e vendeve të cilat nuk kanë arritur akoma një stabilitet dhe ekuilibër socio-politik, e si pasojë presin me krahë hapur çdo prurje të re pa e filtruar edhe aq shumë. Shumë mite kanë qëndruar, por po aq janë krijuar të reja. Sa do të jetë jetëgjatësia e tyre? Sa do t'u rezistojnë kohëve që do të vijnë? Duke përjashtuar mundësitë e profetizimit, do të shohim realisht mundësitë që ka sot pëlhura kulturore e shpirtërore shqiptare për të mbajtur në kembë çfarë ka më të mirë nga tradita e çfarë i ofron modernizmi.

Para kësaj le të kuptojmë katër karakteristikat e përgjithshme të traditës, të paktën sipas studiuesve të teorisë sociologjike të mendimit. Tradita mund të ketë katër aspekte të karakterit, 1) *hermeneutik*; 2) *normativ*; 3) *legjitimimi*; 4) *aspektin e identitetit*.<sup>72</sup>

Këndvështrimi i aspektit të parë, *hermeneutik* është të shikuarit e traditës si një bashkësi tezash që individët i përdorin si të mirëqena në sferën e përditshme të jetës e që trashëgohen nga brezi në brez. Në këtë rast mund të themi se kemi një skemë interpretuese që ndihmon në të kuptuarin e botës. Edhe vetë filozofët hermeneutikë si *Heidegger*<sup>73</sup> e *Gadamer*<sup>74</sup> kanë nënvizuar se *nuk mund të ekzistojë një interpretim pa patur një bazë hamendësimesh e tezash të cilat merren për të mirëqena e që përfaqësojnë një pjesë të traditës së cilës i përkitet*. Asnjë interpretim nuk mund të jetë tërësisht i lirë nga hamendësimet. Si pasojë, *kritika iluministe e traditës duhet të saktësohet*, thekson Gadamer. Gjithmonë sipas tij, duke i kundërvënë nocionet e arsyes, njohjes shkencore dhe emancipimit të autoritetit të miteve, mendimtarët iluministë nuk e kanë mënjanuar aspak traditën, por thjesht po artikulonin një bashkësi tezash e metodash që formojnë bërthamën e një tradite tjetër, atë të vetë iluminizmit. Në interpretimin hermeneutik, iluminizmi nuk është një antitezë e traditës, përkundrazi, është një traditë (apo bashkësi traditash), ose një kompleks tezash të marra si të mirëqena e që furnizojnë një strukturë mbi bazën e të cilës mund të interpretohet bota.

*Aspekti i dytë* i traditës, i quajtur *normativ* nga studiuesit, i drejtohet atij mozaiku tezash, formash besimi të trashëguara nga e kaluara, nga brezi në brez, të cilat respektohen në formë normash sjelljeje në të tashmen e që shërbejnë si norma për veprimet e besimet aktuale. Kjo mund të ushtrohet në formën e *rutinës* dhe, pjesa më e madhe e individëve në jetën e

<sup>72</sup> Thompson John B., *Mezzi di comunicazione e modernità, Una teoria sociale dei media*, il Mulino Saggi, f.260, 1998.

<sup>73</sup> Heidegger, M., *Essere e tempo*, Torino, UTET, f. 31-33, 1969.

<sup>74</sup> Gadamer, H.G., *Verità e metodo*, Milano, Bompiani, f. 317, 1983.



përditshme kryen këto veprime që konsiderohen rutinë. Nga ana tjetër mund ta gjejmë natyrisht në formën e materialit të transmetuar nga e kaluara, i cili shërben si normë udhëzuese sepse *disa praktika gjejnë themelin e tyre në traditë*, ose janë të themeluara apo të justifikuara falë referimit të traditës. Në këtë rast, meqenëse bazat e veprimit janë bërë të qarta dhe janë ngritur në nivelin e përlligjjes auto-evidente, gjendemi përballë një kuptimi normativ edhe më të theksuar se në rastin e parë.

*Aspekti i tretë i traditës* është ai që mund ta quajmë i *legjitimitetit*. Me këtë term kuptojmë faktin që ndonjëherë tradita, në disa rrethana të caktuara mund ta mbështesë pushtetin dhe autoritetin. Sipas Weberit, legjitimiteti i një sistemi pushteti mund të vendoset në tri mënyra kryesore. Mund të bazohet mbi *racionalitetin*, ose mbi besimin në ligjshmërinë e rrethave të formëzuara (ato që Weber i quan “pushtet ligjor”); mënyra e dytë, mbështetet mbi *forcën karizmatike* duke sjellë si pasojë respektimin ndaj shenjtërimit apo tipareve të jashtëzakonshme të një individi (“pushteti karizmatik”); së fundmi, mbi traditën vetë ose *mbi shenjtërinë e traditave shumë të vjetra* (“pushteti tradicional”). Nëse pushteti është ligjor, individët i binden një sistemi rregullash pavetore. Anasjelltas, në rastin e pushtetit tradicional, bindja i detyrohet personit, pushteti dhe autoriteti i lirisë së veprimit të të cilit, janë të sanksionuara nga tradita.

Është e pamundur ta nënvleftësojmë dobishmërinë e analizës së pushtetit tradicional të propozuar nga Weber. Kjo tezë, ndihmon mjaft edhe në të kuptuarit e disa konteksteve shumë të hapura politike. Përveç se udhëzues normativ i veprimit, mund të shërbejë edhe si bazë për ushtrimin e pushtetit mbi të tjerët e si garanci bindjeje ndaj urdhrave. Për këtë arsye, shpeshherë, traditat mund të shndërrohen në “ideologji”: ato mund të shfrytëzohen për të stabilizuar ose për të përforcuar lidhjet e pushtetit, lidhje të strukturuar në mënyrë sistematikisht të çekuilibruara.

*Së fundmi, tradita lidhet edhe me formimin e vetvetes*, pra me aspektin e identitetit. Në këtë proces përfshihet edhe *identiteti personal*, edhe ai *kolektiv*. I pari, ai personal, tregon kuptimin e vetes, të një individi të pajisur me disa veçanti e potencialitete që karakterizojnë rrugëtimin e tij ekzistencial. Identiteti kolektiv nga ana tjetër, i referohet kuptimit të vetes, por në këtë rast si anëtar i një grupi apo kolektivi social. Është ndjesia e përkatësisë, ndjesia e të bërit pjesë të një grupi social që ka një histori të vetën e një fat kolektiv. Cila e sa është rëndësia e traditave në lidhje me këto dy momente të formimit të identitetit? *Duke qenë traditat një bashkësi modelesh e sjelljesh të trashëguara nga e kaluara, ato furnizojnë një pjesë të materialit simbolik të nevojshëm për formimin e të dy identiteteve*. Pavarësisht niveleve të ndryshme sipas konteksteve sociale, kuptimi i vetes

dhe përkatësia janë që të dyja të modeluara mbi këto vlera, besime e forma sjelljesh. Procesi i formimit të një identiteti nuk mund të fillojë nga zeroja. *Ai ndërtohet mbi bazën e një materiali simbolik paraekzistues që shërben më pas si themel i identiteve.*

Megjithatë, ka shumë mundësi që, falë lindjes së mjeteve të komunikimit të masës, natyra e këtij materiali simbolik paraekzistues të ketë ndryshuar, madje edhe në disa aspekte shumë të rëndësishme, të cilat kanë sjellë edhe implikime aspak të vogla.

Nëse flasim për një rezistencë të traditës në botën moderne, a është e mundur pra të flasim për zhdukjen e shoqërive tradicionale? Kundërshtia midis këtyre dy shoqërive, e parë nën këtë dritë, a ngjan si e gënjeshtërt? Në fakt është e tillë. Lidhja midis këtyre dy realiteteve është shumë më paradoksale se sa mund të hamendësohet duke u nisur nga një pohim i tillë. Rënia e autoritetit tradicional si dhe e të vepruarit në një mënyrë të tillë, nuk sjell vdekjen e traditës, por shenjon një transformim të natyrës e të rolit të saj, një transformim i prodhuar nga fakti se, për ta interpretuar botën e për t'u ndjerë pjesë e saj, individët arrijnë t'i besohen gjithnjë e më shumë traditave të ndërmjetësuar nga mjetet e komunikimit, por tashmë të *delokalizuar*. Lidhja e traditave me këto të fundit, është e dyfishtë: nga njëra anë *zhvillimi i mediave e lehtëson rënien e autoritetit tradicional* si dhe të rolit vendimtar të saj në veprimin e shoqërisë; nga ana tjetër, *mjetet e reja të komunikimit dhurojnë njëkohësisht edhe instrumentet për ta ndarë transmetimin e traditës nga aprovimi i përbashkët i një mjedisi shoqëror*, duke krijuar kështu kushtet për rinovimin e traditës në një tjetër nivel. Të këtij mendimi janë një seri sociologësh, të cilët kanë argumentuar përsenë e një transformimi shoqëror nga ndikimi i fuqishëm i mediave, por duke ruajtur gjithsesi traditën e cila mbetet në bërthamën e një komuniteti, por vetëm me një veshje të re.

## 1.2. Tradita dhe mediat. A çrrënjosen traditat nga këto të fundit?

Në fushën e studimeve mbi zhvillimin e, në veçanti, të raportit midis zhvillimit dhe komunikimit, spikat një vepër e cila flet mbi këtë çështje, por në kontekstin e Lindjes së Mesme. Pavarësisht se vepra është shkruar disa dekada më parë, autori, Daniel Lerner<sup>75</sup>, ka ditur të mbjellë aq “zhurmë” sa duhet për të ngjallur diskutimet mbi këtë fenomen të ri që po pushtonte botën, siç u vërtetua në fakt më vonë. Pavarësisht kritikave të

<sup>75</sup> Lerner, D., *The Passing of Traditional Society: Modernizing the Middle East*, Glencoe, III, Free Press, 1958.

kohës, por edhe të mëvonshme, si një teori etnocentrike dhe e kapërcyer nga modernizimi, e bazuar mbi modelet perëndimore dhe mbrojtëse e endoxheneitetit të një pjese të mirë të proceseve, këto rezerva, gjithsesi, po mundohemi t'i shmangim duke marrë në konsideratë faktin se kjo vepër trajtoi ndoshta për herë të parë një problem të tillë kaq të madh e me interes të shumëfishhtë. Edh pse mund ta quajmë veprën “bijë të kohës së vet”, dhe të pranojmë kufizimet që mbart, është e vetmja që e analizon çështjen në mënyrë të detajuar dhe empirike. Le ta shohim paksa si e trajton *Lerner* këtë problem, duke marrë gjithsesi edhe pozicionimin tonë.

Sipas tij, ka një *dallim të qartë midis shoqërive tradicionale dhe atyre moderne*. Ai kërkon të individualizojë kushtet që të çojnë nga e para tek e dyta. Çfarë i karakterizon *shoqëritë tradicionale*? Sipas *Lerner*, ato janë të fragmentuara në komunitete të izoluara e të bazuara në masën më të madhe në lidhjet farefisnore. Horizontet e individëve kufizohen e kushtëzohen nga vendi, ndërsa ndërveprimet e tyre me të tjerët kufizohen me individët e njohur e që ndahen nga i gjithë mjedisi i përbashkët social. Jeta e përditshme drejtohet nga modelet tradicionale. Nuk ndjehet e nevojshme të mbrohen apo të përligjen modele të tilla, është shumë e thjeshtë: për shumicën e individëve nuk ekzistojnë modele të tjera. Individit i shoqërive tradicionale nuk interesohet për çështje të cilat janë jashtë kontekstit të tij. Nuk ka kureshtje për ngjarjet që ndodhin në vendet e largëta nga ai ku jeton. Si pasojë, meqenëse jeton një jetë të bazuar mbi shprehi, as nuk vë në diskutim, as nuk eksperimenton risi. Në shoqëritë tradicionale, vetja, është “vetvete e detyruar”: rrënjët e saj janë tek mjedisi familjar e i zakonshëm, ndërsa zhvillimi i tij është i organizuar pa asnjë lloj ndërjegjësimi për alternativa të tjera të mundshme nga praktikatat ekzistuese.

Cili është kuadri *i individit të shoqërisë moderne*? Gjithmonë sipas gjykimit të tij, kemi të bëjmë me një gradë elasticiteti e lëvizshmërie që është krejt e kundërta e “vetvetes të detyruar” të shoqërive tradicionale. Gjejmë një hapje të vetvetes të çdo individit dhe aftësi të reja për t'u imagjinuar secili prej tyre në situata, vende e mundësi të paparashikuara, shtime udhëtimesh e spostimesh fizike përfshi edhe emigracionin brenda. Një hapje e tillë, pa pikë dyshimi, e këtu shprehim edhe bindjen tonë, është stimuluar edhe falë përhapjes së përvojave të lehtësuara nga ndërmjetësimi *i mjeteve të komunikimit të masës*. Parë nga ky këndvështrim, këto mjete mund të quhen një “*shumëfishues i lëvizshmërisë*”. Këto mjete-instrumente, vënë në dispozicion të individit një gamë të gjerë përvojash që në kushte të tjera do të ishin të pamundura të jetoreshin dhe, e kryejnë këtë rol pa kërkuar spostime fizike. Përveç kësaj, pikërisht sepse bëhet fjalë për një

përvojë fantazie, përvoja e ndërmjetësuar nga mjetet e komunikimit shërben edhe si edukatore e imagjinatës. Individidi përfiton përvojën e të vendosurit në vend të tjetrit, në situata edhe shumë të largëta nga e vetja. Si rrjedhojë, ngurtësia e mënyrave tradicionale kriset, nëse personat përballen me situata që më parë ishin të paimagjinueshme. Jeta shoqërore ngjan më e pasigurtë nëse individët fillojnë të pyesin veten se çfarë do të ndodhë, në vend që të rehatoheshin se e ardhshmeja do t'i ngjante, siç kishte ndodhur deri më atëherë, të kaluarës së sigurtë.

Lerner përdor termin “*empati*” për të treguar *aftësinë e stimuluar nga ekspozimi ndaj mediave*, për ta imagjinuar veten në vend të tjerëve, një aftësi që ai e konsideron një karakteristikë kyçe për jetën shoqërore moderne. Falë zhvillimit të empatisë, individët arrijnë ta ngrenë shkallën e vetvetes në një nivel më të lartë, hapet rrezja e shikimit duke u shndërruar në qenie të afta për të provuar dëshira edhe më të guximshme. Në vend që ta imagjinojnë veten të ngujuar përjetësisht në një vend fikse, brenda një rendi gjërash të paracaktuara prej shekujsh e për rrjedhojë të pandryshueshme, vetvetja imagjinohet si një pikë që lëviz e shëtit përgjatë një rrugëtimi ngjarjesh të imagjinuara

*Ekspozimi ndaj mediave, ndikon edhe në mënyrat se si raportohet individi ndaj pushtetit dhe autoritetit.* Një gjë të tillë, Lerner e ilustron me një shembull të marrë nga një fshat në Liban dhe impaktin e fortë që patën mjetet e komunikimit në këtë realitet. Në rrjetin e komunikimeve tradicionale, burimet njerëzore luanin një rol shumë më të rëndësishëm se mjetet e komunikimit të masës. Banorët e fshatit arrinin të informoheshin e të shpërndanin lajmet veçanërisht nëpërmjet takimit ballë për ballë me të njohurit e tjerë. Ishin krerët e fshatit, pronarët e terreneve, autoritetet fetare e të moshuarit që gëzonin statusin e opinionbërësve. Deri atëherë kur fshatrat kishin mbetur relativisht të izoluara nga pjesa tjetër e botës, respekti i njerëzve u drejtohej këtyre figurave, veçanërisht të moshuarve. Statuti i autoritetit, por edhe i pushtetit ishte plotësisht për ta. Por, sapo izolimi i la vendin shkëmbimeve gjithnjë e më të dendura me qytetet apo me qendrat e mëdha urbane, *autoriteti tradicionalisht i garantuar që gëzonin të moshuarit, filloi të bjerë.* Një grup tjetër ndërmjetësish filloi të luajë rolin e të parëve: meshkujt e rinj që dilnin shpesh në qytet, hynin në kontakt edhe me mediat. Ato transmetonin lajme, i interpretonin ato dhe *riplazmonin opinionet.* Duke qenë të pafavorizuar nga mosha, nga pamundësia për të lëvizur, duke mos ditur të lexonin e të shkruanin, të moshuarit e humbën influencën e tyre. Situata u kthye në favor të të rinjve, të cilët ishin të “zënë” tashmë në rrjetin e ri e të stërmadh të komunikimit të masës.

Për sado të duket e superuar një situatë e tillë e përshkruar nga Lerner, jo vetëm në Libi, por edhe në vende e situata të tjera, gjejmë shumë pika të afërta me të, por mbi të gjitha e gjejmë të një analize mjaft të bindshme nga pikëpamja logjike e shkencore. Në punimin tonë, ajo që na intereson më shumë e që na ka vërtetë rëndësi, është *roli vendimtar e i pakthyeshëm që luajtën mediat në shoqëritë njerëzore në të gjithë globin*. Transformimet kulturore të ndodhura përgjatë gjithë shekullit të kaluar, (madje këtu nuk po konsiderojmë edhe ato të shekullit XIX), janë konferma më e madhe e këtij fenomeni.

Pavarësisht ekzistencës së shumë shkollave të mendimit në lidhje më vendin që zë tradita në shoqëritë moderne, gjithsesi duhet thënë se krijimi i këtyre të fundit nuk është se e fshiu nevojën për të formuluar sisteme të reja besimi, konceptesh e vlerash për t'i dhënë një kuptim botëve të reja që po lindnin. Në ditët e sotme, ndoshta shumë shoqëri që janë në embrion të zhvillimit të tyre modern në kuptimin e vërtetë të fjalës, siç është rasti i Shqipërisë, po hiqet keq të kuptohet ekuilibri që duhet vendosur midis këtyre dy elementëve bazikë për një shoqëri: *tradita apo modernizmi me sistemet e tij të besimeve*. Këto sisteme të reja konceptesh e besimesh, një kombinacion i besimit në progres, së bashku me njohjen shkencore e humanizmin shekullor, disa autorëve u janë dukur autoevidentë<sup>76</sup>.

Por, ajo që për ndokënd ishte marrë si e mirëqenë, për të tjerë përfaqësonte vetëm një zgjedhje, zgjedhjen për të privilegjuar disa koncepte të caktuara, disa vlera e besime në vend të disa tjerave. Natyrisht që të privilegjosh, do të thotë që automatikisht të kryesh përjashtime, apo humbje siç interpretohet prej disa studiuesve. Ndër këto të fundit mund të fusim edhe atë që e kemi quajtur "*deficit moral*", ose e thënë ndryshe, paaftësia për të përballur disa çështje themelore që lidhen me jetën, me vdekjen, me të drejtën e me të padrejtën. Në këtë kuadër mund ta konsiderojmë si deficit moral edhe të mbajturit gjallë të bindjes së rëndësisë së përjetshme të traditës fetare, tek disa persona. Të ruajturit e besimit ne fé të ndryshme, është pjesë integrale e shoqërive si tradicionale, ashtu edhe atyre moderne, meqenëse praktikat fetare ndërthuren me aktivitetin e përditshëm të individëve. Për këtë arsye, Thompson<sup>77</sup> e sheh rolin e këtyre besimeve si një ushtrues të fortë të një autoriteti tradicional që në periudhën e lindjeve të shoqërive moderne, thjesht është rimodeluar. Nga ana tjetër, ai thekson se ky rimodelim është edhe *relativizuar* nën dritën e autonomisë në

<sup>76</sup> Bawman, Zigmund, *Modernity and Ambivalence*, Cambridge, Polity Press, 1991.

<sup>77</sup> Thompson J.B., *Mezzi di comunicazione e modernità, Una teoria sociale dei media*, il Mulino Saggi, f. 272, 1998.

rritje të individit si një faktor i aftë për të reflektuar e për të plazmuar identitetin e vet.

Gjithsesi, vlen për t'u nënvizuar se zhvillimi i mjeteve të komunikimit nuk ka çuar në vdekjen e traditës, por e ka *transformuar* atë në aspektet më kryesore të saj. Në vijim të këtij zhvillimi, proceset e formimit e të transmetimit të traditës janë varur në masën më të madhe nga mediat. Meqenëse shumë forma të komunikimit mediatik, kërkojnë një lloj grade fiksimit të përmbajtjes simbolike mbi një substrakt material, këto mjete i *pajisin këto përmbajtje me një rezistencë ndaj faktorit kohë*. Pa këtë proces të fiksimit, ruajtja e traditës në kohë, kërkon përsëritjen e vazhdueshme simbolike në aktivitetet e jetës së përditshme. Përsëritja praktike është e vetmja mënyrë për të siguruar vazhdimësinë në kohë. *Përfshirja e mjeteve mediatike në kultivimin e vlerave e besimeve të reja, e siguron këtë formë të përsëritjes në kohë, por redukton nevojën e përsëritjes*. Për këtë arsye, rënia e disa aspekteve të ritualizuara të traditës (frekuentimi i vendeve të kultit, për shembull), nuk duhet të interpretohet domosdoshmërisht si një perëndim i traditës. Në fakt, tradita *deritualizohet* në njëfarë mënyre.

Gjithmonë në kuadrin e transmetimit të traditave nga mjetet e komunikimit mediatik, ndodh që ky proces të *depersonalizohet*. E thënë ndryshe, ajo merr një formë që nuk është më thjesht personale për secilin pjesëtar të komunitetit, por fiton (tradita) një autonomi e autoritet të vetin, si një sistem vlerash, besimesh e konceptesh që ekzistojnë e mbijetojnë pavarësisht individëve të përfshirë në transmetimin e tyre nga një brez tek tjetri.

*Depersonalizimi i traditës* nuk është gjithsesi një proces uniform e i njëtrajtshëm. Natyra e kësaj lidhjeje mjaft interesante, me zhvillimin e mjeteve mediatike, kryesisht elektronike, të televizionit në veçanti, midis autoritetit të traditës dhe individëve që e transmetojnë, ka filluar të rikrijohet. Në një masë të madhe, kjo lidhje vendoset e mbahet në brendësi të kornizës së ndërveprimit gati mediatik. Të gjithë ne jemi “njohës”, apo “të njohur”, të personazheve me influencë në televizion, i dëgjojmë ato, u besojmë apo jo, por ne kemi një kontakt të fortë e të dendur. *Sidomos në Shqipëri, kontakti me figurat politike, është i përminutshëm*. Në kushtet normale të një shoqërie të ngritur e të konsoliduar nga çdo pikëpamje, një kontakt i tillë nuk do të ekzistonte, por problemet e forta ekonomike e politike kanë sjellë në qendër të vëmendjes një grup të caktuar “predikuesish” që luajnë rolin edhe të predikatorëve “fetarë” që ndriçojnë mendjet e njerëzve. *Ripersonalizimi që i bëjnë traditave, nëpërmjet autoritetit të pushtetit të traditës (në rastin tonë krejt unikal shqiptar), bën*

*të mundur që individët të vihën në kontakt aty ku mungon ndërveprimi apo ndërsjellësia. Thompson e quan një proces të tillë “intimitet jo i ndërsjellë në distancë”. Ne, masa, turma, dëgjojmë ata, politikanët, të cilët predikojnë e, ndriçojnë mendjet, por pa hyrë në kontakt të drejtpërdrejtë me palën tjetër. Tradita u vihet në shërbim të plotë, për fat të keq nga ana e padrejtë për masën e dëgjuesve. Mediat ua lehtësojnë detyrën atyre, duke na e vështirësuar neve. Tradita, ripersonalizohet falë mediave.*

Me zhvillimin e mediave, traditat që i kishin rrënjët në një vend të caktuar, kanë filluar të humbasin karakteristikat që i ankronin aty. Me fjalë të tjera, sa më shumë që mbijetesa dhe transmetimi i tyre nga brezi në brez u besohet formave të komunikimit mediatik, aq më shumë traditat ndaheshin nga vendet e tyre të origjinës. Çrrënjësja ose “delokalizimi” i traditave ka pasoja të forta. Si çdo gjë tjetër në universin tonë jetësor, varet se në çfarë duarsh bie përdorimi i tyre. Traditat e çrrënjësura që folëm pak më parë, shpesh kanë fatin e keq që të bien prë e manipulimit të individëve që kanë akses në mjetet e prodhimit e të shpërndarjes të formave simbolike mediatike: ata i përshtasin, i transformojnë, i kodifikojnë. Nëse këto përmbajtje simbolike, të quajtura *tradita të mediatizuara*, nuk gjejnë terrenin e zbatimit të tyre në kontekstet praktike të jetës, janë të destinuara të humbasin.

Si duhet ta kuptojmë procesin e rifutjes së traditave të mediatizuara në jetën e përditshme? *Eric Hobsbawm*<sup>78</sup>, por edhe të tjerë pas tij kanë hedhur në “treg” një term që quhet “shpikje e traditës”. Ato kanë dëshmuar se disa prej traditave që sot konsiderohen në përgjithësi si antike prej shekujsh, në realitet janë shpikje relativisht të fundit, madje shpesh të shpikura nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë. Shembulli më tipik është ai që lidhet me fundin karakteristik të Skocisë, i cili në bazë të studimeve të antropologëve të ndryshëm rezultoi që i përket një periudhe relativisht të vonë, aty nga fundi i 1700. Meqenëse nuk përbën fokusin e vëmendjes tonë, nuk po zgjatemi me historinë, e cila për kureshtjen e kujtdo mund të gjendet e detajuar në librin e indikuar tek referencat.<sup>79</sup>

Ajo që na intereson realisht, ka të bëjë me faktin se një pjesë e literaturës mbi shpikjen e traditave është shqetësuar veçanërisht për të nënvizuar gradën e falsifikimit të tashëm në kultivimin restrospektiv të disa praktikave e besimeve tradicionale. Disa tradita jo vetëm që nuk janë aq të vjetra sa duken, por ato rikompozohen e ndihmohen apo mbështeten

<sup>78</sup> Hobsbawm E., Ranger, T., (nën kujdesin e), *The Invention of Traditions*, Cambridge, Cambridge University Press, 1983.

<sup>79</sup> Trevor-Roper, H., *L'invenzione della tradizione: la tradizione delle Highlands in Scozia*, tek *L'invenzione della tradizione*, f.19-44, 1983.

fuqishëm edhe nga mitet apo gjysmë të vërtetat, origjinat e të cilave janë kaq të errëta për t'i njohur si të tilla, saqë tashmë është e pamundur. Një tjetër aspekt po kaq interesant, është edhe *roli që kanë luajtur mediat në rishpikjen e traditave dhe dislokimin e tyre në njësi territoriale të tipeve të ndryshëm*. Një shembull mjaft kuptimplotë është ai ritualeve të monarkisë britanike. David Cannadine<sup>80</sup> ka treguar se shumë prej ceremonive të zhvilluara nga monarkia britanike aktualisht, në fakt, janë një rishpikje e traditave të cilët nuk shkojnë më tej se fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. Deri në këtë kohë ritet e ritualet e ceremonive ishin ekskluzivitet i oborrit mbretëror e pjesëtarëve të tjerë të aristokracisë. Megjithatë, aty nga fundi i shekullit XIX, cerimonitë mbretërore dhe imazhi publik i monarkisë britanike filluan të pësojnë ndryshime të thella. Energjitë më të mëdha filluan të investoheshin në planifikimin dhe organizimin e ngjarjeve të shtetit, duke filluar nga pesëdhjetëvjetori i kurorëzimit të mbretëreshës Viktoria në 1887. Cerimonitë që më parë ishin kryer në një mënyrë fare banale, tani filluan të planifikoheshin në forma paradash të papara. Përveç kësaj, me imponimin që ndodhi aty nga fundi i shekullit XIX nga ana e shtypit popullor gjithnjë e më shumë në përhapje të gjerë, edhe përshkrimi publik i monarkisë ndryshoi thellësisht. Cerimonialet u bënë prestigjioze e gjithnjë e më shumë të respektueshëm, ndërsa përshkrimet e tyre nga shtypi i kohës gjithnjë e më shumë sentimentale. Në një kohë kur autoriteti i monarkisë dhe imazhi i saj ishin në zbritje katastrofike, riorganizimi i ritualeve dhe pasqyrimi i tyre nga shtypi popullor, shërbyen për të përforcuar imazhin e përmbysur të mbretit si kryetar shteti dhe simbol të bashkimit kombëtar. Tradita që dikur ishin ekskluzivitet vetëm i elitës të Londrës, tashmë, falë mediave u bëheshin të prekshme edhe njerëzve të thjeshtë. Në fakt, këto ceremonialë nuk është se ndryshuan në linja të mëdha e të rëndësishme, por thjesht u rishpikën. U ndanë nga “terreni” historik ku kishin lindur dhe gradualisht iu vunë në dispozicion gjithë popullatës. Falë pronësisë së produkteve të mediave, ato u shndërruan në pjesë të jetës së përditshme të individëve të zakonshëm. U lidhën me kufijtë territorialë të shtetit-komb dhe iu destinuan përfaqësimit të bashkimit e të integritetit. Pra, u shndërrua qëllimi për të cilën lindën këto tradita. Tani, çdo qytetar i thjeshtë i ftuar apo i paftuar, mund të marrë pjesë në to, duke i kthyer përfundimisht këto rituale në funksionin e simbolit të unitetit kombëtar.

---

<sup>80</sup> Cannadine, D., *Il contesto, la rappresentazione e il significato del rito: la monarchia britannica e “l’invenzione della tradizione” c. 1820-1977*, tek, *L’invenzione della tradizione*, e cituar, f.99-156, 1983.



Por, një fenomen i tillë ka edhe anën tjetër të medaljes. Në një epokë ku mediat bëjnë të dukshme e të prekshme çdo gjë, pozicioni i monarkisë që morëm si shembull, është i përkohshëm dhe jo fort i sigurtë. Nga njëra anë, *magjia* që ushtron kryerja e ritualeve të tillë e ka zanafillën në aftësinë e saj për t'u vendosur mbi gjithçka *tokësore*, duke i paraqitur përfaqësuesit e saj, si një grusht i pamposhtur i integritetit. Një trup i veshur me kostum antik dhe i qeverisur nga zakone të fisnikëruara nga koha të cilat, të risjella në skenë me një skenar cerimonial të jashtëzakonshëm e të transmetuar nga një "orkestër" e tërë mediash e ekranesh televizive, e pajisin monarkinë dhe përfaqësuesit e saj me një *ndriçim të mbinatyreshëm*. Nga ana tjetër, është shumë e vështirë që në një botë gjithnjë e më shumë mediatike, të njëjtit përfaqësues tokësorë të monarkisë, t'i shpëtojnë fatit që të paraqiten si *individë të zakonshëm*, pra si gra e burra aspak të ndryshëm nga të tjerët, përveçse për fatin e çuditshëm që e kanë vendosur paraardhësit e tyre. Pikërisht falë instrumentit të mediave, të përdorur me aq mjeshtëri fillimisht nga monarkia për të mbuluar problematikat e tyre reale, arrihet të krijohet një tension midis të mbinatyreshmes e tokësore, midis shkëlqimit të monarkisë e jetëve krejtësisht të zakonshme të përfaqësuesve të saj. Ky tension i pasqyruar me një milion forma nga mediat e shkruara e vizive, ndoshta përbën edhe thelbin e gjithë skandaleve që pati pushtuar monarkinë në 20 vitet e fundit.

Mbështetësit e mendimit se këto pseudo tradita mund të konsiderohen edhe si ruajtëse të së kaluarës<sup>81</sup>, natyrisht nuk mendojnë se mund të zënë një vend të respektueshëm në teorinë sociale të komunikimit. Por, thelbi i problemit tonë përmbledhet në këto rreshta: *kur përmbajtjet simbolike të traditave, gjejnë shprehjen e tyre në produktet e mediave, është e pashmangshme që të ndahen të paktën pjesërisht nga kontekstet praktike të jetës së përditshme*.

Para se të shqyrtojmë këto dy aspekte-faktorë të sipërpërmendur, do të përpiqemi të analizojmë *Traditën*, apo natyrën e saj. Përseja është e thjeshtë: vetëm duke kuptuar çfarë është dhe çfarë përmban tradita, karakteristikat e saj dhe vendin e saj në shoqëritë moderne, mund të arrijmë të flasim për vendin që zë ajo realisht, apo atë që do të duhej të zinte në shkencat humanistike së pari, e pastaj në mendësitë kolektive të të gjitha shoqërive të sotme, përfshi edhe atë shqiptare.

### **1.3.Natyra e traditës dhe vendi i saj nën dritën e teorive sociale të komunikimit**

---

<sup>81</sup> Gross, *The Past in Ruins*, kapitulli IV, në veprën e cituar *L'invention of Tradition*.

Çfarë është tradita? Cilat janë karakteristikat e saj kryesore? Në kuptimin më të gjerë të këtij nocioni, “tradita” tregon një *traditum* – ose, çdo gjë që transmetohet apo përçohet nga e kaluara. Një nga trashëgimitë më këmbëngulëse të mendimit shoqëror klasik është ideja se, me zhvillimin e shoqërive moderne, traditat e humbin pak nga pak rëndësinë e tyre, në mënyrë graduale, gati-gati deri në shuarjen e rolit të tyre në jetën e përditshme e në masën më të madhe të individëve. Formimi i shoqërive moderne duket sikur e ka vënë traditën në një biçim kontradite apo konflikti me ta. Shumë mendimtarë kanë rënë dakord mbi faktin se zhvillimi i shoqërive moderne do të ishte shoqëruar në mënyrë të pashmangshme me perëndimin e pakthyeshem të rolit të traditës. Ky komponent interpretativ, është njëkohësisht edhe një element përbërës e themelor i shumë teorive të përpunuara gjatë viteve '50-'60 të shekullit të kaluar. E çuditshme është se kjo ide, është rimarrë me forcë edhe në kohët e sotme nga studiuesit që mbështesin tezën se zhvillimi i modernizmit social sjell si pasojë edhe një proces të “çlirimit nga traditat”.

Por ne do të përpiqemi ta shohim problemin më me kujdes, duke e vënë në diskutim një tezë të tillë. Nëse ne i kushtojmë vëmendjen e duhur impaktit me mediat, arrijmë në një përfundim mjaft të kundërt në lidhje me ndryshimin e traditës e të rolit të saj në jetën shoqërore. Para zhvillimit të mjeteve të komunikimit të masës, ajo që e modelonte kuptimin e të kaluarës e të botës përtej mjedisit në të cilin jetohej, ishte pikërisht përmbajtja simbolike e shkëmbyer në ndërveprimet ballë për ballë. Pjesa më e madhe e individëve e formonte idenë mbi të kaluarën, mbi botën e largët etj., nëpërmjet traditave gojore të prodhuara e të riprodhuara në kontekstet sociale të jetës së përditshme.

Megjithatë, duhet theksuar se zhvillimi i mass-mediave solli edhe eksperimentimin e ngjarjeve, të mësuarit e mënyrave e formave të reja të jetesës, por jo vetëm kaq: duke u vënë në kontakt të drejtpërdrejtë me mediat, individët arritën të marrin edhe distancat e duhura, jo vetëm nga përmbajtjet simbolike të ndërveprimit të drejtpërdrejtë, por edhe nga format e autoritetit që qeverisnin jetën e tyre të përbashkët.

Por, këto zhvillime a e kanë çrrënjësuar traditën? Nuk është e thënë. Jo vetëm traditat e transmetuara gojarisht kanë vazhduar të lozin një rol të rëndësishëm në jetën e shumë individëve, por me procesin e kalimit të përmbajtjeve të tyre simbolike, mjeteve të reja të komunikimit, kanë pësuar ndryshime edhe ata vetë, kanë fituar një forcë të re. Mediatizimi i ka dhënë traditës një jetë të re duke përfutur karakteristika të paparashikueshme. Mund të thuhet se është *deritualizuar*. Ka humbur gjurmët e saj në

kontekstet e jetës së përditshme, por një çrrënjosje e tillë nuk e ka boshatisur. E vërteta është e kundërta: *mediatizimi i traditave, u ka lejuar atyre të shumëfishohen e të rinovohen duke u vendosur në kontekste të reja.*

Si paraqitet situata nga pikëpamja historike e trajtimit të traditës nga teoria sociologjike? Teoria sociale klasike përfaqëson nga pikëpamje të ndryshme një produkt të mendimit iluminist dhe, një nga premisat e *Illuminizmit ishte refuzimi i traditës*, e konsideruar nga shumë mendimtarë si burim mistifikimi, armike e arsyes dhe pengesë e progresit njerëzor. Teori të tjera sociale shikonin direkt në thelbin e proceseve. Shumë mendimtarë socialë klasikë mbështesnin idenë se zhvillimi i shoqërive moderne kishte vënë në lëvizje një dinamikë efektive të cilës mbi traditat do të kishte qenë sigurisht shkatërrues. Pra, tradita jo vetëm që ishte armike e mendimit iluminist, një trashëgimi e së kaluarës, e kritikueshme e që duhej shkrirë në emër të arsyes, por ajo dënohej nga vetë dinamika e vënë në lëvizje nga dalja në pah e shoqërive moderne.

Përkimi i këtyre dy elementëve të marrë në konsideratë nga studiuesit, del shumë i qartë në shkrimet e *Marx*. I ndikuar thellësisht nga armiqësia e iluministëve ndaj traditës, ai këmbëngulte në radhë të parë se, *tradita nuk ishte tjetër veçse një burim mistifikimesh, një vel që fshihte relacionet sociale duke mbajtur në errësire natyrën e vërtetë të tyre.* Në radhë të dytë, dhe kjo përbënte një nga temat më të preferuara të veprës së tij në lidhje me çështjen e traditës, në mënyrën e prodhimit kapitalist spikaste një dinamikë që ishte e aftë të shqyente pëlhurën tradicionale. Ndryshe nga shoqëritë parakapitaliste, mënyra e prodhimit e të cilave ushtronte një ndikim thelbësisht konservator, ajo kapitaliste operon në një territor të ethshëm të ndryshimit të pandërprerë. Falë kësaj tipologjie prodhimi, edhe relacionet sociale e traditat e shoqërisë parakapitaliste janë të destinuara të shkatërrohen. Shkurt, sipas Marksit, *demistifikimi i raporteve sociale është një aspekt thelbësor i zhvillimit të kapitalizmit.* Duke fshirë të gjitha besimet e mendimet e sistemit të vjetër parakapitalist, në shoqërinë kapitaliste, individëve u lejohej të shohin raportet që rregullojnë ekzistencën e tyre, për ato që janë, pra raporte shfrytëzimi të cilat i hapin rrugën tipit të transformimit revolucionar aq të dëshiruar nga Marksi.

Opinione të afërta e të ngjashme me ato të Marksit i gjejmë edhe tek *Weber*. Edhe pse ky i fundit nuk ndante të njëjtin entuziazëm të Marksit në lidhje me transformimin e kapitalizmit, Weber ishte i mendimit se zhvillimi industrial do të shoqërohej nga shkatërrimi i botëve tradicionale, por në dallim me të, Weber shprehej se disa transformime të praktikave e të ideve fetare kishin qenë edhe parakushtet për lindjen e kapitalizmit. Zhvillimi i tij

që, së bashku me lindjen e shtetit burokratik, do të racionalizonte veprimin duke ia përshtatur kritereve të efikasitetit teknike e duke zhdukur kështu gjithë elementët e thjeshtë personalë, spontanë dhe emotivë si pjesë përbërëse të veprimit tradicional. Një “çmagjepsje” të tillë të botës moderne, Weber e konsideron si një *çmim që do të paguhej për të arritur racionalizimin e Perëndimit*. Ai shprehet me njëfarë dhimbjeje se “ky është fati i kohëve moderne”<sup>82</sup>.

Idetë e Marksit e të Weberit, por edhe të tjerëve, kanë ushtruar një ndikim të fortë mbi reflektimet e mëpastajme në lidhje me fatin e traditave. Teoritë e *modernizimit të viteve '50 e '60 të shekullit të kaluar* e mirëpritën pa kushte e si të mirëqenë teorinë e propozuar nga dy mendimtarë të mësipërm, por edhe nga të tjerë përfaqësues të kësaj shkolle mendimi, duke vendosur një konflikt të mirëqenë midis shoqërisë “tradicionale” e asaj “moderne”. Duke u nisur nga ky pozicionim i parapërcaktuar, sipas tyre *procesi i ndryshimit social do të ishte vetëm në një drejtim*. Në kohët më të afërta, disa sociologë si *Ulrich Beck*<sup>83</sup> dhe *Anthony Giddens*<sup>84</sup> për shembull, kanë propozuar një konceptim pak më kompleks: ata mbështesin tezën se, në fazat e para të modernizimit, shumë institucione do të ishin varur nga traditat e shoqërive paramoderne në disa aspekte të një rëndësie të madhe. Për shembull, shumë organizata prodhuese të fazës së parë të modernitetit, do të kishin mbështetur ekzistencën e tyre mbi mbijetesën e formave tradicionale familjare. Gjithsesi, procesi i modernizimit do të kishte hyrë në një fazë të dytë më të avancuar, të cilën Beck e quan “*modernizim reflektiv*” ndërsa Giddens “*modernitetin e vonë*”, faza në të cilat traditat e vjetra do të shkonin drejt një shkatërrimi progresiv. Praktikant tradicionale nuk do të zhdukeshin plotësisht nga bota moderne, por statusi i tyre do të pësonte ndryshime të qenësishme e të rëndësishme. Nga momenti që janë të ekspozuara gjithnjë e më shpesh ndaj qëmtimit e shqyrtimit gërryes të diskutimit publik, ngjajnë më pak të mirëqena e të konsoliduara. Sa më shumë t’u kërkohet atyre të mbrohen, aq më shumë do të humbasin statusin e tyre të së vërtetës të padiskutueshme.

Duke mos dashur të zgjatemi më në detaje mbi autorë të tjerë, do ta përqendrojmë vëmendjen tek pyetja e parë e përgjithshme e problemit tonë: *vërtetë lindja e shoqërive moderne shoqërohet me shkatërrimin e rolit të sistemit të traditave në jetën sociale?* Pavarësisht mendimit të përbashkët të

<sup>82</sup> Weber, M., *L'etica protestante e lo spirito del capitalismo*, tek *Sociologia della religione*, Milano, Comunità, 1982.

<sup>83</sup> Beck, U., *Reflexive Modernization: Politics, Tradition and Aesthetics in the Modern Social Order*, Cambridge, Polity Press, 1994.

<sup>84</sup> Idem.

shumë studiuesve që e përkrahin këtë tezë, ndoshta kemi mundësinë të lëshojmë dy pyetje të tjera: së pari, përse disa tradita apo sisteme besimesh tradicionale, vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm deri nga fundi i shekullit XX? Nëse zhvillimi i shoqërive moderne i spastron traditat, përfshirë edhe disa besime e praktika fetare, përse ato vazhdojnë të mbesin kryeneçësisht në jetën sociale të sotme? Për të gjithë ata që aderojnë në tezën e rënies së traditës, është e vështirë të interpretojnë mbijetesën apo rilindjen e besimeve e të praktikave tradicionale, përveçse si regres. Ruajtja e traditave ngjan si një kthim në të kaluarën, një strehim për shpirtrat nostalgjikë e si një paaftësi për të hequr dorë nga diçka që është e destinuar që të zhduket. Kemi ndoshta të drejtën të themi se, një qëndrim i tillë mendor tingëllon paksa arrogant, për sa kohë ai konsideron traditën si një mbetje regresiste të së kaluarës, e një epoke të kapërcyer, duke përjashtuar kësaj mundësinë e përfshirjes së traditës në shumë aspekte, si një element përbërës të së tashmes.

Pyetja e dytë që mund të shtrojmë, lidhet me faktin e ekzistencës së mediave në shoqërinë kapitaliste. Si mund të injorohet, apo të mos i kushtohet vëmendje një realiteti të tillë të stërmadh për nga rëndësia që ka objektivisht. *Cili ka qenë roli i mediave në atë transformim që folëm pak më lart?* A është vallë e mundur që të kuptojmë këto transformime, pa konsideruar mënyrat me të cilat mjetet e komunikimit kanë gdhendur e plazmuar organizimin social të jetës së përditshme?

#### 1.4. Bota shqiptare midis traditës dhe modernes: përfundime

- Për të kuptuar situatën shqiptare në lidhje me *fenomenin e globalizimit të komunikimit*, ndoshta do të mjaftonin pak elementë që do t'i sjellim në kujtesë. Gjithçka zë fill pas 1990. Për fat të keq, e gjithë periudha e pas Luftës së Dytë Botërore nuk mund të merret në konsideratë për vetë izolimin hermetik e total që e karakterizoi. Siç është thënë shpesh tashmë, Shqipëria është vendi *par excellence* për karakteristikat e saj ekstremiste, sa lindore, po aq edhe perëndimore. E gjendur historikisht para kësaj dileme, apo udhëkryqi, që ngjarjet, apo edhe fataliteti do të thoshte dikush, i diktuan, ajo arriti të marrë drejtimin e aspiruar, atë perëndimor, vetëm pas rrëzimit të regjimit totalitar. Pavarësisht aspiratës dhe vendosjes gjeografike që natyrshëm duhet të çonin drejt “velit perëndimor” të të jetuarit, sipas mendimit tonë, ky aspekt u shpreh më shumë në formë se sa në përmbajtje. Për të mos rënë edhe ne në klishe të “oksidantizimit” me çdo kusht të çdo aspekti jetësor, si një detyrim *sine qua non* për t'u identifikuar me atë që konsiderohet në imagjinatën kolektive si forma më e zhvilluar e

ekzistencës, pohimi që bëme pak më lart *lidhet më shumë me një konstatim, se sa me një gjykim*. Në këtë proces përplasjeje të pashmangshme midis traditës dhe formave të reja, *mediat ishin përçuesi dhe “zëdhënësi” më i fuqishëm i një sistemi vlerash të reja që po dilte në pah*. Në konfliktin e përjetshëm midis të resë dhe të vjetrës në nivelin social, që nuk përbën asnjë lloj risie për vendin tonë, por integrohet si një natyrshmëri midis transformimeve radikale që po ndodhnin, evidentoi një problem me shumë rëndësi. Ky problem kishte të bënte me *lidhjen, nga njëra anë, të modeleve të strukturuar të komunikimit global që nëpërmjet mediave “shtegtonte” në Shqipëri dhe, nga ana tjetër, kushteve lokale në të cilat individët përpiqeshin të përvetësonin këto produkte mediatike*. Përvetësimi i produkteve të mediave është gjithmonë një fenomen i lokalizuar: përshin individë që jetojnë në kontekste historiko-sociale të veçanta dhe që interpretojnë mesazhet e mediave duke i bërë të vetat në jetën e tyre të përditshme, falë burimeve që kanë në dispozicion. Pikërisht për këtë arsye, pse individët i përshtasin mesazhet mediatike në kontekstet praktike të ekzistencës së tyre, këto mesazhe gjatë këtij procesi mjaft të komplikuar, pësojnë transformime. Globalizimi i komunikimit natyrisht ka shkatuar transformime, por nuk mund të pranojmë se ka fshirë plotësisht karakterin lokal të përvetësimit të tyre. Ndoshta, ka krijuar *një aks të ri simbolikash* që i përkasin botës moderne. Një aks të tillë do ta quajmë *aksi i përhapjes globale dhe i përvetësimit lokal*. Sa më shumë intensifikohet dhe shtrihet procesi i globalizimit të komunikimit, aq më shumë rritet rëndësia e këtij aksi. Ky proces rritjeje, dëshmon që, ndërsa qarkullimi i informacionit dhe i komunikimit është bërë global, procesi i përvetësimit të këtyre mesazheve mediatike, mbetet i lidhur ngushtësisht e më një milion fije të pazgjydhshme, me kontekstin dhe hermeneutikën.

- Një nga shembujt që dëshmon këtë proces të vështirë të përvetësimit të mesazheve mediatikë nga ana e individëve, sa kontekstual aq edhe hermeneutik, është kujtimi që të gjithë ne kemi nga ikjet e para të shqiptarëve jashtë kufijve, në fillim të viteve '90. Imazhet e transmetuara nga televizori i vendeve fqinjë, përkthehej dhe interpretohej në format më të papritura nga destinatarët shqiptarë. Mosnjohja me asnjë nga format reale të kapitalizmit të vërtetë, të funksionimit të mediave e të mekanizmave që përdoren në këtë fushë për të kapur vëmendjen e teleshikuesve si dhe, kontekstualizimi lokal që u bëhej atyre, i hapën rrugën një përvetësimi masiv krejtësisht joreal. Natyrisht, ky proces përvetësimi, pati të njëjta karakteristika pothuajse për të gjithë shqiptarët. Kushtet politike që sapo kishin filluar të ndryshonin dhe, e ashtuquajtura liri që po miklonte ndjesitë e individëve të një komuniteti socio-politik si ai shqiptar i para viteve '90

ku, për gati 50 vjet kishte mbretëruar vetëm një formë të jetuari mendor, fizik, shpirtëror e kulturor, i çuan ata të ndërmarrin një hap të jashtëzakonshëm guximi: ikjen drejt një të panjohure të madhe. *E vetmja "siguri", ishte garancia mediatike e imazheve të përfutuara të një parajse tokësore që të shfaqet sapo kalon kufirin, së cilës nuk i njihen mekanizmat se si mund të fitohet, por që ngjante se ishte aty e gatshme për të gjithë ata që e preknin. Mosnjohja absolute e logjikës së komunikimit mediatik, i përkteu pritshmëritë e shqiptarëve të parë në tokë të huaj, në një zhgënjim të jashtëzakonshëm.*

- Kjo është njëra mënyrë e të parit të kontekstualizimit të imazheve të reja e të modeleve të strukturuar të komunikimit global. Ekziston edhe një anë tjetër: *të ndjekurit e imazheve që përçonin realitete të reja, njerëz të ndryshëm në mentalitet dhe sidomos, mundësi konsumi shumë të mëdha, shyrbyen si shtysa më e fortë për emigrimin në masë të shqiptarëve.* Ky emigracion, ashtu si çdo tjetër në historinë e njerëzimit, prodhoi transformime të jashtëzakonshme në të gjitha nivelet. Është banale të thuhet aspekti ekonomik, sepse falë remitancave të emigrantëve, Shqipëria filloi të ushqehet, të mbahej e të zhvillohej në nisma individuale, por një nga pasojat më të drejtpërdrejta në nivel social (aspekti që na intereson më shumë), ishte ai i *ndryshimit të mendësisë në lidhje me familjen*, formën dhe funksionimin e saj. Përzierja e opinioneve, e të menduarit, përballja jo vetëm me realitete të reja sociale, por edhe me ligjësi që mbronin pozitën e gruas në çdo rast, u thye skema e ngurtësuar që pengonte që në ide divorcin. Edhe pse ishte dhe vazhdon akoma të jetë një fenomen negativ për shumë aspekte për familjet që e pësojnë një fat të tillë, gruaja, e mbështetur ndoshta si asnjëherë tjetër nga komuniteti që e rrethonte, por edhe nga aspekti ligjor, arriti të bënte një hap që vite më parë do t'i kishte kushtuar gjithë ekzistencën. Në këtë rast, ndoshta, mund të themi se tradita nuk pati rezistencën që parashikohej. Kontekstualizimi i një modeli të ri të menduarit, u bë në përqindje të vogla. Imazhet e një bote tjetër, janë gjithmonë një burim: u lejojnë individëve të reflektojnë në mënyrë kritike mbi vetë ekzistencën dhe kushtet e tyre.

- Ndërveprimi i produkteve mediatike me praktikën lokale, ndodh në një mënyrë shumë komplekse. Ngandonjëherë mund të shërbejë, për disa aspekte, që të konsolidojë lidhjet e pushteteve ekzistuese, ose të krijojë forma të reja varësie. *Vetëformimi i individëve* ka një dozë të madhe injektimi mediatik. Ata bëjnë përpjekje të mëdha për të siguruar kontrollin e pajtimit apo të mbajtjes së një ekuilibri aspak të thjeshtë, midis mesazheve të panumërta e impulseve që marrin nga mediat dhe, vlerave e besimeve të trupëzuara në praktikën e zakonshme të jetës së tyre të

përditshme. Mbivlerësimi i ndikimit të mesazheve mediatike, do të ishte, mendojmë, i gabuar, por edhe nënvlerësimi, si faqja tjetër e medaljes, do të çonte në dëmtimin e gjykimit. *Ndeshja e kulturave lokale, tradicionale me ato të huaja nga sistemi i tyre*, ka një aspekt të jashtëzakonshëm pozitiv: atë të pasurimit të pamatë të brendësive të individëve. Është një minierë kulturore që ofron perspektiva alternative, duke i nxitur njerëzit të vënë në diskutim vlerat tradicionale si dhe interpretimet zyrtare të deriatëhershme, duke vënë në dispozicion mënyra jetese jo konformiste. Ndoshta mund ta konsiderojmë pak të guximshëm hamendësimin, por falë edhe imazheve televizive të Rumanisë së vitit 1990 që po dënontë më së fundi kolektivisht diktatorin e vet, që të rinjtë tanë gjetën atë guxim aq të pritur për të zhdukur gjurmët e fundit të një sistemi diktatorial. Natyrisht, ishin këto ngjarje, por edhe shumë të tjera që i paraprinë, ishte vetë klima gjeopolitike që paralajmëronte se diçka radikale do të ndodhte, por ajo që duhet nënvizuar është se Shqipëria pa me sytë e saj se çfarë prodhon forca e tyre, pasi perceptuan e përvetësuan mesazhet e forta të mediave në të tërë botën. Nuk është se këto imazhe përcaktuan rrjedhurinë e ngjarjeve politike në Shqipëri, sepse e thamë që ishin një mori faktorësh të tjerë, por mund të themi me gojën plot se, pa televizionin, ngjarjet e lëvizjes studentore në Qytetin e Studentit në 1990, me shumë probabilitet nuk do të ishin zhvilluar në atë mënyrë, por as nuk do t'i kishin ndjekur me mijëra e miliona vetë të tjerë në të gjithë botën.

- Duke iu referuar shqyrtimit të bërë në sythin mbi natyrën e traditës, do të ndalemi paksa të shohim si qëndron ajo në *raport me pushtetin dhe me mitin e tij* që, në mjaft raste *ndihmohet nga vetë tradita*. Nëse traditën e konsiderojmë si një nocion statik i një strukture të caktuar, këtë situatë do ta quajmë *habitus*, një fjalë latine që do të thotë pak a shumë “gjendje e zakonshme”, një “zakonshmëri”. Nga latinët, ajo përdorej në rastin e një gjendjeje të zakonshme e të përsëritur të trupit. Ndërsa nga pikëpamja antropologjike, një atribut i tillë do të përfshinte të kuptuarit e natyrës së pushtetit, të kapitalit simbolik etj. *Habitus*, është diçka që qëndron në mes të objektives dhe subjektives, kolektives dhe individuale. Nga pikëpamja kulturore është i përcaktuar, por vendi i saj është në mendjen e individit. *Habitus* është një tip strukture e veprimit social e kryer nga ekzekutorë që nga pikëpamja kulturore konsiderohen si kompetentë. Në njëfarë mënyre, është një nocion i ngjashëm me atë të Noam Chomsky mbi “kompetencën gjuhësore”, ideja sipas së cilës një folëse që praktikon gjuhën e nënës së saj, ka në kokë një model intuitiv që prodhon “ekzekutimin” e aktit gjuhësor. Në rastin e shkencave sociale e antropologjike në veçanti, *habitus* nuk përbëhet nga institucione sociale, por nga “*predispozicione*” që anëtarët e një



kulture dinë të përdorin në mënyrë intuitive. Në rastin tonë, të një shoqërie të mësuar me pushtetin absolut, historikisht, kjo mendësi është futur në ADN-në shqiptare. Individët e shoqërisë sonë kryejnë zgjedhjet në kuadrin e një habitus, një gjendjeje statike mendore, kufijtë e së cilës ngatërrohen me atë të traditës. Tradita në këtë rast ndihmon me të dyja duart ato individë që duan të pluskojnë me mendimet e vullnetet e tyre. Por, jo të gjithë kanë luksin e hyrjes së barabartë në procesin e vendimeve. Në këtë pikë kyçe, hyn në lojë pushteti. Këto persona që arrijnë t'u imponojnë të tjerëve "taksonominë praktike" të botës që i rrethon, fitojnë edhe pushtetin. Një gjë e tillë ndodh edhe në Shqipëri, sipas mendimit tonë. Të bindur ndaj idesë statike, të përzier me traditën shekullore se, pushteti duhet të ushtrohet në mënyrë vertikale pa u vënë në diskutim asnjëherë (remineshencë e pastër e autoritetit patriarkal të familjes tipike shqiptare), në momentet më të rëndësishme historike tonat, kur kërkohet mendja e kthjellët dhe vullneti i pastër e i lirë i çdo individit për të vendosur mbi fatet e kombit, shqiptarët nuk bëjnë zgjedhje. Për fat të keq, ato "zgjidhen". Janë një grusht njerëzish që "zgjedhin" kë do të komandojnë. Pjesa tjetër, shumica, nuk e vë në diskutim, por zbaton qorrizi urdhërin anonim, jehonë e shekujve. Pushteti nuk është një diçka që zotërohet, më shumë se gjithçka është aftësia për të manipuluar një sistem. Pra, as strukturat sociale, por as ato simbolike nuk duhet të konsiderohen si të mirëqena. Po kështu, as skemat kulturore prej nga merr shtysë ky pushtet i ngritur arbitrarisht e pa ndërgjegje, nuk mund të pranohen si skema që ndahen mendërisht nga çdo anëtar i shoqërisë. Nëse tradita jonë në lidhje me pushtetin kërkon këtë, atëherë do të ishim të mendimit se ka ardhur momenti kur tradita duhet të modifikohet, të plazmohet në bazë të interesave të përbashkëta të kohës të gjithë komunitetit. Staticiteti prodhon inerci mendore, pasivitet. Pasiviteti çon në nënshtrim. Nënshtrimi në diktaturë. Shqipëria është në udhëkryein e mendësisë së saj tradicionale dhe asaj moderne. Por, mos të harrojmë se kur tradita ushqen autarki, është koha të ndryshohet. Pushtetarët nuk mund të fshihen pas traditës, as në forma e, aq më shumë në përmbajtje.

- Në këtë udhëkryq të zgjedhjeve shqiptare, ka raste që ajo që e quajtmë më lart "rishpikje të traditës", ngrre krye në mënyrën më abuzive e dëmprurëse për shoqërinë. Në këtë këndvështrim do ta shikonim edhe ripërdorimin e "riformatuar" të Kanunit të Lekë Dukagjinit në disa zona të Veriut të Shqipërisë, pas viteve '90 të shekullit të kaluar. Meqenëse funksioni i "legjislacionit" të maleve dihet, nuk është e nevojshme të kujtojmë se për çfarë shërbeu e çfarë rëndësie pati për historinë sociale të atyre trevave. Gati prej dy dekadash, Kanuni është duke u manipuluar në mënyrën më banale nga njerëz të pandërgjegjshëm për dëmin që ajo po shkakton në shoqëri. Vrasja, që nuk përlligjet me asnjë ligj në botë, bëhet në emër të atribuimit të traditës. Mbivendosja e mitit të traditës mbi gjithçka, për fat të keq ka çuar edhe në keqpërdorimin e saj, apo edhe në shkeljen me të dyja këmbët të formës dhe funksionit fillestar për të cilin u krijua Kanuni. Në këtë rast, u takon intelektualëve nga njëra anë që të sqarojnë popullatën për dëmin e pallogaritshëm që shkakton kjo "mveshje e re" e Kanunit dhe, nga ana

tjetër është shteti me institucionet dhe mekanizmat e tij që duhet të ndalë me çdo kusht një abuzim të tillë.

- Si përfundim, mund të themi se *qëndrimi mendor e praktik shqiptar aktual ndaj traditës dhe modernes, reflekton në njëfarë mënyrë atë pozicionim sa gjeografik, aq edhe gjeopolitik të vendit tonë*. Ky qëndrim, i ndikuar fuqishëm edhe nga prania aktive e Mediave, ka qenë faktor përcaktues në rikrijimin e miteve kombëtarë e lokalë modernë, si dhe në fenomenin e “rishpikjes së disa traditave” të cilat kanë prodhuar edhe efektet e tyre të shumëllojshme. Por, thelbi i problemit tonë përmblihet në këto rreshta: *kur përmbajtjet simbolike të traditave, gjejnë shprehjen e tyre në produktet e mediave, është e pashmangshme që të ndahen të paktën pjesërisht nga kontekstet praktike të jetës së përditshme*. Por, për këtë arsye nuk mund të konsiderohen më pak autentike se sa ato tradita që transmetoheshin dikur ballë për ballë, apo nga brezi në brez gojarisht. Ndoshta, mund të themi se kemi të bëjmë me të njëjtën histori, por “të kënduar” nga “këngëtarë” të ndryshëm. *Mediat natyrisht që kanë ndryshuar kornizën e traditave e në mënyrë gati radikale, por nuk është se i kanë çrrënjësuar apo kanë shkaktuar vdekjen e tyre*.

### The traditional myth and the modernization

#### SUMMARY

If we talk about the resistance of tradition in the modern world, is it possible then to talk about the disappearance of traditional societies? “Tradition”, comes from the word *traditum* - or, anything that is broadcasted or transmitted from the past. In the anthropological language it is possible to relate this word to the word *habitus*, a latin word used to define a state of consuetude. *Habitus*, is something that lies between the objective and subjective, collective and individual. It’s a definition that belongs to the cultural point of view, but its place is in the mind of the person. This humanistic research is inspired by mostly two factors that strongly influence the tradition: the development of *mass media* and the process of *globalization*. The interaction of media products to local practises, happens in a very complex way. Our conclusion to this is that the development of the mass media has not resulted in the death of tradition, but has transformed it into its main aspects. Following this development, the formation processes of transmission of tradition are dependent largely on the media. On the other side it’s inevitable for this invader system of values to be separated from the practical contexts of everyday life.



Alva DANI

**PSIKOLOGJIZMI SI NDIKIM NË LETËRSINË E  
VITEVE TË PARA TË 1900-TËS  
(PIRANDELO E KOLIQUI)**

Psikologjia, si shkencë që studion sjelljet e qenieve njerëzore dhe marrëdhëniet e tyre psiko-sociale, është e lidhur për vetë natyrën e saj me format më të ndryshme të shprehjes artistike përmes të cilave, në shekuj, njeriu ka treguar rreth vetes dhe ka lënë pas kujtimin e tij. Për ta filluar nga vetë fjala “Nëntëqinda” mund të themi se ajo mori një sërë kuptimesh polemike, pasi në të vërtetë ajo nuk përfaqësonte kronologjinë dhe topografinë thelbësore të një shekulli, por disa tendenca artistike dhe morale të kësaj epoke tragjike, që përjetoi në rrjedhën e pak viteve dy luftërat më të mëdha e më të dhimbshme të historisë njerëzore. Shqetësime psikologjike, vuajtje, ankthe ekzistenciale, dyndje të vrullshme forcash joracionale janë disa nga karakteristikat politike, filozofike dhe letrare që shënojnë vitet e para të nëntëqindës.

Letërsia e viteve të para të shekullit XX, që sot përcaktohet si moderne, përbën një lloj revolucioni narrativ. Ajo pashmangshmërisht do të lidhet me psikologjinë dhe me metodat e studimit të saj, kryesisht me psikoanalizën. Arsyeja e kësaj metode qëndron në faktin që mjaft tipare të rëndësishme të jetës së njeriut, si edhe të artistit, shpesh u ikin metodave të tjera të kërkimit artistik. Pra i rrëshqasin qoftë vetë njeriut që jeton jetën e tij, qoftë artistit që e krijon veprën. *Kjo zonë e errët ose këto zona të errëta të jetës së njeriut, - shkruan Stefan Çapaliku<sup>85</sup>, – dhe rrjedhimisht edhe të veprave letraro-artistike që ai krijon, kërkonin dhe kërkohen të ndriçohen.* Roli i psikoanalistit është të zvogëlojë sa më shumë këto zona që shfaqen në një vepër në mënyrë që të ndriçojë receptuesin e saj. Që nga çasti kur psikanaliza u mishërua me psikologjinë, letërsia e ka parë të nevojshme t’i referohet gjithnjë e më shumë studimeve të Zigmund Frojdit që në fillimin e këtij shekullit i përkushtohet zbulimeve të psikikës. Edhe studiuesi Çarls Brener mendon se metoda më frytdhënëse dhe më e besueshme që kemi sot studimin e proceseve të pandërgjegjshme mendore është teknika që përpunoi Frojdi gjatë një periudhe disavjeçare: *“Këtë teknikë ai e quajti psikoanalizë, për arsyen e thjeshtë se me anë të saj ai ishte në gjendje të*

<sup>85</sup> S.Çapaliku, *Estetika moderne*, Shblu, Tiranë, 2004, f. 104

*njihte dhe të përcaktonte proceset psikike që përndryshe do të kishin mbetur të fshehura ose fare të parashikueshme*<sup>86</sup>. Frojdi mendonte se arti është diçka që qëndron në mes të një realiteti, i cili nuk e pranon ëndrrën nga njëra anë dhe botës së fantazisë ku ëndrrat realizohen nga ana tjetër. Ai mbështeste idenë se koncepti i një vepre letrare, ashtu si edhe koncepti i qartë i një ëndrre mund të na rrëfejnë më së miri dëshirat e pandërgjegjshme të një artisti. “*Megjithatë ai e ka pranuar gjithmonë se psikanaliza nuk ishte në gjendje të shpjegonte natyrën e talentit artistik dhe se kishte disa mistere në inteligjencën krijuese dhe fantazinë rreth të cilave psikanaliza vetëm do të mund të spekulonte pa asnjë shpresë për të dhënë një shpjegim shkencor.*”<sup>87</sup> Psikologjia tashmë është e ndërgjegjshme se gjen tek letërsia një fantazi shumë të pasur krijuese që i shërben për të njohur më mirë psikologjinë e mendimit dhe aktivitetin e nënvetëdijes.

Gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të nëntëqindës, në këtë terren psikologjizmi shohim tek merr formë një narrativë e re në letërsinë italiane, me një rend tematik dhe strukturor tërësisht të veçantë. Kemi të bëjmë me një fenomen analog si ai që u zhvillua në letërsinë bashkëkohore evropiane në lidhje me rrymat filozofike irracionale dhe me zbulimet e kësaj psikologjie të nënvetëdijes. Pothuajse në të njëjtën kohë francezi Marsel Prust dhe irlandezi Xhejms Xhojsi, megjithëse në mënyra të ndryshme e thyejnë skemën e romanit të tetëqindës duke zëvendësuar tregimin e fakteve dhe përshkrimin e personazheve me një analizë të hollësishme të impulseve të psikes. Në Itali në këtë periudhë rasti më domethënës është ai i Pirandelos me *Il fu Matia Pascal* (Ai qe Matia Paskal, 1904), përmes të cilit realizon një roman të ri dhe së bashku me novelat dhe esenë *Humorizmi* (1908) i tejkalon modalitetet narrative dhe vetë konceptimin e artit që kishte sunduar gjatë Tetëqindës. E po kësaj tipologjie dhe pasqyrujes i po kësaj krize të personalitetit është edhe romani i Italo Svevos *Ngjërgjegja e Zenos*

Në letërsinë shqipe të viteve '30 vërejmë po të njëjtin fenomen. Një analizë të thellë psikologjike të personazheve, depërtime të detajuara në mentalitete e tradita shekullore në konflikt të vazhdueshëm me vizionin e një të ardhmeje evropiane, pështjellime mes një realiteti imagjinar dhe atij realiteti që ishte krijuar nga koncesioni shoqëror, mes thelbit dhe shfaqjes, papajtueshmërisht të kundërta. I tillë na shfaqet Koliqi. Përmbledhjet e tij të novelave “Hija e maleve dhe “Tregtar flamujsh” na ofrojnë karaktere të ndryshme personazhesh. Ata janë njerëzit e fortë që jetojnë nën *hijen e*

<sup>86</sup>Charles Brenner, *Breve corso di psicoanalisi*, Martinelli, Firenze, 1990, f.15

<sup>87</sup>L. Edel, *Psicologia e letteratura*, në *Dizionario della letteratura mondiale del 900*, Edizioni Paoline, Roma, 1980, f. 2390.

*maleve*, janë tregtarët e pangopur për mallra e para, janë njerëzit e shkolluar si Hilush Vilza që duan të shartojnë në trungun e lashtë stërgjyshor filizin e ri të qytetërimit perëndimor. Ky i fundit do të ishte edhe misioni i tij si shkrimtar e atdhetar. Por si do të mundej ai të realizonte këtë ndërgjegjësim njerëzor, si do të mund të hidhte dritë mbi errësirën që kishte depërtuar thellë rrënjëve të ekzistencës, si do t'i bënte të fliste memecët e magjepsur nga zanat e shtojzovallet ?

Në këtë përpjekje për të reaguar Koliqi fut në ndihmë gjithë kulturën e formimin që kishte marrë universiteteve italiane, falë gjithë librave që kishte lexuar, falë gjithë filozofive që kishte përvetësuar dhe sidomos falë vetë erudicionit që përfaqësonte personaliteti i tij shumëdimensional. Koliqi tashmë e kishte kuptuar se kishte ardhur koha për një lloj letërsie tjetër, të ndryshme nga ajo didaskalike dhe moralizuese. Në një nga shkrimet e revistës “Leka” ai shprehet qartë se “... *duhet me studjue thellë psikologjin e panjohun të rracës s'onë dhe me u dhanë zhdrivillim problemeve të gjalla shpirtënore të jetës s'onë të përditshme*”<sup>88</sup>. Koliqi ishte i pari që arriti në konkluzionin se nuk mund të shkruhej më si më parë dhe nuk mund të lexohej më si më parë. “*Këtu zë fill dukuria e modernitetit ne gjuhën shqipe, – shprehet një nga studiuesit tanë, - Është lehtësisht e kuptueshme se ky akt nuk kishte lidhje me letërsinë masive. Një e këitillë situatë do të mund të karakterizohej mjaft mirë me anë të fjalëve që vetë Koliqi vë në gojë të njërit prej personazheve të tij në novelën “Anmiku në shtëpi” : Shumëkush s’e merr vesht pse ai ka ndjesi të reja e prandaj përdor trajta të reja shprehjeje. Trut t’ona janë mësue m’u rrokullue mbi shina të një letrësisje të vjetrueme. Ai rreh një rrugë të parratur ndër ne deri më sot.*”<sup>89</sup> Këto fjalë Koliqi i vë në gojën e mësuesit të qytetit, njeriut të kulturuar dhe përkrahësit të shkrimtarit Tush Kezena, një shëmbëlltyrë e Hilush Vilzës. Pohime të hapura të këtij lloji, mendime po kaq të kthjellëta dhe prirje fare të qarta të një psikologjizmi letrar gjejmë edhe në shkrime të tjera të Koliqit, si në novelën thellësisht psikologjike “Gjaku”. Koliqi shpreh vullnetin e plotë të ndihmojë popullin e tij dhe për këtë duhet të dalë nga *kulla e fildishtë ku e kishin ndry studimet e gjata*. Për të realizuar këtë qëllim ai duhet “... *me studjue, me dashuni e kujdes, psiken shqiptare për me gjetë mandej mjetet ma të shpejta të qytetnimit. E kishte nisë me ba*

<sup>88</sup> E. Koliqi, *Misjoni i Letrarve të rij shqiptarë*, në Leka, viti III, 1931, f. 47.

<sup>89</sup> K.Gjika, *Duke hulumtuar fillimet e prozës moderne*, f. 21, në *Letërsia si e tillë: probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare* (aktet të konferencës shkencore, maj 1996), Toena.

*diagnozën e sëmundjeve të shpirtit shqiptar për me zgjedhë, ma vonë mjekimet ma të fuqishme.*<sup>90</sup>

Është e qartë se kjo ishte letërsia për të cilën kishte nevojë ai fillimisht. Ai shpalosi shprehjen e tij më të mirë përmes prozës së shkurtër apo novelave, siç preferoi t'i quante vetë shkrimtari. Por në këtë kontekst do të ishte e padrejtë të mos merrim në konsideratë terrenin ku ai u formua, që ishte letërsia italiane e fundit të tetëqindës dhe e fillimit të nëntëqindës, të cilën e lexonte pa u ngopur dhe e adhuronte pa masë. Vitet nëntëqind shfaqen si një fermentim i vazhdueshëm idesh, temash të forta, analizash të thella dhe qëndrimesh të kundërta. Një nga përfaqësuesit më konkretë të kësaj epoke që la gjurmë të thella në letërsinë italiane dhe jo vetëm ishte Luixhi Pirandelo, autori i njohur i novelave me titull *Novela për një vit*. Ai shpreh një interes të vazhdueshëm për këtë lloj gjinie dhe tek e fundit novela mbetet e vetmja formë narrative prej së cilës Pirandelo nuk dorëhiqet dhe për të cilën deklaron qartë se dëshiron të vazhdojë të punojë. Ai është edhe një nga autorët që të vjen natyrshëm në kujtesë sapo i qasemi novelave të Koliqit. Dhe për këtë arsye kjo qasje nuk është e rastësishme.

Novela moderne, sipas studuesve italianë, është e inauguruar nga Pirandelo, si gjini letrare dhe përbën një etapë thelbësore në historinë e letërsisë. Po kështu Ernest Koliqi “... shartoi në trungun e prozës shqipe zhanrin e “novelës” (sipas konceptit që i jep këtij zhanri letërsia italiane) fakt të cilin e ka nënvizuar edhe Martin Camaj kur shprehej se Koliqi letrar shquhet si krijues i novelës në letërsinë shqipe dhe themelues i prozës moderne.”<sup>91</sup> Pra, kemi të bëjmë me dy personalitete letrare që u lidhën me novelën në mënyrë të pashmangshme, duke gjetur tek ajo mënyrën më të mirë të komunikimit letrar dhe sistemin narrativ më perfekt për të pasqyruar realitetin dhe psikologjinë e trazuar të atij fillimisht. Koliqi arriti t'i qasë kësaj novele e t'i largohej letërsisë masive dhe rrjedhimisht të mbijetonte vetëm sepse vepra e tij nuk u shkrua dhe nuk jetoi në atdhe, në ndryshim nga sa ndodh me Pirandelon.

Protagonistët e novelave të Pirandelos vijnë përgjithësisht nga ambientet e borgjezisë së mesme dhe ata fshatareske siçiliane, të cilët i nënshtrohen punës e jetës së hidhur duke mbajtur mbi supë një mallkim atavik. Po ashtu personazhet e Koliqit, vijnë nga qyteti i tij i lindjes, Shkodra, nga një shtresë e mesme tregtarësh dhe intelektualësh si dhe malësorët e mbishkodrës me rregullat e pathyeshme të kanunit, që shfaqem

<sup>90</sup> E.Koliqi, *Gjaku*, në *Hija e maleve*, Pakti, Tiranë, 2009, f. 33.

<sup>91</sup> Kastriot Gjika, *Duke hulumtuar fillimet e prozës moderne shqipe*, në *Letërsia si e tillë. Probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare*. (Akte të konferencës, 28-29 maj 1996), Tiranë, Toena, f. 201.

herë si tabu e herë si mbrojtje e virtyteve të racës. Të gjithë këto personazhe do të kuptojnë shumë shpejt se jeta është e dominuar nga keqkuptimet, nga absurditeti, do të kuptojnë se mes gjërave nuk ekziston asnjë lloj harmonie, gjithçka zhvillohet kundër çdo lloj pritshmërie a logjike të mundshme dhe asnjëherë nuk arrijnë të bëjnë atë që duhet apo atë që duan. Si pasojë ato ose mbyllën në vetvete ose rebelohen, por gjithsesi mbeten individë të huaj, të panjohur, të zyrtë, të dënuar të mbeten vetëm ose të jetojnë një vuajtje metafizike.

Personazhet e Koliqit luajnë “A t’a laçë ...” mes jetës dhe vdekjes. Ato jetojnë e qeshin hareshëm duke harruar se në të vërtetë vdekja është ajo që luan me jetët e tyre, është vdekja ajo që sodit e qetë dhe pastaj zgjat dorën atëherë kur ndoshta të gjithë e kanë harruar ekzistencën e saj. *Jeta... nji lojë!* – thotë Leci, duke thithur thellë cigaren, - *ngasim nëpër bar e kur hovi i ynë asht ma i gëzueshëm, ndiejmë një dorë të ngritë e të shpulpueme qi na përket shpinën. A t’a laçë... Siellemi e shohim plakën, qi asht nana e vërtetë e gjithë neve*<sup>92</sup>. Dhe jo pa qëllim, asgjë nuk ndodh në kohën kur Leci po bisedonte dhe po qeshte me miqtë, vetëm atëherë kur të gjithë filluan të vrapojnë, të luajnë, të ndjekin njëri-tjetrin, atëherë kur Leci arrin kulmin e kënaqësisë duke kapur Minen, pikërisht në këtë çast duhej të ndodhte diçka e papritur që të ndërpriste atë gëzim të vrullshëm rinor. Vetëm atëherë kur “...i dekuni, përsjellë nga vargimi i përmotshëm, kaloi para tyre” dhe përqethi ftohtshëm trupat rinorë, ku “gjaku këndonte kangën e vet të shkurtë e të shpejtë”, Leci e kuptoi se sa pabesisht bëhemi pjesë të këtij mekanizmi jetësor, ku e vetmja siguri që na ofrohet është vdekja. Një studiues italian i letërsisë së nëntëqindës pohon me të drejtë se “vetëm ideja se vdekja është afër ngjall tek njeriu një proces delirant mendimesh dhe perceptimesh; në të kundër mendja largon me përbuzje çdo lloj ideje që ka lidhje me zhdukjen e vetes”<sup>93</sup>.

Kjo filozofi përshkon edhe novelën “La trappola” (Kurthi) të Pirandelos. Personazhi i vetëm i saj është Fabrizioo. Përmes një monologu të brendshëm na tregon se ndjehet në kurth, i shkëputur nga fluksi i jetës ku ecte pa u ndalur, se është i bindur se jeta të çon gjithmonë drejt vdekjes, në një rrugëtim tragjikisht të pashmangshëm. Dhe njeriu përpëlitet mendimesh dhe ndjehet i ndarë më dysh mes jetës dhe formës. Forma është një koncept thelbësor për Pirandelon, sepse ai mendon se njeriu nuk është asnjëherë vetvetja, se gjithmonë përpiqet të luajë një pjesë të caktuar, sepse gjithmonë

<sup>92</sup> E.Koliqi, *A t’a laçë...*, në *Tregtar flamujsh*, Vepra 2, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 183.

<sup>93</sup> N.Tanda, *I contemporanei*, f. 503.



ndryshon, nuk mund të ketë asnjëherë të njëjtën formë, ashtu si edhe jeta, nëse ai e merr një formë të caktuar fikse atëherë ajo është vdekja: “... *La vita è il vento, la vita è il mare, la vita è il fuco; non la terra che si incrosta e assume forma. Ogni forma è la morte.*”<sup>94</sup>.

Elementin femër e gjejmë edhe në këtë monolog të brendshëm të këtij personazhi të zymtë pirandelian. Sipas tij femra gjithashtu është një kurth, të tërheq pas vetes me ato linjat provokuese dhe sytë e qeshur pa e menduar se edhe ajo bie pre e formave fikse të vdekjes. “...*Tanto fanno e tanto dicono che alla fine ci fanno cascare, ciechi, infocati e violenti, là nella loro trappola.*”<sup>95</sup> Të njëjtën shije të lë edhe loja e Lecit me Minen. Minia vraponte më shpejt, pasi “...*ishte e lehtë në të ngam dhe e shpejt ndër bishtnime...*” e Leci zemërohej por prap qetësohej “*tue kundrue bukurinë e vrapit të saj... atë përkulje plot fuqi rinore të shtatit në përpjetë dhe me atë lëshim në teposhtë me gjoks valëvitës përpara...*” e Leci prap rrëzohej duke ndjekur Minen, e kap vetëm kur ajo për një çast ndalon dhe qëndron e shtangur nga skena e vargut mortor, që po i kalonte para syve.

Asnjëra nga këto novela nuk ka një subjekt të mirëfilltë, është vetëm personazhi kryesor me reflektimet dhe mendimet prej filozofi që përbën boshtin kryesor. Çdo gjë që ndodh *jashtë* personazhit do të vlejë shumë më pak nga ajo që do të ndodhë *brenda* tij. Gjithçka na jepet me një çelës psikologjik dhe introspektiv, sa e ndjen realitetin ky personazh dhe sa e pëson atë.

Në novelën tjetër të Koliqit “Rrokoll”<sup>96</sup>, Ndreke Bytyçi një personazh i dëshpëruar, i pashpresë e me një përbuzje të ethshme për veten bën pjesë në atë tipologji personazhi që karakterizohet nga prirja për të hequr dorë, për t’u arratisur nga realiteti, ose për të qenë pasiv, madje për të qenë tërësisht i paaftë dhe i pavlerë. Duke humbur sigurinë në aftësitë e veta njohëse, duke humbur rëndësinë e ndjenjës së ekzistencë, shkrimtari depërton në psikologjinë e personazhit, në nënvetëdijen e tij, duke zbuluar një realitet të shumëfishtë e të dyshimtë. Ndreke Bytyçi është një baba dhe një bashkëshort që “*mujte vetëm me pi, m’u zhytë në ves ... për gjith mbrëmje pinte sa ku mujte*” dhe kjo e bënte të harronte realitetin ku jetonte, përgjegjësitë që duhej të mbarte në kurriz dhe e shndërronte në një njeri

<sup>94</sup> L.Pirandello, *La trappola*, në *Novelle, L'uomo solo*, Fratelli Melita, Milano, 1993, f. 115.

(Jeta është era, jeta është deti, jeta është zjarri; nuk është tokë që zë kore dhe merr formë. Çdo formë është vdekje.)

<sup>95</sup> Po aty, f.117, (Bëjnë aq shumë e thonë aq shumë sa në fund biem në kurthin e tyre, të verbër, pasionantë e të vrullshëm).

<sup>96</sup> E Koliqi, *Rrokoll*, vep e cituar, f. 248.

pasiv që vetëm thellonte vesin e tij poshtësisht të ulët. Ai nuk pinte që të ngushëllohej, pinte vetëm që të “*mbyste në raki zanin e pakët që i mbet në ndërgjegje*”. Ai nuk arrin më të komunikojë, për të as jeta nuk më asnjë rëndësi “*a me marrë rrugën kah shtëpia a por ...m’u hjedhë prej urës së Buenës*”. Ndreka priste sa “*... t’i zgjohej në zemër aq trimni sa me ba të kryem mendimin m’u mbytë*”. Të njëjtën zgjidhje që i bëhet krizës së vlerave, të njëjtën mënyrë për t’u përballur me realitetin e jashtëm, pothuajse të njëjtën botë shpirtërore do ta gjejmë edhe tek dy novelat e tjera të Pirandelos “*Il coppo*” dhe “*L’uomo solo*”. E gjithë novela përqendrohet në përshkrimin e gjendjes shpirtërore të personazhit kryesor, që është Bernardo Moraska tek “*Il coppo*” dhe Mariano Groa te “*L’uomo solo*”. Bernardo Moraska sapo ka dalë nga burgu, ku kishte vuajtur një dënim prej rreth njëzet vjetësh. Ai e kupton menjëherë se asnjë nuk kishte nevojë për të, se çdo gjë shkonte më së miri. Edhe pranvera ishte tepër e bukur dhe e bënte të ndjehej shumë të plakur “*me flokët gri dhe me mjekërr të gjatë*”. Ndjehej pothuajse i vdekur. “*Tutt’a un tratto s’alzò... Avvertì che non si era alzato da sé, ma che era stato messo in piedi da una spinta inferiore, non sua... Era dunque venuto il momento?*”<sup>97</sup> Bernardo ngushëllohet tek lumi, mendon të hidhet duke u kapur në cep nga një rrjetë ku zihet peshku. Kështu mendon edhe Mariano Groa, të cilit i ka vdekur gruaja, djali i është rritur dhe shtyn jetën në një vetmi të dëshpëruar e mes lotësh pothuajse femënorë. Një tjetër personazh i paaftë të shohë në sy realitetin, një tjetër dramë që i kanoset ekzistencës, një tjetër fluks ndërgjegjeje që shkakton kaos dhe ofron zgjidhja nga më iracionalet. “*Balzando sul paraetto dell’argine, gridava con le braccia levate, enorme: - Ecco, si fa così! E giù nel fiume. Un tonfo. Due gridi e un terzo grido da lontano... del figlio... con le gambe quasi stroncate dal terrore*”<sup>98</sup>. Kemi të njëjtën psikologji që përbashkon këto protagonistë, të njëjtat përjetime të hidhura shpirtërore që burojnë nga një konflikt i brendshëm mes dëshirës për t’i dhënë fund jetës dhe dëshpërimit të thellë ku janë të destinuar të jetojnë.

Novela “*Rrokoll*” përshkohet nga një sërë motivesh, të cilët gërshetohen në mënyrë mjaft organike, duke e bërë këtë novelë mjaft të pasur dhe shumë domethënëse. Një tjetër element i rëndësishëm që të bën të mendosh për një tjetër qasje të mundshme është motivi i vetësakrificimit përmes shitjes së

<sup>97</sup> Vep. e cituar, *Il coppo*, ( U ngrit menjëherë. Parandjeu se nuk ishte ngritur vetë, por që ishte ngritur në këmbë nga një shtytje me e vogël, që nuk ishte e tija... Thua vallë të kishte ardhur çasti?).

<sup>98</sup> Po. aty, *L’uomo solo*, (duke kërcyer mbi barrierat mbrojtëse, thërriste me krahët e ngritur pa masë: - Ja kështu bëhet! E poshtë në lumë. Një hedhje. Dy ulërima dhe një ulërimë e tretë nga larg... e të birin... me këmbët pothuajse të ngurtësuar nga tmerrin.)

trupit që e gjejmë me të njëjtën skemë edhe në novelën “Volare”. Kemi të bëjmë me dy personazhe femra, me Linën tek Koliqi dhe me Nené-në tek Pirandelo. Lina dhe nëna e saj punojnë në shtëpi, endin pëlhura dhe qëndisin për të nxjerrë pak lekë, të cilat shpeshherë nuk mjaftonin as për të nxjerrë bukën e gojës, ndërkohë që i ati e harxhon gjithë rrogën në pijetore. Ato janë të vetme përballë paaftësisë së babait për të reaguar ndaj realitetit të hidhur, janë vetëm dhe duhet të sigurojnë një mënyrë sa për të mbajtur frymën gjallë. Ai ishte “*i lig e i keq*” gjithnjë “*rrokoll nëpër teposhtën e shnjerezimit*”. Pothuajse e njëjtë është edhe situata e Nené-së, personazhit kryesor të novelës “Volare”. Ajo krejt e vetme detyrohet të mbajë në kurriz përgjegjësitë e jetës; të ushqejë të ëmën dhe të motrën e sëmurë dhe të paguajë çdo muaj qiratë e prapambetura. I ati kishte vdekur në spital dhe kishte lënë vetëm gruan me pesë fëmijë, nga të cilët tre djem kishin vdekur nga mjerimi i thellë që kishte kërcënuar për vdekje jetët e tyre. Dhe ai kishte qenë një “*pezzo d’imbecille*”, që e kishte lënë pa shtëpi dhe pa asnjë lekë. Nené dhe Lina (me nënën e saj) mendojnë, përmes një reflektimi të dhimbshëm psikologjik, se ka vetëm një mënyrë për të shpëtuar ekzistencën e tyre; të vetësakrifikohen, të shndërrohen në qenie të tjera nga ato që janë në të vërtetë, të shesin trupin, të mbijetojnë dhe pastaj të humbin detyrimisht njëri-tjetrin në këtë rrjet marrëdhëniesh njerëzore. Lina humb babain, i cili e lexon qartas në sytë e saj “*dënimin e vet në këtë jetë a n’at jetë*”. Po ashtu Nené-ja humb nënën dhe motrën e sëmurë pasi duke mos pranuar t’i nënshtrohet vdekjes nga uria ikën përgjithnjë nga shtëpia, duke shitur gjënë e vetme që i ka mbetur; trupin dhe shpirtin: “*... uscì di fretta senza salutar nessuno. Mandò i denari, ogni giorno. Non la rividero più.*”<sup>99</sup> Psikologjia ndërhyr fuqishëm duke ndërtuar deri në detaje kornizat e këtyre personazheve, duke hedhur vështrimin brenda vetes, brenda shpirtit njerëzor. Koliqi e njeh mjaft mirë psiken e trazuar shqiptare dhe për këtë shpreh hapur kundërshtinë e tij ndaj stereotipit të përhapur të shqiptarit, të rrënjosur në Evropë, duke nisur sidomos nga fundi i shekullit XIX. Ai “*mundohet ta bënte të lexueshëm realitetin shqiptar për sytë evropianë: ai njihte kodin e vlerësimit perëndimor dhe e quante atë si njësinë më të përshatshme me të cilën matet një qytetërim i vërtetë*”<sup>100</sup>. Koliqi solli në letërsinë shqipe atë që studiuesi Plasari e quan “tregim psikospektiv” dhe të cilin e sheh si ndikim të Pirandelos. Pirandelo ishte mjeshtri i madh i përshkrimeve psikologjike prandaj edhe nobelist i shquar. Platoni thoshte

<sup>99</sup> Vep e cituar, L.Pirandello, *Volare*, f. 105 (doli me nxitim pa përshëndetur asnjë.

U dërgoi lekë çdo ditë. Nuk e panë më asnjëherë).

<sup>100</sup> B.Suta, *Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe*, Onufri, Tiranë, 2004, f. 23.

se në fund të fundit shpirti i njeriut shkruan veç ato që pati harruar se pati lexuar më parë. Prandaj mund të themi se “*afëritë dhe ndikimet formale, qoftë edhe tematike janë normale për çdo letërsi të pjellë për së mbari. Nuk mund të gjykohen ato kurrsesi si përcaktuese të veprës së një shkrimtari*”,<sup>101</sup>. Komparativizmi është një nga metodat që i ka qëndruar kohës dhe do të jetë edhe paskëtaj një nga metodat më rezultateve, që jep dorë si për vëzhgime të holla, ashtu edhe për përgjithësime të fuqishme; mbi të gjitha për zbulimin e qarkullimit të vlerave në kohëra dhe kultura të popujve të ndryshëm. Si përfundim mund të themi se Koliqi është mjeshtëri i madh shqiptar i përshkrimeve psikologjike, njohësi i shkëlqyer i fenomeneve njerëzore shqiptare, që me vështrimin e tij prej etnologu dhe antropologu solli në letërsinë shqipe një novelë moderne të përmasave evropiane.

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. L.Pirandello, *La trappola*, në *Novelle, L'uomo solo*, Fratelli Melita, Milano, 1993.
2. L.Pirandello, *Novelle, La giara. Il viaggio*, Fratelli Melita, Milano, 1993.
3. E Koliqi, *Vepra 2*, Faik Konica, Prishtinë, 2003.
4. T.Topalli, O.Baja, *Teksti dhe konteksti në novelën “Gjaku” të Ernest Koliqit*, në T.Topalli, *Kërkime gjuhësore 2*, Gjergj Fishta, Lezhë, 2011.
5. A. Plasari, *Qasje tregimit të Koliqit*, në “Jeta e re”, Prishtinë, 1995.
6. E. Laurretta, *Pirandello e la parola*, Centro degli studi pirandelliani, 2000.
7. Milioto, Scrivani (a cura di), *Pirandello e la cultura del suo tempo*, Mursia, Milano, 1984.
8. S.Çapaliku, *Estetika moderne*, Shblu, Tiranë, 2004.
9. Charles Brenner, *Breve corso di psicoanalisi*, Martinelli, Firenze, 1990.
10. L.Edel, *Psicologia e letteratura*, në *Dizionario della letteratura mondiale del 900*, Edizioni Paoline, Roma, 1980.
11. Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Tiranë, Alb-ass, 2000.
12. Blerina Suta, *Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe*, Onufri, Tiranë, 2004.
13. *Letërsia si e tillë. Probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare*. (Akte të konferencës, 28-29 maj 1996), Tiranë, Toena.

---

<sup>101</sup> A. Plasari, *Qasje tregimit të Koliqit*, në “Jeta e re”, Prishtinë, 1995, f. 91.

- 
14. *Fenomeni i avanguardës në letërsinë shqiptare* (akte të seminarit shkencor), Arbëria, Tiranë, 2004.
  15. Arben Hoxha, *Poetika e prozës së Ernest Koliqit*, Prishtinë, 2005.

**Psychologism as an influence on the early 1900-s literature  
(Pirandelo and Koliqi)**

*SUMMARY*

Koliqi introduced in the Albanian literature the “psychospective story”, as it has been called by Plasari. He considers it as a Pirandelo’s influence. Pirandelo is the great master of psychological descriptions and an outstanding Nobel laureate. Comparitivism is one of the methods which has resisted time and which remains one of the most effective approaches that allows detailed observations and powerful generalizations as well; above all, the discovery of values conveyed to times and civilization of different people.

As a conclusion, we can assert that Koliqi is the great master of psychological descriptions, the excellent connoisseur of Albanian social phenomena. Having an ethnologic and anthropologic vision, he offered to the Albanian literature a modern novel of European dimensions.

Vjollca OSJA

## ENERGJIA SIMBOLIKE NË POEZITË BIBLIKE TË F. NOLIT

*Të emërtojmë një objekt, do të thotë të cungojmë tri të katërtat e haresë së poezisë që duhet të dilte nga zbulimi i dalëngadalshëm; ndërsa, nga ana tjetër, ta sugjerosh objektin është gjë e ëndërrt. .... një objekt e shfaqim pak nga pak në mënyrë që të tregojmë një gjendje shpirtërore ose, anasjelltas, zgjedhim një objekt dhe çlirojmë prej tij një gjendje shpirtërore, duke shfrytëzuar një sërë deshifrimesh.<sup>102</sup>*

Një gjykim i tillë, i një përfaqësuesi të rëndësishëm të simbolizmit francez të shek. XIX (një ngjarje e madhe kjo për letërsinë moderne në përgjithësi<sup>103</sup>), mendojmë se na jep dorë, në formë sugjeruese, për të shkuar sa më afër konceptimit të natyrës së simbolit. Kështu, sipas përcaktimit të mësipërm, natyra e gjuhës së simbolit duhet parë e lidhur ngushtë me projektionin e efekteve që ai shpërndan (*mjegulla semantike*) dhe jo me kërkimin e ngulmët të domethënies së plotë e të vetme të një referenti konkret, sepse, ky i fundit, nëpërmjet denotimit që i bën shenjës simbolike, e zhvoshk simbolin nga vetia esenciale e tij: prodhimi i vazhdueshëm i efekteve, nëpërmjet një sistemi të pafundmë deshifrimesh.

Prej sa më sipër, arrijmë në pohimin se gjuha e simbolit është sugjeruese (sfera e papërcaktueshmërisë nëpërmjet rrotullës së evokimit) dhe jo konkretizuese/e drejtpërdrejtë (sfera e determinizmit semantik nëpërmjet rrotullës së denotimit të shenjës), sepse, në këtë linjë të dytë, gjykojmë se varfërimi i rrethit të referencave është varfërim i strategjisë poetike të tekstit.

Duke e konsideruar simboliken si pjesë e atij *repertori elementesh formale letrare* apo, me gjuhën e Eco-s, si *strategji tekstuale*, bëhet e

<sup>102</sup> “*Mbi zhvillimet letrare*”- bisedë e Mallarmé-së me Jules Huret, te Stéphan Mallarmé, *Poezi*, Tiranë, 2004, f. 84.

<sup>103</sup> Sipas Eco-s kjo është periudha që radikalizon shikimin mbi simboliken, pasi, tashmë, kemi hyrë në një gjithësi laike, ku simboli nuk duhet të zbulojë dhe të fshehë absoluten e besimeve, por absoluten e poezisë. Si manifest të kësaj periudhe letrare ai pranon poezinë “*Les correspondances*” (Përkimet) të Baudelaire-it. U. Eco, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007, f. 147.

mundshme të kemi një perceptim më të qartë të vlerës që ky element zotëron brenda ndërtimit të një teksti apo një sistemi poetik. Në këtë pikë bëhet i mundshëm integrimi i strukturës së simbolit në teksturën e ligjëritimit poetik. Rritja e dendësisë sugjестive, që sjell respektivisht nevojën e zvogëlimit të njësive leksematike në sintaksën poetike, vjen nëpërmjet mekanizmit të kondensimit<sup>104</sup> të frazës poetike.

Në këtë kuptim, qasja jonë ndaj ligjëritimit simbolik, që ofrojnë tekstet poetike të autorit të marrë në shqyrtim, merr parasysh njëherazi mekanizmin e ndërtimit të “mendimit simbolik” (Todorov, f. 225) dhe sërën e rathëve<sup>105</sup> evokues që shpërndahen nga vatra ku ndodhet simboli e që ndërtojnë sfondin interpretativ të tekstit.

Por problemi që mund të ngrihet në këtë rast, dhe jo vetëm këtu, mbetet të jetë ai i fshehjes së simbolit nën “tunikën e leshtë” të alegorisë apo përdorimi i kësaj të dytës si përfaqësuese e simbolit dhe dominante e tekstit. Në një pozicionim të tillë, ku alegoria (kuptimi i drejtpërdrejtë) dhe simboli (kuptimi i tërthortë) shtrihen në dy boshtet koordinative të tekstit, na mbetet të gjykojmë në bazë të vlerës taksonomike që zotëron gjuha poetike si jo e drejtpërdrejtë dhe e shumëkuptimtë.

1. Nëpërmjet shqyrtimit të poezive të Nolit mund të arrijmë të ndërtojmë vlerën që zotëron simboli brenda një sistemi të tillë. Në këtë rast gjykojmë se nga figurat biblike të poezive të Nolit (*Marshi kryqëzimit, Kryqëzimi, Kirenari, Krishti me kamçik, Moisiu në mal*) shpërthen një informacion në nivelin e nënkodeve alegorike dhe mitike, në bazë të të cilave: *kryqëzimi, Krishti, kirenari, Moisiu, golgotha* konotojnë kuptime simbolike të ndryshme, të cilat sugjerojnë leximin e tekstit drejt një subjektivizmi të tij, drejt një idiolekti simbolik.

Marrëdhënia që ka ndërtuar Noli, në poezitë e tij, me referencat biblike mendojmë se është e dy niveleve:

Niveli i parë - ai alegorik - është i kuptueshëm në perspektivën e leximit referencial: dmth në tentojmë të identifikojmë përvojën e autorit (referenti konkret - jeta personale dhe publike e Nolit) me përvojën e njohur të shenjës biblike. Kështu është interpretuar alegorikisht

---

<sup>104</sup> Sipas Todorovit, Goethe insistonte në karakterin lakonik dhe kondensues të simbolit, *Theories of symbol*, Tzetan Todorov, Cornell UP, NY, 1984, f. 204.

<sup>105</sup> “A symbol,” shkruan poeti dhe studiuesi John Ciardi në esenë *The way to the poem Robert Frost. Stopping by Woods on a Snowy Evening*, “is like a rock dropped into a pool: it sends out ripple in all directions, and the ripples are in motion. Who can say where the last ripple disappears?”, Robert Frost, *New Hampshire: A Poem with Notes and Grace Notes*, 1984.

marrëdhënia e Nolit me Moisiun, Krishtin, Shën Pjetrin, Kirenarin etj., tek poezitë e tij.

Dhe niveli i dytë - ai simbolik - është i kuptueshëm në perspektivën e leximit tekstual: dmth ne tentojmë të zbërthejmë shenjat e kondensuara biblike brenda tekstit në bazë të efekteve që ato prodhojnë. Në këtë të dytin, alegoria është e tejkualuar që në momentin kur tentojmë të ndërtojmë vija shenjore leximi dhe të priremi të interpretojmë në bazë të efekteve që ato prodhojnë.

E gjithë poezia *Kryqëzimi*, p.sh., nëpërmjet kondensimit të simbolit të Krishtit rrit potencialin e evokimit të imazheve dhe zvogëlon identifikimin e tekstit në një ide të vetme. Prania e sintagmave të referueshme biblike: *Krishtin kryqëson, tri Mari*, nuk e shter mjegullën semantike që shpërndan teksti. Përkundrazi, simbolika më e lartë e krishtërit, kryqëzimi, mund të merret jo për të ndërtuar analogji me një realitet konkret, por për të evokuar ritualin e aktit nëpërmjet të cilit prodhon efekt dhe “nëpërmjet këtij efekti, ai shenjon”<sup>106</sup> domethëniet. Në këtë rast simboli është një ftesë për një lexim subjektiv, ndërsa referenca mbetet të shërbejë si pikë (sa për afrimi aq edhe për largimi) nga ku ngrihen përvojat e interpretimeve tona. Njohja apo mosnjohja e jetës së Nolit nuk përbën kushtin e interpretimit të tekstit. Sipas Rifaterre-s, poezia nuk priret t’i drejtohet (referohet) një realiteti, por priret të vendosë një sistem koherent domethënie.

Nga ana formale e gjithë poezia mban një veshje simbolike që shtrihet nga përdorimi i simbolit tingëllor (dominanca e tingujve goditës grykorë k/g: *Po troket çekani/Po kërcet mejdani./Dor’e këmb’ i çpon/Krishtin kryqëzon.../ Çdo peronë plagë/përvëlon si flagë/ Çurka gjak buron/ Fryhet dhe pikon*) e simbolikës ritmike (6-rrokësh i shpejtë me këmbë të alternueshme) deri te vetë evokimi simbolik i ideve. Teksti merr vlerë simbolike, sepse perceptimi i tij shkrihet me idenë e emocionit që shkakton. Këto dy elemente, të lidhur me një lidhje specifike, formojnë të ashtuquajturin rreth simbolik.

I njëjti procedë ndërton edhe simbolikën te poezia *Kirenari* apo te *Moisiu*. Te *Kirenari* teksti evokon një sërë idesh dhe i mbledh ato së bashku në një formë të veçantë të fjalëve që sigurojnë një vlerë simbolike. Vetë figura e Kirenarit<sup>107</sup> sugjeron lexime të ndryshme. Që në strofën e parë zëri lirik kondenson dy strukturat simbolike që evokon kjo figurë:

<sup>106</sup> T. Todorov, vep. e cituar, f.114.

<sup>107</sup> Figurë biblike e papërcaktuar qartë për rolin që pati në historinë e kryqëzimit të Krishtit. Sipas tre prej Ungjijve (përveç atij të Gjonit, i cili nuk e përmend këtë figurë) Simoni i Cyrene-s ishte i detyruar nga romakët të mbante kryqin e Krishtit, ndërsa Krishti



*Ç' deshe ti, mor, në Kalvar,  
O qyqar, o Kirenar!  
Del me poçen për sehir,  
Ndrin në Kryqin si martir*

Struktura ritmiko-rimike e sintaktike e kësaj poezie është e njëjtë me atë të poezisë Marshi i Barabbajt

Ndërkohë që vetë poezia ofron, në mënyrë dikotomike këtë perspektivë leximi:

1. Përzierja e rastësishme në histori
2. Sublimimi i aktit nëpërmjet përfshirjes.

Cikli i Marsheve (*Marshi i Krishtit, Marshi i Kryqëzimit, Marshi i Barabbajt*) ndërlidhet me një rreth simbolik. *Marshi i Krishtit* dhe *Marshi i Barabbajt* ofrojnë të njëjtën arkitekturë ndërtimi (aq sa e dyta mund të shihet si projeksion, nga pikëpamja e strukturës ritmiko-rimike e sintaktike të vargjeve dhe strofave, i së parës), por ndajnë një veshje leksiko-semantike të ndryshme në varësi të referencës. Simbolikisht e dyta konoton valencat negative përkundrajt së parës. Të dy variantet së bashku marrin vlerë simbolike dhe në këtë marrëdhënie ato formojnë rrethin simbolik.

Gjysma e këtij rrethi (që korrespondon me poezinë e parë) evokon ndjesinë e madhërimit nëpërmjet njëjtësimi emocional të figurës së Mesisë me frymën simbolike që konotojnë poetikisht fjalët *lule, dafin', brohoritni, trumbeta, zurna* etj., ndërsa gjysma tjetër e rrethit (që korrespondon me poezinë e dytë) evokon ndjesinë e poshtëritimit e pështirosjes nëpërmjet njëjtësimi emocional të figurës së Barabbajt me frymën simbolike që konotojnë fjalët *hithr', shtog, gumëzhit, zinxhir, kamçik* etj. Këto dy poezi në ndërtimin e tyre i referohen arkesemes<sup>108</sup> simbolike.

---

shkonte drejt Kalvarit. Ndërkohë studiuesit e ndarë në dy grupe e kanë analizuar këtë pasazh, se,

1. zgjedhja e Simonit të Cyrene-s për të mbajtur kryqin që bërë për shkak të simpatisë që kishte për Jesusin, dhe
2. grupi tjetër e mohon këtë fakt, duke pohuar se teksti vetë nuk thotë asgjë, se Simoni nuk kishte zgjedhje tjetër dhe se nuk ka baza që ta lidhë detyrimin për mbajtjen e kryqit me simpatinë për Jesusin, T.A. Bryant, compiler. *Today's Dictionary of the Bible*. Minneapolis: Bethany House, 1982. Page 580.

<sup>108</sup> Termi archeseme është formuar për analogji me archiphoneme-n e Trubetzkoy-it për të shënuar njësitë kuptimore që përfshijnë të gjithë elementet e përbashkëta në një kundërvënie leksiko-semantike, J. Lotman, *The structure of artistic text*, University of Michigan, (Michigan Slavic Contributions 7.) USA, 1977, f.146.

**Nga Marshi i Krishtit:**

*Hosanna o çlironjës, Mesi, hosanna!  
 Shtroni udhën me lule, dafin 'e hurma,  
 Brohoritni trumbeta, timpane, zurna,  
 Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna!*

.....  
*Përmi Dhe, përmbi fron, përmbi Qjell u bekofsh,  
 Përmi djall dhe tiran, përmi Ferr mbretërofsh  
 Me pean dhe temjan, dhe këmban ' u- këndofsh,  
 Drit' e gas, rrofsh e qofsh: Hosanna, hosanna!*

**Nga Marshi i Barabbajt:**

*Allalla, o rezil e katil, allalla!  
 shtroni udhën me hithr' e me shtog turfanda  
 Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, baterma  
 Lehni, laro, kaba: Hosanna Barabba!*

.....  
*Në budrum, nëpër llom' e kufom' u-mallkofsh,  
 Në skëterrën, katran e tiran, u harbofsh,  
 Me tam-tam e allarm' e me nëm u-shurdhofsh,  
 Në zëndan mbretërofsh: Hosanna, Barabba!*

Poezia e tretë (Marshi i Kryqëzimit) lidhet me të parën nëpërmjet strategjisë ironike. I gjithë teksti sugjeron një lloj kodi të ri për ta ndërlidhur figurën e Mesisë me atë që evokon poezia e parë. Gjuha sugjeruese e simbolit bëhet komponente e strategjisë ironike të tekstit. Simbolikisht, struktura e vargjeve të kësaj poezie është ndërtuar në bazë të dy gjysmë njësisive kundërvënëse që prodhojnë energjinë ironike.

**Nga Marshi i Kryqëzimit**

*Do të vrasim, Jesu, se të kemi Baba,  
 Do të varrim, Mesi, se të kemi Usta,*

.....  
*Kryqësoji këta, se na vothnë fort pak,  
 Kryqësoje këtë se s'na vodhi aspak,*

.....  
 .....

**Symbolic energy in biblical poems of F. Noli*****SUMMARY***

In this article, the author endeavours to do a formal treatment of Noli's biblical poems. Through examination of poems (especially *Marsh* poems) the author points out the fact that relationship between his poetry and biblical references lies in two levels:

The first is the allegoric level and the second, symbolic level. Obviously on certain stylistic purpose Noli uses the biblical symbols as the ironically strategy of text..

Gëzim PUKA

## FENOMENI SERAFIN FANKO NË DRAMËN SHQIPE BASHKËKOHORE

### 1. Drama shqipe dhe teatri në Shkodër

Drama shqipe, në diakroni dhe sinkroni me atë nivel letrar që paraqitet është lëvruar pa ndërprerje. Sipas studiuesit Sabri Hamiti, “...drama është forma më e kanonizuar letrare, madje formë konservative dhe është e lidhur me teatrin si medium, i cili është i kushtëzuar nga niveli i institucionalizimit të kulturës së një mjedisi. Në parim, forma dramatike nuk shkruhet për t’u lexuar, por për t’u luajtur. Vetë këto venerime dëshmojnë pse drama si formë paraqitet vonë në letërsinë shqipe dhe pse variantet e saj nuk janë të mëdha”.<sup>109</sup>

Drama në letërsinë shqipe shfaqet në epokën Romantike, pak a shumë me kërkesat formale të dramës së epokës. Fillesat janë me dramën e Santorit “Emira” (1885), ndërkohë Sami Frashëri, kishte botuar në gjuhën turke dramën “Besa” (1877). Gjininë dramatike do e lëvronin edhe autorë si A. Z. Çajupi, F. Noli, M. Grameno, K. Floqi. Në këtë periudhë kemi dramaturgj shqipe, por mungon skena e teatrit që do t’i jetësonte qysh në kohën shkrimore.

Pjesët dramatike që u përmendën s’mund të vlerësohen si zanafilla e teatrit shqiptar, në kuptimin e ekzistencës teatrore apo të jetës skenike të veprës dramatike. Në librin e botuar me rastin e 60-vjetorit të themelimit të Teatrit të Shkodrës, studiuesi J. Papagjoni vëren se vepra e parë e vënë në skenë, është ajo e arbëreshit Leonardo de Martino (1830-1923), i cili shkroi shqip melodramën me karakter liturgjik “Nata e Këshndellave” në vitin 1880.<sup>110</sup> Kjo dramë u vu në skenë po atë vit në Shkodër, në Kishën e Etënve Françeskanë nga nxënësit e Kolegjit Saverian. Sipas dramaturgut dhe regjisorit Andrea Skanjeti, në librin e tij “100 vjet teatër në Shkodër, 1879-1979”, si shfaqje e parë përmendet farsa “Mako”.<sup>111</sup> Më 1882 u dha

<sup>109</sup> Hamiti, Sabri: *Tematologjia*, Botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2005, f. 85.

<sup>110</sup> Papagjoni, Josif, *Teatri i Shkodrës*, Shkodër, f. 9

<sup>111</sup> Shih: “Me gjithë këtë, dihet se në Shkodër më 20 shkurt 1879 nga nxënësit e parë të shkollës Saveriane, pas një akademie poetiko-muzikore dhanë farsën “Mako”, përkthyer shqip dhe përshtatur zakoneve shqiptare”. Skanjeti, Andrea, *100 vjet teatër në Shkodër (1879-1979)*, Tiranë, 2002, f. 17.

komedia “Biri i çifutit”, përshtatur në shqip nga dom Pashk Babi. Regjisori dhe hulumtuesi Lec Shllaku në librin e tij “Maska shkodrane – Kur lindej teatri”, shkruan se shfaqja e parë në qytetin e Shkodrës daton në vitin 1876, me pjesën “Zefi i humbur”.<sup>112</sup>

Ndihmesë dhanë në zhvillimin e teatrit në Shkodër veprat e Shtjefën Gjeçovit, Anton Xanonit, Kolë Mirditës (Helenau), Zef M. Harapit, Vinçenc Prendushit, Ndre Zadejës, Ndoc Nikajt, Henrik Lacajt, Filip Papajanit. Veprat e këtyre autorëve u bënë pjesë e repertorit aktiv të shoqërive e grupeve teatrore të kohës. Lënda letrare e shkruar për shfaqjet teatrore të kësaj kohe, ka qenë e natyrave të ndryshme.<sup>113</sup>

Gjergj Fishta është një nga dramaturgët me ndikim më të madh në Teatrin e Shkodrës nga viti 1909-1940.<sup>114</sup> Pothuajse të gjitha veprat e Fishtës u vunë në skenë nga shoqëritë e ndryshme teatrore të qytetit të Shkodrës.

Viti 1949 do të shënonte krijimin e teatrit “Migjeni”, i pari teatër profesionist pas Teatrit Popullor në Tiranë. Ky teatër në vite u shqua për vënien në skenë të dramës shqipe. Në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, u vunë në skenë dramat: “Nën okupacion”, “Toka jonë” e Kolë Jakovës, “Shtatë shaljanët”, “Votra e huej” e Ndrekë Lucës, “Nora e Kelmendit” me autor dhe regjisor Andrea Skanjetin. Në vitet ’60 spektatori ndoqi dramatizimin e romanit “Këneta” të Fatmir Gjatës. Po të kësaj periudhe ishin pjesët dramatike: “Plaku i maleve” i Tom Shoshit, “Bileta e llotarisë” e Dionis Bubanit, “Njerëz të thjeshtë” e Ibrahim Uruçit, “Familja e peshkatarit” e Sulejman Pitarkës, “Cuca e maleve” e Loni Papës, “Ngjarje në fabrikë” dhe “Lagjja e varfër” e Fadil Paçramit, “Fisheku në pajë” e Fadil Krajës, “Këshilli i ndrikullave” i Sheri Mitës, “Drita” e Mimika Lucës. Në këto vite kur në repertorin e teatrit dominoi drama shqipe, dukej që kishte një orientim partiak jo thjesht për të inkurajuar dramaturgjinë kombëtare, por edhe për shkak të përhapjes së ideologjisë së kohës. Edhe në vitet ’70 drama shqipe ishte në krye të repertorit të teatrit “Migjeni”. Të kësaj periudhe janë dramat dhe komeditë me problematikë të thellë politiko-shoqërore, si: “Viti ‘61” e Fadil Paçramit, “Katër nga armata”,

<sup>112</sup> Shih: “*Qysh në vjetin 1876 u ba një provë për shfaqje. Nji Kongregacion fetar katolik shfaqti për antarët e vet e familjet e tyne nji pjesë të nxjerrun prej Biblës, me titull “Zefi i humbur”. Por mbas kësaj deri në vjetin 1880, nuk kemi ma asnji njoftim për nji shfaqje të dytë*”, Shllaku Lec, *Maska shkodrane*, Shkodër, 2002, f. 21.

<sup>113</sup> Papagjoni, Josif: *Teatri i Shkodrës*, Shkodër, f. 10.

<sup>114</sup> Papagjoni, Josif: *Teatri i Shkodrës*, Shkodër, f. 21.

“Lindje në shtërngatë” e Serafin Fankos, “Fytyra e dytë” e Dritëro Agollit, “Çifti i lumtur” i Bik Pepës, “Lulet e shegës” e Kolë Jakovës.

Duke iu rikthyer studiuesit Josif Papagjoni, për krijimtarinë e këtyre viteve konstatohet se *“Një preokupim i vazhdueshëm i teatrit ‘Migjeni’, që përbën njëherazi edhe një tipar të tij sa i takon tendencës ideore, ka qenë kapja dhe sjellja në skenë e disa fenomeneve specifike të natyrës etno-psikologjike dhe zakonore, sikurse qenë recedivet e kanunit të Lekë Dukagjinit me pjesët e tij të gjakmarrjes, që shfrytëzohej kinse nga ‘elementi armik’, diversiv apo mendësia regresive, të gërshetuara rëndom këto me nevojën për tejkalimin e prapambetjes, për unitet e progres midis malësorëve”*.<sup>115</sup>

Të kësaj natyre kanë qenë dramat e Fadil Krajës, “Fisheku në pajë”, “Sinjalet e natës”, “Djem të mbarë”, “Shpartallimi”, “Baca i Gjetajve”.

Në fund të viteve ’70 dhe në fillim të viteve ’80, S. Fanko, themeloi **teatrin poetik** pranë teatrit “Migjeni” të Shkodrës. Shprehja e pastër e mizanskenës, paraqitja vizuale e tipit monumental, sensi i hollë dhe bukuria e fjalës poetike, bashkë me mendimin e figurshëm dhe ngarkesën metaforike të detajeve, janë disa nga cilësitë dalluese të këtij regjisorit, të cilat u shprehën edhe në konceptimin e dramës “Baca i Gjetajve”, 1986, e F. Krajës.

Vitet ’80 do të shënonin një individualizim më të madh të dramaturgut Kraja, sidomos me dramën “Gjaku i Arbërit”. Qasja e spektatorit receptues ndaj kësaj drame me një patos tragjik dhe me elemente të simbolit poetik, ishte edhe meritë e dramaturgut-regjisor Serafin Fanko, me leximin dhe gjetjet e tij skenike. Po në këto vite do të lëvroheshin në skenën e teatrit “Migjeni” dramat: “Rrënjët e dashurisë” e Mustafë Tukajt, “Kënga e dhembjes krenare” (teatër poezie me krijimtarinë e Migjenit), “Tregim për Makbethin” (libret i mbështetur në veprën shekspiriane), “Shtegtim nëpër ankth” (dramatizim i romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” të I. Kadaresë). Të trija këto sprova dramatike u sollën nën firmën autoriale dhe regjisoriale të Serafin Fankos, i cili gjithnjë e më tepër po spikaste si një individualitet brenda skemës së komunikimit dramaturgjik, estetikisht origjinal dhe me statusin e një autori postmodern.<sup>116</sup>

<sup>115</sup> Po aty, f. 54.

<sup>116</sup> Shih: “Natyrisht që një këndvështrim i tillë, i cili e sheh autorin postmodern thjesht e para së gjithash si një “përzierës a moderator” tekstesh, stilesh e artesh të ndryshëm dhe veprën postmoderne si një koktejl të të gjithë këtyre, është në thelbin e tij jo pak manipulues e simplacist. [...] Është e qartë pra, se statusi i autorit postmodern, me gjithë kontestimet jo të vogla, paraqet risi e dallime të rëndësishme në raport me statuset e

Në vitet '90 arriti të pasurojë dukshëm format shprehëse, si një regjisor me identitet të spikatur. Me vënien në skenë të dramës “Ftesë nga larg” (1996), të autorit Stefan Çapalikut, S. Fanko i përcolli publikut, përmes një sensi të fortë kritik dhe një ironie të hapur, shqetësimin social për progres dhe emancipim. Drama e fundit që vuri në skenë regjisori Fanko ishte “Babai” e Ruzhdi Pulahës, në maj të vitit 2006.<sup>117</sup> Kjo dramë e interpretuar nga trupa e Teatrit Kombëtar, shënoi suksesin e fundit të artistit regjisor.

## 2. Fanko autor

Hyrjen e tij në teatër si autor, S. Fanko e kishte filluar që në vitet '70. Më sipër përmendëm dramën “Katër nga armata”(1973) dhe “Lindje në shtërngatë”, kjo e fundit edhe e botuar në revistën “Teatër” në vitin 1975. Në të dyja këto drama si nga ana tematike, ashtu edhe nga ana ideore, është i dukshëm ndikimi i ideologjisë së kohës. Tek teksti “Lindje në shtërngatë” vjen atmosfera e viteve të fundit të Luftës së Dytë Botërore. Me një ndikim të fortë realist, teksti tenton të sjellë konfliktet dhe situatat e ndera në një familje kolaboracionistësh me pushtuesit e huaj, në prag të çlirimit të vendit. Këto drama nuk shënojnë ndonjë risi, madje mund të thuhet se janë në koherencë të plotë me tekstet dramatike të angazhuara të periudhës së realizmit socialist.

Sfidën e tij si dramaturg Fanko do e vazhdonte me sprovat e dramatizimeve të disa teksteve të Migjenit. Me libretin “Kënga e dhembjes krenare” në vitin 1983, ai aplikon me sukses një performancë të tipit të teatrit të poezisë. Po kështu, të një vlere jo shumë të madhe letrare, janë edhe tekstet e dramatizuara “Tregim për Makbethin”(1984) dhe “Shtegtim nëpër ankth” (1987). Për të dyja këto tekste mund të shënohet thjesht magjepsja prej teksteve origjinale, përkatësisht atij shekspirian dhe kadarean. Në gjykimin tonë ato janë vepra të një intenziteti ndërtekstësor të parëndësishëm.

### 2.1. Drama “Pse?”

Në vitet '90 rikthehet si autor me një hapësirë të re mendimi, fuqi përtëritëse për tejkalimin e gjendjeve konfuze në udhëkryqet historike e aktuale të shqiptarëve. Kështu, ai ka parapëlqyer dhe ndërtuar metafora të

---

*mëparshëm përgjatë zhvillimeve historiko- letrare. Një status i tillë duket që i vë në diskutim (për të mos thënë se i mohon) konceptime të tilla klasike si ai i “origjinalitetit krijues”, “hierarkisë së vlerave”, etj. E megjithatë praktika letrare postmoderne, me përfaqësuesit e saj më të rëndësishëm (shenjë kjo e hierarkisë së vlerave), dëshmon për jo pak autorë origjinalë e krijues në veprën e tyre”. Dibra Ridvan, Një lojë me emrin postmodernizëm, Tiranë, 2007, f. 106.*

<sup>117</sup> Hamzai, Dhurata: “Ku ishte ti Serafin Fanko”, Gazeta “Tema”, 5 maj 2006.

guximshme, nga subjektet dhe trajtimet shpesh mitologjike të realitetit. I ngacmuar nga romani “Pse” i Sterio Spases, rreth 60 vjet me vonë, Serafin Fanko do ta risjellë jehonën e këtij teksti në disa përmasa të reja. Teksti i dramës “Pse” në 40 faqet e dramaturgjisë, është pasuruar me elementë të reja. Romani “Pse”, siç e vëren me të drejtë studiuesi Sabri Hamiti ,

“... është shkruar në trajtë ditari që kap një vit. Kjo është formë letrare që krijon iluzionin se e thotë të vërtetën, apo e dëshmon realitetin në letërsi, duke e dëshmuar si shkrim të ditës pa asfarë distance kohore as emocionale me të ndodhurat. Në anën tjetër, kjo metodë krijuese dëshmon një trajtë të shkrimit personal të protagonistit, një gjykim të tij për ngjarjet rreth tij, duke shprehur pikëpamjet e tij për realitetet. Vepra e shkruar në trajtë ditari është e përshtatshme për të treguar emocionet e meditimet, por jo edhe të ndodhurat e veprimeve”<sup>118</sup>. Me këtë tipar të tekstit origjinal, teksti dramatik i Fankos krijon tension ndërtekstësor duke shndërruar veprën në trajtë ditari, monologu, në një vepër veprimi dhe dialogu. Ai ndërton një dialog, ku përveç paratekstit të romanit vërehet edhe citimi i tekstit biblik, tekstit folklorik dhe filozofik. Mbase është montimi i këtyre teksteve dhe veshja me një filozofi ironie romantike, risia që fillon të duket në krijimtarinë e këtij autori. Nëse citojmë përsëri Papagjonin “S. Fanko ka realizuar një harmonizim të dukshëm midis shëmbëllimeve realiste dhe atyre jorealiste, midis parametrave aristotelianë të rikrijimit të gjasës jetësore dhe parametrave të tjerë joaristotelianë, që e tjetërsojnë, që e shfytërojnë, apo që e shndërrojnë pjesërisht, deri edhe tërësisht këtë gjasë jetësore, sikundër është vënë re kjo te dramaturgjisë që i bëri romanit “Pse” të Sterio Spases”<sup>119</sup>.

Forma e thurjes dhe struktura dramatike kanë fituar përmasa të reja. Sapo nis veprimi dramatik disa shtriga dhe shtriganë, shoqërojnë ardhjen në jetë të njeriut. Quhet Gjon Zaveri. Ai vjen në këtë jetë ashtu i lakuriqtë, i pastër me ëndrra dhe shpresa, por njëkohësisht ai vjen në këtë jetë i shoqëruar nga një trashëgimi shpirttrash të vdekur, tepër agresivë që e shoqërojnë si makth, në çdo hap të hedhur. Një nga tiparet e letërsisë që prodhon autori në shqyrtim, është bashkëjetesa e të gjallëve me të vdekurit. Gjon Zaveri gjakon për gjetjen e rrugëdaljes së tij, por kjo rrugëdalje kërkon që ai të ngarkojë, ashtu si gjithkush në këtë botë, kryqin e mundimit. Këtu kemi edhe ndërtekstësorësinë biblike në tekst, kemi Golgotën e tij drejt thelbit dhe së vërtetës. Biblizmin apo detaje dhe aluzione nga Bibla e libra të tjerë të shenjtë, si elemente postmoderne të tekstit të

<sup>118</sup> Hamiti Sabri, *Letërsia moderne shqipe*, Tiranë, 2009, f. 422.

<sup>119</sup> Papagjoni Josif, *Teatri i Shkodrës*, Shkodër, 2009, f. 87.



Fankos, do të takohen edhe më poshtë gjatë këtij studimi. Personazhit Gjon Zaveri i thonë që të martohet me një vajzë të dliërë fshatare, Afërditën, por atij zemra i përgjërohet për një vajzë tjetër nga qyteti, për Polën. Atëherë zërat e moçëm stërgjyshëror, tashmë jo si skelete trupash, por si opinion shoqëror, nisin t'i flasin, ta imponojnë që t'i përmbahet kodit zakonor dhe të martohet me vajzën që i kanë zgjedhur prindërit. Studiuesi Papagjoni thekson: *“Nëse do ta kundronim krijimtarinë e Serafin Fankos në vitet '90, do vinim re se në mendimin e tij zë fill pothuajse ngaherë ideja e sakrifikimit. Diçka e shtrenjtë sakrifikohet, me shumë dhembje, por edhe me shumë dhunë.[...] Edhe dashuria e Gjon Zaverit në shfaqjen “Pse”, tok me të liria e tij sakrifikohen. Ai vetë është viktimë e inercisë së dhunshme të trashëgimisë sonë, e mungesës së emancipimit qytetar”*.<sup>120</sup>

Duket se loja e strategjisë autoriale në dialogun e “Pse”-së, me imagjinaren receptive të lexuesit- spektator, është në tensionin që krijohet midis kodit moral zakonor të besës apo fjalës së dhënë dhe lirisë së zgjedhjes. Teksti funksionon si një metaligjërime ironik mbi ligjërimit moral dhe ligjërimit filozofik të lirisë individuale. Midis këtyre ligjërimeve brenda dramës, patjetër që nuk kemi një konsensus universal. Që lojërat ligjërimore të jenë universalisht të vlefshme, duhet që finalja e të dialoguarit mes tyre të jetë vetë mirëkuptimi. Mirëkuptimi në tekstin “Pse”, nuk është një finale, por një gjendje e gjërave. Duke iu rikthyer Papagjonit gjejmë këtë interpretim: *“Nga gjendja disintegruese, nga mungesa e paqimit mbarëshoqëror, rrjedhimisht e paqimit të brendshëm shpirtëror dhe midis së djeshmes së një Gjon Zaveri në vitet 30, i cili kërkonte pakëz dritë në kubën e errët patriarkale të shoqërisë dhe një Gjon Zaveri të sotëm, tashmë i kuptuar si gjendje shpirtërore, që migron e vjen natyrshëm deri tek ne, në tranzitin e rrëmujshtëm ndërgjegjësor që përjetojmë, pikërisht tek ky pikëtakim duket se qëndron edhe tharmi”*.<sup>121</sup>

Meqë ekziston kjo gjendje në këtë lojë ligjërimore të tekstit dramatik, ajo duhet të jetë lokale dhe jouniversale. Tek Gjon Zaveri nuk kemi një universalitet, por përkundrazi një botë shpirtërore brenda së cilës metarrëfimet morale dhe filozofike, janë pakthyeshmërisht dhe pandreqshmërisht të rrëzuara. Gjoni e mori Afërditën për grua, sepse u dha fjalën, pra besën prindërve të tij, por nga ana tjetër u tregua i pabesë ndaj Polës, të cilën e braktis nga presioni i opinionit. Në të kundërtën, Gjoni martohet me Afërditën, duke pranuar vuajtjen, tjetërsimin. Atëherë

<sup>120</sup> Papagjoni Josif, *Ankthi i njeriut shqiptar në dikotomitë luftë-paqe, besë-pabesi. Vështrim analitik në disa shfaqje të Serafin Fankos, “Pajtimi”*, Nr 2, Prill-qershor 2001, f. 21.

<sup>121</sup> Po aty, f. 23-24.

martesa në kuptimin e paqes, harmonisë, lumturisë, shndërrohet në të kundërtën e saj, kurse dashuria për Polën në ankth. Kjo lojë binare e traditës zakonore me lirinë individuale, prodhon në subjektin Gjon një sferë të tretë ironike, që nuk është as traditë, as e ardhme e lirisë, por është element trenar, që paraqet krizën ekzistenciale, është vetësakrificim.

## 2.2. “Çmurosja”- Legjenda apo miti i çmitizuar

Në traditën kulturore shqiptare përcillet në formë gojore apo të shkruar, legjenda ose miti i murosjes.<sup>122</sup> Kur thuhet legjenda ose miti mbahet parasysh e përbashkëta e tyre, fakti që të dyja i drejtohen kolektivitetit me qëllimin për t'u lidhur fort në aspektin e përkatësisë me këtë kolektivitet, duke lënë mënjanë ndryshimin e tyre si terma letrarë. Në këtë rrëfim simbolik e sakral paraqitet sakrifica njerëzore në themel të mbijetesës së një ndërtese që është kala, kullë, urë. Me këtë mit apo legjendë të murosjes kanë krijuar raport shumë vepra të letërsisë shqipe. Ky mit është parë si thesar tematik, stilistik apo strukturor. Mbështetja në mite ka qenë karakteristike për shkrimtarë që u bënë klasikë të modernizmit, si: Xhojsi, Prusti, Kafka, Rilke, etj. Letërsia e shfrytëzon mitin që të dëshmojë përmes tij unitetin e logocentrizmit tashmë të humbur të botës dhe të shoqërisë njerëzore.<sup>123</sup> Në leximin e kohës drama “Çmurosja” e Fankos, ndesh në reagimin e kritikës. Në një shkrim të Lazër Stanit nënvizohet: *“Dobësia themelore qëndron pikërisht në keqinterpretimin e mitit. Është fakt se çdo shoqëri (qofshin këto edhe të emancipuarat), jeton gjithsesi nën trysninë e së shkuarës së vet, nën trysninë e miteve, zakoneve, dokeve, kodeve morale dhe etike, të përpunuara shumë kohë më parë, të krijuara thellë në të shkuarën. Është fakt gjithashtu se këpucët e së shkuarës janë tepër të ngushta për njeriun e sotëm, e pengojnë atë të vazhdojë normalisht përpara. Procesi gjithnjë ecën nëpërmjet thyerjes së diçkaje dhe krijimit në vend të saj të një diçkaje të re, më të lehtë më të përshtatshme për t'u mbajtur”*<sup>124</sup>. Në këtë nivel leximi, autori i këtij shkrimi nuk dallon huazimin që i bën teksti letrar mitit, jo si ilustrim, por si diçka të vërtetë që krijon realitetin e vet. Teksti dramatik, karakteret, hapësira skenike vihen në

<sup>122</sup> Shih: “Murosja e gruas. Tema e murosjes së gruas është mjaft e përhapur në këngët tona legjendare. E njohur është legjenda e famshme e Rozafatit ose e kalasë së Shkodrës. Tregohet dhe për kala të tjera dhe për ura të ndryshme. Motivi epiko-legjendar i baladës së murosjes së vashës në themel të kalasë, në urë a në kishë, lidhet me besimin shumë të lashtë, sipas të cilit, nëse murosset gjallë një njeri, ky bëhet shpirti mbrojtës i ndërtimit dhe lidhet me të përgjithnjë”. Podgorica Fadil, *Fjalor etnofolklorik*, Shkodër, 2004, f. 280.

<sup>123</sup> Dibra Ridvan, *Një lojë me emrin postmodernizëm*, Tiranë, 2007, f. 91.

<sup>124</sup> Stani Lazër: “Keqinterpretimi i mitit”. - “Republika”, 27 nëntor 1994.

shërbim të mitit apo legjendës. Thënë ndryshe në sprovën postmoderne të Fankos, mitit a legjendës i lihet kryet e vendit në strukturën e veprës. Në shënimin hyrës të tekstit dramatik, autori përshkruan skenën ku në qendër të saj është shtatorja e gurtë me gjinj të që pikojnë qumësht.<sup>125</sup> Prezenca e mitit apo e legjendës së murosjes në dramën “Çmurosjja”, bëhet ironikisht në një rrafsh të ri kohor, hapësinor e social.<sup>126</sup> Në nivelin e leximit të Lazër Stanit, kjo ironi nuk rroket, madje artikulli në fjalë, vijon t’i qaset tekstit dramatik me terma të kritikës social-historike. “*Shqiptarët po të kemi parasysh kontekstin historik të mbijetesës së tyre kanë rezistuar dhe kanë ruajtur identitetin e vet si kolektivitet jo nëpërmjet eksponentëve të fuqishme të kulturës, po pikërisht nëpërmjet kodeve të tyre moralo-etiko-etnike, gjuhës dhe mitit, gjithsesi të patjetërsueshme nga çdo ballafaqim historik.*”<sup>127</sup> Autori i vëzhgimit kritik, nuk ka parasysh se rimartja e miteve në vepra të natyrës postmoderne, sjell patjetër një dije, një ndjeshmëri të re dhe për rrjedhojë një konceptim të ri artistik të mitit të vjetër. Murosjja është një strukturë arketipale narrative. Varianti i paraqitur në dramë tërheq pas personazhet dhe spektatorin. Miti-legjendë është prezent në imagjinaren e lexuesit. Të gjithë e njohin. Tensionet prodhohen prej narratorit tek lexuesi, të cilave ai u bashkon tensionet e tij psikologjike. Miti veç paraqitet përmes shtatoreve të gurta në shënimin autorial hyrës të cituar më sipër. Lexuesi-spektator që lexon apo imagjinon hapësirën skenike, bëhet një bashkëpunues interpretativ. Ai duhet të mbushë “hapësirat boshe” që lë tekstura dramatike. Në mitin-legjendë muroset njëra nga tri nuset. Është ajo shtatorja më e lartë në skenë. Porosia e së murosurës është që njërin gji t’ia lënë jashtë, për të ushqyer breznitë. Në mit besohet tek sakrificat dhe ripërtëritja.<sup>128</sup> Konceptim i ri është në funksion të ironisë postmoderne. Kush nuk e kupton lojën në tekstin dramatik të Fankos, s’ka ç’të bëjë tjetër veç të mos e pranojë. Me këtë tekst mund të ndodhë që loja e tij të merret

<sup>125</sup> Shih: “*Muzikë, errësirë gradual. Sipari hapet në terr. Dritat pak nga pak zbulojnë skenën. Tri shtatore të mëdha lakurige, të gurta. Njëra përballë qendrës dhe dy anash*”. Fanko Serafin, “Çmurosjja”, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1994, f. 2.

<sup>126</sup> Shih: “*Djali 1 – Ne jemi bijt e një fisi të përmendur!*

*Që gjakun e rrënjët i ka në lashtësi.  
Djali 2 – Ç’po punojshin tre vllazën  
Murin e qytetit  
Gjithë ditën po punojnë  
E gjithë natën iu rrënohet*”. Po aty, f.5.

<sup>127</sup> Stani Lazër, “*Keqinterpretimi i mitit*”.- “Republika”, 27 nëntor 1994.


<sup>128</sup> Shih: “*Në qendër të subjektit të këngëve të murimit qëndron një subjekt i lashtë, ai i sakrificës dhe i flijes njerëzore*”. Podgorica Fadil, *Fjalor etnofolklorik*, Shkodër, 2004, f. 178.

seriozisht. Ky është edhe rreziku i ironisë. Në receptimin e kohës kur vepra u shfaq në skenë, një pjesë e kritikës, e mori kuvendimin ironik sikur të ishte serioz.<sup>129</sup> Teksti i Fankos që të bëhet i kuptueshëm kërkon jo mohimin e asaj që është thënë tashmë, por të rimenduarit e saj ironik. Autori e nuhat që të bësh për vete një publik të gjerë dhe të popullosh ëndrrat e receptuesit, s' do të thotë patjetër t'i ngushëllosh.

Lexuesin-spektator teksti i Fankos e tërheq duke i futur ankthin. Ky ankth vjen në dramë që në fillim me përshkrimin skenik të shtatoreve të gurta, të korit të skeletosur, të hapësirës bosh pa objekte dhe ngjyra, të vargojve me gjatësi të ndryshme.

Legjenda-mit e murosjes në dramë është statuja dhe struktura fundamentale skenike e vendosur në bazë të kulturës shqiptare. Përsa i përket domethënies thelbësore kulturore dhe morale, miti i Rozafës në dramë paraqitet fantastik dhe grotesk. Kështu në dramë konvencioni teatror skenografik është një tentacion, për të shpjeguar apo komunikuar me konvencionin kulturor receptues, thënë ndryshe janë këto të fundit dmth receptuesit që do të gjejnë shpjegim. Në njërën anë kemi anën intensionale të tekstit apo remarkave autoriale për skenën dhe në anën tjetër jetën sociale të tekstit të munguar mitiko-legjendar. Në skemën e mëposhtme shprehet në mënyrë të thjeshtë drejtimi i funksionit shënues nga plani i përmbajtjes tek plani i shprehjes.

Drejtimi i autorit model. Fig. 1



<sup>129</sup> Shih: “Unë këtë murosje aspak nuk e shoh si një fenomen alarmant, aq më tepër kur çdonjëri nga ne mund të unifikojë se parimet e internacionalizmit socialist (idiot) shumë njerëzve ua kanë humbur identitetin, i kanë bërë ata të paafte të ballafaqohen dhe të mbijetojnë me identitete të tjera [...], asnjëherë nuk është rënë në një keqinterpretim dhe keqpërdorim të miteve, që gjithsesi janë pasuri shpirtërore e pamohueshme”, Stani Lazër: “Keqinterpretimi i mitit”. Gazeta “Republika”, 27 nëntor 1994.

Në prodhimin e kuptimit autorial duke iu referuar fig.1, legjenda kërkon të shndërrohet në mit dhe miti të çmitizohet. Lexuesi ka njohje për legjendën dhe referentin, që është kalaja e Rozafës dhe historia e saj e lashtë. Me hapjen e siparit apo gjatë leximit të pjesës ai hutohet nga paraqitja skenike.<sup>130</sup> Ai është mësuar me pamjen dhe legjendën e kalasë. Është mësuar me figurën e Rozafës në statuja ose piktura. Një grua e re duke ecur, që u çon ushqimin kunetërve ose ajo që me njërin gji ushqen foshnjën që mban në krah. Lexuesi e ka kontaktuar këtë informacion kudo; në muzeun e kalasë, revista, gazeta, kinema. Lexuesi madje, mund të jetë ndalur edhe nën atë murin, ku ciceronit të kalasë i pëlqen të thotë se rrjedh akoma qumësht. Në të shpeshtën e rasteve i janë ofruar klishtë; motiv frymëzimi, lashtësia e popullit tonë, sakrifikim për brezat që vijnë, besa e mbajtur dhe besa e thyer. Ndonjërin nga këto mund ta ketë trajtuar edhe si temë hartimi kur ishte në shkollë, duke shprehur kështu ndjenjën e krenarisë për të qenët bir i këtij kombi të lashtë. Kritiku Lazër Stani në shkrimin e kohës e vërteton këtë lloj leximi: “...me sa kam lexuar unë, asnjëherë nuk është rënë në një keqinterpretim dhe keqpërdorim të miteve, që gjithsesi janë një pasuri shpirtërore e pamohueshme”.<sup>131</sup> Ky lloj lexuesi apo spektatori i qaset tekstit me indinjatë, por ky nuk është lexuesi, të cilit teksti i drejtohet. Autori model si strategji tekstuale i drejtohet lexuesit model.<sup>132</sup> Teksti dramatik nuk komunikon asgjë, nëse nuk gjen një marrës, lexues apo spektator kompetent, i aftë që ta kuptojë. Domethënia e fig.2 është fillimi i rrugëtimit tonë në kuptimin e veprës.

*Vuku – (Mbas një pauze të shkurtër) Po ata?*

*Nana – Kush?*

*Vuku – Ata. (Tregon shtatoret e gurta.)*

*Nana – Janë themelet e këtij trualli. Janë historia e fisit. Të lashta sa vetë fisi.*

*Vuku – Dhe pikojnë qumësht...*

<sup>130</sup> Shih: “Një shtatore e dyzuar si përfytyrimet e lashta mitologjike; poshtë trupi i zhveshur i një gruaje me gjinj të mëdhenj që mekojnë breznitë e fisit, sipër koka e rrudhur e një burri, mustaqe dhe buzët e shtënguara, që duket se kërkon diçka e s’e gjen dot. E gjitha ajo të duket si e pagdhundur, amorge, enkas e konceptuar kësisoj, si pjesë e një kështjelle, e muruar përjetësisht aty”. Papagjoni Josif, Arta Marku: “Çmurosjë: Vepër dramatike e karakterit dhe e dimensioneve filozofike”. Gazeta “Koha jonë”, 23 nëntor 1994.

<sup>131</sup> Stani Lazër: “Keqinterpretimi i mitit”, Gazeta “Republika”, 27 nëntor 1994.


<sup>132</sup> Shih: “Autori dhe lexuesi model janë dy imazhe që qartësohen në mënyrë të ndërsjelltë vetëm gjatë leximit dhe në fund të tij, kështu që ndërtohen me njërin-tjetrin. Besoj se një gjë e tillë është e vërtetë jo vetëm për veprat e narrativës, por për çdo tip teksti”. Eko Umberto, *Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, Tiranë, 2007, f. 36.

*Djali 3 – E paske vënë re?!*

*Vuku – Ndoshta aromën e qumështit kanë nuhatur ujqërit, që vijnë rrotull*.<sup>133</sup>

Lexuesi hutohet ndërsa ndërmend legjendën origjinale dhe referentin e saj.

Drejtimi i lexuesit model<sup>134</sup>. fig.2



Domethënia e fig.2 është fillimi i rrugëtimit në kuptimin e veprës. Miti i çmitizuar është provokim ndaj lexuesit. Ironia është pikërisht ajo parashtesa e titullit ç-murosjë. Kur përdor ironinë dhe lojën me mitin, teksti i Fankos shtron pyetjen, nëse zgjidhja e gjetur është aq origjinale sa të justifikojë mundimin e bërë. Ne mendojmë se po.

### 2.3. Drama “Trokitje në dyert e dhimbjes”

Drama “Trokitje në dyert e dhimbjes” merr shkas nga ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri, në qendër të saj është një nënë, e cila preket nga lufta dhe e mallkon atë. Është me një ndikim ndërtekstësor strukturor nga dramat e Brehtit. Në të ndeshet një gërshetim i traditës dhe bashkëkohësisë. Duke anuar nga lloji i dramës së angazhuar, tek ky tekst ndihet një lloj angazhimi politik. Në një intervistë të Fankos për këtë dramë ai do shprehej: “*Fabula e kësaj drame zë fill që tre vjet më parë. Për të shkruar këtë pjesë jam ngacmuar nga ngjarjet e vitit 1997. Në qendër të dramës kam vendosur një nënë shqiptare që ashtu si nëna Kurajë në veprën e Brehtit, preket nga lufta dhe e mallkon atë. Por nga ana tjetër jemi ne që e kemi pjellë atë kohë ndaj nuk duhet t’ kthejmë sytë pas. Është një sensibilizim për t’u drejtuar nga e*

<sup>133</sup> Fanko Serafin, “Çmurosjë”, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1994, f. 17.

<sup>134</sup> Shih: “Në fakt të flasim ndryshe drama “Çmurosjë” është për anë të fabulimit dhe kuptimit të drejtpeshuar e kundërta që na ofron miti”. Prendi Arben, “Defigurimi i mitit”, Gazeta “Rilindja”, 16 nëntor 1994.

ardhmja. S' duhet të lusim Zotin në emër të djallit apo të merremi me natën për të dalë në dritë. Të gjitha këto janë mesazhe për ta ndërtuar vetë kohën dhe të luftojmë për ta fituar atë".<sup>135</sup>

#### 2.4. "Quo vadis" rrënqethja ironike

Ndërtëkstoriësia biblike dallohet që në titullin e kësaj drame të Serafin Fankos.<sup>136</sup> Kjo dramë është një tjetër sprovë e guximshme si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Le të sjellim një nga shkrimet në gazetën e kohës, në fokusin e studimit tonë.

*"Duke projektuar imagjinarisht dramën e një familjeje shqiptare, autori shtron odisejadën tragjike të një populli mbërthyer në traditën makabre kanunore. Mozaiku me të cilin fiksohet dhe shprehet artistikisht veprimi dramaturgjik, lëmon dhe merr hua një ngjarje të viteve të kahershme. Kjo klithje e marrë nga e kaluara, shndërrohet në boshtin qendror të veprës dhe i shërben atij si shkak dhe pretekst për të nxitur vizionet e së tanishmes së afërt dhe aktuale. Në këtë botë ku përzihet dhe shkrihet në vetvete e largëta me të afërmen, kanunorja me modernen, e mundshme me të pamundshmen, Fanko pikturon artistikisht bukur kohën tonë duke e ngjyrosur atë me ngjyra të ashpra rembrandiane. Fjala në dramaturgjinë e tij lëmon dhe kafshon tinëzisht në të njëjtën kohë. Duke i lidhur dhe gërshetuar funksionalisht karakteristikat historike, nxjerr dhe i sugjeron shikuesit porosi të rëndësishme shoqërore, kombëtare, filozofike, njerëzore. Ndërsa në fundin tragjik të veprës, Fanko mbështet mendimin se shqiptari edhe gjatë fatkeqësive më të mëdha është marrë më tepër me gjëmën e vet se sa me urrejtjen ndaj shkaktarëve të fatkeqësive dhe të tragjedive kombëtare."*<sup>137</sup>

Në aktualizimin e sotëm të këtij teksti të Fankos, do të thonim se ka akoma shumë më tepër hapësira boshe, përmes të cilave teksti i lë iniciativë interpretative lexuesit të sotëm. Për të qenë sa më shterues, po përpiqemi të risjellim sa më shumë rrugëtime interpretative të kësaj drame, që lindi dhe u shfaq në disa kushte tepër të vështira për kombin tonë. Kritiku Adriatik

<sup>135</sup> Murati Violeta, "Fanko troket dyerve të dhembjes në Pragë", Gazeta "Shekulli", 23 qershor 2001.

<sup>136</sup> Shih: "Sipas librit të akteve të shën Pjetrit, gjatë persekutimit të kristianëve të urdhëruar nga Neroni, shën Pjetri po ikte nga Roma për të evituar sakrifikimin. Papritur i shfaqet Jezusi, që ecën në drejtim të kundërt, drejt qytetit të Romës. Mes tyre zhvillohet ky dialog. (-Quo vadis, Domine?) -Zot, ku po shkon?-e pyet apostulli. (-Eo Romam, iterum crucifigi.) -Po shkoj në Romë për t'u kryqëzuar rishtaz,- iu përgjigj Jezusi. Apostulli atëherë e kuptoi që Jezusi me këtë shenjë, i kërkon të rikthehet në Romë, të pranojë sakrifikimin. Shën Pjetri bindet. Tradita kristiane pranon se shën Pjetri u kryqëzua me kokë poshtë, sipas kërkesës që ai e bëri vetë, pasi nuk ndjehej i denjë të vdiste në të njëjtën mënyrë si Mjeshtri" përkthyer nga "Wikipedia, l'enciclopedia libera".

<sup>137</sup> Radi Ferdinand, "Quo vadis" në Teatrin Kombëtar", Gazeta "Albania", 20 shkurt 1997.

Kallulli shprehet: “*Drama është shfaqur si premierë në ditët e fundit të janarit 1997. Atëherë nuk e tërhoqi shumë vëmendjen e artëdashësve, ngaqë erdhën ngjarje makabre ku s’e mori vesh i pari të dytin. Artisti u paraprin mëkateve tona kolektive. Ai nuk e sheh me skepticizëm procesin e pastrimit. Heroi tragjik i dramës, por edhe i biri i tij e shqelmojnë të keqen. E dinë ku është dhe nga vjen. E nxjerrin nga pragu i derës dhe nga shpirti. Dyluftimi i tyre është i gjallë, cfilitës, madje edhe pasi kanë gabuar, vuajnë gabimin*”.<sup>138</sup>

Një gjykatëse merr në pyetje një burrë, mbuluar deri në fyt me një mantel të gjatë. I pandehuri dhe i biri, akuzohen për vrasje, për krim të shëmtuar, kryer me paramendim në ditët e vrasjes së një çifti. Faktet dhe provat gjyqësore që rëndojnë mbi ta janë të plota. Ata e pranojnë aktin e vrasjes. Kur vjen çështja tek motivet që i shtyjnë në krim, pohojnë vendosmërisht se janë të tjerë që ua kanë helmuar ndërgjegjen për t’i shpënë drejt krimin. Janë këta të tjerë që kanë qëlluar me dorën e tyre të padukshme. Diku nga salla, nga mesi dhe cepet e saj, ngjiten në skenën gjyq, dëshmitarët. Lexuesi-spektator provokohet si pjesëtar dhe si dëshmitar i tekstit. Kështu vendoset mes autorit dhe receptuesit (lexuesit-spektator), një lojë pritjeje reciproke, si një ndeshje shahu. Strategu autor duhet të imagjinojë se cilat janë kompetencat ligjërimore dhe enciklopedike, pritshmëritë, besimet dhe paragjykimet ideologjike të lexuesit. Përpara syve të tij shpaloset i tërë veprimi dramatik dhe konflikti që ka përfunduar me vrasje. Mbi ndërgjegjen e lexuesit vërtiten një varg pyetjesh. Provokimi dhe ironia autoriale duket se kërkon në ndërgjegjen e secilit lexues.

A kemi shpifur?! A kemi ndezur sherre?! A kemi bartur thashetheme?! A kemi mbjellur ligësi?! A kemi thënë të vërtetën atje ku duhet dhe kur duhet?! Në këtë mënyrë Serafin Fanko krijon një imazh të lexuesit të tij model.<sup>139</sup> Para se gjithash ai me këtë tekst, kërkon të parashikojë një lexues model të aftë për bashkëpunim në aktualizimin e tekstit. Le t’i rikthehemi interpretimit të lexuesit të kohës. “*I përqendraur tek krimi i individit, tek disekuilibri që arrin të ndodhë në shpirtin e Kristo Mehmet Markut, autori dhe regjisori nuk qëndron vetëm tek ai. Ndonëse e analizon tërë procesin psikologjik të mësimin të arsyes dhe të prirjes drejt krimin, duke vënë në dukje si rrallë herë tërë luftën e brendshme të heroit, ai shkon më tutje. Bisturia e tij shkon më thellë. Përse individit ynë priret kësisoj? Përse edhe njëherë kaq*

<sup>138</sup> Kallulli Adriatik, “*Drama rrënoqethëse e Serafin Fankos*”, Gazeta “*Republika*”, 23 nëntor 1997.

<sup>139</sup> Shih: “*Autori dhe lexuesi model janë dy imazhe që qartësohen në mënyrë të ndërsjellë vetëm gjatë leximit dhe në fund të tij: kështu që ndërtohen me njëri tjetrin. Besoj se një gjë e tillë është e vërtetë jo vetëm për veprat e narrativës, por për çdo tip teksti.*” Eko Umberto, *Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, Tiranë, 2007, f. 36.



*brumëmirë, si Kristo Mehmet Marku përlahen nga e keqja? Si depërton kjo e keqe në shpirtin e tyre? [...] Si në rrallë dramat tona, Serafin Fanko, mbjell shqetësime të mëdha tek spektatori”*.<sup>140</sup>

Me këtë konkluzion të fundit, është vështirë të biesh dakord. Duhet thënë se me tekstin “Quo vadis”, më shumë se sa shqetësimi dhe angazhimi social autorial, fillon të duket një tendencë e strategjisë aitoriale, për të ironizuar me lexuesin dhe imagjinaren e tij.

Përsëri shfaqen katër magjistrice diabolike, përfaqësuese dhe bartëse të ligësive të larmishme të kolektivitetit shqiptar, që e prishin ekuilibrin e njeriut brumëmirë. Nga një tjetër interpretim kritik citojmë: “*Në dramë e keqja dhe e mira janë ngërthyer në një strukturë të filozofisë biblike. Substanca dramatike nuk ndahet në njerëz të këqinj dhe njerëz të mirë, por në njerëz që kanë në konstitucionin e tyre të mirën dhe të keqen bashkë. Vetëm kështu një shoqëri njerëzore vetëpërsoset dhe vëëndahet në armiq dhe jo të tillë. Trajtimi si anonimat (njerëz pa emra që vijnë nga salla), katër personave që s’janë askushi, por që me vesin e posedimit (të jetës së tjetrit), bëhen gjithkushi, e ka lejuar autorin të kryejë një anatomi sociale dhe të merret me gjithë shoqërinë në një gjyq jo juridik, por moral, përballë virtytit të amshuar”*.<sup>141</sup>

Drama sipas interpretimeve të mësipërme duket si e një natyre sociale, fuqimisht e angazhuar brenda kontekstit social ku lindi, por ky lexim dhe interpretim i tekstit lë për të dëshiruar. “Quo vadis” si dramë mund të vazhdojë t’i flasë lexuesit. Më shumë se dramë ajo është një tragjedi shqiptare, brenda sistemit ballkanik. Në këtë tekst autori moderator bashkangjitet; teatrin antik, elementet biblike, ligjërimin social e moral, ligjërimet zakonore, filozofinë e lirisë. Teksti është një kolazh ligjërimor, është një lojë ligjërimore. Autori moderator nuk jep zgjidhje, nuk ka finale konflikti. E vetmja finale është situata ironike në të cilën lexuesi ndodhet. Me të drejtë artikulli i mësipërm përfundon: “*Quo vadis*”, një dramë që çdo ditë bën një ekskursion në ndërgjegjen tonë, prodhohet prej saj e njëherësh konsumohet nga ajo vetë në një absorbim të dhimbshëm”.<sup>142</sup>

Ndaj këtij absorbimi lexuesit të vëmendshëm, nuk mund t’i mungojë edhe doza e ironisë, që arti i Fankos propozon. S. Fanko si autor postmodern në dramën “Quo vadis” me ndërtekstorësi të fortë biblike, ndërton një skemë trenare dhe jo binare. Meritë e këtij teksti është se ai vë në dialog ironik diskutet shekullore. Në fill të mijëvjeçarit të ri, ndodhemi

<sup>140</sup> Kallulli Adriatik, “Drama rrënqethëse e Serafin Fankos”, Gazeta “Republika”, 23 nëntor 1997.

<sup>141</sup> Kabo Përparim, “Quo vadis” opinion për dramën e “Artistit të popullit” Serafin Fanko”, Gazeta “Zëri i popullit”, 16 nëntor 1997.

<sup>142</sup> Po aty.

në përballje me mundësinë e hyrjes në epokën e shtrembërimeve të përhershme.

#### BIBLIOGRAFI:

1. ANDONI, Ben: *"Serafin Fanko: Koha kurrë nuk mallkohet"*, Gazeta Shqiptare, 29 gusht 2001.
2. APPIGNANESI, Richard; SARDAR, Ziauddin; CURRY, Patrick: *Postmodernizmi*, Prishtinë, 2006, f. 67
3. BARTHES, Roland: *Aventura semiologjike*, Shtëpia Botuese "Dukagjini", Pejë, 2008, 437 f.
4. BIDA, Alda: *"Çmurosjë e Shkodrës në vendin e parë"*, Gazeta "Aleanca", 24 nëntor 1994.
5. BIDA, Alda: *"Quo vadis?", drama shqiptare"*, Gazeta "Koha jonë", 9 shkurt 1997.
6. BUSHATI, Xhahid: *"Drita e kujtimeve"*, (Antologji aktorese e teatrit "Migjeni"), Botim i Pen - Club "Orana", Shkodër, 1998.
7. DIBRA, Ridvan: *Një lojë me emrin postmodernizëm*, Shtëpia Botuese "Albas", Tiranë, 2007, 133 f.
8. DIBRA, Xhoi: *"Serafin Fanko, fëmija jetim që u bë një personalitet i shquar i artit dhe kulturës sonë kombëtare, Artist i popullit dhe simbol i vlerave humane"*, Revista "Pajtimi", Nr.2, Prill - qershor 2001.
9. EKO, Umberto: *Për letërsinë*, Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë, 2007, 318 f.
10. EKO, Umberto: *Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë, 2007, 183 f.
11. FANKO, Serafin: *"Çmurosjë"*, dramë, Teatri "Migjeni", Shkodër, 1994, 45 f.
12. FANKO, Serafin: *"Pse?"*, dramë, Teatri "Migjeni", Shkodër, 1991, 43 f.
13. FANKO, Serafin: *"Quo Vadis?"*, dramë, Teatri Kombëtar, Tiranë, 1996, 42 f.
14. FANKO, Serafin: *"Lindje në shtërngatë"*, dramë, Revista "Teatër", Botim i Shtëpisë Qendrore të Krijimtarisë Popullore, nr.1, Janar-shkurt, 1975, 58 f.
15. GJINI, Miho: *Teatri dhe koha*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1975, 240 f.
16. HAMZAI, Dhurata: *"Ku ishte ti Serafin Fanko"*, Gazeta "Tema", 5 maj 2006.
17. HASIMJA, Ermal: *"Drama e dramaturgjisë kombëtare"*, Gazeta "Drita", 24 nëntor 1996.
18. HAMITI, Sabri: *Tematologjia*, Botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2005, 248 f.
19. KABO, Përparim: *"Quo Vadis" Opinion për dramën e Artistit të Popullit Serafin Fanko*, Gazeta "Zëri i popullit", 16 nëntor 1997.
20. KALLULLI, Adriatik: *"Drama rrëngethëse e Serafin Fankos"*, Gazeta "Republika", 23 nëntor 1997.
21. KASAPI, Albana: *"Quo vadis" vazhdon provat*, Gazeta "Rilindja demokratike", 26 janar 1997.
22. KOLA, Arben: *"Monumentaliteti i planeve aktoriale"*, Gazeta "Rilindja demokratike", 23 nëntor 1994.
23. LIOTAR, Fransoa, Zhan: *Gjendja postmoderne raport mbi dijen*, Shtëpia Botuese "Dukagjini", Pejë, 1996, 158 f.
24. LLOTMAN, Jurij: *Kultura dhe bumi*, Shtëpia e librit dhe e komunikimit & Aleph, Tiranë, 2004, 230 f.
25. MATO, Jakup: *Poetika e dramaturgjisë dhe e mendimit estetik (1901-1939)*, Botim i Akademisë së Shqipërisë, 328 f.

26. MURATI, Violeta: *"Fanko, troket dyerve të dhimbjes në Pragë"*, Gazeta "Shekulli", 23 qershor 2001.
27. PAPAGJONI, Josif: *Teatri dhe aktori*, (shënime kritike), Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1980, 202 f.
28. PAPAGJONI, Josif: *Teatri i Shkodrës*, Shtëpia Botuese "Gjergj Fishta", Shkodër, 2009, 119 f.
29. PAPAGJONI, Josif: *Enciklopedi teatri dhe kinematografia shqiptare*, Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë, 2009, 559 f.
30. PAPAGJONI, Josif: *"Sprova të modernizmit në rrjedhat e fundme të dramës shqipe"*, në Fenomeni i Avanguardës në Letërsinë Shqiptare, Aktet e seminarit shkencor, botim i fondacionit SOROS, Tiranë, 2004, 288 f.
31. PAPAGJONI, Josif; MARKU, Arta: *"Çmurosjë: Vepër dramatike e karakterit dhe e dimensioneve filozofike"*, Gazeta "Koha jonë", 23 nëntor 1994.
32. PAPAGJONI, Josif: *"Ankthi i njeriut shqiptar në dikotomitë luftë-paqe, besë-pabesë"*, Revista "Pajtimi", Nr.2, Prill-qershor 2001.
33. PODGORICA, Fadil: *Fjalor etnofolklorik*, Shtëpia Botuese "Camaj-Pipa", Shkodër, 2004, 597 f.
34. PRENÇI, Mexhit: *Drama dhe spektakli i ndaluar (Kritika 2)*, Shtëpia Botuese "OMBRA GVG", Tiranë, 2010, 305 f.
35. PRENDI, Arben: *"Defigurimi i mitit"*, Gazeta "Rilindja", 16 nëntor 1994.
36. RADI, Ferdinand: *"Quo vadis?" në Teatrin Kombëtar*, Gazeta "Albania", 20 shkurt 1997.
37. RAMADANI, Sali: *"Pse?" në Kosovë*, Gazeta "Art-Kulturë", 4 prill 2000.
38. SKANJETI, Andrea: *100 vjet teatër në Shkodër (1879-1979)*, "Kad", Tiranë, 2002, 448 f.
39. SLATINA, Flori: *Prirje të sotme të teatrit*, (Panoramë mbi teatrin shqiptar 1991-2001), Shtëpia Botuese "Mokra", Tiranë, 2001, 400 f.
40. STANI, Lazër: *"Keqinterpretimi i mitit"*, Gazeta "Republika", 27 nëntor 1994.
41. STEFANOVA, Kalina: *Easter European theater after the iron curtain*, Overseas Publishers Association, 2000.
42. SHLLAKU, Lec: *Maska shkodrane... kur lindej teatri*, Shtëpia Botuese "Camaj-Pipa", Shkodër, 2002, 307 f.

## **Serafin Fanko, the phenomenon of the contemporary Albanian drama**

### **SUMMARY**

The Albanian drama, in diachronic and synchrony, is written without interruption. Serafin Fanko had entered in the theatre work as an author since the 70-s. In 1991 he returned as a dramaturge with a new thinking. Sixty years after the publication of the novel "Pse?" written by Stereo Spasse, he restored this new text size. In the drama entitled "Çmurosjë" the author uses irony and tease with the myth. "Trokitje nw dyert e dhimbjes" is an inter- textual influence of B. Breht's plays. "Quo vadis", as a literary text with biblical

inter- textual intensity, has the merit that he makes ironic dialogue of century discourses.

Alketa BEKTESHI

## PROZA KUTELIANE MIDIS TRADITËS SONË KRIJUESE POPULLORE DHE MODERNITETIT

Krijimtaria e Kutelit në gjininë e prozës mbart dhe shenjëzon vlera të rëndësishme për letërsinë në përgjithësi dhe veçanërisht për futjen e saj në shtratin e qendrueshëm të modernitetit. Shenja të mirëfillta ndihmojnë për të argumentuar rolin e krijimtarisë së Kutelit në fushën e prozës, duken qartë në disa nga tiparet që ajo përvijon apo në trajta të modernitetit në prozë, ku dhe shfaqen dy karakteristika themelore.

Së pari, në lëvrimit prej autorit të të gjithë llojeve dhe nënlojeve letrare të prozës, ku përfshihen tregimi, novela dhe romani, madje edhe duke zgjeruar spektrin e nënlojeve letrare. Tipe të reja letrare, siç edhe janë vënë re nga historia e letërsisë dhe kritika letrare janë rrëfenja apo tregonjëza, rrëfimet apo përrallat. Larmia kaq e gjerë e lëvrimit të prozës tek Kuteli nuk është një faktor rastësor. Ky realitet letrar, i lëvrimit të shtrirë zhanëror, ka të bëjë me parapëlqimin e letërsisë së shkruar për të zbuluar vatra të pranishme të shprehësisë së prozës popullore në gjuhën shqipe.

Së dyti, krijimin e vetëdijes (ndërgjegjes) letrare që letërsia është krijim i veçantë estetik pa marrë parasysh qëllimet.<sup>143</sup>

Kuteli erdhi si autor i prozës moderne tregimtare shqiptare me ndërtime të ndërliqshme strukturore dhe me thellime psikologjike. Veprat letrare të Kutelit bazohen në trajtimin e letërsisë si art me veçantitë e veta të ndryshme nga krijimet e tjera, për të dhënë në plan të parë cilësitë estetike të veprës. Në realizimin e një vepre origjinale dhe befasuese Kuteli përkon edhe me fillesat e shkrimit modern, por që e bëjnë Kutelin të mbetet një kulm i papërsëritshëm në letrat shqipe, duke spikatur kështu si një prozë me përvojë gojore dhe shkrimore, që të mrekullon si estetikë.

Vepra letrare në prozë përmbledh në vetvete frymën romantike, ndërkohë që jep dukshëm tiparet e realizmit kritik. Prania e realitetit letrar të dyjzuar dhe shumëfishuar, në çdo prozë të shkrimtarit ngjizur si mbraujtje esenciale të reales dhe ireales, botës së gjallë me të përtejmen, pakohësisë me matanëhapësinoren, pra një rruzull universal përbën portën

<sup>143</sup> S.Hamiti, "Letërsia moderne shqiptare", Tiranë, 2000, f. 14.

hyrëse të kësaj përvoje krijimtarie të vetëdijshme dhe përplot vetëjakësi shprehjeje letrare.

Qysh në hyrje të librit “Kuteli- prozatori- poeti- kritiku”, ndërsa përveçon të parin, duke patur parasysh sidomos dy krijimet “Vjeshta e Xheladin Beut” dhe “E madhe është gjëma e mëkatit”- studiuesi Bashota, shkruan – “... *Këtu shkëlqen mjeshtëria e artit të tij në tregimtari. Është prozë që shenjon fillet e modernitetit letrar me një rrëfim magjepsës dhe stil brilant*”, si emblemë e shqyrtimit të thelluar të veprës letrare të shkrimtarit.<sup>144</sup>

Kënaqësia e pashtershme, që të mëkojnë tekstet në prozën e Kutelit lidhet natyrshëm me formanten letrare specifike të mbushur me larmi, vibracione dhe vagullima. Kuteli na fut në prozën e tij me endje në një labirinth mistik, plot dritëhije, fëshfërima vanitjesh dhe zhgëndrash, që kanë gjithnjë një shtegdalje. Tregimtaria e ndodhive të pangjara, që rëndomtë ia presin rrugën njeriut dhe përshkojnë kryqëzimet e qenies, është shtrati thelbësor i prozës së shkrimtarit. Rrëfimi përrallor dhe i mbinatyrshëm i një realiteti të preکشëm dhe krejt të vrazhdë që cilido takon gjatë përditshmërisë. Formulimi i hedhur nga Plasari, se “*Sistemi i invarianteve na shërben, në fund të fundit, për ta kuptuar letërsinë si një gjithanshmëri, realiteti i së cilës njëherësh do rrokur dhe do shpaluar*” e zgjeron ndjeshëm sharmin e hemisferave të përjetimit të prozës kuteliane. Në prozën e shkrimtarit, çuditërisht variantet e para mbartin shenja autentike dhe mbishtresime të papritura letrare.<sup>145</sup>

Tek Kuteli vërejmë thyerje fabulash me valëzime fantastike, që njëherësh edhe ta përafrojnë edhe ta shkërrmoqin pluhurnajën rrëzëllitëse përrallore. Kushdo që ka shkruar për krijimtarinë letrare të Dhimitër Paskos padyshim nuk mund të ketë lënë pa përmendur lidhjen e saj të ngushtë me folklorin (traditën tonë krijuese kulturore).

Vepra e Kutelit mbart vlera të individualitetit krijues, të materializuara në stilin e tij të veçantë. Para së gjithash këtu spikasin rrëfenjat, pamfletet dhe tregimet, plot me motive dhe figuracion përrallor.<sup>146</sup>

Por përvoja e historisë së letërsisë botërore dëshmon se edhe në vende të tjera, në epoka të caktuara, ka qenë nënvlerësuar estetikisht një krijimtari pak a shumë e tillë, që ka pasur si burim kulturën popullore duke u përjashtuar nga format “e larta” të letërsisë serioze, të kultivuar, si për

<sup>144</sup> S.Bashota, “Kuteli-prozatori-kritiku”, Tiranë, 1998, f. 9.

<sup>145</sup> A.Plasari, “Letërsia dhe mure”, Tiranë, 1993, Enti botues “Zëri i Rinisë”, f. 20.

<sup>146</sup> A.Uçi, “Çështje të folklorit shqiptar”, *Krijimtaria letrare e M. Kutelit dhe lidhjet e saj me folklorin*, f. 178.

shembull në rastet e krijimtarisë së mrekullueshme të Bokaçios, Servantesit, Gogolit etj. Ndaj ky fenomen nuk ka përjashtuar edhe ato raste kur në rrëfenjat e Kutelit, është çmuar vetëm një “letërsi e rikrijuar” nga folklori duke mos vënë re sa i madh ishte kontributi krijues e rikrijues i Kutelit ndaj gjithë kësaj pasurie vlerash, që ai i huazoi nga thesaret e folklorit. Kuteli nuk ishte shkrimtar folklorizant; ai i njihte mirë kufijtë që e ndajnë letërsinë e kultivuar individuale nga krijimtaria kolektive folklorike, prandaj diti t’i përshtatet si njëres, folklorit, duke përpunuar përrallat, baladat dhe eposet popullore, ashtu dhe tjetres, domethënë letërsisë së kultivuar, brenda së cilës krijoi një stil krejtësisht të pavarur e të panjohur më parë në letërsinë shqiptare.<sup>147</sup>

Në të dy rastet ai ka qenë jo vetëm njohës i vetëdijshëm i veçorive të tyre, por ka treguar edhe shije të holla për të mos ia cënuar vlerat as njëres, as tjetres. S’ ka dyshim se Kuteli është dhe do të mbetet një nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë kombëtare për fëmijë të cilën nuk e shihte si “shkallë të ulët” të letërsisë artistike në përgjithësi, por e quante pjesë të pandarë të saj, madje nga më të vështirat për t’u lëvruar. Emri i tij për ndihmesën që dha në këtë fushë do të radhitet me po të njëjtën peshë me Andersenin, vëllezërit Grim etj., në letërsitë e vendeve përkatëse. Rrëfenjat e Kutelit përbëjnë një lloj të veçantë, që nuk i ka munguar, as letërsisë së vendeve të tjera. Në këtë kuptim ato mund të vlerësohen drejt, nëse i lidhim me traditat e letërsisë botërore (Bokaçio, Rablë, Servantes, Gogol, etj.), të cilat i përkasin periudhës kalimtare nga Mesjeta drejt kohëve të reja, letërsisë së Renësansës Evropiane, etj. Duke u përfshirë në këtë traditë proza kuteliane ndjek letërsinë e Rilindjes sonë kombëtare, idealin e saj social-estetik dhe sidomos lidhjen me folklorin, me kulturën popullore. Ndryshimi është se në të spikasin si shprehje e prirje e re, fryma antimesjetare dhe së dyti, mbështetja në folklor duke shfrytëzuar prej tij, ndryshe nga të tjerët, elementë të kulturës popullore.

Veçoria e parë e lidhjes së Kutelit me folklorin, me kulturën popullore, qëndron në faktin se idetë estetike dhe tematika e subjekteve të prozës së tij përkojnë kryesisht me atë sistem idesh e me atë tematikë që bart folklori. S’ka shkrimtar tjetër shqiptar që ta ketë ngushtuar qerthullin tematik të krijimtarisë së vet në atë të folklorit aq sa M. Kuteli. Sa herë që ky shkrimtar largohej nga kjo rrugë, domethënë sa herë i drejtohej një tematike tjetër ekstrapopullore, stili e krijimtaria e tij zbehej. Ky konstatim provohet jo vetëm në krijime të tilla si: “Tregime të moçme shqiptare” dhe “Përralla”, që mbështeten tërësisht në lëndë folklorike të huazuara nga

---

<sup>147</sup> Po aty.

poezia ose proza popullore dhe në të cilat spikat aftësia e tij për të krijuar përrallën letrare shqiptare.

Shkrimtari në këto krijime respekton lëndën origjinale të folklorit, motivet e subjektet, situatat e veprimet, personazhet, stilin e rrëfimit oral folklorik, ndonëse i lartëson artistikisht, duke i pastruar nga elementët e rastësishëm, inkoherenat, alegorizmat etj., që i mbartin me vete variantet e larmishme të krijmtarisë folklorike. Studiuesi Plasari pohon: *“Në rrafshin narratologjik, shtënia në punë e këtyre elementeve gojshmërie lidhet me përpjekjet e autorëve për t’iu reshtur mënyrës tradicionale të të treguarit asaj duke qëndruar përanash, përjashta veprës”*.<sup>148</sup>

Lënda folklorike përcakton edhe përmbajtjen e një grupi tjetër krijimesh, siç janë “Netë me përralla në fshatin e qepëve”, “Xinxifilloja” etj. Në këto krijime M. Kuteli bën një shartim origjinal, estetikisht produktiv të lëndës së mirëfilltë folklorike (të përrallave, që rrëfejnë teto Ngjela dhe e bija, Fija, e të stilizuara nga shkrimtar dhe të lëndës me tematikë jetësore të kohës, me tematikë aktuale ekstrapolklorike. Struktura tërësore e “Netëve me përralla ...” nuk mund të qëndronte si vepër e pavarur; në të lënda përrallore mund të qëndrojnë edhe e shkëputur nga ato ndërhyrje, intermexo, biseda e dialogje, që ndërpresin ose ndërmjetësojnë rrjedhën e rrëfimeve dhe të përrallave që sjellin jehonën e atmosferës shoqërore e psikologjike të jetës shqiptare në vitet 30.

Baza kryesore e ideve estetike e motiveve dhe e subjekteve qëndron përsëri në krijimtarinë folklorike. Ky grupim krijimesh, sigurisht, dallohet sepse ka të gjithë tiparet, veçoritë dhe epërsitë estetike të krijimtarisë letrare të kultivuar. Ato dëshmojnë, nga njëra anë, për origjinalitetin e talentin e madh të M. Kutelit për të krijuar vlera të shquara artistike në sferën e letërsisë së kultivuar, pavarësisht nga burimet që merrte frymëzimin. Nga ana tjetër, ato tregojnë se ky autor ishte i aftë që edhe lëndën folklorike ta përpunojë, ta transformojë dhe ta lartësojë sipas ligjësive të artit të kultivuar profesionist, ta nxjerrë përtej kufijve të ngushtë të “letërsisë së rikrijuar”, t’u japë atë jetë që ka çdo krijim i individualiteteve të talentuara e origjinale.

Tema mbizotëruese e kësaj krijimtarie të Kutelit është ekzistenca në kapërcyellin e botës së vjetër në përfundim dhe e pasigurisë nga paralajmërimet e agimit të një bote të re, të panjohur e frikësuese, që po trondiste themelet deri atëherë të patundur të jetës patriarkale. Motivët e subjektet e tregimeve e të rrëfenjave përkojnë në thelbin e tyre me motivet

<sup>148</sup> A.Plasari, “Letërsia dhe mure”, Tiranë, 1993, Enti botues “Zëri i Rinisë”, f. 2.



e subjektet e folklorit. Tregimet e rrëfenjat e Kutelit prekin temën e plagëve sociale të periudhës së fundit të feudalizmit, të jetës patriarkale, temën e kurbetit dhe mallit për vendlindjen, temën e dashurisë së lumtur a fatkeqe, temën e jetës së njeriut të punës dhe psikologjisë së tij, temën e njeriut në momentet dhe situatat eksistenciale.<sup>149</sup>

Fati tragjik i njeriut dhe gëzimet e jetës, situatat dramatike, luftërat e përpjekjet e popullit për liri, dinjitet, për nder e drejtësi, jeta e njeriut të fshatit me mentalitetet, bestytnitë, paragjykimet e tij, me kërkesat materiale, trupore e shpirtërore, morale, në raportet e tij me klasat e regjime sunduese, me të huajt, me të kaluarën historike dhe me shpresat për të ardhmen: të tilla ishin parapëlqimet tematike të Kutelit.<sup>150</sup>

Shumica e tregimeve dhe rrëfenjave të Kutelit ka një plan më konkret: jo vetëm motive, subjekte e ide estetike të huazuara nga folklori, nga kultura jonë popullore, por edhe këndi i vështrimit, interpretimit dhe vlerësimit të këtij materiali jetësor përkon me atë botëkuptim e botëpërjetim që përshkon masën anonime krijuese të folklorit dhe kulturës popullore, me sinqeritetin dhe naivitetin e saj, me ndjenjën e drejtësisë dhe solidaritetit dhe ndershmërisë popullore. Jeta e shthurur e sundimtarëve me zakone mesjetare, që vepronin arbitrarisht, të pabesë e të poshtër, të pangopur e të pacipë, të egër e çnjerëzorë, por pa të ardhme, është përqeshur e stigmatizuar në rrëfimet e anekdotat popullore, po ashtu edhe në krijimet letrare të Kutelit. Për jetën e kaçakëve që nuk duronin zullumet e pushtetit e që parapëlqenin të bridhnin e luftonin për liri maleve, duke marrë në mbrojtje vegjelinë e të drejtat e saj; për vuajtjet e mërgimit e të nizamllëkut, që përcilleshin me tragjedi, që e zbraznin vendin nga popullsia më vitale, nga rinia që prishnin zakonet e traditat popullore, që fusnin zakone të reja sëbashku me tragjedi e drama, që përcillnin thyerjen e mënyrës së mëparshme tradicionale të jetës (“Xha Brahua i Shkumbanës”, “Qetësi përpara fërtyme” etj.), për zakonet e mbrapshta, të egra e barbare si gjakmarrja (“Gjonomadhe e Gjatollinj”), për gjithë aspektet e jetës fshatare, me të mirat e të këqiat e saj, me mundimet e gëzimet e trupit e të shpirtit (“Natë kallozheku”), për festat e ritet popullore (“Rusa-Papusa”, “Kryengritje për lugat”, “Fshati im e pi rakinë”), për përfytyrimet morale e mendësitë e vegjëlisë (“Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”), etj.

<sup>149</sup> S.Hamiti: “Letërsia moderne shqiptare“, Tregimet e Kutelit, Tiranë, 2000, f. 126.

<sup>150</sup> N. Jorgaqi, *Parathënia e veprës Mitrush Kuteli* -“ Vepra 1”- Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 22.

Në këtë rrafsh, Mitrush Kuteli merrte nga folklori vetëm motivin e përgjithshëm tematik, idenë, subjektin abstrakt, që i ndizte shkrimtarit frymëzimin fillestar. Pastaj, përmes imagjinatës, forcës krijuese, autori i konkretizonte, individualizonte dhe pasuronte subjektet, motivet ose idetë estetike, folklorike sipas ligjësive e rregullave të letërsisë së shkruarar.

*"Modusi përfytyror i rrëfenjave kuteliane e zotëron fuqinë për të prodhuar ngjarjen, - shprehet Bashota - personazhin, veprimin, kohën e saktësuar në një intrigë".*<sup>151</sup>

Veçoria e dytë e lidhjes së krijimtarisë letrare të Kutelit me folklorin dhe kulturën popullore në përgjithësi, qëndron në aftësinë e tij për të ndërsuazuar materialin jetësor folklorik brenda përfytyrimeve "të kohës së mbyllur" që është karakteristike për zhanre të tilla siç janë: rrëfimet mitike, përrallat fantastike dhe epika legjendare. Sekretin e rrëfimit kutelian është nga ato në të cilat elementët e gojëtarisë janë të pranishme edhe në letërsinë e shkruar. Në rrafshin narratologjik, shtënia në punë e këtyre elementëve të gojëtarisë lidhet me përpjekjet e autorit për të reshtur mënyrën tradicionale të të treguarit, asaj duke i qëndruar për anash, përjashta veprës.

Duke e zmadhuar qëllimisht rolin e tregimtarit, siç shprehet studiuesi Plasari, ky vetënjakësim synon ta zhdukë edhe iluzionin më të vogël se ajo ç' ka ndodh qenkësh "jetë" dhe "jo art"<sup>152</sup>. Shembull, "Gjonomadhë e Gjatollinj":

" - Pse s'janë shkruar në kartë këto çudira ?- do hidhet të më pyesë donjë shkollor nga ata të rinjtë që gjithë në karta e kanë mendjen."<sup>153</sup>

- E kush t'i shkruajë, o djalosh, kur n'atë kohë bota nuk linde me divit në bres e me kalem në vesh. Se po të lindej kështu, sot do të kishim patur një kartë të madhe sa fush'e Domuzdovës të mbushur vetëm me trimërinë e tyre ...".

Në këtë rast tregimtari e heq veten si rrëfimtari, si subjekti që rrëfen përrallën ose këndon rapsodinë. Në krijimtarinë letrare duket se me Kutelin kemi të bëjmë me një shkrimtar formimi i të cilit paraqitet, kryepari, mbi një bazë krijimtarie gojore.<sup>154</sup>

Kuteli i ndërtonte me vetëdije tregimet e rrëfenjat sipas principit dhe formulës së fillimit dhe të mbylljes së përrallave ("Qe dhe s'qe", "Ishte dhe nuk ishte", "as përrallë s'ju rrëfeva por desha dhe ju gënjëva", "Atje

<sup>151</sup> S.Bashota, "Kuteli-prozatori-kritiku, Tiranë, 1998, f. 41.

<sup>152</sup> R. Wellek- A.Warren, "Theory of Literature", New York, 1969, (përkth. shqip: "Teoria e letërsisë", Tiranë, 1994, f. 211-212.

<sup>153</sup> M. Kuteli, "Gjonomadhë e Gjatollinj", Vepra 1, Tiranë, 1990, f. 98.

<sup>154</sup> A.Plasari: "Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve", Tiranë, 1995. f 31.

qeshë e këtu arçë, një të vërtetë se thashë"), formula që theksojnë karakterin konvencionalo-artistik të përmbajtjes së tyre.<sup>155</sup> Ndryshe nga përrallat, që i përcjellin këto formula në fillim dhe në mbyllje, domethënë jashtë subjektit të mirëfilltë, si kornizë të tij, Kuteli përdor kuptimin e këtij "çelësi" të informacionit artistik të tregimeve dhe përrallave popullore, duke u shkrirë në gjithë strukturën e brendshme e të subjekteve sipas natyrës specifike të letërsisë së kultivuar. Këtë koncept të "Kohës së mbyllur përrallore", e kanë edhe të gjithë krijimet e tjera të Mitrush Kutelit.<sup>156</sup>

Edhe krijimet e fëmijërisë së shkrimtarit janë përrallëzuar, janë ndërsuazuar në strukturën e një kohe të mbyllur. Kjo duket se ka shtyrë Kutelin në parapëlqimin e një tematike legjendare, mitologjike e sidomos përrallore. Kuteli parapëlqente t'i ndërtonte tregimet në trajtën e kujtimeve për të kaluarën. Në përgjithësi, tregimet e tij fillojnë me mjetet e stilizuara të përrallave: "*Na ishte një herë një i mirë me mall e gjë shumë e na bënte dasmën e të birit*" ("Natë muaji maj"); "*Asaj kohe, kur flisnin dallandyshtet me kocominjtë, kur të bardhet rrembenin njerëz, kur kuajt kishin krahë e fluturonin si shpesëri...*" ("Babalja"); "*Kështu ishte asohere; muaji lypsej të hynte dhe të dilte me një gjë të shënuar... maji hynte me Ereminë, delte me Rusicat*", ("Rusa-Papusa") etj. Shkrimtari ynë përrallëzimin e materialit jetësor e realizon edhe duke përfshirë në të ngjarje të jashtëzakonshme, befasuese, të çuditshme, e të pabesueshme, të cilat ndodhin vetëm në një botë dhe kohë mitiko-përrallore. Duke aktivizuar këtë material folklorik shkrimtari vë theksin në burimet e thella morale të qëndresës së kombit. Nëpërmjet mënyrës së shfrytëzimit të motiveve të eposit heroik që u mbetet besnike subjekteve tradicionale dhe mënyrës tjetër, kur subjektet folklorike shërbejnë vetëm si pikënisje për të ndërtuar një ngrehinë të re artistike, qëndron një mënyrë tjetër e tretë, ajo e integritit të motiveve të ndryshme të këngëve të eposit në subjekte që s' kanë lidhje me kontekstin social-historik të ciklit, të cilit i përkasin ato motive. Ky është një proces i vazhdueshëm qarkullimi folklorik në arteriet e prozës sonë. Evokimi i kohërave të legjendave për Gjergj Elez Alinë, hedhin dritë në traditën e lashtë të popullit shqiptar, duke qenë në funksion të idesë së gjallërisë së tij historike. Madje vepra si "Tregime të moçme shqiptare" nuk janë tjetër pos ritregime, apo ristrukturime në prozë të këngëve të vjetra e të baladave shqiptare nga të gjitha anët e truallit shqiptar.<sup>157</sup>

<sup>155</sup> A.Uçi, "Mitologjia, folklori, letërsia", Tiranë, 1982, f. 171.

<sup>156</sup> Po aty, f. 186.

<sup>157</sup> S.Hamiti: "Letërsia moderne shqiptare", Tregime e rrëfenja", Tiranë, 2000, f. 126.

Një ndër veçoritë karakteristike të personazheve të Kutelit është se ato nuk kanë mendim dhe gjykim individual për ngjarje të ndyshme, por reagojnë me formulat e gatshme të kulturës popullore. Këto shprehje shkrimtari i ka huazuar nga sfera e folklorit. Sharjet, mallkimet dhe lutjet përbëjnë një pasuri të madhe shprehjesh ekspresive të kulturës popullore që kanë jo vetëm vlerë gjuhësore por përcjellin në mënyre të sintetizuar edhe botëkuptime dhe estetike.<sup>158</sup> Në rrafshin botëkuptimor ato shfaqen dhe funksionojnë sa herë njeriu ndjen veten të pafuqishëm ndaj dukurive negative dhe armiqësore të jetës. Ato luajnë një rol psikologjikisht kompesues dhe nuk e lënë njeriun të bjerë në dëshpërim. Të lindura si bestytini dhe rite fetare, ato fituan një lloj pavarësie në kulturën popullore dhe kanë funksionuar si shprehje të lirisë së mendimit dhe të protestës sociale. Tek “Vjeshta e Xheladin Beut”, përballë arbitraritetit dhe fuqisë së pakufizuar të Beut, njeriut të thjeshtë që e pësonte prej tij, si mbetej veçse ta shante, mallkonte, të nxirrte dufin, duke lëshuar një varg fjalësh të rënda, siç thotë autori, “nga ato që si ngre kandari”. Duke i zgjedhur me shije këto shprehje popullore, shkrimtari ua përshtat rrethanave dhe situatave, duke i bërë që ato të fitojnë një kuptim dhe vlerë të mirëfilltë botëkuptimore dhe estetike dhe e plotësojnë në një drejtim të rëndësishëm stilin e mëvetshëm kutelian.

Një vend të rëndësishëm në strukturën e tregimeve kuteliane zënë përshëndetjet, urimet, dollitë, betimet, duke përbërë dhe një ndër elementet më të pasur të kulturës popullore. Shkrimtari përdori si lëndë konstruktive të strukturës së tregimeve të tij këtë pasuri të madhe të shprehjeve ekspresive të këtij lloji të kulturës popullore, të cilat i aktualizoi në stilin grotesk brenda veçorive të letërsisë së kultivuar. Një varg shprehjesh të këtij tipi që i ndeshim te Kuteli janë përshembull: E hëngsh gëzuar! Udhë e mbarë e u pjekshim shëndoshë! Rrofshi e qofshi! U bëfsh burrë trim! Një tjetër aspekt i lidhjeve të ngushta të krijimtarisë letrare të Kutelit me folklorin, kulturën popullore është shfrytëzimi prej tij i potencialit estetik i gjuhës popullore i papërdorur deri atëherë në prozën e letërsisë së shkruar. Aktivizimi i gjuhës në krijimtarinë artistike kryhet me funksionin estetik, do të thotë shërben si lëndë, mjet material për të ndërtuar një “botë të re estetike”, që mishëron në vetvete, përvetësimin, njohjen estetike të realitetit të jetës. Kjo kuptohet më mirë po të kemi parasysh se në letërsinë artistike gjuha plotëson atë rol që luajnë ngjyrat në pikturë, materialet e ndërtimit në arkitekturë, tingujt në muzikë, gjestet dhe zëri në lojën e aktorit etj.

<sup>158</sup> A. Uçi, “Çështje të folklorit shqiptar”, *Krijimtaria letrare e Mitrush Kutelit dhe lidhjet e saj me folklorin*, Tiranë, 1996, f. 193.

Zotërimi i potencialit estetik të gjuhës është pjesë e pandarë e talentit artistik kutelian, duke u krahasuar nga kritika me Naimin, Çajupin, Fishtën, Poradecin, etj. Në këtë mënyrë veprat më të mira të Mitrush Kutelit kanë mundur të hyjnë dhe të zënë vendin e merituar në çdo antologji të letërsisë shqipe, duke e cilësuar atë si një shkollë të vërtetë të gjuhës artistike. Këto vlera nuk zbehen edhe pse në krijimtarinë e Kutelit hasen shpeshherë dialektalizma apo leksik të të folmeve krahinore. Ato nuk ulin aspak vlerën stilistike gjuhësore të krijimtarisë letrare të Kutelit. Ndërkohë Kuteli nuk anashkalon hollësitë e detajet e realitetit si dhe reagimin emocional impresionues. Themeli i përhershëm ekspresiv i Kutelit i ndërtuar mbi këto fillesa vjen jo vetëm nga të menduarit poetik figurativ të tij, por edhe nga përjetimi i gjithçkaje përmes ndjenjave dhe sferës emocionale të ndërgjegjes artistike të shkrimtarit. Me një lartësi të përkryer e forcë poetike ekspresive ndjesore, prozatori e paraqet jetën duke ju referuar folklorit, duke dhënë jetën fshatarake me gëzimet dhe hidhërimet e saj. Të gjitha këto Kuteli i mbështjell me petkun e mallit dhe nostalgjisë të mërgimtarit për këtë tokë dhe njerëzit që jetojnë mbi të. Ndërthurja e fillesës rrëfyese, deskriptive dhe impresionuese e kombinuar natyrshëm edhe me fillesën dialoguese, e bën veprën e Kutelit të fitojë njëherësh tipare novatore të prozës moderne. Duke i renditur me finesë, Kuteli, vendin e përshkrimt të ngjarjeve dhe situatave intriguese ia lë fillesës dialoguese, e cila përcjell për lexuesin jo vetëm dramacitet, por edhe thellësi mendimi poetik. Sipas shumë kritikëve ky gërshetim dhe roli i veçantë i dialogut në tregimin kutelian është vlerësuar i ngjashëm me dialogun Hemingueijan, proza e të cilit përbën një ndër krijimtaritë më përfaqësuese të letërsisë moderne. Thellësia dhe dimensionimi shkrimor kutelian vetëm në semantikën estetike si realitet letrar artistik, para së gjithash, qëndron te proza e mirëfilltë dhe tejet e larmishme. Proza autoriale ku edhe shfaqet i plotë mjeshtri i fjalës shqipe, qoftë si magji e rrëfimit, qoftë si trillimtari më finok e padyshim fjalëtari më i sprovuar i vlerave dhe shprehësisë magjepsle letrare është një përvojë shkrimore befasuese e kreativitetit në universin mitiko-përrallor shqiptar.

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. Mitrush Kuteli, "Vepra 1", SH.B. Naim Frashëri, Tiranë, 1990.
2. Mitrush Kuteli, "Vepra 2", SH.B. Naim Frashëri, Tiranë, 1990.
3. Mitrush Kuteli, "E madhe është gjëma e mëkatit", Tiranë, 1998.
4. Mitrush Kuteli, "Ago Jakupi e të tjera rrëfime", Tiranë, 1943.
5. Mitrush Kuteli, "Tregime të moçme shqiptare"- SH.B. Naim Frashëri, Tiranë, 1965.
6. M. Kuteli, "Gjonomadhe e Gjatollinj", Vepra 1, Tiranë, 1990.

7. S. Hamiti, "Letërsia moderne shqiptare", Tiranë, 2000.
8. S. Bashota, "Kuteli-prozatori-kritiku", Tiranë, 1998.
9. S. Bashota, "Netë shqiptare të Mitrush Kutelit", Filologji, Prishtinë, nr.5, 1996.
10. A. Plasari, "Letërsia dhe mure", Enti botues "Zëri i Rinisë", Tiranë, 1993.
11. A. Plasari: "Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve", Tiranë, 1995.
12. A. Uçi, "Mitologjia, folklori, letërsia", Tiranë, 1982.
13. A. Uçi, "Çështje të folklorit shqiptar", Tiranë, 1996.
14. N. Jorgaqi, Parathënia e veprës Mitrush Kuteli -"Vepra 1"- Naim Frashëri, Tiranë, 1990.
15. Adem Jakllari, "Historia e mendimit etnologjik dhe mitologjik", SHBLU, Tiranë, 2003.
16. R. Wellek- A. Warrenr, "Theory of Literature", New York, 1969, (përkth. Shqip: "Teoria e letërsisë", Tiranë, 1994.
17. Behar Gjoka, "Proza e Kutelit", botimet Ideart, Tiranë, 2004.
18. Rrustem Berisha, "Subjektet mitologjike në rrëfimet e Mitrush Kutelit", Fjala 9-10, Prishtinë, 1995.
19. Martin Camaj, "Kuteli i pazbuluem", Albania, 4 maj 2000, "Jeta e re", Prishtinë, nr.5, 1995.

### **Kutelian prose between our popular creative tradition and modernity**

#### ***SUMMARY***

Kuteli's creativity in the prose carries significant values for literature in general and especially for introducing it to the stable ground of modernity. Genuine sings that help to prove the role of Kuteli's creativity in the field of prose fiction, are clearly visible in some of the features that it (his creativity) outlines, or in the form of modernity in prose, where he displayed two basic features.

First, in cultivating from the author of all literary kinds and sub kinds of prose, including story, short story and novel and even expanding the spectrum of literary hybrids.

Secondly, creating awareness that literature is the literary creation of special aesthetic, regardless of intentions. Kuteli appeared in albanian narrative modern prose, as an author of complex structural construction and psychological deepening. Kuteli's work is based on literature, as art that unlike other creations provide the aesthetic qualities of the work first. Kuteli's original and starling work coincides with the strands of modern writing, making him remain unique in Albanian letters and being so conspiciores as an experienced oral prose and letters.



**Lisandri KOLA**

**DANTE ALIGHIERI PËRMES PËRKTHIMIT TË  
PASHKO GJEÇIT,  
TE KËNGA E PARË E FERRIT: PËRQASJE.  
GJURMIME NË TEKSTIN DANTESK**

Në traditën tonë, nuk është e para herë që varianti përkthimor i *Komedisë Hyjnore* nga Pashko Gjeçi është bërë objekt trajtuese. Puna e Gjeçit është vlerësuar mjaft, mbasi mjeshhtëria e tij ka arritur të sjellë shumë pranë Danten, duke ruajtur strukturën e vargut të veprës, semantikën, ritmin, gjuhën e punuar, leksikun e pasur, përjetimin e duhur, etj. Por, meqenëse përkthimi është “një kalim nga një kulturë në tjetrën”<sup>159</sup> dhe jo një kalim thjesht gjuhësor, por edhe një kalim nga një enciklopedi në tjetrën, shtoi kësaj edhe pohimin tjetër “përkthyesi përkthen gjithnjë *tekste*, pra do të thotë kumtime që shfaqen në një kontekst gjuhësor apo shqiptohen në një situatë specifike”<sup>160</sup>, – ku në vetvete përkthimi si proces, është mjaft delikat dhe i mundimshëm, natyrisht me humbje prej tekstit burimor, sidomos nëse kemi të bëjmë me një tekst që na ndajnë shekuj në mes<sup>161</sup>, për vetë faktin se semantika e fjalës së tekstit të asohershëm nuk gëzon të njëjtën fushë semantike me fjalën bashkëkohore që përkthyesi mendon se i gjegjet, – po paraqesim disa vëzhgime të këngës së parë të *Ferrit*, duke e krahasuar me përkthimin e Gjeçit. Por përveç kësaj, do të krahasohen një pjesë e shpjegimeve të dhëna nga Gjeçi dhe komenteve të dantologëve italianë, me qëllim që të dallohen e këqyren përkimet mes interpretimeve të këngës së parë. Çka do të thotë se në cilësinë e një përjasjeje, disa prej lemave-simbol të tekstit të Dantes do të përdhën së trajtuari.

<sup>159</sup> Shih Eco, Umberto në: *Të thuash gati të njëjtën gjë*. Përkth.: Mariana Ymeri; Alketa Ylli, Dituria, Tiranë, 2006, f. 171.

<sup>160</sup> Po aty, f. 47.

<sup>161</sup> Lidhur me këtë çështje dhe në mënyrë që të sqarohet problemi, mund t’i drejtoheni rishtas veprës së sipërcituar në footnote, f. 172, ku Eco flet për kuptimet e kundërta të fushës leksikore, që kishin disa fjalë të caktuara të një soneti të Dantes, mes italishtes së hershme dhe asaj bashkëkohore. Imagjino kur ka humbje kuptimore mes fjalëve të një gjuhe të njëjtë në periudha të ndryshme, sa gjasë ka të ketë humbje në gjuhë jo të njëjta?



## v. 1-3

*Nel mezzo del cammin di nostra vita  
mi ritrovai per una selva oscura  
ché la diritta via era smarrita<sup>162</sup>  
vërtetë<sup>163</sup>*

*Në mes të shtegëtisë së kësaj jetë  
u gjeta në një pyll krejt errësi,  
se kishe humbë unë rrugën e*

Vargu I në original është: *Në mes të shtegtimit të jetës sonë*, ndërsa te përkthimi i Gjeçit ndeshet ndryshe. Kjo si duket është për shkak të rimës dhe përlllogaritjes së rrokjeve. Me ndryshim me një sërë përkthyesish të *Komedisë Hyjnore*<sup>164</sup>, Gjeçi i ka dhënë vargut një tjetër natyrë të referimit impersonal të rrëfyesit. Pra, nuk kemi të njëjtën zgjidhje si Cary (...our mortal life); Longfellow (...our life) etj., apo qoftë edhe si tek M. Ndoja (Në gjysë të jetës sonë...)<sup>165</sup>.

Ky varg i parë, merret nga dantologët e ndryshëm, por që gjendet edhe në shpjegimet e Gjeçit, si mesi i jetës së rrëfyesit, e që është edhe mesi i jetës njerëzore njëkohësisht, mbasi asokohe mosha maksimale e jetës njerëzore mbahej 70 vjetëshi. Kjo do të thotë se Dante i bie të ketë qenë diku 35 vjeç<sup>166</sup> kur u gjend në pyllin e errët (origj.: *mi ritrovai*, Gjeçi: *u*

<sup>162</sup> Dante. *Divina Commedia*. Newton Compton editori. Romë, 2008, f. 31.

<sup>163</sup> Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Përkth.: Pashko Gjeçi, bot. III. Argeta - LMG, Tiranë, 2006, f. 25.

<sup>164</sup> Le të krahasojmë variantin në anglisht të këtij vargu, nga Cary: "In the midway of this our mortal life" (= Në mes të rrugës së jetës sonë vdekse), megjithëse përkthyesi dallohet për liri përkthimore. Cary, H(enry). F(rancis). *The Divine Comedy of Dante*. The Pennsylvania State University. Electronic Classics Series, f. 3. Gjasat janë që H. F. Cary priret së tepërmi për kah ana sqaruese, komunikuese përderisa fjalës *jetë* i ka shtuar edhe përcaktorin *mortore/vdekse*. Por më i saktë na paraqitet përkthimi i Longfellow-it: "Midway upon the journey of our life" (= Në mes të udhëtimit të jetës sonë), sa i takon besnikërisë përkthimore. Longfellow, Wadsworth Henry. *The Divine Comedy of Dante Alighieri*. George Routledge and Sons, The Broadway, Ludgate, Londër, 1867, f. 1. Po në të njëjtin konceptim, për besnikëri përkthimi, është edhe varianti në prozë i Ferrit, nga Carlyle: "In the middle of the journey of our life" (= Në mes të udhëtimit të jetës sonë). Carlyle, Aitken John. *Dante's Divine Comedy: The Inferno*. A literal prose translation. Chapman and Hall, 186 Strand, Londër, MDCCCXLIX/1849, f. 1. Ndërsa në gjermanisht, Streckfuß, është më pranë variantit të H. F. Cary: "Auf halbem Weg des Menschenlebens fand" (= N' mes t' rrugës së jetës njerëzore u gjeta). Streckfuß, Karl. *Die Göttliche Komödie*. The Project of Gutenberg. Burim nga interneti.

<sup>165</sup> Ndoja, Mark. *Komedia Hyjnore*. Ferri. QSN & Lisitan, Tiranë, 2004, f. 21.

<sup>166</sup> Khs. edhe komentet e Claudio Scarpati-t kur thotë për vargun e parë: "*Nel mezzo...vita: a trentacinque anni circa*", f. 27. Alighieri, Dante. *La divina commedia. Inferno*. Fabbri editori, Itali, 1997. Po ashtu edhe të Carlyle-t: "Dante was at that time 35 years of age". Vep. e cit., f. 2. Studiuesit mendojnë se fillimi i poemës na lidh me vitin 1300, madje me

*gjeta*). Megjithëse ajo parashtesë (ri-) e foljes së origjinalit, nuk përkthehet kurdoherë në kuptimin e një foljeje intensifikuese, pra që përmban një veprim përsëritës, mbase mund të mendohet se autori e ka pasur fjalën për një gjetje rishtazi në atë pyll të errët. Por sidoqoftë, në variantet përkthimore të *Komedisë* në gjuhë të ndryshme gjendet: *u ndodha, u gjeta*.

Në vargun II: *...una selva oscura*, po të vërejmë komentet e Fallani-t dhe Zennaro-s, aty sqarohet: “nella selva dell male [...] egli raffigura se stesso, il genere umano, il mondo decaduto nell disordine morale e civile”<sup>167</sup>. Në shpjegimet që jep Pashko Gjeçi, thuhet: “pylli simbolizon jetën mëkatore të poetit”<sup>168</sup>. Në vijim të poemës ky pyll paraqitet me karakteristikat e tij: i egër, i ashpër, i fortë, të lidhura këto të gjitha me konceptimin simboliko-biblik të Ferrit, por njëkohësisht edhe me mungesën e arsyes, pa të cilën shpesh njeriu terratiset. Sa i përket tercines nisëse të poemës, varianti i Ndojës duhet përgëzuar, veçan vargu i parë dhe i tretë, ngaqë janë tingullisht njësoj me origjinalin. Pra, për kah ana fonetike e fjalëve të fundit të vargjeve, kemi një barabitje tingullore. Krahaso: *vita-arrita, smarrita-lajthita*<sup>169</sup>.

#### v. 13-15

*Ma poi ch' i' fui al piè d' un colle giunto,  
là dove terminava quella valle  
che m'avea di paura il cor compunto*<sup>170</sup>  
*trazue*<sup>171</sup>

*Po kur te rranza e kodrës qeshë afrue,  
atje ku merrte fund ajo luginë,  
që me aq tmer në zemër m'kish*

Përkthimi i këtyre vargjeve nga ana e Gjeçit, na pajton tërësisht me qëndrimin e Eco-s kur thotë se (po përpiqemi ta përmbledhim mendimin e tij) përkthyesi duhet të jetë një kulturolog i vyer, të jetë i zoti në asimilimin kulturor, nuk mjafton thjesht pasja e fjalorëve dygjuhësh, por së pari aftësia e njohjes së atmosferës së kohës kur është shkruar teksti, në kuptimin më të gjerë të fjalës<sup>172</sup>. Pra, kërkojmë të themi se Gjeçi i ka hyrë në zemër

---

pranverën (me gjasë 25 marsin) e atij viti, që është edhe e *Premtja e madhe*: kohë kur vdiq Krishti. Shih: Fallani-n, Zennaro-n; Gjeçin; Carlyle-n.

<sup>167</sup> “në pyllin e së keqes [...] ai paraqet vetveten, farën njerëzore, botën e rënë në çrregullinë morale e civile”. Dante. *Divina Commedia*. Vep. e cit., f. 31.

<sup>168</sup> Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Vep. e cit., f. 562.

<sup>169</sup> Ndoja, Mark. *Komedia Hyjnore*. Ferri. Vep. e cit., f. 21.

<sup>170</sup> Dante. *Divina Commedia*. Vep. e cit., f. 32.

<sup>171</sup> Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Vep. e cit., f. 25.

<sup>172</sup> Shih edhe Camajn, kur shprehet mbi përkthimin e Gjeçit: “Për shqipnimin e Dantes nuk mjaftonte njohja e asaj lande gjuhësore, por më tepër lypsej që përkthyesi të zotnonte mirë krejt skajet e shprehjes abstrakte në gjuhën shqipe nga degët e filozofis, kulturës

problemeve filologjike të tekstit, duke ruajtur njëkohësisht krejt lëndën krijuese të Dantes. Po kështu pohon edhe Camaj, në lidhje me *Ferrin* e sjellë në shqip nga Gjeçi: “Në një përkthim kësodore nuk mjafton gjetja e shprehjes dhe e fjalës së përshtatëshme, ky është pak a shumë një veprim teknik, por vështirësija vjen mandej, dhe pikrisht në gdhendjen e trajtës pa cenue masën metrike t’origjinalit, rrimën e strofën jo të lehtë të tercinës danteske, tue pasë parasyshë dhe harmoninë e tonit që ndrron pandá prej përskrimit fëtyrash e gjendjesh të ndryshme, në të cilat feksohet përherë kuptimi alegorik për të dalë vrap në djalogje apo kuvende arsyetimesh teorike”<sup>173</sup>. Po ashtu një vit para Camajt, F. Ndocaj shkruan: “shumica e tercinave asht reflektuese besnike e ritmit të poezisë danteske [...] në çdo kangë dhe në çdo tercinë na shohim se me sa kujdes përkëthyesi asht mundue me na e dhanë vepren e Dantit me tekniken aq të përsosun të origjinalit”<sup>174</sup>.

#### v. 31-33

*Ed ecco, quasi al cominciar de l’erta,  
una lonza leggera e presta molto,  
che di pel macolato era coverta*<sup>175</sup>

*E, ja gati përpjetën pa filluem,  
më doli një panterë e lehtë, e shpejtë,  
që me lëkurë të larme ish mbuluem*<sup>176</sup>

Në këto vargje problem paraqitet me përkthimin e fjalës *lonza*, të cilën e gjejmë: *panterë*<sup>177</sup>. Giovanni Fallani dhe Silvio Zennaro këtë fjalë e kanë të shpjeguar në këtë mënyrë: “(in lat. leuncia; etimon. lynx) fiera

---

fetare, drejtësis, gjeologjis etj., mbasi *Komedija Hyjnore* përmbledh përvojën e dijes të breznive të panjehuna ç’prej përrjudhave të përfytyrimeve mitike deri ke Treqindi”. Camaj, Martin. “‘Ferri’” e para kantikë e KOMEDIS HYJNORE në gjuhën shqipe’. *Shëjzat*, vjeti VI. Nr. 5-6, Mâj-Qershuer, 1962, f. 149.

<sup>173</sup> Po aty, f. 149-150.

<sup>174</sup> Ndocaj, Filip. Ndocaj, Filip. “Dante Aligieri në shqipet”. *Nëndori*, viti i VIII i botimit, nr. 7 – Korrik 1961, f. 140. Shih edhe pohimin tjetër, kur Ndocaj thotë se Gjeçit i është dashtë shumë mundë që të përkthejë Danten “në mënyrë që – pa i ikë origjinalit – të na e japi shqip dhe në tanësi këtë kryevepër letratyre, tue ruejtë formen e përmbajtjen, rimen e ritmin, fjalët e frazat, poetiken dhe muzikalitetin e origjinalit”. Po aty, f. 160.

<sup>175</sup> Dante. *Divina Commedia*. Vep. e cit., f. 33.

<sup>176</sup> Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Vep. e cit., f. 26.

<sup>177</sup> Tek përkthimi i Mark Ndojës, kjo fjalë ndeshet: *pantherë* [Vep. e cit., f. 22.], ndërsa tek ai i Nikollë Dakajt: *luqerbull* [Dakaj, Nikollë. *Antologji e poezisë së madhe botërore*. Naim Frashëri, Tiranë, 2008, f. 124.]. Gjithashtu edhe tek Çezar Kurti: *panterë* [Kurti, Çezar. *Komedia Hyjnore. Ferri*. Kurti Publishing, bot. II, New York, 1996, f. 14]. Ndërkohë tek këta përkthyes e gjejmë: Cary: *panther* [Vep. e cit., f. 4.]; Longfellow: *panther* [Vep. e cit., f. 2.]; Carlyle: *Leopard* [Vep. e cit., f. 4.]; Streckfuß: *Panthertier* (komp. *panterë* ‘Panther’ + *bishë/kafshë* ‘tier’) [Vep. e cit., f. 5.].

simile al leopardo o alla pantera, agile e rapida nei movimenti. Indica l'impedimento della lussuria"<sup>178</sup>. Ndërsa fjalori italisht i Tullio De Mauro-s, *Grande dizionario italiano dell'uso*, e shpjegon kështu: “**lonza** [sec. XIII; lat. *luncea(m)*, der. di *lynx, lyncis* “lince”] felino di incerta identificazione, forse un leopardo, una lince o un ghepardo”<sup>179</sup>.

Kurse te *Il dizionario della lingua italiana* i Giacomo Devoto-s dhe Gian Carlo Oli-t kjo fjalë shpjegohet: “**lonza** nome di un animale feroce non ben determinato (forse il ghepardo), assunto da Dante come simbolo dei peccati di frode e di tradimento”<sup>180</sup>.

*Fjalori italisht shqip* i F. Lekës dhe Z. Simonit, këtë fjalë nuk e ka fare të shpjeguar, porse ka vetëm një kuptim tjetër të kësaj fjale që nuk ka lidhje hiç me ndonjë lloj kafshe. Po të shihet aty ka: “**lónza** f. (kuzh.) 1) sallam-proshutë, 2) (kuzh.) kofshë derri”<sup>181</sup>. Ndërsa *Fjalori i madh italisht shqip* i A. Prezës dhe E. Prezës, e ka: “**lónza** I. f. (zool.) (vjet. let.) leopard ose rrëqebull”<sup>182</sup>. Por, çfarë kuptimi ka te *Fjalori i gjuhës shqipe* fjala panterë? Aty shpjegohet: “pantér/ë, -a f. sh. -a (t) zool. kafshë gjithare e egër, mishngrënëse, me trup të madh e me lëkurë të verdhë me njolla të zeza”<sup>183</sup>.

[Ku kërkon të na çojë ky poet me atë leksemë që e vendos në tekstin e poemës së tij, vallë? Pse i mundon aq shumë studiuesit me atë identifikim kafshe?

Natyrisht që erudicionit dhe ambiguitet të tij përherë i duhet trembur. Por, duke qenë se fermenti i kësaj poeme është i mbështetur në paratekstet biblike, jemi të mendimit se (kjo nuk e zgjidh mjegullën receptuese të fjalës *lonza*) gjetja e narratorit përpara kësaj kafshe është e ngjashme me vegimet e Gjonit, tek *Zbulesa*. Po të kemi parasysh fjalët që thotë Gjoni te *Zbu., 13: 2*: “Bisha që pashë ngjante me një leopard”<sup>184</sup>, dhe

<sup>178</sup> “(në lat. *leuncia; etimon. lynx*) kafshë e ngjashme me leopardin ose panterën, e shkathët dhe e shpejtë në lëvizje. Kallëzon pengimin e epshit”. Vep. e cit., f. 33. Shih edhe C. Scarpati-n: “*lonza (mbase një leopard)*”. Burim i cit., f. 29.

<sup>179</sup> “**lonza** [shek. XIII; lat. *luncea(m)*, prejardh. nga *lynx, lyncis* “rrëqebull”] felin (nga lat. e vonë *felīnu(m)*, e prejardhur nga *felis* “mace”, d.m.th. kafshët që bëjnë pjesë në familjen e maces. Shën. i L. K.) me identifikim të pasigurt, mbase një leopard, një rrëqebull ose një gepard”. Versioni në CD.

<sup>180</sup> “**lonza** emri i një kafshe të egër jo fort e përcaktuar (ndoshta gepardi), e marrë nga Dante si simbol i mëkateve të mashtrisë dhe të tradhtisë”. Versioni në CD.

<sup>181</sup> Leka, Ferdinand; Simoni, Zef. *Fjalori italisht shqip*. Infbotues, Tiranë, 2002, f. 351.

<sup>182</sup> Preza, Abedin; Preza, Ervin. *Fjalori i madh italisht shqip*. Ideart, Tiranë 2008, f. 802.

<sup>183</sup> *Fjalori i gjuhës shqipe*. Akademia e shkencave. Tiranë, 2006, f. 744.

<sup>184</sup> Dhiata e Re. *Zbulesa*. Versioni ndërkonfesional (bot. II). Shoqëria biblike, Tiranë, 2008, f. 777. Khs. edhe variantin e Diodatit të Ri, i cili gjithashtu thotë: “Dhe bisha që pashë i ngjante një leopardi”. Shoqata Shqiptare e Biblës, Tiranë, 1994, f. 295.

më tutje përshkruhet si një krijesë e përbërë me gjymtyrë a pjesë të ndryshme trupore nga kafshët e tjera, na lë të kuptojmë për një mundësi qasjeje me tekstin e Biblës. Sikundër shfaqet tek Gjoni: si një kafshë e paidentifikuar saktësisht, por si një krijesë me garanci të pakët identifikimi, edhe për ne ngelet po ashtu. Duket shumë e vështirë, në fakt, dhënia e një përcaktimi të duhur të kësaj fjale, duke pasur parasysh se me kohën e kompozimit të veprës na ndajnë shekuj të tërë, çka e vështirëson edhe aspektin kontekstual të leksemës. Kësomënyre edhe mbërritjen e duhur gjegjëse të fjalës].

Sa i takon Gjeçit, përpos faktit që me anën e përkthimit të kësaj fjale, nuk kemi një përkim vizioni me atë të Dantes<sup>185</sup>, madje për nga ana rrokjesore po kjo fjalë na del me një rrokje më shumë se origjinali. Po ashtu edhe mbiemrat që i prapavihen këtij emri sjellin një ngadalësim ritmik të vargut, por edhe krejt kjo tercinë e sjellë në shqip reduktohet ritmikisht apo vjen ndryshe, si shkak i ndarjes me presje të mbiemrave që e pasojnë: *...një panterë e lehtë, e shpejtë*, sikundër e do natyra e gjuhës shqipe në fakt, por që në origjinal *lonzës*, përcaktorët që i vihen dalin me lidhëz bashkërenditëse “*una lonza leggera e presta molto*”, duke u ruajtur ritmi i vargut.

#### v. 37-40

*Temp'era dal principio del mattino,  
e 'l sol montova 'n sù con quelle stelle  
ch'eran con lui, quando l'amor divino  
mosse di prima quelle cose belle*<sup>186</sup>

*Ish koha kur agonte koha e re  
e ngrihej Dielli me ata yj në qiell,  
që me te ishin, kur Zotynë mbi dhë  
sëpari i lëvizi n'ajr të kthiell*<sup>187</sup>

Në këto vargje të *Komedisë Hyjnore*, sipas komenteve të dantologëve italianë<sup>188</sup> dhe P. Gjeçit<sup>189</sup>, mendohet se poeti, gjithashtu, është

<sup>185</sup> Megjithëse Gjeçi, duke qenë i pajisur me një mjeshtëri të pazakontë, na fut në gjendjen e së dyshimtës (flasim për pasigurinë e identifikimit të kësaj kafshe) kur në v. 42, por edhe në v. 33 na bën me dije për kafshën që i doli Dantes para, krijon një kompozitë: *bishë-larushë*, duke përkuar me kuptimin: *fiera a la gaetta pelle (bishë me lëkurë të larme)*. Pra, na fut në të papërcaktueshmën e kafshës: mbase gepard, mbase leopard... mbase? Sikundër shprehen studiuesit.

<sup>186</sup> Dante. *Divina Commedia*. Vep. e cit., f. 33.

<sup>187</sup> Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Vep. e cit., f. 26.

<sup>188</sup> “era la prima ora del giorno: il sole ascendeva sull’orizzonte della terra congiunto con la costellazione dell’Ariete, col quale si trovava quando Dio iniziò il moto dei corpi celesti. Dante accenna all’opinione [...] che ritiene il mondo creato in primavera” – “ishte ora e parë e mëngjesit: dielli zbriste mbi horizontin e tokës i bashkuar me yjësine

nën ndikimin e *Shkrimit të Shenjtë* dhe të psikologjisë mesjetare njëkohësisht, se Zoti e krijoi botën në pranverë, kur dielli (te Gjeçi haset me germë të madhe kjo fjalë) ishte në yjësine e Dashit. Këtë pohim, na e dëshmon edhe Dante vetë kur thotë më tej *la dolce stagione*, dhe kësomënyre i drejtohet stinës së pranverës. Këtu togfjalëshi *l'amor divino*, nga Gjeçi, jepet me variantin: *Zotynë*, duke mos ruajtur semantikën e duke sjellë një receptim të ndryshëm nga origjinali.

#### v. 43-45

*L'ora del tempo e la dolce stagione;      Ai agu i dritës, e ambla stinë e ndritun,  
ma non si che paura non mi desse      por jo sa frikë aspak t'mos më shkaktonte  
la vista che m'apparve d'un leone<sup>190</sup>      pamja e një luani çfaqë papritun<sup>191</sup>*

E rëndësishme dhe interesante në vargjet e mësipërme, është domethënia simbolike e figurës së *luanit* nga ana e Dantes. Çfarë simboli mbajnë si më të mundshmit dantistët dhe çfarë simbolizon ai sipas shënimeve të Gjeçit? Si tek komentet e dantistëve<sup>192</sup> ashtu edhe te Gjeçi<sup>193</sup>, figura e kësaj kafshe simbolizon krenarinë. Po *ujkonja* çfarë simboli ka? – Te komentet në italisht e ndeshim si simbol të *koprracisë*, *kurnacisë*, të një qenieje që është e etur për interesat vetjake dhe kërkon që vetëm të marrë e të ketë për vete, dhe po ashtu edhe si simbol të *lakmisë*. Andaj edhe Dante e dëfton si kockë e lëkurë këtë kafshë, si krijesë që s'gjen paqe në vetvete (*la bestia senza pace*), ngaqë është e interesuar vetëm për qëllime përvetësimi, e dëshiruar për zhvatje deri në skutat më të errëta të meskenitetit të saj. Në këtë pikë studiuesit, përfaqjen e saj e lidhin edhe me rrënimin moral dhe veset e njerëzve, kryesisht ato të Italisë, të çfarëdolloj shtrese qofshin, e ulët a e lartë. Te Gjeçi, e shohim si simbol të *interesit* dhe *dëshirës për përvetësim*.

---

e Dashit, me të cilën mendohej koha kur Zoti nisi lëvizjen e trupave qiellorë. Dante e ka fjalën për mendimin [...] që e mban botën të krijuar në pranverë”. Shih për më shumë komentet e G. Fallani-t dhe S. Zennaro-s. Vep. e cit., f. 33.

<sup>189</sup> “E ngrihej Dielli me ata yj në qiell: *Të vjetrit besonin se Zoti e krijoi botën në kohën e pranverës, kur Dielli ishte në hyllësinë e Dashit*”. Shën. e Gjeçit. Vep. e cit., f. 562.

<sup>190</sup> Dante. *Divina Commedia*. Vep. e cit., f. 33.

<sup>191</sup> Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Vep. e cit., f. 26.

<sup>192</sup> “*un leone*: simbolo della superbia” – “*një luan*: simbol i krenarisë”. Kom. e G. Fallani-t dhe S. Zennaro-s. Vep. e cit., f. 33. Po të njëjtën gjë pohon edhe Scarpati. Bur. i cit., f. 29.

<sup>193</sup> “pamja e një luani: Simbolizon krenarinë”. Shën. e Gjeçit. Vep. e cit., f. 562.

Duhet thënë se për bishat janë dhënë simbolika edhe politike, ku ato nënkuptojnë Republikën e Firences, Mbretin e Francës, Romën e Papatit. Pra me sa duket, prania e këtyre interpretimeve na bën të mendojmë se poema është një ngjizje simboliko-religjiozo-politike. Por e rëndësishme është se si kapërcehen këto pengesa? Zgjidhja është si tek Odiseja me Polifemin e në raste të tjera. Do të thotë se zgjidhja arrihet me anë të mendjes.

Me vargun 60 të Dantes *...là dove 'l sol tace...* (= atje ku dielli men), *...ku diell nuk llamburiste...* (Gjeçi), ne shkojmë edhe një herë te fillimi i poemës, meqenëse autori na lidh metaforikisht me të dhe me anë të një paralelizmi na lë të nënkuptojmë atë pyll të errët, ku ai u ndesh. Me një fjalë, kaq i errët është ai pyll, sa fije dielli nuk futet brenda tij.

Tani kemi mbërritur në një pikë kur Dantes, pos kafshëve, përpara syve diçka i shfaqet. Kjo soj pamjeje për të është e paidentifikuar, – domosdo nga frika e tepërt që kishte në atë vend të panjohur, e sidomos edhe prej atyre tri kafshëve, që i patën zënë pritë, – dhe prandaj ai është ndërdyshas a është hije apo njeri? Sigurisht që i duket hije: sepse përfytyrimi është i venitur, i paktë. Po ashtu edhe njeri: sepse gëzon çdo tipar të qenies njerëzore. Gjëja e vetme, instiktive dhe tepër e njerëzishme, që i kërkon ai, është mëshira. Pra, kërkon faljen e jetës, mbasi mendon se ajo përfaqje nuk është për mirë. Ndërkohë ajo hije nis e flet, duke i lënë të kuptojë që edhe pse nuk ishte njeri, nuk kishte qëllim dashakeqës, prandaj edhe ai i prezantohet, në mënyrë që ta qetësojë e ta bindë për këtë gjë. Në çastin kur ai i thotë se jetoi: *“nel tempo de li dèi falsi e bugiardi”*, çka do të thotë se i përkiste periudhës parakristiane, pra i takonte besimit pagan, shënimet e Gjeçit ashtu siç vihet re edhe një variant interpretimi në komentet italisht, Virgjili për mesjetarët shihet si pararendës i kulturës kristiane dhe si simbol i arsyes, i dijes dhe i përvojës. Pikërisht te miti i Eneas flitet, se disa krishtologë kërkuan të gjenin (para) fillesat kristiane, pasi ai ishte modeli i heroit që përtëriu jetën dhe qytetërimin duke u prirë kah parimi i rregullit në çdo pikëpamje. Por sa variant-simbole kemi për figurën e Virgjilit? Njeri sosh është: Virgjili dëshmon ekzistencën e kulturës antike në kulturën mesjetare, mandej – për mendimin tonë – kjo figurë mund të shihet gjenetikisht edhe si ndërlidhëse e kulturës (*Tu se' lo mio maestro e 'l mio autore; / tu se' solo colui da cu' io tolsi / lo bello stilo che m'ha fatto onore*<sup>194</sup> – thotë Dante, v. 85-87), pra kemi letërsinë latine

<sup>194</sup> *Ti je mësuesi dhe autori im; / ti je veç ai, nga i cili unë nxora / stilin e bukur që më fali nderim.* Përkth. im, L. K.

që pasqyrohet në letërsinë italiane të Mesjetës, si *fakt marrëdhëniesor gjenetik*.

#### v. 100-102

*Molti son li animali a cui s'ammoglia,  
e più saranno ancora, infin che 'l veltro  
verrà, che la farà morir con doglia.*<sup>195</sup>  
*dërrmohet.*<sup>196</sup>

*Me shum frymorë ajo pa da barcohet,  
dersa të vijë Langoni, të tjerë do gjejë,  
po mizorisht nga ky do të*

Emrin në shumës *animali*, që vjen: *frymorë*, jemi të mendimit se Gjeçi e ka vërejtur hollë problemin, sepse këtu kemi të bëjmë me simbole vesesh që mbart kjo kafshë. Të thuash që këto vese përçohen lehtas dhe shumohen (pas ndërimit) nëpërmjet raportit kafshë me kafshë, kemi të bëjmë me një ngushtim vizioni, ngaqë këto vese tejçohen në çdo qenie frymore dhe ne alegorisht na vjen përmes kafshës kjo simbolikë, por nënteksti është për njerëzit në të vërtetë. Duhet përmendur se kjo fjalë vjen nga rrënja **anima** – *shpirt, frymë*<sup>197</sup> d.m.th. kemi të bëjmë me një qenie të gjallë. Veç kësaj edhe komentuesit italianë e shpjegojnë kështu: “*Molti son li animali*: i vizi si congiungono facilmente, in particolar la cupidigia.”<sup>198</sup>.

Ky përçim vesesh nuk duhet thënë në përkthim që kalon ndërmjet kafshëve<sup>199</sup>, por frymorëve në mënyrë që të zgjerohet vizioni alegorik dhe të nënkuptohet domethënia. Dhe në këtë pikë ku gjendemi, për të argumentuar pajtimin me variantin e Gjeçit, në ndihmë na vjen Eco kur thotë se përkthimi ka të bëjë me botë të mundshme. Çka do të thotë se Gjeçi ka

<sup>195</sup> Dante. *Divina Commedia*. Vep. e cit., f. 35.

<sup>196</sup> Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Vep. e cit., f. 28.

<sup>197</sup> Shih *Fjalorin* e T. D. Mauro-s: “**animale** [...] [1293–94; lat. *animāle(m)* “animato, che dà vita”, der. di *anima* “anima”] **1** relativo agli esseri animati [...] **2** che riguarda la parte fisica dell’esistenza umana” – “**frymor** [...] [1293–94; lat. *animāle(m)* “i gjallë, që ka jetë”, e prej. nga *frymë/shpirt* “shpirt”] **1** që ka lidhje me qeniet frymore [...] **2** që i përket anës fizike të ekzistencës njerëzore”. Burim i cit.

<sup>198</sup> “*Të shumtë janë frymorët*: veset shtohen lehtësisht, në veçanti koprracia.”. Fallani, Zennaro. Vep. e cit., f. 35.

<sup>199</sup> Duam të shtojmë se në një botim për shkollat e mesme nga sh. b. Albas, Tiranë, 2003, f. 36, në shpjegimet që i bën Ardian Marashi *Ferrit* të Dantes nëpërmjet përkthimit të Gjeçit, shumësit: *frymorë*, i ka vënë një yllth duke e shpjeguar se në origjinal është *kafshë*. Për mendimin tonë të gjithë sa kanë mbrojtur këtë variant, nuk paraqiten të saktë, përfshi edhe Ndojën e Dakajn, që *animali* e kanë dhënë: *shtazë* [Vep. e cit., f. 25./126.]. I njëjtë me saktësinë e Gjeçit paraqitet edhe përkthimi i Kurtit, kur për fjalën përkatëse jep variantin: *gjallesë* [Vep. e cit., f. 16.].



zgjedhur kuptimin dhe perceptimin më të duhur e më, për të përkthyer këtë fjalë. Po t'i vëmë një shenjë tjetër barazimi këtyre fjalëve, do të thotë se përkthyesi ka ndërtuar në bazë të kontekstit të fjalës që paraqet origjinali një sistem imagjativ, ku ka hamendësuar alegorinë e autorit të veprës, dhe këtë kontekst e ka funksionalizuar rishtas në gjuhën mbërritëse, madje i ka dhënë të njëjtën gjerësi vizioni. Kjo fjalë (ani-ma-li) në rrokje del e barabartë (fry-mo-rë), dhe vargjet – ashtu si edhe në do vargje të sipërme – përmbillen në bashkëtingëllore, ku si natyrë pajtohen më së miri me epizmin tonë gjenetik. Mëtojmë të themi se rimat fundore të dala në bashkëtingëllore, së bashku me tërësinë e vargjeve në këtë përkthim, kanë pak tharm nga tradita jonë epike (si rasti i v.: *po mizorisht nga ky do të dërrmohet*). D.m.th. shëmbëllimit mistik të vargjeve të Dantes, Gjeçi i gjegjet me një shëmbëllim të traditës sonë epike, ku marrin pjesë ndërtimi i tillë vargnor, ndajfoljet si elemente ndërtuese të lëndës epike, gjithashtu edhe foljet që përmbajtësisht shprehin pohimin e sipërm.

Një interes në këto vargje na shfaq edhe përkthimi i fjalës *veltro*, ku së pari shihet se përkthimi shqip e ka me germë të madhe. Mbase mund t'ia lëmë çështjen edhe botimeve të tekstit origjinal të asokohshëm dhe tekstit në origjinal, që ka në dorë autori i këtij artikulli, porse ky përkthim ka një karakter me liri të madhe vetjake, sepse ndeshen edhe raste të tjera kur germa e madhe përdoret pa qenë në origjinal. Po ta përkthejmë këtë fjalë nga gjuha origjinale është e saktë<sup>200</sup>, por puna është se për këtë fjalë ka një mori hipotezash nga studiuesit se ç'është mbart në vetvete kjo fjalë, mbasi nuk ka asnjë interpretim të saktë e përfundimtar. Për një gjë është e sigurt: *langoi* vjen për të dëbuar ujkonjën bashkë me të këqijat (shtoi nëntekstet këtij përcaktori!) e saj. E këtu ndeshemi prapë me animin kristian të poetit: d.m.th. besimi në një zgjidhje të epërme për t'i dhënë fund krizës morale e qytetare që ka mbërthyer njerëzinë. Disa nga hipotezat që kanë shtruar studiuesit janë: *langoi* simbolizon ardhjen e një perandori që t'i përmbyllë këto rrëtime morale, dikush tjetër mendon se disa veçori karakterizuese të *langoit* dalin edhe në disa vargje të *Parajsës* dhe kështu që, japin ide të ndryshme në lidhje me këto bashkëpërkime. Të tjerë e shohin vetëm nga ana religjioze problemin, duke thënë se bëhet fjalë për një fuqi reformimi të Kishës etj. Po ta marrim nga kjo anë dhe njëkohësisht duke iu shmangur këtyre hipotezave, *langoi* simbolizon përfundimin e një gjendjeje të caktuar, moskompromisin, pakthyeshmërinë misionare. Me një fjalë ai vjen me një qëllim të caktuar: ta zhdukë ujkonjën. Kjo fjalë kyç e Dantes, te Gjeçi del e zhvendosur për nga rendimi i fjalëve në vargje, po

<sup>200</sup> Kurti e jep: *Veltër*, duke e lënë në trajtën e një italianizmi.

ashtu edhe nga numri i rrokjeve, duke na sjellë një kuptimësim ndryshe po ta krahasojmë me tekstin burimor.

## **PËRFUNDIM:**

Në trajtën e një analize përqsëse, u mor në shqyrtim kënga e parë e *Ferri*, përkthyer nga Pashko Gjeçi dhe arritëm në ballafaqim të gjuhës nisëse dhe gjuhës mbërritëse, duke parë në këtë mënyrë edhe ndryshimet por edhe sukseset në variantin përkthimor. Po ashtu, u bë e mundur që të futemi në mënyrë më specifike në konceptimet danteske, përmes një sërë burimesh mbi poemën *Komedia Hyjnore*, duke dhënë një informacion më të plotësuar mbi fjalët kyçe të tekstit dhe një detajim më të konkretizuar lidhur me variantin e Gjeçit.

Në këtë artikull, u synua dhe deri diku u bë e mundur një krahasim qenësor me tekstin biblik (*Zbulesa*), sa i takon lemës: *lonza* tek Dante dhe *leopardit* të dishepullit Gjon, duke bërë edhe më të qartë praninë e ndërtekstorisë në poemën mesjetare, si edhe përkimet me traditën e krishterë. Gjithashtu në kuadrin e një gjurmimi tekstor të *Komedisë*, u arrit një natyrë e përimtuar (kuptohet në përmasat e një artikulli) mbi prodhimin dantesk duke dhënë mendësinë universale dhe faktorin e përhershëm komunikativ mbi botën njerëzore.

## **BIBLIOGRAFI:**

1. Alighieri, Dante. *Komedia hyjnore*. Përktheu: Pashko Gjeçi. Argeta - LMG, Tiranë, 2006. (Bashkë me shën. e përkthyesit.)
2. *Bibla. Zbulesa*. Diodati i Ri, Shoqata Shqiptare e Biblës, Tiranë, 1994.
3. Camaj, Martin. “Ferri” e para kantikë e KOMEDËS HYJNORE në gjuhën shqipe’. *Shëzjat*, vjeti VI. Nr. 5-6, Máj-Qershuer, 1962.
4. Carlyle, Aitken John. *Dante’s Divine Comedy: The Inferno*. A literal prose translation. Chapman and Hall, 186 Strand, Londër, MDCCCXLIX.
5. Cary, Francis Henry. *The Divine Comedy of Dante*. The Pennsylvania State University. Electronic Classics Series.
6. Dante. *Divina Commedia*. Newton Compton editori. Romë, 2008. (Bashkë me komentet e Fallani-t dhe Zennaro-s).
7. Dante. *Ferri*. Albas, Tiranë, 2003. (Shën. e Ardian Marashit).
8. Dakaj, Nikollë. *Antologji e poezisë së madhe botërore*. Naim Frashëri, Tiranë, 2008.
9. Devoto, Giacomo; Oli, Carlo Gian. *Il dizionario della lingua italiana*. Versioni në CD.

10. *Dhiata e Re. Zbulesa*. Versioni ndërkonfesional (bot. II). Shoqëria biblike, Tiranë, 2008.
11. Eco, Umberto. *Të thuash gati të njëjtën gjë*. Dituria, Tiranë, 2006.
12. *Fjalori i gjuhës shqipe*. Akademia e shkencave. Tiranë, 2006.
13. Kurti, Çezar. *Komedia Hyjnore. Ferri*. Kurti Publishing, bot. II, New York, 1996.
14. Leka, Ferdinand; Simoni, Zef. *Fjalori italisht shqip*. Infbotues, Tiranë, 2002.
15. Longfellow, Wadsworth Henry. *The Divine Comedy of Dante Alighieri*. George Routledge and Sons, The Broadway, Ludgate, Londër, MDCCCXLIX /1849.
16. Mauro, De Tullio. *Grande dizionario italiano dell'uso*. Versioni në CD.
17. Ndocaj, Filip. "Dante Aligieri në shqipet". *Nëndori*, viti i VIII i botimit, nr. 7 – Korrik 1961.
18. Ndoja, Mark. *Komedia Hyjnore. Ferri*. QSN & Lisitan, Tiranë, 2004.
19. Preza, Abedin; Preza, Ervin. *Fjalori i madh italisht shqip*. Ideart, Tiranë, 2008.
20. Scarpati, Claudio. *Dante Alighieri. La divina commedia. Inferno*. (Komentet). Fabbri editori, Itali, 1997.
21. Streckfuß, Karl. *Die Göttliche Komödie*. The Project of Gutenberg. Burim nga interneti.

**Dante Alighieri through the translation of Pashko Gjeçi,  
in the first canto of Hell: comparison.  
Researches in the Dante's text**

**SUMMARY**

In the Albanian tradition, it is not the first time, that *The Divine Comedy*, translated by P. Gjeçi, has been treated by point of view of translation's skill. Some critics have seen the Gjeçi's translation as a research object, but our research is concerned only in the first canto of *Hell*. The treatment contains the comparison between Gjeçi's notes and some of Dante's researchers, besides the verses and words analyzed. It has also been possible to enter in a more specific way in the conceptions of Dante, through some fonts over the poem *The Divine Comedy*, giving a more impregnated information about the key words of the text. Regarding the word 'lonza', in reference to the text of *Bible (Apocalypse)*, we think that the text conserves intertextual elements, as it was done a comparison between this word and the word 'leopard' of the apostle John in *Apocalypse* 13:2. Due to the artistic production of Dante, it had been given the universal mentality and the permanent communicative factor of the great poet about the human world.



David LUKA

## EDHE NJË HERË PËR PERIODIZIMIN E HISTORISË SË GJUHËS SHQIPE

Shkak për rishqyrtimin (përkat. rishikimin) e periodizimit të historisë së gjuhës shqipe, u bënë dy fakte gjuhësore.

\*

\*

\*

1. Gjatë kohës që po punonim për të hartuar një kumtesë me rastin e 100-vjetorit të lindjes së prof. Selman Rizës, ndeshem në një shprehje që na tërhoqi menjëherë vëmendjen, Aty thuhej: “... me mjete gjuhësore nuk mund të vendosen kufij, jo vetëm sepse mungojnë dëshmitë e shkruara, por edhe sepse zhvillimet gjuhësore janë të shkallëshkallshme, të pandërprera dhe të papërceptueshme në një çast të dhënë”<sup>201</sup>.

Vetëkuptohet, përfundimi i sipërm nuk do të më tërhiqte vëmendjen, nëse ai nuk do të lidhej me emrin e prof. Rizës. Sepse të krijohej përshtypja që autori i këtij përfundimi po përforconte e mbështeste pikërisht edhe mendimin e prof. Rizës për problemin e periodizimit të gjuhës shqipe, aq më tepër kur ky citonte Rizën: “Rrjedhimisht edhe periodizimi *kryesor* i historisë së një populli duhet poshtë-lart t’i përshtatet, periodizimit të historisë së vetë këtij populli ose e thënë disi ndryshe, historia e gjuhës sonë duhet periodizuar paralelisht me historinë e popullit”<sup>202</sup>.

Fragmenti i mësipërm ndërkaq nuk përkon me atë të S. Rizës. Khs. “Rrjedhimisht edhe periodizimi *kryesor* i historisë së gjuhës së një populli duhet poshtë-lart t’i përshtatet periodizimit të historisë së vetë këtij populli”<sup>203</sup>.

Nga krahasimi i dy fragmenteve vëmë re se të parit i mungon pikërisht thelbi i problemit, sepse këtu flitet për “historinë e një populli”, ndërsa te Riza për “historinë e **gjuhës** së një populli”. Është harruar pra

<sup>201</sup> S. Mansaku, *Periodizimi i historisë së gjuhës shqipe dhe pikëpamja e prof. Selman Rizës për të*, SF 1-2, 2000, f. 119.

<sup>202</sup> Po aty, f. 121.

<sup>203</sup> S. Riza, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009, f. 228.

fjala “**e gjuhës**”, pa të cilën gjithçka do të devijonte nga thelbi i çështjes. Besojmë se harresa e mësipërme e fjalës “**e gjuhës**” duhet të jetë *lapsus*, përndryshe diskutimi i mëtejshëm do të komprometohej tërësisht.

Në vazhdim të studimit, Riza do ta përsërisë edhe dy herë pohimin e tij “se poshtë-lart historia e gjuhës s’onë duhet periodizuar paralelisht me historinë e popullit t’onë”<sup>204</sup>; gjithashtu “... historia e gjuhës shqipe si gjuhë e folur poshtë-lart duhet periodizuar simbas periodizimit të historisë së popullit shqiptar”<sup>205</sup>.

Pas këtij parashtrimi, mbeten për t’u sqaruar dy probleme. Së pari, a mund të perceptohet një dukuri gjuhësore në një çast të dhënë të zhvillimit të saj? Sepse, në qoftë se pranohet që “... me mjete gjuhësore nuk mund të vendosen kufij, jo vetëm sepse mungojnë dëshmitë e shkruara, por edhe sepse zhvillimet gjuhësore janë të shkallëshkallshme, të pandërprera dhe të papërceptueshme në një çast të dhënë”, atëherë vetvetiu çdo përpjekje për të përcaktuar kohën e formimit të gjuhës shqipe, së bashku me përpjekjen për ta periodizuar historinë e saj, do të paraqiteshin të pamundura.

Problemi tani do të kërkonte fillimisht një trajtim filozofik, duke u ndalur për të analizuar se si duhet konceptuar “procesi i njohjes” në lidhje me një dukuri gjuhësore (përkth. me gjuhën në përgjithësi). Ndërkaq duhet sqaruar se në procesin e njohjes së një dukurie gjuhësore, a mund të bëhen krahasime, qoftë edhe nga larg, me procesin e zhvillimit të dukurive të natyrës dhe, më pastaj, a mund të zbatohen edhe për zhvillimet gjuhësore në përgjithësi ligjet e dialektikës.

Së pari, këtu duhet bërë një ndarje e saktë ndërmjet dukurive gjuhësore në zhvillimin e natyrshëm të tyre gjatë kohëve, me politikën gjuhësore që ndiqet për ta ndihmuar a deformuar një zhvillim të natyrshëm të saj.

Gjuha e folur zakonisht paraqet një idiomë që mund të krahasohet me dukuritë e natyrës, sepse të dyja lindin, zhvillohen, arrijnë pjekurinë e vet e, më pastaj, bien, plaken e vdesin. Natyrisht këtu nuk mund të bëhen krahasime për periudha kohore, sa zgjat njëra apo tjetra. Gjithashtu për mundësinë apo pamundësinë tonë për t’i njohur ato në zhvillimin e tyre dialektik. Sepse këto procese zakonisht zhvillohen jashtë ndërgjegjes sonë. Njeriu mund të ndikojë për t’i shpejtuar apo ngadalësuar këto zhvillime, por jo për t’i ndalur. Aftësia jonë për t’i perceptuar këto dukuri në zhvillim varet nga shkalla e njohjes. Njohja e një dukurie gjuhësore në proces, përkth. njohja e tërë këtyre dukurive, që përbëjnë në tërësinë e tyre vetë

<sup>204</sup> Po aty, f. 230.

<sup>205</sup> S. Riza, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009, f. 340.

gjuhën e folur gjatë shekujve, varet nga *studimet* e thelluara të kryera për të. Në qoftë se *studimet* mungojnë, atëherë është e vetëkuptueshme që dukuria nuk përceptohet dot.

Këndeje duhet ndarë çështja: ne nuk mund ta periodizojmë historinë e gjuhës shqipe sepse nuk e njohim, apo sepse një veprim i tillë paraqitet shkencërisht i pamundur.

Tashmë dihet që procesi i njohjes është psikologjik, ai nis nga *ndijimi* “pasqyrimi në vetëdije i vetive të caktuara të realieve që veprojnë mbi organet e shqisave”, duke u ngjitur shkallë-shkallë nëpërmjet disa fazave; *përceptimi* “pasqyrimi i sendeve ose i dukurive në ndërgjegjen e njeriut” (formë e njohjes shqisore të botës); *konceptimi* “pasqyrimi në ndërgjegjen tonë i tipareve më të përgjithshme e më thelbësore e një klase sendesh a dukurish”; *ndërgjegje* “forma më e lartë e pasqyrimin të botës”. Mbi bazën e këtyre fazave të njohjes njeriu formon më pastaj *teorinë*: “përgjithësimin mendor të përvojës, që pasqyron dukuritë thelbësore dhe ligjet e zhvillimit të natyrës, të shoqërisë e të mendimit”.

Këndeje duhet të përshkohet detyrimisht edhe njohja e një dukurie gjuhësore në zhvillimin e saj. Mirëpo, në rastin e shqipes kjo njohje pengohet që në fazën e përceptimit të drejtpërdrejtë të saj, sepse mungon objekti “një tekst (i hershëm), i shkruar a i folur i saj”. Dihet tashmë që kjo punë për shqipen mund të nisë shkencërisht vetëm nga shek. XVI me “Mesharin” e Buzukut. Këtë fakt ka pasur parasysh, ngjan, prof. Riza kur e nis arsyetimin e vet me “*poshtë-lart*”. Për një dijetar si prof. Riza shprehja “*poshtë-lart*” do të thotë “mungesë argumentimi”, mungesë faktesh për të nisur shkallën e njohjes. Të mos harrojmë se shkrimi “Simbas cilëve kritere duhet periodizuar historia e gjuhës shqipe” është botuar në vitin 1965. Që prej asaj kohe e deri më sot kanë kaluar plot 46 vjet. Gjatë kësaj kohe janë shtuar në mënyrë të ndjeshme studimet e monografitë për historinë e gjuhës shqipe në të gjitha nënsistemet e saj, e veçanërisht në strukturën e saj, e cila përbën themelin e një gjuhe.

Gjuha shqipe vërtet është e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, por ajo paraqet një përparësi në njohjen e historisë së vet para Buzukut. Këto janë burimet e tërthorta, ku vendin kryesor e zënë huazimet nga gjuhët e tjera. Krahasimi i këtyre huazimeve në momentin që kanë hyrë në gjuhën shqipe, pra i kanë shkëputur lidhjet me gjuhën dhënëse, me ndryshimet që kanë pësuar këto në gjuhën marrëse (përkth. me gjuhën shqipe), ndjekja e këtyre ndryshimeve tani në pajtim me ligjet e gjuhës shqipe, na jep dorë të përcaktojmë me siguri shumë kufij, që sjellin fakte të reja për njohjen e zhvillimit në kohë të dukurive të ndryshme gjuhësore, duke nisur tani edhe nga “përceptimi” direkt i tyre.

Për të argumentuar sa thamë më lart, mjafton të përmendim se disa kufij mund të vendosen pa frikë se mund të jemi të pasaktë. Ardhja e sllavëve në Shqipëri p.sh. përbën një kufi që sot njihet e pranohet përgjithësisht nga dija e sotme gjuhësore. Kundër mund të jetë vetëm ndonjë dijetar që ka në themel të studimit të tij paragjykimet nacionale.

Një kufi i saktë dhe i përcaktuar mirë nga ana gjuhësore është edhe emërtimi i terminologjisë fetare kristiane (katolike) në gjuhën shqipe, i cili paraqitet krejtësisht latin (në krahasim p.sh. me rumanishten, ku kjo terminologji është krejtësisht sllave). Në vija të trasha ky kufi mund të vendoset pas shek. I (pas Krishtit) deri në fund të shek. V (pas Krishtit). Tani në qoftë se marrim në konsideratë faktin që organizimi i rregullt kishtar në Shqipëri duhet të ketë nisur së paku nga fundi i shek. II a fillimi i shek. III, atëherë koha e vendosjes së kufijve të këtij fenomeni, saktësohet edhe më tej. Më këtë periudhë janë të lidhura një numër i madh dukurish gjuhësore në proces, që datojnë në shek. I-IV, të cilat ne i kemi quajtur “shtresa e dytë”<sup>206</sup> e huazimeve latine të shqipes, sepse gjejnë pasqyrim me shembuj të qartë pikërisht te emrat që lidhen me këtë terminologji kishtar.

Po kështu mund të flasim për periudha të mëvonshme, siç është rasti për përcaktimin kohor të huazimeve turke në gjuhën shqipe, të cilat nuk mund të jenë më të hershme se fundi i shek. XIV e fillimi i shek. XV.

Natyrisht përcaktimet kohore të deritanishme të parashtruara më lart, janë gjithsesi të lidhura në mënyra të tërthorta edhe me periudha historike. Ngjan, këtë ka parasysh edhe prof. Riza kur barazon kufijtë e historisë së Shqipërisë me ato të historisë së gjuhës, po gjithsesi “*poshtë-*

<sup>206</sup> D. Luka, *Rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore” V, Shkodër, 1999, f. 167 v. Khs. tekstin e plotë: Dallohen, pra, ndër huazime latine të shqipes dy shtresa. E para u nënshtrohet ndërrimeve fonetike të përbashkëta me elemente e trashëguara e me ato të huazuara nga greq. e vjetër. Këtë shtresë mund ta vështrijmë si të trashëguar nga ilirishjtja. Së dyti, shtresa më e re, e cila nuk u nënshtrohet më ndërrimeve të lashta.

Për dy “shkallë” a dy “faza” huazimesh latine të dalluara kronologjikisht dhe gjeografikisht, ka folur edhe S. Puçariu, pavarësisht nga interpretimi (për ne jo i drejtë) që njëra shtresë u mor në atdheun e vjetër (Daki) e tjetra nga ndikimi dalmato-roman (*Beiefte* 26, f. 62 v.). Për një shtresë të moçme të huazimeve latine të shqipes është shprehur edhe Weigandi (*Balkan-Archiv* III 178, shën. 1). Edhe H. Bariçi, duke përmbledhur mendimet e dijetarëve para tij, sheh një shtresim të dyfishtë të huazimeve latine të shqipes (*Hÿmje* 62 v.). Tani, duke e quajtur të zgjidhur problemin e vendit të formimit të gjuhës shqipe, që “ky është formuar në përgjithësi në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor gjatë kohëve” (E. Çabej SGJ V 29), vështrimi i dy shtresave ndër huazimet latine të shqipes merr një kuptim të ri, duke ndihmuar në përcaktimin e kohës së formimit të gjuhës shqipe.



*lart*”, pra në copa të mëdha, pa u futur më tej në analizën e drejtpërdrejtë të dukurive gjuhësore në zhvillimin e tyre. Prandaj ai e quan periodizimin e bërë prej tij “konvencional”. Mirëpo, *konvencioni*, mbetet gjithnjë marrëveshje subjektive. Ai gjithnjë do të përdoret edhe në të ardhmen për të përcaktuar periudha të gjata kohore, të cilat ose nuk njihen fare gjuhësisht, ose njihen fare pak. Termi *prehistori* p.sh. do të përdoret gjithnjë edhe në të ardhmen duke mbetur i papërcaktuar saktësisht në kohë. Po kështu termi tjetër *protoshqipja* (përk. *parashqipja*), së cilës nuk i dihet as fillimi e as mbarimi. Në këtë mënyrë duhen kuptuar tani edhe termat e përdorura nga S. Riza: *lashtësi, mesjeta, kohët e reja*.

Ne tani e kemi fjalën për mundësinë e vendosjes së kufijve kohorë të dukurive gjuhësore të mirëfillta. Pra, me dukuri të strukturës së gjuhës shqipe e, kryesisht me ato të nënsistemeve të saj, të cilat nuk kanë asnjë lidhje shkakore me historinë e popullit tonë.

Në këtë mes duhet më së pari të përcaktojmë dy gjëra të rëndësishme: kur nis historia e gjuhës shqipe dhe, si zhvillohet ajo në strukturën e saj gjatë kohëve.

Periodizimi i gjuhës shqipe nis sipas nesh qysh nga ajo periudhë, kur ajo është formuar përfundimisht si një gjuhë cilësisht e ndryshme nga “nëna” e saj. Problemi, mendojmë ne, duhet trajtuar së pari në pikëpamje teorike, e më pastaj, duke u përcaktuar qartë e saktë termat që do të përdoren, të parashtrohet edhe metoda e punës që do të ndiqet në paraqitjen e argumenteve.

Pra, puna e parë që duhet kryer është përcaktimi i kohës së formimit të gjuhës sonë. Për këtë deri tani ka dy mendime, ai i prof. Sh. Demirajt<sup>207</sup>, dhe i D. Lukës<sup>208</sup>.

Për përcaktimet kohore të mësipërme, S. Mansaku ka shkruar: “... përcaktimi i kohës së formimit të gjuhës shqipe si një gjuhë e veçantë e dalë nga ilirishtja ... është një problem i vështirë dhe i pazgjidhur përfundimisht. Kudo që të vihet ky kufi, në shek. IV siç mendojnë disa (ky “disa” është D. Luka, të cilit, nuk di përse autori nuk ia përmend emrin,

<sup>207</sup> Sh. Demiraj, *Gramatikë* 56 “gjatë periudhës midis fazës së fundit të sundimit romak dhe dyndjes së sllavëve ...”, d.m.th. nga shek. IV deri në shek. VI .

<sup>208</sup> D. Luka, *Rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe*, në rev. “Studime filologjike”, nr. 4, 1988, f. 147. Khs. Shqipja u formua si gjuhë “bijë” nga “nëna” e saj ilirishtja në të njëjtat treva në shek. I-IV të erës sonë. Gjatë kësaj periudhe ajo përvijoi tiparet gjuhësore, duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e nënës së saj ilirishte, por duke formuar në të njëjtën kohë edhe tipare të reja që e bënë të dallohet nga ajo. Kushtet historike të asaj kohe (pushtimi romak e në vazhdim dyndjet barbare) e përshpejtuan këtë formim. Në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj.

shën. im), apo në shek. VI të erës sonë, siç është përpjekur të vërtetojë me më shumë argumente Sh. Demiraj, ai do të jetë më tepër një kufi historik konvencional, sesa një kufi i mirëfilltë gjuhësor ...”<sup>209</sup>

Pavarësisht nga kundërshtimi i sipërm, përderisa nuk kemi përcaktim tjetër rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe, e përderisa ata nuk janë larg në kohë, ne do t’i marrim në konsideratë, duke u përpjekur të argumentojmë më tej me fakte gjuhësore kohën e formimit të gjuhës shqipe, nga nis edhe periodizimi i saj.<sup>210</sup>

\*

\*

\*

2. Botimi i librit të Besim Bokshit “*Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*”<sup>211</sup>.

Tashmë dihet se akademiku Bokshi është një ndër personalitetet e gjuhës shqipe në Kosovë e gjithashtu një ndër specialistët më të mirë të morfologjisë historike të gjuhës shqipe. Në *Hyrje* të kësaj vepre prof. Bokshi kishte marrë në analizë edhe parashtrimin tim për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe. Në vazhdim po jap *ad litteram* ç’është shkruar aty:

IX. Tash vonë në materialet e botuara të Konferencës shkencore “Selman Riza gjuhëtar i shquar”, të organizuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës për nder të 100-vjetorit të lindjes, David Luka del me kumtesën “Sprovë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe”.

Për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe ai ka përcaktuar “tri periudha të mëdha: *prehistoria, koha e formimit, historia*.”

**Prehistorinë** e përbën koha e nënës së shqipes. “Në këtë periudhë dukuritë dalin të përbashkëta me gjuhët e tjera simotra indoevropiane me të cilat grupohet”.

**Si kohë të formimit** të gjuhës shqipe ai përcakton shek. I-IV.

**Historia** thotë se nis në shek. V. Ai shton se “Idioma e re tani mund të emërtohet shqipja e vjetër. Që këtu nis periodizimi i gjuhës shqipe”.

<sup>209</sup> S. Mansaku, *Periodizimi*, po aty, f. 119.

<sup>210</sup> D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore” VII, Shkodër, 2002, f. 80 v. D. Luka, *A mund të perceptohen dukuritë gjuhësore në një çast të dhënë të zhvillimit të tyre*, në “Studime gjuhësore” XII, Shkodër, 2010.

<sup>211</sup> B. Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010.

*Periudha e shqipes së vjetër është, sipas tij, nga shek. V deri në shek. XIV. Këtë periudhë e ndan në etapën e parë (shek. V-IX) dhe në etapën e dytë (shek. X-XIII).*

*Në etapën e parë nuk veprojnë më apofonia dhe metafoia, përftohen diftongjet e reja, bëhet ngulitja e theksit në një rrokje të caktuar dhe rregullimi mekanik i tij në rrokjen e parafundit, janë bjerrë gjatësitë e lashta të zanoreve, “guturalet indoevropiane e kanë përfunduar ciklin e tyre” dhe hundorësia e zanoreve “Mbase ka nisur në mesjetën e hershme”. Në morfologji është përfutur lakimi binar i emrit dhe formimi i nyjave, Në fjalëformim “ndikimi latin ka përfunduar”. Ky studiuës mendon se “tipari themelor që e karkterizon këtë etapë, është fillimi i ndarjes dialektore të shqipes” dhe thotë se fillimi i rotacizmit duhet kërkuar në shek. III.*

*Etapa e dytë nis me fillimin e ndikimit të slavishtes në gjuhën shqipe”. Në të “nuk vepron më p.sh. refleksi s : sh dhe nuk bie okluzivim (b, d, g) në trup të fjalës”.*

**Periudha e dytë (ose shqipja e mesme)** shek. XIV-XVIII “nis me dokumentimin e shkrimit të saj”. Dhe “as që mund të flitet për ndryshime në strukturën morfologjike të shqipes.

**Periudha e tretë (ose shqipja e sotme)** shek. XIX deri në ditët e sotme.

Siç shihet, ky periodizim ka mjaft përcaktime të pasakta, të hamendshme, e të diskutueshme. Megjithëkëtë ky është periodizimi me të cilin insistohet për të përcaktuar kohën e ndryshimeve fonetike e morfologjike.<sup>212</sup>

Në shkrimin e mësipërm nuk janë përdorur si duhen thonjëzat dhe korsivi, kështu që nuk merret vesh cilat janë fjalët e mia e cilat të autorit të librit. Ndërkaq, riprodhimi i tekstit tim, është jo vetëm i paplotë, por edhe i mangët e i pasaktë. Këndeje, para se të nis diskutimin për çështjet themelore të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe, e shoh të nevojshme, së pari, të sjell të plotë tekstin tim për problemin në fjalë, nxjerrë nga kumtesa për të cilën shkruan Bokshi.

Në përpjekjen për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe, ne paracaktojmë tri faza të mëdha: *prehistoria, koha e formimit, historia.*

**Prehistoria** i përket gjithsesi nënës së shqipes. Në këtë periudhë dukuritë dalin të përbashkëta me gjuhët e tjera simotra indoevropiane me të cilat grupohet.

---

<sup>212</sup>Po aty, f. 19 v.

**Koha e formimit**<sup>213</sup> (shek. I-IV). Tipari i përgjithshëm: ndërrimet janë të veçanta e vetëm për gjuhën e re që po formohet në të njëjtat treva nga *nëna* e saj, ilirishtja<sup>214</sup>.

**Historia** nis në shek. V. Idioma e re tani mund të emërtohet *shqipja e vjetër*. Që këtu nis periodizimi i historisë së gjuhës shqipe<sup>215</sup>.

\*

\*

\*

**Periudha e parë** ose *shqipja e vjetër*. Nis në shek. V dhe shkon deri në shek. XIV. Ndahet në dy etapa:

1. *Etapa I*, nga shek. V deri në shek. IX. Tiparet themelore janë: trashëgimet e të gjitha nënsistemeve të *nënës* së saj ilirishte. Në **strukturën fonologjike** ajo ka trashëguar pesë zanore *a, e, i, o, u* (zanoret *y*<sup>216</sup> dhe *ë* ngjan të jenë përfitime të brendshme të vetë

<sup>213</sup> Për mendimin e Sh. Demirajt për kohën e formimit të gjuhës shqipe (shek. VI) dhe të D. Lukës (shek. IV), Mansaku shprehet se "... kudo që të vihet ky kufi, ai do të jetë një kufi historik konvencional" (*Periodizimi ...*, po aty, f. 119).

<sup>214</sup> Shiko D. Luka, *Rreth problemit të kohës së formimit të gjuhës shqipe*, SF 4, 1988. Gjithashtu D. Luka, "Studime gjuhësore V", Shkodër, 1999 (punim i përmirësuar).

<sup>215</sup> Tri fazat e sipërme pasqyrohen edhe në sistemin e nomenklaturës së familjes, rrethit familjar e farefisit në gjuhën shqipe.

Së pari, në sistemin e emërtimeve të farefisnisë, institucioni i familjes ka qenë i formuar mjaft herët e krahas me të gjithë popujt e tjerë indoevropianë. Specifika e këtij procesi të shqiptarët është se emërtimet më të afërta, ato që shënojnë thelbin e familjes (*atë, amë - ëmë, bir - bijë, vëlla - motër, djalë - vajzë*) janë me burim indoevropian.

Së dyti, huazimet latine në këtë sistem nomenklature i përkasin një kohe më të vonë, ato nuk zëvendësojnë, por në shumicën e rasteve e pasurojnë atë, duke pasqyruar marrëdhëniet e reja, të krijuara gjatë pushtimit romak. Pas kësaj kohe gjithçka paraqitet e konsoliduar dhe huazimet e mëvonshme ose nuk pasqyrohen fare në të (huazimet sllave), ose prekin sfera anësore të kësaj nomenklature (huazimet turke).

Së treti, shqiptarët e vazhdojnë jetën e tyre familjare në mënyrë aktive, duke krijuar tani edhe marrëdhënie të reja, që padyshim gjejnë pasqyrim edhe në emërtimet e reja etnografike, të formuara brenda sistemit të gjuhës shqipe e me mjetet e tij, duke pasuruar kështu terminologjinë e familjes, të rrethit familjar e të farefisit (D. Luka, *Studime gjuhësore X*, Shkodër 2007, f. 14).

<sup>216</sup> K. Topalli vë re se "... formimi i /y/-së duhet të ketë filluar, vetëm kur gjatësitë e zanoreve filluan të shkurtoheshin nga ana kuantitative e të ndryshonin nyjëtimin nga ana kualitative ..." dhe se "... fillimi i këtij tingulli do të binte në periudhën e kontakteve të dendura me këtë gjuhë (përk. lat., sh. im)", "... por para shek X ..." (*Shndërrime në sistemin zanor të gjuhës shqipe*, Tiranë 2000, f. 121-122). Khs. edhe B. Demiraj, *Fonema /y/ në gjuhën shqipe (Vështrim diakronik)*, SF 1-4, 1994, f. 118 (aty edhe shën. 33). Gjithashtu edhe mendimin e përkundërt të B. Beci, *Rreth evolucionit të \*/ū/-së*

shqipes), pavarësisht nga zanafilla e tyre. Apofonia dhe metaforia nuk veprojnë më. Përfundojnë procesin e nisur diftongjet e reja të shqipes, përfitim i të cilave ka zënë fill në periudhën e formimit të gjuhës shqipe (shek. I-IV)<sup>217</sup>. Ndërsa konsolidimi i sistemit të theksimit, tani me ngulitjen e tij në një rrokje të caktuar gjatë paradigmës, paraqitet si tipar i kohës së formimit të gjuhës shqipe, pasojat e mëtejme të kësaj risie, që tani lidhen me rregullimin mekanik të theksit, i përkasin kësaj periudhe.<sup>218</sup>

Gjatësitë e lashta, që kryenin funksione morfologjike në kundërvënien me zanoret e shkurtra, janë bjerrë të gjitha. Ngjan që një veprim i tillë të jetë kryer në shekujt e parë të epokës sonë (shek. I-IV), atëherë kur edhe gjatësia klasike e zanoreve në latinishte ishte në shuarje e sipër. Kjo periudhë koincidon edhe me dukuri të tjera, që flasin në të mirë të kohës së formimit të gjuhës shqipe nga “nëna” e saj ilirishtja. Në vazhdë të kohëve shqipja ka trashëguar disa gjatësi (kryesisht në fjalë njërrrokëshe), por që nuk kanë funksion të mirëfilltë morfologjik dhe nuk paraqiten më si dukuri morfonologjike. Krahas ka përftuar gjatësi të reja, të cilat njësohen me ato pak të trashëguarat në një sistem gjuhësor.

Po kështu hundorësia e zanoreve në gjuhën shqipe “... nuk është e trashëguar, por lidhet me zhvillimin e brendshëm të gjuhës”<sup>219</sup> dhe “Mbase ka nisur në mesjetën e hershme ...”<sup>220</sup>. Edhe bigëzimi dialektor *vo- va-* në ballë të fjalës ngjan të jetë i kësaj periudhe<sup>221</sup>.

Në sistemin bashkëtingëllor laringalet, sonantet dhe mbyllëtoret aspirative i përkasin prehistorisë. Në etapën e parë (të

---

*indoevropiane dhe latine në y në shqipe*, SF 1-4, 1995 (aty edhe shën. 23 e 24). Sh. Demiraj shprehet se “... fonema /y/ në sistemin zanor të shqipes është përftuar si një zhvillim i brendshëm i kësaj gjuhe, jashtë çdo ndikimi të huaj” (*Fonologjia* 63).

<sup>217</sup>Sipas K. Topallit (*Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes*, Tiranë, 1998) diftongu *-je-*, i dalë nga *-e-ja* e shkurtër indoevropiane, ngjan të ketë nisur herët (periudha historike), por të ketë përfunduar para shek. VIII, sepse huazimet sllave nuk janë prekur nga kjo dukuri (f. 88). Ndërrimi tjetër *-e- : -ja-*, sipas autorit të sipërm, ngjan të jetë edhe më i lashtë (f. 116). Përfitim i diftongut *ua/ue*, siç dihet, kalon në disa faza, që nisin nga periudha romake e përfundojnë te autorët e vjetër të shqipes (f. 128). Sipas Sh. Demirajt “... procesi i diftongimit të */o-/* në rrokje të mbyllur nga */n/* ka zënë fill ... jo më vonë se shekujt IV-V të erës sonë” (*Fonologjia* 100).

<sup>218</sup> D. Luka, *Rreth tri problemeve për historinë e theksit në gjuhën shqipe*, në rev. “Studime filologjike”, nr. 1, 1991, f. 171.

<sup>219</sup> K. Topalli, *Për historinë e hundorësisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1996, f. 117.

<sup>220</sup> Po aty, f. 120.

<sup>221</sup> D. Luka SGJ V 28 v.

periudhës së parë) guturalet (përkat. tektalet) indoevropiane (palatale, labiovelare dhe velare të thjeshta) e kanë përfunduar ciklin e tyre. Tani *k*-ja velare njësohet me një *k* të dalë nga labiovelaret (në rastet e veçanta edhe nga palatale të depalatalizuara) dhe së bashku vazhdojnë të njëjtat ndërrime sipas vendit ku ndodhen (*k/e,i/ > q*). *s*-ja ngjan ende të kthehet në shushuritëse. Bashkëtingëlloret afrikate janë zhvillime të brendshme të shqipes dhe përftimi i tyre bie në këtë periudhë (përkat. në etap. I). Bashkëtingëllorja *nj* ngjan t'i përkasë fundit të kohës së formimit të gjuhës shqipe (përkat. kronologjisë *-t̄ > -i > -i*, si mbaresa të shumësit të emrave me temë *-n*), por procesi duhet të ketë vazhduar edhe në etapën e parë të kësaj periudhe. Bashkëtingëllorja geminante *rr* (si alofone e tjetrës *r*) ngjan të ketë lidhje me natyrën e gjuhës shqipe që një numër fjalësh herë shqiptohen me *r* e herë me *rr*. Në këtë rast tingujt *r* e *rr* përgjithësisht nuk kanë funksion kuptimdalues<sup>222</sup>. Burimi i *rr* nuk duhet kërkuar detyrimisht te një grup *\*-rn-* (khs. p.sh. lat. *furnus* : *furrë* etj.) sa kohë që ky fortim ngjet edhe te huazimet latine që nisin vetëm me një *r*- (khs. lat. *radium* : *rreze* etj.).

Në ***nënsistemin morfologjik*** ngjan të kemi riorganizimin përfundimtar të paradigmave të lakimit e të zgjedhimit dhe të sistemit rasor. Po kështu edhe përsosjen e mëtejshme të disa dukurive të nisura që në kohën e formimit<sup>223</sup> (lakimi binar i emrit, lakimi në ballë të fjalës, prirja për zhvillimin e disa tipareve analitike në strukturën e saj gramatikore; po kështu formimi i nyjave<sup>224</sup> etj.). Megjithëse sistemi përemëror i gjuhës shqipe është i trashëguar nga gjuha indoevropiane, format e ndryshme përemërore kanë evoluar në pajtim me ligjet e zhvillimit të brendshëm të gjuhës<sup>225</sup>.

Në ***nënsistemin e fjalëformimit*** ndikimi latin (gjithsesi i pakët) ka përfunduar. Përgjithësisht prapashtesat latine janë bërë produktive në shqipe vetëm kur kanë përkuar me formantet vendëse të trashëgimisë indoevropiane<sup>226</sup>. Edhe në strukturën morfologjike ndikimi latin është i pakët e i parëndësishëm, megjithëse shqipja ka huazuar rreth një mijë fjalë nga ajo gjuhë. Kjo tregon se shqipja e asaj kohe kishte përvijuar tiparet e saj si gjuhë e re në strukturën e vet morfologjike.

<sup>222</sup> D. Luka, *Geminantja rr në gjuhën shqipe*, në *Studime gjuhësore* V, f. 109 v.

<sup>223</sup> K. Topalli, *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Tiranë, 2009, f. 333 v.

<sup>224</sup> K. Topalli, *Nyjat e shqipes*, Tiranë, 2009, f. 279.

<sup>225</sup> K. Topalli, *Evolucioni historik i përemrave të shqipes*, Tiranë, 2008, f. 193.

<sup>226</sup> D. Luka SGJ V 173 v.

Por tipari themelor, që e karakterizon këtë etapë, është fillimi i ndarjes dialektore të shqipes. B. Beci ka arritur në përfundimin se "... dy dialektet e shqipes u formuan në territoret e tyre të sotme në mesjetën e hershme (shek. VI-VIII), ose në antikitetin e vonë (shek. IV-V) para ardhjes së sllavëve"<sup>227</sup>. Sipas nesh "... fillimet e rotacizmit duhen kërkuar rreth shek. III; më fuqishëm ai vepron në shek. IV-V, ku merr fund edhe ndikimi intensiv i latinishtes në gjuhën shqipe të sapoformuar"<sup>228</sup>.

Pra, krahas dukurive mbarëgjuhësore, shfaqen tani për herë të parë edhe ato dialektoret, çka vërtetojnë që shqipja e kësaj kohe paraqitet si idiomë e përcaktuar me tipare të qarta dalluese.

2. *Etapa II* (shek.X-XIII). Nis me ndikimet e mirëfillta të sllavishtes në gjuhën shqipe, e cila tani paraqitet e konsoliduar në të gjitha nënsistemet. Dukuritë dhe ndërrimet e vjetra nuk gjejnë vend ndër huazimet sllave të shqipes. Nuk vepron më p.sh. refleksi *s : sh*; nuk bie okluzivi (*b, d, g*) në trup të fjalës etj. Shqipja e kësaj kohe huazon nga sllavishtja fjalë, ndonjë prapashtesë dhe toponime, që nuk ngrenë peshë në strukturën gjuhësore të saj. Ndërkaq, ngjan të vazhdojnë ndarjet dialektore si edhe disa dukuri të tjera, si përfundimi i ndonjë procesi të diftongimit, nisur në periudha të mëparme, sinkopa e zanoreve para e pas theksi, krijimi i disa gjatësive të reja etj., tani të njohura e të vëna re me kohë nga gjuhëtarë të ndryshëm.

**Periudha e dytë (ose shqipja e mesme)**, shek. XIV-XVIII. Nis me dokumentimin e shkrimit të saj, që ngjan të jetë më i hershëm se vepra e Buzukut. Tani këtu gjithçka zhvillohet nën dritën e shkrimit, dhe që nga ajo kohë e deri më sot (përk. shek. XVIII) as që mund të flitet për ndryshime të rëndësishme në strukturën morfologjike të shqipes. Në këtë periudhë vazhdon riformimi i sistemit të pronorëve<sup>229</sup>. Ndërkaq vazhdon divergjenca e dialekteve, por edhe përpjekja e ndërgjegjshme për afrimin e tyre.

**Periudha e tretë (ose shqipja e sotme)**, shek. XIX deri në ditët e sotme. Edhe këtu dallohen dy etapa:

1. *Etapa I* (përk. 1850-1972) paraqet përpjekjen e ndërgjegjshme për konvergjenca të të dy dialekteve.

<sup>227</sup> B. Beci, *Lashtësia e dialekteve të shqipes, dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, SF 3, 1982, f. 74.

<sup>228</sup> SGJ V 160.

<sup>229</sup> K. Topalli, *Për gjenezën e pronorëve të shqipes*, SF 1-2, Tiranë, 2007, f. 78.

2. *Etapa II* (përkat. 1972 e deri më sot) nis me Kongresin e Drejtshkrimit, që sanksionoi njësimin e gjuhës letrare shqipe në të gjitha nënsistemet e saj.

\*

\*

\*

Në vitin 2002 unë botova<sup>230</sup> shkrimin me titull “*Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*”. Jo rastësisht artikulli i sipërm niste “*Rreth problemit ...*”. Sepse vështirësitë për trajtimin e kësaj teme qenë tejet të mëdha. Kriteri bazë që do të ndiqej qe ky: do të nxirreshin të gjitha dukuritë përkatëse që trajtonin probleme të gramatikës historike të gjuhës shqipe, të parashtruara nga gramatikanët me të njohur (të vendit, si dhe ata të huaj) e, më pas, të rreshtoheshin sipas kronologjisë së vendosur në veprat e tyre. Pra, dukuritë gramatikore, që përbëjnë në këtë mes shtyllën kurrizore të problemit, janë pothuaj krejtësisht të autorëve të përmendur në artikull (shiko për këtë bibliografinë e punimit në fjalë). Kënde, puna ime qe vetëm rreshtimi i këtyre fakteve gramatikore, sepse nga grupimi i tyre në kohë, do të përcaktoheshin edhe etapat përkatëse.

Punimi i sipërm paraprihej nga një *Hyrje*, ku parashtroheshin edhe kriteret teorike të vendosura, të cilat do të zbatoheshin gjatë trajtimit të problemit. Ngjan që prof. Bokshi nuk e ka njohur këtë artikull, sepse nuk e përmend gjëkund.

Me kalimin e viteve lënda gramatikore, që lidhej me periodizimin e historisë së gjuhës shqipe, qe shtuar shumë. Ishin botuar tanimë një numër i madh veprash si “*Fonetika historike e shqipes*” (2007), *Evolucioni historik i përemrave të shqipes*, (2008), *Për gjenezën e pronorëve të shqipes*, (SF 1-2, Tiranë, 2007) “*Sistemi rasor i emrave të shqipes*” (2009), “*Nyjat e shqipes* (2009) etj., që të detyronin të rishikoje të gjithë shkrimin e parë, të botuar në vitin 2002.

Në vitin 2009, në 100-vjetorin e lindjes së prof. Selman Rizës, unë mbajta në Shkodër e pastaj në Tiranë kumtesën “*Sprovë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe*”. Jo rastësisht ajo niste me fjalën “*Sprovë ...*”. Kjo kumtesë paraqiste vetëm një pjesë të vogël të një shkrimi të gjatë me të njëjtin titull. Në Tiranë, për arsye kohe, u lexua vetëm një fragment i saj, kështu që prof. Bokshi nuk pati mundësi të njihej me të. Ndërkaq, Universiteti i Shkodrës e botoi atë të plotë. Një variant tjetër i kësaj

<sup>230</sup> D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore” VII, Shkodër, 2002, f. 79.



kumtese u botua në “Studime gjuhësore” XII, me të njëjtin titull.<sup>231</sup> Varianti përfundimtar u botua në veprën “Studime për historinë e gjuhës shqipe”.<sup>232</sup> Mirë do të ishte që prof. Bokshi, para se të merrte në analizë kumtesën time, të njëjhej me të gjitha variantet e këtij studimi (veçanërisht atë të botuar në vitin 2002), e pastaj të bënte vërejtjet përkatëse.

\*

\*

\*

Prof. Bokshi shkruan: “Siç **shihet**, ky periodizim ka mjaft përcaktime të pasakta, të hamendshme e të diskutueshme ...”, por pa dhënë asnjë argument për t’i vërtetuar vërejtjet e veta.

Së pari, në tekstin e paraqitur te Bokshi (që nis me: “Siç **shihet** ...), unë “shoh” vetëm një pjesë të vogël të kumtesës sime, riprodhuar pa kujdes e pa respektuar drejtshkrimin e shqipes (thonjëzat, korsivin etj.). Sepse shpeshherë “*sÿni të rrënë*”. Duhet pra argumente, me të cilat operohet në shkencë. Mirëpo, pikërisht këto argumente nuk “**shihen**” gjëkund!

Ka përcaktime të pasakta, “thotë” Bokshi, por pa treguar se cilat janë këto përcaktime të pasakta.

Ka përcaktime të hamendshme “thotë” Bokshi, por pa treguar se cilat janë këto hamendësime. Gjithashtu pa përcaktuar se të kujat janë këto përcaktime të hamendshme. Sepse unë kam rreshtuar aty jo mendimet e mia, po të studiuesve më në zë të shqipes (khs. G. Meyer, N. Jokl, H. Pedersen, W. Meyer-Lübke, A. Desnickaja, B. Janson, E. Çabej, S. Riza, B. Bokshi M. Domi, Sh. Demiraj, B. Demiraj, B. Beci, K. Topalli, etj.). Unë vetëm i kam përqasur në kohë mendimet e tyre dhe, sipas këtyre afrimeve, kam përcaktuar periudhat përkatëse.

Ka përcaktime të diskutueshme, “thotë” Bokshi. Këtu ai ka plotësisht të drejtë, sepse e gjithë historia e gjuhës shqipe, tashmë dihet, është e diskutueshme, sa kohë që nuk kemi asnjë dokument shkrimor të hershëm për ta vërtetuar atë. E pikërisht për këtë arsye përpiqemi ta ndriçojmë atë edhe me mjete të tjera,

Por “*megjithëkëtë*”, shkruan prof. Bokshi, “*Ky është periodizimi me të cilin insistohet për të përcaktuar kohën e ndryshimeve fonetike e morfologjike*”. Është pikërisht ky fakt, që e ka shtyrë prof. Bokshin të rimarrë edhe një herë në dorë periodizimin e ndryshimeve morfologjike të shqipes, duke dhënë tani një pasqyrë të plotë (e pothuaj shteruese) të tyre.

<sup>231</sup> D. Luka, “Studime gjuhësore” XII, Shkodër, 2010.

<sup>232</sup> D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, “Studime për historinë e gjuhës shqipe” (Vepër e zgjedhur, botim i QSA), Tiranë, 2010.

Vërejtjet e mia ndaj artikullit të parë<sup>233</sup>: “B. Bokshi përpiqet ta periodizojë historinë e gjuhës shqipe mbi bazën e rrugës së zhvillimit të temave emërore dhe të sistemit rasor të gjuhës shqipe. Përpyekja e Bokshit paraqet interes, sepse autori e mbështet këtë çështje në kritere gjuhësore. Po ndërkaq identifikimi i tyre është parë mjaft ngusht. Së pari, periodizimi që autori i bën sistemit të rasave dhe zhvillimit të temave emërore është gjithsesi subjektiv, ai ende s’ka zënë vend e nuk është bërë pronë e dijes së sotme gjuhësore. Së dyti, koncepti i zhvillimit të gjuhës është më i gjerë nga ç’paraqitet te Bokshi; aty duhen përcaktuar qartë shkaqet dhe pasojat e tyre më në thellësi e më të argumentuara historikisht. Në një gjuhë si shqipja, e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, duhet ecur me hapa tepër të matura; dukuritë gjuhësore të supozuara apo të rindërtuara duhet të përshkohen nga ideja e sistemit. Diakronia duhet konceptuar edhe si tërësi prerjesh sinkronike dhe jo vetëm si studim i dukurive të veçuara.”<sup>234</sup>, ngjan ta kenë nxitur profesorin tonë të nderuar që t’i risillet edhe një herë problemit në fjalë, po tani duke e kapur për brirësh, sepse ai paraqitet jo vetëm i plotë, jo vetëm gjithpërfshirës, po edhe shterues. Mua më duhet ta rivështroj nga fillimi edhe një herë periodizimin e bërë prej meje, duke përqasur tani me autorët e sipërpërmendur edhe përfundimet e dhëna nga Bokshi në librin e tij. Dhe, mesa kam vënë re deri më tani, nuk jemi shumë larg njëri-tjetrit.

Së fundi më mbetet të them se e kam të vështirë ta pranoj mendimin e prof. Bokshit<sup>235</sup> (ndaj kumtesës së S. Mansakut<sup>236</sup>) se më parë duhet bërë periodizimi, dhe mandej të mbështetet ai me fakte gjuhësore. Ngjan, duhet të jetë e kundërta, më parë duhen rreshtuar në kohë dukuritë gjuhësore, dhe, mbi bazën e tyre të kryhet periodizimi përkatës. Përndryshe ky periodizim do të mbetet gjithnjë subjektiv e konvencional.

<sup>233</sup> B. Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980.

<sup>234</sup> D. Luka, *Sprovë për periodizimin e historisë së gjuhës shqipe*, në vëllimin “Selman Riza, gjuhëtar i shquar” (Në 100-vjetorin e lindjes), “Studime shqiptare 16”, Shkodër, 2010, f. 29 v.

<sup>235</sup> B. Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve ...*, po aty, f. 19.

<sup>236</sup> S.Mansaku, *Disa çështje të studimit diakronik të shqipes: rreth problemit të periodizimit të historisë së saj*”, mbajtur në konferencën shkencore “Çështje të studimeve diakronike të shqipes”, organizuar në Prishtinë, më 6 korrik 2009 (cituar sipas B. Bokshit, *Periodizimi ...*, po aty f. 18, shën. nr. 5).

**Once more on the periodization the History of the Albanian Language*****SUMMARY***


In this article, the author reconsiders the periodization of the History of the Albanian Language. He considers this issue in the theoretical perspective as well as in the practical one. Concerning the former perspective, he argues against S. Mansaku's approach; concerning the latter, he argues against B. Borshi's approach. Luka asserts that the linguistic phenomena should be arranged chronologically and then they should be classified. In his opinion, the reverse procedure would lead to a subjective and conventional periodization.

Artan HAXHI

## FAMILJET E GJUHËVE NË BOTË (vazhdim ...)

### Familja e gjuhëve Khoisan

Në familjen e gjuhëve *khoisan* (gjithashtu të njohura edhe si gjuhët *khoesan*) përfshihen gjuhët që fliten në Afrikën australe. Në këtë familje gjuhësore janë futur të ashtuquajturat gjuhë *kliko*<sup>237</sup>, të cilat janë karakteristike vetëm për këtë familje gjuhësore dhe që nuk i ndeshim në ndonjë familje tjetër (ky është edhe kriteri bazë që ka shërbyer për grupimin e tyre në të njëjtën familje gjuhësore). Në këtë familje përfshihen disa gjuhë vendëse të Afrikës jugore dhe të asaj lindore. Në Afrikën jugore folësit e tyre janë popujt khoi (otentotët) dhe bushmenët (sanët), ndërsa në Afrikën lindore janë popujt sandavë dhe hadza (me gjuhët respektive *sandave* dhe *hadza*, të cilat janë klasifikuar si gjuhë të familjes *khoisan*, ndonëse janë ekstremisht të largëta si në pikëpamje gjeografike, ashtu edhe në pikëpamje gjuhësore). Para pushtimit Bantu, mendohet se gjuhët e familjes *khoisan* ishin të përhapura në të gjithë Afrikën jugore dhe në atë lindore, ndërsa tani ato janë të kufizuara sidomos në shkretëtirën e



Kalharit, kryesisht në Namibi, në Botsvanë dhe në Luginën Rift (Tanzania qendrore)<sup>238</sup>.

Kjo familje gjuhësore përbëhet nga rreth 35 gjuhë, mjaft prej të cilave kanë vdekur, kurse disa të tjera janë të rrezikuara të zhduken, mbasi pjesa më e madhe nuk kanë një traditë shkrimore as sot e kësaj dite (as edhe me dorëshkrime).

Familja e gjuhëve *khoisan* së pari u propozua nga Johan Greenberg (në

<sup>237</sup> **gjuhë kliko** = gjuhë të cilat përdorin disa tinguj (të quajtur bashkëtingëlloret kliko, të cilat grafikisht shënohen me shenja të tilla ! dhe Ꞥ) për të dalluar kuptimet, rasën, gjininë dhe numrin e emrave.

<sup>238</sup> A. Barnard (1988), 'Kinship, language and production: a conjectural history of Khoisan social structure', *Africa: Journal of the International African Institute* **58** (1), f. 29-50.

klasifikimin e tij të 1949-1954, i rishikuar më 1963) si një nga katër familjet e gjuhëve që fliten në Afrikë. Megjithatë, disa gjuhëtarë, të cilët po i studiojnë gjuhët *khoisan*, kanë filluar ta vënë në dyshim ekzistencën e një familjeje të tillë. Sipas tyre, termi *khoisan* është përdorur më tepër për lehtësi studimi, por pa ndonjë domethënie gjuhësore<sup>239</sup>. Ata i trajtojnë degët që e përbëjnë atë si familje gjuhësore të pavarura, të palidhura gjenetikisht me njëra tjetrën. Dijetari Ernst Oswald Johannes Westphal është ndër të parët që e kundërshtoi bashkimin e këtyre gjuhëve afrikane në të njëjtën familje gjuhësore (George Starostin, 2003). Po kështu dijetari tjetër, Bonny Sands (1998), i cili, pasi analizoi disa nga gjuhët e kësaj familjeje, arriti në të njëjtin përfundim. Kurse Anthony Traill, që e kishte pranuar më parë familjen e gjuhëve *khoisan* (Traill 1986), aty nga viti 1998 arriti në përfundimin se ajo nuk mund të vërtetohet me të dhënat aktuale, me metodat dhe me kriterin e vetëm që i bashkonte këto gjuhë në të njëjtën familje (bashkimi i gjuhëve sipas pranisë së klikove)<sup>240</sup>.



Studiues të ndryshëm janë të mendimit se ngjashmëritë gjuhësore ndërmjet gjuhëve të degëve *tuu* dhe *juu* janë më tepër shkak i një *sprachbundi*<sup>241</sup> (lige gjuhësore) të Afrikës jugore se sa rezultat i lidhjeve gjenealogjike në mes tyre<sup>242</sup>.

<sup>239</sup> Bonny Sands (1998), *Eastern and Southern African Khoisan: Evaluating Claims of Distant Linguistic Relationships*. Rüdiger Köppe Verlag, Cologne dhe Gerrit Dimmendaal (2008) "Language Ecology and Linguistic Diversity on the African Continent", in *Language and Linguistics Compass* 2/5, f. 7

<sup>240</sup> Linguistics 112 lecture, Department of Linguistics, University of the Witwatersrand, March 1998.

<sup>241</sup> **Sprachbund** (shqiptim gjermanisht: [ʃ pʁ a : x b ʊ n t]: "ligë gjuhësore" në Gjermanisht) - është një grup gjuhësh që janë bërë të ngjashme në një farë mënyre për shkak të afërsisë gjeografike dhe kontakteve gjuhësore, por që nuk kanë lidhje gjenetike ose kanë lidhje të largëta mes tyre. Kjo krijon një pamje të rreme të afërsisë në mes të këtyre gjuhëve, sa shpesh i detyron gjuhëtarët t'i përfshijnë ato në të njëjtën familje gjuhësore.

<sup>242</sup> Tom Güldemann dhe Edward D. Elderkin (forthcoming) 'On external genealogical relationships of the Khoe family.' In Brenzinger, Matthias and Christa König (eds.), *Khoisan languages and linguistics: the Riezler symposium 2003*. Quellen zur Khoisan-Forschung 17. Köln: Rüdiger Köppe, f. 212.

Ndërkohë që ka edhe mjaft studiues të tjerë, mes të cilëve Ehret Christopher (1986, 2003), Henry Honken (1988, 1998) dhe George Starostin (2003, 2008), që vazhdojnë ta pranojnë familjen e gjuhëve *khoisan* si një familje gjuhësore më vete, e përbërë nga 5 degë :

1. **Dega e gjuhëve *hadza***, që përfshin vetëm një gjuhë të izoluar (gjuhën *hadza*), e cila flitet nga më pak se 1 mijë njerëz përgjatë brigjeve të liqenit Ejasi, në Tanzani. Pavarësisht numrit të vogël të folësve, përdorimi i kësaj gjuhe është mjaft intensiv. Gjuha *hadza* tradicionalisht është klasifikuar në familjen e gjuhëve *khoisan*, së bashku me fqinjen e saj *sandave*, nisur nga fakti se të dyja këto gjuhë kanë në përdorim bashkëtingëlloret kliko. Megjithatë gjuhëtarët kanë vërejtur se gjuha *hadza* në pikëpamje gjenetike paraqet shumë pak ose aspak afri me gjuhën *sandave* ose me gjuhë të tjera *khoisane* (lidhjet mes tyre janë kaq të pakta saqë mund të jenë edhe rastësore). Gjithashtu ata kanë vërejtur edhe se populli *hadza* nuk ka ndonjë lidhje me popujt *khoisan* të Afrikës Jugore. Afritë më të mëdha ato duhet t'i kenë me pigmenët<sup>243</sup> e Afrikës qendrore.
2. **Dega e gjuhëve *sandave*** përbëhet vetëm nga gjuha *sandave*, e cila është një gjuhë tonale e folur nga rreth 40 mijë njerëz në rajonin Dodoma të Tanzanisë. Edhe sot e kësaj dite përdorimi i kësaj gjuhe është mjaft i gjallë dhe intensiv në mesin e të rriturve dhe të fëmijëve, të cilët në shumë raste janë njëgjuhësh. Që nga studiuesi Albert Drexel (në vitet 1920) e këtej, gjuha *sandave* përgjithësisht është klasifikuar si gjuhë që i përket familjes *khoisan* (nisur nga prania e klikove në këtë gjuhë). Studimet e fundit (Güldemann<sup>244</sup>) kanë treguar se gjuha *sandave* është më tepër e lidhur me degën *khoekvadi*, se sa me gjuhët *hadza* apo me gjuhët e tjera të familjes. Kjo gjuhë ka dy dialekte, *sandave veriperëndimore* dhe *sandave juglindore*. Dallimet mes tyre nuk janë të mëdha dhe mbështeten kryesisht në disa elemente jothelbësore, si: shpejtësia në të folur, rënia e

<sup>243</sup> *Pigmenët* - është një term i përdorur për grupe të ndryshme etnike në mbarë botën që karakterizohen nga një shtatlartësi e vogël (me lartësi mesatare 150 cm). Pigmenët e Afrikës janë disa fise (tribu) gjuetarësh, ku ndër më të njohurit janë fiset Aka, Efe dhe Mbuti në Afrikën qendrore.

<sup>244</sup> Tom Güldemann dhe Edward D. Elderkin (forthcoming) 'On external genealogical relationships of the Khoe family.' In Brenzinger, Matthias and Christa König (eds.), *Khoisan languages and linguistics: the Riezler symposium 2003*. Quellen zur Khoisan-Forschung 17. Köln: Rüdiger Köppe, f. 31.

zanoreve, prania e disa fjalëve tabu karakteristike për secilin dialekt, si dhe disa dallime të vogla leksikore e gramatikore.

3. **Dega e gjuhëve *kvadi-khoe*** është një nga degët me numrin më të madh të folësve dhe me shumëllojshmërinë më të madhe të gjuhëve që e përbëjnë, me më shumë se një çerek milioni folës dhe me shtatë gjuhë të gjalla. Për gjuhët e këtij grupi kemi pak të dhëna në dispozicion (për mungesë dokumentimi), kështu që rikonstrukcioni i *proto-kvadi-khoes* është realizuar pjesërisht (vetëm për sistemin përemëror dhe disa pjesë të fjalorit themelor). Është vërejtur se ky grup gjuhësor paraqet afri sidomos me gjuhën *sandave* (kryesisht në sistemin përemëror), ndonëse lidhjet gjenetike mes tyre janë të dyshimta. Dijetarët mendojnë se kjo degë përbëhet nga dy grupe (*kvadi* dhe *khoe*), ndonëse lidhja ndërmjet tyre nuk është pranuar nga të gjithë. Nisur nga afritë në sistemin përemëror dhe në disa pjesë të leksikut themelor, këto gjuhë janë bashkuar në të njëjtën degë të quajtur *kvadi – khoe*.
- a. Grupi i gjuhëve ***kvadi***, i cili përbëhet vetëm nga një gjuhë e shuar, gjuha *kvadi* e Angolës.
  - b. Grupi i gjuhëve ***khoe***, që është grupi më i madh i gjuhëve indigjene të Afrikës jugore (emërtuar edhe me termin dega *khoisane qendrore*). Gjuhët e këtij grupi ishin gjuhët e para *khoisan* të njohura nga kolonizatorët evropianë, të shquara sidomos për praninë e bashkëtingëlloreve klike. Dallohen dy nëngrupe kryesore :
    - nëngrupi i gjuhëve *khoekhoe*, që përbëhet nga :
      - ✓ gjuha *námá* (termi etnik, por njihet ndryshe edhe si *khoekhoegovab* ose *hottentot*), një gjuhë e përdorur nga rreth 270 mijë folës në Namibi (ku është gjuhë kombëtare), Botsvana dhe në Afrikën e Jugut;
      - ✓ gjuha *eini*, një gjuhë e shuar e Agrikës së Jugut;
      - ✓ gjuha *korana*, një gjuhë thuajse e shuar (me vetëm 6 folës gjithsej) e Afrikës së Jugut e me shumë mundësi edhe e Botsvanës;
      - ✓ gjuha *ksiri*, një gjuhë e rrezikuar seriozisht dhe drejt zhdukjes, me rreth 90 folës në Afrikën e Jugut e kohë më parë e folur edhe në Namibi;
    - nëngrupi i gjuhëve *tshu-khve* (ndryshe edhe *kalahari*), shumica e të cilave i kanë humbur pjesërisht bashkëtingëlloret klike, si :
      - ✓ gjuha *shua* (me rreth 6 mijë folës në Botsvana);
      - ✓ gjuha *tsoa* (me rreth 7 300 folës në Botsvana dhe në Zimbabve);

- ✓ gjuha *khve* (ndryshe edhe *kxoe*, me rreth 11 mijë folës në Namibi, Angolë, Botsvanë, Afrikën e Jugut dhe më pak në Zambia);
- ✓ gjuha *naro* (me rreth 14 mijë folës në Botsvana dhe në Namibi);
- ✓ gjuha *gllana-glvi* (me rreth 4 500 folës në Botsvana);
- ✓ gjuha *haba* (një gjuhë e rrezikuar e Botsvanës, e përdorur nga pak folës).

Me përjashtim të gjuhës *nà má*, të gjitha gjuhët e tjera të këtij grupi janë nën presionin e gjuhëve kombëtare apo dialekteve rajonale të vendeve përkatëse, duke u rrezikuar për t'u zhdukur. Gjuha *nà má* është një nga gjuhët me folësit më të shumtë.

- 4. Dega e gjuhëve *tuu*** (e njohur edhe si *kvi*, *ta kvi* etj.), që përbëhet nga dy grupe gjuhësh të lidhur ngusht njëri me tjetrin. Ata janë tipologjikisht shumë të ngjashëm me gjuhët e degës *juu-+hoan*, ndonëse studiuesit nuk kanë vërejtur ndonjë lidhje gjenealogjike ndërmjet tyre. Kjo degë gjuhësore përbëhet nga dy grupe :
- a. Grupi i gjuhëve *taa*, që përfshin gjuhën *!xóǀ* (me rreth 4 200 folës në Botsvana dhe në Namibi) dhe *nossobi i ulēt* (gjuhë e shuar e folur kohë më parë në Afrikën e Jugut dhe në Botsvana);
  - b. Grupi i gjuhëve *!kvi*, që përfshin disa gjuhë të folura në Afrikën e Jugut, si : gjuhën *nǀng* (një gjuhë e rrezikuar për t'u zhdukur, me vetëm 8 folës) dhe gjuhët e shuara *ǀxam*, *+ungkue* dhe *ǀxegvi*.
- 5. Dega e gjuhëve gjuhëve *juu-+hoan***, që është një degë e re, e cila paraqet vetëm disa marrëdhënie të largëta afrie me grupet e tjera të familjes *khoisan*. Kohët e fundit nga ana e studiuesve është pranuar gjithnjë e më shumë përfshirja e kësaj dege në këtë familje gjuhësore. Ajo përbëhet nga dy gjuhë : nga gjuha *+hǀǎ* (një gjuhë e rrezikuar për t'u zhdukur, me rreth 200 folës në Botsvana) dhe gjuha *juu* (e njohur ndryshe edhe si *!kung*, me rreth 45 mijë folës në Namibi, Botsvanë, Angolë dhe në Afrikën e Jugut).



**BIBLIOGRAFI:**

1. **Anthony Traill (1986)**, "Do the Khoi have a place in the San? New data on Khoisan linguistic relationships." In *African Hunter-gatherers* (international symposium), Franz Rottland and Rainer Vossen., *Sprache und Geschichte in Afrika*, special issue 7.1. Hamburg: Helmut Buske Verlag, f.407-430.
2. **A. Barnard (1988)**, "Kinship, language and production: a conjectural history of Khoisan social structure", *Africa: Journal of the International African Institute* **58** (1), f. 29-50.
3. **Bonny Sands (1998)**, *Eastern and Southern African Khoisan: Evaluating Claims of Distant Linguistic Relationships*. Rüdiger Köppe Verlag, Cologne.
4. **Bonny Sands (1998)**, "Comparison and classification of Khoisan languages." In *Language History and Linguistic Description in Africa*, edited by Ian Maddieson and Thomas J. Hinnebusch, Trenton: Africa World Press. f. 75-85.
5. **Christopher Ehret, (1986)**. "Proposals on Khoisan reconstruction." In *African Hunter-Gatherers* (international symposium), edited by Franz Rottland Rainer Vossen, *Sprache und Geschichte in Afrika*, special issue 7.1. Hamburg: Helmut Buske Verlag, f. 105-130.
6. **Christopher Ehret (2003)**. "*Toward reconstructing Proto-South Khoisan*" In *Mother Tongue*, f. 8.
7. **Ernst Oswald Johannes Westphal (1971)**. "The click languages of Southern and Eastern Africa." In *Current Trends in Linguistics, Volume 7: Linguistics in Sub-Saharan Africa*, edited by T.A. Sebeok. Berlin: Mouton, f. 367–420.
8. **George Starostin (2003)**, "[A lexicostatistical approach towards reconstructing Proto-Khoisan.](#)" (Originally published in *Mother Tongue* vol. VIII), f. 81-126.
9. **George Starostin (2008)**, "[From modern Khoisan languages to Proto-Khoisan: The value of intermediate reconstructions.](#)" (Originally published in *Aspects of Comparative Linguistics* 3 (2008), Moscow: RSUH Publishers), f. 337-470.
10. **Gerrit Dimmendaal (2008)**, "Language Ecology and Linguistic Diversity on the African Continent", in *Language and Linguistics Compass* 2/5.

11. **Henry Honken (1988)**, "Phonetic correspondences among Khoisan affricates." In *New Perspectives on the Study of Khoisan*, edited by Rainer Vossen, *Quellen zur Khoisan-Forschung* 7. Hamburg: Helmut Buske Verlag, 1988, f. 47-65.
12. **Henry Honken (1998)**, "Types of sound correspondence patterns in Khoisan languages." In *Language, Identity and Conceptualization among the Khoisan*, edited by Mathias Schladt, *Quellen zur Khoisan-Forschung/Research in Khoisan studies* 15. Köln: Rüdiger Köppe Verlag, f. 171-193.
13. **Tom Güldemann & Edward D. Elderkin (forthcoming)** 'On external genealogical relationships of the Khoe family.' In Brenzinger, Matthias and Christa König (eds.), *Khoisan languages and linguistics: the Riezlern symposium 2003*. *Quellen zur Khoisan-Forschung* 17. Köln: Rüdiger Köppe.

### **SUMMARY**

The **Khoisan** languages (also known as the **Khoesan** or **Khoesaa**n languages) include languages that are spoken in eastern and southern Africa. Click languages are included in this family and they are distinctive only in the Khoisan family. This family is composed of about 25 languages. Most of these languages are considered as dead languages or are endangered as most of them have no written record.

**Khoisan family** was first proposed by the researcher Johan Greenberg (in his classification in 1949 - 1954, and edited in 1963) as one of the four language families spoken in Africa. This family has 5 branches:

- **Hadza** branch includes only one isolated language (*Hadza language*). This branch is spoken by about 1000 speakers in Tanzania.
- **Sandawe** branch is composed only by the *Sandawe language* with about 40 000 speakers in Tanzania.
- **Kvadi-khoe** branch has the biggest number of the speakers with a diversity of languages. This family has about 250 000 speakers with seven active languages that are spoken in Angola, Namibia, Botswana, Zimbabwe and South Africa.

- ***Tuu branch*** is composed of six spoken languages in Namibia, Botswana and South Africa. From these six languages only one is still being spoken the others are considered as dead languages.
- ***Juu - hoan*** branch is a new branch. It shows a limited relation with other groups of *Khoisan family*. It is composed of two spoken languages in Namibia, Botswana, Angola and South Africa. One of these languages is almost extinct.

Evalda PACI

## DISA VEÇORI GJUHËSORE DHE TEKSTOLOGJIKE NË MESHARIN E GJON BUZUKUT (VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM)

*Meshari* i Gjon Buzukut përbën dhe sot e kësaj dite një ekzemplar të historishkrimin të shqipes. Ai bëhet objekt diskutimi veçanërisht në fillim të shekullit të kaluar pas rizbulimit të tij nga Imzot P.Schirò.<sup>245</sup>

Studimi i përmbajtjes dhe i ndërtimit të teksteve të librit mbetet një argument i rëndësishëm për studiuesit e letërsisë së vjetër shqipe. Libri i Buzukut do parë me objektivitet edhe në pikëpamje të teksteve që përmbahen në të. Mungesa e faqeve të para si dhe e të dhënave që orientojnë drejt një titulli të mundshëm apo qëllimit të botimit të kësaj vepre vështirëson në njëfarë mënyre sqarimin e disa çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe strukturimin e librit në fjalë.

Duke pasur parasysh faktin që libri përmban në pjesën më të madhe pjesë nga një Meshar roman, në të nuk përmbahet mbarë Bibla apo të gjitha tekstet ekzistuese katekistike.<sup>246</sup> Mjaft pjesë nga Ungjilli nuk janë sjellë të

<sup>245</sup> Çabej E., *Meshari*, Tiranë, 1968, *Hyrje, Historia e librit dhe lënda e tij*, f.7: Peshkopi i Arbëreshvet të Siqelisë Imzot Pal Skirò, gjurmues e studiues i teksteve të vjetra të shqipes (1866-1941), që në vitet e para të këtij shekulli iu vu gjurmimit të kësaj vepre në Bibliotekën Vatikane. Kërkimevet që u bënë atje u detyrohet që më 1909 u gjet kjo më në fund n'atë qendër studimesh.

<sup>246</sup>Për dallimin e pjesëve të veprës shih edhe Çabej E., *Meshari*, Tiranë, 1968, *Hyrje, Historia e librit dhe lënda e tij*, f.9: Për sa i takon lëndës së veprës, këtu mungesa e frontespicit (ose e fletës së fundit) na lë t'errët në punën se cili ka qenë titulli i kësaj. Me gjithë këtë mungesë shihet mirëfilli se kjo në pjesën e saj më të madhen, e pikërisht që nga fleta XXX e gjer në fund, është një meshar. Pjesa e parë dhe më e vogla e librit, që shkon gjer në fletën XXX, e që siç e pamë, është e mangët në disa vende, përmban Oficen e vogël të Zojës, të Shtatë Psalmet e penesës (Septem psalmi penitentiales), Litanitë e shenjtet (Litanitë e mëdha, Letanie), pastaj Suffragia, deprecium, Cathecuminum exorcismorum (Decem praecepta Dei, de Septem operibus misericordiae, Duodecim articuli fidei), Exorcista cathecuminum. Kështu pra këtu kemi të bëjmë me pjesë që gjinden zakonisht në një Breviarium romanum e që përbëjnë elementet e një horologji; pastaj me copa të katekizmit, e përta u përket pjesëve që flasin për pagëzim e për unazë, me copa të ritualit. Këtu në faqet që mungojnë do të ketë qenë vijimi e mbarimi i kësaj pjesë të veprës që vjen para mesharit. Sikundër shihet, kemi të përmbledhura një pjesë të

plota apo janë këputur pikërisht kur duhej të vazhdonin në mënyrë që të jepej përfundimisht mesazhi i njërës apo i tjetrës pjesë biblike.<sup>247</sup> Këto fakte tërheqin vëmendjen në drejtim të një studimi të vëmendshëm në pikëpamje tekstologjike të kësaj vepre.

Mbizotëron në gjuhën e Buzukut asocimi i formave gramatikore të fjalëve të cilat bëjnë pjesë në të njëjtën familje fjalësh. Në këtë vepër gjenden mjaft shembuj të tillë:

**Mbë *kullosa*** të mira u t i ***kullos***, e **mbë** malet të nalta të Israelit të jetë ***kullosa*** e tyne; e aty të pushonjënë **mbë *kullosa*** të mira, e të ***kullosënë kullosë*** të majme përmbi malt të Israelit. U të kullos dhentë e mī, e u t i banj të pushonjënë, thotë ***Zoti*** qi ***zotënon***.<sup>248</sup>

***In pascuis*** uberrimis ***pascam*** eas, et in montibus excelsis Israhel erunt ***pascuae*** eorum; ibi requiescent in herbis virentibus et ***in pascuis*** pinguibus ***pascuntur*** super montes Israhel. Ego ***pascam*** oves meas et ego eas accubare faciam, dicit Dominus Deus.<sup>249</sup>

Kështu gjenden të pranëvëna edhe përdorime emërore, më saktë mbiemra të emëruar që në pikëpamje semantike i kundërvihen njëri-tjetrit. Kjo pranëvënie nuk mund të jetë e rastësishme. Një përdorim i tillë i të emëruarve në këndvështrimin e studiuesit të sotëm përbën patjetër vlerë stilistikore të ***gjuhës së librit*** së Buzukut:

Të pritunitë e ***t dërejtëvet*** anshtë gazëmend, e shpënesa e ***bākëqivet*** të vdesë. Fuqia e ***t pākeqit*** anshtë udha e Tinëzot; e n̄mner atyne qi banjënë keq. ***I dërejt*** të mos vëlizetë për jetë të jetësë, e ***bākëqitë*** të mos jesënë ndë dhët. Goja e ***t dërejtët*** piell urtënë, e gluha e ***bākëqivet*** të vdesë. Buzëtë e ***t dërejtët*** të kujtonjënë kafshë ***të pëlqyeme***, e goja e ***bākëqivet*** kafshë ***t këqia***.<sup>250</sup> ***Të pākeqtë*** e ***t dërejtëvet*** ata ***të ndëreqnjë***, e ***të n̄gënyemitë e***

---

e teksteve që janë të nevojës së përditshme për meshtarin në ushtrim të shërbimevet fetare.

<sup>247</sup> Në këtë drejtim duhet patur parasysh edhe që një libër meshësh, siç synon të jetë kryesisht ky libër i Gjon Buzukut, nuk mund të përmbajë të gjitha pjesët biblike të mundshme. Gjithsesi, përmbajtja e këtyre pjesëve, raporti i tyre me pjesët e tjera të veprës, siç janë lutjet e caktuara që shoqërojnë paraqitjen e çdo pjesë nga Ungjijtë, impostimi i këtyre pjesëve qoftë në raport me njëra-tjetrën, qoftë në brendi të vetë veprës si e tërë, duhet vërejtur me kujdes e vëmendje të veçantë. Nuk kanë munguar gjithsesi studimet që kanë dalluar dhe evidentuar edhe ndryshimet përkatëse në pikëpamje kryesisht gjuhësore midis pjesëve të sipërpërmendura.

<sup>248</sup> Meshari, Tiranë, 1968, f.123/a.

<sup>249</sup> Hiezechiel propheta, 34, 14-15.

<sup>250</sup> Kundërvënien semantike e vërejmë edhe midis mbiemrit ***e pëlqyeme*** dhe shumësit të mbiemrit ***t këqia***.

*bākëqivet* ata *të shkatëronjë*.<sup>251</sup> *E dërejta* e *t dërejtëvet* ata të shpëtonjë, e *bākëqitë* të jenë zanë nde e këqiat të tyne. *I dërejt* anshtë shpëtuom ̄ sē idhuni, e *bākeqi* të jetë dhanë për të. *Kujtuokeqi* ̄gēnjen miknē e tī me gojēt, e *tē dërejtētē* të jenë shpëtuom ̄ urtet.<sup>252</sup> Nde e mirat *tē dërejtëvet* të gēzonetē qytetja, e për të bdjerēt *tē t bākëqivet* të jetë lavd. Nde e bekuomit *tē t dërejtëvet* të jetë madhēshtuom qytetja.<sup>253</sup>

Expectatio *iustorum* laetitia spes autem *impiorum* peribit. Fortitudo *simplicis* via Domini et pavor his qui operantur malum. *Iustus* in aeternum non commovebitur; *impiū* autem non habitabunt in terram. Os *iusti* parturiet sapientiam; lingua *pravorum* peribit. Labia *iusti* considerant placita et os *impiorum* perversa. Simplicitas *iustorum* diriget eos et subplantatio *perversorum* vastabit illos. Non proderunt divitiae in die ultionis. *Iustitia* autem liberabit a morte, *iustitia simplicis* diriget viam eius et in *impietate* sua corruet *impius*. *Iustitia rectorum* liberabit eos et in insidiis suis capientur *iniqui*. *Iustus* de angustia liberatus est et tradetur impius pro eo. Simulator ore decipit amicum suum, *iusti* autem liberabuntur scientia. In bonis *iustorum* exultabit civitas et in perditione *impiorum* erit laudatio. Benedictione *iustorum* exaltabitur, civitas et ore *impiorum* subvertetur.<sup>254</sup>

Lidhje semantike apo edhe fjalëformuese midis fjalëve të të njëjtit tekst në librin e Buzukut ndeshim edhe në mjaft raste të tjera:

*I urti* të lypnjē *urtēnē*<sup>255</sup> e t parēvet, e të studionjë të thashunatē e profetēvet. E aj të mbae *fjalētē e fola* të nierēzet qi kanë emēnē, e mbe e kthyenēt të *fjalēvet* për të ̄digluom, qi ata thashunē kanë, aj të hinjë.<sup>256</sup>

*Sapientiam* omnium antiquorum exquiret et in prophetiis vacabit. *Narrationem* virorum nominatorum conservabit et in versutias *parabolarum* simul introibit.<sup>257</sup>

Të tilla lidhje krijohen dhe midis fjalëve që kanë origjinē latino-romane. I tillē ēshtë rasti i pērdorimit të fjalëve *adoroj*, *adorator* në tekstin e mēposhtēm:

<sup>251</sup> Kundērvēnie kuptimore vērehet edhe midis foljeve pērkatēse: *̄dēreq* dhe *shkatēronj*, kēshtu edhe midis emrave të paranyjēzuar *tē pākeqtē* dhe *tē ̄gēnjemitē*.

<sup>252</sup> Edhe në këtë fjali *kujtuokeqi* i kundērvihet *tē dërejtīt*, kallēzorja parafjalore *me gojēt* i kundērvihet rrjedhores *̄ urtet*.

<sup>253</sup> *Meshari*, Tiranē, 1968, f.365/b.

<sup>254</sup> *Liber Proverbiorum*, 10, 28-32; 11, 3, 6; 8-11.

<sup>255</sup> *Urta(urtēsi)* si emēr pērdoret edhe në të tjera raste në librin e Buzukut. Ndesht emri *urtē* edhe në shembullin e mēposhtēm, gjithnjē te *Meshari*, f.167/a: E qitnē mbanē *urtēnē* e tyne, e zunē poshtë sȳtē e tyne ata mos shohēnē qielltē, e gjyqitē ma mos u bjerē ̄ndē mend, as e dērejta.

<sup>256</sup> *Meshari*, Tiranē, 1968, f.365/b.

<sup>257</sup> *Liberi Iesu filii Sirach seu Ecclesiasticus*, 39, 1-2.

E Jezu i tha: Gruo, ki besë muo, se ka me ardhunë hera qi as mbë këtë mal, as m Jeruzalem ju të **adoroni** Atënë. Ju **adoroni** atë qi ju nukë dini; e na **adorojmë** atë qi na e dimë, përse të shelbuomitë në Xhudhishit anshtë. Ma kã me ardhunë një herë, e tash anshtë, qi të vërtetë **adoratorë të adoronjënë** Atënë ndë shpirt e nde e dërejhtë. Përse Ati ata lypën qi ashtu ta **adoronjënë**. Zotynë anshtë shpirt, e ata qi **të adoronjënë**, ndë shpirt duhetë e nde e vërtetë me **e adoruom**.<sup>258</sup>

Dicit ei Iesus: mulier, crede mihi, quia veniat hora quando neque in monte hoc neque in Hierosolymis **adorabitis** Patrem. Vos **adoratis** quod nescitis, nos **adoramus** quod scimus, quia salus ex Iudaeis est. Sed venit hora et nunc est quando veri **adoratores adorabunt** Patrem in spiritu et veritate, nam et Pater tales quaerit qui **adorent** eum. Spiritus est Deus et eos qui **adorant** eum in spiritu et veritate oportet **adorare**.<sup>259</sup>

Kështu gjenden të pranëvendosura edhe fjalë të cilat kanë kuptim të kundërt midis tyre, si në tekstin e mëposhtëm:

Gluha **e urtëvet** mbukuron të ditunitë, goja e **t këmbyemet** qet jashtë këmbenjinë. Shtë e Tinëzot shohënë **të dërejhtë e të pādërejhtë**. Gluha **e përvutë** anshtë drutë e gjellësë, **e pākora** nrvret shpirtinë. Shtëpia e **t dërejhtë** anshtë e madhe forcë ndë frujtit, **e bākeqit** anshtë të madh të trazuom. Ndë buzat **të urtëvet** të jetë mbjellë **urta**, e zemëratë e **t këmbyemet** të jenë përdām anso shembëllese. Sakrificiatë **e bākëqivet** janë nde e deshpepqem Tinëzot, e kushtimetë **e dërejhtëvet** nde e pëlqem. E kush ndjek të dërejhtënë, anshtë dashunë në Sinëzot.<sup>260</sup>

Lingua **sapientium** ornat scientiam os **fatuorum** ebulit stultitiam. In omni loco oculi Domini contemplantur **malos** et **bonos**. Lingua **placabilis** lignum vitae quae **immoderata** est conteret spiritum. Domus **iusti** plurima fortitudo et in fructibus **impü** conturbatur. Labia **sapientium** disseminabunt scientiam, cor **stultorum** dissimile erit. Victimae **impiorum** abominabiles Domino vota **iustorum** placabilia. Abominatio est Domino via **impü**. Qui sequitur iustitiam diligetur ab eo.<sup>261</sup>

Pjesë të rëndësishme të librit të Buzukut mbeten gjithashtu lutjet që ndjekin pjesët biblike të përkthyer në shqip. Në këto lutje bie në sy denduria e madhe e përdorimit të emrave të paranyjëzuar, kryesisht asnjës, por edhe femërorë, si dhe përdorimi i fjalëve kryesisht me origjinë latine apo latino-

<sup>258</sup> Meshari, Tiranë, 1968, f.163/a.

<sup>259</sup> *Evangelium secundum Iohannem*, 4, 21-24.

<sup>260</sup> Meshari, Tiranë, 1968, f.363/a-b.

<sup>261</sup> *Liber proverbiorum*, 15, 2-4; 6-9.

romane. Këto fakte provohen nga shqyrtimi i mjaft copëzave të tilla që përmbahen në të:

Oratio post communionem

**Sakramentatë** qi na përzanë kemi, o Zot ynë Zot, **q** **alimentashit** së shpirtit na **mbushinë** e **ndimashit** **së korpit** në na defendoftë. Për tenë Zonë Jezu Krishtnë Birë tand.<sup>262</sup>

Në këto lutje gjenden të pranëvëna edhe trajta emrash veprimi (*nomina agentis*), të cilët ruajnë gjithashtu rrënjën foljore prej nga edhe vijnë:

Oratio supra populum

Ë popullit sit, o **ordhënuos** e **governuos**, katetë e atyne q sish hiq, përse tÿ përherë të jenë nde e pëlqyem, e q së rujtunit sit përherë ata me klenë **segÿr**. Për tenë Zonë Jezu Krishtnë Birë tand.<sup>263</sup>

Në lutje të tilla mund të gjurmohet ndër të tjera edhe tipologjia e emrave që përdor Buzuku, alternimi i emrit të paranyjëzuar prejfoljor asnjans me emra prejfoljorë që marrin prapashtesën –*im*:

Oratio

O Zot, qi e Juda q katit së tÿ **mundimnë**<sup>264</sup> pësoi, e kusari pagëtyrënë e **t rëfyemit** tÿ përzÿ, neve hir në ban **q së afëruomit** sit na me pasunë **të bamëtë**, porsi Jezu Krishti ynë Zot ndë passionët të tÿ dyve ua bani si issillido meritoi pagëtyrënë, ashtu edhe q nesh hjektë gjithë të pëligje q zakonit plak, e **q së ngjallunit** së tÿ hirë na qfaltë. Për Tenëzonë.<sup>265</sup>

Në drejtim të përdorimeve të caktuara që gjenden në vepër duhen vërejtur thënie apo ndërtime tipike, të cilat Buzuku nuk i ka përkthyer nga latinishtja, por i ka ruajtur ashtu siç thuheshin a përdreshin në **tekstet** përkatëse që ai mund të ketë konsultuar. Kështu, në krye të kapitujve apo paragrafeve përkatëse do të gjejmë titujt përkatës:

*Ad laudes, Ad tertiam, Ad sextam, Ad nonam, Ad vespervas, Ad completorium, Ad primam completorii, In aduentu, Septem Psalmi penitentiales, Letanie* etj.

Ndërkohë, edhe në përbërje të këtyre pjesëve të sipërshënuara Buzuku ka ruajtur terminologjinë latine. Këta terma specifike përdoren si emra

<sup>262</sup> Meshari, Tiranë, 1968, f.179/a.

<sup>263</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.181/a.

<sup>264</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.217/a: Këqyrë, tÿ të lusmë, Zot, përmbi këtë fëmijë tande, qi Jezu Krishti ynë Zot nukë ju mat me klenë tradhëtuom ndër duor të t përkatënuomet, e mbë kryqt me bartunë **mundimetë**.

<sup>265</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.217/a-b.



femërorë ashtu siç janë edhe në latinisht si: *Komemoraciona*<sup>266</sup>, *pasiona*<sup>267</sup>, *lekcionia*<sup>268</sup> etj.

Gjithashtu rrënjët latine janë ruajtur qoftë edhe pjesërisht në titujt e Psalmeve në këtë vepër. Titujt përkatës që jepen në libër janë: *Psalmi kondra superbijesë*;<sup>269</sup> *Psalmus kondra golësë*;<sup>270</sup> *Psalmus contra luxuriam*;<sup>271</sup> *Psalmus condra invidiam*;<sup>272</sup> *Psalmus contra mënisë*;<sup>273</sup> *Psalmus condra Iram*.<sup>274</sup>

Veçori të qenësishme gjuhësore të veprës gjurmohen pikërisht në *Litanitë e shenjtërve*.<sup>275</sup>

Në litanitë e përmbajtura në librin e Buzukut, përdorimi i mbiemrit alternohet me atë të mbiemrit të emëruar. Kjo gjë ilustron në shembujt e mëposhtëm:

Ë gjithë **së keqi**, neve na shpëto, Zot./Ë gjithë kati, largona neve, Zot./Ë mëniet sote, largona neve, Zot./Ë **së këqiashit** së dreqit, largona neve, Zot.

Në drejtim të tekstit të litanive në librin e Buzukut (në vepër shënohet *Letanie*)<sup>276</sup> do të vërenim ndër të tjera edhe përdorimin e njëpasnjëshëm të emrave asnjans të paranyjzuar, kryesisht asnjans prejfoljorë, por edhe prejmbiemërorë, të alternuar gjithashtu me emra foljorë të formuar me ndonjë prapashtesë siç është edhe prapashtesa *-im*:

**Për të zanët** qi ti u zune ñ shenë Mëriet, largona neve, Zot, së keq./Për **t ardhunit** qi ti u dorgje ñ qiellshit, largona neve, Zot, së keq./**Për të lenët** qi

<sup>266</sup>Shih *Komemoraciona e gjithë Shenjtet*, në *Meshari*, Tiranë, 1968, f.37/a; *Komemoraciona e Shenjtet*, f.39/a; *Komemoraciona e gjithë Shenjtet*, f.39/b; f.41/a etj.

<sup>267</sup>*Meshari*, Tiranë, 1968, f.221: *Passiona e tinë Zot Jezu Krishtit pors shkrou Gjoni. Capitulo XVIII. Këtë emër e gjejmë të përdorur edhe në kallëzore parafjalore në ndërtimin pors Jezu Krishti ynë Zot ndë passionët të tË dyve ua bani si issillido meritoi pagëtyrënë.. (Meshari, Tiranë, 1968, f.217/b.)*

<sup>268</sup>*Meshari*, Tiranë, 1968, f. 33/a,b. Ndeshim gjithashtu në hyrje të pjesëve të caktuara emrin *lectio* ashtu siç është në gjuhën latine: *Meshari*, Tiranë, 1968, f. 227/a: *Lectio libri Genesis Capitulo I (Lexim i librit të Zanafillës, kapitulli I)*.

<sup>269</sup>*Meshari*, Tiranë, 1968, f.43/a.

<sup>270</sup>*Meshari*, botim kritik i cituar, f.43/b.

<sup>271</sup>*Meshari*, botim kritik i cituar, f.45/a.

<sup>272</sup>*Meshari*, botim kritik i cituar, f.45/b.

<sup>273</sup>*Meshari*, botim kritik i cituar, f.47/a.

<sup>274</sup>*Meshari*, botim kritik i cituar, f.47/b. Të vihen re edhe parregullsitë në këta tituj psalmesh: Buzuku përdor herë trajtën *Psalmi* dhe herë *Psalmus*. Gjithashtu përdor edhe fjalën shqipe (*mënisë*) edhe fjalën latine: *iram*, *luxuriam*, *invidiam*. Disa fjalë të tjera pastaj i përshtat sipas strukturave të shqipes, duke mos i ndryshuar rrënjën latine apo latino-romane: *superbijesë*, *golësë* etj.

<sup>275</sup>*Meshari*, botim kritik i cituar, f. 49-53.

<sup>276</sup>*Meshari*, botim kritik i cituar, f. 49-53.

ti leve, largona neve, Zot, së keq./Për bagmit e *për ngjënimt* tand, largona neve, Zot, së keq./Për kryqt e mundime të tū, largona neve, Zot, së keq./Për mort e për vort tat, largona neve, Zot, së keq./*Për të ngjallunit* tat, largona neve, Zot, së keq./*Për të madhtë* të t shelbuomit tit, largona neve, Zot, së keq./*Për t ardhunit* qi erdh Shpirti shenjt ̈ Rshajesh, largona neve, Zot, së keq.<sup>277</sup>

Po aty, do të ndeshim të përdorur edhe mbiemrin e emëruar *të përkatënuom*:

Na *të përkatënuomitë*, t̄y të lusmë, gjegj oratëtë tonë, Zot.<sup>278</sup>

Dhe emrat e përveçëm që përmenden në këto litani tërheqin vëmendjen në drejtim të përbërjes fonetike të tyre dhe trajtave përfaqësuese të zgjedhura nga Buzuku.

Libri i Buzukut përmban gjithashtu disa tipare gjuhësore të qenësishme të shqipes së vjetër. Të tilla tipare apo nënsisteme gjuhësore janë bërë objekt studimi dhe në punime mbi sistemin foljor<sup>279</sup> apo të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës<sup>280</sup> që përmbahen në këtë vepër. Sistemi emëror, mbiemëror dhe përemëror i veprës, sistemi foljor, çështje të sintaksës së sintagmës apo fjalisë, studimi i teksteve të ndryshme **të librit** mbeten argumente të rëndësishme që orientojnë dhe në drejtim të përvijimit të një tradite studimesh në fushë të morfologjisë historike, historishkrimit të shqipes dhe filologjisë së teksteve të vjetra shqipe.

Shpesh në librin e Buzukut ndeshen trajta foljore të cilat mund të konsiderohen se ruajnë gjurmë të të ashtuquajturit *aorist sigmatik*. Këto trajta përbëjnë një tjetër veçori gjuhësore të qenësishme në libër.

Të tilla janë format foljore të tipit *kleshë*, *u kthyeshtë*, *u dëftuoshë*, *paçë*, *mbeçë* etj.

1. Vëllazënë, u **u** banj me ditunë Ungjillë qi ̈ meje vjen predikuom, qi s ashtë pors̄i ̈ nier̄i, tue pasunë xanë ̈ nier̄i, por u **e paçë** ̈nde e dëftuom të Jezu Krishtit. Për të vërtetë ju mundë dini të klenëtë tem pors̄i **kleshë** ̈ pari, kur **jeshë** ndër Xhudh̄it, përse u p̄a kuor bdonje klishënë e Tinëzot, e keshë marë ̈ndë luftë...<sup>281</sup>

<sup>277</sup> Meshari, Tiranë, 1968, f. 51/b.

<sup>278</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f. 51/b.

<sup>279</sup> Fiedler W, *Das Albanische verbalsystem in der sprache des Gjon Buzuku (1555)*, Prishtinë, 2004.

<sup>280</sup> Kore-Karagjozi M., *Parafrjalët në Mesharin e Gjon Buzukut* (vështrim morfosintaksor-monografi), Tiranë, 2005.

<sup>281</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.333/a.

Notum enim vobis facio, fratres, evangelium, quod evangelizatum est a me, quia non est secundum hominem. Neque enim ego ab homine accepi illud neque didici, sed per revelationem Iesu Christi. Audisti enim conversationem meam aliquando in Iudaismo, quoniam supra modum persequabar ecclesiam Dei et expugnabam illam.<sup>282</sup>

2. E kur pëlqeu atë që muo më dau një barkut së mamësë sime, e muo më grishi për hirit së t'i, përse ai të dëfton Birë e vet një muo, përse u atë ta predikonje përpara gjindës, e u nukë *u dëftuoshë* një mish e një gjak atë ças, as *u kthyeshë* m Jeruzalem tek ata që parë muo klenë Apostoj; por vojta një Arabit, e përparë ktheva<sup>283</sup> një Damaskut. Mbas tri vjeç *ershë* m Jeruzalem me pām Pjetërë, e *mbeçë* me të pesëmbëdhjetë ditë; e as ndonjë një Apostojshishte pae, veçëse Jakobnë të vëllanë e Tinëzot. E kafshëtë që u juvë shkruonj, hinje se përpara Tinëzot se u juve nukë u renj.<sup>284</sup>

Cum autem placuit ei qui me segregavit ex utero matris meae et vocavit per gratiam suam, ut revelaret Filium suum in me, ut evangelizarem illum in gentibus, continuo non *adquievi* carni et sanguini; neque *veni* Ierosolymam ad antecessores meos apostolos; sed abii in Arabiam et iterum reversus sum Damascum. Deinde post annos tres veni Ierosolymam videre Petrum et *mansi* apud eum diebus quindecim. Alium autem apostolorum vidi neminem, nisi Iacobum fratrem Domini. Quae autem scribo vobis, ecce coram Deo quia non mentior.<sup>285</sup>

Në lidhje me këto trajta foljore të gjendura te Buzuku, na duket me vend veçanërisht për qasja e dëshirores së përdorur nga Buzuku edhe brenda periudhës hipotetike në ndonjë rast me trajtat përkatëse në latinishten biblike, meqë kjo për qasje vë në dukje një fakt të rëndësishëm, atë të konsolidimit të këtyre formave gramatikore në shqipë që në kohën kur u shkrua **libri**.

E tha Mëria: *Madhështoftë* shpirti em Tenëzonë; e u gëzuo shpirti em m Tenëzonë e t shëlbuomit tim.<sup>286</sup>

Et ait Maria: *magnificat* anima mea Dominum et exultavit spiritus meus in Deo salutari meo.<sup>287</sup>

<sup>282</sup> *Epistula Beati Pauli Apostoli ad Galatas*, 1, 11-13.

<sup>283</sup> Krahas trajtës *kthyeshë* në këtë tekst gjejmë edhe trajtën *ktheva*.

<sup>284</sup> *Meshari*, Tiranë, 1968, f.333/a.

<sup>285</sup> *Epistula Beati Pauli Apostoli ad Galatas*, 1, 15-20.

<sup>286</sup> *Meshari, botim kritik i cituar*, f.333/b.

<sup>287</sup> *Evangelium secundum Lucam*, 1, 46-47.

Një tjetër përjasje e rëndësishme mes formave të dëshirores dhe konjunktivit latin me vlerë optative ndeshet edhe në trajtimin e kapitullit të parë të *Genesisit*:

***Kloftë bam dritë*<sup>288</sup>/lat. *Fiant luminaria.***

*Kloftë bām dritë qi zditë qielltë, qi anshtë e treta ditë; e ajo dritë daftë ditënë η natet, e klofshinë me shenjë e ndë motëna, ndë dit e ndë vjetë. E ato klofshinë për dritë nde e firmuomit të qiullet, me bām dritë përmbi dhët.*<sup>289</sup>

*Fiant luminaria in firmamento caeli ut dividant diem ac noctem et sint in signa et tempora et dies et annos ut luceant in firmamento caeli et inluminent terram.*<sup>290</sup><sup>33</sup>

Edhe në përdorimet e mëposhtme gjejmë ndërtime me rasa të zhdrejta (*oblike*) si në shqipen e Buzukut, si në latinishten biblike:

E aj tue thirë thā: O ati Abraam, ***kā mishërier η meje***, e dërgo Laxarinë të lanjë gishtnë më të vogëlinë nd ujë, përse aj atë më refreskon gluhënë teme, përse unë *vinj munduom*<sup>291</sup> ndë këtë flakë.<sup>292</sup>

Et ait illi Abraham: pater Abraham ***miserere***<sup>293</sup> ***mei*** et mitte Lazarum ut intinguat extremum digiti sui in aqua ut refrigeret linguam meam quia crucior in hac flamma.<sup>294</sup>

Duhet vërejtur në këtë pikëpamje të shqyrtimit të foljes te Buzuku edhe trajtat e pjesores, shumica e të cilave përfundon me *-uom*, qoftë kur përdoret e veçuar, qoftë kur shoqërohet nga foljet përkatëse ndihmëse.<sup>295</sup>

Një përdorim të veçantë mendojmë se përbën pjesorja *sepelyem*, e cila ndeshet me këtë fundore në përdorime të ndryshme të saj në vepër. Në shembullin e mëposhtëm ajo është në përbërje të një forme analitike foljore me vlerë paskajoreje:

<sup>288</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.227/b.

<sup>289</sup> Meshari, Tiranë, 1968, f.227/b.

<sup>290</sup> *Liber Genesis*, 1, 14-15.

<sup>291</sup> Në variantin italisht : *io soffro terribilmente in queste fiamme.*

<sup>292</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.143/a.

<sup>293</sup> Për foljen *miserēo, misēres, miserūi, miseritum, ēre dep. – aver compassione, pietà, misericordia*, shih Calonghi G.- Badellino O., *Dizionario della lingua latina*, Torino, 1976, f.744.

<sup>294</sup> *Evangelium secundum Lucam*, 16, 24.

<sup>295</sup> Për një studim të thelluar të pjesores te Buzuku shih Lafe E., *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku*, botuar te Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21.11.1962), USHT, IHGJ, Tiranë, 1965, f.356-358.

E muor korpnë e Jezut, e pështuoll ndë lincjoj me ato aromata, porsì ish zakoni i Xhudhivet *me sepelyem*.<sup>296</sup>/Acceperunt ergo corpus Iesu et ligaverunt illud linteis cum aromatibus, sicut mos est Iudaeis *sepelire*.<sup>297</sup>

Bie në sy gjatë gjurmimit të veprës edhe larmia e formave gramatikore, kryesisht analitike, me të cilat ndërtohet koha e ardhme.

Një ndër këto ndërtime është edhe ai i përbërë nga folja *kam* dhe forma e tipit *me ardhunë*, që alternohet edhe me trajtën tjetër analitike me të cilën shprehet e ardhmja: *të+formë foljore e shtjelluar*:

Nd atë mot tha Jezu dishipujet vet: *Kanë me klenë*<sup>298</sup> shenja ndë diellët e ndë anët e ndë uijt, e mbë dhët shumë t idhunë përmbi gjint për kaqë të lëkundunë qi të lëkundetë deti në valëshit; nierëzitë *kanë me u thām* për urrenert e për të pritunitë qi *ka me ardhunë* ndërper gjithë shekullit; e atëherë gjithë fuqitë e qiellët *të vëlizenë*.<sup>299</sup> E atëherë *kanë me pām* të Birë e nierit me ardhunë ndë errët me të mujtunë të madh, e të panë.<sup>300</sup>

Et *erunt* signa in sole et luna et stellis et in terris pressura gentium prae confusione sonitus maris et fluctuum; arescentibus hominibus prae timore et expectatione quae *supervenient* universo orbi, nam virtutes caelorum *movebuntur*. Et tunc *videbunt* Filium hominis venientem in nube cum potestate magna et maiestate.<sup>301</sup>

Ndeshen gjithashtu në librin e Buzukut edhe ndërtime analitike me rend të përmbysur të kohëve të përbëra të foljes, në të cilat participi vihet para foljes ndihmëse:

1.E aj sã tha këto kafshë, ngriti zanë një gruo në shumicet, tha Jezut: Bekuom barktë ata qi ty *bartunë kã*, e sisatë qi ti *thithunë kë*.<sup>302</sup>/Factum est autem cum haec diceret, extollens vocem quaedam mulier de turba dixit illi: beatus venter qui te *portavit* et ubera quae *suxisti*.<sup>303</sup>

<sup>296</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.227/a.

<sup>297</sup> *Evangelium secundum Iohannem*, 19, 40. Shihet se edhe në tekstin latin është përdorur infiniti i së njëjtës folje.

<sup>298</sup> Forma gramatikore analitike *kanë me klenë* ka si përgjegjëse në variantin latin formën sintetike *erunt, do të jenë*, vetën e tretë shumë të së ardhmes së thjeshtë të foljes *jam*.

<sup>299</sup> Kësaj forme analitike me të cilën gjithashtu shprehet e ardhmja e thjeshtë e dëftores të Buzuku, edhe në tekstin latin ka si përgjegjëse një formë gramatikore sintetike të së ardhmes, *movebuntur*.

<sup>300</sup> Meshari, Tiranë, 1968, f. 85/a.

<sup>301</sup> *Evangelium secundum Lucam*, 21, 25-27.

<sup>302</sup> Meshari, *botim kritik i cituar*, f.153/a.

<sup>303</sup> *Evangelium secundum Lucam*, 11, 27.

2. Nd atë mot thanë farizejtë Jezut: Gjithë ato kafshë qi na *gjegjunë kemi* se janë klenë bātë ̇ teje ̇dë Kafarnaut, ban edhe këtu ̇dë botë tande.<sup>304/</sup> Quanta audivimus facta in Capharnaum, fac et hic in patria tua.<sup>305</sup>

Një problem mjaft kompleks që paraqitet para çdo studiuesi që ndërmerr studimin, shpjegimin dhe interpretimin në pikëpamje filologjike të veprës së Buzukut, është edhe çështja e ndikimit të autorit nga tekste e variante ekzistuese të *Vulgatës* e tekste liturgjike në gjuhë të tjera. Ky fakt trajtohet në studimet kritike mbi veprën (Camaj, Riza etj.), por gjurmohet në veçanti edhe në shënimet kritike me të cilat është pajisur botimi i plotë kritik i *Mesharit* (1968).

Studimi i *Mesharit* përbën dhe në ditët e sotme një orientim të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të filologjisë së tekstit në gjuhën shqipe. Nevojitet akoma një studim i pjesëve të veçanta të librit duke pasur parasysh diversitetin e dukshëm gjuhësor dhe përmbajtësor midis tyre. Një studim përqsasës me tekste të tjera pasardhëse ndihmon në përvijimin e mirëfilltë të një tradite të studimit të teksteve të vjetra shqipe si dhe në dallimin e saktë të natyrës së këtyre teksteve.

#### BIBLIOGRAFI:

1. Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, Shkodër, 1996.
2. Camaj M., *Il « Messale » di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
3. Çabej E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHSHT, n.3, 1963.
4. Çabej E., *Shqipja në kapërcyell-Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006.
5. Çabej E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
6. Jorgaqi K., *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe (XVI-XVII)*, Botime Toena, Tiranë, 2001.
7. Petrotta G., *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1931.
8. Ressuli N., *Il « Messale di Giovanni Buzuku », (riproduzione e trascrizione)*, Biblioteca Apostolica Vaticana, Romë, 1958.
9. Riza S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, botime Toena, Tiranë, 2002.
10. Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004.
11. Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P.Geuthner, Paris, 1932.
12. Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime françeskane, Shkodër, 2005.

<sup>304</sup> *Meshari*, Tiranë, 1968, f.155/a.

<sup>305</sup> *Evangelium secundum Lucam*, 4, 23.

**Linguistic characteristics and textology in the Meshari  
(Missal) of Gjon Buzuku**

***SUMMARY***

The Meshari (Missal) of Buzuku still remains one of the monuments of the Albanian language history writing and the history of the Albanian written literature. It precedes the afterward publications of the Albanian papers in this field, representing a precious collection for the vocabulary and the data offered for the studies in the field of the historical morphology and the history of the Albanian written language. In this work the verbal, noun and adjective forms as the usage of some words that are part of the same family are various and some were the study objective and were analyzed in this article.

Orjeta BAJA

**RRETH NOCIONIT *GJUHË* PËRMES *ARTIT***

Nëse arti bashkëkohor na çudit, kjo ndodh ngaqë ne kemi zakon të kërkojmë mesazhin që japin veprat e artit, të pyesim veten se çfarë ka shprehur autori, çfarë do të na thotë ai. Shumë shpesh, ky kërkim për kuptimin bëhet nëpërmjet sqarimit të asaj çfarë përfaqëson vepra. Ne e lidhim realien me kuptimin mbi të, dhe nga ky fakt, edhe kur vepra duket se nuk përfaqëson asgjë, përsëri ne mendojmë që ajo paraqet një qëllim, një gjendje shpirtërore të autorit të saj.

Kur përmendim fjalën *gjuhë* mund të nënkuptojmë çdo lloj kodi, simboli që vë në lidhje shenjat që tregojnë një bashkësi objektesh, p.sh. një hartë është një kod, ashtu siç janë kode notat muzikore dhe gjuha e zakonshme. Në *komunikimin joverbal*, lidhja mes të shenjuarit dhe shenjuesit bëhet pjesë për pjesë, p.sh., në hartë, vija e vogël blu ka domethënien e një lumi, pikat kanë domethënien e një kalimi të vështirë; në *komunikimin verbal*, kuptimi nuk gjendet tek fjalët e veçuara, por në kompozimin e tyre në fjali.

Një vepër arti është sigurisht më afër me një fjali sesa me një hartë. Prandaj, në këtë artikull, do të merremi kryesisht me strukturën e gjuhës verbale për të parë nëse mund ta rendisim artin në kategorinë e gjuhës. Të shtrosh çështjen: *rreth nocionit gjuhë përmes artit*, është të analizosh se në ç' masë mund të aplikohen konceptet kryesore që karakterizojnë gjuhën me të kuptuarit e saj në një vepër arti. Për këtë, drejtojmë pyetjen: *A mund të zbatohet konceptet që përkufizojnë gjuhën me veprën e artit?*

Edhe nëse i përgjigjemi në mënyrë pohuese kësaj pyetjeje, problemi mbetet: të kuptuarit e artit përmes kategorisë së gjuhës, a lejon që të kuptojmë atë që vërtetë përbën esencën e artit apo s'është veçse një karakteristikë dytësore e veprave, ku esenca e vërtetë qëndron krejt larg faktit të të qenit një gjuhë? Rreth kësaj çështjeje, mund të lindin edhe një sërë pyetjesh të tjera: Nëse arti është gjuhë dhe jep një mesazh, a s'është më ekonomike të kalohet direkt nëpërmjet gjuhës verbale sesa nëpërmjet veprës së artit? Apo anasjelltas, nëse nuk e kuptojmë veprën e artit në raport me mesazhin që ajo jep, si mund të përballemi me komunikimin që vendoset nëpërmjet saj: komunikimi mes artistit dhe publikut të tij,



komunikimi me spektatorët. Çfarë lloj komunikimi vendos vepra? Si e jep ajo mesazhin nëse e jep një të tillë? Në ç' masë mund t'i zbatojmë konceptet që përcaktojnë gjuhën e zakonshme me të kuptuarit e veprës së artit? A s'është sikur e lë të të ikë ajo që përbën esencën e artit nëse e konsideron veprën në modelin e gjuhës së zakonshme? Po a s'është edhe më e rrezikshme të kuptosh veprën nëpërmjet termave të gjuhës? A mund ta kuptojmë se ç'është një vepër arti përmes koncepteve që strukturojnë gjuhën e zakonshme? Çfarë sistemimesh mund t'u bëjmë këtyre koncepteve?

Pikëpyetje të tilla do të na çojnë në fund të fundit që të ripërkufizojmë nocionin e gjuhës për faktin e raportit të saj me artin:

Vepra e artit kuptohet, se asaj i përqasim një kuptim. Ajo është mbështetësja e një vajtje-ardhjeje mes një realieje dhe një kuptimi, tamam si gjuha. Fjala është një shenjë që shpreh një gjendje shpirtërore me anë të një simbolizmi. Vepra e artit gjithashtu simbolizon një gjendje të brendshme dhe e materializon atë. Duke e parë artin në aspektin e tij njohës, arti mund të hyjë në kategorinë e gjuhës. Por, mbeten për t'u analizuar diferencat specifike në mes artit dhe gjuhës së zakonshme që na shërben si pikë reference. Sipas B. Andrès dhe M. A. Bernier, *nëse arti do të ishte si gjuha e zakonshme, nëse do ta sillte në të njëjtën mënyrë një mesazh të të njëjtit tip me ato që jepen në gjuhën e zakonshme, kjo do të thoshte që e tejkalojmë simbolin për të mbërritur tek ajo çfarë ai simbolizon, pra do të ishte e njëjta gjë si në rastin kur përkthejmë kuptimin nga një gjuhë në tjetrën*<sup>306</sup>. Për artin është diçka e pamundur: nuk mund ta përkthejmë një muzikë në një pikturë. Një vepër arti nuk mund ta zëvendësojmë kurrë me kuptimin e saj. Nëse arti nuk është një gjuhë si gjuha e zakonshme, çfarë tip gjuhe është ai, nëse ende mund ta konsiderojmë si një gjuhë?

Në aspektin e tij formal, *arti dallohet nga gjuha e zakonshme*:

1 - Në gjuhën e zakonshme, shenjat janë raporti në mes një shenjuesi dhe një të shenjuari, raport arbitrar i vërtetuar nga shumica e gjuhëve. Ky arbitraritet i shenjës nuk mund të përçohet edhe në kuptimin e veprës së artit. "*Vepër arti kemi kur 'paraqitja është shpirti i pamjes'*. Raporti në mes një shpirti dhe mishërimit të tij nuk ka asgjë arbitrare – pohojnë Andrès e Bernier. Sipas tyre, *nuk mund ta shkëpusim veprën e artit nga kuptimi i saj,*

---

<sup>306</sup> B. Andrès et M. A. Bernier (dir.), *Portrait des arts, des lettres et de l'éloquence au Québec*, Québec, PUL, coll. « République des Lettres », 2002, f. 33.

*ndërsa një të shenjuar mund ta shkëpusim nga shenjuesi i tij, për ta lidhur me një tjetër shenjues kur përkthejmë një tekst nga një gjuhë në tjetrën.*<sup>307</sup>

2 - Gjuhët njerëzore karakterizohen nga artikulimi, i cili bëhet sipas rregullave gramatikore, të cilat jemi të detyruar t'i respektojmë. Rregulla të tilla janë të pamendueshme për veprën e artit. Artisti krijon rregullat e veta, poeti e kthen mbrapsht gramatikën dhe krijon fjalë..., gjë që është e pamendueshme në përdorimin e zakonshëm të gjuhës. Apoliner (Apollinaire), për shembull, refuzon rregullat e pikësimit dhe shpik një mënyrë të re shkrimi.

3 - Një kuptim gjuhësor mund ta ndajmë në njësi; ndërsa kjo është e pamundur për një vepër arti.

Kështu, vepra e artit, ashtu si gjuha, është shenjë drejt një kuptimi, por pa arbitraritetin e shenjës, pa gramatikën, pa artikulimin. Ky kuptim duhet kapur nga një receptor. Atëherë del çështja mbi *lexueshmërinë e veprës së artit dhe të gjuhës së zakonshme*. Për të dytën, kemi një fjalor: çdo fjalë ka një kuptim pak a shumë të gjerë, por të ngulitur nga përdorimi. Ekuivoku qëndron tek përjashtimi, dhe jo tek rregulli në përdorimin normal të gjuhës. Për të parën, kur marrim në shqyrtim një vepër, ajo që na bën përshtypje është hapja e saj kundrejt një mori kuptimesh. Kuptimi i gjuhës së zakonshme identifikohet relativisht shpejt, nëse folësi shprehet qartë dhe ndershmërisht. Krejt ndryshe, kuptimi i një vepre arti lë vend për interpretime të pafundme. Pra, në vepër arti, ashtu si në gjuhë, ka patjetër një kuptim, por kemi një kuptim lehtësisht të qartësuar në gjuhë dhe një kuptim të pashtershëm në vepër. Një vepër arti është një shenjë, përderisa i njihet një domethënie (edhe pse mbetet e errët), por kjo shenjë nuk ka asgjë arbitrare; ka sigurisht një lloj lexueshmërie të veprës, por ajo mbetet polisemike. A duhet ta nxjerrim kështu konkluzionin se, në se vepra është një gjuhë, është një gjuhë me nivel më të ulët e konfuze. Apo, mos na duhet të eksplorojmë një hipotezë tjetër, të kuptojmë që: ajo çka përbën identitetin e një vepre arti është pikërisht ajo çka e dallon nga gjuha.

Esenca e artit nuk mund të merret mbi modelin e gjuhës, megjithëse çdo vepër arti transmeton një mesazh dhe funksionon kështu si suport i një njohjeje. Për më tepër, arti ka një dimension estetik që nuk mund të reduktohet në një kënaqësi të thjeshtë që lidhet me aktivitetin njohës të nxjerrjes së kuptimit. Përveç kësaj, është shpesh ana enigmatike e veprës që

<sup>307</sup> B. Andrès et M. A. Bernier (dir.), *Portrait des arts, des lettres et de l'éloquence au Québec*, Québec, PUL, coll. « République des Lettres », 2002, f. 35.

na tërheq. Na duhet pra të shqyrtojmë këtë dimension estetik të veprës së artit përkundrejt dimensionit njohës të gjuhës:

Gjuha është e paimagjinueshme pa iu referuar diçkaje të jashtme: një fjalë i referohet një koncepti (i cili, gjithashtu, i referohet një kompleksi eksperiencash), një kumtim i referohet një gjendjeje të botës. Ndërsa, një vepër arti nuk shpie tek një botë e jashtme ashtu si gjuha. Arti vendos një komunikim në nivel të ndjeshmërisë dhe jo një komunikim sipas koncepteve. Komunikimi nuk vendoset me një marrëveshje mbi përmbajtjen njohëse të dalë nga objekti i soditur si tek një ligjëratë, marrëveshja bëhet mbi përmbajtjen njohëse të dalë nga kumtimi. Nëse vendoset komunikimi, kjo ndodh nga kënaqësia estetike që lind. Vepra e artit është mjeti për të vendosur një marrëdhënie estetike dhe një komunikim me njerëzit.

Gjuha e zakonshme na shpie tek një aspekt i botës së cilës i përket. Ajo përshkruan fenomene, na lidh, ka një prirje praktike para së gjithash; ndërsa arti na hap drejt një vizioni më të gjerë, që futet thellë në shpirt. Vepra e artit luan rolin e zbulimit të shpirtit përtej ligjëratës, hap direkt në shpirt atë çka gjuha përpiqet të afrojë. Gjuha është thirrje e shpirtit dhe materializim i mendimit, ajo nuk është vetëm përshkrim i gjendjes së botës. Vetëm tek afërsia e saj me artin, gjuha mund të gjejë dimensionin e saj real. Arti nuk është një nënkategori e gjuhës, ai është gjuha autentike dhe madje *“është gjuha ajo që duhet të ngrihet në nivelin e artit për të pasur një kuptim”*<sup>308</sup> - shprehet Declerq. Ai s’mund të kuptohet duke u nisur vetëm nga modeli i gjuhës verbale të zakonshme, sepse kjo do ta reduktonte në përmbajtjen e vet njohëse dhe do të neglizhohej dimensionin estetik që përbën tiparin e veprave të artit. Megjithatë, ky dimension estetik s’është domosdoshmërisht irracional: duhet të kujdesemi që të mos e bëjmë artin përçuesin e diçkaje të pashprehshme, që gjuha verbale nuk do të mund ta arrinte. *“Nëse arti me anë të estetikës lejon që të arrihet një princip çfarëdo, ky funksion nuk merr kuptim veçse nga dhe brenda një ligjërate që sqaron. Soditja pa zë nuk mjafton për t’i dhënë veprës atë çka meriton”*<sup>309</sup> - pohon Declerq.

Si përfundim, me pak fjalë, mund të përkufizojmë: Arti nuk është gjuhë (edhe pse ai është i pandashëm nga gjuha), por është ai që i jep kuptim gjuhës së zakonshme. Arti është objekti me anë të të cilit gjuha na flet për shpirtin.

<sup>308</sup> G. Declerq, *L'art d'argumenter*, Paris, Éditions Universitaires, 1992, f. 44.

<sup>309</sup> G. Declerq, *L'art d'argumenter*, Paris, Éditions Universitaires, 1992, f. 48.

**BIBLIOGRAFI:**

1. B. Andrès et M. A. Bernier (dir.), *Portrait des arts, des lettres et de l'éloquence au Québec (1760-1840)*, Québec, PUL, coll. « République des Lettres », 2002.
2. F. Douay-Soubliin, « La rhétorique en Europe à travers son enseignement », dans Sylvain Auroux, (dir.), *Histoire des idées linguistiques*, Liège, Mardaga, 1992.
3. G. Declerq, *L'art d'argumenter*, Paris, Éditions Universitaires, 1992.
4. J. Hellegouarc'h, *L'art de la conversation. Anthologie*, Paris, Dunod, 1997.
5. M. A. Bernier (dir.), *Archive et poétique de l'invention*, Québec, Nota Bene, 2003.

About the notion *language* through *art*

**SUMMARY**

In this article, the author confronts the structure of verbal language with the work of art, to see if we can range the art in the category of language. For this, she rises the question: Can we apply the concepts that define the language in an artwork?

First, the author lists distinguishing and their common features mainly in cognitive aspect.

Among other things, she claims that: the meaning of the ordinary language is identified relatively quickly, if the speaker expresses clearly and honestly, while, the meaning of an artwork let space for endless interpretations. So, in both language and artwork there is a meaning, but we have a clear one in language and infinity of meanings in artwork.

In short: the art is not a language, even if it is inseparable from language. Art is the object through which the language speaks to the soul.

Aida URUÇI

## NDIHMESA E MARTIN CAMAJT PËR PASURIMIN E LEKSIKUT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE

Fjala e poetëve, prozatorëve dhe dramaturgëve tanë më të mirë zë vend e ngulitet thellë në zemrat e mendjet e lexuesve, i pasuron e fisnikëron ato dhe ua shton dashurinë për gjuhën amtare. Një rol të tillë ka luajtur edhe Martin Camaj, një nga shkrimtarët më të shquar të kulturës kombëtare shqiptare, me krijimtarinë e tij të larmishme.

Leksiku i veprave të tij na sjell botën materiale e shpirtërore të dukagjinave e të arbëreshëve, të qytetit të Shkodrës dhe të fshatrave të Malësisë, të reales e të mitit, sjell kulturën shpirtërore e perëndimore. Camaj shquhet për njohjen e thellë të mundësive dhe të aftësive të mëdha të shqipes, për krijimin e njësive të reja që jo pak prej tyre mbajnë vulën e tij. Për leksikografinë të rëndësishme janë kuptimet e reja, të cilat janë me dhjetëra e me dhjetëra në veprat e Camajt, madje shumica e fjalëve dalin për herë të parë, kurse një pjesë e tyre gjenden të pasqyruar si lema në fjalorë shpjegues e sjellin kuptime, nuanca e ngjyime të reja kuptimore.

*“Martin Camaj ka një leksik mjaft të pasur, që është i përfaqësues për nga sasia e cilësia me ato shkrimtarë gegë, si: Ernest Koliqi, Gjergj Fishta e ndonjë tjetër, që në veprat e tyre kanë një lumë fjalësh, shprehjesh e frazeologjizmash të rralla që gjithsesi e begatojnë leksikun e shqipes përgjithësisht”.*<sup>310</sup>

Në këtë punim ne do t'i shohim këto fjalë si: zgjerim të çerdhes fjalëformuese, përdorimet antonimike të tyre e mjaft kuptime të reja stilistikore.

Autori duke shfrytëzuar lemën foljore **kënaq** arrin të ndërtojë fjalë të reja, si: *përkënaqem (folje), përkënaqje (emër), përkënaqësi (emër), i përkënaqur (mbiemër)*, duke arritur të krijojë çerdhe fjalëformuese.

*Përkënaq* si folje kalimtare del e pasqyruar në fjalorin e M. Elezit: I gëzoi e i përkënaqi të tanët. (Plavë, Guci). Ndërsa përdorimet si folje

<sup>310</sup> Adem Hajdari, *Rreth disa fjalëve, togfjalëshave dhe frazeologjizmave në veprën e Martin Camajt*, në EDUCOLOGIA, 3/2009, Prishtinë, 2009, f. 27.

joveprore (përkënaqëm), si emër (përkënaqësi) e si mbiemër (i përkënaqur) nuk dalin të pasqyruara në FGJSSH (2006), në fjalorin e Gazullit e të '54, por M.Elezi në fjalorin e tij shprehet se “*Këto fjalë gjenden të përdorura tek M. Camaj*”<sup>311</sup>. Ne mund të ilustrim me shembuj nga krijimtaria e këtij shkrimtari këto përdorime.

**përkënaqej** (...edhe plaku **përkënaqej** tejet me gruen e pjekun...Pishtarët e natës, f. 44).

(...nëse i delte mbarë puna, **përkënaqej** në vete për duresën që paska pasë ende nuk e kishin fitue kthjellësinë e duhun...Gjon Gazulli, f. 267). Kjo folje është e ndërtuar nga ndajshitesa për- + kënaq, e ka kuptimin me u kënaq ngadalë e thellë.

**përkënaqje** (... **përkënaqje** të zemrës e të mendes sonë... Loja e mbasdrekës, f. 72).

**përkënaqësi** (...heroi vdes vetëm për të gjallnue kujtesë e se **përkënaqësia** e të gjallit qenka Vetëdija...Djella, f. 136). Në FGJSSH (2006) kemi përdorimet emrore: *kënaqje e kënaqësi*, por ndërtimet me parashtesën për- nuk janë të pasqyruara e mund të themi që janë krijime të autorit.

**i përkënaqur** (... qeshte nën mustak **i përkënaqur**...Djella, f. 123).

Nga folja **ndal** kemi përdorimet: *përndal (folje), që është e ndërtuar nga për- + foljen ndal e ka kuptimin me u ndalë ngadalë dhe e përndalun (mbiemër)*. Në FGJSSH (2006) kemi të pasqyruar vetëm foljen *ndal*, ndërsa fjalët e prejardhura nuk janë të pasqyruara në fjalorët e marrë për krahasim e mund të themi që janë krijime të autorit, ose janë fjalë që gjallojnë në vendlindjen e autorit në Prekal. Si shembuj mund të sjellim disa prej tyre, të cilat do të mundohemi t'i paraqesim më poshtë:

**përndalet** (...gjama i vetmi kor i lashtë në malësinë e gurrit **përndalet** hallakatshëm shpatijeve.. Djella, f. 94).

**i përndalun** (...ndëgjohet një lloj gazi, **i përndalun**, por askush nuk e hap gojën... Loja e mbasdrekës, f. 65).

Tek Camaj janë shumë interesante përdorimet e mjaft fjalëve me ndajshitesën për-, duke krijuar emra e mbiemra me një veshje të re leksikore, si p.sh.:

**përdhimbtimet** (...për t'i shprehë Bjeshkës **përdhimbtimet** që të mblidhemi krye më krye...

<sup>311</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1101.

Loja e mbasdrekës, f. 71). Kjo fjalë nuk del e del e pasqyruar në fjalorin e Gazullit, në fjalorin e '54 e në FGJSSH (2006), por M. Elezi shprehet që kjo fjalë del e përdorur në Plavë e Guci.<sup>312</sup>

**e përfrigueshme** (...qenka aq **e përfrigueshme** fytyra e tij...Kandili i argjandit, f.97). Kjo fjalë ka kuptimin që të frikëson thellë. Ajo del e pasqyruar edhe tek shkrimtari i madh gegë GJ. Fishta.<sup>313</sup>

**të përलगun** (...si delshin prej puseve të Lumit, **të përलगun** nën diell...Legjenda, f. 152).

Mbiemri *i përलगun* del i përdorur jo vetëm nga M. Camaj, por edhe nga M. Elezi.<sup>314</sup>

**të përлагshtë** (...natyra përmbas qelqeve **të përлагshtë** dhe të përlyhem dukej si kuadër impresionisti... Djella, f. 60). Këtu ka kuptimin “që ka ujë e lagështi; i qullur etj.”. Emrin lagësht e kanë disa të folme gege “paska ra shumë lagsht”, që ka kuptimin vesë. Mbiemri i lagësht e ka antonimin i tharë, ndërsa mbiemri i përлагshtë që është përdor nga Camaj nuk e ka antonimin. Kjo fjalë shprehet M. Elezi del e pasqyruar tek Camaj.<sup>315</sup>

**E përdhunshme** (...do të kishte qenë një ujë si ndalje e **përdhunshme**...Pishtarët e natës, f. 65).

Po të khs. me FGJSSH (2006) kemi përdorimet mbiemrore: *e përdhunët, i, e përdhunuar*. Ndërsa në fjalorin e M. Elezit kemi përdorimin *përdhunshëm* si ndajfolje.<sup>316</sup>

**e përdhunueme** (...me parzëm pak të shpërvjelun, si martire e **përdhunueme** dhe e përgjakun... Shkundullima, f. 101).

**të përngeshëm** (...ia kishte lakmi treguesve **të përngeshëm** e pa të keq të cilët përkënaqëshin

<sup>312</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1091. Përdhimbje, -a, f.sh. -e, -et (prej për+dhimbje). Kryeshëndosh, ngushëllim. Shkoi për përdhimbje (Plavë, Guci).

<sup>313</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1093. “...me uturimë/t’ përfrigueshme, i shakullonte...” (GJ. Fishta, Lahuta e malcisë).

<sup>314</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f.1104. “Një sy i pafjetur, i përmalluar e i përलगur prej një loti të dënuar diku...” (M. Elezi, (Pa) koka).

<sup>6</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1104.

<sup>316</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1104. “Këto dyer kanë qenë të mbyllura përdhunshëm.” (M. Elezi, Publicistikë).

... Rrungaja në mars, f. 168). Kjo fjalë sipas M. Elezit<sup>317</sup> del e pasqyruar tek Camaj e mund të themi që është një krijim i tij, ndërsa në fjalorët e tjerë të marrë në shqyrtim nuk del e dhënë.

**të përmoçëm** (...në plasaritjen e gurëve **të përmoçëm**...Shkundullima, f. 103)

**të përnotun** (...anat e thyeme të gurve **të përnotun**...Shkundullima, f. 146). Në FGJSSH (2006)

kemi përdorimin: *përmotsh/ëm (i), -me (e) mb. bised. i përvitshëm*. Camaj përpiket të luaj më elementët fjalëformues të shqipes, duke i dhënë së njëjtës fjalë ndajshitesa të ndryshme që s'i përkasin standardit e që nuk dalin të pasqyruara me një formë të tillë në fjalor. Shkrimtari në shumicën e rasteve ruan trajtat e gegërishtes, sepse ai mbarti kudo me vete leksikon e vendlindjes, ashtu si breshka me zhguallin e vet.

Gërshetimi i punës së shkrimtarit me atë të gjuhëtarit shfaqet dukshëm edhe në ndërtimin e disa ndajfoljeve, si: **përdore**, **përkrye**, **përmaje**, të cilat si të tilla me parafjalën për- nuk i kemi të pasqyruara në FGJSSH (2006) e mund të jenë krijime të autorit.

**përdore** (...kam marrë **përdore** një vajzë, të paemën...Djella, f. 92). ( Po të khs. me FGJSSH

(2006) kemi që për- është parafjalë, ndërsa dorë emër, këtu kemi ngjizjen kësaj parafjale duke na kaluar në mjet fjalëformues në parashtesë.). Në fjalorin e Gazullit të '54 nuk del e pasqyruar një fjalë e tillë, ndërsa në fjalorin e M. Elezit kemi përdorimin e ndajfoljes: *përdoresh*. I vjen përdoresh, e ka zanat.<sup>318</sup>

(...në Romë pata mundësinë me pasë **përduersh** librin ma të vjetër...Pishtarët e natës, f. 179).

Camaj këtu ka arrit të ruaj formën gege sikur vepron në shumicën e fjalëve, ndërsa përdorimin e standardit e gjejmë të përdorur tek A. Istrefi.<sup>319</sup>

Mbështetja në traditën paravajhtëse duket mjaft qartë në fjalët që do japim si shembuj më poshtë që dalin të pasqyruara në

<sup>317</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1111.

<sup>318</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1090.

<sup>319</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1090. "...pse duhej të më rrëmbenin përduarsh...?" (A. Istrefi, Argatët e dreqit).



- “Kanunin e Lekë Dukagjinit” e në ciklin e kreshnikëve”  
Deka e Halilit”.
- përkrye** (...mjafton një fluturim blete /**përkrye**/ e bie përtokë/ ndër mija tjera fletë...Nema, f.145).  
(...i dolën **përkrye** dy cica krye...Buelli, f.164).  
Përdorimin si ndajfolje e kemi të pasqyruar edhe në fjalorin e M. Elezit.<sup>320</sup>
- përmaje** (...para linjës së tij **përmaje** avullit...Buelli, f. 166). Këtë fjalë e kemi të përdorur tek cikli i kreshnikëve e tek Camaj.<sup>321</sup>  
Me ngjyrimë të bukura stilitikore kemi edhe ndajfoljet **përngadalë, përngeshëm, përpishëm**, të cilat nuk i kemi të pasqyruara në fjalorin e Gazullit, të '54 e FGJSSH (2006), ndërsa M.Elezi shprehet që këto fjalë gjenden të pasqyruara në krijimtarinë e M.Camaj, dhe ne mund të themi që janë krijime të Camajt, por vlen të theksojmë edhe njëherë që përcaktimi i autorësisë është i vështirë. Lemat e këtyre fjalëve janë të pasqyruara në fjalor: *ngadalë, ngeshëm* (si ndajfolje: flisnin ngeshëm), *pijshëm*.
- përngadalë** (...kisha një copë akulli në kurm që duhej shkri **përngadalë** para flakadanit...Djella, f. 105).
- përngeshëm** (...flitnin **përngeshëm**...Pishtarët e natës, f. 74).  
(...sillej **përngeshëm** me foshjtë e mjaltit...Rrungoja në mars, f. 189).
- përpishëm** (...gëlltiti/pluhnin e t'bijve,**përpishëm**...Nema, f. 127). Në FGJSSH (2006) nuk e kemi trajtën ndajfoljore përpishëm, por kemi përdorimet si folje: *përpij*: e përpiu errësira (nata), e si emër *përpirje*.  
Martin Camaj arriti të shpalosë artin e tij magjik e aftësitë e tij krijuese në mjaft fjalë të reja të krijuara prej tij sipas gjedheve të shqipes. Ai arrin të përdorë mjaft çifte antonimike për të treguar dorën e tij prej mjeshtri, kur lodron me fjalën shqipe. Kështu kemi çiftet antonimike: **njoftë - panjofhtë, i thirrun- e pathirrun, të grishun - të pagrishun**, ku ndërtimet me parashtesën pa- nuk janë të pasqyruara në fjalorë me këtë formë.

<sup>320</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1103. "...peshkun e xanun do ta dajné përshpi e jo përkrye" (Kanuni i Lekë Dukagjinit).

<sup>321</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1106. "Dhetë e vorrit përmaje ja ka puthë..." (EK, Deka e Halilit).

- panjoftë** (...zgjoi te të gjithë, **njoftë e panjoftë**, kureshtinë ta shihnin...Pishtarët e natës, f. 87).  
Në fjalorin e '54 e FGJSSH (2006) kemi përdorimet si mbiemër: *panjohur (i,e)* e si emër: *i njohur*.
- pathirrun** (...rrodhën në drekët e malësorit **i thirrun e pathirrun**...Pishtarët e natës, f. 87). Në fjalorin e '54 e FGJSSH (2006) kemi trajtën: *thirrmë-a ef, shm.* –a një e thirrun, ndërsa ndërtimin me parashtesën *pa-* nuk e kemi të pasqyruar, kurse M.Elezi shprehet se kjo fjalë gjendet e përdorur në krijimet popullore.<sup>322</sup>
- të pagrishun** (...mirë se vini **të grishun e të pagrishun**, njëherë...Rrungaja në mars, f. 287). Në FGJSSH (2006) kemi f. *grish*, em. *grishës,-i m. sh. –(it) ftesës, ose grishtar, -i m. sh.-ë(t)*.
- të paqena** (...tregonte ngjarje e rrethana **të qena e të paqena**...Djella, f. 118). Në FGJSSH (2006) kemi formën *qenë* pjes. e jam, *qenësi, -a f. libr. 1.Të qenët. 2. Thelbi i diçkaje, ndërsa në fjalorin e M. Elezit trajtën emërore paqenësi.*<sup>323</sup>  
Një përdorim i veçantë mbrujtur me nuanca leksikore, stilistikore e etnolinguistike është fjala *pabestar*, lidhur ngusht me rrënjën e saj *besë*, si lemë që të evokon vlera kombëtare e identitetin tonë. Një lemë aq e veçantë për nga përdorimi i saj në fjalësin e Camajt. Tek shkrintari i madh shohim brenda saj një lojë kuptimesh që lidhet me ndajshesën e vendosur nga Camaj, të cilat në fakt nënkuptojnë të kundërtën e kuptimit fillestar të fjalës. Kështu *besë – bestar* (ai që mban besën) ruhen të paprekura kuptimet e para, ndërsa parashtesa *pa-bën* që të krijohet antonimi kuptimore brenda vetë fjalës.
- pabestarët** (...lutu për **pabestarët**, për ateistët...Kandili i argjandit, f. 84)  
Fjalën *bestar, -i m. sh. – ët* si fjalë të vjetëruar e kemi të pasqyruar në FGJSSH (2006) e fjalorin e M. Elezit<sup>324</sup> (ku vihet re mbështetja tek tradita), ndërsa ndërtimin me

<sup>322</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1069. “Mirë janë veshë e mirë janë mathë / e t’pathirrun krushq kanë ra...(EL, Martesa...”. “Un i pathirrun u kam ardhë në ship...” (EL, Musa Qesenxhi).

<sup>323</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1056. “...që kur ke zbritur në tokë nga paqenësia” (I. Gërvalla).

<sup>324</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 196. “(Bestarët) mbeten dorxanë të shtëpisë së vramit deri në ditën e fundit të kuvendit (besës)” (Kanuni i Skanderbegut).

parashtesën pa- nuk e kemi të dhënë e mund të jetë krijim i autorit

Në ndërtimet emrërore vlen të veçojmë edhe fjalën *papërndalje*, e cila nuk del e pasqyruar në fjalorët e lartpërmendur as me parashtesën për-, as me parashtesën pa-, po kemi ndërtimet: ndal (si folje) e ndalje (si emër) etj., e mund të themi që është krijim i autorit.

**papërndalje** (...fuqia vepruese e tij zgjohej e nganjëherë kalonte edhe në **papërndalje** e agresivitetit... Shkundullima, f. 131).

Camaj duke u mbështetur në lemat e shqipes arriti të ndërtojë mjaft fjalë me ndajshitesën *pa-* të cilat nuk dalin të pasqyruara në fjalorët e lartpërmendur e mund të themi që janë krijime të autorit, si p.sh: *e paturbullueme e padiktueme, i pavarrueshëm, i pazbutun, e palatueme* etj., ndërsa lemat mbiemrore: *i turbulluar, i varrosur, i zbutur, i latuar* dalin të pasqyruara në fjalorë, por ndërtimet antonimike të tyre nuk dalin të pasqyruara. Ja disa shembuj:

**i pavarrueshëm** (...në sy e bahesh **i pavarrueshëm**...Loja e mbasdrekes, f.81). Në FGJSSH (2006)

kemi përdorimin si mbiemër: *i varruar, i varrosur*, ndërsa ndërtimi *i pavarrueshëm* nuk del i pasqyruar, por kemi trajtën *i, e pavorruem* të dhënë në fjalorin e M. Elezit.<sup>325</sup>

**i pazbutun** (...varg **i pazbutun**\dardhë e egër në shkamb...Vargje të shpërndame, f.153).

Ndërtimi mbiemror *i zbutur* na del i dhënë në FGJSSH (2006).

Interesante janë edhe përdorimet me ndajshitesën *stër-*, si p.sh.:

**i stërpjekun** (...ashtu si bie prej peme një fryt **i stërpjekun**...Djella, f. 70). M.Elezi shprehet që si folje *stërpjek* e hasim që tek Gazulli, por me formën sinonimike rrpjek: e stërpoqa mishin. Mbiemri i stërpjekun i përdorur në shkallën sipërore del i përdorur jo vetëm nga M. Camaj, por edhe tek M. Elezi.<sup>326</sup>

<sup>325</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1070. (pavorruem (i), - e (e) mb. (prej pa + vorruem). I pavarrosur).

<sup>326</sup> M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1329. "...një pulë të stërpjekun, të stërpjekun që të mos prishej..." (M. Elei, Dita...).

**të stërkallëzue** (...si të më kishte kallëzue një përrallë të lashtë, **stërkallëzue** kushdi saherë... Djella, f. 99). Kjo fjalë nuk del e pasqyruar në fjalor e mund të jetë krijim i autorit.

Në gjuhën popullore janë formuar kompozita me parashtesën pa-, futur midis dy elementesh të kompozimit, si infiks.<sup>327</sup>

Një dukuri e tillë vihet re edhe tek Camaj në shembullin e dhënë më poshtë:

**mjekër-pakrehun** (...sa peta e tanë zgjatet për dikund rrugimi / **mjekër-pakrehun** plak / dhe i shkujdesun me qafë të vjedhun atleti...Vargje të shpërndame, f.158). Në FGJSSH (2006) kemi ndërtimin *pakrehur* (i,e) mb., ndërsa kompozitat e ndërtuara me fjalën mjekër janë: *mjekërbardhë*, *mjekërcjap*, *mjekërgjatë*, *mjekërthinjur*, *mjekërzi*, kurse kompozitën mjekër- pakrehun nuk e kemi të pasqyruar në fjalor e mund të jetë krijim i autorit.

Nuanca të holla kuptimore Camaj krijon sidomos përmes disa kompozitave, si p.sh.;

**lukth-shtjerrë** (...rrashta e breshkës **lukth-shtjerrë**... Dranja, f. 86). *Këtë kompozitë sipas studiuesit D. Luka, autori e ndërton në mënyrë të përkryer si kompozitë ekzocentrike me vlerë pronësore (që krahasohet me bahuvrihit indoevropiane) brenda sreukturës së gjuhës shqipe, duke dhënë një fjalë të re që nuk e ka jo vetëm Fjalori 1980, po as vetë leksiku i gjuhës shqipe të sotme.*<sup>328</sup>

**mrekullibamëse** (...nuk kishte besim në barnat **mrekullibamëse** të mjekimit popullor... Rrathë f. 237). Nga tema emrore *mrekulli* në FGJSSH (2006) kemi të dhënë vetëm fjalët e prejardhura: *mrekulloj* (folje), *i mrekulluar* (mbiemër), *mrekullisht e mrekullueshëm* (ndajfolje), ndërsa fjala e përbërë mrekullibamëse mendoj se është krijim i autorit e është afër me kompozitën çudibërëse që është e standardit.

**fshehësiplotë** (...të marrin me mend se qenësit **fshehësiplotë**...Pishtarët e natës, f. 33). Në FGJSSH (2006) vërejmë se tek temat: vështrim e fshehësi nuk kemi kompozita të ndërtuara, ndërsa

<sup>327</sup> Aleksandër Xhuvani, Vepra I, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, A. Xhuvani – E. Çabej, Tiranë, 1980, f.393

<sup>328</sup> D.Luka, “Ndihmesa e Fishtës, Koliqit dhe Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe”, në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 2004, f. 281

me gjymtyrën e dytë ndajfoljore: *plotë* kemi ndërtimet, si: *fuqplotë, ose i, e plotpushtetshëm*, etj.

**mirëtingëllimi** (...kakofomi e acartë dhe mbytëse e çdo shije **mirëtingëllimi**...Rrungoja në mars, f. 286). Në FGJSSH (2600) me ndajfoljen mirë kemi ndërtimet: *mirëbesim, mirëkuptim, mirëtrajtim* etj., ndërsa kompozita mirëtingëllim nuk na del e pasqyruar e mendoj se është krijim i Camajt.

**bakeqe** (...mund të ishte edhe ndonjë shpirt **bakeq**... Rrathë, f. 238). Formë e shqipes popullore, besojmë e gegërishtes veriperëndimore, e cila paraqitet si sinonim i keqbërës të standardit, duke përmbysur rendin, e me shkurtësinë e nevojshme e të pëlqyeshme në pikëpamje të stilit letrar, e që tek “Dranja” na del pikërisht me këtë formë (por në variantin dialektor):

**keqbamëse** (...nisi me bulue bima e ndërgjegjes së breme, mrekullia **keqbamëse**...Dranja f. 105).

**kambë-sharavelas** (...si u lëshue breshka teposhtë nepër mjellazën e borës, **kambë-sharavelas**

prej çuku në çuk...Dranja, f. 51). Në FGJSSH (2060) kemi të pasqyruara 45 kompozita të ndërtuara me temën emërore këmbë, ku ndër to 11 janë ndajfolje, si: *këmbadoras, këmbëngultas* (të ndërtuar me të njëjtën prapashtesë), *këmbëcingthi, këmbëkryq, këmbëthyerazi* etj., por ky ndërtim nuk na del i pasqyruar e mund të jetë krijim i **autorit**.

Si përfundim mund të themi që këto fjalë që ne pasqyruam janë tepër të hijshme e tepër tingëlluese, ato sjellin një ndihmesë të madhe në pasurimin e gjuhës letrare shqipe, sepse Camaj, përveçse shkrimtar i madh ishte edhe një gjuhëtar i përgatitur mirë.

Camaj arriti të fusë në përdorim mjaft fjalë të krijuara nga ai ose me origjinë popullore, por edhe mjaft fjalë të vjetra e krahinore, të cilat gjallojnë në veprën dhe në vendlindjen e tij, të cilat duke u evidentuar mund të përfshihen në leksikon aktiv të gjuhës shqipe. Se “*Camaj e shikonte pasurinë leksikore të shqipes në drejtime të ndryshme, duke u përpyetur të dëshmonte shkencërisht lidhjet e qëndrueshme historikisht midis formave gjuhësore të vjetra dhe të reja.*”<sup>329</sup>

Kontributi i Martin Camajt është një model me pasuri të madhe gjuhësore në mjaft rrafshë, që nga leksiku i rrallë, frazeologjia, formimi i fjalëve me brumë të shqipes dhe sidomos nga mënyrat e veçanta të ndërtimeve sintaksore, sipas natyrës së gjuhës sonë. Krijimtaria e tij është me vlerë për gjuhësinë tonë e në

<sup>329</sup> Petrit Kotri, “*Probleme të gjuhësisë krahasuese në veprën shkencore të Martin Camajt*”, në Seminari Ndërkombëtar “*Shkodra në shekuj*”, Shkodër, 2004, f. 89.

mënyrë të veçantë për leksikografët, prandaj kërkohet një studim më i plotë në këtë fushë të krijimtarisë së tij të pasur.

#### LITERATURË E SHFRYTËZUAR:

1. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
2. N. Gazulli, *Fjalori i Gazullit*, Botim anastatik, Tiranë, 2005.
3. K. Cipo, E. Çabej, M. Domi, A. Krajni, O. Myderrizi, *Fjalor i gjuhës shqipe – Fjalor i '54-ës*, Tiranë, 2005.
4. M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
5. Aleksandër Xhuvani, Vepra I, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, A. Xhuvani – E. Çabej, Tiranë, 1980.
6. D.Luka, “Ndihmesa e Fishtës, Koliqit dhe Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe”, në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 2004.
7. Adem Hajdari, *Rreth disa fjalëve, togfjalëshave dhe frazeologjizmave në veprën e Martin Camajt*, në *EDUCOLOGIA*, 3/2009, Prishtinë, 2009.

#### LETËRSI E VJELË:

1. CAMAJ, M., “*Rrathë*”, München, 1978.
2. CAMAJ, M., *Vepra 1*, Tiranë, 1996.
3. CAMAJ, M., *Vepra 2*, Tiranë, 1996.
4. CAMAJ, M., *Vepra 3*, Tiranë, 1996.
5. CAMAJ, M., *Vepra 4*, Tiranë, 1996.
6. CAMAJ, M., *Vepra 5*, Tiranë, 1996.

### Contributions of Martin Camaj vocabulary enrichment of Albanian literary language

#### SUMMARY

Martin Camaj is one of the most prominent writers of the Albanian national culture.

Vocabulary of his work brings material and spiritual world of the arbereshdukagjinasve, the city of Shkodra and the Highland Village, the real and the myth, brings spiritual Western culture.

Words in the overview in this work are more sleek and more resonant, they bring a great contribution to the enrichment of Albanian literary language, because Camaj, great writer but also a linguist was well prepared.

Camaj managed to put enough word in use created by or popular origin, but also quite old and provincial words, which gjallojnë at work and in his hometown, which by being identified may be involved in an active vocabulary of the language Albanian.

Martin Camaj contribution is a great model with real language in many directions, from rare vocabulary, wording, dough formation with the Albanian words and especially by means of specific syntactic constructions, the nature of our language. His creativity is of value to our linguistics in particular for the lexicographer, and therefore required a more comprehensive study in this field was his creativity.

Irena FISTANI

**PASURIMI I SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE  
SHQIPE E FRËNGE, NGA DIALEKTET DHE ROLI I  
TYRE, SI THESARE TË VYERA TË KULTURËS PËR  
POPUJT RESPEKTIV, NË MISHËRIMIN E VLERAVE  
GJUHËSORE, FOLKLORIKE E KOMBËTARE**

Pierre Guiraud në *“Locutions Françaises”*, shprehet: *“Gjuha është mënyrë e shprehjes së realitetit. Ajo pasqyron sendet që emërton: natyrën njeriun, jetën e zakonet e tij, institucionet, teknikën dhe mënyrën e tij, se si i ndjen dhe si i koncepton gjërat ai.”*  
*“...Gjuha është prodhim i historisë dhe ngërthen një traditë dhe një mjedis, prej nga ka dalur.”*<sup>330</sup>

Frazeologjia frënge e ajo shqiptare, janë thesare të vyera të kulturës për popujt respektiv. Për këtë dëshmon edhe pasuria e madhe folklorike tregimtare e shprehjeve popullore, thellësia alegorike e kallëzimeve, metaforika e shprehjeve, urtia dhe mençuria e shprehur ndër to.

Mbi të gjitha, në shprehjet frazeologjike, mishërohen vlerat gjuhësore e folklorike, kombëtare, duke kaluar gojë më gojë dhe brez pas brezi, në mbrojtje të këtyre vlerave, me ngulmim të pasqorë ndër beteja e qëndresa heroike ndër shekuj. Andaj ato mbeten gurra të pashtershme leksikore, dialektore, stilistike të gjuhës për shkrimtarët e për mbarë ligjërimin.

Po thuajse të gjitha shprehjet frazeologjike, që burojnë nga dialektet, përdoren më me forcë nga autorët edhe për qëllime stilistike, sidomos në gjuhën e shkruar, por edhe në gjuhën e folur. Ato përdoren, për t'i hedhur “kripë” bashkëbisedimit.

Një prej burimeve të përhershme të pasurimit të gjuhës me fjalë e shprehje të reja, është dygjuhësia apo bilinguizmi, sado që në parim edhe i kritikueshëm, në mos tjetër, gjithsesi i padëshirueshëm, në thelbin e vet, mbetet prurës, pasurues dhe zgjerues i rezervave fjalësore e frazeologjike të gjuhëve. Kjo, sidomos në rastin e gjuhëve të përpunuara vonë e në kristalizim e sipër, sikundër është shqipja e sotme. Marrjet nga

<sup>330</sup> P. Guiraud, *Les Locutions Françaises*, PUF, Paris, 3<sup>e</sup> édition, Paris, 1980, f. 11.



gjuhët e tjera nëpërmjet dygjuhësisë apo bilingualitetit, si dhe nga dialektet e folura e frazeologjia popullore nëpërmjet bilinguizmit dialektal, përbëjnë kahet e mëdha të zhvillimit e pasurimit të përhershëm të gjuhës shqipe.

Burimi më kryesor që ndikon vazhdimisht në pasurimin e gjuhës shqipe, është përdorimi e përpunimi i leksikut që vjen prej dialekteve, si dhe nga kalkimet e mbartjet prej gjuhëve të tjera. Ndonëse pa fqinjësi të drejtpërdrejtë, një numër jo i vogël huazimesh kanë ardhur e vijojnë të vinë në shqipen prej gjuhës frënge. Në shembujt e mëposhtëm shohim se struktura leksiko-semantike të ndryshme, ngërthejnë interpretime të njëjta, por në të njëjtën kohë dallojmë dhe pasurinë e gjuhës shqipe, që duke kaluar nga njëra krahinë në tjetrën, gjejmë shprehje frazeologjike me të njëjtin kuptim figurativ e të njëjtën domethënie.

Tek ato njësi, ku nuk ka ngurosje të gjymtyrëve dhe mund të kalohet në sinonimet e tyre, mund të pranohen fjalë të tjera në mes, pa cënuar kuptimin e pastër frazeologjik.

Në shprehjet frazeologjike të gjuhës shqipe: “S’ia pret koka (dikujt), nuk kupton shumë, nuk e kap vetë diçka, nuk është i zgjuar”, dallojmë se, mund të ndërrohen pjesët përbërëse me sinonime e fjalë të përafërta, duke respektuar edhe dialektologjinë e për rrjedhojë dhe të kemi të njëjtin kuptim si në rastet që vijojnë: “s’i hyn në kokë”, “s’i hyn në krye”, “s’ia pret mendja”, “s’ia rrok mendja”, “s’ia kap mendja”, “s’ia pret kaplloçja”, (krahinore), “s’ia pret kaptina”, (krahinore), “s’ia pret rradakja”. (krahinore), “s’ia pret kungulli”, (krahinore), “s’ia pret llaçja”, (krahinore), s’ia pret poçi”, (krahinore)<sup>331</sup>.

“Zeqos s’ia pret koka më shumë. Çupën nazelie, që s’i kish mbetur pikë gjaku në fytyrë, e ngriti në krahë dhe e shtriu në krevatin e saj.”<sup>332</sup>

Në shembujt e mësipërm dallojmë se, gjuha pasurohet me shprehje frazeologjike nga krahina në krahinë, që me sinonimet e fjalës “kokë” në dialekte të ndryshme, përftojnë dhe shprehje frazeologjike të larmishme, që vetëm e pasurojnë gjuhën. *Kaplloçja, kaptina, rradakja, kungulli, kungullaçja, poçi* etj., janë të folme në dialekt, që pasurojnë gjuhën shqipe e që përdoren në regjistra të ndryshëm të komunikimit.

Gjuha standarde, që nisat nga një bazë krahinore a dialektore, por që ka si model forma shprehëse a frazeologjizma, nga shumë gjuhëtarë, sidomos të profilit sociolinguistik, si A. Martineja në Francë, F. Koko në Itali etj., është quajtur; “bilinguizëm dialektal”. Një koncept i tillë ka gjetur zbatim edhe në sociolinguistikën shqiptare.

<sup>331</sup> J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, Shkenca, 1999, f. 528.

<sup>332</sup> Po aty, f. 528.

Profesori i madh i gjuhës shqipe Gj. Shkurtaj, në veprën e tij *Sociolinguistika* na mëson: **“Dialektet, nuk janë degëzime apo degjenerime të gjuhës kombëtare. Në përgjithësi, dialektet janë historikisht të lidhura me gjuhën kombëtare ose me gjuhën zyrtare, përderisa ato kanë të përbashkëta origjinën dhe zhvillimin gjenetik dhe nuk janë derivate të gjuhës në mënyrë të drejtpërdrejtë”**.<sup>333</sup>

E njëjta dukuri vihet re dhe me fshatin francez: “Cheval de retour”: përsëritës, recidivist dhe pastaj kuptimi figurativ: “i dënuar”

“*Un des diagnostics infallibles auxquels les directeurs de prison et leurs agents, la police et ses aides, et même les magistrats instructeurs, reconnaissent les chevaux de retour..... est leur habitude de la prison* .”<sup>334</sup>

(Balzac: “Splendeur et Misères des courtisanes”)

- Cheval de retour: Politikan i diskretituar që merr shpesh pushtetin.  
- “*S’ils arrivaient à leur fins, cherchez les noms de chevaux de retour que nous verrions reparaître*”.

(F. Mauriac. “Bloc – Notes”).<sup>335</sup>

Në shembujt e mësipërm kemi dy përdorime të shprehjeve frazeologjike.

“ Un (vieux) cheval de retour. Un récidiviste (de retour au bagne ou à la prison)

Kjo është një shprehje argotike, që i përket mjedisit të burgosurve. Është popullarizuar në kujtimet e Vidocq në shek. XIX, Sipas ‘*le Dictionnaire Quillet de la Langue Française*’ ‘Cheval de retour’ janë thundrorët që merren me qera dhe që i a kthejnë prap të zotit, pasi kanë kryer shërbimin. Në kuptimin figurativ përdoret për politikanë të diskretituar, që marrin disa herë pushtetin<sup>336</sup>

**Tenir le haut du pavé : “Avoir une situation honorable”.**

Shpjegohet prej një veçorie që kishin rrugët në mesjetë, pa trotuare, të gërryera në mes nga balta dhe nga rrjedhja e ujërave të përdorura, të pakanalizuara, bënte që çdo njeri të kishte interes që të ecte në pjesën e ngritur të rrugës.

Këtë privilegj e gëzonin njerëzit e rëndësishëm. Në se fjala ka mbijetuar mbi atë zakon që nuk ka më përdorim, fjala **“haut”** dhe **“hauteur”**, japin idenë e dinjitetit dhe të fisnikërisë<sup>337</sup>.

<sup>333</sup> Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 148.

<sup>334</sup> E. Shijaku, *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip*, Tiranë, Dituria, 1998, f.55.

<sup>335</sup> Po aty, f..55 .

<sup>336</sup> *Les expressions françaises décortiquées*.

<sup>337</sup> P.Guiraud, *Les Locutions Françaises*, PUF, Paris, 3<sup>e</sup> édition , Paris, 1980, f.65.

(Të pasurit paguanin, për të mbajtur gjithmonë më të ngritur anën e rrugës, ku kishin shtëpitë e tyre, me qëllim që uji, balta e për rrjedhim e gjithë lagështira, të kalonte nga ana e rrugës, ku jetonin të varfërit.)<sup>338</sup>

Mund të hyjnë në njësitë frazeologjike të motivueshme edhe shprehjet me origjinë dialektore, tërësia semantike e të cilave nëpërmjet mjeteve gjuhësore që përdoren, na komunikon një krahasim.

P.sh.: në gjuhën frënge: “*être têtue comme une mule*”, “*avoir une tête de mule*”<sup>339</sup>, “*manger comme quatre*”.

Shprehjeve frazeologjike: “*être têtue comme une mule*” dhe “*manger comme quatre*”, menjëherë u gjejmë barazvlerësin në gjuhën shqipe dhe pothuajse siç shihet edhe nga ana ndërtimore e njëjtë, kemi të bëjmë me paralele të mirëfillta të gjuhës frënge me gjuhën shqipe. Edhe në shqip përdoret “*e ka kokën si të mushkës*”, “*është kokëfortë si mushkë*”, “*ha sa për katër*” etj.

“*Marcher sur des oeufs*, ec si mbi vezë ; *écrire comme un chat*, shkruaj si mace; *clair comme de l'eau du roche*, i qartë si uji i burimit; *prendre le taureau par les cornes*, kap demin për brirësh etj. Të gjitha këto shprehje janë mjaft të qarta; janë përdorime në kuptimin figurativ të jetës së përditshme, kuptimi i parë i tyre motivon përdorimin e sidomos vlerat që sjell ky përdorim.”<sup>340</sup>

“*Tani duhet të zgjedhim gjithçka që nevojitet për jetën tonë; të ndajmë egjërën nga gruri, të shfrytëzojmë atë që është e dobishme dhe të harrojmë atë që nuk na hyn në punë.*”<sup>341</sup>

• **Être comme un coq en pâte:** Është si veshka mes dhjavit:

“*J'étais comme un coq en pâte. On me fêtait. On ne me perdait pas un moment sans me regretter. J'étais leur petit Rameau, leur joli Rameau.*”<sup>342</sup>

(Diderot: “*Le Neveu de Rameau*”).

• Është si veza në kulaç (dikush) - Është rrethuar më gjithë të mirat.

- Ra si pula në grurë.
- Është si veshka në mes të dhjavit.
- Është si pjergulla në fik të bardhë.
- Është si veza në mes të kulaçit.
- Është si pula në grurë.

<sup>338</sup> Shënim i autorit.

<sup>339</sup> V.Kokona, *Dictionnaire Francais-Albanais*, Botimet Kokona, 2001, f. 662.

<sup>340</sup> P.Guiraud, *Les Locutions Françaises*, PUF, Paris, 3<sup>e</sup> édition, Paris, 1980, f.29.

<sup>341</sup> J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, Shkenca, 1999, f.255.

<sup>342</sup> E.Shijaku, *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip*, Tiranë, Dituria, 1998, f. 95.

- “Atij i qe mbushur mendja se qe lindur për qejf e për të ndenjuri si veza në mes të kulaçit.

*Prandaj s’vonoj dhe e thirri doktorin.”*<sup>343</sup>

Tek shprehja që vijon dallojmë se, me sa mjeshtëri, duke kaluar nga njëra krahinë në tjetrën, shprehjet e përfituara nga sinonimet nuk çenojnë aspak kuptimin e figurshëm të shprehjes.

Po të marrim në shqyrtim edhe disa frazeologjizma gjuhësore të tjera si: *me sa ka në kokë, sa çel e mbyll sytë, (jam) në pikë të hallit: jam në gjendje të vështirë, me zemër të ngrirë, për mustaqet e Çelos, në pikë të hallit, si kofini pas të vjeli, flakë për flakë, hap pas hapi, fjalë për fjalë, brez pas brezi, djalë pas djali etj.*, do të dallojmë një larmi të perlave, që pasurojnë gjuhën shqipe, duke kaluar nga njëra krahinë në tjetrën, nga jugu në veri dhe nga lindja në perëndim të Shqipërisë.

Ndërsa profesor Androkli Kostallari thekson: “**Gjuha është një kategori shumë e qëndrueshme. Edhe dialektet, si pjesë e saj, ndonëse janë tashmë në një proces të vazhdueshëm shllurjeje, do të vazhdojnë të bashkëjetojnë edhe për një kohë të gjatë krahas gjuhës letrare, si një formë më e ulët, më e ngushtë e kumtimin gojor, të shtresave të caktuara të popullsisë**”<sup>344</sup>

Nga pikëpamja strukturore, frazeologjia letrare në të shumtën e rasteve është në fazën kalimtare e të figurshme, përmes metaforizmit dhe e ka burimin në togfjalëshat e lirë; “i ngeci sharra në gozhdë”, “i hasi sharra në gozhdë”, “i ra sëpata në gur”, “i ngeci plori në rrënjë”, “i mbeti kocka në fyt”, “i ngeci kocka në fyt”, “i ngeci veza kryq”, “i mbeti luga në pilaf” (ironi).<sup>345</sup>

Të gjitha këto shprehje kanë një shpjegim: ngeci në një pengesë të pakapërcyeshme e nuk shkon dot më tej për të bërë diçka, ngeci në vend papritmas.

- “Hë, le të vërë mend, si me atë hundëlesh, që i ngeci sharra në gozhdë.”<sup>346</sup>,

- “Ç’të mendojmë ne, - u përgjigj menjëherë komandanti i xhandarmërisë, - sharra i ngeci në gozhdë. – Cila është sharra e cila është gozhdë? – e pyeti prefekti”<sup>347</sup>.

E njëjta dukuri shkencore ndodh edhe me gjuhën frënge. Duke kaluar nga njëra krahinë në tjetrën, gjejmë shprehje frazeologjike, që kanë

<sup>343</sup> J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, Shkenca, 1999, f. 1091.

<sup>344</sup> A.Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973, f. 41.

<sup>345</sup> J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, Shkenca, 1999, f. 919.

<sup>346</sup> Po aty, f. 919.

<sup>347</sup> Po aty, f. 919.

të njëjtin kuptim, por duke përdorur sinonime me prejardhje nga dialektet e ndryshme zbukurojnë dhe e pasurojnë gjuhën.

Në frëngjisht: “dormir comme une souche”, “dormir comme une marmote”, “dormir comme un sonneur”, “dormir comme un loir”, “dormir comme un sabot”, “dormir comme une bûche”, “dormir comme un plomb”: bën gjumë të rëndë plumb. Bën gjumë aq të thellë, sa nuk e zgjojnë topat. Fle si kërcu<sup>348</sup>.

A.Martinet në librin “Langues en fonction”, thekson katër çaste me rëndësi për çdo bashkësi gjuhësore:

*“Asnjë bashkësi nuk është gjuhësisht homogjene; nuk gjenden dy vetë që ta përdorin gjuhën ekzaktësisht njëlloj; e njëjta situatë do të shkaktojë reaksione të ndryshme tek dëgjues të ndryshëm; s’ka mundësi, që dy persona të përdorin ose të kuptojnë ekzaktësisht njëlloj të njëjtin fjalor; edhe aspekte më të strukturuar të gjuhës, si fonologjia dhe gramatika, mund të diferencohen në pika të rëndësishme, nga një folës te tjetri, pa cënuar të kuptuarit e dyanshëm, madje pa u vënë re nga bashkëfolësi.”<sup>349</sup>*

Shprehjet frazeologjike: “Être noyé de dettes”, “être criblé de dettes”, “être abimé de dettes”, “être accablé de dettes”, kanë barasvlerësin në shqip: “është i krimbur, i mbytur, i humbur në borxhe; Avoir beaucoup de dettes: kam shume borxhe.

“Être criblé de dettes”: “Yvonne s’est résolue à demander une aide financière à ses parents. Elle ne peut plus payer son loyer et elle est criblée de dettes”<sup>350</sup>.

Në kundërshtim me gjuhët e tjera, shumë perla të bukurisë së gjuhës shqipe e kanë prejardhjen nga fshati, ndoshta kjo për faktin, se pjesa më madhe e popullsisë shqiptare ka jetuar në fshat.

Ndryshe paraqitet gjendja me fshatin francez. Pierre Guiraud në “Locutions françaises” thotë: “Një karakteristikë themelore, që bashkon frëngjishten me shumicën e gjuhëve perëndimore, është izolimi kulturor dhe gjuhësor i fshatit. Gjuha përpunohet në qytet, në shkollë e në sallone nga njëra anë dhe në punishte e në dyqane nga ana tjetër”<sup>351</sup>.

Shprehjet frazeologjike të gjuhës frënge që vijojnë, na përcjellin të njëjtin kuptim, por dallojmë se, duke kaluar nga njëra krahinë në tjetrën, pasurohen me mjete stilistike të ndryshme, që fuqizojnë, zbukurojnë e bëjnë më bindës ligjërimin:

<sup>348</sup> E, Shijaku, *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip*, Tiranë, Dituria, 1998, f.78.

<sup>349</sup> Martinet A., *Éléments de linguistique générale*, Paris, Armand Colin, 1960, f.113.

<sup>350</sup> I.Chollet, J.-Michel Robert, *Les Expressions Idiomaticques*, Cle International. Paris, 2008 f. 133.

<sup>351</sup> P.Guiraud, *Les Locutions Françaises*, PUF, Paris, 3<sup>e</sup> édition, Paris, 1980, f. 26.

- Fouiner dans la vie privée de qqn<sup>352</sup>: gërvëlis, rrëmoj, fam. zhbiroj, fut hundët në punët e të tjerëve. v i.<sup>353</sup> :
- fouiller dans la vie privée de qqn<sup>354</sup>: chercher pour decouvrir des choses cachées ou des secrets: fut hundët në punët e të tjerëve, rrëmoj, gërmoj<sup>355</sup>
- fureter dans la vie privée de qqn<sup>356</sup>: fouiner dans la vie privée de qqn: fouiner dans la vie privée de qqn

Foljet: fouiner, fureter (chasser au furet), janë sinonime dhe komunikojnë tek në kuptimin e foljes fouiller: fut hundët në punët e të tjerëve, rrëmoj, gërmoj (fig),<sup>357</sup>

- fourrer son nez dans la vie privée de qqn<sup>358</sup>: fut hundët në punët e të tjerëve, rrëmoj, gërmoj etj
- “Charrosselles qui fourrait son nez partout, fut curieux de savoir ce qu’était un papier”.

A. Furetière “Le Roman bourgeois”<sup>359</sup>

Një dukuri tjetër sociale që përdoret në gjuhën e shkruar dhe të folur frënge është edhe **verlan**.

**Verlan**, është një formë argotike frënge, që konsiston në leximin invers (mbrapsht) të fjalës.

Kjo mënyrë e të shprehurit, është krijuar duke ndërruar vendin e rrokjeve të shprehjes frazeologjike (*à l'envers*). Është zhvilluar kryesisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, si gjuhë e fshehtë në mjediset e punëtorëve dhe emigrantëve në periferitë e Parisit, për t’u përhapur në të gjitha shtresat e popullsisë. Përdoret në muzikë, si gjuhë e repistëve, por edhe në kinematografi. Këngëtari Jacques Dutronc kishte përdorur “verlan” që në vitin 1971:

***J’avais la vellecère qui zéfait des gueuvas: J’avais la cervelle qui faisait des vagues***).<sup>360</sup>

Leksikologu i madh i gjuhës frënge, Alain Rey, në veprën e tij madhore: “*Dictionnaire historique de la langue française*”, shprehet: - *Po të*

<sup>352</sup> LAROUSSE, *Dictionnaire Encyclopedique* volume 1. Paris, 1994, f. 542.

<sup>353</sup> V.Kokona, *Fjalor frëngjisht-shqip*, Botimet Kokona, Tiranë, 2001, f. 443.

<sup>354</sup> LAROUSSE, *Dictionnaire Encyclopedique* volume 1, Paris, 1994, f. 463.

<sup>355</sup> V.Kokona, *Fjalor frëngjisht-shqip*, Botimet Kokona, Tiranë, 2001, f. 456.

<sup>356</sup> LAROUSSE, *Dictionnaire Encyclopedique* volume 1, Paris, 1994, f. 463.

<sup>357</sup> V.Kokona, *Fjalor frëngjisht-shqip*, Botimet Kokona, Tiranë, 2001, f. 456.

<sup>358</sup> E,Shijaku, *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip*, Tiranë, Dituria, 1998, f. 124.

<sup>359</sup> Po aty, f. 124.

<sup>360</sup> [Fr.wikipedia.org/wiki/Verlan](http://fr.wikipedia.org/wiki/Verlan) – [Cached](#) – [Similar](#)

*bazohemi në disa studime sociologjike dhe ideologjike, vemë re se, përzgjedhja e fjalëve në fjalorë ka qenë shumë selektive, sepse merrnin vetëm fjalë të përdorimit të rregullt*<sup>361</sup>.

Për mendimin tim modest, kjo dukuri bën që, të mos pasqyrohet zhvillimi real i gjuhës, por të “çensurohet” ajo, duke mos e lënë atë të rrjedhë në shtatin e vet të trazuar e të rrëmbyeshëm dhe si pasojë pasurimin ritmik të saj.

Në veprën tjetër, “A mots découverts”<sup>362</sup> ai shprehet se “*Mënyra të tjera të pasurimit të gjuhës, janë dhe dialektologjizmat (régionalismes), më mirë se të përdoren fjalë të huazura nga gjuhë të tjera e sidomos vitet e fundit nga anglishtja*”.

Në një intervistë kam lexuar: “Alors ce “big” plaisir, je le partage avec vous”, kur fare mirë në vend të mbiemrit “big” i huazuar nga anglishtja mund të përdorej mbiemri “grand”: i madh në gjuhën frënge.

Gjuhëtari i madh, Androklli Kostallari, në veprën e tij: “*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*”, shprehet: “***Të gjithë ata që flasin cilëndo nga të folmet e pranëvëna në një mjedis të përbashkët, qofshin edhe të brezit të vjetër, e kuptojnë tërësisht gjuhën letrare kombëtare dhe, në shkallë të ndryshme, janë nën ndikimin e saj. Kjo lidhet në radhë të parë me arsyen që baza e sistemit të gjuhës letrare kombëtare, janë elementet e përbashkëta të shqipes, që i gjejmë në të dy dialektet***”<sup>363</sup>.

Siç pamë dhe më lart, si në gjuhën frënge ashtu dhe në gjuhën shqipe dialektet pasurojnë më shumë gjuhët respektive, duke e bërë edhe më të figurshëm ligjërimin.

Në këtë pikë, jap edhe mendimin tim modest se, për pastrimin e njësive frazeologjike nga ndikimet e huaja, me qëllim pasurimin e stivele dhe të mbarë gjuhës me mjete shprehëse emocionale, shkrimtarët duhet të kenë parasysh njohjen e ligjërimeve popullore e folklorike, vlerat shprehëse leksiko-semantike e stilistike të frazeologjisë dhe nevojën e përdorimit të saj në masë të mjaftueshme. E rëndësishme është të bëhet zëvendësimi i shprehjeve frazeologjike të huaja, me shprehje frazeologjike dialektore.

<sup>361</sup> Alain Rey, “*Dictionnaire historique de la langue française*”, Le Robert, Paris, 1988 (Comment fait-on pour montrer dans un dictionnaire cette différence entre la langue écrite et orale, et laisser de la place au régionalisme ou au verlan)?

V. Kokona *Fjalor frëngjisht-shqip*, Botimet Kokona, Tiranë, 2001, f. 456.

<sup>362</sup> Alain Rey, “A mots découverts, chroniques au fil de l’actualité”, Robert, Laffort, Paris, 2007.

<sup>363</sup> A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973, f. 33.

Krahas pastrimit dhe pasurimit të gjuhës me fjalë, togfjalësja e shprehje të larmishme, e rëndësishme është dhe ndërthurja e tyre me koloritin dhe dinamikën gjuhësore kombëtare. Nga sa thamë më sipër dalim në përfundimin se, *shprehjet frazeologjike me burim dialektor, janë një kategori leksikologjike, që zgjojnë kërshëri studimi dhe interpretimi në nivele të ndryshme gjuhësore. Ato duhet të ruhen e të pasurohen brez pas brezi, si pasuri që na kanë lënë të parët tanë.*

Pra në përfundim, dalim me konkluzionin se, *dialektet, si të gjuhës shqipe, ashtu edhe të gjuhës frënge, mbeten një prej burimeve të përhershme të pasurimit të gjuhës me fjalë e shprehje të reja, të cilat formojnë një tërësi sintaksore dhe leksikologjiko-semantike, ku pasqyrohen tiparet specifike të një gjuhe të caktuar, vetëdija shoqërore, psikologjia e veçantë e personave bartëse të kësaj kulture. Ato nuk mund të veçohen, nga jeta e përditshme shoqërore, kulturore-letrare dhe gjuhësore e popullit, sepse burojnë nga vetë populli.*

#### BIBLIOGRAFI:

1. P.Guiraud, *Les Locutions Françaises*, PUF, Paris, 3<sup>e</sup> édition, Paris, 1980.
2. P. Guiraud, *La sémantique*, Paris, Larousse, 1966.
3. I.Chollet, J-M Robert ‘*Les expressions idiomatiques*’ CLE International, 2008.
4. A. Martinet, *Elements de linguistique générale*, Paris, Armand Colin, 1960.
5. A. Martinet, A. *Langue et fonction, une théorie fonctionnelle du langage*, Paris, Danoel, 1969.
6. Alain Rey, “A mots découverts, chroniques au fil de l’actualité”, Robert, Laffort, Paris, 2007.
7. Louis - Jean Calvet “La Sociolinguistique” PUF, 2006, f. 43.
8. LAROUSSE, *Dictionnaire Encyclopedique* volume 1. Paris, 1994.
9. J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, Shkenca, 1999.
10. V. Kokona, *Mbi përkthimin dhe përkthyesin*, Botimet Kokona, Tiranë, 2003.
11. A.Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973.
12. J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984.
13. Gj.Shkurtaçaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003.
14. Gj.Shkurtaçaj, *Etnografi e të Folurit të Shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004.
15. N.Varfi. *Introduction à la lexicologie du français*, SHBLU, Tiranë, 2005.
16. N.Varfi. *Shqipja ballë frëngjishtes* (mbi fjalorin e V. Kokona), *Universi i Librit*, Mars, 1999.
17. N.Varfi. *Précis de lexicologie française*, SHBLU, Tiranë, 1996.
18. E. Shijaku, *Fjalor frazeologjik frëngjisht-shqip*, Tiranë, Dituria, 1998.
19. V. Hugo, *Parathenja e Cromwell*, 1827.
20. Z.Gjocaj, *Trajtesa frazeo-stilistike letrare shqipe*. ERA, Prishtinë, 2008.
21. Sh. Rrokaj, *Shqipja standarde në prag të shekullit të ri*, Seminari ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë shqiptare, Prishtinë, 2001.



**BURIME ELEKTRONIKE**

*fr.wikipedia.org/wiki/Verlan*

<http://www.google.com/books?id=mrh0f...69&output=textpp>

*www.mon-expression.info/Encyclopédiedesexpressions* -

*www.senioractu.com/100-Expressions-a-sauver-par-Bernard-Pivot\_a10047.html* -

Le Trésor de la langue française informatisé

“les locutions phraséologiques décortiquées.”

<http://www.expressio.fr/newsletter.php?id=PIMX171R>

[contact@expressio.fr](mailto:contact@expressio.fr)

<http://www.expressio.fr>

**The enrichening of Albanian and French idioms from the dialects,  
their role in representing the national cultural and linguistic values of  
the respective people**

***SUMMARY***

Idioms that have a dialectal origin are one category of a lexical items that has generated interest in various linguistic levels. Having been inherited from our ancestors, idioms constitute a wealth which should be preserved and enriched generation after generation. As a conclusion we can say that dialect, whether in Albania or French are in effective way of enriching language with new words and expressions which constitute a syntactical, lexical and semantic whole. They reflect the features of a specific language, as well as the social consciousness and psychology of the people who speak this language. They can not be taken apart from the everyday life of the people because they stem from their culture in general and from their literary and linguistic culture in particular.

Olese MEMA

## 100 – VJETORI I NJË FJALORI DYGJUHËSH (Fjalori italisht-shqip i P. Antonio Buseti-t)

Para një shekulli u botua në Shkodër fjalori dygjuhësh i misionarit italian Antonio Buseti<sup>364</sup>, me rreth 30 mijë fjalë e shprehje. Buseti ka lindur me 11 nëntor të vitit 1870, në Udine të Italisë Veriore. Në urdhrin e shoqërisë “S.J.” ai hyri pas mësimeve të maturës, më 7 shtator 1891. Në Kolegjin Saveriane ai ka qenë Prefekt i studimeve të kësaj shkolle mes viteve 1898 – 1923. Biografët e quajnë atë “albanolog”,<sup>365</sup> në respekt të veprave leksikografike dhe gjuhësore që hartoi në gjuhët italisht dhe shqip. Buseti vdiq më 31 janar të vitit 1948 në Lonigo të Vicencës, ndërkohë që misionarët italianë të urdhrit S.J. ishin dëbuar nga Shqipëria që më 1946.<sup>366</sup> Historiani Peters, në fund të biografisë së shkurtër të misionarit italian, vë edhe publikimet e veprave, sipas kronologjisë së botimit:

- 1910: Grammatichetta della lingua albanese, 71 faqe.
- 1911: Vocabolario Italiano - Albanese compilato dal P. Antonio Buseti S.J. 1147 f.
- 1914: Pratica e grammatica della lingua Albanese con 158 esercizi ed un rispettivo vocabolario. 1. Auflage, 293 faqe.
- 1933: Grammatica Albanese - Seconda edizione/interamente rifatta. 2. Auflage, 167 f.

Autori vazhdonte një traditë të përvijuar prej shekujsh gjatë së cilës udhëtarë të huaj (që nga Arnold von Harff-i), diplomatë në oborret feudale shqiptare e më vonë misionarë katolikë, kishin përpiluar, për nevojat e tyre të komunikimit dhe të shërbimit, fjalorë dygjuhësh të madhësive të ndryshme. Deri në fillim të shekullit XX, kur hartohej ky fjalor, ishin publikuar gjithsej 21 të tillë: dy, tri dhe katërgjuhësh, të cilët e përballnin

<sup>364</sup>Vocabolario Italiano-Albanese, compilato dal P. Antonio Buseti S.J., Scutari d’Albania, Tipografia dell’Immacolato, 1911.

<sup>365</sup>Marcus W.E. Peters, “Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur”, Verlag Dr. Kovač, Hamburg, 2007. f. 352.

<sup>366</sup>Po ai, po aty, f. 353.

gjuhën shqipe me gjuhë të tjera mjaft të lëvruara e të zhvilluara.<sup>367</sup> Jo vetëm me gjuhët rreth kufirit të Shqipërisë, si me greqishten e re, serbishten,

<sup>367</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Leksikografia shqipe (Trashëgimi dhe perspektivë), Tiranë, 2005, f.329 -332. Këta fjalorë, sipas autorëve të shkrimit brenda këtij libri: Pavli Haxhillazi-Artan Goga-Flora Zeqja “Bibliografi e leksikografisë shqipe (1635-2004), janë:

- Dictionarium latino-epiroticum, Franciscum Blancum [Fjalor latinisht-shqip, Frang Bardhi], Romë, 1635, 384 f.; Paris, 1932; Prishtinë, 1983.
- Dizionario italianë-albanese [Fjalor italisht-shqip], F.M. da Lece, 1702.
- Fjalor katërgjuhësh (greqisht-shqip-maqedonisht-turqisht) [Leksicon tetraglosson; çetiri jaziçen rečnik], P.Haxhi Danil, Voskopojë, 1762-1764.
- Protopeiria (përfshin edhe një fjalor greqisht-arumanisht-shqip me 1170 fjalë), Teodor Kavalioti, Venedik, 1770 f.; Vjenë, 1895, 127 f.
- Die Sprache der Albaner oder Schipetaren [Gjuha e shqiptarëve], I.R. von Xylander, Frankfurt mbi Majn, 1835 (përmban një Fjalor gjermanisht-shqip dhe shqip-gjermanisht me mbi 3000 fjalë).
- Dizionario italiano-albanese [Fjalor italisht-shqip], L. La Monte Giove, 1848.
- Fjalor i gjuhës shqipe, A.Santori, 1850.
- Albanesische Studien [Studime shqiptare], Johan George von Hahn, Jenë, 1854, 141 f.(përmban një Fjalor shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip.
- Fjalori i Arnold von Harffit i vitit 1496, e botoi E. von Grootte, në “Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Cöln durch Italien, Syrien, Aegypten, Arabien, Aethopien, Nubien, Palästina, die Türkei, Frankreich und Spanien, wie er sie in den Jahren, 1496 bis 1499 vollendet, beschrieben und durch Zeichnungen erläutert hat”, Këln, 1860, 51 f. + 280 f.
- Vocabolario italiano-epirotico [Fjalor italisht-shqip], Francesco P.Rossi, Romë, 1866, 353 f.
- Fjalor alfabetik shqip-epirotisht, Dhimitër Kamarda, Livorno, 1869.
- Rečnik od četiri jezika: srpski-arbanski, arbansko-arnautski-turski, turski-grčki [Fjalor katërgjuhësh:serbisht-shqip, shqip-turqisht, turqisht-greqisht] Djordje M.Puljevski, Beograd, 1873; Shkup, 1974.
- Rečnik od tri jezika: makedonski, arbanski i turski [Fjalor trigjuhësh, maqedonisht-shqip-turqisht], Mijak Galjicki, Beograd, 1875.
- Vocabolario della lingua epirotica-italiana[Fjalor shqip-italisht]Francesco P.Rossi, Romë,1875, 1400 f.
- Manuel de la langue shqipe ou albanaise: grammaire, vocabolaire, chrestomathie [Manual i gjuhës shqipe], August Dozon, Paris, 1879, 348 f.
- Kurzgefasste albanische Grammatik mit Lesestücken und Glossar [Gramatikë e shkurtër e shqipes me pjesë leximi e fjalor], Gustav Majer, Leipzig, 1888, 11+105 f.
- Etimologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache [Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe], Gustav Majer, Strasburg, 1891, 526 f.; Leipzig, 1980.
- Fjalori greqisht-arumanisht-shqip, Teodor Kavalioti, e botoi Gustav Majeri në Vjenë, 1895, 127 f. (ribotim i vitit 1770).
- Fjalur i voghel scyp e ltiniscet (Fjalor i vogël shqip-latinisht), Jak Jungu, Shkodër, 1895, 200 f.

arumanishten, maqedonishten, turqishten, por edhe më gjerë: me gjuhët klasike-latinisht, greqisht- dhe gjuhët moderne: gjermanishten e frëngjishten. “*Shqipja, shkruan Jani Thomaj, nëpërmjet fjalorëve dygjuhësh, ka hyrë në lidhje leksikografike thujse me të gjitha gjuhët indoevropiane, përfshirë latinishten, dhe, përtej kufijve të kësaj familjeje gjuhësore... Fjalorët dygjuhësh janë hartuar kryesisht për t’u shërbyer të huajve që mësonin shqipen ose shqiptarëve që mësojnë gjuhë të huaja.*”<sup>368</sup>

Në përmbledhjen me kumtesat e konferencës shkencore të 3 dhjetorit, 2004, ka një fjalë hyrjeje, një referat dhe 32 kumtesa, ndër të cilat nuk përmendet asnjëherë Fjalori i Buseti-t, megjithëse, pas atij të Rossi-t (1875) që ka 1400 faqe, përmban një fjalës aq të pasur në 1147 faqe. Të dy këta fjalorë janë më të mëdhenjtë fjalorë dygjuhësh deri në vitet 1980. Nga ana tjetër, duhet vënë në dukje se ky fjalor u botua menjëherë pas Fjalorit shqip-italisht të shoqërisë “Bashkimi” (1908) dhe, pa dyshim se ka mbështetjen e tij për autorin e huaj. Përveç kësaj, Fjalori i Buseti-t është e para vepër leksikografike, me përmasa të tilla, që u shtyp me alfabetin e Kongresit të Manastirit. Fjalori i këtij misionari njohu dy botime: si vepër unike e plotë dhe në dy volume<sup>369</sup>, mbase për arsye të përdorimit më praktik. Padre A. Buseti kishte vite në Shqipëri si misionar dhe pedagog në Kolegjin Saveriane, kishte mësuar mjaft mirë gjuhën shqipe dhe me hartimin e fjalorit, dëshironte që edhe të tjerët ta përvetësonin këtë gjuhë. Sipas të dhënave për shtypin shqiptar në Shkodër, del se P. Antonio Buseti ka drejtuar për 3 vjet edhe revistën më të madhe të urdhrit Jezuit “Elcija e Zemers T’Jezu Krisctit”, që doli për 22 vjet me radhë në qytetin e Shkodrës

- Srpsko-arnautski rečnik [Fjalor serbisht-shqip] (Fuhtar srpošiptarçe), L.P.D. Kujunxhiq, Beograd, 1902, 138 f.; 1953, 228 f.

- Lexicon tës alvanikës glössës [Fjalor i gjuhës shqipe], Konstantin Kristoforidhi, Athinë 1904, 502 f.; Tiranë, 1961, 397 f.; Prishtinë, 1977, 397 f.

- Fjalorth shtyp-frangisht e frangisht-shcyp i fjalëve t’reja, L.Gruda (Luigj Gurakuqi), Napoli 1906, 30 f., dhe në veprën “Vargënim n’gjuhë shcype me gni fjalorth shtyp-frangjisht n’marim”, Napoli, 142 f.

- Fialuer i Rii i Shcypes (Fjalor i ri i shqipes). Perbâam préi Shocniét t’ Bashkimit, Shkodër, 1908, 538 f.; Prishtinë, 1978.

- Vocabolario italiano-albanese [Fjalor italisht-shqip], Antonio Buseti, Shkodër, 1911, 1147 f.

5. Jani Thomaj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Leksikografia shqipe (Trashëgimi dhe perspektivë), Tiranë, 2005, f. 17.

<sup>369</sup> Vocabolario italiano-albanese, compilato dal P. Antonio Buseti S.J (A – L, 576 faqe), Scutari d’Albania, Tipografia Immacolata, 1911, dhe volumi II, shkronjat M – Z, me 571 faqe.

(1891 – 1913), si revista e parë në gjuhën shqipe të Shqipërisë së atyre kohëve.<sup>370</sup> Autorët e mësipërm vënë në dukje se revista doli me këtë titull deri në vitin 1913, ndërsa nga viti 1914, vazhdoi të qarkullonte me titullin “Lajmtari i Zemers t’Jezu Krishtit” dhe ishte revista e parë e shtypur në Shqipëri në periudhën e sundimit osman.<sup>371</sup>

Revista e njohur “Shêjzat”, përmban një vlerësim pak të çuditshëm të filologut Karl Gurakuqi, i cili, pasi shkruan për fjalorë të përpiluar nga të huajtë, shënon: “Nji tjetër fjaluer, prep nga dora e njëj të hueji, âsht ai i botuem në Shkoder, në vjetin 1911 nga Āt A.Buseti. Në ket fjaluer janë përmbledhë, persa ka qênë e mundun, materiali i fjalorvet të mâparshem; gjinden regjistruue edhë shum fjalë turqishte qi aso kohe ishin ende në përdorim.”<sup>372</sup> Së pari, fjalët turqishte të regjistruara nga Busetti, kanë qenë në përdorim, si dëshmon edhe Gurakuqi, dhe duheshin përfshirë, ashtu siç ishte vepruar me Fjalorin e Bashkimit; e dyta, të gjithë fjalorët dalin nga fjalorët, duke u pasuruar nga njëri tek tjetri, siç ngjet edhe në kohën tonë me fjalorët shpjegues normativë, apo ata dygjuhësh.

Në veprën madhore “Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)”<sup>373</sup>, në kapitullin VI, pika 3, titulluar “Fillimi shkencor i studimit të gramatikës së gjuhës shqipe”, në radhë me Gjergj Pekmezin, Anton Xanonin, Gjuk Dukagjinin (Salih Gjuk Dukagjini), Thanas Floqin, Nikollaq Lakon, si autorë të librave gramatikorë të shqipes, përmendet edhe Anton Buzeti për botimin “Gramatikë e shkurtër e gjuhës shqipe (1910)”,<sup>374</sup> së cilës dijetari shkodoran i bën një analizë strukturore sipas kapitujve dhe çështjeve të trajtuara, deri edhe tregues për sintaksën e shqipes: “Në mënyrë të veçantë, shkruan Kastrati, aty ka të dhëna mbi funksionin sintaksor të rasave të emrit, të mbiemrit, të përemrit dhe të numërorëve; mbi përdorimin e mënyrave dhe të kohëve të foljeve si dhe mbi ndajfoljet e parafjalët.”<sup>375</sup> Në

<sup>370</sup> Hamit Boriçi-Mark Marku, *Histori e shtypit shqiptar* (Nga fillimet deri në ditët tona), shblu, Tiranë, 2010, f.71. Autorët shpjegojnë më gjerë në shënimet e faqes për revistën në fjalë: “Në kohë të ndryshme revista u drejtua nga: Jak Jungu (1891-1894 dhe 1895-1899), Ded Pasi (1894-1898-1899), Frano Gjenoviçi (1897, 1902-1903 dhe 1909-1911,1915), Ejll Serreqi (1899-1902), Shtjefen Zadrime (1905-1909), Anton Busetti (1911-1914) dhe Anton Xanoni (1914-1915, të gjithë klerikë.

<sup>371</sup> Po ata, po aty, f.72.

<sup>372</sup> Karl Gurakuqi, *Hulumtime gjuhësore*: “Leksikografia shqipe deri te Fjalori i Tiranës, 1954”; *Shêjzat* 7 – 8/ 1962, f. 259.

<sup>373</sup> Jup Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)*, Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 288-289).

<sup>374</sup> Po ai, po aty, f. 288.

<sup>375</sup> Po ai, po aty, f. 289. Më gjerë shton Kastrati: “Autori qe i huaji, që e pat mësuar shqipen mjaft mirë; por, në redaktimin përfundimtar të librit, unë mendoj se ai do të

“Historinë e gramatologjisë shqiptare”, autori tregon se në përpilim të librit *Buzeti është mbështetur te gramatikat e shkruara mbi bazën e gegërishtes nga Rosi, Jungu, P.Vasa, D.Koleci, Jakova-Mërturi, Xanoni*.

Për veprën tjetër të Buseti-t, në sythin “Gramatikanët e huaj për shqipen”<sup>376</sup> Kastrati e dëshmon veprën e misionarit italian, me emërtimin “Gramatikë (tjetër) e gjuhës shqipe” (1914), për të cilën shkruan vetëm këto fjalë: “Anton Buzeti – botoi italisht, më 1914, “Gramatikë e gjuhës shqipe me fjalorth”. Vepra është një libër për mësimin e gjuhës shqipe me 158 ushtrime stërvitjeje, në shërbim të tyreve që dinë italishten. Manuali është praktik dhe ka 290 faqe. Veprën nuk e kam parë. Informacionin e botimit e nxora nga “Kalendari kombëtar”<sup>377</sup>. Është e çuditshme që ky dijetar aq skrupuloz dhe i gjithanshëm, të mjaftohet me të dhëna të tërthorta për një libër prej 293 faqesh (!), të na japë një titull tjetër nga i vërteti dhe të mungojë analiza e tij në këtë vepër unike të historisë së gramatikave shqipe, ashtu siç ka ndodhur që as libri i tretë gjuhësor i misionarit të shquar me titull “Grammatica albanese”<sup>378</sup> e vitit 1933, të mos pasqyrohet. Mund të mendojmë për ndonjë “kufi” të vënë nga “koha” kur u hartua “Historia e gramatologjisë shqiptare”, ndryshe s’ka si shpjegohet “heshtja” e dijetarit të shquar albanolog, profesor Kastratit.

### Struktura e fjalorit të Buseti-t

Fjalori dygjuhësh i Buseti-t, është pa dyshim vepra e jetës intelektuale e pedagogjike e autorit, gjatë viteve të qëndrimit në Shqipëri, kur ai arriti të përvetësojë mirë gjuhën shqipe, në nivelin e një gjuhëtari. Në vitet e daljes së Fjalorit, në Kolegjen Savriane ishte futur jo vetëm mësimi i gjuhës amtare për nxënës e studentë, por edhe mësimdhënia po bëhej në shqip prej pjesës më të madhe të pedagogëve. Buseti duhet të ketë qenë ndër të parët misionarë të huaj që nisën ta praktikonin këtë.

---

jetë ndihmuar nga ndonjë mësues shqiptar, shkodran, i cili do të ketë pasur njohuri të sigurt rreth gjuhës sonë amtare. Ndryshe s’ka si të shpjegohet që në atë libërth ose “gramatikëz” (grammatichetta – siç e quan autori) të jenë dhënë aq me përpikëri, sidomos në shtojcën e tekstit, disa nuanca të shkodranishtes, shikuar në prizmin sintaksor.”

<sup>376</sup> Po ai, po aty, f. 320.

<sup>377</sup> Po ai, po aty, f. 320. Për hir të së vërtetës, duhet të shënojmë se gramatika e Buseti-t nuk mban titullin e mësipërm, por ballina ka këto të dhëna: P.Antonio Buseti S.J. “Pratica e Grammatica della Lingua Albanese, con 158 Esercizi ed un rispettivo VOCABOLARIETTO, Shkodër, Shtyp. e Zojës s’Paperlyeme”, 1914.

<sup>378</sup> P.Antonio Buseti S.J., *Grammatica albanese* (seconda edizione interamente rifatta), Scutari, Tipografia Immacolata Concezione, 1933.167 faqe.

Lidhur me qëllimin e hartimit të këtij fjalori, mësojmë në parathënien e shkruar prej vetë autorit:

*“Kam kompiluar këtë fjalor, me qëllimin të ndihmoj në përvetësimin e gjuhës shqipe ata që tashmë e njohin italishten. Këto pak nocione gramatikore, që përmban fjalori, mund t’u shërbejnë atyre që s’kanë njohuri të kësaj gjuhe. Nëse kjo punë arrin një farë përparësie, siç doja të shpresoja, janë të falënderuar Zoti dhe gjithashtu bashkëvëllezërit e mi të besimit, të cilët më dhanë një ndihmë jo të vogël.”*

*Shkodër e Shqipërisë, 25 maj 1911.*

*Përpiluesi*

Fjalësi i fjalorit zë hapësirën nga faqja 1 – 1140; vijon me disa emra njerëzish më të përdorur në Shqipëri (1141 – 1143), ku bien në sy emra tradicionalë vendës, si: Shutë, Dushe, Agetinë, Anja, Anjeze, Agostin, Cin, Sandër, Lekë, Llesh, Taze, Nushë, Prendë, Zogë, Anë, Ndrejë, Ejll, Lush, Lulash, Tone, Tonine, Nine, Ndue, Ndokë, Balto, Bardel, Bardec, Vashë, Vasil, Vasë, Vatë, Katë, Çile, Cinë, Daniel, Dilë, Dedë, Lenë, Gjelosh, Gasper, Jak, Gjergj, Gjon, Markush, Tush, Marë, Kolec, Linë, Pal, Pashko, etj, etj.; ndërsa mbyllet me paraqitjen e mjaft emrave gjeografikë më të njohur në Shqipëri (f.1144 – 1147), ndër të cilët nuk ka vetëm toponime vendase, por edhe emra shtetesh në Evropë e më tej.

Siç veprohet përherë në fjalorë të tillë dygjuhësh, Busetti i ka paraprirë fjalorit me disa nocione paraprake gramatikore të gjuhës shqipe; është një gramatikë e mjaftueshme për njohuritë themelore të shqipes,<sup>379</sup> që zë fill

<sup>379</sup> Busetti është autor edhe i dy dy gramatikave të shqipes, njëra: P. Antonio Busetti S.J., *Pratica e grammatica della lingua albanese*, con 158 esercizi ed un rispettivo VOCABOLARIETTO, Shkodër, Shtyp. e Zojës s’Papërljeme, 1914; dhe tjetra: P. Antonio Busetti S.J., *Grammatica albanese*, sekonda edizione interamente rifatta, Scutari, Tipografia Immacolata Concezione, 1933. Në të parën autori u drejtohet të vegjëlve: *“Ho scritto quest’operetta per iniziarti allo studio dell’albanese e dell’italiano. L’ho divisa in tre parti. Nella prima, per conformarmi alla tua piccola intelligenza, mi sono accontentato di ricreati con alcuni Esercizi brevi e facili, senza romperti il capo regole grammaticali: e ciò è conforme al titolo del libro, che promette prima la pratica. Un po’ di grammatica, però, ci sarà nella seconda parte, dove ho auto di mira che tu apprenda qualche regoletta e la cognizione dei verbi ausiliari essere ed avere. Nella terza poi mi sono prefisso di darti una nozione grammaticale quanto basta, a parer mio, affinché possa intraprendere a suo tempo lo studio del franceze e del tedesco. Ho voluto anche favoriti d’un piccolo Vacabolaririo, che ti potrà servile quando non ricordi il corrispondente di qualche parola... Scutari d’Albania 1 Agosto 1914, L’autore. Në librin tjetër, botuar më 1933, autori thekson përsëri se edhe në këtë botim të dytë, sikurse në të parin, ka si qëllim të parë të ndihmojë studiuesit për të përvetësuar gjuhën shqipe mirë dhe në një kohë të shkurtë. Të dyja gramatikat e Busetti-t do të kërkonin një studim më vete, për përmbajtjen e tyre dhe metodën e zgjedhur prej tij.*

me njohuritë nga fonetika: me paraqitjen e alfabetit shqip, praktika për leximin e tij, çështje të tingullit të pazëshëm “ë”, gjatësinë e zanoreve, theksin e fjalës, deri në kapitullin I, që i kushtohet emrit. Brenda të dhënave morfologjike, autori i ndan emrat në tri lakime: në lakimin e parë përfshin emrat që në numrin njëjës, mbarojnë me *-a*; në të dytin ata emra që marrin *-i*, kurse në lakimin e tretë, emrat që shquhen me *-u*, duke sjellë modele paradigmatsh për secilin, shoqëruar edhe me shënime për rregulla, përjashtime dhe parregullsi që ndeshen. Lakimi jepet në dy trajta dhe sipas 7 rasave, të cilat njiheshin dhe zbatoheshin në gramatikat shqipe të kohës: *emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, thirrore, rrjedhore, vendore*, të reduktuar tashmë në 5 rasa. Është interesante të vihet në dukje se Busetti nuk flet për lakim të emrave asnjans; ata i quan *emra foljorë* (sostantivi verbali), duke shënuar se po i paraqet paradigmat e veçanta të këtyre emrave me këtë emërtesë, pasi rregullisht ata rrjedhin nga foljet; quhen, shkruan Busetti, se quhen edhe asnjans, por në konkordanca sillen sikur të ishin femërorë, për shembull: *t'ardhun – t'ardhunit*. Nocionet e gjera gramatikore të fjalorit të autorit vazhdojnë me njohjen e mbiemrave të nyjshëm e të pa nyje, me njohjen me përemrat: vetorë, pronorë, dëftorë, lidhorë e pyetës.

Kapitulli V (f.29 – 55), zë pjesën më të madhe të gramatikës dhe i kushtohet foljes, filluar me zgjedhimin e tyre në mënyrën dëftore (në 7 kohë), mënyrën urdhërore (2 kohë), habitore (2 kohë), lidhore (në 4 kohë), mënyrën kushtore (2 kohë), dëshirore (3 kohë), pajisur me rregulla dhe parregullsi në paradigmat e tyre. Është interesante të tregojmë se autori i huaj jep edhe dy mënyra të tjera, të pazakonta në gramatikat shqipe në atë kohë dhe më pas, pikërisht: *mënyra e mundësisë* (modo possibilitativo) dhe *mënyra e domosdoshmërisë* (modo necessitativo). Format e pashtjelluara Busetti i quan përgjithësisht *mënyrë paskajore* (modo infinito) dhe jep tabelën e mëposhtme:

E tashme –	<i>me kenë.... me pasë;</i>
E shkuar –	<i>me pasë kenë ... me pasë pasë;</i>
Pjesore e tashme –	<i>kenës.....pasës;</i>
Pjesore e shkuar –	<i>kenun.... pasun;</i>
Gerundi i thjeshtë –	<i>tui kenë – tui pasë;</i>
Gerundi i përbërë –	<i>tui pasë kenë – tui pasë pasë.</i>

Autori i ndan foljet në 2 zgjedhime sipas mbaresës që marrin ato në pjesore: *me shkue, me ba ; me prekë, me paditë* etj.; jep modele paradigmatsh për secilin zgjedhim, me mjaft shënime gramatikore, f. 41 –



45. Me zgjedhimin pësor, vetvetor dhe me një paraqitje zgjedhimi të dhjetëra e dhjetëra foljeve të parregullta, mbyllen të dhënat e gramatikës së gjuhës shqipe, para fjalorit të Busetti-t.

### Fjalësi i fjalorit

Fjalori i Antonio Busetti-t ka parametrat e një fjalori modern, sipas të gjitha të dhënave leksikografike të një vepre të tillë. Kjo duket që nga të quajturat “shkurtime kryesore” që gjenden në fjalor; aty gjejmë jo vetëm terma gjuhësorë e morfologjikë, por edhe shënime stilistike, si: kuptim i figurshëm, e dhënë fizike, fjalë e sferës morale, fjalë neutrale (tregues që e paraqet më të përparuar se Fjalori i Bashkimit, dalë 3 vjet para tij) dhe, ç’është e rëndësishme, me një asterisk (\*) janë dalluar etimologjitë turke e arabe. Fjalësi i fjalorit ka nga dy kolona në çdo faqe dhe për secilën leksemë jepet përkatësia si pjesë e ligjëratës, treguesit gramatikorë dhe sinonimet përkatëse të fjalës, si dhe proverba të rralla, për shembull:

**abbattuto**, a, (fisc.), (i,e) rruzem e, (i,e) permyzun. – (*abbattuto di forze*), (i, e) kputun, (i,e) shkalitun, (i,e) molisun, (moralmente) zemerlshuem e.<sup>380</sup>

**abito**, m. petk-u, pl. a-t, m. –fare un vestito; me pre nji petk. Es: quando t’hanno fatto quel vestito? Kuer t’a kan pree at petk? – far l’abito (*abituarsi*) m’u msue. – aver l’abito (*l’abitudine*), me pasë per zakon, me pasë zanat. Es: ha l’abito del rubare; e kaa zanat ovv. Per zakon hainiin.<sup>381</sup>

**accordo**, m. uidii-ia, pl. ii-t, f. godii-ia, pl. ii-t, f. godi (ind.) – andar d’accordo, me shkue mirë, me i pasë pipat bashkë, me u ra pipxat. – essere d’accordo, me kenë n’nji fialë. Venire ad un accordo, me raa n’godi ovv. n’uidii.<sup>382</sup>

**acqua**, f. ui-uji, pl. uina-t, m. – acqua stagnante, ui amull. – qyqua piovana, ui brrakash – acqua profonda e quieta, linaz (indecl.) – terreno pregno d’acqua, botinë-a, pl. a-t f. – acqua che doppo la pioggia aderisce alle foglie, erbe ecc. lagshtë, pl. a-t, f. – trovarsi in cattive qcque, me ra ngusht, me ra n’pil[ t’hallit].<sup>383</sup>

<sup>380</sup> Faqe 3.

<sup>381</sup> Faqe 7.

<sup>382</sup> Faqe 15.

<sup>383</sup> Faqe 19.

**acquavite**, f. rakii-a, pl. ii-t, f.- acquavite artefatta, mastikë, pl. kë-t f. – fare l’acquavite, me piekë rakii – myte kaalin me tagjii, myte plakun me rakii, (prov. che vuol dire): come al cavallo fa bene abbondante biada, così al vecchio abbondante acquavite.<sup>384</sup>

**addolorare**, va. me idhnue, me çartë zemren, me prishë zemren. Es: quella parola m’ha addolorato, ajo fialë m’a kaa prishë zemren.<sup>385</sup>

**affiarsi** (convenire), vn. me pasë hije (col.dat, di pers. o di cosa). Es: non gli si affa quel discorso; s’kaa hije ajo bisedë; andar d’accordo, me shkue mirë.<sup>386</sup>

Me shumë sinonime jepet shpjegimi i fjalës “**affliggere**”, va. me idhnue, me pervnerë, me gandue, me sikletue, me ja çartë ovv. me ja prish zemren. – **mortificare**, me mundue, me shterngue, me dhanë shterngim ovv. ezgjet.<sup>387</sup>

**amministrare**, (governare), va. me sundue, me marështue. – aver cura di qualche cosa, m’u perkuidesë per..., me pasë n’kuidesë, me i ardhë rreth, me i ra mrapa. – Es: amministra bene le cose del padrone; perkuideset per t’mirat etj., i kaa n’kuides t’mirat etj., u vien rreth t’mirave etj., u bie mrapa t’mirave etj., - amministrare l’estrema unione, me vojue.<sup>388</sup>

**amore**, m. dashtnii-a, pl.ii-t, f. \*hater i, m. amore disordinato, \*jeranii-a, pl. ii-t, f. dashtnii-a e mbrapshtë. – amor patrio, dashtnii per atdhee, atdheedashtnii-a, f. – amor proprio, vetdashtnii-a, f. e vehteia, f.<sup>389</sup>

Jo rrallë, fjalët dalin me shpjegime të gjera, plot frazeologjizma, siç është rasti me fjalët “**animo**” dhe “**anno**”:

**ànimo**, a. shpirtë-i, pl. tna-t, m. – con tuttë l’animo; me gjithë shpirtë. – con tutte le forze dell animo; me gjith fuqii t’shpirtit. – di mal animo; me t’keqe t’zemers. – perversi d’animo, cader d’animo, m’u toipiitë ovv. me lshue zemra. Es: non si perdette d’animo; s’u topit ovv. s’e lshoi zemra. – bastare

<sup>384</sup> Faqe 19.

<sup>385</sup> Faqe 23.

<sup>386</sup> Faqe 29.

<sup>387</sup> Faqe 31.

<sup>388</sup> Faqe 57.

<sup>389</sup> Faqe 59.

l'animo; me punue ovv. me baa zemra. Es: non gli basto l'animo di dire...,s'i punoi ovv. s'i bani zemra me thanë. – venire in animo, m'u mush mendja, ovv. me le me zemer. Es: mi venne in animo d'abbandonare il mondo: m'u mush mendia ovv. m'leu n'zemer me braktisë shekullin. – andare, passare per l'animo, me shkue neper krye. – far animo, me zemrue, me trimnue, me baa zemer, me dhanë gairet. – leggere nell'animo d'alcuno, me ja blee menden. – stare di buon animo, m'u trimnue, m'u zemrue.<sup>390</sup>

**anno**, m. vietë-a, anche vietë-i, pl. vietë-t, f. \*sende -ia, pl. e-t, f. mot-i, pl. e-t, m.-anno solare, vietë diellore, - anno lunare, vietë hanore, - anno astronomico, vietë hyitore, - anno civile, vietë shekullore, - anno ecclesisastico, vietë kishtare, - anno di grazia, vietë mbas Krishtit, - anno santo (giubileo), shendviet-i, pl. e-t, m. – anno bisestile, vietë perishtup, ovv. vietë brishtë. – capo d'anno, anno nuovo, motmot i rii. quest' anno, sivjet ovv. siviet. – l'anno scorso, viet – di quest'anno, (i,e) simietshem e – due anni fa, parvjet, parvieti. – oggi anno, perviet. – di oggi anno, (i,e) pervietshem e. di anno in anno, per vietë, vietë n'vietë, vietë per vietë. – anni fa, anni sono, tesh saa vietë. – essere innanzi vogli anni, me kenë shtye n'mot, - avere due cinque, vent'anni ecc.me kenë dy, pes, njizet vieç ovv.vietësh. – carico d'anni, (i,e) motësyym – saper mill'anni, memzii ç'... Es: mi sa mill' anni di vederlo, memzii ç'pre m'e paa. – nei suoi verdi anni, n't'rii t'vet.<sup>391</sup>

**bene**, avv. Mirë, marë – molto bene, mirë fort, bukur mirë, për faqe t'bardhë.-voler bene, me dashtë, me dashtë mirë, me pasë per zemer. – pigliare in bene, (in buona parte), me marrë me t'mirë. – credere bene, me pa me rrugë, ovv. me udhë, - pagar bene una cosa, m'e laa shtrepit, - di bene in meglio, mirë e ma mirë, - or bene, e mirë, - quasi ad ogi augurio si risponde: mirë paç: (abbi bene). – bene ti sta (te l'hai merito), mirë e kee.<sup>392</sup>

**berteggiare**, va. me qestisë, me vuu n'loi, me qeinue, me vuu n'shoshë, me vuu n'bisht të lahutës.<sup>393</sup>

**boccone**, m. kashatë-a, pl.a-t, f. – boccone dilicato, \*meze-ia, pl.e-t, f. – il boccon grande ti soffoca, kashata e madhe t'xenë fytin; (prov.), fa il paso seconda la gamba. – in- goiar i bocconi ingordamente, me rruckullue.<sup>394</sup>

<sup>390</sup> Faqe 65.

<sup>391</sup> Faqe 67 – 68.

<sup>392</sup> Faqe 130.

<sup>393</sup> Faqe 123.

**bugia**, f. rrenë-a, pl. a-t, f. – la bugia ha le gambe corte ; rrena i ka kamët e shkurta. –luminico con manico, bishtuk-u, pl. kë-t, m.<sup>395</sup>

**cadere**, vn. me raa, m'u rrzue. – cadere con impeto, m'u planosë. – far cadere, me rrzue, me gremitë – cadere dalla stanchezza, me metë, m'u gofye, - cadere in potere, me raa n'dorë, - cadere d'animo, me lshue zemra. Es: non cadde d'animo, s'e lshoi zemra. – cader malato, me raa i lig. – cader opportuno, me raa mirë, me xanë vend – Es: qui cade opportuna la sentenza; ktu bie mirë fiala, ovv. xen vend. – cader in miseria, me raa n'skam, - cadere in disgrazia di quale. \*me i dalë hatrit. – cadere il discorso, me raa biseda ovv. me bisedë – cadere in animo, in mente, me raa n'mend. Es: non gli è caduto in mente di dirglielo; nuk i raa n'mend me ja thanë. – cadere sotto la legge, sotto l'articolo, me kapë ligja, artikulli. Es: cade sotto la legge questo fatto? A e kapë ligja ket ndolli?<sup>396</sup> etj..

Nëse shohim me vëmendje leksikun e përfshirë në fjalorin e Busetti-t, vëmë re qartë se autori ka vjelë fjalë të sferave të ndryshme: nga familja, punët bujqësore, blegtorale, veshjet e banorëve, veprimtaria e përditshme e njerëzve, por nuk mungon as fjalori diturak, siç quhen fjalët e sferës së inteligjencës, si: akademikisht (accademicamente), shpërdorim (abusivamente), t'kaparuemit (accaparramento), me theksue (accentare), ujdii (accordo), etj.. Fjalët turke janë shënuar me \* dhe, sipas krahasimit me fjalorët e sotëm, janë shpjeguar mirë: \*ziafet-i, gostë; \*(i,e) ganishem, i bollekshëm; \*kallablek-u, popull i madh; \* t'begenisun, pëlqim; \*me meremetue, me ndreqë (goditë); \*hardub-i, cub; \* i pa insaf , nieri i pa dhimë; \*me baa konak, me perbuitë, me kondisë; \*hanxhii-a, perbuits; \*qeflii –a, dashtnitar; \*zalldan-i, idhnim; \*haber-i, laim; \*laverdaa-ja, vend i hapët; \*qoshelii e, skitar e; \*m'u ba razii , me pëlqye; \*mushtulluk-u, t'laimtuemit, laimsii-a; \*derman-i, mëngjii-a; \*jerdamxhii-a, krenar, kryenalt-i; \*me kapllue, me xanë; \*me kurdisë, me ndreqë, me shestue; \*ispatë, me baa deshmi; \*qyrek-u, vangë; \*hamam-i, baië-a; \*katile, barbarisht, etj.. Turqizmat dhe arabizmat, siç i quan autori, janë në masën që në kohën e tij ishin të përdorshme, ashtu si gjenden edhe në Fjalorin e Bashkimit, prandaj dhe janë pasqyruar si fjalës aktiv të ligjërimit të popullit.

<sup>394</sup> Faqe 140.

<sup>395</sup> Faqe 152.

<sup>396</sup> Faqe 156.

Nisur jo vetëm nga vlerat e fjalorit, që për kohën kur u hartua ka pasur rëndësinë e vet për pasurinë e fjalësit dhe gramatikën hyrëse, por edhe nga librat e gramatikës, Antonio Buseti meriton të studiohet në leksikografinë shqiptare, pasi ai ia doli të hartonte një fjalor mbi kritere gjuhësore të drejta; ai përpiloi edhe dy gramatika shqipe për të mësuar misionarët e huaj gjuhën e vendasve dhe për t'i shërbyer më mirë popullit. Jo veç fjalori, por edhe librat për mësimin e shqipes duhet të zënë një vend të merituar në historinë e gjuhës së shkruar shqipe.

#### BIBLIOGRAFI:

1. *Vocabolario Italiano-Albanese*, compilato dal P. Antonio Buseti S.J., Scutari d'Albania, Tipografia dell'Immacolato, 1911.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Leksikografia shqipe* (Trashëgimi dhe perspektivë), Tiranë, 2005.
3. P. Antonio Buseti S.J., *Pratica e grammatica della lingua albanese*, Shkoder, Shtyp. e Zojës s'Paperlyeme, 1914.
4. P. Antonio Buseti S.J. *Gramatica albanese*, seconda edizione interamente rifatta, Scutari, Tipografia Immacolata Concezione, 1933.
5. *Fjaluer i Rii i Shcypes*, Perbam Preie Shocniet t' Bashkimit, Rilindja, Prishtinë, 1978.
6. Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
7. Ferdinand Leka-Zef Simoni, *Fjalor italisht-shqip*, Infbotues, Tiranë, 2000.
8. Mehmet Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Enti botues "Gjergj Fishta", Lezhë, 2006.
9. Instituti i Shkencave, Sekcioni i Gjuhës e i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.
10. Jani Thomaj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Shtëpia botuese "Shkenca", Tiranë, 1999.
11. Jup Kastrati, *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
12. Pavli Qesku, *Fjalor themelor i gjuhës shqipe*, EDFa, Tiranë, 2008.
13. Modern Dizionario. *Lingua italiana*, LITTLEITALY- Milano, 2011. Stampa Lito Terrazzi, Firenze.
14. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972.
15. "Shejzat", 7-8, 1962.
16. Markus W.E. Peters, "Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur", *Die "Buchdruckerei der Unbeflecten Empfängnis" zu Shkodra (1870-1945)*, Verlag Dr. Kovač, Hamburg, 2007.

**100 - a dictionary ANNIVERSARY OF bilingual  
(Italian-Albanian Dictionary of Antonio P. Buseti-t)**

***SUMMARY***

In this script the author has reflected an Italian-Albanian dictionary, published in 1911, in Shkodra city, composed by the Italian missionary Antonio Buseti, who was also the author of two practice grammar books of Albanian language. He was docent in Saverian Kolege and also a director of the Saverian Kolege newspaper.

This dictionary with 1147 pages & with nearly 30.000 words in it, continued a tradition of dictionaries that the foreigners used to edit in order to learn the Albanian & Italian languages. The Buseti`s dictionary has the indications of a scientific dictionary for the time it was written & it holds in words of different areas for daily use, words of knowledge & enough Turkish words frequently used in that period.

The author has described the time the dictionary was published and its structure through some words from the Albanian language explained correspondingly and some well known idioms and proverbs as well.

**Drita BRAHIMI**

**TRE KOLOSË TË LETRAVE SHQIPE, FRANCEZE DHE AMERIKANE, PETRO MARKO, ANDRE MALRO DHE ERNEST HEMINGUEJ  
(PËRPJEKJE PËR STUDIM KRAHASUES )**

Në këtë punim, jam munduar të paraqes tre kolosë të letërsisë shqiptare, franceze dhe amerikane, si tre itinerare paralele të të njëjtit realitet, Lufta e Spanjës, si prelud i Luftës së Dytë Botërore. Bëhet fjalë për një përjasje më tepër biografike dhe tematike.

Së pari, kam vënë në dukje domethënien e titujve të romaneve, që shërbejnë si një pikënisje për të kuptuar veprat e tyre.

Së dyti, këndvështrimet origjinale përbëjnë një aspekt të veçantë të këtij punimi, pasi lexuesi arrin të krijojë një imazh letrar dhe ideor të secilit autor, pa lënë mënjanë emocionet që ngjallin tek lexuesi bashkëkohor, edhe pse është shkruar për një ngjarje të largët në kohë.

Ky punim përbën një përpjekje në drejtim të përjasjes biografike dhe tematike të këtyre tre autorëve me tre romanet *Hasta la Vista*, *Shpresa* dhe *Për kë bie kembana*.

Përjasja fillon që nga tre metaforat e titujve të tyre. *Hasta la Vista*, *Shpresa* dhe *Për kë bie kembana* do t'i konsideroja si tre romane me tri konotacione të përbashkëta, pasi ato të bëjnë të kujtosh pika takimi, një ndër të cilat është ëndrra e tyre për të krijuar vlera njëjësore të gatshme për të luftuar kundër së keqes, kundër fatalitetit, por edhe tingëllon qartë bindja se humbja e një beteje nuk është fundi i lufës së popujve kundër fashizmit.

*Hasta la Vista*. Një fjalë që po të përkthehet në shqip ka kuptimin *Mirupafshim*. Kjo fjalë merr kuptime të ndryshme në romanin e Petro Markos.

Një ndër kuptimet kryesore është përdorimi i kësaj fjale nga dy personazhet Gori – Anita si shpresë për ritakime të tjera. Kjo shprehje *Hasta la Vista* kthehet në një leitmotiv të këtyre dy të rinjve të cilët janë takuar e njohur në kohë të vështira dhe *Mirupafshim* do të thotë të mbijetosh. Dalëngadalë kjo *Hasta la Vista* tek këto dy personazhe nuk simbolizon vetëm takimin e tyre përsëri në këtë jetë, por edhe atë të personazheve të tjera të cilët duan të shprehin se kohë më të mira do të vijnë.

*Hasta la Vista* mund të jetë përdorur nga Petro Marko sepse një nga pengjet e tij ishte edhe moskthimi i tij në Spanjën e bukur e plot diell. Ai e kishte ëndërr të kthehej qoftë edhe një herë të vetme në Spanjën e kujtimeve të paharruara dhe “Hasta la Vista” e Gorit në fund të romanit i drejtohet jo vetëm Anitës por edhe Spanjës, për të cilën ishte gati të jepte edhe jetën dhe të cilës i dhuroi madje edhe zemrën.

*Hasta la Vista* është një përshëndetje që përdoret nga djemtë antifashistë spanjollë që kur të kthehen në shtëpi t’i gjejnë të gjithë shëndoshë e mirë. Pra, kjo metaforë e përdorur nga Marko shërben si një shpresë për një botë më të lirë e demokratike, gjithmonë në paqe e në vëllazërim.

*Shpresa* e Malrosë është një ekzaltim i një aksioni vëllazëror dhe kolektiv i paraqitur në vepër në mënyrë krejt origjinale. Kjo metaforë, e cila përshkon tërë romanin shfaqet që në fillim të romanit në shprehjen “*forca më e madhe e revolucionit është shpresa*”.<sup>397</sup>

Ku qëndron kjo shpresë? Përgjigjja bëhet e qartë me zhvillimin e ngjarjeve të veprës, në pritjen e një bote të re, të një fitoreje vëllazërore.

Duke i dhënë këtë titull veprës së tij, Malro nuk mbështetet vetëm tek çështja e luftës. Kështu, zbritja nga mali në fund të romanit, si “zbritja e kryqit”, të cilën e paraqet në planin e artit figurativ, nuk shpreh nënshtrimin ndaj vdekjes, por fitoren e njeriut, e njerëzve të angazhuar krah për krah njëri - tjetrit mbi vdekjen. Me të drejtë romani *Shpresa* mund të konsiderohet si simboli i triumfit mbi tiraninë dhe vdekjen. Personazhet e përballojnë fatin, d.m.th. atë ç’është jashtë njeriut duke i dhënë ndërgjegjen e ekzistencës së tij, pra, qetësinë e botës dhe indiferencën kozmike mbi të cilat profilizohen shumë skena të veprës. Në këtë këndvështrim, *Shpresa* bën një kalim nga tragjika te epikja sepse subjekti i kësaj vepre është marrëdhënia e popullit spanjoll me mbijetesën, me vlerat që ai i mbron e me shpresën që e gjallëron, por gjithnjë duke pasur parasysh që kjo bëmë të mos çojë në dështim dhe në vdekje.

Titulli i zgjedhur nga autori francez Malro hap perspektivën e së ardhmes duke shpalosur në këtë mënyrë historinë e një populli si dhe pjesëmarrësve nga vende të ndryshme të botës, të cilët luftojnë në vëllazërim për lirinë e Spanjës e që duan të tregojnë mjetet për të arritur dhe për të dominuar fatin e tyre. Ja përse romani mbyllet me këtë ide: “*Manueli dëgjonte për herë të parë zërin e asaj që është më e rëndë se*

<sup>397 397</sup> MALRAUX, André. *L'espoir*. Folio plus, 1996, f. 65.



*gjaku i njerëzve, më shqetësuese se prania e tyre në tokë, mundësinë e pafund të fatit të tyre*”<sup>398</sup>

*Për kë bie këmbana?* është një pyetje imagjinare e një njeriu që dëgjon një zile funerali dhe të cilës Xhon Done<sup>399</sup> i përgjigjet: “*Asnjëri nga ne nuk qëndron vetëm në këtë botë, vdekja e secilit ndikon tek ne. Çdo zile funerali, pra, bie për ty*”<sup>400</sup>. Janë pikërisht këto fjalë që Heminguej preferoi t’i vinte në epigrafin e romanit të tij e për më tepër ta titullonte me këtë shprehje; *Për kë bie këmbana*. Për ta shpjeguar më mirë domethënien e titullit, jemi përpjekur ta trajtojmë nisur nga dy aspekte kryesore; tematik dhe politik.

Së pari, titulli *Për kë bie këmbana* thekson rëndësinë e vlerave universale të ndjenjave njerëzore, të cilat e nxisin heroin kryesor të romanit të lërë atdheun për të mbrojtur këto vlera në një luftë të një vendi të largët siç ishte Spanja. Gjatë leximit të veprës ne vëmë re që Robert Xhordan i sheh këto vlera të komplikuar nga cinizmi i fituar në luftë dhe nga një mungesë qartësie morale në radhët e udhëheqësve të korruptuar dhe të paafte republikanë. Përsëri nga fundi i romanit, Robert Xhordan mëson t’i përqafojë këto vlera të njëjta, me anë të lidhjeve të thella që ai vendos me luftëtarët guerilas edhe pse për një periudhe të shkurtër kohore (vetëm tri ditë). Robert Xhordan bën përpjekjen e tij të fundit - hedhjen e urës në erë me qëllim që të largojë afrimin e kavalerisë fashiste e të mundësojë ikjen e miqve të tij.

Për më tepër, titulli i romanit na ndihmon të interpretojmë skenat e tmerrshme të brutalitetit dhe vrasjeve që Heminguej na i paraqet me mjeshtëri. Për shembull, mizoria e ekzekutimeve në fshatin e Pablos lë njolla të pashlyeshme në mendjet e atyre që janë të pranishëm – Pilar, Pablo dhe njerëzit e tij. Po kështu, Lietenant Berrendo i ndjen efektet jo vetëm të vdekjes së shokut të tij, por edhe të kasaphanës së njerëzve të El Sordos. Edhe vetë Robert Xhordan, i cili vret jashtë detyre, nuk arrin t’i shpëtojë kësaj situatë. Na çudit fakti që Heminguej përmes monologjeve të shpeshta të Robert Xhordanit në lidhje me luftën, gjykon vrasësin dhe njëkohësisht e justifikon atë, kjo sepse parimet e tij janë pro jetës, megjithëse rrethanat e vështira në të cilat ndodhet e kushtëzojnë të besojë se për t’i kthyer botës bukurinë e paqen duhet luftuar e ndoshta edhe vetësakrifikuar.

<sup>398</sup> MALRAUX, André. *L'espoir*. Folio plus .1996, f. 606.

<sup>399</sup> <http://www.poetryfoundation.org/bio/john-donne> ; John Donne is a great English poet, and one of the greatest writers of English prose.

<sup>400</sup> <http://www.sparknotes.com/lit/belltolls/study.html#explanation1>

Së dyti, po ta shqyrtojmë nga pikëpamja politike, titulli i romanit *Për kë bie këmbana* pasqyron pozicionin e Heminguejt, më tepër antifashist sesa prokomunist. Ja se si shprehet protagonistin kryesor i romanit në një nga dialogjet e tij me Pilarin: “- Komunist je ti ?- Jo, unë jam antifashist që kur e kam kuptuar ç’është fashizmi”<sup>401</sup>.

Si shumë intelektualë perëndimorë, Heminguej e sheh luftën civile të Spanjës si një betejë simbolike ndërmjet autoritarizmit dhe si një alternativë më e mirë humaniste dhe liberale. Në këtë këndvështrim, titulli shpreh në njëfarë mënyre simpatitë e autorit për personazhet që marrin pjesë në luftë.

Nisur nga elementët biografikë të secilit autor, pikat e takimit konvergjojnë në mënyrë të përkryer: Petro Marko, një djalosh nga Shqipëria, Andre Malro një i ri nga Franca dhe Ernest Heminguej nga Amerika e largët nisen në Spanjë për të marrë pjesë në Luftën e Spanjës në mbrojtje të lirisë dhe demokracisë që rrezikohej nga një e keqe e madhe; bisha fashiste. Të tre këta shkrimtarë dhe gazetarë marrin pjesë në Kongresin e Shkrimtarëve të organizuar në Barcelonë, si përçuesit e parë të realitetit spanjoll, një realitet i dhimbshëm që i përket mbarë njerëzimit.

Tani do të ndalem te këndvështrimet origjinale, të cilat ne i kemi konstatuar gjatë leximit të këtyre tri veprave.

Pasi mbaron së lexuari veprën *Hasta la Vista*, të bën përshtypje mënyra se si Petro Marko ia ka dalë mbanë, që në 500 e ca faqe të shkruajë historinë e një jete katërvjeçare në Spanjë, të mbarsur me shumë peripeci dhe shumë ngjarje. Romani, nga njëra anë, është një përshkrim realist i historisë së Spanjës së atyre viteve pa lënë pas dore dhe realitetin shqiptar të asaj kohe dhe sigurisht, nga ana tjetër, është edhe një përshkrim poetik letrar i bërë me mjeshtri dhe finesë.

Përshkrimi i Markos është më realist se sa ai i Malrosë. Që nga 1938, ndodhën shumë ngjarje të tjera në Spanjë dhe romanin e tij *Hasta la Vista*, Petro Marko e shkroi në vitin 1956, 20 vite më vonë. Marko nuk të lë përshtypjen se romani është shkruar në këtë vit, duke i përshkruar ngjarjet me aq korrektësi dhe vërtetësi, pa u ndikuar fare nga ngjarjet që pasuan luftën e Spanjës. Edhe fashizmit ai i referohet si një e keqe e madhe, por ai nuk tregon asgjë në lidhje me atë që ka ndodhur në vitet në vazhdim.

Tek Malro të habit fakti se si ndërtimi i librit bëhet një me vorbullitjen e luftës së Spanjës në fillimet e saj, sikur tregimi del ashtu i armatosur e i gjakosur nga luftimet. Personazhet, edhe pse të sajuar, përfaqësojnë situata konkrete ose të mundshme përballë revolucionit dhe

<sup>401</sup> HEMINGUEJ, Ernest, *Për kë bie këmbana*, Shtëpia botuese ombra GVG, Tiranë, f. 79.

fashizmit, të privuar nga çdo biografi, nga çdo e kaluar, ballë për ballë me vdekjen, ata rigjejnë këtë “jetë themeltare” që e përshkon rrëfimin . Ç’është kjo jetë themeltare? “dhimbje, dashuri, nënshtrim, pafajësi”<sup>402</sup>.

Po t’i referohemi veprës së Heminguejt, *Për kë bie këmbana*, i shkruar 3 vite pas mbarimit të luftës, gjejmë shumë pika takimi midis saj dhe romanit *Hasta la Vista* të Petro Markos.

Ndryshe nga Malro, emrat e vendeve, personazheve, ngjarjet historike e deri tek datat dhe të dhënat e *Hasta la Vista* janë shumë korrekte. Shumë personazhe të tjera janë të vërteta dhe kur lexon romanin kupton se emrat e tyre që janë përdorur janë realë. Ai u ka ndryshuar emrat vetëm personazheve që kanë qenë gjallë, për të mos ndikuar në jetën e tyre dhe intimitetin e për këtë mendoj se mund të ketë ndryshuar edhe emrin e Anitës. Anita e romanit, nga ana e saj, është një vajzë spanjolle, të cilën shkrimtari e njihnte dhe që na e ka sjellë përmes përshkrimit letrar si shembull të gruas dhe të rinisë spanjolle.

Nga ana tjetër, pas leximit të romanit të Heminguej, dallojmë ngjashmëritë që ka me *Hasta la Vista* e Markos, fakt ky i pohuar nga vetë autori Petro Marko, i cili i drejton një letër Hemingueijt duke i shkruar këto fjalë: “*I frymëzuar thellë dhe i nxitur nga romani juaj “Për kë bie këmbana”, kushtuar vullnetarëve amerikanë, që ranë në Spanjë, unë shkrova këtë roman modest, kushtuar shqiptarëve, që ranë në Spanjë*”<sup>403</sup>. Pikërisht, ngjashmëri gjejmë edhe në mënyrën e ndërtimit të ngjarjes dhe ndërthurjes së personazheve. Anita e Markos ekziston edhe te vepra e Heminguejt, e njohur me emrin Marie. Këto dy femra kanë role kyçe në vepra, sepse ata janë frymëzimi dhe shërimi i heronjëve kryesorë. Të dyja kanë patur fate tragjike të familjarëve për shkak të luftës dhe të dyja jetojnë nën përkujdesjen e njerëzve të besuar. Të bukura, të bindura dhe shumë të ndjeshme, ato i japin dimensione të ndryshme veprave, duke i bërë më emocionuese dhe të gjalla ngjarjet. Përkundrazi, në veprën e Malrosë elementin e dashurisë nuk e gjejmë fare të ndërthurur me linjën e luftës; ndryshe nga dy romanet e tjera. Madje Malro e gjykon dashurinë si një tabu në kohë lufte, pasi në kohë lufte nuk ka kohë për dashuriçka.

Si përfundim, theksoj se veprat e tyre nuk bazohen thjesht në fantazi, por kanë edhe një funksion njohës të qëndrueshëm e janë një poezi e gjallë mendimesh e idesh të thella. Ata përbëhen nga copëza narrative, ku çdo detaj i bën jehonë një ngjarjeje historike të jetuar apo të sajuar nga këta

<sup>402</sup> MALRAUX, André. *L'espoir*. Folio plus .1996, f..63.

<sup>H</sup> HEMINGUEJ, Ernest, *Për kë bie këmbana*, Shtëpia botuese ombra GVG, Tiranë, f. 4 (Parathënie e Petro Markos në këtë roman).

shkrimtarë të mëdhenj. Edhe pse realitet i largët në kohë, librat e tyre lexohen me endje falë ideve që ata përçojnë dhe vlerave të padiskutueshme estetikeo-artistike që ata shpalosin para lexuesit.

#### BIBLIOGRAFI:

1. ALIU Ali, *Katër romane të Petro Markos*, Tiranë, 1990.
2. ALIU Ali, SINANI Shaban, ÇAPALIKU Alfred, ÇOBANI Tonin, *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Shtëpia Botuese ALB- Ass, 2001.
3. BENASSAR Bartolomé, *Histoire des Espagnols*, Paris, A.Colin, 1985, 2 vol.
4. HEMINGUEJ Ernest, *Për kë bie këmbana*, Ribotim, Shtëpia botuese ombra GVG, Tiranë, 2003.
5. MALRAUX André. *L'espoir*. Folio plus, 1996.
6. MARKO Petro, *Hasta la Vista*, Ribotim, Botimet OMSCA-1, Tiranë, 2002.
7. MOSSUZ-LAVAU Jeanine, *André Malraux qui êtes-vous?*, La Manufacture, 1987.
8. THOMAS Hugh, *La guerre d'Espagne juillet 1936- mars 1939*, Paris, Laffont, 2003.

#### SITOGRAFI

<http://www.poetryfoundation.org/bio/john-donne>  
<http://www.sparknotes.com/lit/belltolls/study.html#explanation1>

### **Three colossus of Albanian, French and American letters Petro Marko, André Malraux and Ernest Hemingway (comparative study attempt)**

#### **SUMMARY**

In this paper, I have tried to present three Colossus of Albanian, French and American literature, as three parallel routes of the same reality, the Spanish War, as prelude of World War II. It is about a more biographical and thematic approach.

First, I have pointed out the significance of novels titles, which serve as a starting point for understanding their works.

Secondly, the original views are a particular aspect of this paper because the reader manages to create a literal and conceptual image of each author, without leaving aside the emotions that give rise to the modern reader, although it is written about a remote event in time.



## Shpresa DELIJA

## VENDI I ANTONIMEVE NË FJALORËT DY-GJUHËSH

## Hyrje

Në këtë artikull do të trajtoj përdorimin e antonimeve në përkufizimet e fjalëve titull në botimin e katërt të fjalorit “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*.”<sup>404</sup>

Gjatë studimit të këtij fjalori kam shqyrtuar tri çështje kryesore për të bërë të qartë se cila është baza e përfshirjes së antonimisë në të.

1. Cilat fjalë titull kanë antonime?
2. A shprehin kuptimet e çifteve antonimike diçka rreth strukturës leksikore të antonimisë në gjuhën angleze?
3. A mbështeten çiftet antonimike që të përfshihen në fjalor në parimet leksikografike?

Arsyeja pse kam zgjedhur *Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary* për studim është se,

1. *Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary* është një fjalor që në bazë të tij ka fjalësin e gjuhës.
2. Kryeredaktori i këtij fjalori, John Sinclair<sup>405</sup>, thekson se në përpilimin e fjalorit “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*” është përdorur një korpus prej 520 milionë fjalësh të fondit bazë të gjuhës së sotme angleze. Ai, gjithashtu, thekson se vendimet se cilat fjalë do të përdoren si fjalë titull, cilat kuptime apo shprehje frazeologjike do të përdoren, në fjalor do të merreshin nga fondi bazë i gjuhës angleze.

Në parathënien e fjalorit thuhet se informacioni i fjalësit është në themel të çdo fjale titull. Madje është bërë dhe një program kompjuterik për t’i ndihmuar leksikografët që të vendosin për kuptimet e ndryshme të fjalëve. Informaticienët kanë shkruar gjuhën që do të përdoret për përkufizimet e fjalëve, kanë bërë zgjedhje të ushtrimeve, si dhe të informacionit

<sup>404</sup> Sinclair, J. (1987) *Looking up an account of the COBUILD project in lexical computing and the development of the Collins COBUILD English language dictionary*, London,

<sup>405</sup> John Sinclair *Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary* (parathënie të fjalorit) 2003.

gramatikor. Ndërsa, përdoruesit e këtij fjalori e marrin këtë informacion duke menduar se leksikografët kanë trajtuar struktura leksiko-semantike, si p.sh. antoniminë.

3. “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*”, është fjalor mësimor dhe se nxënësit dhe studentët janë të interesuar t’i mësojnë antonimet në çifte, si p.sh. *full/empty, light/dark*. Ushtrimet rreth antonimeve përfshihen në planin mësimor dhe sipas Halliday dhe Hasan<sup>406</sup> antonimet janë të domosdoshme në kompetencën tekstuale. Prandaj, leksikografët i lënë një vend të veçantë përfshirjes së tyre në fjalor.
4. “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*”, është ndërtuar në mënyrë të tillë që fjalët tregohen në lidhje leksikore, d.m.th. lidhje paradigmatiske dhe sintagmatike.
5. Së fundi, “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*”, është tepër praktik në krahasim me fjalorët e tjerë, mbasi lidhjet leksikore janë të vendosura në anë të faqes duke i bërë ato të dukshme dhe të mundshme për t’u marrë dhe përdorur.

Gjatë studimit të këtij fjalori leksikografët kanë vënë në bazë të fjalorit fondin bazë të gjuhës angleze me qëllim që të tregojnë qartë natyrën dhe strukturën e antonimisë në gjuhë.

Prej gjithë korpusit të fjalëve të mbledhura nga tekstet autentike 520 milionë fjalësh të fondit të gjuhës së sotme angleze janë përfshirë në studim. Ky fjalor ka më shumë se 110.000 fjalë. Kuptimet dhe shembujt e secilës fjalë kyçe jepen nëpërmjet përkufizimeve dhe shembujve të nxjerrë nga ky korpus gjigand. Fjalori, në një kolonë të veçantë, jep informacion edhe rreth sinonimeve, antonimeve dhe modeleve gramatikore të përdorimit të tyre. P.sh. kuptimi i fjalës *hazardous* përkufizohet si ‘something that is hazardous is dangerous, especially to people’s health or safety’. Shembulli i mëposhtëm është marrë nga korpusi gjigand: *They have no way to dispose of the hazardous waste they produce*. Ndërsa një kolonë të veçantë thuhet se fjala *hazardous* është mbiemër. Ndërsa, si antonim i fjalës *hazardous* dhe *dangerous* jepet fjala *Safe*.

Por, ka edhe fjalë të tjera në gjuhën angleze që zënë më shumë vend në fjalor në krahasim me fjalën *hazardous*. Këto janë fjalë që mbartin shumë kuptime. Kështu, p.sh. fjala *Light* është një shembull i mirë, meqenëse ka më shumë se një fjalë kyçe që kanë disa kuptime. Në anë të faqes jepen dhe antonime të ndryshme, si: *heavy, dark, deep and serious*.

---

<sup>406</sup> Halliday, M.A.K., Hasan R. (1976) *Cohesion in English*, Harlow, Longman.

Në fjalorin “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*” ka rreth 1750 çifte antonimike. Fjalët titull që kanë antonime janë shqyrtuar në lidhje me:

1. klasën që i përkasin,
2. karakteristikat e tyre semantike,
3. shpërndarjen e tyre sipas ndajshesave,
4. nëse të dy përbërësit e çiftit antonimik paraqiten si antonime të njëri-tjetrit,
5. nëse parimet e zgjedhjes së çifteve antonimike janë të qarta dhe hedhin dritë në ndërtimin e antonimisë në fjalorin e gjuhës angleze. Si t’i kuptojmë këto parime?

Sipas Paradisit,<sup>407</sup> përsa i përket **klasës**, më shumë se 1031 nga 1750 fjalët titull (rreth 59%) i përkasin klasës së mbiemrave. Nga këto 95% ose (977 nga 1031) janë të shkallëzuara (**Gradable**), si p.sh. *big/small*. Ndërsa, 5% ose (54 nga 1031) janë mbiemra të pashkallëzuar (**Nongradable**), si p.sh. *abstract/concrete* and *female/male* etc.

Antonimet e shprehura me emra përbëjnë 317 ose (19%); foljet 220 ose (13%); të tjerë 182 ose (9%). Pra, gjithsej 1750.

Nga përshkrimi i mësipërm del se mbiemrat përbëjnë shtrirjen më të madhe në radhët e antonimeve. Arsyeja është se një numër i madh mbiemrash kryesisht tregojnë cilësi apo veti, ndërsa shumë emra kanë kuptime të ndryshme me shumë veti. P.sh. çifti antonimik mbiemror *big* and *small* të dy lidhen me përmbajtjen e fushës semantike të Madhësisë në shkallën e tyre matëse, ndërsa mbiemrat *dead* and *alive* lidhen me fushën semantike të Qenies, por që janë në dy skajet e dimensionit.

Ata mbiemra që vijnë nga emrat duke mbartur kuptime të ndryshme janë të pashkallëzuar dhe në këto raste përdoret fjala mohuese *non-* duke formuar strukturën sintaksore ‘not being X’, si p.sh., antonimet *financial*, *linguistic*, *pictorial* apo *dental* janë *non-financial*, *non-linguistic*, *non-pictorial* dhe *non-dental*.

Parashtesa *non-* në formimin e fjalëve në fjalët titull përdoret rrallë, mbasi ajo nuk jep shumë informacion dhe ka vetëm kuptimin e mohimit dhe jo të pohojë atë që është mohuar.

Megjithatë, ka mbiemra të pashkallëzuar që janë dikotomike, pra, të dyzuar, si p.sh., *abstract/concrete*; *female/male*. Të dy çiftet tregojnë se si

<sup>407</sup> Paradis, C. (2001) ‘Adjectives and boundedness.’ *Cognitive Linguistics* 12.1: 47-65.



njerëzit i kategorizojnë fenomenet në botë dhe se si natyra na detyron në të kategorizojmë gjërat.

Po në fjalorin “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*” për fjalën *strong* jepen gjegjëset antonimike *weak* and *slight*. Mbiemri *Weak* i kundërvihet mbiemrit *Strong*, ndërsa mbiemri *Slight* nuk i kundërvihet, mbasi nuk janë në të njëjtën fushë semantike.

Sipas studimeve të bëra emrat grupohen në emra abstraktë dhe konkretë, ku 71% e tyre shprehin kuptime abstrakte, ndërsa 29% shprehin kuptime konkrete. Emrat abstraktë janë si p.sh. *victory/defeat, advantage/disadvantage, aggression/gentleness, pessimism/optimism, absence/presence* dhe emrat konkretë janë si p.sh. *borrower/lender, buyer/seller, hero/villain* etj.

Antonimet e shprehura me folje tregojnë ngjarje dhe shprehin veprime, si p.sh., *accept/reject*. Vetëm një numër i vogël i tyre tregojnë gjendje, si p.sh. *hate/love, like/dislike*.

Kategoria tjetër janë parafjalë që tregojnë pozicion, drejtim, apo kohë etj., si dhe ndajfolje që tregojnë mënyrën, kohën e kryerjes së veprimit, si p.sh. *in/out, up/down*. Ato kanë fushën e tyre semantike dhe madje mund të formojnë pole të kundërta në shkallën e matjes.

Sipas autorëve të fjalorit vetëm 37% e lidhjeve direkte të çifteve antonimike janë dhënë në të dyja drejtimet, si p.sh. *broad↔narrow, clean↔dirty, dark↔light, dry↔wet, hard↔soft, heavy↔light, large↔small*.

Është e rëndësishme të theksojmë se në fjalorin “*Collins COBUILD Advanced Learner’s English Dictionary*” hasen edhe çifte të tilla si: *big→small*, por jo *small→big*; *little→big*, por jo *big→little*, hasen gjithashtu edhe mbiemra të tillë vetëm në këtë renditje, si: *cheap→expensive, cordial→hostile, cruel→kind, difficult→easy, dry→sweet, dusk→dawn*.

Gjatë studimit të këtyre çifteve antonime, mua personalisht, më duket se ato mund të përdoren edhe në anën e kundërt të tyre. Pra, nuk është e qartë pse këto çifte jepen vetëm në këtë formë. Por, nga sa kam studiuar, mendoj se një arsye është se një vendosje e tillë bëhet që të mos krijohet keqkuptime në përdorimin e fjalës titull. P.sh. në këtë fjalor jepen fjalët *interesting* dhe *sunny* si antonime të fjalës *dull*. Sipas mendimit tim kjo jepet për të dhënë qartë dy kuptimet e fjalës *dull* dhe se ky funksion keqkuptimi nuk është i nevojshëm të merret për bazë për fjalët *sunny* dhe *interesting*. Një arsye tjetër është se ka raste kur këto çifte janë të kuptueshme, si p.sh. çifti antonimik *underwhelmed→overwhelmed* jepet vetëm në këtë formë. Një arsye tjetër më shumë është se fjala

*underwhelmed* është një formim i ri për ta krahasuar me fjalën *overwhelmed*. Formime të tilla fjalësh bëhen normë dhe përdoren ashtu siç jepen, pa asnjë lloj hezitimi.

Antonimet e formuara morfologjikisht rrallë-herë mund të këmbehen me njëra-tjetrën. Edhe brenda kësaj kategorie vëmë re se ka dallime. Lin Mërfi<sup>408</sup> në punimin e saj thekson se antonimet që përdoren si fjalë titull dhe që formohen me parashtesën *in-* mund të këmbehen në 35% të rasteve; ato që kanë parashtesën *un-* këmbehen në 16% të rasteve, ndërsa ato që formohen me parashtesën *non-* nuk këmbehen asnjëherë, mbasi parashtesa *non-* vepron si mohues i mohimit, duke mos lënë vend për interpretime.

Në këtë fjalor nga i gjithë numri i fjalëve titull i fjalëve antonime, 638 e këtyre fjalëve janë të formuara me parashtesë, ku përqindjen më të lartë e kanë parashtesat *un-* (33%) dhe *in-* (21%), ndërsa të tjerat veç e veç kanë përqindje më të vogël.

Antonimet që formohen me anë të prapashtesave zënë një numër më të vogël. Gjithsej janë 99 çifte, nga ku 75 prej tyre gjenden në shprehjet foljore, si p.sh., *check in/check out*, *mark down/mark up*, *stay in/go out*, *turn on/turn off*. Pjesa tjetër që përbën 25 çifte antonimike formohen me anë të prapashtesës *ful-* dhe *less*, si p.sh. *careful/careless*, *emotionless/emotional*, *joyless/joyous*, *noiseless/noisy*. Këto çështje nuk do të trajtohen gjerë në këtë punim.

Përsa i përket leksikografisë së gjuhës shqipe, ajo daton në vitin 1635, me hartimin e “Fjalorit latinisht-shqip” të Frang Bardhit. Por, hapi i parë për të hartuar një fjalor të gjuhës shqipe u hodh në vitin 1904 nga gjuhëtari dhe atdhetari Konstandin Kristoforidhi, i cili më vonë u përpunua nga gjuhëtari prof.dr. Aleksandër Xhuvani. Megjithë punën e mirë, ky fjalor nuk ishte mirëfilli fjalor shpjegues. Vetëm në vitin 1954 u botua “Fjalori i gjuhës shqipe”, që përgjithësoi në mënyrë kritike arritjet e fjalorëve të mëparshëm, i zgjeroi e i thelloi këto me fjalë e shprehje të tjera të gjuhës së folur e të shkruar dhe çeli një etapë të re në rrugën e leksikografisë sonë. Ai ndihmoi shumë për njohjen e gjuhës amtare dhe për njësimin e normës gjuhësore.<sup>409</sup>

Me zhvillimin e mëtejshëm politik, ekonomik-shoqëror dhe kulturor të vendit edhe gjuha shqipe pësoi zhvillime të dukshme. Prandaj, lindi nevoja që këto zhvillime të pasqyroheshin në një fjalor ku përbërja e

<sup>408</sup> Murphy, L. (2003). *Semantic relations and the lexicon antonyms, synonyms and other semantic*.

<sup>409</sup> Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe 1980. (Parathënie).

fjalësit dhe e frazeologjisë t'u përgjigjej nevojave dhe interesave të përdoruesve të gjuhës shqipe. Kështu, më 1980 hartohet "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" dhe gati më shumë se dy dekada më vonë më 2007 ripunohet dhe pasurohet "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" me zhvillimet e mëtejshme të jetës politike, ekonomike, shoqërore e kulturore të vendit tonë.

Kristoforidhi i radhiti antonimet ballë njëra-tjetrës, për t'i zbuluar më mirë kuptimet e tyre të kundërta.<sup>410</sup> Në këtë fjalor janë pasqyruar 351 çifte antonimike, prej të cilëve 46 çifte shprehen me emra, 82 me mbiemra, 147 me folje dhe 74 me ndajfolje, kurse 2 çifte janë përemra të përcaktuar.

Parimi themelor i Kristoforidhit ishte që të përfshinte çifte me kuptime sa më të plota, duke i vënë ato kundrejt njëra-tjetrës. Sipas Goçit, në Fjalorin e Kristoforidhit antonimet me parashtesa janë më të pakta në numër, rreth 54 çifte, dhe 297 çifte janë morfologjikisht të ndryshme.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1954 kishte rreth 146 çifte antonimike, ku fjalët janë kundërvënë për të pasqyruar më qartë kuptimin e tyre.

Fjalori i Gjuhës së sotme Shqipe botuar në vitin 1980 dhe sidomos ai i vitit 2007 përbëjnë kulmin e arritjeve në leksikografinë shqiptare. Të dy këta fjalorë bëjnë një shpjegim të gjithanshëm të antonimeve, ku kuptimet, shpjegimet dhe përdorimet e fjalëve jepen qartë duke vjelë të gjithë fjalësin e gjuhës së shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe.

Por, duhet të theksojmë se Fjalori i Antonimeve në Gjuhën Shqipe hartuar nga prof.dr. Miço Samara më 1998, me vlera të veçanta e të paçmuara, është një thesar i leksikografisë shqiptare. Ai renditet pas fjalorit të Kristoforidhit.

Samara ka ndjekur pak a shumë rrugën e Kristoforidhit në hartimin e Fjalorit të antonimeve të gjuhës shqipe. Ai është mbështetur në disa kritere, ku mund të përmendim:

1. çiftet anonimike me rrënjë të ndryshme, si p.sh., *dimër/verë, shuaj/ndez, afër/larg* etj.
2. antonime me parashtesa privative ose kundërshtuese, si p.sh. *mbuloj/zbuloj, lodhem/çlodhem, mpihem/shpihem* etj.
3. antonime me parashtesa mohuese (pa-, mos-, jo-), që plotësojnë të gjitha kërkesat e antonimisë, si p.sh., *kënaqësi/pakënaqësi, ekzistent/mos-ekzistent* etj.
4. lidhjet fjalëformuese si p.sh., mbiemri *i lehtë/i vështirë* etj.

---

<sup>410</sup> Ibrahim Goçi *Antonimet e gjuhës së sotme shqipe*, 1985.

Ky Fjalor është i pari i këtij lloji dhe përmban 1500 çifte antonimesh ose rreth 3000 çifte bashkë me ato të ndërsjelltat.

Duke lavdëruar punën e madhe të autorit dhe të bashkautorëve të tij, mendoj se ky fjalor do të ndihmojë jo vetëm leksikografët dhe leksikografinë shqiptare, por kryesisht mësuesit, nxënësit dhe të gjithë ata që merren me mësimin e gjuhës shqipe apo të gjuhëve të huaja duke rritur kështu, njohuritë, shprehitë gjuhësore dhe kulturën e gjuhës mëmë, si dhe duke i vënë ato në raporte krahasimore me gjuhën e huaj.

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. Halliday, M.A.K., Hasan R. (1976): *Cohesion in English*, Harlow, Longman.
2. Ibrahim Goçi (1985): *Antonimet e gjuhës së sotme shqipe*.
3. Murphy, L. (2003): *Semantic relations and the lexicon antonyms, synonyms and other semantic*.
4. Paradis, C. (2001) 'Adjectives and boundedness.' *Cognitive Linguistics* 12.1: 47-65.
5. Samara, Miço, (1998). *Fjalori i Antonimeve në Gjuhën Shqipe*.
6. Sinclair, J. (1987) *Looking up an account of the COBUILD project in lexical computing and the development of the Collins COBUILD English language dictionary*, London.
7. Sinclair, John. (2003): *Collins COBUILD Advanced Learner's English Dictionary (parathënie të fjalorit)*.
8. *Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe*, 1980.

### **Antonyms in bilingual dictionaries**

#### **SUMMARY**

Dictionaries in general and especially Dictionaries for learners are important tools to be used during the foreign language teaching and learning process. These dictionaries are useful to researchers, teachers, translators and learners during their daily life.

The main goal of designing and using dictionaries for language learners is to provide the users with the necessary information and the right meanings of the words and expressions and to explain the link that exists between words and expressions in relation to their field of study. So for this reason lexicographers take special care while designing them by including sufficient information about the lexico – semantic relation of the words. A good example of this work is the Dictionary of synonyms and antonyms in the Albanian language.

**Rudina XHILLARI**

## **EVOLUIMI I GJUHËS NË PËRKTHIMET E RIPËRKTHIMET NË GJUHËN SHQIPE**

Përkthimi është një proces që krijon vlerë të shtuar në gjuhën marrëse, pasi përfshin krijimin e vlerave gjuhësore, letrare, fetare, politike, tregtare, kulturore dhe arsimore. Si një proces i krijimit të vlerave, ai jeton për një periudhë të caktuar kohore në kulturën marrëse. Se sa është jetëgjatësia mesatare e një teksti të përkthyer, kjo është e vështirë të thuhet apo të vendoset përmes rregullave të përcaktuara qartë. Ajo varet shumë nga kultura marrëse, sa kjo kulturë është në gjendje ta “strehojë” këtë tekst brenda hapësirave të saj.

Me kalimin e kohës, përkthimet kanë prirjen që të “plakën” apo të “vjetërohen”, pasi ato e humbin aktualitetin e tyre dhe nuk u përgjigjen më nevojave të lexuesve, duke çuar kështu në ripërkthimet e teksteve të përkthyer më parë me qëllim që ta sjellin në kohë përsëri përkthimin. Vjetërimi ose ‘plakja’ e një përkthimi lidhet me faktin se procesi i përkthimit synon ta sjellë përkthimin në kohë dhe në kulturën e asaj kohe dhe tregon mënyrën se si një kulturë e pranon një tekst të përkthyer. Me kalimin e kohës përkthimi humbet aktualitetin e tij dhe nuk i përgjigjet më nevojave të lexuesit e vepra ka nevojë për ripërkthim, për ta sjellë sërish në kohë.

Ka shumë arsye që qëndrojnë pas ripërkthimeve. Faktori kohë është një arsye e rëndësishme që e shndërron përkthimin në një proces të ndikuar nga koha. Arsye të tjera janë të lidhura me faktorët e jashtëm si ndryshimi i normave paraprake, atyre operacionale dhe të parashikueshmërisë.

Punimi nxjerr në pah evoluimin e gjuhës që qëndron pas procesit të ripërkthimit dhe jep shembuj nga përkthimet dhe ripërkthimet e veprës “Robinson Kruzo” përkthyer e ripërkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe të ripërkthimeve të Biblës me qëllim që të ilustrohen këto arsye. Në të është përdorur metoda analitike dhe krahasuese.

Fakti që përkthimi i një vepre letrare klasike i bërë para një shekulli nuk quhet më si i lexueshëm dhe si pasojë kërkon një ripërkthim ose një përkthim më ‘modern’, tregon se standardi marrës i një kulture është faktor

përcaktues dhe duhet të ndryshojë me kohën. Shkaku i vjetërimit të përkthimit duhet të kërkohet në rrethana nga të cilat varet gjuha dhe stili i përkthimit në momentin kur është bërë përkthimi. Metoda krahasuese diakronike (krahasimi i moshës së përkthimit në kohëra të ndryshme) ndihmon shumë për të parë dhe analizuar evolucionin e gjuhës shqipe në përkthimet e ripërkthimet e veprave letrare nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

Duke parë evoluimin që pëson gjuha e përkthimit që nga varianti i parë i një përkthimi të një vepre dhe deri te varianti i fundit i ripërkthimit mund të shohim pasqyrimin e procesit diakronik të evoluimit të gjuhës shqipe. Pra, një tjetër kriter që na ndihmon në krahasimin e përkthimeve apo të përkthyesve është ai diakronik. Ndryshimet që ka pësuar shqipja gjatë këtyre viteve, e evidentuar kjo në përkthime e ripërkthime të ndryshme kanë qenë të mëdha.

Duke pasur parasysh kronologjinë, mund të themi se çdo përkthim i bërë në kohë pas përkthimit të parë quhet “ripërkthim”. Pra ai i referohet përkthimit të një vepre që është përkthyer më parë në të njëjtën gjuhë ose rezultatin e një akti të tillë, d.m.th vetë teksti i përkthyer.

Sa është jetëgjatësia e përkthimit të parë deri në momentin e ripërkthimit, kjo nuk është diçka e mirëqenë apo e përcaktuar me rregulla të prera e të qarta. Studiues të ndryshëm kanë ide të ndryshme në lidhje me këtë kohëzgjatje.

Nga historia e përkthimeve dhe ripërkthimeve në gjuhën shqipe, mund të themi se përkthimi i një teksti mund të jetojë për vite, dekada e madje shekuj të tërë, pasi kjo nuk është e vendosur prerazi.

Ndërsa në rastin e përkthimit të Biblës ekziston një hark kohor prej disa shekujsh ndërmjet përkthimit të parë dhe ripërkthimit. Historia e përkthimit të Biblës në shqip fillon në shekullin IV, kur Shën Jeronimi nga Stridoni i Ilirisë përktheu Biblën nga gjuha çifute dhe greke në gjuhën latine që ishte gjuha e shkruar shumë e afërt me atë të paraardhësve tanë. Dhe u deshën rreth 10 shekuj dhe më saktësisht në vitin 1555 që të vinte ripërkthimi i Biblës në shqip përmes Mesharit të Gjon Buzukut.

Një arsye tjetër që justifikon ndërmarrjen e ripërkthimeve është gjuha dhe stili i përkthimit. Sipas Toury-it: *“Metateksti krijohet për lexues bashkëkohorë, kështu kushtet e tij diktohen nga kriteri i pranueshmërisë i një brezi të caktuar lexuesish dhe kritikësh: në këtë kuptim, ai ka prirjen të vjetërohet më shpejt (por për të njëjtat arsye që vjetërohet një tekst*

*original*”<sup>411</sup>. Kështu gjuha dhe stili kalojnë një shndërrim shumë të madh, një proces tërësisht evolues dhe me qëllim që lexuesi i kohës të ketë variante dhe tekste lehtësisht të lexueshëm, teksti ka nevojë të ripërkthehet dhe të pasqyrojë ndryshimet e gjuhës dhe të stilit.

Nëse krahasojmë përkthimin e parë të “Robinson Kruzosë” të shkrimtarit Daniel Defo bërë në 1911, me ripërkthimet nga Gjergj Pekmezi, 1936 dhe H. Selfo, 1966 e B. Doko botuar pas vdekjes 1977, ribotuar 2000, të cilat janë përkthyer e botuar në etapa të ndryshme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, mund të shohim dukshëm ndryshimet që ka pësuar gjuha shqipe gjatë një shekulli. Një shekull është një hark i gjatë kohor sa i takon zhvillimit të gjuhës. Teksti i përkthyer para një shekulli është i palexueshëm për lexuesin e sotëm dhe kjo për shkak të gjuhës, ortografisë, strukturave fjalëformuese, strukturave sintaksore, kohëve të foljes, fjalë të vjetëruara, arkaike apo të dala jashtë përdorimit.

Ky tekst i shkëputur nga varianti i parë i përkthimit të Robinson Kruzosë do të ishte i padëshifrueshëm për lexuesin e sotëm. Do të duhej të bëhej një transkriptim i tekstit për ta bërë të lexueshëm në ditët e sotme.

Kam lindur më 1632 në qytet të Jork-ut, ku im atë i rregullonte  
si kitarë tregtarë. Më atë më kishte dhënë një mesim mjaft të gjerë,  
aq sa mund të mësonje njeriu me një shkollë të jashtme, dhe pas  
stërvitjes së rregullt. (Robinson Kruzo përkthyer nga  
Lumo Skëndo, 1911)<sup>412</sup>,

i cili mund të ishte në këtë formë sipas gjuhës së sotme shqipe:

U lindi në vitin 1632 në qytetin e Jorkut, aty ku im atë  
ishte vendosur, pasi kishte lënë tregtarinë. Im atë më kishte  
dhënë mësim shumë të mëdha, më aq sa mund të mësojë  
njeriu në një shkollë të jashtme dhe nga praktika e punëve  
të shtëpisë.

Ky përkthim tregon gjendjen e gjuhës shqipe në atë kohë, fundi i periudhës së parë të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, kur ishin hedhur themelet e gjuhës letrare kombëtare shqipe dhe ishte përcaktuar zhvillimi i mëtejshëm i saj.

<sup>411</sup> Toury Gideon. (1978), ‘The Nature and Role of Norms in Literary Translation.’ In: J.S. Holmes, J. Lambert, R. Van den Broeck (eds.), *Literature and Translation. New perspectives in literary studies*. (Leuven, Acco, (93-100)

<sup>412</sup> Defo Daniel (1911), Robinson Kruzo. Mbrothesija, Kristo Luarasi.

Në atë kohë, drejtshkrimi ishte ndryshe dhe mbështetej në “Alfabetin e Stambollit” të miratuar nga Shoqëria e të Shtypurit të Shkronjave Shqip (1879). Sipas këtij alfabeti ka shumë gërma në gjuhën greke p.sh. θ (për th); τ- (për sh); ε (për ë); π (për sh), δ(për dh); η (për nj); λ (për ll) etc., nga gjuha latine : g (për gj) dhe alfabeti cirilik И (për NJ); Б (për for DH).

Në tekstin e përkthimit ka dhe ndryshime të tjera që tregojnë ndikimin që gjuha shqipe kishte nga gjuhë të ndryshme. Janë përdorur shumë fjalë në gjuhën greke: skopos (për shkak), stafidhe (për rrush i thatë), klima (për kohë/mot), nga turqishtja: huçum (për sulm), hazer (për gati), sash (për trap), ymydi (për shpresa), alete (për vegla), araba (për qerre), hall (për problem) dhe gjuha arabe: kubé (për shpellë), etj. Gjithashtu ka ndryshime për sa i takon përdorimit të kohëve të foljes p.sh., i kohës së kryer të thjeshtë, kohës së ardhme etj.: u muarç, u munduash, do mirnja, s’mund të takonja, u bëçë, vajçe etj në vend të formave që përdoren tani në shqip si: mori, u mundua, do të merrja, s’mund ta takoja, u bë, vajti etj. Ndryshime vihen re dhe në leksik, në përdorimin e disa formave të fjalëve që nuk përdoren sot p.sh.: urag (uragan), murr (murlan), papagan (papagall), brazilanet (brazilianet), ap (jap), parvere (pranverë), me te madhuare (me zmadhimin), srugas (zdrukthoj), qepës (rrobaqepës), notëtor(notar) etj.

Po të shohim ripërkthimet e mëvonshme të “Robinson Kruzosë” mund të vërejmë ndryshime dhe evoluim të gjuhës shqipe: në ripërkthimin e vitit 1936 nga Gjergj Pekmezi shohim se përkon me etapën e dytë e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe (1912-1944), ku megjithë përpjekjet nuk u bë njësim i të dy varianteve letrare:

Isha lindun me 1632 në qytetin Jork n’Angli prej një familjeje...

Në ripërkthimin e vitit 1966 nga H. Selfo, B. Doko botuar pas vdekjes 1977, dhe ribotuar në vitin 2000, identifikojmë një etapë të re të zhvillimit të gjuhës shqipe: etapën e kristalizimit të plotë të normës letrare ku pati një shuarje të veçorive dalluese të dialekteve dhe ribotimi i tij u bë nën dritën e daljes së “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (1980)”, që sigurisht ndihmoi në ngulitjen e normës letrare.

Linda në motin 1632, në qytetin e Jorkut, nga një familje e mirë, por që nuk ishte vendase, sepse im atë ishte një i huaj nga Bremeni, i cili në fillim u vendos në Hull. Atje ai arriti të vërë një pasuri majft të madhe me anë të tregtisë; pastaj si hoqi dorë nga



tregtia, u shpërngul në Jork, ku qe martuar me nënën time, bijë nga familja...

Një shembull shumë i mirë që tregon evolucionin e gjuhës shqipe janë dhe përkthimet e ripërkthimet e Biblës. Në gjuhën shqipe, përkthimet e ripërkthimet e teksteve të shenjta janë të lidhura me çaste kthesash të rëndësishme në historinë shoqërore, kulturore e gjuhësore të popullit shqiptar, në ato momente kur shqiptarët kanë përjetuar ripërtëritje e për lindje kulturore e shpirtërore kombëtare. Ato kanë luajtur role me rëndësi në kulturën e popullit tonë duke e ballafaquar atë dhe gjuhën e tij me konceptet e filozofisë universale të besimeve të ndryshme, të besimeve dhe gjuhëve të fqinjëve të tij, me besimet e gjuhët e pushtuesve të tij. Bibla që nga botimi i parë i saj dhe deri te botimi e ripërkthimi i fundit është quajtur si libri më i përkthyer në botë, libër *par excellence*, libri i librave. Kjo ka ndodhur për disa arsye; Bibla ka karakter të dyfishtë parë nga vështrimi letrar ose historik dhe vështrimi tipik ose shpirtëror.

Përkthimet e shkrimeve të shenjta kanë rëndësi për faktin se kanë shënuar gjithmonë ngjarje të rëndësishme jo vetëm për historinë kishtarë, por edhe për historinë gjuhësore, kulturore dhe letrare të popujve. Me to fillojnë periudha të caktuara historike, histori gjuhësh e qytetërimesh. Kështu ka ndodhur dhe me gjuhën shqipe, e cila nisi periudhën e saj historike si gjuhë e shkruar në shek.XV me përkthimin nga latinishtja të Formulës së Pagëzimit dhe vijoi rrugëtimin e saj me përkthimet e ripërkthimet e teksteve të vjetra në shekujt pasardhës nga Buzuku, Bogdani, Grigori i Akademisë së Voskopojës, Teodor Haxhi Filipi, Kostë Berati, Vangjel Meksi, Anonimi i Elbasanit, Kristoforidhi, Fan Noli, Diodati, Vincens Dorsa në Kalabri, Zef Kamarda në Sicili, Pal Skiroj, e deri në përkthimet e fundit të Biblës nga Vladimir Dervishi dhe dom Simon Filipaj. Ripërkthimi i Shkrimeve të Shenjta ka ndjekur hap pas hapi zhvillimin e shqipes, lindjen, rrugën e saj drejt formimit e kalimit nga gjuhë e folur në të shkruar, krijimin e identitetit të saj, hedhjen e themeleve të gjuhës letrare, praninë dhe përdorimin e të dyja dialekteve, njohjen, ngritjen dhe afirmimin e të dy dialekteve si variante letrare, përpjekjet për njësimin e saj, kristalizimin e plotë të normës letrare dhe shuarjes së veçorive dalluese të dialekteve dhe ngulitjes së normës letrare unike.

Ripërkthimet e Biblës janë dëshmitare të dokumentuara të evoluimit të shkrimit të gjuhës shqipe. Ripërkthimi i Biblës ka ndjekur hap pas hapi edhe shkrimin e shqipes, përdorimin e alfabetit të përdorur prej përkthyesve

të ndryshëm në periudha të ndryshme. Dom Simon Filipaj ka pohuar se “*Historia e përkthimit të Biblës është historia e shkrimit shqip*”.<sup>413</sup>

Meshari ka vlera të jashtëzakonshme, pasi krijoi bazën e shkrimit të gjuhës shqipe - alfabetin latin e pasuroi me shenja greke dhe forma të shkruari sllave, e orientoi shkrimin shqip drejt gjuhës latine. Kjo traditë përvijoi dhe në miratimin e ‘Alfabetit të Stambollit’ nga ‘Shoqëria e të shtypurit të shkronjave shqip’ (1879), i cili u ndërtua sipas një parimi të rreptë shkencor që për çdo tingull të kishte një shkronjë të veçantë; 25 shkronja të alfabetit latin që u plotësuan me shkronja dyshe nga shkronjat greke, cirilike etj. Gjatë një periudhe përveç Biblës në gegërisht me alfabet latin pati dhe përkthime në toskërisht me alfabetin grek, por gjatë Rilindjes u bënë përpjekje për një alfabet të përbashkët, përpjekje të cilat u kurorëzuan me sukses në Kongresin e Manastirit.

Po kështu, mjafton të japim vetëm një fjali të thjeshtë nga Bibla dhe mund të shohim ndryshimet e gjuhës dhe të stilit.

Buzuku (1555): E tha Zotynë: Kloftë bam drita. E u ba drita;

Kristoforidhi(1872): Edhe Perëndia tha, U baftë dritë: edhe u ba dritë;

Diodati i ri (1994) : Pastaj Perëndia tha “U bëftë drita”! Dhe drita u bë;

Simon Filipaj (1994) : Hyji tha “Le të bëhet drita!” Dhe drita u bë”.<sup>414</sup>

Meshari, duke qenë se përmban tekste të njohura liturgjike dhe pjesë nga Dhiata e Vjetër dhe e Re, ai nuk është shumë i vështirë për t’u interpretuar, me gjithë ortografinë e ndërlikuar, gjuhën arkaike, gabimet e shumta të shtypit e mungesat e fjalëve. Në tekst dalin edhe elemente të dialekteve të tjera. Gjuha e Buzukut jo vetëm që nuk ka asnjë lloj ndikimi turk që shfaqet në shqipen e mëvonshme, por ajo përmban edhe shumë tipare çuditërisht arkaike. Për shkak të sistemit të ndërlikuar të shkrimit që ka përdorur, deri më tani këto tipare janë hulumtuar vetëm pjesërisht.

Meshari në shqip u botua në alfabetin latin me stilin gjysmëgotik të Italisë së Veriut, ku përfshihen edhe pesë shkronja me prejardhje cirilike për tingujt që nuk i kanë latinishtja dhe italishtja.

Përkthimi i dom Simon Filipajt mund të quhet si përkthimi i parë i Biblës në gjuhën standarde shqipe. Ai bëri një punë të gjatë 40 vjeçare, e ndihmuar nga njohja e gjuhëve biblike: latinisht, greqishte e vjetër, italisht, hebraisht dhe është cilësuar si Jeronimi i ditëve tona<sup>415</sup>. Ky përkthim ka vlera dhe risi: bën përpunimin dhe njësimin e terminologjisë kishtare, sjell

<sup>413</sup>Filipaj Dom Simon, (1990). *Historia e përkthimit të Biblës është historia e shkrimit shqip*, Prishtinë.

<sup>415</sup> Ahmeti Isak, (1999), *Bibla në letërsinë shqiptare*, Prishtinë.

fjalë e shprehje të reja, të harruara, kuptime të reja, sintaksë karakteristike për stilin biblik. Duke përdorur gjuhën letrare shqipe ai kapërcen ndarjet dialektore të shqipes dhe synon të sjellë mesazhin e integritit, afrimit, ripajtimit dhe bashkimit. Sipas fjalëve të Filipajt: “*E pranova gjuhën e njësuar për dy arsye kryesore: pse e pranuan të gjithë gjuhëtarët - ata që me profesion mbajnë përgjegjësi për këtë me “videant consules” dhe pse më ndrydh mendimi se me dialekte, qofshin ato dhe letrare, siç u treguan gegërishtja dhe toskërishtja, më duket se mbetemi edhe në shekullin XX ende “tribus”-fis*”.<sup>416</sup> Teksti është përkthyer nga latinishtja në gegërisht dhe pastaj përshtatur në gjuhën standarde, d.m.th. aty ndërthuret ballafaqimi ndërgjuhësor dhe ndërdialektor.

Përkthimi i Filipajt është i saktë, pa shmangie dhe lënie jashtë, ka përdorur fjalë e shprehje të reja ose shprehje frazeologjike dhe struktura gramatikore të gegërishtes dhe i ka përshtatur me mjeshtëri në gjuhën standarde, ka vendosur dhe përshtatur si duhet emrat e përveçëm biblikë dhe ata gjeografikë e historikë. Ai gjithashtu ka arritur të bëjë njësim të terminologjisë fetare.

Në qoftë se do të krahasojmë një pjesë nga Ungjilli sipas Mateut, kapitulli 2 të Kristoforidhit në gegërisht dhe toskërisht, të Diodatit, Vladimir Dervishit dhe të dom Simon Filipaj mund të shohim se koha tregimtare e së kryerës së thjeshtë i ka bërë qëndresë të mirë ndryshimeve të kohës: lindi- lëu-lindi; erthnë- erthnë- arritën-ia behën; lint- lën- kã lëme- duhet të lindte- duhej të lindte. Në ripërkthimet e ndryshme mund të shohim evoluime të formave të emërtimeve gjeografike, si: Vithleemë- Be0leem-Bethlehem-Betlehem;Jerusalimi-Ierusalem-Jeruzalemi;të emrave të përveçëm: Iroth-Herodi, Jisuj-Iesui-Jezusi; përdorimi i emrave foljorë: të-lindurit të djellit- të Lemit të diellit- yllin e tij duke lindur- yllin e Tij në Lindje; apo fjalë të tilla si: magjishtarë- mađi- dijetarë- dijetarë-magët; krye-priiftërit’ edhe shkronjësit’ e gjindjesë- Krÿepriiftënit eđe Škrÿisit e pōpultit- kryepriiftërinjtë e skribët e popullit etj.

Në të tre variantet e fundit të bëra në shekullin XX (Diodati, Dervishi, Filipaj), mund të themi se ato pasqyrojnë më së miri ndryshimet e gjuhës shqipe gjatë periudhës së tretë të zhvillimit të saj “1944 deri në ditët tona, kur gjuha standarde letrare është kristalizuar dhe janë kapërcyer dallimet ndërmjet dy dialekteve, ndërsa Kristoforidhi e hartoi Biblën në dy dialekte geg dhe tosk dhe në alfabetin e kohës, variantin toskërisht me

---

<sup>416</sup> Filipaj Dom Simon, (1994) , *Paraqitja, Bibla*, Ferizaj.

*alfabetin grek dhe zgjidhjen e Leipsiusit për jugun dhe variantin geg me alfabetin latin dhe zgjidhjen e Leipsiusit për verium*<sup>417</sup>.

Kristoforidhi, 1879, në variantin toskërisht me alfabetin e sotëm.

“ Ungjilli pas Mateut” Krye 2

Edhe Jisuj si lindi në Vithleemë të Judhesë,  
në ditë të mbretit Iroth, ja ca magjishtarë nga  
të - lindurit' e djellit erthnë në Jerusolim,  
e thoshinë, Ku është mbret' i Judhenjvet  
që ka lindurë? Sepse pam' yllin' e ati në  
të - lindurit të djellit, e erthmë t'i falemi.  
Edhe mbreti Iroth kur dëgjoj, undroth edhe  
gjithë Jerusolimi bashkë me atë. Edhe si  
mblodhi gjithë krye - priftërit' edhe shkronjësit'  
e gjindjesë, pyeste të marrë vesh prej atyre,  
ku lint Krishti. Edhe ata i thanë ati,  
Në Vithleemë të Judhesë; sepse kështy është  
shkaurë me anë të profitit:

Kristoforidhi, 1872, në variantin gegërisht me alfabetin origjinal:

Śēnti unğill mbas Mateout Kaptina II.

Ede Iesui mbassi lēu në Beθleem tē Iudese tē  
ditt tē mbretit Herodit kē ku erθnē në Ierusalemē do mađi  
pre i tē Lēmit tē dielit, e θofinē, Ku ālftē mbreteti i Iudēvet  
ki kā lēme? sepsē pām ŷlin e ati nē tē Lēmit tē dielit ede  
erθmē me e ađuruem. Ede mbreteti Herodit kur nēđđōi  
uperzie,ede ġiθē Ierusalemā bālķē me atē. Ede si mbēlodī  
tē ġiθē Krŷepriftēnit ede Śkrŷisit e pōpūlit, pŷeste me  
mařē vešt prei atyneve, ku lēn Krišti. Ede atā i θanē, nē  
Beθleem tē Iudese: sepsē kēštu āštē śkruem prei āneše  
profetit:

Diodati, 1994

Mateu Kapitulli 2.

1 Pasi Jezusi lindi në Bethlehem të Judesë në kohën e mbretit  
Herod, ja që disa dijetarë nga lindja arritën në Jeruzalem,  
2 duke thënë: "Ku është mbreti i Judenjve, që ka lindur? Sepse

<sup>417</sup> Lloshi Xhevat, Rreth Alfabetit të shqipës, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2008.

*pamë yllin e tij në Lindje dhe erdhëm për ta adhruar".*

3 Mbreti Herod, kur dëgjoi këto fjalë, u shqetësua, dhe bashkë me të mbarë Jeruzalemi.

4 Dhe, mbasi i mblodhi të gjithë krerët e priftërinjve dhe skribët e popullit, i pyeti ku duhet të lindte Krishti.

5 Dhe ata i thanë: "Në Bethlehem të Judesë, sepse kështu është shkruar nëpërmjet profetit":

Dom Simon Filipaj, 1994

### Kapitulli 2 Mateu

Pasi Jezusi lindi në Betlehemin e Judesë, në kohën e mbretit Herod, ja, prej Lindjes ia behën në Jerusalem disa Dijetarë,<sup>2</sup> e pyetën: "Ku është foshnja e lindur, që do të bëhet mbreti i judenjve. Sepse e pamë yllin e tij duke lindur dhe erdhëm t'i shprehim nderimet tona."<sup>3</sup>

Mbreti Herod, posa i dëgjoi këto fjalë, u shqetësua vetë e me të edhe mbarë Jerusalem. I bashkoi të gjithë kryepriftërinjtë e skribët e popullit dhe i pyeti se ku duhej të lindte Mesia. Ata iu përgjigjën: "Në Betlehemin e Judesë, sepse kështu ka shkruar profeti".

Vladimir Dervishi, 2000

### Kapitulli 2

1 Dhe ja, sapo lindi Jezusi në Betlehem të Judesë në ditët e mbretit Herod, arritën në Jeruzalem magët nga Lindja,

2 duke thënë: "Ku është Ai që ka lindur mbret i judenjve? Sepse ne pamë yllin e Tij në Lindje dhe erdhëm ta adhurojmë."

3 Me të dëgjuar këtë, mbreti Herod u turbullua dhe bashkë me të gjithë Jeruzalemi.

4 Si mblodhi të gjithë kryepriftërinjtë dhe skribët e popullit, ai kërkoi të dinte prej tyre vendin ku do të lindte Krishti.

### PËRFUNDIME:

Përkthimi i Biblës apo i një vepre letrare klasike të bërë para një shekulli nuk quhen më si të lexueshëm dhe si pasojë kërkojnë ripërkthim ose një përkthim më 'modern'. Kjo tregon se standardi marrës i një kulture është faktor përcaktues dhe duhet të ndryshojë me kohën. Shkaku i vjetërimit të përkthimit duhet të kërkohet në rrethana nga të cilat varet gjuha dhe stili i përkthimit në momentin kur është bërë përkthimi.

Metoda krahasuese diakronike (krahasimi i moshës së përkthimit në kohëra të ndryshme) ndihmon shumë për të parë dhe analizuar evolucionin e

gjuhës shqipe në përkthimet e ripërkthimet e veprave letrare në gjuhën shqipe.

Bibla si libri më i përkthyer në botë ka rëndësi të madhe pasi ka shënuar ngjarje të rëndësishme jo vetëm për historinë kishtarë, por edhe për historinë gjuhësore, kulturore dhe letrare të popujve dhe të popullit shqiptar gjithashtu. Ripërkthimi i Biblës e ka sjellë këtë tekst në kohë duke iu përgjigjur nevojave të lexuesit.

Evoluimi i gjuhës së përkthimit, nga versioni i parë dhe deri te versioni i fundit i ripërkthimit ndihmon të shohim pasqyrimin e procesit diakronik të evoluimit të gjuhës shqipe. Ripërkthimi i Shkrimeve të Shenjta ka ndjekur hap pas hapi zhvillimin e shqipes, lindjen, rrugën e saj drejt formimit e kalimit nga gjuhë e folur në të shkruar, krijimin e identitetit të saj, hedhjen e themeleve të gjuhës letrare, praninë dhe përdorimin e të dyja dialekteve, njohjen, ngritjen dhe afirmimin e të dy dialekteve si variante letrare, përpjekjet për njësimin e saj, kristalizimin e plotë të normës letrare dhe shuarjes së veçorive dalluese të dialekteve dhe ngulitjes së normës letrare unike.

Përkthimet duhet të nxiten, pasi përveç ndryshimeve dhe evoluimit të gjuhës sjellin risi në gjuhën dhe kulturën marrëse, duke e pasuruar atë më tej.

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. Ahmeti, Isak, Bibla në letërsinë shqiptare, Prishtinë, 1999.
2. Bibla. Shkrimi i shenjtë. Besëlidhja e vjetër dhe Besëlidhje e re. Përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Drita, Ferizaj, 1994.
3. Bibla: Dhiata e Vjetër dhe Dhjata e re: Përkth 1991-94/Nga Diodati i Ri . T.: Shoqata Shqiptare e Biblës, 1995.
4. Kristoforidhi, K. Dhiata e Re e Zotit edhe shërbyesit t'onë Iesu-krishtit, këthyem prei Greqishtesë vietër - shqip. Në gjuhë gegenishte prej K Brownley Siobhan, Narrative Theory and Retranslation Theory. Across Languages and Cultures 7 (2), 144-170, 2006.
5. Çabej, Eqrem, (1968): "Meshari" i Gjon Buzukut, Botim kritik, Tiranë.
6. Çabej, Eqrem, "Meshari i Gjon Buzukut" (1995). Botim kritik, Tiranë, 1968.
7. Defo, Daniel (1911): Robinson Kruzo. Mbrothesija, Kristo Luarasi.
8. Dhiata e Re e Zotit dhe Shpëtimtarit t'ënë Jisu Krisht kthyerë prej Elinishtesë shqip, ndë të folë toskënisht 1879 1872.
9. Dhjata e Re, "Dhjata e re", botim i Albanian Bible society, Tiranë, 2000, përkthyer nga Vladimir Dervishi.
10. Dhiata e Re (përkthimi i Kostandin Kristoforidhit) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Tiranë, 1994.
11. Filipaj Dom Simon, (1994): Paraqitja, Bibla, Ferizaj.
12. Filipaj Dom Simon, (1990): Historia e përkthimit të Biblës është historia e shkrimit shqip, Prishtinë.

13. Gjika L. Thanas (2007): Kur dhe ku u shkrua Dhiata e Re, Tiranë.
14. Lloshi, Xhevat, (2004): Larmia e traditës së përkthimit shqip të Biblës, Tiranë.
15. Lloshi, Xhevat, Rreth Alfabetit të shqipes, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2008.
16. Lloshi, Xhevat, Bibla shqip, në AKS, Suplement i përjavshëm i “Koha Jonë” 1994, nr. 9.
17. Lloshi, Xhevat, Përkthyesi i parë i suksesshëm i Dhjatës së re shqip në Vangjel Meksi (1770-1823) personalitet i gjuhës shqipe, Dita 2000.
18. Mancaku, Seit, (2004): Historia e shqipes së shkruar dhe përkthimi i Biblës në shqipen standarde, Tiranë.
19. Rrota Justin, (1938): Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe, Gjon Buzuku,
20. Sedaj Engjëll, “Bibla dhe përkthimet e saj në gjuhën shqipe”
21. Toury Gideon. (1978): ‘The Nature and Role of Norms in Literary Translation.’ In: J.S. Holmes, J. Lambert, R. Van den Broek (eds.), Literature and Translation. New perspectives in literary studies. (Leuven, Acco, (93-100)

### **Language evolution in Albanian translations**

#### ***ABSTRACT***

Retranslation is not an in-depth studied phenomenon, although it is really important, because it provides interesting data about a series of issues in Translation Studies as well as the evolution of target language. Translations and retranslations have given a valuable contribution to the language and the culture of the Albanian language, leading to easily readable works for the contemporary reader and trying not to let the classical writers or first translations fall under the shadow of oblivion. The paper attempts to highlight the retranslation concept as a time-affected process and viewed from a diachronic perspective, it brings about huge changes that are identified through the translations and retranslations of the Bible that extend over a centuries-long period and also through the versions of the work “Robinson Crusoe” which has been translated within a one-century period from the first version to the last one. It illustrates and compares these changes by providing examples, since they reflect the birth, shaping, development of the identity of the Albanian language, evolution of the language and writing, road towards its creation and turning from a spoken to a written language, dissolution of the distinctive features, unification of the language, standardization and crystallization of the literary norm.

**Key words:** retranslation, language evolution, literary norm crystallization, “aging” of translation.

Nevila DRISHTI

## QASJE KONCEPTUALE DHE PRAGMATIKE NDAJ GJENERATIVIZMIT

### I

Noam Chomsky bën pjesë në atë grup studiuesish që janë vënë në kërkim të ligjeve dhe rregullave e të padukshme e që besojnë se vëzhgimet e ngurta të sjelljes njerëzore kanë rëndësi vetëm për sa kohë ato na zbulojnë ligje të ‘nëndheshme’ e misterioze, të cilat kjo sjellje i pasqyron vetëm pjesërisht dhe shpesh të shtrembëruara nga faktorë jashtë gjuhësorë.

Në këtë qëndrim anti-bihejvlorist<sup>418</sup> të tij, Chomsky arriti në konkluzione mbi natyrën e gjuhës njerëzore që shkojnë përtej sferës së gjuhësisë. Duke e përballur modelin gjuhësor të deriatëhershëm me të dhëna e shembuj, të cilët ky i fundit nuk i trajtonte dot, Chomsky arriti ta thyente dhe të krijonte një model krejtësisht të ri. Deri në publikimin e *Syntactic Structures*, në 1957, përpjekjet e gjuhëtarëve në përgjithësi ishin të drejtuara drejt klasifikimit të elementeve të gjuhëve njerëzore, gjë që funksiononte shumë mirë me njësi që kanë një ‘korpus’ të kufizuar siç janë fonemat, morfemat dhe fjalët.

Strukturalizmi<sup>419</sup>, ku Chomsky kishte rrënjët e formimit të tij, me metodat strikte të verifikimit, përjashtonte nga objekti i vet mundësinë e trajtimit të kuptimeve të fjalive, apo të çfarëdo njësie tjetër të pavëzhgueshme në lidhje me mendimin, që shiheshin si modele të sjelljes njerëzore të përcaktuara nga stimujt dhe përgjigjet ndaj tyre, ndaj për rrjedhojë u panë si lëndë për psikologjinë dhe shkencat e tjera bihejvloriste.

<sup>418</sup> Refuzimi i Chomski-t, politik dhe intelektual, i një ideje të tillë (bihejvlorizmit) u bë i qartë dhe publik, në vazhden e recensionit të tij "të pamëshirshëm dhe të ndezur" ndaj librit të B. F. Skinner *Sjellja Gjuhësore* 1975. ... Ky recension u shfaq në vitin 1959 në gazetën *Gjuha*, dhe mori vëmendje të konsiderueshme. Chomsky tridhjetë vjeçar ishte duke u përballur me një figurë të konsoliduar dhe të ngulitur mirë, dhe, duke vepruar kështu, po vinte në dyshim një shkollë të tërë psikologjike. (Barsky, *Noam Chomsky: a life of dissent*, f. 96-97).

<sup>419</sup> Revolucioni i Chomsky-t ishte një revolucion *përbrenda* gjuhësisë strukturaliste – i tillë që ndryshoi thellësisht konceptet tona mbi natyrën e strukturës gjuhësore dhe hapi një rrugë të re për të kuptuar se si natyra e saj ndikon në mënyrën se si funksionon mendja njerëzore. (Newmeyer, *Generative Linguistics: a historical perspective*, f. 27).



Gjithashtu, metodat klasifikuese strukturaliste nuk ishin në gjendje të jepnin llogari për pafundësinë e fjalive që mund të gjenerohen në ligjërimin njerëzor, për faktin që ato mund të zgjaten potencialisht pafundësisht, apo për marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet disa tipave të fjalive: për shembull, në fjalitë ‘*Djali ledhatohet nga prindërit*’ dhe ‘*Djali largohet nga prindërit*’ vërejmë në pamje të parë të njëjtën strukturë gramatikore, por kjo ngjashmëri është vetëm sipërfaqësore, sepse gramatika e tyre është shumë e ndryshme. Në fjalinë e parë ‘djali’ funksionon si një kundrinor i drejtë, sepse ka kuptimin që *prindërit ledhatojnë djalin*, ndërsa në fjalinë e dytë e njëjta fjalë funksionon si kryefjalë. Nga transformimet që mund t’i bëjmë shembullit të parë, mund të përftojme: ***Ledhatimi i djalit nga prindërit ishte qetësues, por edhe Ledhatimi i prindërve e qetësoi djalin***. Ndërsa në rastin e dytë mund të përftohet *largimi i djalit*, por jo *largimi i prindërve*.

Një rast tjetër që lë vend për diskutim është një fjali si ‘*Kontrolli i ministrisë nxori disa probleme*’, ku mund të kuptohet që ministria bëri kontroll, ose që ministria ishte ajo që u kontrollua. Apo edhe një fjali e tipit ‘*Nuk më pëlqeu sharja e tij*’, e cila pavarësisht se nuk përmban asnjë fjalë dykuptimëshe, përsëri mund të nënkuptojë që: nuk më pëlqeu që e shanë, apo se si e shanë, nuk më pëlqeu që ai shau, apo se si ai shau.

Për rrjedhojë, sipas këtij orientimi të ri të objektit të gjuhësisë, një përshkrim gramatikor duhet të ketë për qëllim hartimin të një tërësie të fundme rregullash gramatikore për një gjuhë të caktuar, në bazë të të cilave do të ishim në gjendje të gjeneronim një pafundësi fjalish (por jo vargje të tjera fjalësh që nuk përbëjnë fjali).<sup>420</sup> Gjithashtu, do të përftohej edhe një shpjegim i fenomeneve të tilla si ambiguiteti i disa fjalive apo lidhjet e brendshme që ekzistojnë midis disa të tjerave.

Ky drejtim i ri, në njëfarë mënyre, reagon kundrejt qasjes më tradicionale ndaj gjuhës që kërkon të mbajë distancë nga rrafshi teorik, por që gjithsesi bën shumë hipoteza ‘implicite’ mbi gjuhën të cilat nga ana e tyre nuk u nënshtrohen hetimeve të mëtejshme. Por, mënyra e vetme për të ecur përpara dhe për t’u bindur për ‘korrektësinë’ e hipotezave është që ato të përballen e të vihen vazhdimisht nën lupë dhe për këtë ato duhen bërë ‘eksplicite’.<sup>421</sup>

<sup>420</sup> Qëllimi themelor në analizën gjuhësore të një gjuhe L është të ndajë sekuencat gramatikore të cilat janë fjalitë e L nga sekuencat jogramatikore, të cilat nuk janë fjalitë e L dhe të studiojë strukturën e sekuencave gramatikore. Gramatika e L do të jetë kështu një pajisje që gjeneron të gjitha sekuencat gramatikore të L dhe asnjë nga ato jogramatikore (Chomsky, *Syntactic Structures*, f. 13).

<sup>421</sup> ... Por duke vepruar në këtë mënyrë, ai vendosi standarde më rigorozë të ‘shpjegimit’ gjuhësor nga ato me të cilat ishin mësuar gjuhëtarët deri atëherë. Këto standarde janë

## II

Me teorinë e tij gjuhësore, Chomsky bën një rikthim të pohimeve të filozofëve racionalistë të shekullit XVII mbi idetë e brendshme, ekzistuese në mendjen e njeriut, mbi njohuritë që nuk rrjedhin nga ndonjë eksperiencë. Ndërkohë, empirikët dhe bihejvloristët e shekullit të kaluar e trajtonin mendjen njerëzore si një *fletë të bardhë*, pa asnjëfarë njohurie paraprake që të ‘drejtojnë’ apo ‘kufizojnë’ njohuritë e fituara nga eksperiencia.

Duke pasur ndër sy edhe faktin që, pavarësisht nga niveli i inteligjencës, të gjithë fëmijët e mësojnë gjuhën, sipas Chomsky-t ky përvetësim i gramatikës nga fëmija i ngjan në njëfarë mënyre ndërtimit të pavetëdijshëm të një teorie gjuhësore që ai bën në mendjen e tij. Kjo nuk mund të arrihet kurrësi në një *tabula rasa*, por vetëm nëse fëmija ka paraprakisht njëfarë forme, aftësie, apo njohurie gjuhësore, një Gramatikë Universale (GU) të programuar në trurin e tij si pjesë e trashëgimisë gjenetike, duke e bërë atë të aftë të mësojë një gjuhë çfarëdo. Në këtë pikë, një përfundim i pranueshëm është se fëmija duhet ta ketë në trurin e tij, që para se të fillojë të mësojë të flasë, atë pjesë të gjuhës që është e përbashkët për të gjitha gjuhët njerëzore.

Chomsky e zgjeroi teorinë e tij gjuhësore, e cila në *Syntactic Structures* (1957), përbëhej në thelb nga përcaktimi i rregullave bazë për ndërtimin e fjalive; ndërsa në *Aspects of the Theory of Syntax* (1965), me përpunimin që i bën teorisë së tij, Chomsky liston si ‘detyrë’ të një gramatike (duke pasur parasysh kuptimin teknik që i jep ai termit *gramatikë*) “shpjegimin e marrëdhënieve mes aspektit tingullor dhe aspektit kuptimor të gjuhës”, gjë për të cilën një gramatikë që synon të jetë e plotë i duhen tre komponentë:

- komponenti *sintaksor*, që shërben për gjenerimin dhe përshkrimin e strukturës së brendshme sintaksore të ‘pafundësisë’ së fjalive në një gjuhë të caktuar;
- komponenti *fonologjik* që përshkruan strukturën tingullore të fjalive të gjeneruara nga komponenti sintaksor;
- dhe së fundmi komponenti *semantik*, që përshkruan strukturën kuptimore të këtyre fjalive.

Nga këto, më i rëndësishëm është komponenti i parë, ai sintaksor.

---

ende disi të diskutueshme (megjithëse kjo përgjithësisht shkaktohet nga keqkuptimi). Por ato janë pranuar nga shumica... Ky është faktori që i jep Syntactic Structures rëndësinë e saj ‘revolucionare’ (Lyons, *Introduction to theoretical linguistics*, f. 267).

Sigurisht që fjalitë nuk janë vargje të thjeshta fjalësh çfarëdo, por janë vargje fjalësh të renditura në mënyrë lineare e të organizuara edhe me strukturë hierarkike në përbërës funksionalë. Një pjesë e mirë e njohurive të folës/dëgjuesit të lindur të një gjuhe mbi strukturën e brendshme të fjalive mund të pasqyrohet me anë të disa rregullave të thjeshta të quajtura rregulla të ‘strukturës frazale’<sup>422</sup>, në përbërës të anës së majtë e të djathtë. Psh.:

1. FJ (Fjalia) → FE (Frazë Emërore) + FF (Frazë Foljore)
2. FE → Nyje + E (Emër)
3. FF → F (Folje) + FE
4. F → (kërkon, këndon, blej, etj.)
5. Nyje → (një, -i, -a, etj.)
6. E → (vend, vajzë, djalë, udhëheqës, këngë, etj.)

Në bazë të këtyre rregullave, mund të përftohet fare lehtë një fjali e tipit: “Një vend kërkon një udhëheqës”:

Fj

FE + FF (sipas rregullit 1)

Nyje + E + FF (sipas rregullit 2)

Nyje + E + F + FE (sipas rregullit 3)

Nyje + E + F + Nyje + E (sipas rregullit 2)

Vendi kërkon një udhëheqës.

Vajza bleu një kukull.

Një djalë këndoi këngën.


} (sipas rregullave 4, 5, 6)

Një informacion i tillë mund të paraqitet grafikisht në një skemë në formë peme. Kjo skemë e quajtur ‘*tregues frazal*’ është një mënyrë për të

<sup>422</sup> Termi *frazë* nënkupton një përbërës funksional çfarëdo brenda kufijve të një fjalie. Sot në terminologjinë gjuhësore përdoret rëndom edhe termi sintagëm: “Koncepti i marrëdhënieve sintagmatike u prezantua fillimisht në terminologjinë e Sosyrit, sipas së cilës çdo lloj njësie strukturore në gjuhë, në çfarëdo niveli, është një *syntagm* ose *syntagma*, fjalë kjo e ndërtuar në analogji me *paradigm*, dhe një sintagëm përbëhet nga një tërësi njësish më të vogla strukturore, të kombinuara sipas rregullave të caktuara dhe që mbajnë me njëra-tjetrën marrëdhënie sintagmatike... Një model i caktuar sipas të cilit kombinohen një numër sintagmash quhet strukturë” (Trask, *Key concepts in language and linguistics*, f. 202)

pasqyruar sintaksën apo strukturën sintaksore të fjalisë e njëkohësisht edhe kompetencën gjuhësore të folësit që e shqipton atë.<sup>423</sup>

Rregulla të tilla të strukturës frazale gjendeshin edhe ndër disa gramatika strukturaliste, por gjendeshin në mënyrë të nënkuptuar dhe ishte Chomsky ai që i evidentoi ato duke sjellë në vëmendje aftësinë apo rolin e tyre për



përfitim të fjalive.<sup>424</sup> Ai gjithashtu edhe faktin që këto rregulla nuk ishin të mjaftueshme për të shpjeguar të gjitha faktet gjuhësore në lidhje me sintaksën e gjuhëve natyrore siç p.sh., ambiguiteti sintaksor i disa fjalive si ato që u përmendën më lart: *Nuk më pëlqen sharja e tij.* apo në fjali si *Djali ledhatohet/largohet nga prindërit.*

Duke u nisur nga pohimi strukturalist që për të kuptuar strukturën sipërfaqësore (ss), më parë duhet të kuptohet struktura e thellë (sth) dhe mënyra se si kjo e fundit ndikon në atë sipërfaqësore, Chomsky fillimisht skicoi një gramatikë të tillë: Struktura e thellë është një formë abstrakte që përcakton anën kuptimore të fjalive. Struktura sipërfaqësore është ajo që

<sup>423</sup> Në gjuhën shqipe, nyja shquese i prapavendoset fjalëve emërore dhe për thjeshtësi ajo mund të paraqitet edhe e bashkëlidhur me emrin, por për analogji me nyjën joshquese dhe determinantë të tjerë që dalin si specifikatorë të emrit si përemrat dëftorë, të pacaktuar, etj., mund ta paraqesim edhe në këtë mënyrë.

<sup>424</sup> Nivelet gjuhësore që pranoheshin dhe nuk kishin nevojë për argumentim ishin: niveli fonetik, fonemik, i fjalës, i kategorive sintaksore, i përfaqësimit morfologjik dhe niveli i strukturës frazale. “Në kontrast, niveli “transformacional” ishte një risi fillimisht e propozuar nga Harris, por akoma e papranuar nga shumica e gjuhëtarëve; qoftë amerikanë apo evropianë. Kështu që, përpjekja kryesore në punën e hershme të Chomsky-t ishte të tregonte domosdoshmërinë e një niveli transformacional për një trajtim sa më adekuat të gjuhëve natyrore” (Graffi, *200 years of syntax: a critical survey*, f. 337-338)

shkruhet apo thuhet dhe të dyja këto shtresa lidhen me anë transformimesh të tilla si kombinime të ndryshme, shtesa apo fshirje elementësh. Më pas, në *Reflections on Language* (1975), skica e tij gjuhësore paraqitet më e komplikuar, duke përfshirë dy struktura: një për fjalitë e thella dhe një për fjalitë sipërfaqësore, që lidhen me njëra-tjetrën me anë rregullash transformimi dhe ku për fjalitë ambigue (dykuptimëshe) parashiheshin dy struktura të thella. Kështu struktura bazë kërkon një *leksikon*<sup>425</sup> dhe rregulla të ndërtimit (të strukturës frazale) dhe me anë të komponentit transformacional kjo strukturë bazë shndërrohet në një strukturë sipërfaqësore, e cila nga ana e vet nëpërmjet komponentit fonologjik shndërrohet në fjali sipërfaqësore.

Teoria e Chomsky-t në përgjithësi dhe gramatika e tij në veçanti, nuk ka qenë asnjëherë pa kritikët e vet; brenda kësaj teorie, probleme nxorën edhe të ashtuquajturit *kuantifikatorë*, *pjesëzat mohuese* dhe *rregullat e lëvizjes*. Nga të gjitha këto, janë krijuar ‘zgjatime’ të ndryshme të teorisë gjuhësore të Chomsky-t, të cilat, duke përqafuar vetëm pjesërisht pohimet e bëra nga ai, përpiqen të shoshitin problemet e shumta që dalin nga zbatimi i kësaj teorie në gjuhë të ndryshme të botës.

### III

Megjithatë, për Chomsky-n dhe ndjekësit e tij, ky debat i ndezur del shpeshherë jashtë fokusit të teorisë së tij, qëllimi i së cilës është përcaktimi i *fjalive gramatikore* dhe paraqitja e *kompetencës gjuhësore* si karakteristikë e mendjes njerëzore. Dhe në shumë raste, në mënyrë të thjeshtuar, kjo teori përdoret nga gramatikanët si një metodë për të bërë përshkrimin e një gjuhe, ndërkohë që të tjerë përdorin gjuhën për të testuar teorinë, duke pasur tre elemente:

---

<sup>425</sup> Në gjuhësi ... flasim për *leksikon*, tërësia e përgjithshme e fjalëve në dispozicion të folësit. Shpesh, leksikoni s’është konsideruar thjesht si një listë e gjatë fjalësh. Më tepër, ne e konceptojmë leksikonin si një tërësi të burimeve leksikore, duke përfshirë **morfemat** e gjuhës, si edhe proceset që vë në dispozicion gjuha për ndërtimin e fjalëve nga ato burime. Për shembull, duke pasur parasysh ekzistencën e foljeve në anglisht si *varnish* dhe *scratch*, dhe i afikseve fjalëformuese *-able* dhe *-un*, është krejtësisht e mundur për ju të krijoni fjalët *varnishable* dhe *unscratchable* sa herë që keni nevojë për to, dhe njëkohësisht të prisni që të kuptoheni, edhe në qoftë se ju dhe personi me të cilin po flisni nuk i keni hasur këto fjalë më parë. (Trask, *Language and linguistics...*, f. 151)

1. së pari një tërësi rregullash të strukturës frazale, të cilat zgjerojnë kategoritë frazale në kategori të tjera (derisa përfundojnë në njësi leksikore)
2. së dyti, një Leksikon (fjalor), që përmban një listë të fjalëve të shqipes së bashku me përcaktimet përkatëse mbi kategorinë leksikore së cilës i përkasin
3. një rregull për ndërfutjen (vendosjen) e njësive leksikore (=fjalëve) sipas nyjeve kategoriale përkatëse (p.sh., që bën vendosjen e fjalës *mur* nën nyjen e etiketuar E - emër); kështu, gramatika p.sh., mund të na sugjeronte një fjali të tillë:

- Rregullat e strukturës frazale:

1. FJ → FE + FF
2. FE → Nyje + E
3. FF → F + FE


- Leksikoni (i paraqitur në mënyrë të reduktuar)

F = shikon, vlerëson, dëgjon E = mesues, president, nxënës, audiencë, Nyje = një, -in/ a (ja), etj.

- Rregulla për vendosjen leksikore:

Për çdo kategori leksikore fundore (që gjendet në fund të treguesit frazal – pemës) duhet përzgjedhur rastësisht një njësi leksikore (=fjalë) nga kategoria përkatëse që gjendet në Leksikon.

Tani jemi gati të zbatojmë rregullat që përcaktuam për të parë se çfarë fjalish do të gjenerohen:



<sup>426</sup> Këmba e drejtë tregon kokën e frazës, d.m.th. gjymtyrën kryesore.

## Skema 2

Siç shihet nga fjalitë e gjeneruara më lart, por edhe nga kombinime të tjera të mundshme, Leksikoni që përcaktuar përmban fjalë, të cilat kur vendosen në nyjet fundore sipas kategorive përkatëse japin rezultate të kënaqshme, pra fjali të rregullta gramatikore.


Ajo që ka rëndësi të analizohet pikësëpari është fraza foljore, meqenëse ajo përbën edhe thelbin e strukturës së një fjalie. Por nëse në Leksikon do të përfshinim edhe folje, si: *fle, ecën, rri, pushon, bie*, etj., rregullat gramatikore që përcaktuar më lart dështojnë në qëllimin e tyre për të gjeneruar fjali të rregullta, gramatikore, si:

- \* Një nxënës bie presidentin.
- \* Presidenti rri audiencën.
- \* Mësuesi fle një nxënës., etj.

Me sa shihet, problemi qëndron në faktin se foljet e fundit janë folje jokalimtare dhe nuk mund të vendosen në një frazë foljore – FF që përmban një frazë emërore – FE si kundrinor të saj (komplement). Por, në pamundësi për të përcaktuar qartësisht se cilat folje marrin kundrinor dhe cilat jo, del nevoja që një informacion i tillë i veçantë të përfshihet në specifikimet që i bëhen asaj si njësi leksikore. Kështu p.sh., foljet *ha* dhe *kullufit* kanë përgjithësisht të njëjtin kuptim, por dallojnë në faktin se e para mund të marrë pjesë në një frazë foljore-FF që përmban, apo ndiqet nga një frazë emërore –FE, ndërsa e dyta jo:

- Beni hëngri/kullufiti dy pjata gjellë në drekë.
- Beni nuk kishte ngrënë/\*kullufitur akoma.

Për këtë na duhet t'i nënkategorizojmë foljet, si: *vlerësoj, dëgjoj, shikoj*, etj., si folje që mund të marrin pjesë në një FF që përmban një kundrinor, ndërsa foljet si *fle, ecën, rri, pushon, bie*, etj., si folje që nuk mund ta bëjnë këtë dhe këtë mund ta pasqyrojmë në këtë mënyrë:



<sup>427</sup> Kllapat katrore përmbajnë informacionin që ka të bëjë me nënkategorizimin e njësisë përkatëse. Ndërsa, në një situatë kur rendi do të ishte i ngulitur, siç është përgjithësisht në shqip pozicioni i mbiemrit pas emrit, shenja \_\_\_ e vendosur brenda kllapave do të indikonte pozicionin e njësisë në fjalë, në këtë rast foljes; por meqenëse në shqip, kundrinori i drejtë mund të pozicionohet si para, edhe pas emrit, atëherë kjo shenjë do të

*shikoj, etj**pushon,  
bie, etj.*

Në shqip, kundrinori i drejtë shprehet me një fjalë emërore, por ka një kufizim të mëtejshëm në lidhje me formën razor, e cila është gjithmonë në kallëzore dhe, nëse ne nuk e specifikojmë këtë kufizim në kornizën nënkategoriale të foljes, mund të përftojmë rezultate jogramatikore si më poshtë:

\*Audienca dëgjon presidentit

\*Mësuesja vlerëson një nxënësi

Prandaj do ta rishkruajmë 'formulën' e mësipërme në këtë mënyrë:

*vlerësoj,*  
*dëgjoj,*  
*shikoj, etj* } F-folje, + [ \_\_\_ FE<sub>4</sub>]

Në të njëjtën mënyrë mund të krijohet një kornizë e nënkategorizimit të njësisë për të gjithë plotësorët (komplementët) që ajo merr apo mund të marrë, ndërkohë që për një folje si *ha*, e cila mund të përdoret edhe si kalimtare, edhe si jokalmimtare, formalisht ky informacion mund të paraqitet në një nga mënyrat e mëposhtme:

*ha*: F, + [ \_\_\_ (FE<sub>4</sub>) ]

*ha*: F, ± [ \_\_\_ FE<sub>4</sub> ]


Pas kësaj, mbasi njësisia leksikore u pajis jo vetëm me informacionin kategorial të saj, por edhe me atë nënkategorial, që përcakton numrin e plotësorëve (komplementëve) të domosdoshëm – të ashtuquajturat *argumente* të foljes, na duhet t'i rikthehemi rregullës së vendosjes leksikore dhe ta riformulojmë në atë mënyrë që ajo të parashikojë apo të reflektojë edhe kufizimin e ri që vumë sipas të cilit njësisia leksikore do të përzgjidhet jo më vetëm në bazë të përkatësisë kategoriale, por edhe në bazë të nënkategorizimit, gjë që do ta lejojë të përdoret vetëm në strukturat sintaksore përkatëse.

Tani, në strukturën e mëposhtme rregulla e rishkruar nuk do të na lejojë që të vendosim në nyjen F një folje jokalmimtare:

---

merret vetëm si një indikator i njëfarë rendi të zakonshëm, por jo të domosdoshëm të foljes përpara kundrinorit.





### Skema 3

Po çfarë mund të themi për nënkategorizimin e një foljeje si *vendos/vë* e cila merr pjesë në fraza foljore që kërkojnë jo vetëm pjesëmarrjen e një fraze emërore, por njëkohësisht edhe të një fraze parafjalore, sepse siç shihet nga shembujt e mëposhtëm, mungesa e njërës prej këtyre frazave në frazën foljore ku merr pjesë folja *vendos/vë*, jep rezultat jogramatikor:

Beni vendosi letrat në çantë/ në tavolinë / në sirtar, etj.

\*Beni vendosi letrat.

\*Beni vendosi në sirtar

Kështu, në vijim të metodës së mëparshme, nënkategorizimin e kësaj foljeje si një folje që kërkon si argumente të vetat një frazë emërore dhe një frazë parafjalore mund ta paraqesim si më poshtë:

*vë/vendos*, F, + [\_\_ FE<sub>4</sub> \_\_FP]

por sërish edhe këtu na del nevoja për kufizime të mëtejshme, pasi shembulli i mëposhtëm tregon se jo çdo frazë parafjalore mund të marrë pjesë në fraza foljore si argument i kësaj foljeje:

\*Beni vendosi letrat nga çanta/për në çantë/ prej çantës

Për të rregulluar këtë problem, duhet që nënkategorizimi i foljes *vendos/vë* të rishikohet në mënyrë që të specifikojë faktin që frazat parafjalore që dalin si argumente të saj të tregojnë vend:

*vë/vendos*, F, + [\_\_ FE<sub>4</sub> \_\_FP<sub>+VEND</sub>]

Të njëjtën rrugë do të ndjekim edhe për folje, si: *them, jap, prezantoj*, etj., të cilat përveçse mund të dalin të shoqëruara nga vetëm një kundrinor i drejtë, tipikisht marrin si argument edhe një kundrinor të zhdrejtë:

Ai tha të vërtetën

Ai u tha të vërtetën prindërve

\*Ai tha

Edhe në këtë rast, ashtu si në rastin e kundrinorit të drejtë, është e nevojshme të specifikojmë që folje të tilla, përveç një fraze emërore me emër në rasën kallëzore, mund të kenë si argument edhe një frazë emërore me emër në rasën dhanore. Kuptohet që specifikimi i rasës i referohet gjymtyrës kryesore të frazës (kokës së sintagmës):

<i>them,</i> <i>jap,</i> <i>prezantoj, etj.,</i>	}	F, + [__ FE <sub>4</sub> (__FE <sub>3</sub> )]
--	---	--

Këto sa u thanë më lart për frazën foljore, japin një ide mbi llojin e informacionit që përbën kornizën nënkategoriale të një njësie dhe mënyrën se si e përftojme këtë informacion, thelbi i së cilës është që njësitë nënkategorizohen duke u bazuar në argumentet (në rastin e foljes) apo në plotësorët e veçantë që kërkojnë, që nuk mund të përcaktohen nga ndonjë rregull e përgjithshme.

#### LITERATURA:

1. Barsky, R. F., *Noam Chomsky: a life of dissent*, MIT Press, 1998.
2. Chomsky, N., *Syntactic Structures (1957)*, 2<sup>nd</sup> ed., Mouton de Gruyter, Berlin . New York, 2002.
4. Chomsky, N., *Aspects of the Theory of Syntax*, MIT Press, Massachusetts Institute of Technology, Cambridge, Massachusetts, 1965.
5. Emonds, J. E., *Lexicon and grammar: the English syntacticon*, Walter de Gruyter, 2000.
6. Graffi, G., *200 years of syntax: a critical survey*, John Benjamins Publishing Company, 2001.
7. Lasnik, H., Depiante, M. A., Stepanov, A., *Syntactic structures revisited: contemporary lectures on classic transformational theory*, MIT Press, 2000.
8. Lyons, J., *Introduction to theoretical linguistics*, Cambridge University Press, 1968.
9. Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, 2008.
10. Newmeyer, F. J., *Generative Linguistics: A Historical Perspective*, Routledge, 1997.
11. Perlmutter, D. M., Soames, S., *Syntactic argumentation and the structure of English*, University of California Press, 1979.
12. Radford, A., *Transformational Syntax*, Cambridge University Press, 1984.
13. Radford, A., *Transformational Grammar: A first course*, Cambridge University Press, 1988.
14. Trask, R. L., *Key concepts in language and linguistics*, Routledge, 1999.

#### Conceptual and pragmatic approaches to generati

***SUMMARY***

In this writing the author has reeled some information about the generative school, starting by the Universal Grammar (GU) with the universal language ratings.

She has shown the general and special innovations that this school brings in the world language directions; starting by getting the L<sub>1</sub> L<sub>2</sub> and finishing with the analysis on directly components of the sentence.

The writing is associated with schemes of Chomsky's tree and syntagmatic rates

Etleva KONI

**FJALITË PYETËSE TËRËSORE NË GJUHËN  
ANGLEZE DHE SHQIPE, LARMIA E SHPREHJES  
SË TYRE NË GJUHËN SHQIPE SI RRJEDHOJË E  
RENDIT TË LIRË TË FJALËVE**

Janë fjali pyetëse të cilat dalin pa fjalë pyetëse, përgjigja zakonisht jepet me fjalët –fjali *po* ose *jo* dhe kanë intonacion ngjitës. Si në anglishte, edhe në shqipe fjalitë pyetëse tërësore janë ato fjali ku folësi kërkon të mësojë një fakt që nuk e di, të sigurohet për vërtetësinë e një fakti që e di, por s'është plotësisht i sigurt, ose të përforcojë një mendim të vetin.<sup>428</sup> Në gjuhën shqipe, këto fjali pyetëse mund të jenë dialogjike, të cilat përgjithësisht paralajmërojnë një përgjigje dhe ndiqen në dialog prej kësaj, por edhe monologjike, të cilat janë pyetje që folësi mund t'ia bëjë vetes, mund t'i formulojë në mendjen e tij.<sup>429</sup>

*Po si të futem unë në lëkurën e tyre, se? – pyeti veten Kujtimi.*

Fjalitë pyetëse që kërkojnë një përgjigje pohore ose mohore zakonisht në anglishte formohen duke vendosur foljen ndihmëse përpara kryefjalës duke i dhënë fjalisë intonacion ngjitës.

Nëse nuk ka asnjë element në togfjalëshin foljor që mund të funksionojë si folje ndihmëse atëherë përdoret folja ndihmëse “**do**”, e cila shërben për të formuar fjalinë pyetëse pohore dhe mohore. Në gjuhën shqipe kjo folje ndihmëse nuk ka ekuivalent.

*Do you mind my smoking?                      Të bezdis po të pi duhan?  
Do you believe what you paint?              E beson atë që pikturon?*

<sup>428</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, 1996, f. 140.

<sup>429</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, 1996, f. 136.

Ashtu si në anglishte, ato përdoren pa fjalë pyetëse, por ndryshe nga anglishtja, shqipja përdor pjesëza të ndryshme pyetëse. P.sh., pjesëzat pyetëse si: *a, vallë, mos, thua*, dhe bashkime të tyre si: *mos vallë, vallë a, a... vallë, a mos, a thua (se)*, të cilat zakonisht dalin në krye të fjalisë, herëherë pas fjalës së parë a fjalëve të para.<sup>430</sup>

**Mos** jeni dhe ju nga këto anë?

**A** e gjetët?

Po ky **a** e di?

(Gramatika e gjuhës shqipe II)

Ai **vallë** e dinte këtë gjë?

**Mos** është kjo dobësi **vallë**?

Po **a** e dinte **vallë** ajo?

Këto pjesëza nuk vendosen vetëm në fillim të fjalisë pyetëse. Ka pjesëza që mund të vendosen edhe në mes, apo në fund të fjalisë pyetëse. Ato sjellin ngjyrimë të ndryshme si p.sh., ngjyrimë dyshimi apo pasigurie për faktin e dhënë në formë pohimi apo mohimi.<sup>431</sup>

E kishin pyetur **vallë** Migenën? (Kadare “E penguara”, f. 23)

Ndryshe nga anglishtja, e cila ka një strukturë të ngurtë për formimin e fjalisë pyetëse, shqipja ka një rend më të lirë. Siç mund ta vëmë re dhe nga shembujt, fjalitë pyetëse në shqipe kryesisht fillojnë me pjesëz ose me folje, por jo gjithmonë. Ato mund të fillojnë dhe me pjesë të tjera të ligjëratës.<sup>432</sup> Kjo ndodh pasi në çastin që dikush flet ose shkruan, veprojnë disa faktorë të tjerë, që ndikojnë për mënyrën se si do të aktualizohen modelet sintaksore. Ndër dy faktorët më të rëndësishëm do të shënojmë.<sup>433</sup>

1. Struktura e aktit të komunikimit, që do të thotë nëse kemi të bëjmë me monolog, ku fjalitë kanë një vendosje të caktuar të gjymtyrëve, apo me dialog, ku fjalia ka një rend të lirë.
2. Struktura e aktit të të menduarit.

*I pari mashkull, më kupton?*

*Po tani, a dëgjohet më mirë?*

<sup>430</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, 1996, f. 141.

<sup>431</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, 1996, f. 144.

<sup>432</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, 1996, f. 394

<sup>433</sup> Lloshi, Xh. “Stilistika dhe pragmatika”, 1999, f. 87.

*Doktor, më dëgjoni?*

*Vërtet ti nuk e kap që Linda ishte ndryshe? (Kadare, "E pengara", f. 184, 123, 116, 101)*

Pra, gjuha shqipe në krahasim me gjuhën angleze, ka një rend më të lirë të gjymtyrëve dhe kjo për arsye se ka një sistem të pasur trajtash morfologjike dhe përdorim të gjerë të parafrjalëve. Kjo dukuri e gjuhës shqipe shfrytëzohet për ngjyrim të ndryshme stilistikore. Vetë rendi, që do të thotë ndërrimi i vendit të zakonshëm të gjymtyrëve, tregon se ku do të mëshojë folësi, se çfarë do të theksojë apo do të vërë në dukje ai, apo për të shprehur diçka në mënyrë sa më të gjallë, me ngjyrim afektiv.<sup>434</sup> Por këtë dukuri nuk mund ta gjejmë në fjalitë pyetëse në gjuhën angleze, të cilat fillojnë me një folje ndihmëse dhe kur rendi i gjymtyrëve është i përcaktuar.

Fjalitë pyetëse tërësore në gjuhën shqipe mund të përdoren edhe për të shprehur nxitje, kur është fjala për të formuluar një propozim, një kërkesë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.<sup>435</sup>

*Po sikur ta ndezim njëherë o shoku Xhemal?*

Ndodh shpesh që në gjuhën e folur shqipe thënie të tilla si:

*A s'të vjen të pëlçasësh?*

*Nuk ta bën borxh ky?*

gjejnë një përdorim më të gjerë për arsye se janë më shprehëse. Gojtaria dhe letërsia e kanë kthyer këtë në një figurë të njohur, që quhet pyetje retorike, domethënë si një ndërhyrje emocionale, e cila nuk kërkon përgjigje, por e nënkupton atë.<sup>436</sup> Këto janë pyetëse ose të ngjashme me fjalitë pyetëse vetëm nga forma. Ato shërbejnë jo për të pyetur, por për të pohuar a mohuar diçka me forcë të veçantë. Shqiptohen zakonisht me një intonacion pyetës thirrmos.<sup>437</sup>

## 1. Rendi i fjalëve në fjalitë pyetëse në gjuhën shqipe dhe angleze

Raportet sintaksore në disa raste mund të gjejnë shprehje në topikën a rendin e fjalëve e të gjymtyrëve, herë-herë dhe të fjalive. Topika luan një

<sup>434</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. "Gramatika e Gjuhës Shqipe II", 1996, f. 413.

<sup>435</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. "Gramatika e Gjuhës Shqipe II", 1996, f. 135.

<sup>436</sup> Lloshi.Xh. "Stilitika dhe pragmatika", 1999, f. 95.

<sup>437</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. "Gramatika e Gjuhës Shqipe II", 1996, f. 127.

rol të rëndësishëm në gjuhët që s'kanë sistem të zhvilluar eptimi siç është gjuha angleze. Në të rendi i fjalëve është i ngulitur dhe shërben për dallimin e funksioneve të tyre sintaksore në fjali. Ndërsa në gjuhët ku funksionet e fjalëve zakonisht përcaktohen nga trajtat e tyre, siç ndodh në gjuhën shqipe, rendi i fjalëve është përgjithësisht i lirë dhe ka kryesisht karakter stilistik.<sup>438</sup>

### 1.1 Inversioni

Inversioni është një tjetër dukuri që i bën fjalitë pyetëse të ndryshojnë në këto dy gjuhë. Në anglishte kemi inversionin *kryefjalë - folje ndihmëse*, e cila është një domosdoshmëri për të formuar fjalinë pyetëse në këtë gjuhë. Ndërsa në gjuhën shqipe inversioni nuk është një tipar i domosdoshëm për të formuar fjalinë pyetëse duke qenë se tipat e fjalive në gjuhën tonë dallohen zakonisht nga intonacioni i veçantë me të cilin shqiptohen.<sup>439</sup> Melodika është një prej mjeteve të diferencimit të fjalive sipas funksionit të tyre në ligjërim (fjali dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse). E njëjta fjali, me të njëjtën përbërje dhe strukturë, mund të jetë dëftore ose pyetëse, sipas vijës melodike të ndryshme me të cilën shqiptohet.<sup>440</sup>

*Ai ende s'i kishte marrë vesh?* (Kadare, "E penguara", f. 34)

Ai ende s'i kishte marrë vesh.

*S'e di as vetë?*

(Kadare, "E penguara", f. 10)

S'e di as vetë.

Mund të themi se në shumicën e rasteve kryefjala mungon, por ajo kuptohet nga sistemi i mbaresave foljore. Kryefjala, si në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, përshtatet me foljen në vetë dhe numër kur është përemër, dhe vetëm në numër kur është emër. Në gjuhën angleze kjo përshtatje e kryefjalës vihet re te folja "*jam*" në kohën e tashme dhe të kryer të thjeshtë, dhe më të gjitha foljet e tjera vetëm në kohën e tashme, veta e tretë, numri njëjës. Në gjuhën shqipe kjo përshtatje është e dallueshme për të gjitha foljet, në çdo kohë të foljes, pasi kjo gjuhë karakterizohet nga sistemi i mbaresave, gjë që mungon në anglishte.

<sup>438</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. "Gramatika e Gjuhës Shqipe II", 1996, f. 71.

<sup>439</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. "Gramatika e Gjuhës Shqipe II", 1996, f. 118.

<sup>440</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. "Gramatika e Gjuhës Shqipe II", 1996, f. 73.

*A e gjetët?  
Did you find it?*

Te ky shembull vëmë re se për të formuar fjalinë pyetëse në shqipe përdorim pjesëzën “a” kurse në anglishte përdorim foljen ndihmëse “**did**”, e cila shpreh dhe kohën e foljes. Te fjalia pyetëse në shqipe mungon kryefjala dhe kundrinori i drejtë i shprehur me trajtë të shkurtër është vendosur përpara foljes, gjë që nuk mund të ndodhë në gjuhën angleze. Kundrinori në anglishte vendoset pas foljes kryesore, ndërsa në shqipe ai jepet me anë të trajtës së shkurtër e cila i paraprin foljes.

Kur e përdorim kryefjalën në fjalinë pyetëse në shqipe, ajo ka një funksion të ndryshëm nga ai në anglishte. Ajo përdoret në rastet kur theksohet vetë kryefjala.

*Have you ever been to New York? / Ke qenë ndonjëherë në Amerikë ti?*

*Would that still be there? / Atje do të ishte akoma ajo?*

Në fjalitë pyetëse në gjuhën shqipe, kryefjala vendoset në fund të saj kur mbi të bie theksi logjik. Theksi logjik bën që fjala të shqiptohet më fuqishëm, e njëkohësisht me një ton më të lartë, gjymtyra që kërkohet të vihet në pah. Ai mund të veprojë vetëm ose njëkohësisht me topikën. Kjo vihet re më shpesh në fjalitë pyetëse tërësore dhe shërben për të tërhequr vëmendjen mbi elementin e thënies, për të cilin pyetet, ai orienton për përgjigjen që pritet.<sup>441</sup>

Në gjuhën shqipe rendi i zakonshëm është dalja e kallëzuesit para kryefjalës për fjalitë pyetëse. E anasjella (inverioni) në gjuhën shqipe bën që një gjymtyrë e caktuar të shquhet, të tërheqë vëmendjen, të fitojë një ngjyrim. Shembulli më i qartë është kalimi i foljes ndihmëse pas pjesores në trajtat e përbëra të foljeve.<sup>442</sup>

E, o Pilo, për t'i blerë ke, *që po m'i mat ashtu?* (J.Xoxa, Lumi i vdekur)

Në gjuhën e folur e anasjella është mjaft e zakonshme për theksim dhe nën ndikimin e emocionit.<sup>443</sup>

## 1.2 Përgjigje të shkurtra

Përgjigjet në anglishte, shqipe dhe në shumë gjuhë të tjera nuk duhet të jenë fjali të plota. Nuk do të ishte e natyrshme që përgjigjja të ishte e

<sup>441</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, 1996, f. 74.

<sup>442</sup> Lloshi. Xh. “Stilistika dhe pragmatika”, 1999, f. 89.

<sup>443</sup> Lloshi. Xh. “Stilistika dhe pragmatika”, 1999, f. 89.



njëjtë me fjalinë pyetëse; që do të thotë në përgjigje nuk mund të kemi të njëjtat gjymtyrë si në fjalinë pyetëse.

*Did you get injured?*  
*Yes, I got injured.*

*U vrave?*  
*Po, u vrava*

Ky lloj bashkëbisedimi, rrallë ndodh midis dy folësve të një gjuhe. Ajo çfarë do të ishte e natyrshme për të dyja gjuhët është një përgjigje e shkurtër.

*Did you get injured?*  
*Yes, I did. (në shqip: Po, u vrava)*

Studentët shqiptarë që studiojnë gjuhën angleze hasin problem me foljen që duhet të përdorin në përgjigjet e shkurtra, pasi në shqipe mund të themi ‘**po**’ ose ‘**jo**’, por mund të përdorim edhe togfjalëshin foljor në fjalitë pyetëse, kurse në anglishte është më e vështirë të kuptojmë se cilën folje duhet të përdorim, pasi këtu përdorim vetëm foljen ndihmëse e jo të tërë togfjalëshin foljor. Në shembullin e mësipërm, në fjalitë pyetëse përdoret folja “**get injured**” (vritem), por në përgjigjen e shkurtër përdoret folja “**did**”. Pra, ndryshimi ndodh te folja që ne përdorim në përgjigjen e shkurtër në shqipe. Nëse në gjuhën angleze përdoret folja ndihmëse “**did**” (e cila nuk ka një përkthim të mirëfilltë në shqipe), në shqipe përdoret folja “**u vrava**”. Nëse në shqipe themi: ‘*Po u vrava*’, në anglishte nuk mund të themi: ‘*Yes I got injured.*’ (*Po, u vrava*).

*A: Do you have a picture of her?*  
*B: No, I don't.*

*A ke një fotografi të saj?*  
*Jo, nuk kam.*

*A: Have you been in New York all the time? Ke qenë në Nju Jork gjithë kohën?*

*B: Yes, I have*  
(“Romancë në trenin Orient Ekspres”)

*Po, atje kam qenë.*

Fjalitë pyetëse përmbajnë foljen “**have**” (kam), por ajo nuk përdoret në të gjitha përgjigjet e shkurtra. Në anglishte kjo ndodh për arsye se p.sh., në dialogun e parë folja “*have*” (*kam*) është folje kryesore, ndërsa në të dytin ashtu si në shqipe ajo shërben si folje ndihmëse, për të formuar një kohë të përbërë, në rastin tonë ‘kohën e kryer’. Ndryshe nga gjuha angleze, në të cilën folja “*have*” është folje kryesore dhe në një fjali pyetëse

përdorim foljen ndihmëse “do”, në gjuhën shqipe nuk përdorim një folje ndihmëse për të formuar fjalinë pyetëse. Në gjuhën shqipe ajo e formon vetë fjalinë pyetëse dhe përgjigjja jepet po me këtë folje.

Në përgjigjet e shkurtra në të dyja gjuhët, përveç foljes ndihmëse në anglishte apo grupit foljor në shqipe mund të përdorim edhe fjalë të tjera, si p.sh., ndajfolje.

A: *Has your honesty ever caused you trouble in this business?*

B: *Yes, **always**.*

A: *A të ka shkaktuar ndonjëherë ndershmëria jote probleme në biznes?*

B: *Po, **gjithmonë**.*

Por në gjuhën shqipe, vlen të përmendet dhe fakti se pyetjes mund t’i përgjigjemi me mohim ose me pohim dhe kjo është asnjëherë. Ndërsa po t’i përgjigjemi me pyetje, e cila e përmban pohimin, kemi një ngarkesë emocionale, që është ngacmuese për tjetrin dhe sjell tendosje në marrëdhënie.<sup>444</sup> P.sh. pyetjes *A shkove?* mund t’i jepet përgjigjja e thjeshtë: *Po/Jo*. Ndërsa është me ngarkesë: *Si nuk shkova?*

## 1.2 Fjalitë pyetëse tërësore me folje gjysmëndihmëse

Fjalitë pyetëse si në anglishte dhe në shqipe, sipas qëndrimit të folësit ndaj realitetit të pasqyruar prej thënies, mund të kenë ngjyrimë modale të ndryshme. Përdorimi i foljeve gjysmëndihmëse në fjalitë pyetëse u jep atyre kuptime të ndryshme. Foljet gjysmëndihmëse të “**lejimit**” *may/can (mund)* dhe ato të “**detyrimit**” *must/have to (duhet)* shprehin autoritetin e folësit në fjalitë dëftore dhe autoritetin e dëgjuesit në fjalinë pyetëse.<sup>445</sup>

A: *Must I / do I have to leave now? (Are you telling me to leave now?)*

B: *Yes you must/have to (I am telling you to leave.)*

A: *Këtej duhet të kthehmi? (Po më thua të kthehem?)*

<sup>444</sup> Lloshi. Xh. “Stilistika dhe pragmatika”, 1999, f. 95.

<sup>445</sup> Quirk, Randolph. Greenbaum, Sidney, Leech, Geoffrey. Starvik, Jan “*A Comprehensive Grammar of the English language*”, 1985, f. 822.

Këto lloj fjalish pyetëse i gjejmë në të dyja gjuhët. Duhet të përmendim këtu se këto lloj fjalish pyetëse nga ana kuptimore kanë më shumë të përbashkëta se nga ana strukturore.

Le të analizojmë strukturën e foljeve gjysmëndihmëse:

në Anglisht: modal auxiliary + base form  
*Ought he to marry her?*                      *May we come in?*  
*Ought to+ marry*                                *May + come*

në shqip: modal auxiliary + a verb in the subjunctive mood  
*A duhet të martohet ai me të?*                *Mund të hyjmë ?*  
*duhet + të martohet*                              *Mund + të hyjmë*

Në këto fjali në gjuhën shqipe, ajo që përshtatet me kryefjalën nuk është folja që tregon mundësi apo domosdoshmëri, por folja në mënyrën lidhore. Ndërsa në anglishte kjo përshtatje nuk jepet me anë të foljes që e ndjek foljen gjysmëndihmëse, pasi ajo është një formë e pashtjelluar. Nëse do të mund të përshtatej me kryefjalën, e vetmja folje do të ishte ajo gjysmëndihmëse. Duke qenë se foljet gjysmëndihmëse janë të çrregullta në këtë gjuhë ato nuk ndryshojnë, kanë një formë të vetme në të gjitha vetat dhe përshtatja nuk mund të pasqyrohet me anë të mbaresave foljore, siç ndodh në gjuhën shqipe.

Ndryshe nga anglishtja, shqipja ka dhe disa folje të tjera gjysmëndihmëse të cilat tregojnë fillimin, vazhdimin ose mbarimin e një veprimi, si: *filloj, zë, nis, vazhdoj, mbaroj*. Këto folje gjithashtu ndiqen nga një folje në mënyrën lidhore. Ndërsa folja gjysmëndihmëse ‘*mbaroj*’ ndiqet nga pjesëza “*së + pjesore e emërzuar*”. Kur kemi të bëjmë me këto folje, me kryefjalën përshtaten si folja në lidhore ashtu dhe folja gjysmëndihmëse. Bën përjashtim vetëm folja gjysmëndihmëse “*mbaroj*”. Në këtë rast përshtatet me kryefjalën vetëm folja gjysmëndihmëse dhe jo ‘*pjesorja e emërzuar*’.

*Filloi të punonte?*

Në anglishte kjo do të shprehej me foljen *begin (filloj) + infinitive (formë e pashtjelluar)*, ku folja ‘*begin*’ ndryshe nga shqipja nuk është folje gjysmëndihmëse

*Mbarove së punuari?*

E shprehur në anglishte me “*finish + gerund*”

*Did you finish working?*

## 2.1 Zhvendosja e foljes gjysmëndihmëse në fjalitë pyetëse tërësore

Në anglishte kjo lloj zhvendosjeje luan një rol të rëndësishëm në sintaksën e fjalive pyetëse tërësore, ndërsa në shqipe nuk ekziston. Kështu pra, ndryshimi sintaksor midis fjalisë dëftore dhe fjalisë pyetëse në shembujt e mëposhtëm:

[1] *[He will tell the truth.]*

[2] *Will [he tell the truth?]*

është se folja gjysmëndihmëse pozicionohet pas kryefjalës ‘he’ tek fjalia dëftore [1], dhe përpara kryefjalës tek fjalia pyetëse [2], në gjuhën shqipe nuk ndodh e njëjta dukuri.

[1] *[Ai do të tregojë të vërtetën.] ose [Do të tregojë të vërtetën]*

[2] *[Do të tregojë të vërtetën?] ose [Do të tregojë të vërtetën ai?]*

Siç mund ta shohim dhe te shembujt e mësipërm, nuk kemi inversion dhe në rastin e fjalisë së dytë pyetëse, kryefjala është vendosur në fund të saj. Fjalinë dëftore në shqipe mund ta shprehim shumë mirë edhe pa kryefjalën “ai”. Në këtë rast, si fjalia dëftore dhe ajo pyetëse, nuk do të kishin kurrfarë ndryshimi strukturor; i vetmi ndryshim do të ishte ai i intonacionit, pasi siç e dimë fjalitë pyetëse karakterizohen nga intonacioni pyetës ose nga vija melodike e pyetjes.<sup>446</sup>

Ajo çfarë vumë re në shembullin [2] në anglishte është inversioni, pra zhvendosjen e foljes gjysmëndihmëse në pozicionin bosh të plotësit. Rrjedhimisht, foljet gjysmëndihmëse zhvendosen nga pozicioni i tyre (që në këtë rast është midis përemrit dhe foljes kryesore) në pozicionin *para kryefjalës*.<sup>447</sup>

Kjo zhvendosje krijon një ‘boshllëk’ në pozicionin fillestar nga i cili është zhvendosur folja gjysmëndihmëse. Nëse do ta jepnim këtë boshllëk me simbolin •, mund të themi se pas inversionit fjalitë e mëposhtme do të kishin përkatësisht këto struktura.

*Ought he • to marry her?*

*Could you • be more specific?*

*Will you please • answer my question?*

<sup>446</sup> Çeliku, Domi, Floqi, Mansaku, Përnaska, Prifti dhe Totoni. “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”, 1996, f. 138.

<sup>447</sup> Redford, A. “Transformational grammar”, 1988, f. 411.

Në gjuhën shqipe mund të përdoret e njëjta strukturë si në anglishte, por kjo vetëm për efekte stilistikore.

*Should I have called the police? Duhej unë ta kisha telefonuar policinë?  
Could you be more specific? A mundesh ti të jesh më specifik?*

Kryefjala (fjalët e nënvizuara) në fjalitë pyetëse në shembujt e mësipërm si në anglishte dhe në shqipe ka të njëjtin pozicion. Në shqipe kjo gjë ndodh jo për shkak të një rregulli strikt, të ngulitur si në anglishte, por për ngjyrimet e ndryshme stilistikore. Në rastin tonë kryefjala është fjala mbi të cilën bie theksi logjik, pasi në një kontekst tjetër, rendi i fjalisë pyetëse mund të ndryshonte, në varësi të qëllimit të folësit dhe kryefjala mund të mos përdoret në këto fjali pyetëse. Nga shembujt e mësipërm do të kishim:

*Duhej ta kisha telefonuar policinë?  
A mund të jesh më e qartë?*

Fjalitë pyetëse tërësore, bazuar në materialiet praktike të shfrytëzuara për këtë studim, kanë një përdorim mjaft të gjerë si në ligjërimin e folur dhe në ligjërimin e shkruar.

Ligjërimi i shkruar			Ligjërimi i folur		
Burimi	Korpusi i fjalëve	Numri i fjalive pyetëse tërësore pohore dhe mohore	Burimi	Korpusi i fjalëve	Numri i fjalive pyetëse tërësore pohore dhe mohore
Romani "Death in Holy Orders"	981045 fjalë	370 fjali	Filmi "West Wing"	9020 fjalë	119 fjali
Romani "Tess of the d'Urberville"	142100 fjalë	151 fjali	Filmi "Romancë në trenin Orient Ekspres"	4730 fjalë	60 fjali
4 revista të stilit shkencor	213920 fjalë	58 fjali	Filmi "Billy Elliot"	6490 fjalë	50 fjali
-	-	-	5 revista "OK"	121500 fjalë	317 fjali
-	-	-	Filmi "East is East"	10285 fjalë	60 fjali
Romani "Engjëj dhe"	1634476 fjalë	757 fjali	Revista "Jeta"	19800	28 fjali

djaj”					
2 revista shkencore në shqip	68088 fjalë	75 fjali	Revista “Shqip”	19760	57 fjali
Romani ‘E penguara’	52824 fjalë	156 fjali			

### KONKLuzion:

Ky punim u bazua në dy çështje kryesore:

- (i) inversioni
- (ii) rendi i lirë i fjalëve

**Së pari**, gjuha angleze karakterizohet nga zhvendosja e foljes ndihmëse në fillim të fjalisë pyetëse, që do të thotë ajo zhvendoset nga pozicioni i saj fillestar pas kryefjalës duke çuar në inversionin kryefjalë-folje ndihmëse. Kjo zhvendosje krijon një boshllëk në pozicionin fillestar të foljes ndihmëse, gjë e cila nuk ndodh në gjuhën shqipe.

Për më tepër në gjuhën shqipe, kryefjala mund të mungojë në fjalinë pyetëse. Ajo nuk jepet me një fjalë apo togfjalësh në fjali, por është e kuptueshme falë sistemit të zhvilluar të mbaresave në gjuhën tonë.

**Së dyti**, rendi i lirë i fjalisë pyetëse në shqipe shfrytëzohet nga folësit e kësaj gjuhe për strukturat e ndryshme funksionale sipas qëllimit të kumtimit në momentin e ligjërimin.

Rendi i fjalëve dhe i gjymtyrëve është një nga mjetet më të rëndësishme të formësimit të fjalisë në gjuhën shqipe. Gjymtyrët mund të vendosen në vende të ndryshme pa e ndryshuar funksionin e tyre sintaksor. Ndërkaq, çdo vendosje konkrete e tyre në një fjali të dhënë kushtëzohet nga rëndësia që ato kanë në atë fjali, nga pesha e tyre kumtuese dhe shprehëse-emosionale. (Lloshi: (1999: 87))

### BIBLIOGRAFI:

1. Asatiani R. (2004): “*The semantics and typology of yes no questions*” (Institute of Oriental Studies).
2. Çeliku M., Domi M., Floqi S., Mansaku S., Përnaska R., Prifti S., Totoni M. (1996): “Gramatika e Gjuhës Shqipe II”.
3. Hardy Th. (2000): “*Tess of d’Urbervilles*”, Wordsworth Classics, (roman).
4. Huddleston, R.D. (1984): *Introduction to the grammar of English*. Cambridge: Cambridge University Press.
5. James P.D. (2001): “*Death in Holy Orders*”, (roman) ‘Faber and Faber’
6. Kadare I. (2009): “*E penguara*”, (roman), Onufri.
7. Lloshi Xh. (1999): “*Stilistika dhe Pragmatika*”, Toena.

8. Quirk R., Greenbaum S. (1973) "A *University Grammar of English*", Longman, (p 166-207).
9. Quirk R., Greenbaum S., Leech G., Starvik J., (1985) "A *Comprehensive Grammar of the English language*", Longman, (p. 806-827).
10. Redford A.(1988) "Transformational grammar", Cambridge University Press, (p 492-507).
11. Roberts N. B., (1997) "Analysing Sentences. An Introduction to English Syntax", Longman, (f. 219-249).
12. Worhtington J. (1998) "Romancë në trenin Orient Ekspres", british version, (film).
13. "OK", magazine, nr. 463, 5 April, 200.
14. "Shqip", revistë, Korrik, 2011.
15. "Jeta", revistë, Korrik, 2011.

### **Interrogative questions in English and Albanian ,Albanian varied forms of expression due to free word order**

#### **SUMMARY**

This paper is concerned with a contrastive analysis of yes/no questions in English and Albanian language which would be helpful to show some of the similarities and differences in the question word structure and syntactic functions found between the two languages. The differences are reflected through inversion, a feature of the English language, and the free word order which is one of the main means of forming sentences in Albanian. An important part of this paper in analyzing the grammatical structure of yes-no question in both languages is to identify the constituent parts from which the sentence is formed and the order in which these constituents occur. In other words, the paper's basic task is to identify the similarities and the differences in the formation of the yes/no questions in both languages.

**Keywords:** word order, inversion, yes-no questions, inflective language, stylistic effects.

Rovena VORA

## DISA VEÇORI TË NJËSIVE FRAZELOGJIKE FOLJORE NË GJUHËN ANGLEZE E SHQIPE

Frazeologjizmat foljorë përbëjnë grupin më të madh të frazeologjizmave si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze. Ato kanë kuptimin e përgjithshëm të kategorisë së foljes dhe funksionojnë në fjali si folje. Natyra leksikore dhe gramatikore ka shumë rëndësi për këtë tip frazeologjizmesh. Së paku një gjymtyrë duhet të jetë folje, e cila përbën vatrën gramatikore, idiomatike dhe ndonjëherë edhe atë leksikore të frazeologjizmit. Në pjesën më të madhe të rasteve vatrën leksikore e përbën gjymtyra e dytë e njësisë frazeologjike. Trajtat që merr gjymtyra e dytë përcaktojnë ndryshimet semantike, karakterin idiomatik, ngjyrimin emocional etj. Gjymtyra foljore krijon një sërë veçorish të tjera leksiko-gramatikore të frazeologjizmit siç janë lidhjet sintaksore brenda dhe jashtë frazeologjizmit, drejtimin gramatikor, gjymtyrët fakultative, ndryshimet semantike etj. Për t'i parë të gjitha këto tipare do të na duhet të ndalemi në tre veçori, që synojmë t'i trajtojmë në mënyrë specifike në këtë studim, të cilat janë: veçoritë morfologjike, veçoritë e funksionet sintaksore si dhe veçoritë semantike të frazeologjizmave foljorë në gjuhën angleze në përjasje me gjuhën shqipe.

### *Veçoritë morfologjike të njësisë frazeologjike foljore*

Jeta frazeologjike e fjalës d.m.th. ekzistenca e gjymtyrës në përbërje të njësisë frazeologjike foljore dallohet nga fjalët që hyjnë në lidhje me këtë njësi frazeologjike.

Një nga veçoritë që dallohet është se numri i formave të elementëve të njësisë frazeologjike është më i vogël se numri i formave që kanë këto fjalë jashtë kufijve të shprehjes frazeologjike. Shprehjet frazeologjike kanë si veti ndryshimin formues të gjymtyrës foljore ose të gjymtyrëve foljore në njësinë frazeologjike me strukturë lidhëzore. Këtë e shohim duke analizuar formën e njësisë frazeologjike “*pull one's leg*” (tallem (me shaka)). Folja e këtij frazeologjizmi përdoret në këto kohë: present continuous (koha e tashme e vazhdueshme), present perfect continuous (e kryera e



vazhdueshme), past continuous (e pakryera), past perfect continuous (më se e kryera e vazhdueshme).

Folja “pull” e pavarur mund të përdoret në të gjitha kohët, por është njësia frazeologjike ku ajo bën pjesë që e kufizon numrin e kohëve. Mënyra urdhërore është shpeshherë e mundur:

“*Don’t pull my leg!* You went to the theatre. (Mos u tall me mua! Ti ke qenë në teatër.)

Në disa njësi frazeologjike në anglishte folja përdoret vetëm në pësore:

- *be gathered to one’s fathers* (vdiq, shkoi me të shumtët)<sup>448</sup>

Në njësi frazeologjike të tjera përdoret vetëm në veprorë:

- *make bricks without straw* (bëj diçka pa mjetet e nevojshme, bëj petulla pa vaj)<sup>449</sup>
- *steal a march on somebody* (fitoj terren, dal para të tjerëve)<sup>450</sup>
- *take the wind out of sb’s sail* (i pres krahët, lë si peshku pa ujë)<sup>451</sup>

Në shprehje të tjera foljore ku ka emra, këtij emri i përshtaten format nominative të njëjësit dhe shumësit:

- *keep one’s head above water* (mbahem, rri mbi ujë)<sup>452</sup>
- *set one’s cap at somebody* (ia vë syrin (për ta marrë për burrë))<sup>453</sup>
- *turn one’s back on somebody* (i kthej krahët dikujt)<sup>454</sup>

They could never *keep their heads above water*. (Ata nuk do të mund të mbaheshin.)

Mrs. Skane said they were all *setting their caps at me*. (Zonja Skane më rrëfeu që ato ma kishin vënë syrin.)

<sup>1</sup> Stefanllari, I. (1998) “Fjalor idiomatik anglisht-shqip”, *Botimet enciklopedike*, f. 131.

<sup>2</sup> Stefanllari, I. (1998) “Fjalor idiomatik anglisht-shqip”, *Botimet enciklopedike*, f. 258.

<sup>3</sup> Po aty, f. 376.

<sup>4</sup> Po aty, f. 398.

<sup>5</sup> Po aty, f. 222.

<sup>6</sup> Po aty, f. 349.

<sup>7</sup> Po aty, f. 420.

*He turned his back on his family when they needed help.* (Ai i ktheu krahët familjes së tij kur ata kishin nevojë.)

Në disa njësi frazeologjike numri shumëës nuk varet nga numri i vetave, por nga numri i kundrinorit ku përqendrohet veprimi.

“*We used to pull his leg about shadowing people and all that.* (Ne e vinim në lojë pas ii vihej njerëzve nga mbrapa hap pas hapi.)

“*They’ve just been pulling our legs very wittily.* (Ata na kanë vënë në lojë me shumë zgjuarsi)

Në shumë njësi frazeologjike forma e shumësit nuk është krejtësisht e përfunduar, ndaj përdoret numri njëjës:

- *be born with a silver spoon in one’s mouth* (është në gjendje shumë të mire, ha me lugë të florinjte)<sup>455</sup>

- “*I forbid to come here all those who are not born with a silver spoon in their mouths.*” (Ua kam ndaluar të vijnë këtu të gjithë atyre të cilët nuk janë në gjendje të mirë ekonomike).

- “*Men born with a silver spoon in their mouth were like him.*” (Të gjithë ata që ishin në gjendje të mirë ishin si ai.)

- *cut off one’s nose to spite one’s face* (në vend që t’i vinte vetulla, i nxori sytë; është fatale)<sup>456</sup>

“Many labour leaders rushed to comply with the obnoxious clause ... even if it meant *cutting off their noses to spite their faces.*” “Shumë drejtues të sindikatave u pajtuan me çështjen shumë të debatueshme ... edhe pse ajo do të ishte fatale për ta).

Shumë prej njësive frazeologjike karakterizohen nga një shkallë e lartë e abstraksionit duke bërë që elementët në një farë mase i humbin vetitë e tyre. P.sh., format e njëjësit dhe shumësit janë fiksuar në çdo kontekst pavarësisht nga numri i vetave:

- *carry (keep) a stiff upper lip* (qëndroj i fortë, tregoj burrëri, nuk e lëshoj veten)<sup>457</sup>

“Your colleagues are good at *keeping a stiff upper lip.* (Kolegët e tu arrijnë të mos e lëshojnë veten.)

<sup>455</sup> Po aty, f. 29.

<sup>456</sup> Po aty, f. 82.

<sup>457</sup> Stefanllari, I. (1998) “Fjalor idiomatik anglisht-shqip”, *Botimet enciklopedike*, f. 218.

- *cook somebody's goose* (i bëj gropën dikujt, e marr dikë në qafë rrënoj dikë në mënyrë të pashpresë)<sup>458</sup>
- “Well ... he said with a chuckle. I think we've *cooked their goose*. (Mirë... tha me nënqeshje. Mendoj se i kemi rrënuar fare).
- *shake a leg* (nxitoj; lëviz shpejt- (zakonisht përdoret si urdhër))<sup>459</sup>
- “She told me to *shake a leg*, so I hurried the best I could.” (Më tha të nxitoja, kështu që nxitova aq sa munda.)

Përdorimi i emrave në njësinë frazeologjike në numrin shumës ose është i pamundur, si në:

- *pay through the noses* (e paguaj shtrenjtë, paguaj si frëngu pulën)<sup>460</sup>
- ose e shndërron shprehjen frazeologjike në një shprehje të ndryshëm, e cila mund të mos ketë karakter frazeologjik:
- *cook somebody's geese* (gatuaj rosa)

Në shprehje të tjera emrat përdoren vetëm në shumës, pasi veprimi nuk realizohet vetëm nga një person.

- *be on pins and needles* (të jesh në ankth)<sup>461</sup>
- *burn one's fingers* (digjem, e pësoj)<sup>462</sup>
- *draw in one's horns* (përmbahem, tërhiqem, ul pendët)<sup>463</sup>
- *rest on one's laurels* (fle mbi dafina, rri kot)<sup>464</sup>

Numri shumës i emrit është element i rëndësishëm, në bazë të të cilit bëhet e mundur lindja e kuptimit të njësisë frazeologjike.

- *win/earn somebody's spurs* (tregoj veten)<sup>465</sup>

He felt that he *had earned his spurs* when he received his Ph.D. (Kuptoi që e kishte treguar veten kur mori gradën “Doktor i Shkencave”).

Fjala “*spurs*” (mamuze) duke u nisur nga vetë origjina e njësisë frazeologjike, nuk mund të përdoret në njëjës, pasi për të ngarë kalin duhen dy mamuze.

<sup>458</sup> Po aty, f. 76.

<sup>459</sup> McGraw – Hill's Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs, (2005): f. 600.

<sup>460</sup> Stefanllari, I. (1998) “Fjalor idiomatik anglisht-shqip”, *Botimet enciklopedike*, f. 299.

<sup>461</sup> McGraw – Hill's Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs, (2005): f. 467.

<sup>462</sup> Stefanllari, I. (1998) “Fjalor idiomatik anglisht-shqip”, *Botimet enciklopedike*, f. 41.

<sup>463</sup> Po aty, f. 97.

<sup>464</sup> Po aty, f. 326.

<sup>465</sup> McGraw – Hill's Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs, (2005): f. 181.

### ***Veçoritë semantike të njësive frazeologjike foljore***

Në bazë të numrit të madh të njësive frazeologjike qëndron kuptimi metaforik që i përgjigjet togfjalëshit të ndryshueshëm. Kuptimi figurativ realizohet në bazë të ngjashmërisë së veprimit.

- *dance on air* (të jesh i lumtur; euforik)<sup>466</sup>
- *go off with one's tail between one's legs* (të ikësh me bisht ndër shalë)<sup>467</sup>

Disa shembuj mbartin karakter të qartë hiperbolik:

- *eat out of somebody's hand* (të bësh siç të thotë tjetri)<sup>468</sup>
- *flog a dead horse* (të këmbëngulësh për të folur për diçka pa interes)<sup>469</sup>
- *jump out of one's skin* (hidhem përpyjetë nga frika, habia etj.)<sup>470</sup>
- *make a mountain out of a mole hill* (ta bësh qimen tra; ta bësh mizën buall)<sup>471</sup>
- *twist somebody round one's little finger* (të manipulosh dhe të kontrollosh dikë)<sup>472</sup>

shembuj të tjerë kanë karakter eufemistik:

- *go the way of horse and buggy* (zhduket; del nga përdorimi)<sup>473</sup>
- *go to one's reward* (vdes)<sup>474</sup>

Shumë togfjalësha hyjnë në togfjalësha terminologjik me kuptim të mirëfilltë.

- *hit below the belt* (përdoret për boksierët – të godasësh kundërshtarin poshtë brezit)<sup>475</sup>

<sup>466</sup> McGraw – Hill's Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs, (2005): f. 141.

<sup>467</sup> Po aty, f. 761.

<sup>468</sup> Po aty, f. 183.

<sup>469</sup> Po aty, f. 220.

<sup>470</sup> Stefanllari, I. (1998) "Fjalor idiomatik anglisht-shqip", *Botimet enciklopedike*, f. 215.

<sup>471</sup> Po aty, f. 256.

<sup>472</sup> Po aty, f. 423.

<sup>473</sup> McGraw – Hill's Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs, (2005): f. 263.

<sup>474</sup> Po aty, f. 264.

<sup>475</sup> Po aty, f. 160.

Kërkimet etimologjike shpesh japin mundësinë e hedhjes dritë mbi prejardhjen e njësisë frazeologjike veçanërisht karakterin e saj metaforik:

- *give somebody the cold shoulder* (sillem ftohtë, i kthej krahet dikujt)<sup>476</sup>

Nuk ka as shprehje të tjera ose të huazuara që t'u përgjigjen këtyre njësive frazeologjike foljore, pasi në themel të tyre nuk qëndron një situatë reale, por e imagjinuar. Karakteri metaforik vendoset duke krahasuar komponentët e njësive frazeologjike foljore.

- *drink like a fish* (pi shumë, pi me opingë)<sup>477</sup>
- *hitch one's wagon to a star* (shprehje e cila përdoret më tepër në mënyrën urdhërore – 'Hitch your wagon to a star!' Aspiro për gjëra të mëdha! Mos jri pesimist!)<sup>478</sup>
- *knock something into a cocked hat* (prish një plan)<sup>479</sup>

Prej këtyre shembujve vihet re se në shumicën e njësive frazeologjike kuptimi figurativ del i qartë. Në të tjera si tek "knock somebody into a cocked hat", kuptimi figurativ errësohet disi.

Shpesh një njësi frazeologjike mbushet me kuptim figurativ, si "give way", shprehje e cila ka afërsisht 16 kuptime në fjalor. Ndërsa në shekullin e 15-të ajo shënonte vetëm "tërheqje". Sot sistemi i kuptimit të "give way" është shumë i ndërlikuar. Si rezultat i zhvillimit të semantikës së njësive frazeologjike, kuptimet e saj largohen në shkallë të ndryshme nga kuptimi fillestar dhe lidhja midis tyre mund të humbë përfundimisht.

Shprehjet metonimike takohen në njësi frazeologjike foljore më shpesh se ato metaforike.

- *make a clean breast of something* (pranoj diçka)<sup>480</sup>
- *get a big hand* (të marrësh duartrokitje ose lëvdata)<sup>481</sup>

### ***Lidhjet sintaksore të njësive frazeologjike foljore***

Siç thamë në hyrje të këtij punimi gjymtyra foljore është vatër gramatikore e idiomatike e njësive frazeologjike. Ajo krijon një sërë veçorish leksiko

<sup>476</sup> Stefanllari, I. (1998) "Fjalor idiomatik anglisht-shqip", *Botimet enciklopedike*, f. 150.

<sup>477</sup> Stefanllari, I. (1998) "Fjalor idiomatik anglisht-shqip", *Botimet enciklopedike*, f. 98.

<sup>478</sup> McGraw – Hill's Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs, (2005): f. 304.

<sup>479</sup> Po aty, f. 379.

<sup>480</sup> Po aty, f. 422.

<sup>481</sup> Po aty, f. 45.

gramatikore të njësisë frazeologjike, siç janë lidhjet sintaksore brenda dhe jashtë togfjalëshit frazeologjik, gjymtyrët fakultative etj.

Në gjuhën angleze ka raste kur njësitë frazeologjike foljore janë të pandashme nga ana sintaksore.

- *kick the bucket* (vdes)<sup>482</sup>

Mirëpo zëvendësimi i gjymtyrëve me elementë të ndryshueshëm si dhe mundësia e transferimit të varësisë janë tregues të ndarjes së njësisë frazeologjike.

Në njësinë frazeologjike “*pull somebody’s leg*” (tallem me dikë) është njësi frazeologjike foljore me lidhje kundrinore, e cila ka kuptim të pamotivueshëm, por kjo nuk e pengon “gjallërinë” e marrëdhënieve sintaksore midis gjymtyrëve.

Le të shohim ndryshimet e kësaj njësie frazeologjike në kontekste të ndryshme:

- a. zëvendësimi i **somebody’s** me përemrin pronor ose me emër në gjinore.

“Oh, you are *pulling my leg*. It’s too beastly of you.”<sup>483</sup> (Oh, po tallesh me mua. Është mizore nga ana jote.)

“There’s a strong possibility that the letter writer was *pulling the editor’s leg*.” (Ka shumë mundësi që shkrimtari të jetë duke vënë në lojë redaktorin.)

- b. Futja e elementëve të pandryshueshëm:

“The mysterious process of nature had been perhaps for some purely biological purposes, *pulling, as people say, his leg*.” (Procesi i mistershëm i natyrës kishte ndodhur për arsye biologjike, duke, siç thotë populli, tërhequr këmbën – (duke u tallur)).

- c. përdorimi i foljes në diatezën pësore:

“You don’t see how *your leg is being pulled*.” (Ju nuk e shihni se si po viheni në lojë).

<sup>482</sup> Stefanllari, I. (1998) “Fjalor idiomatik anglisht-shqip”, *Botimet enciklopedike*, f. 227.

<sup>483</sup> Maugham, W. S. “Stories”, *Wordsworth Editions Limited*, (1972), f. 205.

“Of course it gradually became apparent that *the public’s leg had been pulled.*” (Sigurisht që me kalimin e kohës u bë e ditur që publiku ishte vënë në lojë).

d. inversion dhe ndërfitje e elementëve të tjerë:

“He has got a woman up there: “*Whose leg you think you are pulling?*” (Ai ka një femër aty. Me kë kujton se po tallet?)

Inversioni përdoret gjerësisht në anglishte si mjet theksim. Por ai është i pranishëm dhe në shqipe për të njëjtin qëllim.

- tek perëndon dielli të venë?

### ***Funksioni sintaksor i njësive frazeologjike foljore***

Në lidhje me funksionin sintaksor të njësive frazeologjike brenda një fjalie do të bazohemi në: funksionin sintaksor të krahasimeve foljore.

- **Funksioni sintaksor i krahasimeve foljore**

Në gjuhën shqipe ndeshet si gjymtyrë e parë një folje vetvetore ose pësore, të cilat në disa raste nuk e kanë të shprehur gjuhësisht lidhëzën krahasuese

*u bë erë*

*u bë tapë*

*m’u bë zemra mal*

Xhezarit i pëlqen më fort andej nga Jeni Xhamia, që është xhamia e shqiptarëve. Aty pothuaj tërë lagjja flet shqip. Atij *i bëhet zemra mal* kur dëgjon fëmijët që thërresin e shajnë shqip.<sup>484</sup>

Sërbët, - që *i kishin halë në sy* shqiptarët – e njohën menjëherë Ethem Benë si ‘qeveri’ më vete, e ftuan në Shëndaum, i shtruan drekë e darkë.<sup>485</sup>

Nga ana tjetër, mund të ketë edhe struktura me lidhëzën krahasuese:

*u bë si derr*

*u bë si dyllë*

*të mbesësh si pa gojë*

<sup>484</sup> Kuteli M., (1972), “Tregime të zgjedhura”, Tiranë, Naim Frashëri, f. 214.

<sup>485</sup> Po aty, f. 241.

Ago Zylalit mënt i ra pika. Bëri t’i përgjigjej, po ju muarr goja. Murmuriti: - “Edepsëz njeri. Mua ... ai ... Po ... dhe u nxi ashtu siç ish nxirë, ndofta, sulltan Abdyl Hamiti kur e kishin zbritur nga froni. Ata të tjerët, bashkë me Grendellin e me djalin e Shaqos, kishin *mbetur si pa gojë*.<sup>486</sup>

Funksioni i krahasimeve foljore në fjali përkon në tërësi me funksionet e foljes së kuptimshme. Krahasimet foljore në formën vetore si në fjalinë e thjeshtë edhe në atë të përbërë luajnë rolin e kallëzuesit. Më shpesh përdoren format pavetore të krahasimeve foljore:

- Infinitivi

- 1- në kallëzuesin e përbërë foljor në përbërje të elementit të dytë :

“I don’t know much of money matters, but at any rate we can *spend money like there’s no tomorrow*.” (Nuk marr vesh shumë nga çështjet e biznesit, por si do që të jetë mund të shpenzojmë para pa kursyer.)

- 2- Më rrallë ndeshet në kallëzuesin foljor shprehës në përbërje të gjymtyrës së dytë:

“Dickens used to *fit like a glove* in the days when B.B.C still believed in its civilizing mission”. (Dickens *shkonte për shtat* në kohën kur BBC akoma besonte në misionin e saj civilizues.)

- Përcjellorja

1. në funksionin e përcaktorit

“But now comes a terrible rumour, *spreading like wild fire* through the silk-stocking district of this city”. (Por na ka dalë një thashethem i tmerrshëm tani, që po përhapet shumë shpejt në të gjithë qytetin.)

1. si rrethanor

---

<sup>486</sup> Po aty, f. 306.



“Why should you stay here *working like a galley slave* in the dust and heat?” (“Pse duhet të qëndrosh këtu e të punosh si skllav në pluhur e në vapë?”)

2. si përcjellore:

“The noise of the Combat was terrific – each of the three Combatants *swearing like troopers*”. (Zhurma që vinte nga beteja ishte e tmerrshme – secili nga tre luftëtarët shante e mallkonte.)

- Emër foljor

Krahasimet foljore në formën e emrit foljor (gerund) hasen rrallë:

“Well, I’ve heard of people *getting on like a house on fire*, but it beats me to find you two find so much to talk about”. (Kam dëgjuar për shumë njerëz që shkojnë shumë mirë me njëri –tjetrin, por habitem kur shikoj sa shumë bisedoni ju të dy.)

Zakonisht me këto emra foljorë realizohen funksionet sintaksore të foljeve krahasuese.

Në përfundim të trajtimit të disa prej veçorive të njësive frazeologjike mund të themi se analiza e strukturës së brendshme të frazeologjizmave përbën më tepër vështirësi se sa ai i strukturës së jashtme. Për t’i kuptuar më mirë ndryshimet dhe veçoritë që kanë njësitë frazeologjike foljore nga togfjalëshat e lirë duhet të kemi parasysh zhvillimin historik të këtyre strukturave togfjalëshore jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në atë angleze. Zhvillimi i pavarur i sistemeve gjuhësore të të dyja gjuhëve ka bërë që të ketë pak përkime të veçorive të tyre.

**BIBLIOGRAFI:**

1. **Kuteli M.**, (1972): “*Tregime të zgjedhura*”, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë.
2. **McGraw – Hill’s Dictionary of American Idioms and Phrasal Verbs**, (2005). McGraw –Hill Companies, Inc. U.S.A.
3. **McMordie W. ; Seidl J.** (1978) “*English Idioms and how to use them*”, Oxford University Press.
4. **Thomai J.**,(1981): “*Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*”, Shkenca, Tiranë.
5. **Thomai J.**, (1999): “*Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*”, Shkenca, Tiranë.
6. **Thomai J.**, (1982): “*Togfjalëshi, frazeologjia dhe fjala*”, Studime filologjike, Tiranë.
7. **Thomai J.**, (1976): “*Frazeologjizma foljorë në gjuhën shqipe*”, *Studime filologjike*, Tiranë.
8. **Stefanllari, I.** (1998) “Fjalor idiomatik anglisht-shqip”, *Botimet enciklopedike*, Tiranë.

**English and Albanian Phrasal Verbs Their Characteristics****SUMMARY**

In this paper we have introduced some features of verbal phraseological units in English and Albanian. Morphological, semantic and syntactic features of these units are presented through the analysis of the their components by the use of examples in both languages. The changes and the peculiar features of verbal units are used to distinguish the latter from free collocations. The distinction between the two can be traced through the study of the historical development of English and Albanian language. A few similarities can be detected through the analysis of the components of verbal phraseological units, their changes and syntactic function within a sentence in both languages.

Violeta SHABA

**PËRDORIMI NË MËNYRË KRIJUESE I NJËSIVE  
FRAZELOGJIKE: DIMENSIONI TJETËR****(Rast studimor: Idioma të gjuhës angleze dhe shqipe të ndryshuara  
në tituj të shtypit)**

*“Nëse gjuha natyrale do të ishte krijuar nga një logjicien, idiomat  
nuk do të ekzistonin”*

(Philip Johnson-Laird, 1993)

Ky citim përmbledh me pak fjalë qëndrimin gjerësisht të pranuar në lidhje me shprehjet idiomatike, të cilat “...përbëjnë një sfidë në përpjekjen tonë për të kuptuar gramatikën dhe leksikun, sfidë kjo që nuk është fituar ende plotësisht (Fellbaum e të tjerët 2006:349)”.

Tradicionalisht, idiomat apo njësitë frazeologjike janë përkufizuar si njësi konvencionale shumëfjalëshe që janë të pazbërthueshme nga ana kuptimore dhe të ngurta nga ana strukturore. Në dallim nga togfjalëshat e lirë, ato përshfaqin mangësi në transformime, d.m.th. nuk lejojnë ndryshime leksiko-gramatikore dhe kanë forma paradigmore të kufizuara e çdo zëvendësim i gjymtyrëve përbërëse apo riformësim i strukturës së trajtës përfaqësuese të cilën J. Thomai (1999:22)<sup>487</sup> e quan “etalon” të korpusit frazeologjik, mund të çojë në humbje të kuptimit.

Duke pasur parasysh që ngurosja leksiko-gramatikore është parë gjithnjë si një prej tipareve përcaktuese të njësive frazeologjike, të kërkosh ndryshueshmëri leksikore e sintaksore tek to tingëllon kontradiktë termash. Megjithatë, studimet e bazuara në korpus të njësive frazeologjike tregojnë se ndodh shpesh që njësitë frazeologjike të ndryshohen në një mënyrë apo tjetër në ligjërim për efekte stilistikore duke iu larguar përdorimit të njësive frazeologjike në trajtën e tyre bazë e cila nuk përbën ndonjë risi e duke

---

<sup>487</sup> Thomai, J. *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*, 1999.

përfaquar përdorimin stilistikor kontekstor i cili, sipas Nascicone (2010), është përdorimi në formën që kërkohet për qëllime pragmatike në një tekst me ndryshime të konsiderueshme në trajtë dhe kuptim të diktuar nga mendimi dhe konteksti. Nga ana gjuhësore, në mënyrë krijuese, edhe ato shprehje që janë shumë kompakte trajtohen si të afta për riformësim të elementeve të tyre përbërës, duke futur kështu parimin e ‘*përzgjedhjes së lirë*’<sup>488</sup> tek to. Sa herë që një shprehje ‘e ngurtë’ shfrytëzohet në këtë mënyrë, efekti në tekst është rigjallërues.

Kështu, ndryshime si zëvendësimi, shtimi i elementeve që s’janë gjymtyrë përbërëse të trajtës bazë të njësive frazeologjike, heqja e gjymtyrëve përbërëse, riformulimi, përmbysja e rendit të gjymtyrëve për efekt theksimi dhe ndryshime të tjera të trajtës bazë, të cilat zakonisht janë të papranueshme, bëhen të mundura për të krijuar efekte të pazakonta e të papritura, duke e shkelur kështu kufirin e kufizimeve që i karakterizon njësitë frazeologjike. Megjithatë, duhet theksuar se këto riformësime të cilave u nënshtrohen njësitë frazeologjike mbeten përpunime vetjake, të vlefshme për një kontekst a situatë të caktuar. Në dallim nga variantet frazeologjike ato nuk regjistrohen në fjalorë e mbeten në kuadrin e krijimit të një efekti të caktuar stilistikor, transformime *ad hoc* që marrin kuptim vetëm në një kontekst të dhënë dhe interpretimi i tyre varet plotësisht nga njohja e trajtës përfaqësuese e cila ka pësuar ndryshime.

Këto devijime të qëllimshme nga trajta përfaqësuese kanë qenë në rritje këtë shekull sidomos në gjuhën e gazetave, ku kanë gjetur terren pjellor. Studimet tregojnë se në gazetatat e reklamave në gjuhën angleze denduria e këtyre njësive frazeologjike e kalon gjysmën e të gjitha rasteve të përdorimit të njësive frazeologjike. Kjo tendencë në zhvillimin e tyre semantik vërehet edhe në gjuhën shqipe, edhe pse ka dallime të konsiderueshme sasiore. Rregullat për këto riformësime nuk janë vendosur ende, por mendohet se ato janë kryesisht konceptore dhe semantike nga natyra.

Ky potencial i njësive frazeologjike është më i dukshëm dhe mbizotërues tek njësitë me bazë metaforën sesa tek tipa të tjerë njësish,

<sup>488</sup> Sipas Sinclair (1991) ekzistojnë dy parime që diktojnë zgjedhjet që bën një përdorues gjuhe kur ndërton një tekst: *parimi i zgjedhjes së lirë* (së hapur) dhe *parimi i idiomës*. I pari ka të bëjë me alternativat e shumta që ka folësi për të formuar fjali në bazë të sistemit të rregullave të një gjuhe të dhënë e lidhet me aftësinë krijuese të përdoruesit për të plotësuar vendet bosh në një tekst me një gamë të gjerë fjalësh të mundshme e të pranueshme. Parimi i dytë, ai i idiomës ka të bëjë me faktin që “*përdoruesi i gjuhës ka në dispozicion një numër të madh togfjalëshash të ndërtuar më parë që përbëjnë zgjedhjen e vetme, edhe pse mund të duket që ato janë të analizueshme në segmente të veçantë*”.

meqë metaforat, si imazhe mendore, janë lehtësisht të modifikueshme. Këto modifikime i gjen sidomos në tituj shkrimesh, të cilët ndërtohen qëllimisht me shprehje idiomatike, duke qenë se ato përftojnë një vlerë sinjalizuese dhe tërheqin vëmendjen e lexuesit tek qëllimi i autorit dhe strategjitë retorike të përdorura. Titujt shihen si pjesë përbërëse e kornizës së shkrimit gazetaresk e zakonisht luajnë rol në vendosjen e një marrëdhënieje ndërpersonale mes gazetës dhe lexuesit të saj, në përcaktimin e *'mënyrës si i flet' artikulli audiencës'* (Hartley, 1982:88), si dhe në nxitjen e *'iluzionit të komunikimit gojor'* (Fowler, 1991: 63). Ata janë një burim i rëndësishëm i lojërave me fjalë, edhe pse në disa raste lidhja është sipërfaqësore dhe thjesht leksikore. Duke qenë se njësitë frazeologjike shpesh kanë natyrë klisheje, loja e fjalëve që bazohet tek shprehjet e ngurta idiomatike krijon një efekt të fuqishëm stilistikor, duke krijuar një kontrast me leximin "normal" të njësisë frazeologjike në trajtën e saj të pandryshuar duke sfiduar kështu parashikimet e lexuesit.

Zgjedhjet leksikore që bëhen tek titujt janë të rëndësishme, pasi ato përcaktojnë pritshmërinë e lexuesit me anë të referimit kataforik<sup>489</sup> si dhe i ofrojnë atij pikënisjen në lidhje me tekstin në vijim (Moon, 1998). Lidhja llogjike mes njërive frazeologjike të riformësuar në tituj dhe vetë shkrimit realizohet nëpërmjet përkimeve leksikore, tematike dhe fonologjike. Edhe pse formulimi është i veçantë dhe i ri, në shembuj të tillë kuptimi i njërive frazeologjike dallohet qartë. Qëllimi i njësisë frazeologjike të transformuar është të përcjellë të njëjtin kuptim, por të aktualizuar dhe kohezioni arrihet nga elementët e mbetur jashtë dhe nga lidhjet semantike me të tërë njësinë frazeologjike. Përmes aktualizimit synohet të vendosen lidhje sa më të ngushta mes përmbajtjes së njësisë frazeologjike dhe rrethanave konkrete të ligjëritimit. Kështu rritet konkretësia e njësisë e veprimi a tipari i shprehur lidhet më ngusht me kohën, vendin, vepruesin etj. Ta shohim të ilustruar këtë me një shembull në shqipe:

o ***Kutia e Ruzhdies apo e Pandorës?*** (Gazeta 'Shqip', 4 mars 2010)

Ky është një shembull i një transformimi stilistikor të njësisë frazeologjike *kutia e Pandorës*. Njësia frazeologjike e ndryshuar (e pranëvënë asaj të pandryshuar) aludon për krizën elektorale në Shqipëri. Elementi zëvendësues *Ruzhdie* është emri i një fshati ku përflitet se zgjedhjet janë kompromentuar nga votimi i paligjshëm, por është, gjithashtu, edhe emër njeriu i gjinisë femërore në shqip. Krijohet një

<sup>489</sup> Në gjuhësi, referimi kataforik ka të bëjë me përdorimin e një njësie gjuhësore për t'iu referuar paraprakisht një njësie tjetër gjuhësore që përdoret më vonë në tekst.

pranëvënien e shprehjes *kutia e Pandorës* me nuancat e saj kuptimore dhe kuptimit të drejtpërdrejtë të '*kutia e Ruzhdies*' (kuti votimi), duke shkrirë kuptimet e fjalës *kuti*. Si kuptimi i drejtpërdrejtë i kutisë ashtu edhe ai metaforik aktivizohen duke lejuar një perceptim të dyfishtë e duke e bërë të qartë qëndrimin e autorit të shkrimit në lidhje me këtë çështje.

Ndryshimi i njësive frazeologjike është dukuri e gjuhës në përdorim e kështu natyra e ndryshueshme e tyre mund të vrojtohet vetëm nëpërmjet të dhënave të përdorimit real. Asnjë prej shembujve të analizuar në këtë punim nuk është hipotetik, sepse '*sado i besueshëm të jetë një shembull i sajuar, nuk mund të ofrohet si një shembull original i gjuhës në përdorim*' (Sinclair, 1991:4).

Për qëllime të këtij punimi kemi zgjedhur njësitë frazeologjike që shërbejnë si tituj të shkrimeve të botuara në gazetën e mirënjohur me format reviste *The Economist*, e cila shquhet për lojën e fjalëve dhe përdorimin e metaforave dhe njësive frazeologjike në gjuhën e titujve e në brendinë e shkrimeve, si dhe gazeta e revista të ndryshme shqiptare. Do të shohim se çfarë mekanizmesh ndryshimi përdoren nga gazetarët për të arritur efektin e dëshiruar retorik duke qenë se transformimi stilistikor lidhet ngusht me gazetarinë.

Sado të paparashikueshme, rastësore, të çrregullta e të veçanta të jenë transformimet mund të identifikohet një numër i kufizuar i tipave bazë të transformimit apo teknikave të ndryshimit, të cilat mund të kryqëzohen me njëra-tjetrën. Kemi mundur të identifikojmë mekanizmat e mëposhtëm të ndryshimit, të cilët nuk janë kurrsesi shterues, ashtu siç nuk janë as shembujt:

## ❑ ZËVENDËSIMI LEKSIKOR

Në gjuhën angleze:

- [1] a. A ***Lama in sheep's clothing?*** (*the Economist*, 8 maj 2008)  
 b. A ***pilgrimage to the birthplace of a jackal in monk's clothing*** (*the Econ.*, 26 shkurt 2009)  
 (Forma bazë: *a wolf in sheep's clothing*)
- [2] The Arabs: ***Between fitna, fawda<sup>490</sup> and the deep blue sea*** (*the Econ.*, 10 janar 2008)  
 (Forma bazë: *between the devil and the deep blue sea*)
- [3] ***Whom the cap fits*** (*the Econ.*, 5 mars 2009)  
 (Forma bazë: *If the cap fits (, wear it)*)
- [4] ***Trojan dragons*** (*the Econ.*, 1 nëntor 2007)

<sup>490</sup> Fjalë në arabishte për mosmarrëveshje dhe kaos.

- (Forma bazë: *Trojan horse*)
- [5] **Stones of contention** (*the Econ.*, 26 janar 2006)  
(Forma bazë: *bone of contention*)
- [6] **The Jekyll and Hyde economy** (*the Econ.*, 13 maj 2011)  
(Forma bazë: *a Jekyll and Hyde personality*)
- [7] Japan Airlines' clouded future: **On a wing and a rumour**  
(Forma bazë: *on a wing and a prayer*)
- [8] **The elephant outside the room** (*the Econ.*, 11 nëntor 2010)  
(Forma bazë: *the elephant in the room*)
- [9] a. **China's battered image: Bears in a China shop** (*the Econ.*, 14 janar 2010)  
b. Taiwan-China trade talks: **Chinas in a bull session**. (*the Econ.*, 19 prill 2010)  
(Forma bazë: *(like) a bull in a china shop*)

Në gjuhën shqipe:

- [1] **Fjala e liderit, në vesh të Budës** (*Shekulli*, 27 prill 2009)  
(Forma bazë: *fjala (e dikujt) në vesh të perëndisë*)
- [2] a. Pronat, **një vërë në ... tokë** (*Klan*, Korrik- 2005)  
b. **Vrima poshtë ujit** (*Monitor*, 14 qershor 2010)  
(Forma bazë: *një vërë/vrimë në ujë*)
- [3] **Flluska e lehtësimit të vizave** (*Bota Shqiptare*, 6 mars 2009)  
(Forma bazë: *flluskë sapuni*)
- [4] **Xhelozia e Pandorës** (*Panorama*, 26 janar 2010)  
(Forma bazë: *kutia e Pandorës*)
- [5] **Tetë vjet burg për mustaqet e Stalinit** (*Telegraf*, 11 qershor 2010)  
(Forma bazë: *për mustaqet e Çelos*)
- [6] **Peshku në det, shqetësimet në breg** (*Koha jonë*, 20 dhjetor 1998)  
(Forma bazë: *peshku në det, tigani në zjarr*)
- [7] Kur **humbet tenxherja kapakun** (*Shekulli*, 17 qershor 2011)  
(Forma bazë: *gjeti tenxherja kapakun*)

Shembujt e mësipërm janë raste të riformësimeve stilistikore të njësive frazeologjike nëpërmjet zëvendësimeve leksikore shoqëruar shpesh edhe me ndryshime morfologjike. Në këtë tip ndryshimi, kemi të bëjmë me zëvendësimin e një ose më shumë përbërësve leksikorë të njësisë frazeologjike bazë me elementë të rinj leksikorë (fjalët e nënvizuara në shembujt më lart) që nuk bëjnë pjesë në formën bazë, për të krijuar efekte të veçanta gjuhësore si humor, ironi, lojë fjalësh, ose për ta lidhur njësinë

frazeologjike sa më shumë me situatën. Ndryshime të tilla sjellin ndryshime në kuptimin e njësisë.

Fjalët zëvendësuese shpesh janë të lidhura nga ana kuptimore me përmbajtjen e tekstit, duke kontribuar kështu në koherencën e tij, siç ndodh në shembullin e mëposhtëm (por jo vetëm) - titull shkrimi për Dalai Lama-n:

- A ***Lama in sheep's clothing?*** (*the Economist*, 8 maj 2008)  
(Forma bazë: ***a wolf in sheep's clothing***)

Kjo njësi frazeologjike -titull është një manipulim stilistikor i njësisë frazeologjike ***a wolf in sheep's clothing***. *Lama*<sup>491</sup> që i referohet udhëheqësit shpirtëror *Dalai Lama* në këtë artikull, zëvendëson *wolf*. Efekti i synuar arrihet duke aktivizuar si kuptimin e drejtpërdrejtë ashtu edhe atë të figurshëm. Meqë ekziston lidhja mes njësisë frazeologjike të ndryshuar dhe asaj origjinale është e kuptueshme që metafora bazë përcillet tek versioni i ndryshuar duke bërë të qartë kështu qëndrimin që mbahet ndaj Dalai Lamës

Një arsye tjetër për të zgjedhur një fjalë zëvendësuese të veçantë është ngjashmëria fonetike, si rima apo homofonia. Në njësinë e ndryshuar frazeologjike ***Stones of contention***, *stones* rimon me *bones*. Megjithatë, ngjashmëria fonetike nuk është e shkëputur nga aspekti kuptimor, por shkojnë krah për krah.

#### □ ZGJERIMI (Futja e elementëve të rinj leksikorë)

Në gjuhën angleze:

- [1] [Canada: From local pillars to National Post](#) (*The Econ.*, 29 tetor 1998)  
(Forma bazë: ***from pillar to post***)
- [2] [Needles in giant haystacks](#) (*The Econ.*, 28 janar 1999)  
(Forma bazë: ***a needle in a haystack***)
- [3] ***The cat got your mother tongue*** (*The Econ.*, 12 qershor 2008)  
(Forma bazë: ***Cat got your tongue?***)
- [4] [Alitalia and the taxpayer: On a wing and a taxpayer's prayer](#) (*The Econ.*, 4 shtator 2008)  
(Forma bazë: ***on a wing and a prayer***)
- [5] ***Sino - Trojan horse*** (*The Econ.*, 28 maj 2009)  
(Forma bazë: ***Trojan horse***)

<sup>491</sup> *Lama* është njëkohësisht edhe lloj kafshe.



[6] [The politics of the AV referendum: \*Pandora's ballot box\*](#) (*The Econ.*, 17 shkurt 2011)

(Forma bazë: *Pandora's box*)

[7] The coca leaf: *Storm in an Andean teacup* (*The Econ.*, 20 janar 2011)

(Forma bazë: *a storm in a teacup*)

Në gjuhën shqipe:

[1] *Vetëm pak nga kutia e Pandorës ballkanike* (*Klan*, nr. 201, 22 mars 2001)

[2] *Mullinjtë e shëmtuar të erës* (*Gazeta Shqiptare*, 9 dhjetor 2008 (Bulevardi Vip))

[3] *Qeveria, jo ca zona të nënës dhe ca të njerksës*. (*Shqip*, 14 mars 2006)

Në këtë lloj transformimi, shoqëruar shpesh edhe me ndryshime morfologjike, modifikimi i njësive frazeologjike arrihet me shtimin e fjalëve të reja që s'janë pjesë e formës bazë, zakonisht mbiemra a ndonjë përcaktor tjetër, duke e ndërprerë kështu njësinë, por zakonisht duke e ruajtur aludimin për të tërën origjinale. Kjo lloj ndërprerjeje është mjet stilistikor, i lidhur ndoshta me zhanrin, si edhe mjet për të përshtatur brendinë ideore të njësisë frazeologjike me kontekstin. Elementët e shtuar (përcaktorë, përforcues të kuptimit, fjalë vlerësuese) janë në varësi të kontekstit. Ka kufizime në llojin e modifikimit sintaksor-semantik. Shumica marrin përcaktorë që shprehin pikëpamje. Në këto raste, elementët e ndërfaqur (fjalët me vijëzim të dyfishtë në shembujt e mësipërm) japin një kontribut të rëndësishëm për kuptimin specifik të njësisë frazeologjike duke e kontekstualizuar të tërën. Nëse fjala apo fjalët e shtuara i referohen drejtpërdrejt një a disa prej gjymtyrëve të njësisë frazeologjike, shpesh ajo/ato lidhen me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë gjë që çon në dykuptimësi.

#### ❑ CUNGIMI me bazë ad –hoc

Në gjuhën angleze:

[1] *The wood for the trees* (*the Econ.*, 19 qershor 2008)

(Forma bazë: *can't see the wood for the trees*)

[2] *Dirty linen* (*the Econ.*, 19 mars 2008)

(Forma bazë: *wash one's dirty linen in public*)

[3] *Ill winds* (*the Econ.*, 30 dhjetor 2008)

(Forma bazë: *it's an ill wind (that blows nobody any good)*)

[4] Bad for people, bad for profits: *Out of the frying pan* (*the Econ.*, 12 janar 2006)

(Forma bazë: *out of the frying pan and into the fire*)

Në gjuhën shqipe:

- [1] *Shqipëria, “dhia e zgjebosur” e FMN-së.* (Shekulli, 2 mars 2009)  
(Forma bazë: *dhi e zgjebosur dhe bishtin përpyjetë*)
- [2] a. *Luga bosh* (Shqip, 31 mars 2009)  
b. *Luga Bosh e Lulzim Bashës* (Shekulli, 8 maj 2011)  
(Forma bazë: *ngop me lugë bosh*)
- [3] *Kriza e fasonëve dhe veshi i shurdhët i qeverisë* (Tema, 1prill 2009)  
(Forma bazë: *bie(daullja) në vesh të shurdhët*)
- [4] Partitë, *“sytë katër”* te komisionerët (Shqip, 28 qershor 2009)  
(Forma bazë: *bëj sytë katër*)
- [5] *Kufirin tek thana* vendorëve të cilët abuzojnë me taksat. (Koha Jonë, 29 mars 2009)  
(Forma bazë: *vë kufirin te thana*)

Cungimi me bazë *ad hoc* ka të bëjë me heqjen e një a më shumë elementëve përbërës të njësisë frazeologjike. Forma e shkurtuar mund të shihet si eliptike, duke qenë se në shumë raste aludimi për origjinalin dhe formën e plotë mbetet, por shpesh kuptimi i një idioime të shkurtuar duket më pak specifik apo i detajuar në krahasim me atë të njësisë frazeologjike të plotë. Versionet e plota njihen si forma origjinale apo forma bazë. Ky lloj cungimi bëhet në bazë *ad hoc* e format e cunguara mbeten përdorime individuale të krijuara për t’i shërbyer një qëllimi të caktuar. Shumë prej këtyre formimeve kanë natyrë të përkohshme, por të tjera janë në procesin e cungimit, si *‘red herring’* nga origjinali *‘draw a red herring across the trait’*. Cungimin mund ta shoqërojnë ndryshime morfologjike si në rastin e *ill winds* (nga njëjësi në shumës), *luga bosh*, *veshi i shurdhët*, *dhia e zgjebosur* (nga trajtë e pashquar në trajtë të shquar), etj.

#### □ RASTE TË PËRZIERA RIFORMËSIMI

Riformësimi i njësisë frazeologjike të mëposhtme është realizuar duke kombinuar mekanizmat e përmendur më lart e ndonjë tjetër si topikalizimi, aludimi, përmbysja e rendit të gjymtyrëve etj., shoqëruar edhe me ndryshime morfologjike të cilat, në pjesën dërrmuese, kanë çuar në ndryshime edhe të kategorisë leksiko-gramatikore të njësisë. Në shembullin e fundit të titujve në shqip, për shembull, vëmë re se njësisë frazeologjike *‘me kulaç e me kërbac’* në shembullin [3.c] i janë shtuar elementë të rinj (*vizat*, përcaktori *i BE*) dhe ka pësuar ndryshime morfologjike (nga trajtë e pashquar në të shquar duke hequr parafjalët), të cilat kanë çuar edhe në ndryshimin e vlerës leksiko-gramatikore të njësisë nga njësi ndajfoljore në

njësi emërore. Këto ndryshime i shërbejnë realizimit të lidhjes mes njësisë dhe temës së artikullit.

Në gjuhën angleze:

- [1] a. **Messenger, Shot** (*the Econ.*, 8 prill 2009)  
 b. **The messenger not the message** (*the Econ.*, 18 mars 2010)  
 (Forma bazë: *don't shoot the messenger*)
- [2] a. **Seeing the world for the trees** (*the Econ.*, 16 dhjetor 2010)  
 (Forma bazë: *can't see the wood for the trees*)
- [3] a. The crisis in Syria: **More stick than carrot** (*the Econ.*, 12 maj 2011)  
 (Forma bazë: *carrot and stick*)
- [4] **Rattling Europe's skeletons** (*the Econ.*, 14 mars 2002)  
 (Forma bazë: *a skeleton in the closet*)
- [5] **Needles and haystacks** (*the Econ.*, 30 tetor 2003)  
 (Forma bazë: *needle in a haystack*)
- [6] Charity and truthfulness: **Storms and tea cups** (*the Econ.*, 20 prill 2011)  
 (Forma bazë: *a storm in a teacup*)
- [7] a. **German industry: RAGs or riches?** (*the Econ.*, 19 tetor 2006)  
 b. **Chinese immigration: A ragged tale of riches** (*the Econ.*, 19 qershor 2003)  
 (Forma bazë: *from rags to riches*)
- [8] Browsers track eternally: **The cookie that never crumbles** (*the Econ.*, 17 tetor 2010)  
 (Forma bazë: *That's the way the cookie crumbles*)

Në gjuhën shqipe:

- [1] **Bishti e ka dardhën para** (*Panorama*, 9 dhjetor 2007)
- [2] **Tenxheres kapakun: secilit hakun!** (*Panorama*, 18 qershor 2011)  
 (Forma bazë: *gjeti tenxherja kapakun*)
- [3] a. Bode: **Pas amnistisë, vjen "kërbaçi"** (*Shqip*, 19 mars 2011)  
 b. **Bashkimi European ka humbur kërbaçin** (*Shqip*, 30 tetor 2010)  
 c. **Vizat, kulaçi dhe kërbaçi i BE me Shqipërinë, Bosnjen e Kosovën** (*News Agency*, 20 dhjetor 2009)  
 (Forma bazë: *me kulaç e me kërbaç*)

#### □ Ndryshime Morfologjike

Përveç ndryshimeve që ndikojnë ndjeshëm në kuptimin e njësisë frazeologjike, ka edhe ndryshime që nuk i çenojnë ato, por veprojnë si mjet demetaforizimi duke kthyer format abstrakte të njësisë frazeologjike në konkrete. Ndryshime të tilla (pjesa e nënvizuar në shembujt e mëposhtëm) përfshijnë ndryshimin e nyjeve nga trajta e shquar në të pashquar ose

anasjelltas, përdorimin e shumësit, kur subjekti është shumë, përdorimin e mbiemrit në shkallën sipërore, emërzimin, etj. Kështu, njësia frazeologjike mund të përdoret për të bërë një krahasim më të fuqishëm me personin apo gjënë së cilës i referohet.

Në gjuhën angleze:

- [1] ***Bulls in a China shop***  
(Forma bazë: *(like) a bull in a china shop*) (the *Economist*, 21 gusht 2008)
- [3] Bush's last day: ***the lamest duck*** (in the arena)  
(Forma bazë: *lame duck*) (*Time magazine*, 8 dhjetor 2008)
- [4] ***Needles in a haystack*** (the *Econ.*, 3 korrik 2008)  
***The needle in the haystack*** (the *Econ.*, 12 dhjetor 2002)  
(Forma bazë: *a needle in a haystack*)
- [5] ***The Spanish civil war: Bones of contention*** (the *Econ.*, 25 shtator 2008)  
(Forma bazë: *bone of contention*)
- [6] Education: ***Flies in the ointment*** (the *Econ.*, 21 dhjetor 2000)  
(Forma bazë: *a fly in the ointment*)

Në gjuhën shqipe:

- [1] ***Pushtetarët dhe Flluskat e sapunit*** (*Panorama*, 24 maj 2010)  
(forma bazë: *flluskë sapuni*)
- [2] ***Puthja me Milton*** (revista *Klan*)  
(Forma bazë: *Puthu me Milton!*)

\* \* \*

Imazhi për frazeologjinë si një tërësi njësisish gjuhësore të ngurta e të paaftha për ndryshim ka filluar të davaritet disi. Gazetarët e shfrytëzojnë këtë potencial transformimi që kanë njësitë frazeologjike për t'i përpunuar ato në mënyrë krijuese që t'i përshtasin me situatën, duke shfrytëzuar modelet ekzistuese në gjuhë. Fakti që lexuesi automatikisht e kupton se cila njësi frazeologjike është ndryshuar në tituj tregon se këto shprehje nuk janë blloqe gjuhe të paanalizueshme, edhe pse përbërësve të një njësie frazeologjike u pëlqen 'të mbyllin radhët' dhe të mos përdoren a të ekzistojnë pa njëri-tjetrin. Kështu, është e rëndësishme që përdorimi i njësisive frazeologjike të shihet si proces zhvillimi e jo si material gjuhësor i fosilizuar.

Përdorimi stilistikor kontekstor është një nga ato tipare të përdorimit të njësive frazeologjike që është universale semantike. Përveç parimit të përgjithshëm të transformimit të njësive frazeologjike që duket se është universal, edhe tipat e ndryshëm të transformimit nuk duket se ndryshojnë nga njëra gjuhë tek tjetra, edhe pse mund të ketë ndryshime për sa i përket dendurisë së një tipi. Ndryshime të tilla kanë të bëjnë me veçoritë e gjuhës përkatëse dhe jo vetë sistemit të njësive frazeologjike. Ndër teknikat e ndryshimit përmendim zëvendësimin e përbërësve leksikorë, heqjen e elementëve përbërës të njësisë frazeologjike, shtimin e elementëve të rinj etj. Ndryshimet që pësojnë njësitë frazeologjike pasqyrojnë dallime të rëndësishme sintaksore-semantike, në një kohë që, në shumë raste, kuptimi i së gjithës zor se ndikohet nga këto ndryshime.

Mund të themi që potenciali transformues në anglisht është më i madh se në shqip edhe për vetë natyrën idiomatike të gjuhës angleze. Megjithatë, studime të tjera janë të nevojshme, me qëllim që tabloja e njësive frazeologjike të jetë sa më e qartë, e saktë dhe e plotë.

#### BIBLIOGRAFI:

1. Fellbaum, C. ED. (2000): *Corpus-based studies of German idioms and light verbs*. International Journal of Lexicography, 19(4):349–361
2. Fowler, R. (1991): *Language in the News*. London and New York: Routledge
3. Hartley, J. (1982): *Understanding News*. London and New York: Routledge
4. Johnson-Laird, P. N. (1993): Foreword. To Cacciari, C. & Tabossi, P., Eds. *Idioms, Processing, Structure, and Interpretation*. Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
5. Moon, R. 1998a. *Fixed Expressions and Idioms in English: A Corpus-Based Approach*. Oxford: Clarendon Press
6. Naciscone, A. (2010): *Stylistic Use of Phraseological Units in Discourse*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company: xiii, 292 pp. ISBN 978 90 272 1176 7 (HB); ISBN 978 90 272 8769 4 (EB).
7. Sinclair, J. (1991): *Corpus, concordance, collocation*. Oxford: Oxford University Press. Amsterdam: John Benjamins.

#### Fjalorë

1. *Cambridge International Dictionary of idioms*. 1998. Cambridge: Cambridge University Press.
2. *Collins COBUILD Dictionary of Idioms*. 1995. London: Harper Collins Publishers.
3. Cowei, A. P., Mackin, R., and McCaig, I. R. 1983. *Oxford Dictionary of Current Idiomatic English*, 1; *Oxford Dictionary of Current Idiomatic English*, 2 (new editions 1993), Oxford: Oxford University Press.
4. Stefanllari, I. 1998. *Fjalor Idiomatik Anglisht Shqip*. Botimet enciklopedike.
5. Thomai, J. 1999. *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*. Shtëpia botuese 'Shkenca'.

Gazeta e revista (~150 numra)

---

*The Economist, Time magazine, Panorama, Shekulli, Shqip, Gazeta Shqiptare, Telegraf, Tema, Koha Jonë, revista Klan, Monitor*

**The creative use of phraseological units: the other dimension  
(Case study: English and Albanian idioms modified for  
use in headlines)**

***SUMMARY***

This paper addresses the question of creative modifications to phraseological units to create specific stylistic effects. To account for this language phenomenon two uses of phraseological units are contrasted: the core use and the instantial stylistic use ('marked' use). The base form of the phraseological unit is altered in a given context in a way that never occurs in its core use. The paper explores the main mechanisms of alteration which come into play when phraseological units are used creatively. Such modifications are prevalent in the media and this paper briefly discusses this creative use of phraseological units in a corpus of newspaper and magazine headlines in English and Albanian.

**Key words:** phraseological unit, variation, creative modifications, stylistic effect, lexical replacement, clipping, expansion, alterations

Simon LUFU

## HISTORIA DHE MANIPULIMI I SAJ

Krahas dokumenteve zyrtare, në drejtim të analizës historike kontribuojnë edhe ditarët, kujtimet dhe autobiografitë. Studiuesi nuk duhet të heqë dorë kurrë nga skrupuloziteti shkencor dhe nga vëmendja e tejskajshme ndaj rrezikut të falsifikimeve historike.

Ky punim synon të vërë në dukje rëndësinë e dokumenteve të falsifikuara në fushën e kërkimit historik. Ky lloj dokumentacioni mund të bëjë që historianë të pavëmendshëm të bien në gabime që mund të hedhin poshtë punën e tyre dhe mbi të gjitha teoritë që ata duan të pasqyrojnë me kërkimin e tyre.

Në historiografinë e Rilindjes, në kuadrin e shkollës erudite, historianët gjatë kërkimeve të tyre filluan të bazohen mbi dokumentet e arkivave publike. Në vazhden e kësaj përçapjeje të re midis studiuesve të historisë filloi të përvijohet një qëndrim me besim të pakufizuar në lidhje me vlefshmërinë dhe vërtetësinë e dokumenteve të ekzaminuar. Një qëndrim i tillë ka vazhduar për një kohë të gjatë, të paktën deri në shekullin XIX duke çuar, siç thekson Federico Chabod<sup>492</sup>, në një mbivlerësim të burimeve dokumentare. Emblematik është rasti i Rankes, i cilësuar nga Lord Acton si “*inisiatori i vërtetë i studimit heroik të dokumenteve*”. Në fazën e dytë të karrierës së tij, ky historian i madh gjerman i bazoi kërkimet e tij mbi dokumentet arkivorë duke hequr dorë pothuajse krejtësisht nga burimet narrative. Kjo lloj përçapje historike harron ose lë mënjanë rëndësinë e ditarëve, kujtimeve dhe autobiografive, që janë të dobishme në mënyrë të veçantë për studimin e historisë bashkëkohore. Kujtimet dhe ditarët pasqyrojnë sigurisht një pikëpamje subjektive, atë të autorit, por për këtë nuk duhen të konsiderohen të padobishëm nga pikëpamja historike, përderisa janë dokumente që përfaqësojnë kulturën dhe shoqërinë në momentin e hartimit të tyre. Duke cituar sërish Chabod, është ankthi i të vërtetës objektive që çon në këtë gabim metodologjik, duke mos marrë në konsideratë faktin që edhe burimet dokumentare mund të shprehin një element jo objektiv.

---

<sup>492</sup> B. Vigezzi, *Federico Chabod e la nuova storiografia dal primo al secondo dopoguerra, 1919-1950*, Milano, Jaca Book, 1984.

Kur ndërmerret një kërkim historik, në përdorimin e burimeve dokumentare është i detyrueshëm një vërtetim paraprak i vërtetësisë së burimeve, që duhet të shoqërohet me eliminimin e dokumenteve të falsifikuara.

Falsifikimi i burimeve dokumentare është një fenomen shumë i përhapur, në mënyrë të veçantë në periudhën mesjetare. Të sjellim ndër mend *Donatio Constantini*<sup>493</sup>, dokumenti i famshëm që synonte të demonstronte pushtetin laik të Papës dhe Kishës mbi territoret e Perandorisë Romake të Perëndimit, bazuar mbi një dhurim që supozohej se perandori Kostandini i Madh i kishte bërë Papës; ky dokument është deklaruar i falsifikuar nga Lorenzo Valla. Po kështu *Dekretalet e Pseudo-Isidorit* janë letra false që i atribuohen papëve në shekujt e parë nga Klementi I tek Grigori I, të përfshira në shekullin IX në një koleksion kanonesh, nga një farë Isidoro Mercator, me synimin për të privilegjuar pushtetin papal. Ose *Privilegium maius* i dukëve të Austrisë (Shtëpia e Habsburgëve), duke i ngritur në një rang më të lartë se princat elektorë, me titullin Arqiduka Palatin; bëhet fjalë për një dokument që nxjerr në pah se si Habsburgët po fitonin një pozicion mbizotërues në panoramën e perandorisë gjermane. Mund të vazhdohet kështu me falsifikimet e Richenau ose falsifikimet e Pjetrit nga Montekasino.

Një tjetër dokument që ka ngjallur jo pak polemika, ku është i përfshirë drejtpërdrejt Volteri, është *Testament Politique* i Kardinalit Richelieu. Dokumenti, në fakt, pas një analize të vëmendshme, u konsiderua si autentik, por jo i shkruar nga Kardinali, por përkundrazi nga bashkëpunëtorët dhe sekretarët e tij pas vdekjes, siç thekson zvicerani R. Pitton.

Motivet që çojnë në falsifikimin e një dokumenti janë të ndryshme. Së pari mund të theksohet se falsifikimet kanë qëllime politike, që shërbejnë për të mbështetur një tezë të caktuar, ose për të lartësuar një personazh ose lëvizje të caktuar. Këto lloj falsifikimesh janë të shpeshta gjatë luftërave, kur palët ndërluftuese përhapin lajme të shpikura me qëllimin për të ulur moralin e kundërshtarit dhe për të motivuar trupat e veta. Për rrjedhojë, historianët duhet ta shohin me vëmendje të madhe publicistikën e luftës.

Falsifikimet për qëllime politike nuk janë avantazh vetëm i periudhave të luftërave. Shumë të famshëm janë shembujt e procesit Agram

<sup>493</sup> M.Regoliosi, Vian, G.Maria Valla e la donazione Costantini tra storia e apologia, "Cristianesimo nella storia" 2007 f. 679. Shih edhe G.M.Vian, *La donazione di Costantini Bologna* 2004 dhe D.Maffei, *La donazione di Costantini nei jurisi medievali* Milano, 1964.



dhe të procesit Friedjung, ku provohet publikisht falsiteti i disa dokumenteve të paraqitura nga Ministria e Jashtme austro-hungareze për të dëshmuar veprimtarinë antihabsburge të grupeve nacionaliste serbe. Një tjetër shembull emblematik, që përfshihet në këtë kategori falsifikimesh, është testamenti politik i Pjetrit të Madh që provon projektet e dominimit planetar nga ana e Ruisë duke i dhënë Anglisë një pretekst për reagim luftarak, por që në fakt ishte redaktuar nga polaku Sokolnicki.

Një qëllim tjetër që çon në falsifikimin e dokumenteve është kur i vihet autorësia e një emri të shquar disa shkrimeve heterodokse për të favorizuar famën e tyre ose për t'iu shmangur prejardhjes së tyre. Ky lloj falsifikimi është tipik për prodhimin letrar të shekujve XVII-XVIII: p.sh., është provuar që shkrimet e Boulainvilliers janë apokrifë.

Një motiv tjetër për falsifikimin, këtë herë tipik për periudhën mesjetare, është ekzaltimi i atdheut. Rivalitetet midis qyteteve, në mënyrë të veçantë në periudhën e komunave, ishin aq të theksuara sa që shtynë disa qytetarë në falsifikimin e dokumenteve për të rritur prestigjin e qytetit të vet.

Më tej falsifikimet mund të jenë bërë nga disa familje, me origjinë fisnike për nevoja heraldike. Në këto raste është e lehtë të krijohen dokumente false që fisnikërojnë mbiemrin dhe ndodhin kryesisht në momentet kur familja gjendet në dekadencë.

Në të vërtetë historianët që nga zanafilla e tyre, që nga shprehjet e para të artit të tyre në gjenealogjitë e monarkëve ose në tregimet për luftërat e qyteteve greke, kanë qenë gjithnjë të rëndësishëm si pasqyrë e politikës në funksion të legjitimitit të pushtetit. Përdorimi politik i Historisë besoj se është një problem i vjetër po aq sa dhe shoqëria njerëzore. Në lidhje me këtë pikë dua t'i referohem një kujtimi personal. Hera e parë që kam konstatuar mbi përdorimin politik të historisë në antikitet ka qenë pikërisht referimi ndaj botës antike, kur para shumë viteve në Bibliotekën e Departamentit të Historisë pranë Universitetit të Padovës po konsultohesha me një libër të Santo Mazzarino-s, *Il pensiero storico classico*<sup>494</sup>. Duke lexuar faqet e këtij libri mbeta i befasuar kur mësova se disa familje të mëdha romake – *gens Iulia* ose *gens Flavia*, për shembull – nxisnin përpunimin e historive që buronin nga heronj mitikë eponimë. Këto ishin tregime të përpunuara për arsye të qarta politike, pra për t'i dhënë prejardhje fisnike dhe për të fuqizuar familjet që përfshiheshin brenda shoqërisë romake.

---

<sup>494</sup> S. Mazzarino, *Il pensiero storico classico*, (3 vol., 1965-1966) Laterza.

Presioni mbi përdorimin politik të historisë është bërë dominues paralelisht me rritjen e Shteteve kombëtare moderne në dy shekujt e fundit. Me ardhjen e regjimeve totalitare dhe shtypjes ideologjike, me zhvillimin e artit të propagandës dhe të censurës, sistemi ka degjeneruar në mënyrë tragjike: përdorimi politik i historisë ka qenë i qartë dhe i përdorur mbi të gjitha, në funksion të fuqizimit kombëtar, për konsolidimin e konceptimeve të epërsisë së qytetërimeve, racave, klasave, dhe misionit historik. Do të qe absurde të mendohej se përdorimi politik i historisë është një fenomen i ri. Vetë karakteri civil që ka shkenca e historisë, çon në përkufizime të aktiviteteve politike: qoftë kur studion ngjarje individuale ose lokale, qoftë kur studion grupe, institucione ose kombe, qoftë kur studion formimin e shteteve dhe zhvillimin e kulturave, nuk duket i ndarë nga aspekti civil i përcaktimit të identitetit. Kështu historiografia ka prodhuar gjithmonë vizione të caktuara për botën, një element politik, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme ishte i paevitueshëm.

Historia i është nënshtruar gjithnjë logjikës politike të pushtetit, por duke dhënë edhe një valencë pozitive në sensin e angazhimit civil të historianit për formimin e vetëdijes publike.

Padyshim që historianët gjithnjë kanë zhvilluar krahas detyrës disiplinare, një detyrë civile në kontakt me pushtetin politik dhe për shumë shekuj kanë ushtruar funksionin e organizimit të konsensusit me pushtetin. Vetë programet shkollore kanë parashtruar mësimin e historisë në funksion të konfigurimit të identitetit kombëtar që dëshironin autoritetet.

Nacionalizmi mbështetej mbi një memorie të manipuluar. Për shembull në Francë, në periudhën e Republikës së Tretë, në fundin e shekullit XIX, mësimi i historisë ka qenë një instrument themelor për të futur në mendjen e të rinjëve, duke filluar që nga shkolla fillore, të ndjenjës kombëtare, ose më mirë të idesë se i përkisnin një komuniteti, dhe idesë së detyrave që kishin përballë tij. Në mënyrë të veçantë kjo kishte të bënte me detyrën, që nën shembullin e vëllezërve më të mëdhenj, të niseshin për pushtimin e Alzasës dhe Lorenës. Ose e kundërta, për të qëndruar në shembullin e Francës, historia ndonjëherë është shfaqur edhe subversive. Kështu regjimi totalitar francez i Vichy-së ka bërë gjithçka për reduktimin e mësimin të historisë. Në atë periudhë nuk mësohej më historia e së kaluarës së afërt. Autorizohej mësimi vetëm për periudhat më antike, në mënyrë që të mos përftoheshin elementë reflektimi mbi aktivitetin aktual të pushtetit.<sup>495</sup>

---

<sup>495</sup> G. Duby, Pjesë nga intervista "Origjina dhe metodologjia e historisë së përditshme" Paris, 15 mars 1996.

Një tip tjetër falsifikimi lidhet padyshim me maninë për t'u dukur, ku persona pak të njohur përvetësojnë meritën e zbulimit të dokumenteve të pabotuar si *Correspondance inédite de Marie Antoinette*, botuar nga P. Vogt<sup>496</sup> në shekullin XIX. Një falsifikator i famshëm në shekullin XVII ishte Gregorio Leti që shpiku një numër të papërcaktuar letrash, sikur njerëz të shquar ia kishin shkruar atij, me qëllimin e ekzaltimit të figurës së vet.

Motivi i fundit për falsifikimin e një dokumenti është ai për qëllime përfitim. Mund të vërtetohet që janë falsifikuar autografet e personazheve të shquar, me qëllimin për t'ia shitur koleksionistëve të pasur, siç ndodh shpesh edhe sot me veprat e artit.

Falsifikimet mund të jenë “moderne” (kur i referohen momenteve historike të shkuara në raport me autorin) ose “bashkëkohëse” (kur lidhen me periudhën historike në të cilën operon falsifikuesi). Të parat janë të frymëzuara nga dëshira për përfitim ose për vetëcelebrim, të dytat shpeshherë janë të frymëzuara nga çështje juridiko-politike, pra praktike. Ndryshimi themelor mes dy tipave të falsifikimeve qëndron në faktin që falsifikimet moderne, me t'u identifikuar, duhen mënjanuar ndërsa falsifikimet bashkëkohëse kanë akoma vlerë dokumentare sepse mund të vazhdojnë të evidentojnë të dhëna të dobishme për punën e historianit. Si shembull të falsifikimit të parë mund të citohet rasti Harta e Vinlandit, që u gjykua false, pasi një bamirës i pasur i Universitetit të Yale-s e kishte blerë me një çmim shumë të lartë. Shembull tipik për rastin e dytë janë falsifikimet e Richenau, që sidoqoftë na japin elementë të rëndësishëm për të kuptuar shoqërinë e Gjermanisë jugore në një periudhë të caktuar historike.

Përsa i përket burimeve narrative ose kujtimeve, shpeshherë, në mënyrë të veçantë në epokën moderne, ndeshen burime të falsifikuara vetëm pjesërisht, si në rastin Monarkia e Spanjës e Campanella-s, shkrim që është integruar, nga persona të panjohur, me pjesë të disa librave të Boteros. Përveç kësaj, ka raste kur vetë autori i veprës bën një falsifikim, duke mos cituar as librin dhe as autorin prej ku janë marrë pjesët, duke falsifikuar autorësinë e punës së vet dhe duke kryer një plagjiaturë të vërtetë.

Për të përcaktuar autenticitetin e një dokumenti duhen bërë dy prova. E para është prova sipërfaqësore, që synon të përcaktojë nëse dokumenti korrespondon në formë me dokumentet e së njëjtës kohë. Të rëndësishëm për këtë lloj prove janë: verifikimi i materialit mbi të cilin

---

<sup>496</sup> P.Vogt, *Correspondance inedite de Marie Antoinette*, Dentu, 1864.

është hartuar dokumenti (duke kontrolluar nëse korrespondon me materialet në përdorim në dokumentet e së njëjtës periudhë); shkrimi (përmes një ballafaqimi të shkrimit të përdorur); shprehjet letrare (p.sh., mënyra e shkrimit të datës); stili (zgjedhja e fjalëve dhe konstruktet sintaksore). Prova e dytë, që është ajo thelbësore, konsiston në analizën e përmbajtjes së dokumentit, me qëllimin për të përcaktuar që nuk është në kundërshtim me dokumentet e së njëjtës periudhë, ose të mëparshmes. Me të kryer provën sipërfaqësore do të ishte e nevojshme, edhe nëse rezultati do të ishte pozitiv, të vazhdohej me provën e dytë thelbësore.

Rastet e pasqyruara më sipër ndihmojnë për të vënë në dukje se si falsifikimi dhe manipulimi i realitetit kanë qenë gjithnjë të pranishëm në panoramën e qytetërimeve dhe që prej tyre mund të përftoheshin faqe themelore të historisë. Detyra e historianit është ratifikimi i këtyre manipulimeve. Nëse historiografia ka një rol, në mbrojtjen e paqes dhe të demokracisë, duhet reflektuar mbi këto deformime, duhen kontrolluar tekstet shkollore në mënyrë që t'i përgjigjen realitetit.

#### BIBLIOGRAFI:

1. A.A.May, *La monarchia asburgica*, Il Mulino, Bologna, 1973.
2. B.Vigezzi, *Federico Chabod e la nuova storiografia dal primo al secondo dopoguerra, 1919-1950*, Milano, Jaca Book, 1984.
3. G.M.Vian, *La donazione di Costantini*, Bologna, 2004.
4. D.Maffei, *La donazione di Costantini nei juristi medievali*, Milano, 1964.
5. A.Valastro Canale, *Isidoro di Siviglia. Etimologie o Origini*, Torino, 2004.
6. P.Meyvaert, *The Autographs of Peter the Deacon*, "Bulletin of the Joh Rylands Library" 38 (1955).
8. S.Mazzarino, *Il pensiero storico classico*, (3 vol., 1965-1966) Laterza.
9. J.Tosh, *Introduzione alla ricerca storica* - La nuova Italia, Firenze, 1989.
- 10.F.Chabod, *Lezioni di metodo storico*, Laterza, Roma-Bari, 2004.

### History and its manipulation

#### SUMMARY

The public use of historical knowledge is one of the most frequent. Since school has institutionalized the story was a case of public use of history. The public use has this characteristic that historical knowledge is curved for purposes other than those of knowledge: political, ideological, ethical, civic... In this mode of use inevitably follows the degradation of

knowledge. The study of history may reinforce the tendency to this mode of use, or can be directed at countering such use and its effects.

Nertila HAXHIA (LJARJA)

## KRYENGRITJA E MALËSISË SË MADHE E VITIT 1911

*(Mbështetur në dokumentacionin arkivor britanik  
të zv.Konsullit Britanik në Shkodër)*

Kryengritja e vitit 1911 e malësorëve të Mbishkodrës përbën një nga aktet më kulmore për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare gjatë të gjithë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Në programin e kësaj lëvizjeje objektiv kryesor ishte lufta kundër pushtuesit osman për liri dhe autonomi, “*për të ngritur në të gjithë vendin, bajrakun kuq e zi të Skënderbeut*”<sup>497</sup>.

Në këtë punim ngjarja do të trajtohet duke u mbështetur në dokumentet arkivore, të cilat janë raporte që mbajnë të gjitha firmën e Zv.Konsullit Britanik në Shkodër, shqiptarit Nikolla Summa (bir i familjes së mirënjohur katolike Summa të Bonatëve, kishin shërbyer në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX si konsuj dhe zv. konsuj britanikë në Shkodër dhe shtëpinë e kishin shndëruar edhe në konsullatë). Problemet e kësaj periudhe transmetohen prej tij, hap pas hapi, duke lënë të kuptohet fare qartë rëndësia që kishte trajtimi i çështjes shqiptare në kancelaritë evropiane, dhe në rastin tonë asaj britanike, vëmendja që iu kushtua këtyre ngjarjeve nga kjo qeveri. Për përgatitjen e kësaj kumtese janë përdorur rreth 150 faqe dokumentacion arkivor i panjohur dhe i pakumtuar më parë në lidhje me këtë çështje.

Nga ana tjetër dëshmia e tij është shumë e rëndësishme mbasi është marrë fare pranë burimit dhe kësisoj paraqet nivel të lartë besueshmërie faktike.

Dokumentacioni i përket dosjes voluminoze personale të Nikolla Sumës në *National Archives* në Londër, dosje që përbëhet nga të gjitha origjinalet (kopje) që letërshkruesi ka ruajtur në arkivën e tij personale në

---

<sup>497</sup> Terenc Toçi, Thirrje e Qeverisë së Përkohshme Shqiptare drejtuar shqiptarëve. PRO. FO. 371.1228, 9 janar 1911.

Shkodër dhe që më pas, nuk dihet në çfarë rrethanash, është transferuar në *Foreign Office*, e më pas në *National Archives*. Në të janë përfshirë të gjitha letrat e fundvitit 1910 e vitit 1911, që janë të gjitha në gjuhën frënge, shkruar me dorë, dhe të cilat janë transkriptuar me shumë kujdes dhe përkthyer në gjuhën shqipe.

Në punimin tërësor që është përgatitur nga ana ime, ngjarjet e kryengritjes së vitit 1911, janë rindërtuar vetëm në bazë të informacioneve që ofron ai. Ndërsa në këtë artikull do të mbështetemi jo aq në ecurinë e ngjarjes se sa në disa momente që na janë dukur më domethënëse dhe ku bie në sy më tepër kontributi i Sumës, si përfaqësues i një prej Fuqive më të interesuara për ngjarjet në Shqipëri gjatë kësaj periudhe.

Gjendja në kufijtë veriorë të Shqipërisë paraqitej mjaft e vështirë në fund të vitit 1910 dhe në fillim të vitit 1911, sidomos pas ekspeditës së dhunshme të Turgut Pashës (1910), dhe valës tjetër të shkurtit 1911 kur turqit filluan përsëri të mbledhin rekrutë<sup>498</sup>. Mjaft malësorë për t'i shpëtuar presionit të ushtruar mbi ata, emigruan masivisht drejt Malit të Zi<sup>499</sup>.

Për këtë problem zv.Konsulli Britanik njofton vazhdimisht eprorin e tij Z.Lamb, Konsull i Përgjithshëm i Mbretërisë së Bashkuar, në Selanik, nga i cili ai varej administrativisht në hierarkinë e rrjetit të shërbimeve

---

<sup>498</sup> Pjesa më e madhe u vendos në Podgoricë dhe rrethina (pranë kufirit shqiptar), ku në fillim të marsit mendohet se ka pasur rreth 1000 burra të armatosur nga vilajeti i Shkodrës dhe kosovarë, ndërsa nga muaji maj numri mendohet të ketë arritur shifrën 5000. Këto refugjatë u ndihmuan nga qeveria malazeze me para, ushqime, më vonë edhe me armë dhe municion.

Nën drejtimin e Isa Boletinit. Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare* (1878-1912), Dituria, Tiranë, 2006, f. 214

<sup>499</sup> “Të gjithë burrat e moshës 20-26 vjeç, të detyruar për shërbim ushtarak, të cilin, popullsia në përgjithësi e sidomos elementi katolik mbajnë hapur qëndrim armiqësor, emigrojnë ose përgatiten për të.

Ka gjithashtu të larguar edhe nga elementi mysliman shkodran, por ky numër deri tani nuk është shumë i rëndësishëm. Ky qëndrim joaktiv dhe pritës i myslimaneve tanë, sipas mendimit tim, varet nga qëndrimi që qeveria otomane do të mbajë ndaj refugjatëve tanë në Mal të Zi, numri i të cilëve tashmë ka arritur në rreth 1300 vetë. Shqiptarët e emigruar në vilajetin e Kosovës janë akoma më shumë.

Kufijtë janë të hapur për të gjithë refugjatët pa dallim besimi. Ata gjetën në Mal të Zi një pritje të përzemërt dhe ato më në nevojë morën edhe ndihmë në para kur qeveria malazeze nuk ndjehet e detyruar të mohojë se financat e saj nuk janë shumë të forta.

Regjistrimet publike do të hapen në qytetet malazeze në favor të emigrantëve të varfër shqiptarë dhe Valiu i Shkodrës, nga e keqja, vendosi të armatosë banorët myslimanë të Tuzit dhe të fshatrave përreth dhe 900 pushkë, me municion, janë dërguar tashmë për t'u shpërndarë mes popullsisë myslimane të këtyre lokaliteteve me qëllim sigurimin e qetësisë në kufi, e rrezikuar nga eksodi i malësorëve si rrjedhojë e pamjaftueshmërisë së garnizonit tonë.” PRO. FO. 371.1228, 31 tetor 1910.

konsullore britanike në ish Perandorinë Osmane. Informacioni i dërguar nga ana e tij është mjaft i shpeshtë për periudhën tetor 1910-shtator 1911, madje në muajt kur kryengritja ishte në kulmin e saj ai informoi edhe 3 herë në muaj për situatën duke dhënë në shumë raste dhe mendimin e tij personal për ecurinë e tyre.

*Situata në Malësinë e Mbishkodrës në fund të vitit 1910 dhe fillimin e vitit 1911. Fillimi i kryengritjes.*

Dokumenti i parë, nga ku e kemi filluar rrëfimin tonë, daton më 31 tetor 1910. Suma shpreson që Qeveria ta kuptojë situatën dhe të marrë masat e nevojshme për një marrëveshje mes emigrantëve dhe qeverisë otomane që të vendoset qetësia. Dokumentacioni jep një pasqyrë të situatës permanente të trazuar në Malësi që nga vitit 1910, kur ekspedita e parë e Turgut Pashës kishte shkaktuar dramë të rëndë në të gjithë Shqipërinë e Veriut, nga Kosova në Malësi.

Sipas Sumës, emigrimi i malësorëve shqiptarë në Mal të Zi nuk ishte si pasojë e tërheqjes nga paraaja e huaj, as nga priftërinjtë katolikë, dhe as nga propaganda sllave, por ishte pasojë e drejtëpërdrejtë e politikës së padrejtë të xhonturqve ndaj Shqipërisë.<sup>500</sup>

Në rrethanat e situatës së tendosur në kufirin mes Vilajetit të Shkodrës dhe Malit të Zi, Valiu i Shkodrës, Bedri Pasha takohet në nëntor 1910 me Mbretin Nikolla të Malit të Zi. Në këtë takim u bisedua në lidhje me një amnisti ndaj malësorëve refugjatë atje dhe vetë ky i fundit i kishte këshilluar ata që të ktheheshin në shtëpitë e tyre<sup>501</sup>.

Valiu në këtë takim premtoi se e vetmja mënyrë për të qetësuar situatën do të ishin masat shtrënguese, por të njëjtën ditë ai kërkoi ndihmën e arqipeshkvit katolik të Shkodrës për këtë arsye. Ndërsa sipas mendimit të Sumës ndërhyrja e klerit katolik për të vendosur qetësinë, kishte të bënte me politikën austriake në Shqipëri. Austria nuk e shihte me sy të mirë emigracionin e shqiptarëve drejt Malit të Zi, sepse nuk dëshironte që shqiptarët katolikë të vendoseshin nën ndikimin malazez dhe nga ana tjetër kjo perandori, në këtë kohë nuk dëshironte një prishje të status-quo-së në krahinë dhe në Perandorinë Osmane në përgjithësi, nga prishja e së cilës mund të përfitonin në këtë rast shtetet sllave ballkanike që ishin

<sup>500</sup> PRO. FO. 371.1228, 31 tetor 1910.

<sup>501</sup> Më 17 nëntor 1910 Mbreti Nikolla i kërkoi kthimin në shtëpitë e veta malësorëve, në një takim që ai pati me 14 krerë malësorë shqiptarë. Por ato nuk pranuan të ktheheshin dhe parashtruan kushtet e tyre. Për më tepër: Romeo Gurakuqi, *Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës* 1991. Phoenix Shkodra, Shkodër, 2002, f. 29.



momentalisht nën ndikimin e rreptë të Rusisë, rivales së saj në Ballkan. Por megjithatë vala e emigrantëve drejt Malit të Zi vazhdoi gati pa ndërprerje.

*Në një takim që Suma ka pasur me gjeneralin Vukotić, ky i fundit i ka deklaruar se qeveria turke nuk ishte dakord t'i bënte lëshime shqiptarëve, por do të vazhdonin politikën e mëparshme.*

Duke parë se si rrjedhojë e precipitimit të situatës po rrezikohej gjendja e qytetarëve të krishterë dhe atyre të huaj që ishin në Shqipëri, u bë e nevojshme disa herë që përfaqësitë e huaja në Shkodër t'i kërkonin autoriteteve siguri dhe mbrojtje. Në një takim që Zv.Konsulli Suma ka pasur me Valiun e Shkodrës, Bedri Pasha, ky i fundit e ka siguruar se as të huajt dhe as të krishterët s'duhej të kishin frikë. Ai e ka vënë në dijeni Sumën për premtimin formal zyrtar që ka marrë nga Mbreti Nikolla i Malit të Zi se malazetët do ta shihnin në mënyrë më strikte neutralitetin, do të ndalnin përkrahjen ndaj emigrantëve shqiptarë dhe do të ruanin kufijtë e tyre për të ndaluar kontrabandën e armëve dhe kalimin e vullnetarëve malazetë.<sup>502</sup> (Kupto shqiptarë të dy fiseve shqiptare që ishin që nga koha e Krizës Lindore e vitit 1878 nën Malin e Zi, Triepshit dhe Kojës, shënim i imi N.L.). Duke parë se armatosja e myslimanëve kishte krijuar mjaft keqkuptime tek të krishterët, Valiu në një farë mënyre ishte ndjerë i detyruar të pranonte që do ta kishte parasysh këshillën e Sumës (për të cilën dhe e ka falënderuar) se mund t'i shpërndareshin armë edhe popullsisë së krishterë të qytetit nën garancinë e Muhtarit të tyre. Gjithashtu Valiu e ka vënë në dijeni Sumën se së shpejti do të zbarkojnë në Shëngjin trupa të nevojshme ushtarake për vendosjen e qetësisë.<sup>503</sup>

Më 1 prill u zhvillua një mbledhje e trupës Konsullore në Shkodër, nën drejtimin e Dekanit, Kontit Mancinelli Scotti, Konsull i Përgjithshëm i Italisë në Shkodër, për të diskutuar mbi situatën aktuale në vend. Nga kjo mbledhje u vendos që t'i dërgohej një Notë Verbale Valiut për disa nga kërkesat që kishin këto përfaqësi në lidhje me gjendjen e krijuar.

Kjo ngjarje i është transmetuar menjëherë ambasadave të vendeve përkatëse në Konstandinopojë nga konsullatat e fuqive të mëdha në

<sup>502</sup> Në lidhje me qëndrimin e Mbretit Nikolla, Tajar Zavalani thotë: “*Sidoqoftë, për një kohë, Kral Nikollës ju deshtë me ndjeë politikën e mësallës me dy faqe. Nga një anë i nxiste Malësorët me qitë sa më shum ngatërresa qeverisë “Zhonturke” për me e dobësue,; nga ana tjetër ai refuzonte me iu dhanë Shqiptarve armët dhe pajimet luftarake qi iu kishte premtue për mos me lanë qi të delshin fitues në luftën kundër ushtëris së Durgut Pashës*”. Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*. Phoenix & Shtëpia e Librit, Tiranë, 1998, f. 213.

<sup>503</sup> PRO. FO. 294.49, 3 prill 1911.

Shkodër. Ky fakt tregon për interesin që këto vende kishin për ngjarjet që po ndodhnin në Shqipëri. Në Notën Verbale drejtuar Valiut të Shkodrës, që mban datën 3 prill 1911, tregohet se një ditë më përpara në Shkodër janë mbledhur të gjithë përfaqësitë konsullore. Ndërhyrja e tyre ka për qëllim sigurimin e popullsisë së krishterë mjaft të alarmuar dhe t'i dalin para pasojave që mund të vinë nga kjo gjendje alarmante.<sup>504</sup>

Bedri Pasha u shpreh se ishte dakord në lidhje me propozimet e bëra, përveç pikës që kishte të bënte me armatosjen e popullsisë së

<sup>504</sup> Notë verbale, 3 prill 1911.

Ngjarjet e këqija të ndodhura në një rajon të Vilajetit kanë detyruar autoritetet lokale të armatosin pa dallim, në Shkodër dhe rrethina, të gjithë myslimanët në gjendje të mbajnë armë, popullsia e krishterë e Shkodrës po provon një frikë shumë të fortë, me vendimin e marrë ajo ka qenë objekt i një mase përjashtimi duke i lënë pa mbrojtje në mëshirën e një turme të shqetësuar duke e ditur që shumë myslimanë gjithashtu të armatosur kanë qëndruar në qytet ndërsa është marrë angazhimi për t'i nisur të gjithë nga rajonet e kërcënuara dhe së fundi ajo besonte që transferimi në Shkodër i të plagosurve dhe të vdekurve do të bëjë të mundur shpagimin dhe ato do të vuajnë pasojat.

Në këto kushte Trupi Konsullor e e ka parë të detyrueshme të mblidhet sot nën kryesinë e Dekanit të tij, Konti Scotti i San Vito, Konsull i Përgjithshëm i Italisë me qëllimin që Shkëlqësia e Tij Qeveritari i Përgjithshëm i Vilajetit të Shkodrës të pranojë propozimin e masave.

Duke falënderuar Bedri Pashën për atë që ka bërë deri tani për mbrojtjen e Konsullatave, institucionet publike, banesat e të huajve dhe në përgjithësi të lagjeve, ai i mendon megjithatë të nevojshme propozimet e mëposhtme:

1. të mbajë në Shkodër një pjesë të trupave që priten së shpejti
2. armatosjen, nën garancinë e moukhtari-t dhe Kodjabeche-s, të të gjithë të krishterëve në gjendje të mbajnë armë, por me kushtin që të mos i kthejnë kundër revoltuesve dhe t'i kërkojnë dorëzimin atyre të armëve dhe municioneve ditën kur dhe vetë myslimanët do t'i kthejnë.

Duke bërë këtë propozim Trupi Konsullor shpreh dëshirën e popullsisë së krishterë

3. mëshirë, gjatë operacioneve ushtarake, në lidhje me gratë, fëmijët, pleqtë dhe fshatrat që s'kanë lidhje me revoltën.

4. mbrojtjen nga zjarri dhe nga topat të shtëpive të fshatrave në të cilat ose rrotull tyre nuk ka pasur angazhime.

Këto dy masat e fundit janë diktuar nga dëshira për të reduktuar sa më shumë të jetë e mundur motivet që i kanë detyruar malësorët të ikin siç kanë bërë më përpara, për t'u strehuar në një vend të Fuqisë fqinje, e cila gjendet në një situatë shumë kritike.

Duke ju nënshtruar këtyre dëshirave vëmendjes së saj dashamirëse, Përfaqësuesi i Italisë, Austrisë, Hungarisë, Francës, Malit të Zi dhe Britanisë së Madhe shpresojnë që Shkëlqësia e tij Guvernatori i përgjithshëm i Vilajetit të Shkodrës dëshiron që të bindet që ndërhyrja e tyre ka për qëllim sigurimin e popullsisë së krishterë të alarmuar dhe ta ruajë nga rrjellojat e këqija të të gjitha raprezaljeve të mundshme.

Shkodër 2 prill 1911

Nënshkruar nga Konti Scotti; D.Gregovitch; N.J.Summa; Cav. De Lambaur, L.Kraievski  
PRO. FO. 294.49, 3 prill 1911.

krishterë, pasi duhej marrë autorizimi nga Qeveria për këtë. Përfaqësuesit e Trupës Konsullore, në këtë takim (në takim me Valiun morën pjesë Konsulli i Përgjithshëm i Italisë dhe Nikolla Suma zv. konsull i Britanisë së Madhe, në Shkodër të Shqipërisë), u shprehën se do të mbështetnin propozimet e bëra. Kështu deklaroi edhe Bedri Pasha duke i siguruar dhe për qetësinë në qytet.<sup>505</sup>

A ndikoi ndërhyrja e konsujve të fuqive në qetësimin e situatës së panikut në Shkodër?

Për situatën e këtyre ditëve, Suma informon se ka filluar të ndjehet pak qetësi në qytet. Popullsia katolike ndjehet më e qetë nga përpjekjet e Trupës Konsullore, nga lajmi i çlirimit të Tuzit dhe nga zbarkimi i trupave dhe ardhjen e tyre në Shkodër. Se sa e vështirë ka qenë gjendja në qytet në këto ditë kuptohet fare mirë kur ai shprehet: “*Në Pazar edhe pse pjesërisht disa persona kanë hapur dhe po merren me punë*”.<sup>506</sup> Por si përfundim ai mendon: “*se lëvizja aktuale, edhe pse serioze, nuk është e përgjithshme; pasi ajo është e kufizuar tek fiset malësore shqiptare në kufi me Malin e Zi*”.<sup>507</sup>

Megjithëse përpjekja për të shfrytëzuar ndasitë fetare dështoi, fakti është se kjo kryengritje, meqë kishte filluar nga katolikët<sup>508</sup> dhe u mbështet nga Mali i Zi, bëri që një pjesë e myslimanëve shqiptarë të mos i mbështeste ato. Kjo ishte një përpjekje e njohur nga turqit për të përçarë popullin shqiptar e për të penguar bashkimin e tij në luftë për një çështje më të madhe, atë kombëtare.

Momenti më kulmor i kësaj lëvizjeje dhe ngjarja më e rëndësishme e kësaj lëvizjeje është ngritja për herë të parë pas kaq shumë vitesh robëri e flamurit kombëtar, më 6 prill 1911 në Bratilë të Deçiqit. **Por, në fakt në dokumentet në dispozicion nuk jepet ndonjë informacion në lidhje me këtë.** Por tashmë, ky moment është analizuar dhe pasqyruar fare saktë nga historianët e sotëm shqiptarë, duke u mbështetur në dëshmitë e periudhës në fjalë.<sup>509</sup>

***Turgut Pasha nuk arriti këtë radhë të kishte suksesin e vitit të kaluar (1910) në Shqipëri, përkundrazi në luftimet e tij me kryengritësit***

<sup>505</sup> PRO. FO. 294.49, 3 prill 1911.

<sup>506</sup> PRO. FO. 294.49, 3 prill 1911.

<sup>507</sup> PRO. FO. 294.49, 3 prill 1911.

<sup>508</sup> Një pjesë e fiseve malësore myslimane si Krasniqi dhe Bituçi, nuk i përkrahën bashkatdhetarët kryengritës. Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f.215

<sup>509</sup> Romeo Gurakuqi, *Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës 1991*. Phoenix Shkodra, Shkodër, 2002, f. 86-90.

*pati humbje të mëdha. Kështu që ai u detyrua të negocionte me kryengritësit, për të ruajtur prestigjin e Qeverisë.* Në një situatë të tillë ishte e domosdoshme të ndiqej një politikë pajtimi. Sipas mendimit të Sumës, kjo politikë kishte mundësi të ishte e suksesshme me kusht që të procedohej pa u menduar shumë dhe jo siç kishte ndodhur në Vilajet pas shpalljes së Kushtetutës Otomane, duke premtuar pa bërë asgjë.<sup>510</sup>

Sipas Sumës, për momentin nuk do të ketë veçse një ndërhyrje dashamirëse dhe njerëzore të Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha pranë Portës në Konstandinopojë që mund të bëjë të ndalet gjaku dhe tmerri që po bëhet prej një muaji dhe të rivendoset qetësia në rajon.<sup>511</sup>

Më 9 maj, Turgut Pasha harton një proklamatë nëpërmjet së cilës kërkon nga malësorët që të dorëzojnë armët, të pranojnë faljen e Sulltanit brenda 5 ditëve, me përjashtim të 8 krerëve të tyre kryesorë. Pas këtij afati tradhtarët do të ndëshkoheshin. Por krerët e kryengritjes nuk pranuan faljen, por deklaruan se do të luftojnë deri në fund. Përgjigjja e malësorëve që mban datën 12 qershor iu dërgua edhe përfaqësive të huaja nëpërmjet konsullit anglez në Cetinjë.<sup>512</sup>

**Shumë e rëndësishme besoj se është dëshmia e Sumës për takimin me Turgut Pashën:**

Suma është takuar me Turgut Pashën, i cili i ka bërë të ditur që duke pasur parasysh rëndësinë e situatës, ai e shihte të nevojshme që të parandalonte malësorët nëpërmjet një shpalljeje amnistie (me përjashtim të krerëve të rinj, emrat e të cilëve i ka dhënë, dhe që konsideroheshin si shtytës të lëvizjes aktuale), me kusht që për pesë ditë, kryengritësit të dorëzonin armët pa kushte. Por Suma mendonte “...që optimizmi i kryekomandantit ka rënë për momentin, pasi proklamata e tij nuk është marrë në konsideratë seriozisht nga malësorët.”<sup>513</sup>

Më 17 maj, Suma ka pasur një takim tjetër me Turgut Pashën, i cili duke përsëritur deklaratat e tij të mëparshme ka shtuar që trupat kanë rimarrë pozicionet e zaptuara nga kryengritësit në Samobor dhe në lartësitë e malit Deçiç, mbi Tuz; që është vendosur komunikimi me këtë rajon, dhe që do të zbrapste kryengritësit drejt Malit të Zi, që i çarmatoste ose do t’i shpallej hapur lufta. Në parashikimin e kësaj ngjarjeje të fundit ishte bërë një përqendrim i trupave gjatë kufirit. Suma ka theksuar se pushtimi nga trupat i lartësive dominuese të Tuzit ishte bërë para skadimit të afatit prej 5

<sup>510</sup> PRO. FO. 294.49, 24 prill 1911.

<sup>511</sup> PRO. FO. 294.49, 24 prill 1911.

<sup>512</sup> Romeo Gurakuqi, *Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës 1991*. Phoenix Shkodra, Shkodër, 2002, f. 104-105.

<sup>513</sup> PRO. FO. 294.49, 8 maj 1911.

ditësh dhe se një konflikt me Malin e Zi do të kishte pasoja negative dhe do të pasonte në të gjitha vendet e Ballkanit, por Turgut Pasha i është përgjigjur që kishin qenë malësorët që kishin provokuar, duke gjuajtur kundër trupave, që i janë kundërpërgjigjur dhe kanë kapur pozicionet e tyre, pa humbje, veç 5 ose 6 të plagosur.<sup>514</sup>

Memorandumi i Gërçës

Me kalimin e ditëve, nga qershori 1911, me gjithë ndihmën malazeze, filloi të ndjehej mungesa në ushqime dhe municione në rrallët e kryengritësve. Kjo bëri që ata tashmë të pushojnë qëndresën, të ulen në bisedime me turqit, duke parashtruar kushtet e tyre. Me pjesëmarrjen aktive të Ismail Qemalit dhe Luigj Gurakuqit, më 23 qershor 1911 kryengritësit hartuan në pllajën e Greçës, në anën malazeze, aktualisht të kufirit të Shqipërisë me Malin e Zi, dy orë në këmbë nga fshati Selcë, memorandumit<sup>515</sup> që iu dorëzua përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Cetinjë<sup>516</sup>. Ky memorandum i përbërë nga 13 pika ishte një përgjigje e ofertës së Turgut Pashës për amnisti.<sup>517</sup>

Në hyrje të tij në mënyrë të kujdesshme dhe mjaft diplomatike thuhej se shqiptarët i kishin qëndruar besnikë sulltanit dhe kishin mbrojtur Perandorinë Osmane. Ato kishin dhënë ndihmën e tyre edhe për ardhjen në fuqi të xhonturqve dhe kishin mbështetur Kushtetutën. Por shpresat e tyre nuk ishin realizuar, gjë kjo që bëri që ato të kërkonin të drejtat e tyre me armë. Krahas kërkesave për mësimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe futjen e saj, krahas turqishtes, si gjuhë zyrtare në vilajetet shqiptare, ato kërkuan edhe: *“mbrojtje kundrejt veprimeve antikushtetuese; njohje të ekzistencës kombëtare të shqiptarëve; zgjedhje të lira të deputetëve shqiptarë; riorganizim të qeverisjes në vilajetet shqiptare në përshtatje me kushtet vendore; emërim të një inspektori të përgjithshëm që të ketë për detyrë kontrollin e respektimit të ligjit; kryerjen e shërbimit ushtarak në vilajetet amtare dhe hartimin e një statusi të veçantë për popullsinë kufitare, në rastet nevojë të mbrojtjes së kufijve; përdorim të një pjese të taksave për nevojat vendore; fonde qeveritare për rindërtimin e shtëpive të*

<sup>514</sup> PRO. FO. 294.49, 20 maj 1911.

<sup>515</sup> Memorandumi i Gërçës është i njohur edhe me cilësimin “Libri i kuq” (nga lidhja me të kuqe). Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f. 216.

<sup>516</sup> Kryengritësit i dërguan një memorandum të veçantë kryeministrit anglez Sir Edward Grey ku paraqisnin kërkesat e tyre dhe luteshin për përkrahjen e qeverisë britanike. Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f. 217.

<sup>517</sup> Për më tepër: Romeo Gurakuqi, *Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës 1911*. Phoenix Shkodra, Shkodër, 2002, f. 116-123.

*shkatërruara dhe – pikë e rëndësishme – rikthim të armëve pronarëve të tyre.*<sup>518</sup>

Siç shihet nga kërkesat, memorandumit shpreh aspiratat e mbarë popullit shqiptar për autonomi, kërkesa këto që do të përsëriten vazhdimisht deri në shpalljen e pavarësisë.

Në vazhdim Suma njofton eprorin e tij mbi kushtet e këtij memorandumit. Ai tregon se Malësorët kërkojnë një autonomi administrative, e cila ndalon pretendimet e Turgut Pashës që të arrijë një nënshtrim pa kushte dhe i detyron malësorët të vazhdojnë armiqësinë.

*Konsulli Suma mbi misionin e Imzot Serreqit*

Nga ana e tij Konsulli i Përgjithshëm i Austro-Hungarisë (me lutjen e turqve) ka bërë përpjekje për të ndikuar tek malësorët që të nënshtrohen. Për këtë arsye, konsulli austriak në Shkodër, Zambaur, i ka propozuar Monsinjor Serreqit t'i takonte malësorët personalisht në Podgoricë. Arqipeshkvi nuk ka pranuar, kështu që Konsulli i Austrisë i është drejtuar Vjenës që të siguronte nga Vatikani një urdhër që të detyronte atë të bënte një tentativë pajtimi me malësorët kryengritës. Më 3 korrik Imzot Serreqi është takuar në Koplik me Turgut Pashën.<sup>519</sup>

Po atë natë Serreqi është takuar me zv. konsullin Suma ku i ka konfirmuar se me udhëzimet e Vatikanit ai do të ndërhynte për të arritur një zgjidhje të kënaqshme dhe afatgjatë. Ai ishte bindur për dështimin e misionit të tij dhe që Turgut Pasha nuk pajtohej dhe nuk kishte autoritetin të bënte ndonjë lëshim malësorëve.<sup>520</sup>

<sup>518</sup> Peter Bartl, *Shqiptarët*. Istituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, f.137.

Për më tepër:

Leka, 1937/1, “*Memorandum mbi vendimet e dhanuna prej Kuvendit të përgjithshëm të Krenëvet Shqyptarë në Gërçë, më 10/23 të Qershorit 1911, si përgjigje të proklamacionit të Shefqet Turgut pashës*”, f. 12-13.

Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f.216-217.

<sup>519</sup> PRO. FO. 294.49, 11 korrik 1911.

<sup>520</sup> Duke i sugjeruar atyre një nënshtrim pa kushte, vetëm me premtimet e tij verbale se do të ishin të kënaqur duke i trajtuar si fëmijët e tij. Arqipeshkvi nuk besonte në premtimet e Turgut Pashës që refuzonte garantimin e ekzekutimit; që e kishte tepruar kur i kishte thënë se ai mund t'i shkatërronte malësorët deri në fund kur i kishte rrethuar me trupat e tij, por në sajë të humanizmit të tij i kishte lënë një rrugë të lirë drejt kufirit malazez. Arqipeshkvi kishte mbetur i habitur nga ky version i dhënë nga kryekomandanti, që ishte krejt ndryshe nga realiteti, duke humbur kështu të gjithë besimin në fjalët e tij. Megjithatë të nesërmen ai do të nisej për në Podgoricë për të takuar malësorët, të cilëve ia kishte bërë të ditur që gjuha që do të përdorte kishte të bënte me dëshirën për të evituar të gjitha dyshimet dhe nuk do të influenconte në qëllimet e tyre.

PRO. FO. 294.49, 11 korrik 1911.

Së fundmi Mons. Serreqi i ka thënë Sumës në konfidencë, “...se Konsulli i Përgjithshëm i Austrisë i kishte kërkuar të përdorte të gjithë influencën e tij për të bindur Malësorët të nënshtrohen me qëllim që të evitohej ndërhyrja, në gjendjen aktuale, e Anglisë që i interesonte dhe që do të çonte në atë të Fuqive të tjera; dhe që edhe në rast të pasuksesshëm, Arqipeshkvi duhet të presi në Podgoricë udhëzime të reja që ai, Konsulli, do t'i kërkonte nga Vjena”.<sup>521</sup>

Më 4 korrik Mons. Serreqi është nisur për në Podgoricë. Ai është pritur për një darkë nga Mbreti Nikolla në Cetinjë, ku ishte edhe Ministri i Turqisë dhe Ismail Qemali, deputet i Beratit. Kuptohet se përpjekjet e arqipeshkvit për të pajtuar Malësorët ishin të kota, pasi ata ishin të vendosur për kërkesat e memorandumit, ndërsa turqit nga ana e tyre nuk i pranonin.<sup>522</sup>

Sipas Sumës, situata aktuale, për të parandaluar derdhje të reja gjaku, nuk sjell asnjë rezultat. Vetëm ndërhyrja e Fuqive të Mëdha do të jetë e vetmja mënyrë për të vendosur rregullin në këtë rajon.<sup>523</sup>

Arqipeshkvi i Shkodrës qëndroi në Podgoricë, megjithëse misioni i tij ishte i dështuar. Ndërsa famullitari i Shkodrës që kishte qenë së bashku me të pas kthimit më 18 korrik informon Sumën duke i thënë: “...në mënyrë konfidenciale që malësorët insistojnë në përmbushjen e kërkesave të tyre të paraqitura në memorandumimin e 10-23 qershorit të shkuar. Ata do të kërkojnë që zbatimi i këtyre pikave të garantohet nga Fuqitë e Mëdha, dhe nuk do të mjaftohen me garancitë e ofruara vetëm nga Austro-Hungaria, që për qëllimet e saj politike, që tani duket se favorizon Turqinë, do të sillte realizimin e një marrëveshjeje mes tyre, por që do të prishej sigurisht në të ardhmen”.<sup>524</sup> Pastaj famullitari do të vinte në dijeni edhe konsullin austriak për dështimin e misionit dhe për vendimin e kthimit menjëherë në Shkodër. Por konsulli Zambauer ka kërkuar që Arqipeshkvi të qëndronte edhe disa ditë, deri sa ai të merrte udhëzime të reja nga Vjena për të.

Mbi bisedimet përfundimtare të paqes, fundi i Korrikut dhe fillimi i muajit gusht 1911

Përfundimi i afatit dhënë kryengritësve për të dorëzuar armët ishte data 3 gusht. Në fakt afati është zgjatuar për arsye të mospërfundimit të misionit të Monsinjor Serreqit dhe pse mendohej se nëse banorët e Shalës do të dorëzoheshin, nevojitej kohë për formalitetet që do të kryheshin për

<sup>521</sup> PRO. FO. 294.49, 11 korrik 1911.

<sup>522</sup> PRO. FO. 294.49, 11 korrik 1911.

<sup>523</sup> PRO. FO. 294.49, 11 korrik 1911.

<sup>524</sup> PRO. FO. 294.49, 19 korrik 1911.

60 familje malësorësh që do të ktheheshin nga Podgorica. Por në fakt dukej se banorët e Shalës as që kishin ndërmend të dorëzoheshin.<sup>525</sup>

Më 28 korrik, në Cetinë filluan bisedimet turko-malazeze për problemin e refugjatëve. Disa kërkesa të memorandumit, si: armëmbajtja nga kryengritësit, ulja e taksave, lejimi i shkollave shqipe, shërbimi ushtarak një vit në Stamboll dhe pjesa tjetër në vilajetin e Shkodrës, rindërtimi i shtëpive dhe ndihma në para dhe ushqime për refugjatët në Mal të Zi, u pranuan nga turqit. Gjithashtu Mbret Nikolla premtoi që do të ndikonte për kthimin e refugjatëve në shtëpitë e tyre.<sup>526</sup>

Në fillim të shtatorit Suma flet për gjendjen e vështirë të malësorëve që vijnë në qytet dhe për mosdashjen e autoriteteve qeveritare për të përmbushur premtimet. Duke qenë në kushte kaq të vështira, pa shtëpi dhe me dimrin që po afrohej, ato mund ta mendonin si rrugëzgjidhje migracionin përsëri në Mal të Zi. Ndërsa myslimanët shkodranë kërkojnë nga Valiu të drejtën për të mbajtur armë, por kjo çështje është delikate edhe për Stambollin.<sup>527</sup>

Kështu mori fund kryengritja shqiptare e vitit 1911, që konkretisht u kufizua vetëm në Shqipërinë e Veriperëndimore<sup>528</sup>. Përhapjen e saj në viset jugore shqiptare qeveria turke arriti ta pengojë duke bërë në kohë lëshimet e duhura.<sup>529</sup>

<sup>525</sup> PRO. FO. 294.49, 19 korrik 1911.

<sup>526</sup> Më 2 gusht ambasadori turk në Mal të Zi takoi në Podgoricë kryengritësit, por nuk u arrit ndonjë marrëveshje, pasi shumica e shqiptarëve kërkonin garanci evropiane për plotësimin e premtimeve turke. Por këtë autoritetet turke nuk e pranuan, ndaj refuzuan shpërndarjen e bukës dhe kërcënuan me dëbim. Në ditët në vazhdim shqiptarët u mblodhën përsëri, dhe vendosën të pranonin amnistinë me kushtet e përmendura. Peter Bartl, *Myslmanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f.217-218.

<sup>527</sup> PRO. FO. 294.49, 2 shtator 1911.

<sup>528</sup> Shumica e kryengritësve ishin katolikë dhe myslimanët me disa përjashtime (ndër të tjerë edhe një grup nën Isa Boletinin), mbajtën qëndrim mospranues ndaj kryengritjes. Mali i Zi e ndihmoi. Peter Bartl, *Myslmanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f.219.

<sup>529</sup> Peter Bartl, *Shqiptarët*. Istituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, f.134-139.



**The Great Highland Uprising of 1911  
(based on personal archival file documents of  
British Vice Consul in Scutari)**

*SUMMARY*

The paper is an attempt to address the events of the Great Highland Uprising of 1911, the implications of domestic, international and regional ones, based only on personal archival file documents of British Vice Consul in Scutari, Nicholas Summa, an Albanian. The folder is taken at the National Archives in London and found the PRO index. FO. 294.49. Problems associated with the uprising of 1911 are transmitted by the consul Summa step by step, towards the Consul General of the United Kingdom of Great Britain in Thessaloniki. Harry Lamb. Voluminous documentation personal file at the National Archives Summa Nicholas, in London, consists of all originals (copies) that Summa maintained in his personal archive in Shkodra and then, is not known under what circumstances, it is transferred to the Foreign Office. The paper is an attempt to rebuild the whole progress of events in the Shkodra and its highlands in the north on the course of the year 1911 and above all to examine the Highland uprising under the light of Nicholas Summa's reports. They also get a clear understanding of: diplomatic intervention of foreign representations in Scutari to protect Christians in Upper Albania; Montenegro's position towards the Albanian Uprising of 1911; the performance of the uprising, the scale of the deployment of Turkish military forces, efforts to organize Albanian political program to finalize the Memorandum of Greçe; the mission of Monsignor James Serreqi, Archbishop of Scutari and the final talks on peace in the end of July and beginning of August 1911.

**Sereta KOPERAJ**

## QËNDRIMI BRITANIK NDAJ MBRETIT ZOG NË PRAG TË PUSHTIMIT ITALIAN

Në vitet 1938-1939, kur Evropa përjetonte tensionimin mes dy blloqeve të fuqive të kontinentit, i cili do të shpiente në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte një prej vendeve, fati i të cilit përbënte një prej dëshmimeve më të qarta se konflikti i armatosur ishte në prag dhe nuk mund të ndalej. Në këtë periudhë tejet të trazuar për mbarë Evropën, shteti i vogël shqiptar i dalë i gjymtuar, pas vendimeve të Traktatit të fshehtë të Londrës (26 prill 1915) e më pas të Konferencës së Paqes në Paris (1919-1920)<sup>530</sup>, ishte përballë një rreziku të ri, pushtimit fashist italian. Pushtimi italian i Shqipërisë do të ishte një ngjarje që do të komplikonte edhe më tej politikën e shteteve demokratike e veçanërisht ato të qeverisë britanike, e cila ishte për një paqe dhe ruajtje ekuilibrash në Evropë<sup>531</sup>. Në muajt e fundit të vitit 1938 dhe në tre muajt e parë të vitit 1939, Italia përgatitej për të ndërmarrë një veprim ushtarak, që sido ta gjykojë do të ishte një agresion i hapur kundër një shteti të pavarur, që për më tepër ishte anëtar i Lidhjes së Kombeve, siç ishte Shqipëria. Në parashtimin në vijim, qëndrimin e Britanisë së Madhe, si fuqia kryesore fituese e dalë nga Lufta e Parë Botërore dhe që mbahej si arbitri kryesor ndërkombëtar, do të përqendrohemi, jo tek reagimi ndaj përgatitjes për ndërhyrje ushtarake të Italisë, por tek qëndrimi anglez në këtë periudhë ndaj Mbretit Zog.

Zogu ishte padyshim jo vetëm figura kryesore e shtetit shqiptar të asaj periudhe, por dhe një personalitet shumë kompleks edhe në marrëdhëniet me shtetet e tjera. Duke i bërë një analizë dokumenteve të *Foreign Office-t* të gjysmës së parë të vitit 1939, shohim se qëndrimi i diplomacisë britanike ndaj Mbretit Zog nuk është i njëtrajtshëm, ai ndryshon në lidhje me zbulimin gradual të planeve të Italisë për pushtimin e Shqipërisë. Qëndrimi anglez mund të perceptohet i lëkundur nga vetë dilema para të cilës ndodhej diplomacia britanike, sepse nga njëra anë Britania e Madhe ndeshej me një sfidë të sigurimit kolektiv, por nga ana

<sup>530</sup> M. MacMillan, Paris, 1919, *gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë, 2006, f. 153-156.

<sup>531</sup> H. Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë, 1999, f. 305-307.

tjetër ajo kishte pranuar që Shqipëria të ishte në sferën e interesave italiane.<sup>532</sup>

Duke hulumtuar në dokumentet arkivore të *Foreign Office*-it, mund të vërejmë jo vetëm analizën që i bëhet lëvizjeve të Zogut, por dhe gjykime mbi personalitetin e mbretit shqiptar të asaj periudhe. Vetë pozicioni neutral britanik, i bën burimet nga dokumentet e F.O. më të besueshme dhe objektive për periudhën që po shqyrtojmë (dhjetor 1938 - prill 1939). Në fakt lidhjet e Zogut me britanikët janë më të hershme, ato fillojnë që me koncesionin e vajgurit në fillimet e viteve '20<sup>533</sup>, e më pas, sidomos me organizimin dhe trajnimin e xhandarmarisë shqiptare nga oficerë anglezë<sup>534</sup>. Por duke u përqendruar tek raportimet e *Foreign Office*-it, në kapërcyellin e viteve 1938-1939, Mbreti Zog cilësohet si një udhëheqës që ka arritur të bëjë përparime të dukshme sidomos në rend, arsim dhe pjesërisht në administratën shtetërore, në vendin më të prapambetur të Evropës, por nuk lënë pa vënë në dukje diferencën e madhe mes jetës luksoze të oborrit mbretëror dhe vafërisë së madhe të vendit. Diçka e tillë vihet në dukje edhe në raportin vjetor të hartuar nga legata britanike në Durrës, për vitin 1938. Ministri diplomatik anglez në Shqipëri, A.Rayan, në këtë raport gërshetonte të dhënat jo vetëm diplomatike, por edhe sjelljet personale të Mbretit Zog në raport me diplomacinë britanike, por edhe me përfaqësues të qeverisë angleze dhe oficerët anglezë në Shqipëri. *“Pakënaqësia është rritur edhe nga kontrasti i madh mes varfërisë së popullit dhe luksit të oborrit mbretëror, i cili megjithëse modest, ka organizuar një varg festimesh që nga nëntori i 1937. Marrëdhëniet politike mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar janë bërë edhe më sipërfaqësore seç kanë qenë më 1936-ën dhe 1937-ën. Ministri i Jashtëm i Madhërisë së Tij në muajin janar informoi qeverinë shqiptare se qeveria britanike nuk dëshironte që vendet e vogla të rreshtoheshin në njërin krah apo tjetrin të konfliktit që ka ndarë Fuqitë e Mëdha të kontinentit. Si rrjedhojë qeveria britanike ia vuri në dukje asaj shqiptare përkrahjen që i bëri në Gjenevë Italisë për statusin e Etiopisë dhe me 28 shtator iu komunikua qëndrimi i Ministrisë së Jashtëm Çambërle në një dite më parë për krizën ndërkombëtare. Duke përjashtuar vetëm këto komunikime, pak a shumë formale, asgjë tjetër me rëndësi politike nuk ka ndodhur mes dy*

<sup>532</sup> P.Teli(Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927*, Tiranë, 2005, f. 366.

<sup>533</sup> S.Villamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942*, Tiranë, 2000, f. 319-321, si dhe A.Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Tiranë, 2009, f. 404.

<sup>534</sup> J.B.Fischer, *Mbreti Zog dhe përjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, 1996, f. 99-102, dhe A.Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Tiranë, 2009, f. 475.

vendeve. Mbreti Zog ishte i pëlqyeshëm, si asnjëherë në atë bisedim të shkurtër me ministrin e Madhërisë së Tij, dhe i gatshëm për të diskutuar çështje me interes të përgjithshëm, por ai nuk tregoi në ndonjë rast gatishmërinë për të ndjekur këshillat britanike. Marrëdhëniet e kortezisë janë mbajtur sipas rastit të paraqitur midis dy vendeve. Madhëria e tij, Mbreti megjithëse jo i interesuar, i dërgoi një mesazh urimi Mbretit Zog me rastin e martesës së tij, duke i paraprirë shkëmbimit të letrave që ndoqën më pas. Inspektoriati i xhandarmarisë britanike, të cilin e drejtoi major-gjeneral Jocelyn Percy që prej vitit 1926 u likujdua deri në fund të muajit shtator. Numri i oficerëve vartës u reduktua shumë dhe nuk u tregua konsiderata e duhur ndaj gjeneral Percy-t, kështu që shkrirja e inspektoriatit nuk përbën ndonjë keqardhje për mënyrën sesi u krijuan kushtet. Sidoqoftë u ndërpre në lidhjet që ishin krijuar me shumë shqiptarë, që respektonin më shumë oficerët britanikë dhe tregonin një vlerësim më të madh për shërbimet e tyre, sesa vetë mbreti Zog duhej të bënte së fundmi. Mbreti tregoi një shenjë falënderimi duke kërkuar deri diku papritmas shtyrjen e kontratës edhe për 6 muaj të tjerë të oficerëve vartës pas përfundimit të saj me 31 mars, në mënyrë që qëndrimi i tyre në Shqipëri të përfundonte në mënyrë simultante me atë të gjeneral Percy-t.

Duke përjashtuar këtë rast, ai nuk shfaqti ndonjë shenjë vlerësimi ndaj inspektoriatit në prag të nisjes së tij. Gjenerali asnjëherë nuk e ka parë aq fodull, nëse i referohemi përshkrimit të tij, sesa në pritjen e fundit. Ai nuk priti asnjë nga oficerët e tjerë, përveç njërit që e shoqëronte gjeneral Percy-n dhe ky si përkthyes. Madje ai nuk do të dekoronte tre oficerë, po të mos ia kishte sugjeruar gjenerali me rastin e festimeve të përvjetorit të Pavarësisë në nëntor.<sup>535</sup> Siç shihet qëndrimi britanik ndaj Zogut ishte deri diku indiferent, ashtu siç ishin mjaft të zbehta interesat angleze për Shqipërinë, kjo duke u nisur edhe nga fakti që marrëveshja e paratifikuar e tregtisë anglo-shqiptare e 1931 vazhdonte të mbetej pezull. Madje qeveria britanike nuk kishte shfaqur ndonjë shqetësim në lidhje me restriksionin në marrëveshjen e tregtisë së jashtme me Shqipërinë, të arritur më 1937. Ndërsa kompania anglo-iraniene e naftës në muajin qershor të atij viti (1938) tërhoqi kërkesën për një marrëveshje të re koncesionare për nxjerrje naftë në Shqipëri, për shkak se kishte zgjeruar impenjimet e saj tjetërkund. Kjo kuptohet edhe tek fraza që mbyll raportin ku flitet për tokën

<sup>535</sup>F.O 371.23710 R 724/ 724/ 90, Annual Report, 1938. Sir A.Ryan to Vicount Halifax, Durazzo January 23, 1939 Raport vjetor 1938. Nga z.A.Rayan për Viskontin Halifax, Durrës, 23 Janar 1939.

që qeveria britanike kishte blerë në Tiranë për legatën e re të saj, *“HMG bleu një shtëpi të papërfunduar dhe afro një akër tokë në lagjen moderne të Tiranës për ngritjen e një Legate të re, e cila mund të përfundojë brenda 1939-ës. Ngjan pak ironike të shënosh këtë në fund të përshkrimit, kjo edhe me zvogëlimin e interesave britanikë në Shqipëri, por është gjithashtu mëse e vërtetë që legata është një vend vëzhgimi, kështu që ia vlen ta mbajmë të gjithën, dhe vendin e saj në kryeqytet.”*<sup>536</sup> Por kjo indiferencë dhe vëzhgim në distancë ndaj Mbretit Zog, ndryshoi në ditët e para të shkurtit të 1939. F. O. bën një raport të zgjeruar për situatën në Shqipëri në lidhje me rrezikun e një ndërhyrjeje ushtarake nga ana e Italisë, sepse megjithë interesat për marrëdhënie më të mira me Italinë, Qeveria Britanike ishte e interesuar edhe për pavarësinë dhe integritetin e shtetit shqiptar. Në raportimet dhe analizat e bëra për situatën që po tendosej mes Shqipërisë dhe Italisë F.O. e sheh fillimin e situatës konfliktuale mes italianëve dhe Mbretit Zog që dy vite më parë<sup>537</sup>. Në një sërë raportesh bëhet vlerësimi nga burime të ndryshme duke dhënë një tablo më reale të asaj shtete të turbullt në Shqipëri, ku Zogu nuk ka probleme vetëm me situatën e jashtme, por edhe atë të brendshme: *“Pakënaqësia e Italisë ndaj mbretit Zog ka filluar të rritet që nga festimet për përvjetorin e pavarësisë në nëntor të 1937. Pavarësisht nga entuziazmi i shfaqur në aparençë, qeveria italiane nuk aprovonte shpenzimin tejmasë të bërë për festimet, e sidomos në demonstrimin ushtarak... ky tensionim që vazhdoi të ishte i pranishëm në gjithë këtë periudhë, por ishte rritur ndjeshëm muajt e parë të këtij viti”*<sup>538</sup>. Madje në dokumentet britanike dilet në përfundimin se loja e dyanshme e Zogut me italianët i kishte prishur punë edhe në opinionin e brendshëm në Shqipëri, por britanikët e vlerësojnë atë si faktorin kryesor rezistues ndaj kërkesave të italianëve. *“Këndvështrimi i italianëve për mbretin Zog mund të përmbidhet në një fjali të vetme të përmendur edhe në telegramin e dërguar në Romë, nr.136 të 26 shkurtit që për ata, Zogu është shumë shpenzues dhe shumë kërkuës. Ajo çfarë e bën tragji-komike situatën e tij është se, nëse nga pjesa më e madhe e shqiptarëve ai akuzohet se i ka shitur vendin e tij Italisë, në fakt ai i ka dëshpëruar italianët duke i rezistuar kërkesave të tyre në shumë drejtime. Ai gjithnjë ka refuzuar çdo gjë që mund të shpiente në një kolonizim në shkallë të gjerë.”*<sup>539</sup> Së fundmi,

<sup>536</sup>F.O 371.23710 R 724/ 724/ 90 , Annual Report, 1938. Sir A.Ryan to Vicount Halifax, Durazzo january 23, 1939.

<sup>537</sup> Në fakt më 1937 rezultoi dhe fillimi i idesë së pushtimit të Shqipërisë, nga Konti Ciano. Shih *Diario 1937-1943*, Torino 1998, f. 238.

<sup>538</sup> F.O.371.23711 R.16 97/ 725/ 90 F.O.minutes.

<sup>539</sup> F.O.371.23711 R.16 97/ 725/ 90 From A.Ryan to Lord Halifax, 4 mars 1939, Durrës.

theksi vihet edhe tek metodat e administrimit të financave të qeverisë shqiptare, të cilat kishin krijuar hije dyshimi në Romë dhe ishte e sigurtë që hedhja poshtë e skemës së tyre për organizimin e rinisë fashiste ishte një zhgënjim i madh për qeverinë italiane. Madje edhe në fushën ekonomike Mbreti nuk kishte shkuar aq larg, apo aq shpejt sa italianët do të kishin dëshiruar. Vetë, Foreign Office, e kishte të vështirë të gjykonte mbi efektin e tërë këtyre ngjarjeve mbi marrëdhëniet shqiptaro-italiane, që rodhën me shpejtësi brenda dy muajve. Në dy muajt e parë të vitit 1939, dukej se italianët ishin të shqetësuar nëse Mbreti Zog do të përqendrohej tek marrëveshjet me ta, vetëm në aspektin financiar të tyre. Por situata nuk po shkonte drejt një mirëkuptimi për realizimin e marrëveshjes dhe dukej se Zogu po i bënte rezistencë kërkesave të qeverisë së Musolinit. Çështja Giro<sup>540</sup>, ndoshta, vetëm kishte precipituar pak a shumë në mënyrë aksidentale një situatë të acaruar. Nga ana tjetër, FO nuk mund të mos mendonte që qeveria italiane të ishte dorë jashtë në përpjekjet për trazira në Shqipëri, në mënyrë që të rrëzohej Mbreti Zog dhe të justifikonte një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake<sup>541</sup>. Prandaj raporti me Zogun kthehet në një prej plan tjetër për diplomatët anglezë. Më 9 mars 1939, Mbreti Zog i kërkoi një takim ministrit britanik në Shqipëri, A. Ryan, ku po përpiqej t'ia bënte prezent shqetësimin e tij ndaj rrezikut italian. Nga ana tjetër, Zogu, siç dukej kërkonte edhe të maste pulsën e Anglisë, si do të reagoonte ndaj një pushtimi të mundshëm të Shqipërisë nga Italia.

Në fakt qëndrimi britanik i ishte bërë i qartë Zogut edhe më parë, që në fillim të vitit, më 23 janar, kur një i besuar i Zogut kontaktoi me A.Ryan, për ta informuar se Italia po përgatitej ta përmbyste Mbretin Zog. Këtë do ta arrinte përmes një komploti të organizuar nga G.Giro me Mustafa Krushën dhe disa emigrantë shqiptarë në Paris, për të rrëzuar Mbretin Zog, si dhe për ta zëvendësuar mbretërinë me një regjim më pranë ideve italiane. Por synimi i takimit ngjante të ishte tjetër gjë: tërheqja e mbështetjes britanike, për të çuar drejt dështimit skemat, që informatori shqiptar ia atribuonte qeverisë italiane. Përgjigjia nuk ishte aspak shpresuese.

*“Unë e dekurajova atë me vendosmëri, duke mos e lënë të shpresonte që në rrethanat e tanishme, Qeveria Britanike do të përfshihej në një çështje të tillë”, - ,do të ishte ky raportimi i ministrit britanik në*

<sup>540</sup> Bëhet fjalë për eksponentin italian G.Giro, që erdhi në Shqipëri për organizimin e rinisë shqiptare sipas modelit fashist, por që u kthye në një prej protagonistëve për rrëzimin e Zogut, plan që dështoi dhe përfundoi me largimin e Girus nga Shqipëria.

<sup>541</sup> PRO F.O.371.23711 R.26 97/ 725/ 90 FO minutes A.Noble 28 mars 1939.

Shqipëri<sup>542</sup>. Ngjante se vetëm Zogu dhe rrethi i tij shumë i ngushtë ishte i alarmuar për situatën që po afrohej. Është e dukshme se Zogu ishte i qartë për pozicionin në të cilin ndodhej, por me precipitim e situatës, kur presioni italian mbi qeverinë shqiptare ishte bërë shumë i ndjeshëm, Zogu shpresonte tek një reagim, apo dhënia e një sigurie nga Britania e Madhe. Por nga vetë përgjigjia që i jepej Zogut përmes diplomatit britanik në Shqipëri, kuptohej që për Foreign Office, asgjë nuk kishte ndryshuar që nga janari :

*“Ndër të tjera ai (Mbreti Zog, shënim i imi. SK.) më pyeti për qëndrimin e Qeverisë Britanike, nëse historitë e fundit (fjalën e kishte në lidhje me një sulm të Italisë ndaj Shqipërisë) do të bëheshin realitet. Unë i thashë se nëse pyetja ishte e bërë zyrtarisht, unë duhej t’i drejtohesha qendrës, dhe me shumë mundësi do të merrja një përgjigje që qeveria britanike nuk mund të prononcohet në lidhje me situata hipotetike. Por unë shpreha një mendim timin, personal, që ajo (qeveria britanike, shënim i imi. SK) nuk do ta shihte të arsyeshme të ndërhynte në një çështje të tillë, të paktën përderisa ajo të mos krijonte një luftë të përgjithshme.”*<sup>543</sup>

Zogu, nga ana e tij, kishte shprehur palëkundëshmëri në qëndrimin e vet, duke e konsideruar integritetin e vendit si mjaft të rëndësishëm në lidhje me marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë. Nga biseda në takim me A.Rayan-in, del që Zogu ishte gjithashtu shumë skeptik në lidhje për një kërcënim italo-jugosllav, nga diskutimet që kishin pasur ministri i jashtëm italian, Konti Cianno me Stojadinoviçin mbi Shqipërinë. Ai nuk besonte që Jugosllavia të merrte pjesë në ndarjen e Shqipërisë, pasi, në asnjë rrethanë, shtetit jugosllav nuk i interesonte të kishte Italinë në Ballkan. Me ndërrimin e qeverisë së Stojadinoviçit, Zogu shpresonte që qëndrimi jugosllav, kundër një ndërhyrjeje të mundshme ushtarake të Italisë në Shqipëri, të ishte më i dukshëm, por mendonte që diçka e tillë do të kishte pak gjasa. Mbreti i kishte folur A.Rayan-it, edhe për përpjekjet për t’u lidhur me Gjermaninë, siç duket përpjekja e fundit për t’u shkëputur nga Italianët, por qëndrimi i “Herr Hitler-it” kishte qenë jomiqësor, duke treguar kështu një shenjë të qartë mosinteresimi. Mendimit të Rayan-it që interesi ekonomik i Gjermanisë nuk mund të shtrihet deri në këtë vend të Ballkanit, Zogu i ishte përgjigjur “se ai nuk mendonte vetëm për interesin ekonomik, por edhe për atë politik, dhe për Gjermaninë, Shqipëria nuk paraqiste asnjë

<sup>542</sup> F.O..371.23711 R 2065/145/ 90, 23 janar 1939, Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax.

<sup>543</sup> F.O..371.23711 R 2065/725/90, 10 mars 1939, Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax (bisedë me mbretin Zog).

*interes, as atë ekonomik, as atë politik.*<sup>544</sup> Diplomati britanik raportonte se “Mbreti të jepte përshtypjen e një njeriu që pasi i ka studiuar me hollësi të gjitha mundësitë, nuk sheh alternativë tjetër, vetëm atë të vazhdimit të marrëdhënieve me Italinë, duke iu mbështetur asistencës financiare, por duke shprehur vendosmërinë që të mos pranojë kontrollin e tyre. p.sh. ai do të pranonte, në varësi të negociatave për hua, skemën e italianëve për ndërhyrjen në procesin e zbatimit, por nuk do të pranonte në asnjë mënyrë që italianët t’i menaxhonin ato”<sup>545</sup>.

Duke pasur parasysh rrjedhën e ngjarjeve që vijuan deri në javën e parë të muajit prill, sipas britanikëve Zogu është pengesa kryesore për italianët, të cilët duan të ndjekin gjermanët në avancimin e tyre në Çeki dhe Austri. Në një memorandum të dt.4 prill 1939, Foreign Office pasqyrore kështu situatën: “Ne e dimë që kur Konti Çiano bëri një vizitë në Beograd, në fillim të këtij viti i sugjeroi z. Stojadinoviç që Italia dhe Jugosllavia mund ta ndajnë Shqipërinë. Ky propozim cinik u hodh poshtë nga pala jugosllave me arsyen se Princi Pavle nuk donte të dëgjonte për të. Nuk pati zhvillime të tjera deri në mesin e muajit shkurt, kur filluan të shfaqen një sërë ngjarjesh në Shqipëri. Është e pamundur të përcaktohet se çfarë ndodhi dhe sa ishin të përfshirë italianët pas tyre, por çështja Giro ishte më e rëndësishmja, që çoi në largimin e këtij të fundit nga vendi si organizatori i një komploti kundër Zogut. Por deri në mes të muajit mars situata u duk sikur u zbut, deklaratat e agjensisë Stefani dhe vetë fjala e Mbretit Vitore Emanueli, më 23 mars duke vlerësuar marrëdhëniet me Shqipërinë, krijuan përshtypjen se nuk ka asnjë krizë në raportet mes dy vendeve. Por qeveria italiane i ka kërkuar qeverisë shqiptare një marrëveshje të re e cila më shumë i ngjan një ultimatum, për kontroll të financave, pranimin e një misioni ushtarak italian, bashkimin doganor, organizimin e rinisë sipas stilit fashist, kontrollin e ushtrisë si dhe një migrim i pakufizuar për italianët në Shqipëri. Mbreti Zog është shprehur i gatshëm që të pranojë marrëveshjen deri në atë pikë ku nuk cënohet integriteti dhe pavarësia e vendit të tij. Por përqendrimi i trupave ushtarake në jug të Italisë, tregojnë se italianët kërkojnë kontrollin tërësor të Shqipërisë.”<sup>546</sup> Sipas Foreign Office, kjo politikë i shkante përshtat dëshirës së Musolinit, për të qenë i vendosur sa më ngjitur me Jugosllavinë për të mbrojtur krahun e tij

<sup>544</sup> F.O. 371.23711R 2065/725/90, 10 mars 1939, Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax ( bisedë me Mbretin Zog).

<sup>545</sup> F.O. 371.23711R 2065/725/90, 10 mars 1939, Durrës, from Sir A.Ryan to Lord Halifax (bisedë me Mbretin Zog).

<sup>546</sup> PRO-F.O. 371.23713 R 2758/1335/90 Memorandum i Foreign Office, London 4 prill 1939.



kundrejt Gjermanisë<sup>547</sup>. Edhe ikja e Zogut nga Shqipëria më 7 prill 1939, nga britanikët, nuk shihet si një arratisje, por si një ikje nga një situatë e pashpresë, pasi edhe një tërheqje në male për të vazhduar rezistencën, apo një luftë guerile, ishte një plan i perealizueshëm pas qëndrimit jugosllav që nuk do të lejonte që rezistenca shqiptare të zhvillohej, apo të lëvizte drejt kufirit jugosllav<sup>548</sup> e po kështu edhe ai grek<sup>549</sup>. Madje largimi i Zogut drejt Greqisë me mbretëreshën lehonë, i përshkruar me nota tragjike në gazetata britanike do të rriste indinjatën e opinionit anglez ndaj pushtimit italian duke vënë në pozitë edhe vetë qeverinë britanike për qëndrimin që duhej të mbante ndaj agresionit ushtarak të kryer në Shqipëri<sup>550</sup>. Pandaj ndryshe nga vendet e tjera, Britania ishte mikëpritësja e mbretit shqiptar në mërgim, pavarësisht se në miratimin e kërkesës së Zogut për qëndrim në Londër, Foreign Office shpjegonte se qeveria angleze dhe Buckingham Palace (pallati mbretëror) e kishte të vështirë të refuzonte kërkesën e një *ish-mbreti*<sup>551</sup>.

#### BIBLIOGRAFI:

Burime arkivore:

**National Archives (Public Record Office),**

**Foreign Office Archives (FO), (PRO), KEW, London: Viti 1939-** PRO. FO.371. 23710; FO.371. 23711; FO.371. 23712; FO.371. 23713; FO.371. 23714; FO.371. 23715; FO.371. 23716; FO.371. 23717.

#### LITERATURA:

1. **Ciano, G.** “*Diario 1937-1943*”, Torino, 1998.
2. **Della Rocca, R.M.** “*Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*”, Tiranë, 1994.
3. **De Felice, R.** “*Mussolini, il duce, lo stato totalitario 1936-1940*”, Torino, 1981.
4. **Dezhgiu, M.** “*Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*”, Tiranë, 2005.
5. **Duka, V.** “*Histori e Shqipërisë 1912-2000*”, SHBLU, Tiranë, 2007.
6. **Fischer, B. J.** “*Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945*”, Tiranë, 2004.
7. **Fischer, B. J.** “*Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*”, Tiranë, 2004.
8. **Fusco, G.C.** “*Guerra d’Albania*”, Romë, 1961.
9. **Giannini, A.** *L’Albania dall’indipendenza all’unione con l’Italia (1913-1939)*, Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, Varese, 1940.
10. **Historia e Shqipërisë**, Vëll.II, Tiranë, 1965.

<sup>547</sup> PRO-F.O. 371.23713 R 2758/1335/90 Memorandum i Foreign Office , London 4 prill 1939.

<sup>548</sup> B.J.Fischer, “Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945”, Tiranë 2004, f.296.

<sup>549</sup> PRO-F.O. 371.23712 R 2470/1335/90 Foreign Office, minutes, dt.8 prill1939.

<sup>550</sup> PRO-F.O. 371.23716 R 3593/1335/90 Foreign Office, Sir A.Noble, London, dt.24 prill1939.

<sup>551</sup> PRO-F.O. 371 23710 R 5682/ 1335/90 dt.26.6.1939.

11. **Historia e popullit Shqiptar. Periudha e Pavarësisë 1912-1939**, Vëll.III, Tiranë, 2007.
12. **Ivanaj,M.**” *24 orët e fundit të Mbretërisë së Zogut*”, Tiranë, 1997.
13. **Jacques, E.** “*Shqiptarët*”, Tiranë, 1994.
14. **Jakomoni, Fr.** “*Politika e Italisë në Shqipëri*”, Tiranë, 2005.
15. **Jelavich, Barbara**, “*History of Balkans, Twentieth Century*”, Cambridge University Press, 1983.
16. **Kissinger, H.** “*Diplomacia*”, Tiranë, 1999.
17. **Koka,V.**”*Agresioni i Italisë fashiste kundër Shqipërisë dhe qëndresa e popullit shqiptar*”, Tiranë, 1964.
18. **Mellini, A.** “*L’Italia entra in guerra. Gli eventi diplomatici dal 1 gennaio 1939 al 10 giugno 1940*”, Bologna, 1950.
19. **Pavlovitch, Setvan K.**, *A History of the Balkans 1804-1945*, Pearson Education, Longman, London and New York, 1999.
20. **Pearson, O.** “*Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy 1908-1939*”, London, 2004.
21. **Puto, A.** “*Shqipëria politike 1912-1939*”, Tiranë, 2009.
22. **Puto, A.** “*Nëpër analet e diplomacisë angleze*”, Tiranë, 2001.
23. **Puto, A.** “*Ballkani dhe fuqitë e Mëdha*”, *Studime Historike*, 1990, nr.1.
24. **Quaroni, P.** “*Valixhe diplomatike*”, Tiranë, 1993.
25. **Teli (Dibra), P.** “*Shqipëria dhe Diplomacia angleze 1919-1927*”. Tiranë, 2005.
26. **Teli (Dibra), P.** “*Diplomacia angleze, ekuilibrat në Adriatik dhe statusi i Shqipërisë (1918-1925)*”, Phoenix nr.3, Shkodër, 1998, f.63-77.
27. **Smirnova, N.** “*Historia e Shqipërisë përgjatë shek.XX*”, Tiranë, 2004.
28. **Stevens, J.R.** “*Zhvillimet politike në Shqipëri, 1920-1939*”, Tiranë, 2004.
29. **Tomes, Jason**, “*King Zog, self-made monarch of Albania*”, Gloucestershir, 2003.
30. **Zavalani, T.** “*Historia e Shqipnis*”, Tiranë, 1998.
31. **Vickers, M.** “*The Albanians - a Modern History (1995)*”, London: Tauris, 2001.

## **British attitude towards King Zog on the verge of Italian occupation**

### **SUMMARY**

The aim of this article is to present the attitude of british government towards albanian king, Ahmet Zogu, between 1938-1944. In this period, the british attitude was dual towards king Zog, whom Foreign Office described as extremely selfish and well versed in all the methods of old turkish school of politiks and generally able to look after himself, but in the other hand so skill in enternal politiks, and diplomatik orientations. Foreign office’s documentation of these years shows that king Zog was not a proitalian, but the main factor of perturbation and resistance to stop the italians plans. He had not give way and accepted an italian arrangement which made Albania openly an italian protectorate.



Hasan BELLO

## KOLONIA SHQIPTARE E TURQISË DHE VENDOSJA E KONTAKTEVE DIPLOMATIKE ME PERANDORINË OSMANE

Shkëputja e Shqipërisë nga Perandoria Osmane me 1912 nuk e ndali emigrimin e shqiptarëve drejt Turqisë. Megjithëse midis dy shteteve nuk pati ndonjë marrëveshje për shkëmbimin e popullsisë. me 13 maj 1913, qeveria xhonturke njoftonte drejtuesit e vilajetit të Ajdënit se të gjithë ata nxënës shqiptarë që gjendeshin brenda territorit të këtij vilajeti, dhe që prindërit e tyre nuk banonin në Perandorinë Osmane, të riatdhesoheshin<sup>1</sup>.

Një qëndrim më tolerant u tregua ndaj popullsisë shqiptare që vinte nga territoret e pushtuara nga Serbia dhe Greqia. Sipas dokumentacionit, çdo shqiptar që dëshironte të vendosej në Turqi, mjaftonte t'i paraqeste një kërkesë konsullit osman dhe do të pajisej me pasaportë<sup>2</sup>. Për t'i pasur nën kontroll shqiptarët e ardhur nga Manastiri dhe Kosova, me 3 shkurt 1914, ministria e brendshme urdhëronte me anë të një qarkoreje të gjitha vilajetet, se këta të fundit duhet të paraqiteshin brenda pesëmbëdhjetë ditëve në zyrat e regjistrimit të popullsisë për t'u pajisur me dokumente indetifikimi<sup>3</sup>. Me 17 maj qeveria osmane shpërndau një qarkore tjetër, ku ndalonte vendosjen e shqiptarëve në afërsi të zonave ushtarake, si në Çatëllxha, apo në qytete, si: Stambolli, Edirneja dhe Izmiri, nga frika e krijimit të një grupi kompakt etnik<sup>4</sup>. Pasi dihej se në këto qytete, shqiptarët zinin një numër të madh<sup>5</sup>.

Me 31 korrik 1915 kabineti osman mori një vendim sipas të cilit, çdo shqiptar mysliman që braktiste Greqinë, mund të hynte dhe të dilte lirisht në Turqi<sup>6</sup>. Ndërsa me 1 tetor, kryeministri Talat Pasha njoftonte vilajetin e Ankarasë, për të mos lejuar përqendrimin e muhaxhirëve

<sup>1</sup>*Başbakanlık Osmanlı Arşivi (Arkivi i Kryeministrisë së Perandorisë Osmane, më tej BOA), DH.ID. 26-2, 28.*

<sup>2</sup>*BOA, DH. SN. THR. 69, 41.*

<sup>3</sup>*BOA, DH. HMŞ. 30, 65.*

<sup>4</sup>*BOA, DH. EUM. EMN. 2116, 72, 42.*

<sup>5</sup>*BOA, DH. SN. THR. 60, 95.*

<sup>6</sup>*BOA, MV. 198, 101.*

shqiptarë e boshnjakë në një zonë të caktuar; gjithashtu urdhëronte që këta të fundit mos të zinin më shumë se 10% të popullsisë vendase<sup>7</sup>. Pothuajse të gjithë emigrantët shqiptarë që erdhën në Turqi për t'i shpëtuar genocidit sllavo-grek u shpërndanë në brendësi të Anadollit, si në Adana<sup>8</sup>, Ankara<sup>9</sup>, Bafra<sup>10</sup>, Bursa<sup>11</sup>, Dijarbakër<sup>12</sup>, Eregli<sup>13</sup>, Konja<sup>14</sup>, Marash<sup>15</sup> dhe Sivas<sup>16</sup>. Për këtë, në vitin 1917 qeveria xhonturke hartoi dhe një rregullore, sipas së cilës:

- 1) Ndalohej vendosja në territorin e Perandorise Osmane e të gjithë atyre shqiptarëve që më parë kishin marrë pjesë në kryengritje kundër shtetit osman dhe që njiheshin si armiq të popullit turk.
- 2) Pranimi i të krishterëve shqiptarë në Perandorine Osmane shihej me kënaqësi.
- 3) Ndalohej vendosja e shqiptarëve në Stamboll, Edirne, Çatëllxha, Izmit dhe Gelibollu, qoftë tek e tek, qoftë me familjet e tyre. Me përjashtim të atyre që ishin vendosur më parë, por dhe këta, nuk lejohej që t'u shisnin tokat dhe mallin të afërmëve, gjë e cila do të shkaktonte precedent që ata të vendoseshin aty.
- 4) Nuk lejohej përqendrimi i një fisi ose sasive shqiptarësh në një lagje apo zonë të caktuar.
- 5) Ndalohej ndryshimi i vendbanimit pa miratimin e autoriteteve përkatëse.
- 6) Shqiptarët e ardhur në Perandorine Osmane mund të vendoseshin vetëm në disa territore të caktuara<sup>17</sup>.

Duke pasur parasysh numrin e madh të shqiptarëve që emigronin drejt Turqisë dhe frikën e krijimit të zonave me popullsi homogjene, politika e qeverisë xhonturke, e cila njihej për orientimin e saj nacionalist, mund të thuhet se ishte e justifikueshme. Në një kohë lufte, kur ekonomia dhe vendi ishte në gjendje të mjeruar, ardhja e një popullsie nuk do të shihej me sy të mirë, sikurse ndodhte në Perandorine Osmane.

---

<sup>7</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 56, 290.

<sup>8</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 54, 246.

<sup>9</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 44, 158.

<sup>10</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 97, 276.

<sup>11</sup>BOA, *TIGMA*, 272, 11, 32, 14.

<sup>12</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 54, 246.

<sup>13</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 82, 156.

<sup>14</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 44, 158.

<sup>15</sup>BOA, *DH. SN. THR*, 61, 59.

<sup>16</sup>BOA, *DH. ŞFR*, 54, 246.

<sup>17</sup>BOA, *TIGMA*, 272, 14, 74, 9, 15.

Kolonia e shqiptarëve të Turqisë, megjithatë kishte një historik më të hershëm, ishte një nga kolonitë më të mëdha, qoftë për fuqinë ekonomike, qoftë për shkallën e integritit në administratën dhe shoqërinë turke. Por, për arsye të ndryshme kjo koloni nuk ishte organizuar ende siç duhet. Pas tragjedisë që pësoi kombi shqiptar përgjatë Luftërave Ballkanike dhe LPB-së, diçka filloi të lëvizë dhe midis tyre. Kështu me 15 mars 1919, në Stamboll u themelua shoqëria “Bashkimi”. Në kërkesën zyrtare drejtuar ministrisë së brendshme të P. Osmane, shkruhej në shqip “Komiteti i Kolonisë Shqiptare në Turqi”<sup>18</sup>, me qendër në Stamboll, themeluesit e saj ishin Nezir bej Leskoviku, Hasan bej Tetova, Selim Ulvi bej, Mustafa bej, Xhemaletini bej, dr.Ihsan Fevzi bej, Hasan Hajdar bej dhe Hysein Fuat beu nga Prishtina. Në statut theksohej qartë, se qëllimi i kësaj shoqërie do të ishte *përpyekja për bashkimin e trojeve shqiptare, ndihma ndaj çdo bashkëkombasi, lidhja e tyre me idealin kombëtar, dhe mbrojtja e propogandimi i interesave të Shqipërisë* (italic-H.B.). Krijimi i saj nuk ishte i rastësishëm. Me 18 janar 1919 në Paris ishte mbledhur Konferenca e Paqes, ku do të shtrohej për diskutim edhe fati i Shqipërisë.

Ndërkaq, në javën e fundit të dhjetorit 1918, në Shqipëri ishte mbledhur Kongresi i Durrësit. Qeveria e dalë nga ky kongres, krahas një Memorandumi që i kishte dërguar Konferencës së Paqes me 12 shkurt 1919<sup>19</sup> kishte nisur dhe një delegacion në Paris, të përbërë nga Turhan pasha, Mihal Turtulli, Mehmet Konica, Luigj Gurakuqi, Luigj Bumçi, Gjergj Fishta, Mit'hat Frashëri dhe Mustafa Kruja. Në Paris, gjithashtu, kishin mbërritur dhe disa përfaqësues të kolonive shqiptare të Amerikës dhe Rumanisë. Ndërsa kolonia shqiptare e Turqisë dërgoi si përfaqësues të saj Halil pashë Gjirokastrën, Prift Bonatin, Benedikt Blinishtin, Shan Tepelenën, Sulejman Delvinën dhe Fuat Dibrën<sup>20</sup>. Ky i fundit, një patriot i përkushtuar e shkriu pasurinë e tij në shërbim të çështjes kombëtare, qoftë duke marrë përsipër harxhimet e delegacionit të qeverisë shqiptare, qoftë duke paguar gazeta të ndryshme franceze për të lobuar në favor të Shqipërisë<sup>21</sup>. Nga Stambolli, kjo koloni i kishte dërguar dhe një telegram Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Wilson, ku i bënte thirrje për të përkrahur interesat e kombit shqiptar, kundrejt pretendimeve të kryeministrit të Greqisë Venizellos, i cili, kërkonte copëtimin e

<sup>18</sup> Tanık Zafer Tunaya, *Türkiye`de Siyasal Partiler: Mütareke Dönemi 1918-1922*, C.III, Istanbul: “Hürriyet Vakfı Yayınları”, 1986, s.452.

<sup>19</sup> *Shqipëria përpara Konferencës së Paqes*, vëllimi i parë, Romë, 1919, f.7-13.

<sup>20</sup> Mustafa Kruja & P. Paulin Margjokaj, *Letërkëmbim (1947-1958)*, Shkodër: “Camaj-Pipa”, 2006, f.179-181; Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Tiranë, 1928, f.XVI.

<sup>21</sup> *Kultura Islame*, nr.7-8, 1944. f.210; *Bashkimi i Kombit*, 23.11.1944.

Shqipërisë<sup>22</sup>. Në këtë kuadër, po në Stamboll ishin organizuar disa tubime, dhe shkruar protesta, të cilat më pas u ishin dorëzuar përfaqësive diplomatike të Anglisë, Italisë, Francës dhe Amerikës<sup>23</sup>. Kolonia shqiptare e Turqisë, ndoqi me vëmendje dhe shqetësim të madh të gjitha fazat e Konferencës së Paqes, duke dhënë kontributin e saj në drejtim të rikonfirmimit të pavarësisë kombëtare dhe mbrojtjes së territoreve shqiptare nga një copëtim i ri.

Në fillim të janarit 1920 në Shqipëri kishin filluar përgatitjet për mbajtjen e një kongresi kombëtar nga një komision organizues me qendër në Lushnje, i cili, ftonte të gjitha krahinat e vendit të dërgonin në këtë qytet përfaqësuesit e tyre. Nevoja e zëvendësimit të qeverisë së Durrësit me një qeveri të re, e cila do të ndiqte një politikë kombëtare kishte dalë në plan të parë. Kongresi i zhvilloi punimet prej 28 deri më 31 janar 1920. Ai mori në shqyrtim planet e Konferencës së Paqes për copëtimin e Shqipërisë dhe, pasi i hodhi poshtë ato, u shpreh për pavarësi të plotë, duke mos njohur asnjë protektorat apo mandat të huaj. Ai zgjodhi një Këshill të Lartë prej katër vetash, i cili do të përfaqësonte kryetarin e shtetit shqiptar dhe një Këshill Kombëtar ose senat i përbërë nga 37 veta që do të kryente funksionet e parlamentit. Kongresi i Lushnjës analizoi veprimtarinë e qeverisë së Durrësit dhe mori vendimin e tretë të rëndësishëm: e rrëzoi këtë qeveri, veprimtarinë e së cilës e quajti antikombëtare dhe zgjodhi një qeveri të re të kryesuar nga Sulejman Delvina<sup>24</sup>. Vendimet e Kongresit të Lushnjës patën një rëndësi shumë të madhe për të ardhmen e Shqipërisë, sepse, hodhën bazat e një politike kombëtare dhe krijuan institucione kushtetuese, duke i dhënë shtetit shqiptar karakter të pavarur dhe sovran.

Me dëbimin e pushtesve italianë nga Vlora dhe me dështimin e ndërhyrjes së armatosur jugosllave të gusht-shtatorit 1920, për qeverinë shqiptare u krijuan kushte të përshtatshme për të forcuar pozitat e saj në arenën ndërkombëtare. Qeveria e Tiranës tani e zhvendosi vëmendjen e saj nga Konferenca e Paqes në Lidhjen e Kombeve. Me 12 tetor 1920 Pandeli Evangjeli drejtoi kërkesën zyrtare për pranimin e Shqipërisë në këtë organizatë. Por, kjo kërkesë ndeshi në kundërshtimin e Jugosllavisë, Greqisë dhe të Francës, që qëndronte pas tyre. Për pranimin e Shqipërisë në LK këto vinin si kusht caktimin përfundimtar të kufijve dhe njohjen e qeverisë shqiptare *de jure* dhe *de facto* nga shtete të tjera. Edhe Italia, e cila

<sup>22</sup> *Yeni Gün*, 28 Şubat 1920, s.1.

<sup>23</sup> *Peyami Sabah*, 5 Kasım 1921, s.2.

<sup>24</sup> *Dokumente e Materiale Historike nga Lufta e Popullit Shqiptar për Liri e Demokraci 1917-1941*, Tiranë: “Botim i Drejtorisë së Arkivave Shtetërore të R.P.SH”, 1959, f. 21-22.

me votën e saj kërkonte të bënte presion për t'i shkëputur qeverisë shqiptare sa më tepër konçensione, e kundërshtoi në fillim kërkesën shqiptare. Por në LK një rol me rëndësi luante Anglia, interesimi i së cilës për pozitën strategjike të Shqipërisë ishte shumë i madh, ndonëse disa studiues e lidhin këtë interesim me burimet vajguore të saj. Qeveria angleze njoftonte Tiranën se do ta bënte të mundshme pranimin në LK në rast se qeveria shqiptare do t'i jepte shoqërisë vajguore Anglo-Persiane të drejtën ekskluzive për të kërkuar dhe shfrytëzuar vajgurin në Shqipëri<sup>25</sup>. Qeveria e Iliaz Vrionit, e cila në nëntor 1920 zëvendësoi atë të Sulejman Delvinës, e pranoi pa kushte kërkesën e mësipërme angleze. Si pasojë, me propozimin e përfaqësuesve të dy dominioneve britanike, të Afrikës së Jugut dhe të Kanadasë, Asambleja e Përgjithshme e LK e pranoi Shqipërinë më 17 dhjetor 1920 si anëtare me të drejta të plota<sup>26</sup>. Ky pranim kishte rëndësi të veçantë sepse ripohonte në mënyrë kolektive njohjen ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

Zhvillimet e fundit kishin ngjallur entuziazëm tek shqiptarët e Turqisë, megjithëse pozita e tyre politike, për shkak të situatës në të cilën ndodhej shteti osman i pas luftës, ishte mjaft kritike.

Në Konferencën e Paqes, në janar 1919, kishte pasur plane të ndryshme për copëtimin e Perandorisë Osmane, por arritja e marrëveshjes ishte vonuar për shkak të përplasjes së interesave midis fituesve<sup>27</sup>. Greqia që kishte hyrë në luftë vetëm në çastin e fundit, në shkëmbim të premtimeve të bëra nga aleatët, pretendonte të pushtonte Izmirin dhe një pjesë të madhe të Anadollit lindor, duke i justifikuar ambiciet e saj me një lidhje historike midis brigjeve lindore e perëndimore të Egjeut. Këtë pretendim e mbështeste Anglia, nisur nga qëllimi që Egjeun ta kishte nën kontroll një vend mik. Te inkurajuar edhe nga ndjenjat filohelene të kryeministrit britanik Llojd Xhorxh, grekët do t'i hynë aventurës së luftës, përballë së cilës do të vendosen forcat nacionaliste turke të drejtuara nga Mustafa Qemali.

<sup>25</sup> William Bland, *A Tangled Web : a history of Anglo - American relations with Albania : (1912 - 1955)*, London, 1986, p.13; Sejfi Vllamasi, *vep. e cituar.*, f.168.

<sup>26</sup> Vuk Vinaver, *Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë mes dy luftërave botërore*, Gjurmime Albanologjike, 1968, nr.1, f.192.

<sup>27</sup> M.Philips Price, *A history of Turkey from Empire to Republic*, London: "The Macmillan Company", 1956, p.98-99; Harold Nicolson, *Curzon: the Last Phase 1919-1925*, New York: "Houghton and Mifflin Company", 1934, p.95-96; Arnold J.Toynbee, *The Western Question in Greece and Turkey: A study in the contact of civilizations*, Boston: "Houghton and Mifflin Company", 1922, p.73-74.



Nënshkrimi i traktatit të Sevrit me 10 gusht 1920 midis Fuqive të Mëdha dhe P. Osmane e asgjësonte juridikisht këtë të fundit. Territori i saj do të kufizohej në një zonë të vogël në qendër të Anadollit dhe në Stamboll, i cili tashmë gjendej i pushtuar nga forcat aleate. Greqia merrte zonën e Egjeut dhe Trakën lindore; qyteti i Izmirit bashkë me rrethinat e tij, po ashtu vendosej nën administrimin grek për një periudhë prej pesë vjetësh, pas së cilës ajo që mbetej nga popullsia do të lejohej të kërkonte, nëse dëshironte, bashkim të plotë me shtetin grek.

Të gjendur brenda një situatë të tillë, anëtarët e kolonisë shqiptare të Turqisë, disa herë kishin kërkuar nga shteti shqiptar hapjen e një përfaqësie diplomatike. Me 3 qershor 1921, një nga drejtuesit kryesor të kësaj kolonie, Nezir Leskoviku, në një letër drejtuar qeverisë shqiptare i shkruante se, ndonëse kolonia kishte bërë sa kishte mundur për t'u ardhur në ndihmë bashkatdhetarëve të saj, përsëri vështirësitë ishin të mëdha. Sepse, një koloni nuk kishte aq të drejta politike sa ç'mund të kishte një përfaqësues i qeverisë. Dhe si shembull sillte çështjen e pajisjes me pasaporta<sup>28</sup>. Konsullata italiane-shkruante ai-me anë të një letre kishte informuar drejtuesit e kësaj kolonie se, pas një urdhri të qeverisë italiane, ndërpritej lëshimi i pasaportave për shtetasit e huaj. Prandaj, për mos i detyruar shqiptarët që kishin nevojë për pasaporta, t'i luteshin serbëve e grekëve dhe të humbisnin ndjenjat kombëtare, anëtarët e kolonisë i kishin propozuar Halil pashë Gjirokastrës që të merrte përsipër detyrën e përfaqësuesit të Shqipërisë në Turqi. Duke u nisur nga kjo, komiteti drejtues i kolonisë, kërkonte nga qeveria shqiptare se, nëse ishte dakord me këtë veprim, ta pajiste këtë të fundit me letrat kredenciale për t'ia paraqitur kryeministrit të Turqisë. Ose në të kundërtën, mund të dërgohej një person tjetër<sup>29</sup>. Vetëm pas dy javësh, me 17 qershor 1921, erdhi dhe përgjigjja e kryeministrit Iliaz Vrioni, i cili, pasi e falënderonte komitetin drejtues të kolonisë mbi kërkesat e parashtruara më sipër, i bënte të ditur se, për arsye politike tani për tani qeveria shqiptare nuk e shihte të arsyeshme hapjen e një përfaqësie diplomatike në Stamboll. Dhe se kur të vinte koha, qeveria nuk do ngurronte të emëronte një përfaqësues, i cili do ta përfaqësonte atë më së miri. Duke marrë parasysh mbrojtjen e interesave të qytetarëve shqiptarë në Turqi, kjo qeveri, parapëlqente më së shumti hapjen e një Zyre Pasaportash nën kryesinë e z. Nezir Leskoviku. Me që kryetari i kësaj zyre, do të ishte atje i vetmi autoritet me kualitet zyrtar, ngarkohej gjithashtu, kur ta donte

<sup>28</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej, AMPJ)*, Dos.4, Viti.1921, fl.74-75.

Letër e Komitetit të Kolonisë Shqiptare të Turqisë, drejtuar qeverisë shqiptare.

<sup>29</sup> *Po aty*.

nevoja, dhe me mbrojtjen e interesave të shqiptarëve. Bashkë me letrat kredenciale, kryeministri porosiste që të shtypeshin edhe disa pasaporta, dhe të regjistroheshin të gjithë shqiptarët që ishin nga vendet e Shqipërisë së 1913-tës, duke i dhënë atyre nga një dokument identiteti<sup>30</sup>.

Një kërkesë të ngjashme qeverisë shqiptare i dërguan dhe shqiptarët e Izmirit me 15 korrik të 1921. Ata vinin në dukje se me mijëra familje të kësaj kolonie ishin në gjendje të mjerueshme dhe pa zot, nga shkakut i mospasjes së një përfaqësuesi të vendit të tyre apo ndonjë shtet mbrojtës si kombet e tjera. Autoritetet e ushtrisë greke që kishin pushtuar këtë qytet, i konsideronin si subjekt turk, i ndalonin të lëviznin lirshëm dhe nuk i njihnin pasaportat e tyre. Prandaj, nëse nuk shihej e arsyeshme dërgimi i një përfaqësuesi hë për hë, detyra e mbrojtjes së popullsisë shqiptare të Izmirit t'i ngarkohej një shteti tjetër<sup>31</sup>. Po kjo koloni, me 22 gusht 1921, informonte kryeministrin shqiptar mbi një mbledhje të organizuar në 10 gusht, ku ishte diskutuar në lidhje me situatën politike dhe ekonomike të anëtarëve të saj (kolonisë). Sipas tyre, deri në kohën kur Himara iu aneksua qeverisë shqiptare, marrëdhëniet midis kësaj kolonie dhe autoriteteve greke kishin qenë normale, por, pas kësaj, situata kishte ndryshuar. Tani e tutje, grekët, i ndalonin të dilnin dhe të hynin në Izmir, dhe nga një rekuizion i bërë disa muaj më parë, ushtria greke i kishte konfiskuar shqiptarëve kuaj, karroca dhe mallra të tjera duke i paguar vetëm një të tretën e vlerës reale. Bile, shumicës së shqiptarëve nuk u kishte dhënë asgjë. Demarshet e bëra për këtë, nuk ishin marrë aspak parasysh. Prandaj, edhe një herë ata i luteshin qeverisë shqiptare të dërgonte një përfaqësues të saj në Izmir, me premtimin se kjo koloni merrte përsipër të gjitha shpenzimet e duhura. Ose, këtë mund t'ia ngarkonte si detyrë konsullatës italiane, sepse, nga të dhënat që kishin qeveria greke mund t'i merrte si ushtarë, siç kishte marrë armenët dhe thrakët, por edhe mund t'i dëbonte fare nga Izmiri<sup>32</sup>.

Lidhur me kërkesën e qeverisë shqiptare për hapjen e një Zyre Pasaportash, Perandoria Osmane nuk shfaqti asnjë kundërshtim. Ahmet Izet pasha, i cili tashmë mbante postin e ministrit të jashtëm, në përgjigjen drejtuar homologut shqiptar, i vinte në dukje atij se, për këtë, midis dy qeverive do të ishte mirë të nënshkruhej dhe një marrëveshje<sup>33</sup>. Me 15

<sup>30</sup> *Po aty.*, fl.76. Letër e Kryeministrit dhe zv/Ministrit të Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni, drejtuar Komitetit të Kolonisë Shqiptare të Turqisë.

<sup>31</sup> *Po aty.*, fl.29. Letër e degës së kolonisë shqiptare të Izmirit, drejtuar Kryeministrit Iliaz Vrioni.

<sup>32</sup> *Po aty.*, fl.133-134.

<sup>33</sup> *Po aty.*, Letër e Ministrit të Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane Ahmet Izet pasha, drejtuar Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, 30.6.1921.

korrik 1921, Nezir Leskoviku, njoftonte kryeministrin Iliaz Vrioni mbi dorëzimin e letërkredencialeve: “*Letrën, Ministrit të Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, Ahmet Izet pashës, ia dhashë, më priti shumë mirë dhe shfaqti një simpati për Shqipërinë, duke më thënë se «...nga thelbi i zemrës dëshiroj të mirën e Shqipërisë dhe lehtësimin e punës Tuaj, letrën që më dhatë do t’ia japë Këshillit Ministror»*”<sup>34</sup>. Mbas tre ditësh, Nezir Leskoviku, kishte pasur dhe një takim me drejtorin e zyrës së posaçme, i cili, i kishte pohuar atij se qeveria osmane e shihte me nota pozitive hapjen e zyrës së pasaportave, prandaj ai mund të punonte lirshëm. Por, për t’u marrë vesh zyrtarisht duhej që midis dy palëve të nënshkruhej një konventë, e cila bënte fjalë për interesat e përbashkëta. Dhe pas nënshkrimit të kësaj konvente, ai mund të njihej direkt si konsull i Shqipërisë. Nezir Leskoviku informonte gjithashtu dhe mbi takimin që kishte pasur me Komisararin e Lartë të Italisë, urimet që ky i kishte shfaqur, dhe nevojën e shqiptarëve për çertifikata e karta identiteti<sup>35</sup>.

Qeveria shqiptare i dha një rëndësi të veçantë vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Perandorinë Osmane, kjo vihet re dhe nga fakti se vetëm disa ditë më vonë, me 5 gusht 1921, Këshilli i Ministrave vendosi që zyra e pasaportave të kthehej në konsullatë. Në krye të së cilës do të ishte përsëri Nezir Leskoviku, dhe si sekretar i tij emërohej Asaf Xhaxhuli<sup>36</sup>. Nga ana tjetër, Ministria e Jashtme bëri disa demarshe pranë përfaqësive të Anglisë dhe Italisë, dhe porositi delegacionin shqiptar në Paris, t’i shkruante një lutje Ministrisë së Jashtme Franceze, ku t’i kërkohej që të instruktonte diplomatët e saj në Stamboll, për të njohur zyrtarisht kalitetin e kësaj zyre<sup>37</sup>. Me 20 shtator 1921, Nezir Leskoviku njoftonte qeverinë se, përfaqësuesit e këtyre shteteve e kishin njohur më në fund statusin e tij diplomatik<sup>38</sup>.

Megjithë përpjekjet e shtetit shqiptar për t’i ardhur në ndihmë kolonisë shqiptare të Turqisë, vonesën e shtypjes së pasaportave apo pengesa të tjera të këtij lloji, nuk munguan ta shfrytëzojnë klubet epiriote të

<sup>34</sup>*Po aty.*, fl.101. Letër e drejtorit të Zyrës së Pasaportave në Stamboll Nezir Leskoviku, për Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni.

<sup>35</sup>*Po aty.*, fl.102.

<sup>36</sup>*Po aty.*, fl.118. Letër e Kryeministrin Iliaz Vrioni, për drejtorin e Zyrës së Pasaportave në Stamboll Nezir Leskoviku.

<sup>37</sup>*Po aty.*, fl.139. Letër e Kryeministrin Iliaz Vrioni, për drejtorin e Zyrës së Pasaportave në Stamboll Nezir Leskoviku.

<sup>38</sup>*Po aty.*, fl.170. Letër e drejtorit të Zyrës së Pasaportave në Stamboll Nezir Leskoviku, për Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni.

cilët punonin për llogari të Greqisë<sup>39</sup>. E nderë vazhdoi të mbetej situata edhe për shqiptarët e Izmirit, nënkryetari i kësaj kolonije, me 9 gusht 1922 njoftonte Kryeministrin Xhaferr Ypi se kolonia e Izmirit, e cila përbëhej nga më shumë se 2500 frymë kishte nevojë të madhe për një mbrojtës, se qeveria e Greqisë ishte duke i munduar së tepërmi, duke i marrë ushtarë, burgosur apo vendosur taksa të rënda. Dermashve të bëra nga kryesia e kolonisë, grekët i përgjigjeshin se ata ende nuk e njihnin qeverinë e Shqipërisë, dhe se të gjithë shqiptarët do t'i konsideronin si turq<sup>40</sup>. E pafuqishme për të bërë diçka tjetër, qeveria shqiptare urdhëroi përfaqësuesin e saj në Londër, Mehmet Konicën, të ndërhynte pranë qeverisë angleze që të kishte mirësinë dhe të interesohej për fatin e nënshtetasve shqiptarë në Turqi, që gjendeshin pa asnjë përkrahje, dhe t'i tërhiqte vërejtjen qeverisë greke për të ndaluar përndjekjet dhe masat armiqësore kundër tyre<sup>41</sup>.

Rivalitetin midis forcave politike brenda vendit, pati persona që tentuan ta përçojnë dhe tek shqiptarët e Turqisë. Nezir Leskoviku, informonte Kryeministrin Xhaferr Ypi, se në Stamboll disa shqiptarë të ardhur nga Shqipëria, me fjalimet e tyre po mbillnin farën e përçarjes. Duke thënë se *“Toskët e kanë marrë qeverinë në dorë dhe gegëve më s’u japin punë; pra, duhet të kundërshtojmë e të thyejmë këtë sjellje, etj...”*<sup>42</sup>. Sipas tij, këta ishin Avni Gjilani, Zija Dibra dhe dy persona të tjerë, fjalët e tyre ndonëse nuk kishin gjetur aspak vend midis atdhetarëve të vërtetë, përsëri duheshin marrë masa për ta ndaluar një gjë të tillë<sup>43</sup>. Për këtë, në Stamboll u dërgua Hafiz Ismet Dibra, i cili, sipas udhëzimeve të Ministrit të Punëve të Brendshme Ahmet Zogu, duhet të bënte propagandë ndërmjet shqiptarëve myslimanë që ndodheshin atje, në dobi të shtetit shqiptar<sup>44</sup>.

<sup>39</sup> *Po aty.*, fl.32-33. Letër e drejtorit të Zyrës së Pasaportave në Stamboll Nezir Leskoviku, për Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme Iliaz Vrioni, 1.9.1921.

<sup>40</sup> *Po aty.*, dos.103, fl.1-2. Letër e nënkryetarit të kolonisë së Izmirit, drejtuar Kryeministrit dhe zëv.Ministrit të Punëve të Jashtme Xhaferr Ypi.

<sup>41</sup> *Po aty.*, fl.4. Letër e Kryeministrit dhe zëv.Ministrit të Punëve të Jashtme Xhaferr Ypi, për Mehmet Konicën, 31.8.1922.

<sup>42</sup> *Po aty.*, dos.57, fl.141. Letër e drejtorit të Zyrës së Pasaportave në Stamboll Nezir Leskoviku, për Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme Xhaferr Ypi, 12.8.1922.

<sup>43</sup> *Po aty.*, fl.141.

<sup>44</sup> *Po aty.*, dos.150, fl.37. Letër e Ministrit të Brendshëm Ahmet Zogu, për Ministrin e Punëve të Jashtme, 15.2.1923.

**BIBLIOGRAFI:**

1. Tarik Zafer Tunaya, *Turkiye de Siyasal Partiler: Mutareke Donemi 1918-1922*, C. III, Istanbul: "Hurriyet Vakfi Yayinlari", 1986.
2. *Shqipëria përpara Konferencës së Paqes*, vëllimi i parë, Romë, 1919.
3. Mustafa Kruja & Paulin Margjokaj, *Letërkëmbim (1947-1958)*, Shkodër: "Camaj-Pipa", 2006.
4. Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Tiranë, 1928.
5. *Kultura Islame*, nr. 7-8, 1944.
6. *Bashkimi i Kombit*, v. 1944.
7. Yeni Gun, 1920
8. Peyami Sabah, 1921.
9. *Dokumente e Materiale Historike nga Lufta e Popullit Shqiptar për Liri e Demokraci 1917-1941*, Tiranë, 1959.
10. William Bland, *A Trangled Web: a history of Anglo-American relations with Albania: (1912-1955)*, London, 1986.
11. Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri*, Shtëpia botuese "Barleti", Tiranë, 1995.
12. Vuk Vinaver, *Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy luftërave botërore*, *Gjurmime Albanologjike*, 1968
13. M. Philips Price, *A history of Turkey from Empire to Republic*, "The Macmillan Company", 1956
14. Harold Nicolson, *Curzon: the Last Phase 1919-1925*, New York: "Houghton and Mifflin Company", 1934.
15. Arnold Toynbee, *The Western Question in Greece and Turkey: A study in the contact of civilizations*, Boston: "Houghton and Mifflin Company", 1922.

**Albanian emigrants in Turkey and the establishment of diplomatic relations with the Ottoman Empire****SUMMARY**

Albanian's detachment from the Ottoman Empire didn't stop the emigration of the citizens from Albania to Turkey. Ottoman government's hospitality welcomed the establishment of the Albanians in their territory, with a condition which was to settle in certain places.

In the Peace Conference, the Albanians of Turkey gave an important contribution in defending the national interests of Albania. The first diplomatic relations between the two states were settled with the encouragement of these emigrants.

**Sokol AXHEMI****EVOLUCIONI I HAPËSIRËS SOCIALE TË  
ARGËTIMIT NË SHQIPËRI.  
TENDENCA DHE PERSPEKTIVA*****Hyrje***

Në kuadrin e studimeve të ndryshme gjeografike, sidomos të karakterit human, këndvështrimi mbi tematikat sociale, jo vetëm që po gjen gjithnjë e më tepër pasqyrim, por po rritet njëkohësisht edhe karakteri analitik i trajtimit të tyre. Krahas studimeve që realizohen për hapësirën socio-gjeografike, tiparet dhe veçoritë e saj, për grupet sociale që veprojnë në këtë hapësirë socio-gjeografike, rolin në ndryshimin dhe transformimin e saj, interes po marrin gjithnjë e më tepër edhe analizat shkencore që orientohen drejt kontributit që japin në një hapësirë të caktuar socio-gjeografike, vendet dhe funksionet sociale. Orientimi drejt studimit të tyre paraqitet interesant nga pikëpamja shkencore në dy drejtime. Së pari lidhet ngusht me faktin e zgjerimit të vazhdueshëm të disiplinës gjeografike, konkretisht të gjeografisë sociale, në studimin e tematikave sociale. Së dyti, vendet dhe funksionet sociale, përfaqësojnë sot një nga elementet më të prekshëm dhe më të përdorshëm në aktivitetin e tyre nga grupet sociale në hapësira të ndryshme socio-gjeografike, gjë që ka rritur së tepërmi rëndësinë e studimit të tyre.

Krahas vendeve dhe funksioneve sociale themelore të banimit, prodhimit, shkëmbimit dhe pushtetit, radhiten edhe ato të argëtimit. Vendet dhe funksionet sociale të argëtimit, në mënyrë të veçantë gjatë fundit të shekullit të kaluar dhe në ditët e sotme, paraqiten mjaft komplekse nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre, evolucionit shumë intensiv të transformimit të tyre, larmishmërisë dhe pasurimit gjithnjë e në rritje. Mjaft të evidentuara këto karakteristika e tipare të tyre shfaqen në kuadrin e shpërndarjes gjeografike, në hapësira të caktuara socio - gjeografike.

Nisur nga një këndvështrim i tillë kemi bërë përpjekje për të dhënë në materialin e mëposhtëm një analizë të vendit dhe të funksionit social të

argëtimit në vendin tonë. Padyshim hapësira jonë socio-gjeografike paraqet tipare dhe veçori interesante jo vetëm në tërësinë e saj, por edhe në kuadrin e shpërndarjes gjeografike. Evolucionin e pësuar lidhur ngusht me periudhat e ndryshme të ecures së shoqërisë shqiptare ka lënë gjurmët e veta edhe në drejtim të aktivitetit të argëtimit, ndonëse tipari themelor i tij, është pasurimi në vazhdimësi i tij. Një gjë e tillë është e lidhur ngushtë me faktin se grupet sociale ndajnë domosdoshmërinë e kultivimit të shijeve për muzikën, pikturën, artin në tërësi, sportet e llojeve të ndryshme. Tërësinë e këtyre aktiviteteve ato dëshirojnë t'i ndjekin në vende të larmishme sociale, salla koncertale apo teatri, sallat e operave apo pallate sporti e stadione sportive.

### **Vendet sociale të argëtimit në Shqipëri**

Hapësira socio-gjeografike në tërësinë e saj paraqitet shumë e larmishme në drejtim të ofertës për vende të ndryshme sociale. Në këtë kuadër krahas vendeve të larmishme sociale të banimit, të prodhimit, të shkëmbimit dhe të pushtetit në këtë hapësirë socio-gjeografike evidentohen edhe vendet sociale të argëtimit. Padyshim një analizë më e detajuar bën të mundur që në sensin praktik të kësaj hapësire socio-gjeografike të dallosh qartë se, ndërmjet shtëpive dhe apartamenteve të ndryshme, vilave dhe rezidencave, punishteve dhe fabrikave, spitaleve, shkollave dhe universiteteve, marketeve e dyqaneve të ndryshme e të shumta, bashkive dhe njësisive të tjera administrative vendore, parlamenteve apo selive të qeverive të ndryshme, janë të pranishme në lloje e përmasa të ndryshme edhe kafenetë e ndryshme, baret e restorantet të llojeve të ndryshme, diskotekat, pubet, bibliotekat e ndryshme, shtëpitë e pushimit, sallat e lojërave, stadiomet e qendrat sportive, pallatet e sportit, teatrot, etj.

Theksojmë se në këndvështrimin e përgjithshëm shkencor “*tërësia e vendeve sociale të argëtimit ka si qëllim apo mision të saj realizimin e një relaksi dhe argëtimit për popullsinë, kënaqjen e interesave në drejtim të çlodhjes e pushimit që ato duhet apo dëshirojnë të realizojnë, kënaqësive individuale apo kolektive të tyre. Një gjë e tillë njerëzit, individët, grupet sociale e realizojnë në drejtime të ndryshme, artistike, sportive, kulinare, mjekësore, dietike, estetike, etj.*”(3)

Shqipëria krahas aktiviteteve të tjera vlerësohet edhe për kontributin në drejtim të pranisë në hapësirën e saj socio-gjeografike të vendeve sociale të argëtimit. Është një fakt konkret që në tërësinë e njësisive administrative të ndryshme të vendit, janë të pranishme teatro të përmasave të ndryshme, salla koncertesh, stadione e salla të shumta lojërash, kinema, pube, disko,

etj. Në mënyrë të veçantë duhet vlerësuar fakti se dendësia me e madhe e tyre, komoditeti dhe standardet bashkëkohore të arkitekturës dhe efikasitetit të tyre janë në kryeqytet, Tiranë dhe në qendrat e mëdha urbane, si: Durrësi, Shkodra, Vlora, Fieri, Korca, Elbasani, etj.

Në lidhje të ngushtë me rritjen gjithnjë e më tepër të vendeve të tilla sociale, evidentohet edhe pasurimi i vazhdueshëm i vetë funksionit social të argëtimit. Në këtë mënyrë duke u rritur gjithnjë e më shumë shkalla e specializimit e degëve të ndryshme të muzikës, teatrit, dramës apo komedisë nga njëra anë si pjesë përbërëse e artit në tërësi, evidentohet edhe pasurimi gjithnjë e më i madh i vendeve sociale. Një gjë e tillë ka ndikuar dukshëm edhe në drejtim të rritjes dhe zhvillimit edhe të mjaft vendeve të reja sociale që u shërbejnë aktiviteteve të tilla kulturore e argëtuese. Theksojmë se në kuadrin e shpërndarjes gjeografike të tyre evidentohen dallime të qarta. Kështu në mënyrë të veçantë në qendrat e mëdha urbane, në të cilat është grumbulluar një numër i konsiderueshëm i popullsisë, është bërë e mundur lindja e mjaft galerive të reja të pikturës, kryesisht të karakterit privat, salla teatroshe të reja të përmasave të ndryshme, kryesisht pjesë e institucioneve shtetërore, por ka edhe tendenca të rolit të investitorëve privatë, kryesisht artistë të profesioneve të ndryshme.

Gjithashtu një faktor tjetër mjaft ndikues në kuadrin e shpërndarjes gjeografike të këtyre vendeve të reja sociale të argëtimit që përfshijnë Tiranën, Shkodrën, Korçën, Vlorën, Durrësin, etj., është edhe prania e një tradite në këto qendra të rëndësishme të zhvillimit urban. Shumë studio muzikore e salla koncertale, teatro të llojeve e përmasave të ndryshme, tashmë i kemi prezente si në territoret qendrore të këtyre qendrave urbane, ashtu edhe në ato periferike, të cilat shërbejnë për argëtimin e grupeve të ndryshme sociale.

Po kështu në drejtim të çlodhjes dhe rekreacionit të individëve dhe grupeve të ndryshme sociale, janë të pranishme në tërësinë e qyteteve të Shqipërisë pube dhe disko, salla lojërash, të llojeve dhe përmasave të ndryshme, të cilat përgjithësisht përfaqësojnë investime të karakterit privat. Por duhet vlerësuar se në lidhje me funksionimin dhe ecurinë e tyre si në drejtim të programacionit dhe frekuentimit të tyre dallohen ndryshime të rëndësishme në kuadrin e shpërndarjes gjeografike të tyre. Një gjë e tillë është në përqendrimin e popullsisë, lëvizjes migrative të saj e në mënyrë të veçantë me faktorin social, zhvillimin e diversitetit kulturor e social në hapësira të ndryshme të Shqipërisë.

Theksojmë se pasurimi i funksioneve sociale, shoqëruar me gjenerimin e vendeve të reja sociale, ka luajtur një rol të konsiderueshëm edhe në gjallërimin e jetës sociale, apo të tërësisë së këtyre hapësirave



socio-gjeografike. Evidentohet në të njëjtën kohë edhe ndikimi në fluksin turistik, kryesisht gjatë sezonit turistik veror, ku mjaft prej këtyre vendeve të reja sociale të argëtimit po kthehen në qendra të rëndësishme të organizimit të eventeve muzikore, teatrore, koncertale, të arteve figurative, filmike të karakterit ndërkombëtar. Shembuj të tillë janë të shumtë duke përfshirë në mënyrë të veçantë edhe qytetet turistike të tilla, si: Durrësi, Saranda, Vlora, Korça, Shkodra, Tirana, Gjirokastra, etj.

Megjithatë vlerësojmë faktin se prania e vendeve sociale të argëtimit është prezente edhe në qendrat e vogla urbane në Shqipëri, e njëkohësisht edhe në qendrat e medha rurale, lidhur ngusht me tradicionin kulturor, artistik e sportiv që mbizotëron në këto hapësira socio-gjeografike. Ndonëse vihen re disnivele përsa i përket pjesëmarrjes së individëve dhe grupeve sociale, të gjinive dhe moshave të ndryshme, përsëri në këto qendra të vogla urbane dhe qendra të mëdha rurale evidentohet prania e sallave koncertale, kinemave, sallave të ndryshme sportive, etj.

Një përhapje kaq e gjerë e vendeve sociale të argëtimit në tërësinë e qendrave rurale dhe urbane të Shqipërisë, pavarësisht dimensioneve të tyre të ndryshme në to dhe njëkohësisht numrit dhe përqendrimit të tyre, i dedikohet bashkëveprimi të ngushtë të dy faktorëve kryesorë ndikues, faktorit ekonomik dhe faktorit social. Pikërisht në varësi të zhvillimit të ndryshëm ekonomik dhe social që ka prekur hapësirat e ndryshme socio-gjeografike urbane dhe rurale në Shqipëri evidentojnë një zhvillim të ndryshëm edhe të vendeve sociale të argëtimit.

Në momentin që marrim në analizë rolin e zhvillimit ekonomik në evolucionin dhe zhvillimin e vendeve sociale në përgjithësi, dhe të argëtimit në veçanti evidentojmë një rol të dyfishtë të tij. Së pari, me zhvillimin ekonomik konsiderojmë suportimin shtetëror në drejtim të përsosjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të vendeve sociale të argëtimit, lidhur ngusht me investimet e realizuara në fushat e ndryshme të artit (muzikë, pikturë, arte figurative, teatro, salla koncertale, qendra të ndryshme muzikore), ose në vendet sociale sportive të përmasave e dimensioneve të ndryshme, si: salla sportive, salla lojërash, stadiume, pallate sportive, palestra, pishina, etj.. Njëkohësisht rolin e faktorit ekonomik e shohim të lidhur ngushtë edhe me faktin e ndryshimeve të rëndësishme të ndodhura në Shqipërinë e pas viteve 1990, ku kemi rilindjen dhe gjallërimin gjithnjë e në rritje të sektorit privat. Në këtë mënyrë mjaft investitorë duke parë mundësinë e fitimeve në fushën e ndërtimit të vendeve sociale të argëtimit janë përfshirë në sipërmarrje të tilla të suksesshme. Shembuj konkretë mund të vërejmë në territoret periferike të Tiranës (teatri “Kamë”, në

Mullet, kompleksi “Blur”, mjaft galeri arti në qytete të ndryshme të vendit), shumë disko e pube, fusha sportive e kalçeto të përmasave të ndryshme, pishina, palestra, fitness centre, etj..

Së dyti, një element tjetër që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik, si faktor i rëndësishëm, ndikues në zhvillimin dhe përsosjen e vendeve sociale, është edhe rritja gjithnjë e më e madhe e mundësisë që grupe të ndryshme sociale të frekuentojnë këto vende sociale argëtimi. Individë e grupe sociale, të moshave dhe gjinive të ndryshme, të arsimit e të kualifikimit të ndryshëm, bëjnë të mundur që nëpërmjet frekuentimit të këtyre vendeve sociale të argëtimit, të mund të realizojnë jo vetëm karakterin relaksues të tyre, por edhe realizimin e sigurimit të një fitimi për sipërmarrësit privat, duke i bërë në këtë mënyrë mjaft efektive investimet e biznesit privat në Shqipëri, që orientohet në drejtim të investimeve në fushën e vendeve sociale të argëtimit.

Një faktor tjetër mjaft ndikues në lindjen, zhvillimin dhe përsosjen e mëtejshme të vendeve sociale të argëtimit është edhe faktori social. Theksojmë se Shqipëria dallon në tërësinë e hapësirës së saj socio-gjeografike nuanca të ndryshme të zhvillimit social. Hapësira të ndryshme urbane apo rurale dallojnë nga njëra-tjetra edhe në drejtim të psikologjisë sociale të tyre, mentalitetit, trashëgimisë së shfaqur edhe në drejtim të vetë vendeve sociale të argëtimit.

Hapësira të veçanta janë dalluar në vite për organizimin e mjaft eventeve muzikore të njohura jo vetëm në Shqipëri, por edhe në arenën ndërkombëtare. Si të tilla mund të përmendim festivalin folklorik të Gjirokastrës, festivale të rapsodëve të ndryshëm popullorë që zhvilloheshin në Pukë, Mirditë, “odën dibrane” që zhvillohej në Peshkopi, festivalet e lojërave popullore në Shkodër apo në hapësira të ndryshme të tjera të Shqipërisë. Një gjë e tillë ishte një element mjaft tradicional, që për hapësira të ndryshme, sidomos pas viteve 1990 zbehu deri diku aspektin tradicional të organizimit të tyre, për shkak të mosrealizimit të tyre për një kohë të gjatë. Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe kemi lindjen e vendeve të reja sociale të argëtimit, lidhur ngusht me pasurimin gjithnjë e në rritje që vetë funksioni social i argëtimit pësoi, gjë që lidhet me vetë rritjen dhe zhvillimin e mjaft aktiviteteve të reja nga individët dhe grupet sociale tepër të larmishme në këto hapësira socio-gjeografike. Megjithatë hapja e pubeve apo diskove të ndryshme, sallave rekreative të dimensioneve të ndryshme u pritën në mënyra të ndryshme në hapësira të ndryshme, lidhur ngusht pikërisht me shkallën e zhvillimit të psikologjisë sociale e mentalitetin e këtyre hapësirave të veçanta socio-gjeografike.

Suportimi social i vendeve të reja sociale të argëtimit ishte më aktiv, më i mirëpritur në qendrat e mëdha urbane, se sa në ato të vogla urbane apo në zonat rurale. Gjithsesi me kalimin e viteve vihet re gjithnjë e më shumë një rënie e dallimeve ndërmjet këtyre qendrave urbane ndërmjet njëra-tjetrës në drejtim të frekuentimit të vendeve sociale. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur jo vetëm zhvillimi social i vetë këtyre hapësirave, por edhe efekti migrator i brendshëm dhe i jashtëm.

Nga pikëpamja e vendosjes së tërësisë së vendeve sociale të argëtimit në kuadrin e arkitekturës së një hapësire të caktuar socio-gjeografike, vihet re një balancim ndërmjet vendeve tradicionale në raport me vendet e reja sociale të argëtimit. Në të njëjtën kohë një raport i tillë vendosjese i këtyre vendeve sociale të argëtimit ruhet në kuadrin e hapësirave të ndryshme socio-gjeografike. Në këtë mënyrë vërejmë se sallat koncertale, teatrot apo galeritë kryesore të artit, së bashku me sallat e lojërave janë të vendosura në pjesët qendrore të hapësirave urbane apo rurale. Ndërsa vendet e reja sociale të argëtimit, kryesisht qendrat e mëdha multifunkionale sportive apo artistike përgjithësisht janë të vendosura në pjesët periferike të këtyre hapësirave.

Në këtë drejtim një shembull i veçantë i prishjes së këtyre raporteve paraqitet Tirana, qendra më e madhe urbane e vendit, e cila përfaqëson një vendosje jo unifome apo unike të këtyre vendeve tradicionale apo të reja të vendeve sociale të argëtimit. Një mënyrë e tillë vendosjeje ka sjelle që pubet, diskot, sallat sportive, galerite e artit, kalçetot, etj., të jenë pjesë përbërëse e godinave të mëdha të banimit, ose të vendosura në pjesë të ndryshme të tërësisë së shtrirjes së kësaj hapësire socio-gjeografike. Padyshim në lidhje me një vendosje të tillë, por jo vetëm të vendeve sociale të argëtimit, por edhe të vendeve të tjera sociale, përfaqësojnë sot një nga debatet më të diskutuara.

Theksojmë se në kuadrin e transformimeve të rëndësishme që evidentohen në hapësira të ndryshme socio-gjeografike, kanë ndikuar edhe në pasurimin e mjaft aktiviteteve argëtuese, kryesisht në drejtim të vendeve të reja sociale. Kjo ka sjellë që në kuadrin e këtyre vendeve të integrohen edhe vendet sociale turistike, vendet sociale religjioze, etj. Vendet sociale të argëtimit gjithnjë e më shumë po grupohen në një objekt të vetëm multifunksional, në kuadrin e qendrave të mëdha të argëtimit që ofrojnë baret e restorantet, por edhe teatrot e koncertet, edhe lojërat sportive, por edhe kazinotë apo llojet e tjera të kënaqësisë dhe argëtimit.

### **Aktiviteti social i argëtimit në Shqipëri**

Njerëzit, individët, grupet e ndryshme sociale, gjatë aktivitetit të tyre në vendet sociale të argëtimit, të cituara më sipër, krijojnë marrëdhënie dhe raporte të ndryshme ndërmjet tyre. Ky aktivitet, veprimtari që ato realizojnë përfaqëson nga pikëpamja shkencore konceptin e funksionit social të argëtimit.

Shqipëria dallohet tradicionalisht për praninë e llojeve të ndryshme të aktiviteteve sociale argëtuese në hapësira të ndryshme socio-gjeografike. Shumë prej tyre jo vetëm që i kanë qëndruar kohës, por edhe po përsosen, duke rritur rolin dhe rëndësinë e tyre. Aktivitete të tilla sociale argëtuese kanë ndikuar dukshëm edhe në rritjen, fuqizimin dhe pasurimin e funksionit social të argëtimit. Në këto aktivitete sociale të ndryshme, individë dhe grupe sociale jo vetëm bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për organizimin e tyre, por edhe rrisin dhe shtojnë ndërveprimin dhe marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Si rezultat i këtij funksioni social argëtimi, grupe dhe individë të fushave të ndryshme, të sportit, muzikës, pikturës, etj., kontribuojnë në hapësira të ndryshme socio-gjeografike të vendit.

Këto aktivitete gjithnjë e më tepër po pasurohen duke bërë të mundur që eventet e tilla sportive, artistike e kulturore të krijojnë mundësinë e përfshirjes së tyre në guidat e ndryshme turistike. Një gjë e tillë po rrit e zgjeron në vazhdimësi jo vetëm emërtimin dhe *‘shënjimin’* e hapësirave të ndryshme socio-gjeografike në Shqipëri me eventin përkatës, por edhe pjesëmarrjen e individëve dhe grupeve të ndryshme sociale në to. Si shembuj konkret mund të përmendim festivalet e teatrove në Sarandë, gurrat popullore në Pukë, *“odën dibrane”* në Peshkopi, festivalet e filmit në Durrës, bienalet në Tiranë, karnavalet në Shkodër e Korçë, festën e birrës në Korçë, maratonën e këngës popullore nëpër qytete të ndryshme të Shqipërisë gjatë sezonit turistik, etj.

Në kuadrin e funksionit social të argëtimit në Shqipëri duhen evidentuar edhe mjaft risi, lidhur ngusht me pasurimin e tij. Risi të tilla janë tregues edhe i ndryshimeve të rëndësishme socialekonomike dhe politike, që prekën Shqipërinë e pas 1990. Aktualisht evidentohen mjaft aktivitete të reja të karakterit argëtues, të cilat janë shoqëruar domosdoshmërisht edhe me praninë e vendeve të reja sociale të argëtimit. Hapja e Shqipërisë me vendosjen e sistemit demokratik pas vitit 1990, kontakti me aktivitetet e ndryshme argëtuese në vendet e tjera evropiane dhe me gjerë, risitë e zhvillimit teknologjik, pasurimi i jetës sociale dhe ekonomike, të shtresave të ndryshme sociale në vendin tonë, janë disa nga faktorët kryesorë të përsosjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të funksionit social të argëtimit. Nisur nga ndikimi i këtyre faktorëve të sipërpërmendur është shtuar dhe pasuruar se tepërmi aktiviteti social i argëtimit, madje mund të evidentojmë

se sot ai paraqitet multidimensional. Njëkohësisht gjithnjë e më tepër po zgjerohet edhe aktiviteti turistik në destinacione të rëndësishme turistike bregdetare, liqenore, alpine, kulturore, sportive, religjioze, etj.

Funksioni social i argëtimit dallon për larminë dhe shumëllojshmërinë e tij. Një gjë e tillë është e lidhur ngushtë me faktin se janë pikërisht aktivitetet argëtuese, marrëdhëniet dhe raportet që krijohen nëpërmjet këtyre aktiviteteve, shtysë kryesore motivuese në drejtim të kësaj larmie dhe shumëllojshmërie të konsiderueshme të funksionit social të argëtimit. Individët dhe grupet e ndryshme sociale gjatë aktivitetit të tyre normal jetësor e ndjejnë domosdoshmërinë e realizimit të aktivitetit të tyre relaksues apo rekreativ. Një situatë apo aktivitet i tillë buron nga diçka e përgjithshme jetësore, që individi apo grupet sociale nuk mundën vetëm të punojnë apo të banojnë, por edhe të argëtohen. Ato kanë nevojë të shkojnë në një shfaqje të caktuar, koncert, teatër, opera, për të parë një galeri arti, të shkojnë në kafetari apo restorant, pub apo disko, për të qëndruar vetëm apo me të tjerë. Njëkohësisht ato ndiejnë edhe domosdoshmërinë e ndjekjes edhe të aktiviteteve të ndryshme sportive t'i shohin apo të ushtrjnë vetë llojet e ndryshme të sportit.

Nga tërësia e këtyre elementeve që përmëndëm më sipër evidentohet edhe roli gjithnjë e më intensiv në jetën sociale të shoqërisë të funksionit social të argëtimit. Në të njëjtën kohë një situatë e tillë sociale tregon dukshëm edhe tiparin karakteristik të funksionit social të argëtimit që është shumëllojshmëria e larmia e tij. Një gjë e tillë është mjaft e evidente në tërësinë e hapësirave socio-gjeografike të Shqipërisë, si në ato urbane, ashtu edhe në ato rurale, pavarësisht dimensionit të shfaqjes dhe shtrirjes.

Individët dhe grupet sociale gjatë aktivitetit të tyre argëtues krijojnë marrëdhënie e raporte të ndryshme me njëri-tjetrin, lidhje e komunikim më të ngrohtë me familjarët e tyre, me individët e tjerë brenda një grupi të caktuar social ose edhe jashtë tij. Njëkohësisht ato bëjnë të mundur edhe krijimin e relacioneve me njëri-tjetrin në drejtim të miqësisë, dashurisë, biznesit të tyre, etj., duke e kthyer këtë funksion social në një element tepër të rëndësishëm në vetë jetën sociale të shoqërisë.

Në pasurimin e vazhdueshëm të aktivitetit social, të funksioneve sociale, një rol gjithnjë e më të rëndësishëm po marrin edhe tërësia e elementeve që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik e social, potencialet dhe resurset natyrore, traditën dhe historinë e hapësirave të ndryshme socio-gjeografike. Elemente të tillë kanë ndikuar dukshëm edhe në shpërndarjen gjeografike të vetë funksionit social të argëtimit, i cili shfaq tipare jouniforme në hapësira të ndryshme socio-gjeografike të vendit tonë.

### **Tendenca dhe perspektiva e vendeve dhe funksionit social të argëtimit**

Lidhja e ngushtë e funksionit social të argëtimit dhe vendeve sociale të argëtimit me jetën dhe aktivitetin e njerëzve në Shqipëri, ka bërë të mundur që një aktivitet i tillë i dyanshëm të marrë një rëndësi të konsiderueshme nga studiuesit e ndryshëm. Në mënyrë të veçantë sot po evidentohen tendenca të rëndësishme, të cilat po orientojnë edhe ecurinë e vendeve sociale të argëtimit dhe funksionit social të argëtimit. Një gjë e tillë shihet ngusht edhe në kuadrin e zhvillimit perspektiv të vetë hapësirës socio-gjeografike të Shqipërisë në përgjithësi, dhe hapësirave të veçanta të saj në veçanti. Më poshtë po mundohemi të trajtojmë disa nga tendencat që njohin vendet dhe funksioni social i argëtimit në Shqipëri.

Një nga tendencat kryesore të tyre në Shqipëri ka të bëjë me faktin e rritjes numerike gjithnjë e më shumë të vendeve sociale të argëtimit. Gjithnjë e më tepër po evidentohet tendenca që në hapësira të ndryshme socio-gjeografike, qendra urbane apo rurale, të shohin si element të rëndësishëm të jetës së tyre edhe vendet sociale të argëtimit. Këto vende sociale, masiviteti i tyre dhe roli që ato luajnë ka bërë të mundur gjallërimin e jetës sociale të hapësirave të ndryshme socio-gjeografike. Ajo çfarë duhet përmendur ka të bëjë me faktin se ky karakter masiv gjithnjë e më shumë po përfshin jo vetëm qendrat e mëdha urbane, por edhe hapësirat më të vogla urbane dhe ato rurale. Shembuj konkretë janë të shumtë në tërësinë administrative të vendit.

Karakteret masiv i vendeve sociale të argëtimit në Shqipëri po lidhet gradualisht edhe me të ardhurat e konsiderueshme që po përftohen nga këto vende sociale. Një element i tillë i leverdisë ekonomike që bartin në vetvete tërësia e vendeve sociale të argëtimit paraqet një tendencë gjithnjë e më rritje, që biznesi të shohë një aktivitet të tillë si mjaft të leverdisshëm. Prandaj tendenca aktuale e mjaft shoqërive tregtare është investimi në drejtim të vendeve sociale të argëtimit. Sot janë të shumta kafetë, restorantet, sallat e lojërave e qendrat e ndryshme sportive apo salla lojërash kudo në Shqipëri. Gjithnjë e më tepër po vihet re një lidhje e ngushtë reciproke ndërmjet biznesit dhe vendeve sociale të argëtimit.

Një tendencë tjetër mjaft e spikatur në kuadrin e vendeve dhe funksionit social të argëtimit ka të bëjë me rritjen e konsiderueshme të fluksit të individëve e të grupeve sociale, që frekuentojnë këto vende sociale. Si rezultat i frekuentimit të këtyre vendeve sociale, si: kafene, restorante, salla lojërash, salla koncertesh, disko, pube, të cilat janë të përmasave të ndryshme, evidentohet në tërësinë e hapësirës socio-

gjeografike një gjallërim e pasurim i jetës sociale të saj, për faktin e marrëdhënieve e raporteve të reja që krijohen në këto vende sociale argëtimi. Vlerësojmë se përhapjen më masive këto vende sociale i kanë të përqendruara kryesisht në qendrat e mëdha urbane, si: Tirana, Shkodra, Durrësi, Vlora, Elbasani, Fieri, Vlora, etj. Njëkohësisht lidhur edhe me përqendrimin më të madh të popullsisë në këto qendra urbane, përlllogaritet edhe frekuentimi me fluks me të lartë individësh në to.

Një tendencë tjetër e rëndësishme lidhet me faktin e pasurimit të funksionit social të argëtimit. Krahas aktiviteteve tradicionale gjithnjë e më tepër po vihen re aktivitete të reja argëtuese për individët dhe grupet sociale. Krahas teatrove apo koncerteve të zakonshme e tradicionale, ndeshjeve sportive të llojeve të ndryshme, kafeve apo restoranteve tradicionale, gradualisht po lindin aktivitete të reja të karakterit muzikor, artistik, sportiv, etj., me qëllimin e vetëm argëtimin e tyre. Lloje të ndryshme lokale e hapësirash gjeografike (kalatë e ndryshme në Durrës, Shkodër, Sarandë), ku performohet muzikë e llojeve të ndryshme, salla lojërash e kazino të përmasave bashkëkohore, palestra e qendra të vogla e të mëdha estetike e fitness, po njohin gjallërim të konsiderueshëm, në mënyrë të veçantë në hapësirat socio-gjeografike urbane, të tilla, si: Tiranë, Vlorë, Durrës, etj.

Një tendencë tjetër lidhet me imazhin gjithnjë e në rritje që muzikologë e aktorë, personalitete të rëndësishme të jetës kulturore në Shqipëri, po promovojnë organizimin gjithnjë e në rritje të mjaft eventeve ndërkombëtare në fusha të ndryshme të muzikës, baletit, arteve figurative, etj. Si të tilla mund të përmendim festivalin ndërkombëtar të muzikës operistike “*Marie Kraja*”, festivalin ndërkombëtar të teatrove në qytetin antik të Butrintit në Sarandë, aktivitetet e ndryshme të bukurisë, performancat e pasarelave të ndryshme, aktivitetet ndërkombëtare të hedhjeve me parashutë në qafën e Llogarasë në bregdetin e Jonit, etj.

#### LITERATURA:

1. Axhemi, Sokol (1999): *Shkodra Turistike*, Shkodër.
2. Axhemi, Sokol (2007): *Gjeografia e popullsisë dhe e vendbanimeve. Tekst mësimor universitar*, Tiranë.
3. Axhemi, Sokol (2008): *Gjeografia Sociale. Tekst mësimor universitar*, Tiranë.
4. Axhemi, Sokol (2000): *Aspekte historike dhe aktuale të turizmit në Shkodër. Seminari Ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”*.
5. Yzeiri, Egerem (2005): *Gjeografia politike. Tekst universitar*, Tiranë.
6. Draci, B., Doko, Dh. & YZEIRI, E. (2001): *Gjeografia Humane. Tekst mesimor universitar*, Tiranë.

7. Karaguni, M. & Dumani, B. (2006): *Tirana. Reliev ekonomik, demografik e social. Monografi*. Tiranë.

The evolution of social space and perspective in Albania.  
Tendencies of entertainment in the future

**SUMMARY**

In the context of different geographical studies, especially of human character, point of view on social topics, not only is getting more and more reflection, but simultaneously increase the analytical nature of their treatment. Besides sociogeographic studies realized for space, features, and its features, the social groups that operate in this sociogeographic spaces, role in changing and transforming it, interest is increasingly taking the scientific analysis that is oriented towards the contribution that we give a sociogeographical certain space, social places and social functions. The orientation towards their study appears interesting from the scientific point of view in two directions. First relates closely to the fact of continually expanding the geographical discipline, namely the social geography, the study of social topics. Secondly, countries and social functions, represent today one of the most vulnerable elements and usable in their activity by social groups in different sociogeographical spaces, which has grown immensely the importance of their study.

Besides the basic social functions and places of residence, production, exchange and power, range and those of entertainment. Places of entertainment and social functions, especially during the last century and today, appear quite complex in terms of their content, very intense evolution of their transformation, diversity and increasing enrichment. Plenty of features identified these features appear in the context of their geographical distribution, we allocated sociogeographical space.

Given such a view have made efforts to provide the material following an analysis of domestic and social function of entertainment in our country. Our country definitely sociogeographical presents interesting features and features not only in its entirety, but also in the context of geographical distribution. The evolution of closely related undergone different periods of the progress of the Albanian society has left its traces even in terms of entertainment activity, although its basic feature, is continuously enriching it. Such a thing is closely related to the fact that social groups feel the necessity of cultivating the taste for music, painting, art in general, sports and others. All these activities they wish to pursue in



diverse places, social, concert halls or theater, or opera halls and sports stadiums sports palaces.

Ardita REÇI, Artan REÇI

## A ËSHTË I MJAFTUESHËM PLURALIZMI I MEDIAVE PËR NJË KOMUNIKIM POLITIK FUNKSIONAL NË DEMOKRACINË TONË?

Arritja e të drejtës universale të votës në shumicën e shoqërive shkoi paralelisht me revolucionin teknologjik në mjetet e komunikimit masiv, si shtypi, pastaj filmi, radioja dhe televizioni, që u bënë të përdorshme në audiencat masive.<sup>552</sup> Veçanërisht qysh prej viteve 1950 dhe pas përhapjes së televizionit, në pothuajse çdo familje në botën e zhvilluar kapitaliste, komunikimi ndërpersonal u shmang në cep të procesit demokratik. Në ditët e sotme, siç thotë Colin Seymour-Ure: “*Televizioni është bërë një pjesë integrale e mjedisit brenda të cilit zë vend jeta politike*”. Studimet tregojnë se për shumicën e njerëzve, media, përfshirë tani edhe internetin, rëndësia e të cilit rritet me çdo ditë e më shumë, përfaqëson burimin kryesor për informacionin e tyre rreth politikës.

Por, a e siguron media e sotme pluraliste dhe e shumëllojshme përcjelljen e mesazheve të sakta politike? A është media e sotme pluraliste një tregues i komunikimit politik funksional? Lidhur me këto pyetje mendojmë të ngremë për diskutim hipotezën se, pluralizmi i mediave nuk mjafton për realizimin e një komunikimi politik funksional në rastin e demokracive si ajo e Shqipërisë. Ne mendojmë që së pari duhen trajtuar konceptet, si: *mediat në demokraci, pluralizmi i mediave dhe komunikimi politik funksional në demokraci*.

### Mediat në demokraci sipas McNair

I pari koncept për t’u trajtuar është ai i mediave në demokraci, për të cilat Brian McNair në librin e tij “Hyrje në komunikimin politik”<sup>553</sup>, i jep pesë funksione të medias së komunikuar në shoqëritë moderne të tipit ideal:

<sup>552</sup> McNair, Brian, 2009, *Hyrje në komunikimin politik*, botimi i katërt, UET-Press, f. 35.

<sup>553</sup> McNair, Brian, 2009, *Hyrje në komunikimin politik*, botimi i katërt, UET-Press, f. 33-34.

1. Ato duhet t'i informojnë qytetarët se çfarë ndodh përreth tyre (atë që mund ta quajmë “mbikqyrje” ose “monitorimin e medias”). 2. Ato duhet të edukojnë përsa i përket kuptimit dhe domethënies së fakteve (rëndësia e këtij funksioni shpjegon seriozitetin me të cilin gazetarët e mbrojnë objektivitetin e tyre, përderisa vlera e tyre si edukatorë presupozon një këndvështrim profesionist për problemet që analizohen). 3. Media duhet të sigurojë një platformë për diskutim politik publik, për ta lehtësuar krijimin e opinionit publik dhe për t'i ushqyer atë opinion sërish publikut, prej nga erdhi. Kjo duhet të përfshijë përgatitjen e hapësirës për shprehjen e mendimeve të ndryshme, pa të cilat nocioni i konsensusit demokratik do të ishte i kotë. 4. T'u bëjë publicitet institucioneve qeveritare dhe politike – roli i gazetarisë si qen roje, i ilustruar me shembullin e medias amerikane gjatë episodit të Watergate. 5. Media në shoqëritë demokratike shërben si një rrugë për avokatinë e pikëpamjeve politike.

Partitë kërkojnë një rrugëdalje për të artikuluar politikat dhe programet e tyre tek një audiencë masive, ndaj edhe media duhet të jetë e hapur për ta. Për më tepër, meqë mediat, kryesisht në sektorin e shtypit, do t'i bashkohen aktivisht njëres apo tjetres parti në kohëra të ndjeshme, siç janë zgjedhjet. Sipas këtij kuptimi të fundit, funksioni avokator i medias mund të kuptohet edhe si një funksion bindës. Këtu gjen filluesin edhe shpjegimi i konceptit të pluralizmit të mediave (më konkretisht për pluralizmin e mediave në Shqipëri, do t'i referohemi studimit të Ilva Tares, botuar në revistën *Polis*, nr. 8, Dimër, 2009)<sup>554</sup>.

### **Pluralizmi i mediave në Shqipëri**

Shqipëria është një nga vendet e llojit B, sipas klasifikimit të raportit të Bankës Botërore (2002), çka nënkupton se ritmi i reformave demokratike është shumë më i ngadaltë, për shkak të regjimeve të përqendruara dhe transformimit të paplotë paskomunist (Jakubowicz, 2005). Faji i kësaj situate sipas Tares rëndon mbi kornizën ligjore, duke u shprehur se tregu i televizioneve shqiptare ka qenë në krizë për shkak të një kornize ligjore kaotike (i pari ligj i vërtetë për radion dhe televizionet u miratua nga Parlamenti vetëm 8 vite pas rënies së komunizmit (1998), dhe ishte kaq i papërshtatshëm, sa pati nevojë për ndryshime të vazhdueshme gjatë viteve në vijim).

---

<sup>554</sup> Tare, Ilva, *Shpërthimi i kanaleve televizive private në Shqipërinë pas komuniste*, *Polis* 8, Dimër 2009, f. 29.

Përsa i përket rregullimit institucional ligji rregullator është ende tepër larg zbatimit, dhe ndërhyrjet politike, bashkë me tregun ekonomik joformal, kanë lejuar që Shqipëria të jetë një parajsë veprimesh të paligjshme. Pronarët e televizioneve nuk janë përpjekur të marrin licencë para se të nisnin transmetimet. Shteti ishte i dobët dhe njëkohësisht i paimteresuar t'i kontrollonte, me shpresën se do të përdorte punët e tyre “*të pista*” për të mbajtur marrëdhënie të mira mes kanaleve televizive dhe politikanëve. Si pasojë, biznesmenë të pasur, të cilët kishin fituar pasuri në sektorë të tjerë, vendosën të përfitojnë nga situata duke investuar në industrinë transmetuese, në mënyrë që të mbronin bizneset e tyre parësore nga trysnitë qeveritare.

Në një situatë të tillë, është krejt e kuptueshme se zinxhiri i komunikimit politik nuk është lidhur drejt. Informacioni shkon përmes duarve të biznesmenëve të mëdhenj, të cilët nga ana tjetër ndikojnë deri edhe në qëndrime të caktuara politike. Në studimin e saj, Tare vazhdon me konkluzionin se “*nga kjo “martesë e gabuar” ndërmjet interesave të pronarëve të medias dhe përfitimeve të politikanëve, humbësit e vërtetë ishin njerëzit, të cilëve iu ofroheshin produkte të prera sipas logjikës se, një stacion televiziv përdoret si mburojë dhe shigjetë. Në këtë mënyrë, nuk është e rastësishme që, në dallim nga vende të tjera ish komuniste, investimet e huaja mungojnë në tregun shqiptar dhe se tregu televiziv shqiptar ende besohet të jetë i paaftë dhe i kotë në sytë e investitorëve*”<sup>555</sup>.

Nga më sipër kuptohet qartë se studimi i ambientit mediatik të një vendi ka lidhje të drejtpërdrejtë me grupet e biznesit, prej të cilëve varet shumë herë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe politika. Dhe një ambient i tillë kushtëzon edhe komunikimin politik funksional.

### **Komunikimi politik në Shqipëri**

Realizimin e drejtë të komunikimit politik në Shqipëri e lidh me pronësinë e medias edhe studiuesja Ilda Londo<sup>556</sup>, studimi i së cilës na ndihmon edhe në përcaktimin e saktë të termit “*komunikim politik funksional*”, siç kemi pretenduar në fillim të kësaj teme. Në përgjithësi skicimi i skemës së pronësisë në peizazhin e medias shqiptare nuk është një detyrë e lehtë, duke pasur parasysh infrastrukturën e dobët të sistemit të të

<sup>555</sup> Tare, Ilva, *Shpërthimi i kanaleve televizive private në Shqipërinë pas komuniste*, Polis 8, Dimër, 2009, UET-Press, Tiranë, f. 29.

<sup>556</sup> Londo, Ilda - *Pronësia e medias dhe ndikimi i saj në pavarësinë dhe pluralizmin e mediave*, Polis 8, Dimër, 2009, UET-Press, Tiranë, f. 32.

dhënave në këtë fushë, si dhe mangësitë ligjore që mund të çojnë në fshehjen e pronësisë. Mund të thuhet se pronarët e medias kanë një prejardhje nga biznesi dhe kanë vazhduar të kujdesen për bizneset e tyre; për më tepër, i kanë shtuar ato. Megjithëse peizazhi i medias është mjaft i pasur përse i përket numrit të organeve mediatike, në mënyrë pothuajse jo të natyrshme madje, është e mundur të gjesh grupet dhe aktorët kryesorë mediatikë. Megjithatë, thelbi i çështjes nuk qëndron te pronësia si e tillë, por te financimi i medias dhe te transparenca e saj. Pikërisht për këtë arsye, pyetja se si është e mundur që një numër kaq i madh mediash të vazhdojë të funksionojë në një treg kaq të vogël, ende qëndron në skenën e medias shqiptare. Në këtë sens, numri i madh i gazetave dhe televizioneve në Shqipëri ia detyrojnë ekzistencën e tyre kryesisht financimit nga biznese paralele dhe mungesës së transparencës së këtyre burimeve financuese. *“Nga pikëpamja profesionale, ky financim paralel i lë mediat të zbuluara ndaj presionit ose censurës së bizneseve që i mbështesin ato, disa më shumë se të tjerat. Ky tipar i peizazhit të medias, padyshim që lë gjurmën e tij në informacionin që i përçohet publikut, ku janë interesat e pronarëve dhe jo ato të publikut që vendosin rendin e ditës”*. Media jonë është tjetërsuar dhe nuk ka qenë një roje e ndershme dhe e pavarur; ajo është keqpërdorur. Për pasojë, transparenca rreth pronësisë së medias, aktivitetit të saj, si dhe ndikimit të publiku, mbeten ende nevojë kyçe për zhvillimin e pluralizmit dhe pavarësisë së medias.

### **Një rrugë e mundshme për shpëtimin e komunikimit politik**

Sociologët e shquar Seymour Martin Lipset dhe Francis Fukuyama, që kanë folur në lidhje me demokracinë dhe kushtet e realizimit të saj, si kusht të rëndësishëm kanë cilësuar kulturën politike të një vendi. Bazuar në qëndrimin e shprehur prej tyre, mendojmë se gjithashtu edhe realizimi i komunikimit politik funksional lidhet me këtë element të demokracisë.

Idenë e tij Lipset, e ka theksuar duke u shprehur se *“faktori kulturor është shumë i vështirë për t’u manipuluar”*<sup>557</sup>, ndryshe nga institucionet politike që mund të ndryshohen lehtësisht. Kjo mendojmë se duhet njohur shumë mirë nga ana e komunikuesve të programeve dhe risive politike, në mënyrë që zhvillimet me qëllim instalimin e demokracisë, t’i përshtasin me kulturën mbizotëruese në këtë vend.

---

<sup>557</sup> Seymour Martin Lipset dhe Francis Fukuyama, të cituar nga shkrimet e tyre në Course Pack, të përmbledhur nga prof. dr. Fatos Tarifa për lëndën Sociologji Politike e Tranzicionit Demokratik.

Edhe nëse ndryshimet politike mund të bëhen me një akt të thjeshtë formal dhe pa pasoja konfliktuale (siç ndodhi në vendin tonë, ku kalimi i vendit nga një vend monopartiak, në vend pluralist, u bë brenda natës dhe pa gjakderdhje), kultura është shumë e vështirë të ndryshohet.

Pikë së pari, pasi mendojmë se ajo është një gjendje e caktuar e një populli, e akumuluar dhe e mbivendosur në shtresat e saj, për shekuj, është “*karta e identitetit*” të një kombi, ajo që e shoqëron gjithmonë çdo pjesëtar të kësaj bashkësie; pjesë e stereotipizimit të individëve të një kombi. Në këtë vend ku fjala e lirë nuk është ende e garantuar (sipas të dhënave vjetore të “*Freedomhouse*”, edhe në vitin 2010 ne kishim ende një shtyp gjysmë të lirë), ku prona nuk ka shkuar ende në duart e pronarit të saj të ligjshëm, ku partia në pushtet e ka të vështirë të pranojë idenë e rotacionit, ku po shiten pothuaj të gjitha asetet shtetërore, e shumë probleme të tjera, a ka vend të flasim për kulturë politike? Apo për mungesë të kulturës politike?

Mendojmë se kultura politike në Shqipëri është e lidhur ngusht me kulturën mediatike, ose më mirë të themi me kulturën e të shkruarit. Dhe është kjo e fundit garantuese e cilësisë së komunikimit politik dhe jo shumësia e titujve mediatikë. Këtë mendim e mbështesim, jo vetëm tek përvoja ime në media (të shkruar dhe elektronike), por kryesisht tek mendimet e studiuesve, lidhur me problemet kulturore të shtypit, që transportohen drejtpërsëdrejti në komunikimin politik, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv. Kultura politike shkon krah për krah me kulturën e të shkruarit, apo me kulturën e të transmetuarit mediatikisht të mesazheve politike. Në mendësinë e vjetër të regjimit komunist, shtypi, radioja dhe televizioni ishim mjetet e propagandës shtetërore dhe mjetet mbi të cilat shprehej më dukshëm censura e aparatit shtetëror mbi të drejtën e shprehjes dhe lirinë e fjalës.

### **Ndikimi i ndryshimeve politike në kulturën mediatike**

Në fakt, në kohën kur është bërë me ndryshimi i regjimeve, situata ka qenë më ndryshe. Ishte koha e ndryshimeve të vrullshme, ritmi i të cilave u zbeh shpejt duke u pasuar nga zhgënjimi dhe pasiguria. Studiuesit Blendi Kajsiu, Aldo Bumçi dhe Arben Rakipi në studimin e tyre me titull “*Shqipëria në kërkim të demokracisë*”<sup>558</sup>, kanë vlerësuar se “*Rënia e komunizmit në Shqipëri u shoqërua më një krizë morale, shpirtërore dhe*

<sup>558</sup> Kajsiu Blendi, Aldo Bumçi, Arben Rakipi: *Shqipëria në kërkim të demokracisë*, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare,

*kulturore që pasqyrohet te mungesa e besimi, rënia e krenarisë kombëtare dhe e moralit qytetar. Shqipëria u fut në një nga periudhat më të vështira të historisë së saj. Një pështjellim i përgjithshëm mbizotëronte me rënien e komunizmit. Siguria e brendshme mungonte, ndërkohë që vendi po përjetonte një dislokim të mprehtë ekonomik, që solli varësi të plotë tek asistenca e huaj, këto fenomene ishin më të theksuara në rastin e Shqipërisë, sesa në vendet e tjera ish-komuniste dhe si rezultat i një regjimi më të ashpër që kish përjetuar vendi”.* Autorët rreshtojnë efekte që pasuan:

1. Humbja e krenarisë dhe moralit kombëtar
2. Ndarja shoqërore që rrjedh nga e kaluara komuniste
3. Individualizmi antibashkëpunues
4. Identifikimi i partisë me shtetin

Lidhur me efektet dhe ndihmesën e medias mbi proceset e demokratizimit në Shqipëri në të njëjtin studim gjejmë vlerësimin: *“Ndihmesa e medias ka qenë e dukshme mbi proceset e demokratizimit të vendit dhe të vlerësuara në dekadën e parë të tranzicionit. Dalja e shtypit opozitar në fund të viteve nëntëdhjetë ka qenë një ngjarje historike për shqiptarët, nëse krahasohet kjo me bunkerin stalinist të Hoxhës”.* Media, sidomos shtypi i shkruar dha një ndihmesë të shquar në proceset demokratike në fillimet e tranzicionit, ku shërbeu edhe si një tribunë e debateve dhe për uljen e tensioneve sociale. Në faqet e shtypit opozitarët thanë të vërtetat e komunizmit që i ishin fshehur publikut, *“u bënë edhe gjyqe”*, e si të thuash hakmarrja u zhvillua në formën e polemikave në shtyp dhe jo në rrugë në mënyrë të dhunshme. Më vonë pati tendenca që reflektonin mentalitetin komunist dhe u synua kontroll politik mbi shtypin. Në mënyrë të veçantë mbi kanalën televiziv kombëtar shtetëror ku administrata e re ruajti kontrollin duke mos i lënë hapësirë opozitës.

### **Televizioni publik, “pasqyra” e kulturës së publikut ...**

TVSH është interesant në fakt. Megjithëse tashmë është një stacion publik, që do të thotë se të ardhurat e tij nuk xhirohen më nga buxheti i shtetit (me përjashtim të një përqindjeje të vogël), por burojnë nga taksat e publikut, ky televizion nuk është në shërbim të publikut, por të qeverisë, për shkak të mendësisë së vjetër të stafit po të vjetër drejtues të këtij televizioni, të cilët i përshtaten më së miri të gjitha ndryshimeve të elitës drejtuese politike, por ama nuk ndërgjegjësohet për trajtimin e problemeve ndaj të cilave është më i ndjeshëm publiku. Kjo për mendimin tonë është shprehje e drejtëpërdrejtë e mungesës së kulturës mediatike.

Roli i medias si “*pushtet i katërt*”, siç e ka cilësuar edhe Zimo Krutaj<sup>559</sup> është i pazëvendësueshëm në transformimet demokratike të një shteti dhe mund të gjenerojë kulturë në dy aspekte kryesore a) respektimi i publikut dhe b) respektimi i etikës profesionale; të cilat shpesh thyhen si në rastet që sipërcituam. Autori kërkon nga dhënësit e lajmit kritere profesionale bashkëkohore, të shoqëruara me nivelin e duhur kulturor në gjuhën shqipe, leximin, drejtshqiptimin e saj, si dhe komunikimin e natyrshëm, logjike të besueshëm gjatë përcjelljes së lajmit për teleshikuesit. Gjithashtu i njëjti autor thekson se kultura shprehet edhe në mënyrën se si trajtohet organikisht një lajm, renditjen e fakteve dhe tendencën për të mos shkuar më larg se deri tek lajmi. Mungesë kulture të shprehur me mungesë respekti ndaj shikuesve tregohet edhe me transmetimin e pamjeve makabre në oraret e edicioneve informative, të cilat shkaktajnë shqetësim për familjarët dhe janë njëkohësisht thyerje e Kodit të Etikës.

#### **BIBLIOGRAFI:**

1. Kajsiu, Blendi; Aldo Bumçi, Arben Rakipi (2001): *Shqipëria në kërkim të demokracisë*, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë.
2. Kodi etik shqiptar i gazetarit.
3. Krutaj, Zimo, në “Fletore e Demokracisë”, botim elektronik i OSBE për Shqipërinë
4. Londo, Ilda (2009): *Pronësia e medias dhe ndikimi i saj në pavarësinë dhe pluralizmin e mediave*, në Polis 8, UET-Press, Tiranë.
5. McNair, Brian (2009): *Hyrje në komunikimin politik*, botimi i katërt, UET-Press.
6. Raporti vjetor i Freedomhouse për Shqipërinë, për vitin 2010.
7. Seymour Martin Lipset dhe Francis Fukuyama, të cituar nga shkrimet e tyre në Course Pack të përmbledhur nga prof. Fatos Tarifa për lëndën Sociologji Politike e Tranzicionit Demokratik.
8. Tarifa, Fatos (2006): *Në kërkim të legjitimitetit dhe venitja e utopisë*, UET Press, Tiranë.
9. Tare, Ilva (2009): *Shpërthimi i kanaleve televizive private në Shqipërinë pas komuniste*, në Polis 8, UET Press, Tiranë.

---

<sup>559</sup> Krutaj Zimo: në *Fletore e Demokracisë*, botim elektronik i OSBE për Shqipërinë.



**Is it sufficient for a plurality of media functional political communication in our democracy?**

*SUMMARY*

The achievement of universal suffrage, in most societies went hand in hand with the technological revolution in mass media, such as print then film, radio and television, which became accessible to mass audiences. Particularly since 1950 and after the spread of television, in almost every household in the developed capitalist world, interpersonal communication was averted at the corner of the democratic process. Nowadays, says Colin Seymour-Ure: "Television has become an integral part of the environment within which political life takes place". Studies show that for most people, the media now including the internet, whose importance grows with each day more, represents the main source of their information about politics. But whether today's pluralistic media provide diverse and accurate transmission of political communication? Regarding these questions I raise for discussion the hypothesis that: The media pluralism is not enough for the realization of a functioning political communication in the case of democracies like Albania.

**Pranvera SKANA**

## **SHTYPI LOKAL, NJË MANGËSI E DOMOSDOSHME PËR MEDIAN SHQIPTARE**

### **Vështrim historik mbi lindjen e shtypit të shkruar lokal në Shqipëri (vitet 1891- 2006)**

Shypi lokal në Shqipëri zë fill me revistën e “Elcija i zemrës t’Jezu Kristit”, e përmuajshme fetare e klerit katolik, që nisi të botohej në Shkodër në Mars të vitit 1891. Zaptuesit osmanë e lejuan daljen e kësaj reviste, në kuadër të lëshimeve që bëri qeveria e Stambollit për religjозin kristian. Ishte koha, kur shtypi shqiptar dhe ai në gjuhën shqipe botohej jashtë Shqipërisë së okupuar nga Turqia. E dyta gazetë e natyrës lokale do të botohej në Korçë më 10 Korrik 1909, gazeta e përdyjavshme “Lidhja Orthodoxe”, organ politik fetar dhe letrar, që pas disa muajsh, do të shoqërohej nga vjetari “Kalendari Korça”. Në vitet 1910- 1912, përsëri nën sundimin otoman, u lejuan të botohen edhe 5 organe shtypi: gazetat “Shkodra” (1909-1910) dhe “Koha” (“Bashkimi”, 1 Janar 1910) në Shkodër, “Tomorri”, gazetë politiko-letrare, që doli në Elbasan më 10 Mars 1910, e përvjetorja politiko-letrare “Koha” në Korçë (1 Shkurt 1911) dhe “Kalendari i Vjetës” (Shkodër, 1911). Këto të përkohshme pasqyronin kryesisht ngjarje dhe probleme fetare apo edhe politiko-shoqërore me karakter lokal. Vetëm “Koha” e Mihal Gramenos, që botohej si vijim i gazetës me të njëjtin emër, që ishte botuar disa vjet në Amerikë, merrej në një farë mase edhe me probleme, që i kalonin caqet e rajonit të Korçës. Gazetat e revistat që u përmendën më sipër i përkasin periudhës së Rilindjes. Deri tani ende nuk kemi një studim të plotë për historinë e shtypit lokal. Në qoftë se si periudhë të parë të shtypit lokal në Shqipëri do të pranohet dhjetëvjeçarit e fundit të Rilindjes, periudhë e dytë do të vinte pas shpalljes së pavarësisë, vitet 1913-1920. Gjatë këtyre viteve u botuan 16 të përkohshme në Shkodër, gjashtë në Korçë, gjashtë në Vlorë, dy në Tiranë, tre në Durrës, dy në Gjirokastër dhe dy në Elbasan.<sup>560</sup> Ndonëse

<sup>560</sup> Boriçi, H. “Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare”, (1848-1907), Tiranë, 1997, f. 75.

gazetat e revistat botoheshin në qytete të ndryshme të Shqipërisë ato me informacionin, tematikën dhe problematikën e tyre bënë përpjekje të dalin jashtë qyteteve dhe rajoneve përkatëse.

Periodha e tretë mund të konsiderohet ajo e viteve 1921-1924, kur shtypi lokal kishte fituar pjekuri dhe shërben si bazë për shtypin qendror, me të cilin bashkëjeton. Pas vitit 1925 fillon e merr hov shtypi qendror në Tiranë. Ndonëse krahas tij dalin e shihen të përkohshme lokale, përsëri vëmendja përqendrohet në gazetatat e revistat e Tiranës. Shtypi lokal e rajonal bashkëjeton disi edhe në periudhën e Luftës II Botërore, nga zaptimi fashist i Shqipërisë deri në çlirimin e saj (1939-1944), por përsëri mediat lokale janë në rënie.

Në vitet e para pasçlirimit numri i gazetave lokale ishte i kufizuar. Kështu edhe vijoi deri në fund të vitit 1991, kur marrin hov e zhvillim proceset demokratike. Gjatë viteve 1970-1991 në çdo rreth të Shqipërisë u krijuan dhe dolën gazetatat lokale, si organe të komiteteve të partisë. Edhe numri i radiove lokale ishte i kufizuar në disa rrethe, si: Shkodra, Kukësi, Vlora, Gjirokastra dhe Korça.<sup>561</sup> Vitet e para të periudhës së tranzicionit u karakterizuan nga një bum gazetash e revistash edhe në qytete rrethet e ndryshme të vendit. Por sipas kritikut letrar Adriatik Kallulli, i intervistuar për këtë artikull, rrëfen se shtypi i vërtetë lokal fillon në Shqipëri pikërisht me periudhën e tranzicionit, me ardhjen e demokracisë, ku qytetet themelore të vendit, gazetarët dhe vetë popullata e panë të nevojshme të thuhet e vërteta e të japë informacionin e pastër. Në këtë pikëpamje sipas tij, ka disa gazeta të konsoliduara, në rrethe të mëdha të vendit.

### **Karakteristikat e shtypit lokal, si dhe domosdoshmëria e ekzistencës së tij. Shtypi lokal “përballë” atij kryeqytetas**

Sipas orientimit të përgjithshëm, apo rrethit të lexuesve, të tematikës e problematikës, që trajton shtypi ndahet në disa lloje; shtyp politik, ekonomik, letrar, kulturor, sportiv etj. Ndërsa, sipas periodicitetit dhe shtrirjes gjeografike shtypi ndahet në shtyp i përditshëm dhe periodik, shtyp qendror dhe lokal. Këto emërtime nuk kanë të bëjnë thjeshtë me ndërtim sistemesh apo grupim të organeve të masmedias për qëllime praktike. Ato lidhen me brendinë, gjerësinë dhe thellësinë e shtjellimit të problemeve. Shtypi i përditshëm ndryshe nga shtypi lokal ka ngarkesë më të theksuar operative, por në të njëjtën kohë mban qëndrim të shpejtë dhe të

<sup>561</sup> Boriçi, H. “Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare”, (1848-1907), Tiranë, 1997, f. 75.

drejtpërdrejtë për ngjarjet e ditës. Shtypi kombëtar trajton probleme në shkallë kombëtare, çështje, dukuri me shtrirje të gjerë. Shtypi lokal, i qyteteve dhe i komunave merret kryesisht me shqetësimet dhe punët me shtrirje të kufizuar rajonale.<sup>562</sup>

Duhet theksuar se shtypi lokal shërben edhe si një burim i sigurt informacioni për mediat e mëdha, për shkak të afërsisë së ndodhisë së ngjarjes dhe koherencës së saj.

Shtypi lokal është i domosdoshëm, për informimin e komunitetit për të rejat, ngjarjet dhe zhvillimet e ditës, për shkëmbimin e mendimeve për çështje, probleme të kohës, për të luajtur rolin e tij, si oponent autoritar ndaj pushtetit ekzekutiv a lokal dhe pushteteve të tjerë<sup>563</sup>.

Media e shkruar lokale është e rëndësishme sepse bën që të ketë më shumë transparencë për problemet më të prekshme që ka komuniteti. Ajo është më larg politizimit dhe më afër konkretes. Ushtron trysni për të rritur transparencën në institucionet lokale, bën më të ndjeshëm komunitetin dhe drejtuesit, zgjedhësit dhe të zgjedhurit. Shtypi lokal, nxit konkurrencën, pjesëmarrjen në komunikim debatin në fushata, mban në tension realitetin apo edhe të shkuarën, servir perspektivën në komunitet. Kjo gazetari, nxjerr në pah tipa, karaktere, zbut agresivitetin e mentalitetin provincial të trashëguar apo të detyruar për t'u përshtatur në mungesë të gazetës lokale. Ekzistenca e shtypit lokal shqiptar motivohet të ekzistojë, pasi mediat lokale janë të nevojshme, si pjesë tërësore e medias kombëtare, jo thjesht plotësuese të saj. Rëndësia e këtij shtypi lokal është sepse, ashtu siç mund t'i thonë gjërat njerëzit që i jetojnë dhe kanë parë ngjarjet e jetës së tyre të përditshme, këtë gjë nuk mund ta raportojë një gazetar i një gazete qendrore, i cili e sheh nga larg një ngjarje, apo nuk ka qenë prezent në të.

Në shtypin qendror nëse shumë gjëra janë mbuluar, fshehur, në atë lokal kanë dalur në shesh shkrime dhe dëshmi të shumta, mbi ngjarje dhe figura të caktuara, për shkak të njohjeve personale dhe afrimitetit që ta mundësojnë vendet më të vogla, se sa metropoli. Kjo gazetari kthehet në një furnitor më të fuqishëm se ai qendror. Shtypi "periferik", ka meritën e madhe se saktëson data, emra, elementë të rëndësishëm të ngjarjeve, të cilat janë deformuar gjatë procesit historik.

Po të bëjmë një panoramë të përgjithshme të medias së shkruar lokale në Shqipëri, ajo nuk zë një vend periferik me shpërndarjen e saj gjeografike, duke i lënë Tiranës statusin e kryeqytetit të medias. Për arsye

<sup>562</sup> Boriçi, H. Gjergji, B. Tirana, G. Ramabaja, S (2003): *Gazetaria. Njohuri të përgjithshme*. Botimi i dytë. SHBLU, Tiranë.

<sup>563</sup> Intervistë me prof. dr. Hamit Boriçin, për këtë artikull, dt. 06.06. 2007.

të ndryshme media lokale vazhdon që të ketë përqendrim në pjesën jugore të Shqipërisë. Që nga fillimet e saj media lokale e pavarur shqiptare e ka pasur gjithnjë e më të vështirë të lëvizë nga pozicioni i saj pothuajse i marginalizuar, për shkak të një morie faktorësh. Për këtë arsye të kuptueshme Tirana, vazhdon të jetë kryeqyteti mediatik.

Konkurrenca e vazhdueshme me median kombëtare nuk e ka ndihmuar aspak media lokale, madje edhe për të mbijetuar. Përkundrazi, shumë nga këto media nuk kanë arritur t'i përshtaten komunitetit ku jetojnë dhe t'i japin karakter lokal veprimtarisë së tyre, në mënyrë që të bëhen pjesë e rëndësishme e tij. Shumë pak dihet për median e shkruar lokale në përgjithësi dhe për nevojat e saj specifike. Media e shkruar lokale përveç vështirësive financiare përballet edhe me mungesën e infrastrukturës në shtypje dhe shpërndarje.

### **Por, çfarë ka qenë dhe ç'është sot shtypi lokal ?**

Sipas kritikut letrar Adriatik Kallulli, shtypi i shkruar lokal, sot është një dritare, një refleksion informativ dhe kronikan i të gjitha ngjarjeve, që ndodhin në “provincën”, apo periferinë shqiptare. Shtypi qendror e ka të vështirë t'i kapë gjurmët lokale, ndoshta edhe për arsye, që i konsideron ato zhvillime të parëndësishme për audiencën qendrore. Shtypi lokal është biografia dhe autobiografia më e madhe dhe e plotë e kohës.

Shqipëria nuk është pa traditë në këtë çështje, sepse po të hedhësh një vështrim, që në fillim të shtypit tonë, që në gazetat e para të vjetra, që kanë mbushur një shekull, aty shohim jo vetëm lajme të një karakteri shumë të rëndësishëm, me karakter botëror, gjithëkombëtar apo për rajonin e Ballkanit, po aty njëherazi thuhet edhe lajme, të cilat i takojnë një hapësire më të vogël gjeografike lokale<sup>564</sup>.

Mund të thuhet me plot gojën se gazeta e famshme e Faik Konicës “Albania”, që botohej në Bruksel nga viti 1897-1906 ka pasur edhe ajo ngjarje dhe elemente të madha për të gjithë Shqipërinë, por edhe për mjedise me të ngushta e më të kufizuara. Prandaj shtypi lokal, nuk lindi mbi një boshllëk apo si një vakum, por lindi si një dëshirë e përbashkët e këtyre komuniteteve, mjediseve për të pasur median e tyre dhe pasqyrimin e halleve të tyre. Edhe atëherë kur shtypi lokal thuajse mungonte, kjo “kronikë lokale” ripërtërihej nga njerëz, mësues, intelektualë të kohës, të cilët të ndodhur në vende të izoluar mbanin nëpër ditare sekrete ngjarje të ndryshme, si martesë, lindje, aksidente, ardhjen e njerëzve të shquar në

---

<sup>564</sup> Adriatik Kallulli, kritik letrar, intervistë me dt. 20.05. 2006.

krahinën e tyre, apo ndonjë ndodhi tjetër interesante. Kjo dukuri megjithëse nuk kishte karakterin e një gazete kishte përmbajtjen e një të tilla.

Dëshirat, idetë, mundësitë kur nuk institucionalizohen ato humbasin dhe nuk kanë më vlera. Gazetat lokale, që operonin në Shqipëri kanë një institucionalizim, i cili fillonte që në periudhën e mbretit Zog, ku në vend kishte gazeta lokale që mbulonin një pjesë të mirë të qyteteve. Si për shembull, gazeta lokale për Shkodrën, Korçën, Gjirokastrën, Sarandën, Vlorën, Durrësin, Beratin etj. Në këtë itinerat të hershëm lokal mediatik kanë shkruar edhe pena elitare të kohës. Kjo traditë u vazhdua më tej me shtypin e periudhës së shoqërisë totalitare, ku pothuajse u arrit momenti, që në të gjitha vendet e Shqipërisë të kishte gazeta lokale. Një pjesë e këtij shtypi, e kronikave dhe shkrimeve të asaj kohe, qëndronte më së miri edhe në shtypin qendror. Kjo periudhë në media kishte një karakter informal informacioni. Ky i fundit (informacioni) i fenomeneve negative të jetës provinciale nuk raportohej fare, për shkak të qëndrimit rozë, që ishte e gjithë koha. Në ato gazeta lokale u jepej më shumë rëndësi të ashtuquajturave suksese të mëdha të kohës si në drejtimin ekonomik, në drejtimin harmonik, në drejtimin e familjes së shëndoshë shqiptare dhe në shumë drejtime të tjera shoqërore.

Prandaj, shtypi lokal i asaj kohe në shumë pikëpamje mund të shumëzohet me zero, pasi shpesh herë nuk thoshte apo iu shmangej gjërave të vërteta. Shtypi i kohës ishte i tëri i drejtuar, i frikësuar dhe shumë gazetarë të asaj kohe, të cilët tentonin të thonin më shumë detaje edhe ndëshkoheshin. Një rast të tillë mund të përmendim në gazetën lokale të Peshkopisë, “Ushtima e Maleve” apo “Ushtima e Korabit”, një gazetar ka arritur të shkruajë në vitin 1967-1968 disa artikuj kundra burokracisë së kohës, të cilin për këtë arsye e pushuan menjëherë nga puna. Pra, nga këto arsye në çdo qytet të vendit ka pasur edhe njerëz të viktimizuar për shkak të punës së tyre nëpër këto media.<sup>565</sup>

Njerëzit e gazetarisë së kohës nuk guxonin të përshpërisnin asnjë detaj të së vërtetës së madhe, të vërtetës sistematike të përditshme, nuk mund të thuhej as të mendohej me “zë”.

---

<sup>565</sup> Adriatik Kallulli, kritik letrar, intervistë me dt. 20.05. 2006.

**BIBLIOGRAFI:**

1. Boriçi, H. (1997): "Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare", (1848-1907), Tiranë.
2. Boriçi, H. Gjergji, B. Tirana, G. Ramabaja, S (2003): *Gazetaria. Njohuri të përgjithshme*. Botimi i dytë. SHBLU, Tiranë.
3. Kallulli, A. Kritik letrar, *Intervistë mbi këtë artikull*, marrë me dt. 20.05. 2006
4. Boriçi, H. Studiues i historisë së medias në Shqipëri, *Intervistë mbi këtë artikull*, marrë me dt. 06.06. 2007.

**Local press, an essential deficiency for Albanian media*****SUMMARY***

This article is part of my diploma thesis headed for undergraduate studies, at Journalism Department, University of Tirana. The importance of this paper is constant, because they're few studies for this topic, even today; communication researchers in our country considerate "Local Press" a "Dead press". But which are the issues that will be briefly presented on the following; the article begins with a short historical overview of local press birth in our country, then claims why this "peripheral" media is so important in relation to the national press? What contribution has nowadays? How is local press characterized and how it stands by "Central Press?"

## JETA SHKENCORE

### VEPRIMTARI SHKENCORE

#### KONFERENCË SHKENCORE “SHQIPJA NË ETAPEN E SOTME: POLITIKAT E PËRMIRËSIMIT DHE TË PASURIMIT TË STANDARDIT”

Konferenca shkencore “*Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*” organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, me pjesëmarrjen e specialistëve nga tërë hapësirat shqiptare i zhvilloi punimet, më 15-17 dhjetor 2010 në Durrës, ku u mbajtën rreth 40 referate dhe kumtesa.

Nga Shkodra morën pjesë dhe kumtuan: Artan HAXHI - Tomor OSMANI, *Disa forma shumësi të gjinisë mashkullore*; David LUKA: *A mund të zgjerohet baza dialektore e shqipes standard ?*

Konferencën e karakterizoi niveli i lartë, fryma e tolerancës, diskutimet me kompetencë shkencore.

Në fund konferenca arriti në këto përfundime:

1. *Megjithëse u vendos në një epokë të ngarkuar me ideologji dhe me mungesë të lirisë shkencore, standardi gjatë gjithë këtyre viteve e ka dëshmuar vlefshmërinë e tij.*
2. *Praktika e përdorimit të shqipes standarde në këto dyzet vjet dëshmon se shqipja ashtu si të gjitha gjuhët e lëvruara, ka nevojë që t’i nënshtrohet periodikisht një shqyrtimi shkencor lidhur me funksionimin e sistemit në të gjitha segmentet.*
3. *Është e nevojshme që të shqyrtohen më tej disa rregulla të drejtshkrimit, me qëllim njësimin e tyre dhe shmangien e konflikteve të krijuara si pasojë e zbatimit të dy parimeve të ndryshme njëherësh (atij fonetik dhe atij morfologjik). Në mënyrë të veçantë drejtshkrimi i zanores ë ka nevojë për rishqyrtim.*
4. *Të rishikohet përdorimi i shkronjës së madhe, drejtshkrimi i emrave të huajtë përveçëm, si dhe drejtshkrimi i toponimeve.*
5. *Leksiku i standardit të shqipes të jetë i hapur ndaj prurjeve nga dialektet, sidomos nga dialekti gegë dhe nga autorët e traditës letrare në këtë dialekt. Të vazhdojë puna për pasurimin e leksikut me krijime të reja sipas*



*gjedheve fjalëformuese të shqipes, si dhe për pastërtinë ndaj huazimeve të panevojshme.*

*6. Të thellohet puna për begatimin, njësimin dhe kodifikimin e terminologjisë në të gjitha fushat.*

*7. Në sistemin morfologjik, të rishqyrtohet formimi i shumësit të emrave, për një saktësim të mëtejshëm paradigmatic, duke synuar njësimin dhe shmangien e përjashtimeve të shumta.*

*8. Të studiohet mundësia e integritit të paskajores gege në standardin e sotëm.*

*9. Studimet dhe hulumtimet të jenë të hapura edhe në fushën e sintaksës.*

*10. Nxënia e shqipes në shkollë, në të gjithë hapësirën shqiptare, ka shfaqur vështirësi dhe problem, ndaj propozohet përmirësimi i kurrrikulave, i teksteve, i metodave të mësimdhënies, si dhe aftësimi i mëtejshëm i mësuesve të gjuhës amtare.*

*11. Në konferencë u shfaqën edhe shumë mendime dhe teza të veçanta lidhur me standardin dhe me përdorimin e shqipes. Konferenca dëshmon se debate për çështjet e normës së shqipes dhe të përdorimit të saj është një debat pjellor, i cili e pasuron mendimin gjuhësor shqiptar dhe hap perspektiva studimore dhe kërkimore të domosdoshme për etapen e sotme të zhvillimit të shqipes.*

*12. Krijimi i Këshillit Mbarëkombëtar për gjuhën në statusin e personit publik, mund të jetë një rrugë e mirë për t'u gjetur zgjidhje çështjeve të rëndësishme të politikave gjuhësore të planifikimit të gjuhës dhe të strategjisë për zhvillimin dhe mbrojtjen e shqipes.*

Pasdreke të dt. 17 dhjetor u bë promovimi i dy veprave, botuar nga QSA-ja.

T. Osmani

### **VEPRIMTARI SHKENCORE NË GJERMANI “50 VJET ALBANOLOGJI NË UNIVERSITETIN E MYNIHUT”**

Dega e albanologjisë në Universitetin “Ludwig-Maximilian” të Mynihut është një nga qendrat albanologjike më me traditë në botën evropiane, themeluar nga shkrimtari e studiuesi i njohur Martin Camaj në vitin 1961, i cili e drejtoi atë për 30 vjet me radhë. Këtë vit kjo degë mbushi 50 vjet e me këtë rast u organizua tubimi i 4-t shkencor “50 vjet albanologji në Universitetin e Mynihut”. Ky tubim u mbajt në datat 23-24 qershor 2011 në Gut Schönwag të Bavarisë, mbështetur nga fondacioni Nehemia dhe Rrjeti Ndërkombëtar i Albanologjisë INA.

Historiku i kësaj dege nis me Camajn, por këtë traditë do ta vazhdonte më pas albanologu i njohur Wielfrid Fiedler e pas daljes në pension të tij, drejtimi i saj do të merrej përsipër nga prof. Rexhep ISMAJLI. Tani ajo drejtohet me profesionalizëm nga prof. Bardhyl DEMIRAJ. Falë një pune të përkushtuar gjatë këtyre viteve janë promovuar disa breza albanologësh, një pjesë e të cilëve kanë bërë sot emër në botën shkencore në përgjithësi e atë albanologjike në veçanti. Aktualisht dega e albanologjisë është pjesë përbërëse e Institutit të Gjuhësisë Krahasuese-Indoevropiane në këtë universitet dhe ka bashkëpunime me shumë qendra albanologjike në kuadrin e shkëmbimit të studentëve, botimeve, aktiviteteve shkencore etj.

Tubimi kishte si qëllim jo vetëm promovimin e arritjeve të këtyre studimeve gjatë këtyre viteve, por edhe sensibilizimin për vështirësitë në të cilat ndodhet sot dega e albanologjisë pas përfshirjes së këtij universiteti në procesin e Bolonjës . Implementimi i tij ka vënë në pikëpyetje ekzistencë e të ashtuquajturat “*gjuhë të vogla*” dhe të ardhmen e albanologjisë, e cila me këtë sistem të ri, rrezikon të humbë fizionominë e saj, të formuar me aq mund e përkushtim gjatë këtyre 50 viteve. Në këtë takim morën pjesë ambasadorët e Shqipërisë e Kosovës.

Ishte pikërisht drejtuesi i kësaj dege prof. Bardhyl DEMIRAJ, i cili bëri një historik të kësaj katedre, duke u ndalur në momentet më të rëndësishme dhe bëri thirrje për ndihmë sidomos në drejtim të një lektori të shqipes.

Në këtë tubim të 4-t morën pjesë 30 albanologë nga 12 vende të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pjesëmarrësit ishin nga disa universitete, të Gjermanisë, Austrisë, Rusisë, Italisë, Kosovës, por edhe nga Amerika. Morën pjesë edhe studiues nga Qendra e Studimeve Albanogjike (Tiranë) dhe Universiteti i Tiranës. Nga Universiteti i Shkodrës morën pjesë prof.dr. Tomor OSMANI dhe dr. Mimoza PRIKU, të cilët mbajtën kumtesën, “*Njësimi i alfabetit dhe i gjuhës së përbashkëtdy probleme gjuhësore parësore të viteve të para të shekullit XX*”. Pas çdo referimi pati diskutime nga pjesëmarrësit, të cilët sqaruan më tej çështjet e shtruar në këtë konferencë.

M. Priku

### KONFERENCË SHKENCORE “MIGJENI I SHEKUJVE”

Me dt. 10 tetor 2011 Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Studimeve Albanologjike, Departamenti i Gjuhësisë dhe ai i

Letërsisë në bashkëpunim edhe me Bashkinë e Shkodrës organizuan konferencën përkujtimore shkencore “*Migjeni i shekujve*”, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit e prozatorit Millosh Gjergj Nikolla (1911-2011). Fjalën e hapjes së kësaj konference e mbajti Rektori i Universitetit të Shkodrës prof.dr. Artan HAXHI, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e përkujtimit të figurave të tilla që kanë kontribuar për kulturën shqiptare e kanë lënë gjurmë në historinë e saj.

Me këtë rast përshëndeti konferencën edhe mbesa e Migjenit, znj. Angjelina CEKA, e cila në fjalën e saj, pasi falënderoi organizatorët e kësaj konference, shprehu dëshirën që me anë të kumtesave të bëhej i mundur ndriçimi e zbulimi i anëve të reja të krijimtarisë së Migjenit. Ajo bëri gjithashtu edhe një panoramë të shkurtër të rrugës që ka ndjekur vepra e Migjenit që nga fillimi deri në botimin e plotë të saj.

Kumtesën e parë me titull “*Prozë-poezia, “Një refren i qytetit tem”*” e mbajti prof.dr. Alfred ÇAPALIKU, i cili u ndal kryesisht në risinë që solli Migjeni në mënyrën e konceptimit të prozës. Prof.dr. Shaban SINANI mbajti kumtesën “*Ikja nga miti i malit*”, i cili bëri fillimisht një historik të këtij miti në letërsinë shqipe e u ndal më pas në veçanti tek konceptimi e pasqyrimi i tij në veprën e Migjenit.

Shkrimtari i njohur Fadil Kraja mbajti kumtesën “*Migjeni pa paraardhës dhe pa pasardhës*”. Ai vuri në dukje faktin se në 300 faqet që përmbledh e gjithë krijimtaria e Migjenit, çdo poezi, prozë e tij ka skicën e një romani. Prof.dr. Tomor OSMANI referoi “*Disa konsiderata rreth gjuhës së Migjenit*”, duke vënë në dukje disa veçori gjuhësore të krijimtarisë së Migjenit. Temën me titull “*Mozaiku i magjishëm migjenian në perspektivën e sotme të leximit*” e mbajti prof. dr. Fatbardha HOXHA, e cila tërhoqi vëmendjen, mes të tjerash, se vepra e Migjenit kërkon një lexues studioz. Dr. Mimoza PRIKU mbajti kumtesën “*Proza e Migjenit në vështrim etnolinguistik*”. Dr. Rrezarta DRAÇINI në kumtesën e saj “*Qemal Draçini për Migjenin*”, solli disa konsiderata të shkrimtarit shkodran Qemal Draçini një pjesë e të cilave të panjohura më parë, marrë nga ditari personal i Draçinit. Vinçens MARKU - Lisandri KOLA lexuan kumtesën “*Soneti: afri dhe dallime formale mes parimësisë së vargëzimit të “Arti poetik” i Bualosë dhe Migjenit*”, bënë një përjasje mes artit të Migjenit dhe atij të Bualosë. “*Prirje morfosintaksore në veprën letrare të Migjenit (prozë-poezi)*”, ishte kumtesa e përgatitur nga prof.as.dr. Tefë TOPALLI-MA. Aida URUÇI, në të cilën u zbuluan disa mënyra të ndërtimit të kohëve dhe të sintagmave, parë kryesisht në prozën e Migjenit. MA. Gëzim PUKA kumtoi, “*Modeli binar shpërthyes i nënës/grua tek proza e Migjenit “Bukën tonë të përditshme falna sot” (vështrim semiotik)*”, duke na sjellë një

vështrim të ri në prozën e Migjenit, në vështrim semiologjik; ndërsa MA. Elindë RAMADANI mbajti kumtesën, “*Krijuesit bashkëkohës për veprën e Migjenit*”. Në fjalën e saj zj. RAMADANI paraqiti me fakte reale se si u prit dhe u vlerësua vepra e Migjenit nga bashkëkohësit e tij. “*Mbi arsyet e “Shkëndisë” Migjen*”, ishte kumtesa e mbajtur nga dr. Valbona KARAKAÇI. Në kumtesën e saj autorja parashtrroi e analizoi arsyet që ndihmuan në lindjen e këtij krijuesi. MA. Ermira ALIJA - Arjeta FERLUSHKAJ mbajtën kumtesën, “*Personazhet për fëmijë në veprën e Migjenit*”, duke ravijëzuar personazhet për fëmijë në krijimtarinë migjeniane.

Kumtesat bënë një panoramë të të gjithë kontributit të Migjenit në lëmin e letërsisë, po u panë edhe disa prurje në rrafshet e tjera si ai gjuhësor, semiotik etj. Disa herë gjatë këtyre kumtesave u theksua fakti se Migjeni ka shkruar me një gjuhë të kuptueshme dhe nuk ka pasur e nuk ka një lexues të kufizuar.

M. Priku

### **VEPRIMTARI SHKENCORE NË TIRANË “GJUHA STANDARDE DHE VARIANTET DIALEKTORE”**

U zhvillua në Tiranë më 24 tetor Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “*Gjuha standarde dhe variantet dialektore*”, organizuar nga Departamenti i Gjuhësisë dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i Universitetit të Tiranës. Konferenca kishte një pjesëmarrje të gjerë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Italia. Të përfshirë në këtë konferencë ishin dhe kumtues nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës. Konkretisht Mimoza PRIKU u prezantua me punimin “*Një vështrim rreth përdorimit të disa leksemave në letërsinë artistike, si prirje drejt variacioneve gjuhësore*”, Tefë TOPALLI dhe Zamira SHKRELI kishin trajtuar temën, “*Disa tregues leksikorë dhe frazeologjikë të variantit të veriut në veprat e fundit në prozë të I.Kadaresë*”, Rrezarta DRAÇINI kumtoi, “*Pjekuria biologjike e individit dhe mundësia e tij për t’u bërë standardfolës i mirë*” dhe Anisa KOSTERI - Aida URUÇI u paraqiten me “*Valenca leksikore në disa lema të fjalorit të Gazullit*”. Konferenca për shkak të pjesëmarrjes së gjerë, pasi ishte ndërkombëtare, u zhvillua e ndarë në tri seanca: *Politikat gjuhësore dhe kultura e gjuhës, Funksione stilistikore të gjuhës standarde dhe të dialekteteve dhe Prurje të varianteve*

*letrare, autorë të traditës dhe të sotëm.* Në fund për rreth një orë u zhvilluan debate dhe diskutime mbi temën bosht të konferencës.

Rr. Draçini

**PROMOVOHET LIBRI I PROF DR. DAVID LUKËS “STUDIME  
PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE”. (Vepër e zgjedhur)**

Në ditën e fundit të Konferencës së Durrësit, më 17 dhjetor 2010 QSA-ja organizoi promovimin e librit “*Studime për historinë e gjuhës shqipe*”, të prof.dr. David LUKËS, përfshirë në Botime albanologjike, recensentë: akademik K. TOPALLI dhe dr. E. PACI, Tiranë, 2010, 552 faqe.

Në parathënien e kësaj vepre prof. LUKA shënon se ajo është një për zgjedhje e studimeve të autorit për historinë e gjuhës shqipe, të kryera gjatë katër dekadave 1970-2010.

Libri është ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin shkrime për 1. Historinë e gjuhës shqipe 2. Fonetikën historike 3. Gramatikën historike 4. Etimologjinë.

Pjesa e dytë titullohet “*Onomastika shqiptare në regjistrat kadastrale osmane të shek. XV*”, ku përfshihen: Regjistri turk i vitit 1431 (Elemente fonetike; elemente vendëse dhe të huaja; Identifikimi dhe lokalizimi i emrave (përkat. Fshatrave); Regjistri turk i vitit 1467; Regjistri turk i vitit 1485; Krahina e Mysjes.

Janë gjithsej 39 studime dhe artikuj të përfshira në këtë vepër.

Fjalën e rastit e mbajti drejtori i QSA-së, botues i veprës, prof.dr. Ardian MARASHI, i cili e çmoj veprën, si një sukses për autorin, i cili merret prej kohësh me studime, kryesisht të diakronisë.

Pastaj diskutuan pjesëmarrës të konferencës, të cilët vunë në dukje vlerat shkencore të këtij botimi, punën që ka bërë autori në fushat që janë përfshirë në këtë vepër, si dhe u ndalën në disa arritje të kësaj përmbledhjeje në rrafshin diakronik. Veprën e konsideruan të arrirë dhe një kontribut që sjell prof.LUKA në studimet e historisë së gjuhës shqipe.

T. Osmani

## LIGJËRATA NË UNIVERSITETIN “FAN NOLI” TË KORÇËS

“Nga data 12 - 15 maj të këtij viti, pedagogu Tefë TOPALLI, me ftesë të Universitetit "Fan Noli" të Korçës, ka mbajtur një cikël ligjëratash në disiplinën "*Sintaksë e gjuhës shqipe*" (nga analiza e përbërësve të periudhës). Kursi i leksioneve është ndjekur me interes jo vetëm nga studentë të degës Gjuhë shqipe - Letërsi, por edhe nga Fakulteti i Gjuhëve të huaja i atij universiteti. Kjo ishte një nismë e drejtores së Departamentit të Gjuhës shqipe, prof. Elona BIBA (Çeçe) për fillimin e bashkëpunimit midis Universitetit të Shkodrës dhe atij të Korçës, nëpërmjet shkëmbimit të ndërsjelltë me pedagogë, konferenca shkencore dhe diskutime programesh për lëndë të ndryshme kurrikulare të katedrave përkatëse.

Z. Shkreli

## MARRJE TITUJSH SHKENCORË

1. Z. Bajram L. XHAFJA iu dha titulli akademik “*Profesor*” me vendim nr. 118, dt. 07.05.2010 të Komisionit të vlerësimit të titujve akademikë.

## BOTIME TË REJA TË UNIVERSITETIT TONË

Ditë më parë në kolanën “Studime shqiptare” u botuan dy përmbledhje kumtesash e studimesh:

1. *Fishta poeti dhe mendimtari kombëtar*, Studime shqiptare 18, Shkodër, 2011, 204 f.

2. *Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi” në 100-vjetorin e tij*, Studime shqiptare 19, Shkodër, 2011, 157 f.

“*Fishta poeti dhe mendimtari kombëtar*” është botim i Universitetit të Shkodrës, Departamenti i Letërsisë.

Kjo përmbledhje përmban referatin e kumtesat të mbajtura në veprimtarinë shkencore me temë “*Fishta poeti dhe mendimtari kombëtar*”, organizuar nga Departamenti i Letërsisë i Universitetit të Shkodrës, me rastin e 70-vjetorit të vdekjes, dhjetor, 2010.

Parathënia, fotografitë e Gjergj Fishtës dhe fjala e hapjes është përgatitur nga prof.as. dr. Ledri KURTI; Materiali vazhdon me përshëndetjen e zëvendësrektorit të Universitetit të Shkodrës prof.as.dr.Fatmir Vadahi si dhe me përshëndetjen e prof.as.dr. Paulina HOXHËS, Dekane e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

Botimi hapet me referatin me titull “At Gjergj Fishta-Prijësi intelektual i dëbuar, i ndaluar, por madhërisht i pashmangshëm për themelet e kombit, gjuhës dhe kulturës shqipe” përgatitur nga Ledri KURTI. Në vazhdim janë përfshirë kumtesat:

Alfred ÇAPALIKU “Fishta për letërsinë e shkruar shqipe”, Dom Nikë Ukgjini “Fishta në dokumente të panjohura”, Shaban SINANI “At Gjergj Fishta për statutet dhe kanunet”, Fatbardha HOXHA “Vepra e Gjergj Fishtës në vështrimin e kritikës”, Mark MARKU “Fishta lirik. Një propozim për rileximin e Fishtës”, Nertila HAXHIA, Ljarja “Kontributi i Fishtës në çështjen shqiptare”, Lili SULA “Receptimi kritik i Fishtës në periudhën 1944-1990”, Vinçens MARKU “Elemente të neoklasicizmit evropian sipas doktrinës së Bualosë në satirën fishtiane përmes veprës “Anzate Parnasit”, Orjeta BAJA, Merita HYSA “Stilema të rrafshit fonetik në poemën epike të Gjergj Fishtës”, Arben PRENDI “Mendimi estetik i Fishtës për folklorin”, Gjovalin ÇUNI & Elindë DIBRA “Roli i Fishtës në shtypin e kohës”, Eleni KARAMITRI “Gjergj Fishta “Bukurija prej se ciles ngallite arti”, Ermira ALIA “Simbolika e “Juda Makabe”si formë alternative didaktike”, Ledri KURTI “Fenomeni “Fishtë”. Vlera e fjalës dhe mendimi i tij teoriko-estetik”.

Mbyllet ky botim me disa foto miqësore nga veprimtaria shkencore.

Në botimin e dytë “Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi” në 100-vjetorin e tij” përfshihen këto shkrime:

Tomor OSMANI “Fjalori i shoqërisë “Bashkimi”-vepër me vlera të rëndësishme leksikografike”, Emil LAFE “Fjalori i shoqërisë “Bashkimi”i vështruar në krahasime Fjalorin K. Kristoforidhit”, Enver HYSA “Larmia e mjeteve dhe e tipave fjalëformues te Fjalori i shoqërisë “Bashkimi”, Kolec TOPALLI, “Fjalori i shoqërisë “Bashkimi dhe etimologjia e shqipes”, Gjovalin SHKURTAJ, “Kahe të mbara fjalëformuese dhe normëthemeluese të Fjalorit të “Bashkimit”, Mimoza PRIKU, “Fjalësi diturak në Fjalorin e shoqërisë “Bashkimi”, Ledi SHAMKU, “Pastë jetë të gjatë më se një shekull!”, Anisa KOSTERI “Frazologjizmat në Fjalorin e “Bashkimit”,

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI “Shtresat stilistikore në Fjalorin e shoqërisë “Bashkimi”,

Shezai RROKAJ, “Disa parime të zbatuara në Fjalorin e “Bashkimit”, Miço SAMARA “rreth vlerave leksikografike të fjalorit të shoqërisë “Bashkimi”, Shefkije ISLAMAJ “U ribotua Fjalori i shoqërisë “Bashkimi”, Karl Gurakuqi “Pesëdhjetëvjetori i Fjalorit “Bashkimi”. Kujtime të reja e të vjetra. Parathënie e Fjalorit, 1908, Ahmet Kelmendi, Dy fjalë me rastin ribotimit, Prishtinë, 1978. A. Xhuvani, Fjalori i

*“Bashkimit” (1911), D.Ndoc Nikaj, Sajimi i një alfabeti të përgjithshëm, A.Pal Doçi, Puna e Doçit dhe e shoqërisë “Bashkimi” në fushën e gjuhës shqipe.*

Z. Shkreli

### **BOTIME TË PEDAGOGËVE JASHTË SHTETIT**

Gjatë vitit 2011, pedagogët e Fakultetit tonë kanë botuar artikuj studimorë në revista shkencore dhe në organe të ndryshme kulturore e shkencore. Botimet janë si më poshtë:

E. DIBRA - Rr. DRAÇINI: *“Il ruolo delle suore stigmatine nello sviluppo dell’istruzione albanese”*, në "Viaggio Adriatico", Aggiornamenti bibliografici sulla letteratura di viaggio in Albania e nelle terre dell'Adriatico. Botuar nga Centro Interuniversitario Internazionale di Studi sul Viaggio Adriatico (CISVA). Romë, 2011.

E. DIBRA - Rr. DRAÇINI: *“Asetet autentike të trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës në funksion të turizmit kulturor”*, Naucni Bilten, Centar Ekonomosko Iztrazivanja-Ulcinj, Ulqin, 2010.

M. PRIKU: *“Vëzhgime rreth disa ndikimeve semantike e morfologjike të shqipes, në fokusin e gjuhësisë kontaktuale”*, Seminari XXIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2011.

M. HYSA - O. BAJA: *“Asimetritë gjuhësore dhe përplasja e kodeve në situatën e bilinguizmit”*, Seminari XXIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2011.

M. HYSA: *“Fonologjia gjenerative dhe shtresëzimet teorike të saj”*, revista shkencore “Filologji”, nr.18, Prishtinë, 2011.

N. LJARJA: *“Kalvari i Kishës Katolike në Shqipëri 1944-1990”*, në X<sup>e</sup> Congres de l’Association internationale u Sud-Est européen (AIESEE) Paris, 24-26 septembre 2009, *“Actes, L’homme et son environnement dans le Sud-Est européen”*. Editions de l’Association Pierre Belon, Paris, 2011, shtator 2011 .

N. LJARJA (ba): *“Imzot Lazer Mjeda në marrëdhëniet mes Kishës Katolike dhe shtetit shqiptar 1925-1935”*, në: Don Ndue Ballabani (ed.), *“Imzot Lazer Mjeda, mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar”*. (Simpoziumi ndërkombëtar mbi jetën dhe veprën e Imzot Lazër Mjedës, si mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar, Zagreb, 14 mars 2009), Prishtinë- St.Gallen-Zvicër 2011.



O. BAJA-M. HYSA: “*Arbërishtja - varietetet gjuhësor më vete nën ndikimin e italianizimeve (në fjalorin “arbërisht-shqip” të Kolë Kamsit)*”, Revista Aktet (Botim i Institutit Albshkenca), Tetovë, 2011.

R. DIBRA: *Poemë*, Semicerchio, Rivista di poesia comparata, Firenze, 2010.

Rr. DRAÇINI - A. HOTI: “*Mediat shqiptare në Mal të Zi - ndikimi i kontakteve gjuhësore*”, Seminari XXIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2011.

S. Laçi - D. Rrustja - E. Caci: “*Shumëllojshmëria e veprimtarive ekonomike si bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendbanimeve rurale, në birgjet e liqenit të Shkodrës-rasti i fshatit Zogaj*”.

Në Konferencën ndërkombëtare mbi liqenin e Shkodrës (organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Malit të Zi), botim special i Akademisë së Shkencave, Podgoricë, 2011.

T. OSMANI: “*Pjetër Bogdani, personalitet i shquar në panteonin e kulturës shqiptare të shek. XVII*”, revista shkencore “Malësia”, nr.6, Podgoricë, 2011.

T. OSMANI, “*Shqipja e Malit të Zi në sfidat e kohës*”, Seminari XXIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2011.

M.Hysa

## LIBRAT E BOTUAR GJATË VITIT 2010-2011

Nga pedagogët e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (Fakulteti i Shkencave Shoqërore) për vitin 2010-2011 janë botuar këto monografi e libra:

1. Bajram XHAFJA, Ribotim i përmirësuar, “*Historia e Shqipërisë. Periudha e Pavarësisë*”, Shkodër, 2009, 370 f.
2. David LUKA, “*Studime për historinë e gjuhës shqipe, vepër e zgjedhur, Botimet albanologjike*”, Tiranë, 2010, 552 f.
3. Ledri KURTI, “*Benardin Palaj dhe Donat Kurti, Kodifikuesit e parë të eposit të kreshnikëve*”, Lezhë, 2011, 110 f.
4. Mimoza PRIKU, “*Carlo Tagliavini dhe studimet albanologjike rreth shqipes*”, Shkodër, 2011, 285 f.
5. Sereta KOPERAJ, “*Pushtimi italian i Shqipërisë dhe qëndrimi i Britanisë së Madhe*”, Shkodër, 2010, 156 f.

- 
6. Rokin DABERDAKU, "*Historia e vjetër e Shqipërisë*", Shkodër, 2010, f.187.
  7. Romeo GURAKUQI, "*Principatat e Shqipërisë dhe mbretëria e Greqisë 1913-1914*", Tiranë, 2011, 254 f.
  8. Tefë TOPALLI, "*Kërkime gjuhësore-1*" Lezhë, 2011, 540 f.
  9. Tefë TOPALLI, "*Kërkime gjuhësore-2*", Lezhë, 2011, 520 f.
  10. Tefë TOPALLI, "*Gjuhësi teksti*", Lezhë, 2011, 400 f.
  11. Tefë TOPALLI, "*Sintaksa e fjalisë (sprovë monografike)*", Shkodër, 2011, 746 f.